

# **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

## **PËR NDËRTIMET**

*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*

**Nëntor, 2010**

© të gjitha të drejtat e Qendrës së Publikimeve Zyrtare

ISBN 978 – 9928 – 01 – 012 - 4

# PËRMBAJTJA

## I. URBANISTIKA

Ligj nr.8405 datë 17.9.1998	Për urbanistikën <i>ndryshuar me</i> - <i>ligjin nr.8453, datë 4.2.1999</i> - <i>ligjin nr.8501, datë 16.6.1999</i> - <i>ligjin nr.8682, datë 7.11.2000</i> - <i>ligjin nr.8982, datë 12.12.2002</i> - <i>ligjin nr.8991, datë 23.1.2003</i> - <i>ligjin nr.9743, datë 28.5.2007</i> - <i>ligjin nr. 9843, datë 17.12.2007</i> - <i>ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009</i> - <i>ligjin nr.10 097, datë 13.3.2009</i> - <i>ligjin nr.10 319, datë 16.9.2010</i>	9
Vendim i KM nr.722 datë 19.11.1998	Për miratimin e rregullores së urbanistikës <i>ndryshuar me:</i> - <i>vendim të KM nr.401, datë 25.6.2004</i> - <i>vendim të KM nr.545, datë 12.8.2004</i> - <i>vendim të KM nr.574, datë 14.7.2010</i>	45
Vendim i KM nr.358, datë 27.5.2001	Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e instalimeve bregdetare, për transportimin dhe depozitimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre	116
Vendim i KM nr.836, datë 3.12.2004	Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë <i>ndryshuar me:</i> - <i>vendim të KM nr.717, datë 22.11.2005</i>	119
Udhëzim i MPVD nr.1, datë 24.1.2001	Për funksionimin e KRRT-ve	123
Udhëzim i MRRTT nr.4, datë 11.8.2004	Për mënyrën e ushtrimit të kompetencës për planifikimin e territorit nga njësitë e qeverisjes vendore	124
Vendim i KM nr.337, datë 16.4.1996	Për forcimin e kontrollit në ndryshimet e rikonstruksionet e ambienteve në ndërtesat ekzistuese në bashkëpronësi	127
Ligj nr.10 119 datë 23.4.2009	Për planifikimin e territorit <i>ndryshuar me:</i> - <i>ligjin nr.10 258, datë 25.3.2010</i> - <i>ligjin nr.10 315, datë 16.9.2010 për miratimin e aktit normativ nr.4, datë 25.8.2010</i>	128
Vendim i KM nr.460, datë 16.6.2010	Për organizimin dhe funksionimin e regjistrit të planifikimit të territorit	173
<b>II. INSPEKTIMI I NDËRTIMIT</b>		
Ligj nr.9780 datë 16.7.2007	Për inspektimin e ndërtimit <i>ndryshuar me:</i> - <i>ligjin nr.10 240, datë 25.2.2010</i> - <i>ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010</i>	179

Udhëzim i MPPTT nr.17, datë 13.8.2007	Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar gjatë periudhës kalimtare të transferimit të përgjegjësiave dhe detyrave në inspektoratet ndërtimore e urbanistike vendore	187
Vendim i KM nr.862, datë 5.12.2007	Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai vendor <i>ndryshuar me:</i> <i>-vendim të KM nr.625, datë 28.7.2010</i>	194
Vendim i KM nr.868, datë 12.12.2007	Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar <i>ndryshuar me:</i> <i>- vendim të KM nr.548, datë 7.7.2010</i>	213

### III. KONTROLLI DHE DISIPLINIMI I PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

Ligj nr.8402 datë 10.9.1998	Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit <i>ndryshuar me:</i> <i>- ligjin nr.9200, datë 26.2.2004</i> <i>- ligjin nr.9794, datë 23.7.2007</i> <i>- ligjin nr.9826, datë 1.11.2007</i> <i>- ligjin nr.10324, datë 23.9.2010</i>	214
Vendim i KM nr.447, datë 19.9.1994	Për ndalimin e përdorimit të asbestit si material termoizolues në të gjitha llojet e ndërtimit	220
Vendim i KM nr.584, datë 2.11.2000	Për kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë në ndërtime	220
Vendim i KM nr.68, datë 15.2.2001	Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit <i>ndryshuar me:</i> <i>- vendim të KM nr.186, datë 3.5.2002</i> <i>- vendim të KM nr.4, datë 10.1.2003</i> <i>- vendim të KM nr.391, datë 19.6.2004</i> <i>- vendim të KM nr.279, datë 18.4.2007</i>	221
Vendim i KM nr.363, datë 18.7.2002	Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e ndërtimit të objekteve <i>ndryshuar me:</i> <i>- vendim të KM nr.206, datë 16.4.2004</i>	228
Vendim i KM nr.808, datë 4.12.2003	Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit <i>ndryshuar me:</i> <i>-vendim të KM nr.736, datë 1.7.2009</i>	229
Urdhër i MRRTT nr.44, datë 4.2.2004	Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”	230
Vendim i KM nr.679, datë 22.10.2004	Për miratimin e rregullave teknike për përdorimin e betoneve strukturore	237
Vendim i KM nr.35, datë 18.1.2006	Për miratimin e rregullores për punimet e ndërtimit të sistemeve të kanalizimeve, për largimin e ujërave të përdorimit shtëpiak	267

Udhëzim i KM nr.3, datë 15.2.2001	Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit <i>ndryshuar me:</i> - <i>udhëzim të KM nr.4, datë 17.5.2001</i> - <i>udhëzim të KM nr.7, datë 21.11.2001</i> - <i>udhëzim të KM nr.1, datë 22.2.2005</i>	278
Udhëzim i KM nr.2, datë 8.5.2003	Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit	283
Udhëzim i KM nr.2, datë 13.5.2005	Për zbatimin e punimeve të ndërtimit	288
Vendim i KM nr.514, datë 18.8.2007	Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit	296
Vendim i KM nr.42, datë 16.1.2008	Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi <i>ndryshuar me:</i> - <i>vendim të KM nr.406, datë 22.4.2009</i> - <i>vendim të KM nr.835, datë 15.7.2009</i>	299
Vendim i KM nr.1035, datë 9.7.2008	Për caktimin e tarifës së licencimit të subjekteve, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në fushën e punimeve të ndërtimit dhe të transportit <i>ndryshuar me:</i> - <i>vendim të KM nr.1123, datë 13.11.2009</i>	323
Urdhër i MPPTT nr.47, datë 29.3.2010	Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit	324
Vendim i KM nr.30, datë 20.1.2010	Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre	343
Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010	Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”	429
Ligj nr.8937 datë 12.9.2002	Për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa	491
Vendim i KM nr.38, datë 16.1.2003	Për miratimin e normave, të rregullave dhe kushteve të projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa	492
Ligj nr.9290 datë 7.10.2004	Për produktet e ndërtimit <i>ndryshuar me:</i> - <i>ligjin nr.9825, datë 1.11.2007</i> - <i>ligjin nr.10327, datë 30.9.2010</i>	533
Vendim i KM nr.58, datë 1.2.2006	Për miratimin e rregullores “Për procedurat e kontrollit të produktit në fabrikë dhe në qendrën e shpërndarjes, për marrjen e certifikatës së vlerësimit të konformitetit për çimentot, për të cilat ka rëndësi parësore rezistenca dhe qëndrueshmëria”	540

Vendim i KM nr.279, datë 18.4.2007	Për miratimin e listës së produkteve të ndërtimit, për të cilat kërkohet vlerësimi i detyruar i konformitetit <i>ndryshuar me:</i> <i>- vendim të KM nr.756, datë 15.9.2010</i>	555
---------------------------------------	---	-----

#### IV. NDËRTIM E PROJEKTIM

Vendim i KM nr.613, datë 13.12.1993	Për ushtrimin e veprimtarisë në ndërtim dhe projektim të shoqërive <i>ndryshuar me:</i> <i>- vendim të KM nr.142, datë 4.3.1996</i> <i>- vendim të KM nr.428, datë 4.8.2000</i> <i>- vendim të KM nr.335, datë 11.7.2002</i> <i>- vendim të KM nr.786, datë 22.11.2006</i>	565
Vendim i KM nr.444, datë 5.9.1994	Për tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit	566
Vendim i KM nr.699, datë 22.10.2004	Për “Miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në konstruksionet dhe ndërtimet, që shërbejnë për veprimtari akomoduese turistike”	577

#### V. LEGALIZIMI I SHITESAVE

Ligj nr.9482 datë 3.4.2006	Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje <i>ndryshuar me:</i> <i>- ligjin nr.9786, datë 19.7.2007</i> <i>- ligjin nr.9895, datë 9.6.2008</i> <i>- ligjin nr.10 099, datë 19.3.2009</i> <i>- ligjin nr.10 169, datë 22.10.2009</i> <i>- ligjin nr.10 219, datë 14.2.2010</i>	615
Vendim i KM nr.544, datë 12.8.2004	Për miratimin e procedurës dhe të dokumentit të legalizimit të shtesave në ndërtime	635
Udhëzim i MRRTT nr.6, datë 26.11.2004	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.544, datë 12.8.2004 “Për miratimin e procedurës dhe të dokumentit të legalizimit të shtesave në ndërtime”	638
Vendim i KM nr.289, datë 17.5.2006	Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) <i>ndryshuar me:</i> <i>- vendim të KM nr.678, datë 4.10.2006</i> <i>- vendim të KM nr.1147, datë 5.8.2008</i>	641
Udhëzim i MF&MRRTT nr.6, datë 4.2.2003	Për taksën mbi ndërtesat <i>ndryshuar me:</i> <i>- udhëzimin e MF&amp;MRRTT nr.1, datë 2.2.2005</i>	642
VKM nr.173 datë 29.3.2006	Për miratimin e kostos minimale fiskale në ndërtim dhe për mënyrën e përcaktimit të çmimit të shitjes së banesave	646
Vendim i KM nr.397, datë 21.6.2006	Për miratimin e planveprimit për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje	652

Vendim i KM nr.437, datë 28.6.2006	Për përcaktimin e procedurave për mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për ndërtimet pa leje, për ngritjen e bazës së të dhënave	657
Vendim i KM nr.438, datë 28.6.2006	Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo	665
Vendim i ERE nr.36, datë 12.6.2006	Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e tarifave të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike	669
Udhëzim i KM nr.5, datë 7.9.2006	Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe të koeficientit “k” për vitin 2006	676
Udhëzim i MPPTT nr.6, datë 8.11.2006	Për dokumentacionin tekniko-ligjor për miratimin e kufirit të zonës/vendbanimit/bllokbanimit/ndërtimit informal të veçuar dhe të territoreve të tjera me ndërtime pa leje	679
Vendim i KM nr.1180, datë 5.8.2008	Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimin e të ardhurave të procesit të legalizimit <i>ndryshuar me:</i> - vendim të KM nr.1587, datë 3.12.2008 - vendim të KM nr.246, datë 13.4.2010	681
Udhëzim i KM nr.2, datë 4.4.2007	Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe të koeficientit “k”, për vitin 2007	683
Udhëzim i MPPTT nr.7, datë 8.11.2006	Për mënyrën e plotësimit dhe ruajtjen e të dhënave për ndërtimet pa leje	687
Urdhër i ALUIZNI-t nr.8, datë 30.10.2006	Për miratimin e manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike	691
Vendim i KM nr.258, datë 4.5.2007	Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara	699
Vendim i KM nr.259, datë 4.5.2007	Për miratimin e rregullores për normat dhe standardet minimale urbanistike, për urbanizimin e zonave informale	705
Udhëzim i KM nr.1, datë 20.8.2008	Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2008 <i>ndryshuar me:</i> - udhëzim të KM nr.2, datë 5.11.2008	717
Udhëzim i MF nr.37, datë 20.11.2008	Për përdorimin e të ardhurave nga procesi i legalizimit	720
Vendim i KM nr.515, datë 13.5.2009	Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale	721
Udhëzim i KM nr.3, datë 3.2.2010	Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010	722
Vendim i KM nr.411, datë 19.5.2010	Për kriteret, procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit	726

Ligj nr.10 112 datë 9.4.2009	Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit	728
Vendim i KM nr.447, datë 16.6.2010	Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit	741



**LIGJ**  
**Nr.8405, datë 17.9.1998**

**PËR URBANISTIKËN**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8453, datë 4.2.1999;  
ndryshuar me ligjin nr.8501, datë 16.6.1999;  
ndryshuar me ligjin nr.8682, datë 7.11.2000;  
ndryshuar me ligjin nr.8982, datë 12.12.2002;  
ndryshuar me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003;  
ndryshuar me ligjin nr.9743, datë 28.5.2007;  
ndryshuar me ligjin nr.9843, datë 17.12.2007;  
ndryshuar me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009;  
ndryshuar me ligjin nr.10 097, datë 13.3.2009;  
- ndryshuar me ligjin nr.10 319, datë 16.9.2010;*

*I përditësuar*

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**PËRKUFIZIME**

Neni 1

*(Shtuar dhe ndryshuar me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003, neni 1)*

Në kuptim të këtij ligji:

"Studim urbanistik rajonal" është studimi urbanistik kompleks dhe përfshin territorin e një ose më shumë bashkive dhe rretheve;

"Master plan" është studimi urbanistik me një temë të caktuar dhe përfshin të gjithë territorin kombëtar ose pjesë të veçanta të tij;

"Studim mjedisor" është studimi i bërë për të përcaktuar kushtet apo gjendjen ekologjike të një mjedisi të dhënë;

"Plani strategjik" është një proces pjesëmarrjeje në zhvillim, i cili, nëpërmjet një plani afatmesëm, bashkërendon punën për arritjen e objektivave strategjike, të përcaktuar nga vendimmarrësit kryesorë të pushtetit vendor. Plani strategjik ndërthur aspektin fizik, atë financiar dhe institucional. Veprimi i tij është i orientuar drejt menaxhimit të qendrës së banuar si një e tërë ose, të paktën, të komponentëve të tij kryesorë: banimit, tokës, infrastrukturës, rigjenerimit të burimeve financiare, administrimit të përgjithshëm, duke synuar integrimin e tyre.

"Plan i përgjithshëm rregullues" është studimi urbanistik kompleks për një territor të kufizuar dhe përfshin territorin e një qyteti bashkë me zonën suburbane (periferike) të shtrirjes perspektive, të një fshati, të një qendre të banuar, të një qendre pushimi, të një qendre industriale etj;

"Studimi urbanistik pjesor" është studimi urbanistik i detajuar, që mbështetet në parashikimet e planit të përgjithshëm rregullues dhe përfshin zona ose pjesë të territorit të tij, ku parashikohen ndërhyrje rregulluese;

“Plani i veprimit” është një proces pjesëmarrjeje në zhvillim, i cili, nëpërmjet një plani relativisht afatshkurtër, bashkërendon punën për aktivizimin e burimeve të vlefshme materiale, financiare, për të arritur objektiva të kufizuar në zona të përcaktuara.

"Planimetri e sheshit të ndërtimit" është materiali grafik që nxirret nga studimi urbanistik pjesor dhe i bashkëngjitet vendimit për miratimin e sheshit të ndërtimit dhe kushteve urbane të tij;

"Vijë kufizuese e ndërtimit" është kufiri gjeografik i shtrirjes territoriale të ndërtimeve;

“Zona suburbane” është zona që shtrihet jashtë vijës kufizuese të ndërtimit të qytetit. Kufiri i kësaj zone shërben për të ruajtur e parapërgatitur territorin e zhvillimit perspektiv të qytetit.

"Vijë ndërtimi" është kufiri i lejuar për ndërtimin e një volumi në lidhje me zonën përreth apo rrugën që i referohet;

"Truall" është një sipërfaqe toke që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit e përcaktuar nëpërmjet studimit urbanistik të miratuar për të ndërtuar mbi të;

"Territor pronë publike" është sipërfaqja e tokës brenda dhe jashtë vijës kufizuese të ndërtimit e përcaktuar dhe e miratuar për përdorim publik;

"Tokë pronë private" është çdo sipërfaqe toke brenda dhe jashtë vijës kufizuese të ndërtimit në pronësi private;

"Projektide" është faza e zhvillimit të një projekti ndërtimor i mjaftueshëm për t'u përdorur për gjykimin e miratimit të kushteve të sheshit të ndërtimit;

"Projektteknik" është faza e zhvillimit të një projekti ndërtimor i mjaftueshëm për t'u përdorur për dhënien e lejës së ndërtimit;

"Projektzbatim" është faza e zhvillimit të një projekti ndërtimor i mjaftueshëm për t'u përdorur për zbatimin e ndërtimit të objektit;

"Urbanizim" është procesi i zënies së një sipërfaqeje toke për t'u ndërtuar që nga elementët e thjeshtë të sistemimit deri në ndërtimin përfundimtar;

"Zonë e mbrojtur" është zona me vlera të veçanta natyrore dhe ekologjike dhe ndjeshme;

"Zonë e gjelbërt" është sipërfaqja e tokës e destinuar për gjelbërim që nga bari deri te gjelbërimi i lartë;

"Kushte urbanistike" janë kushtet dhe kërkesat teknike të detyrueshme për t'u zbatuar që përkufizojnë zhvillimin hapësinor të një ndërtimi (shtrirje në gjatësi, gjerësi, lartësi, vëllim, formë etj.).

Përmbajtja dhe mënyra e përgatitjes së përcaktimeve të mësipërme parashikohen në Rregulloren e Urbanistikës.

## KREU II DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 2

Urbanistika, në kuptimin e këtij ligji, shpreh dhe përcakton rregullat e përgjithshme të vendosjes dhe të arkitekturës së ndërtimeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në përcaktimin e këtyre rregullave mbahen parasysh zhvillimi ekonomik dhe social, aktual dhe prespektiv i vendit, në nivel kombëtar dhe lokal, mbrojtja e vendit, mbrojtja e mjedisit, ruajtja dhe vënia në dukje e vlerave urbanistike, arkitekturore e arkeologjike, si dhe mbrojtja e interesave të ligjshme që lidhen me pronën private.

### Neni 3

Organet e pushtetit lokal janë administruese të territorit që ndodhet nën juridiksionin e tyre, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me ligj. Me qëllim që të përmirësohen kushtet e jetesës, të administrohet territori mbi baza ligjore, të sigurohet mbrojtja e mjedisit, të ruhet ekuilibri në zhvillimin e zonave urbane dhe rurale dhe të përmirësohen kushtet ekzistuese, organet e pushtetit lokal harmonizojnë vendimet e tyre, duke respektuar reciprokisht autonominë lokale.

#### Neni 4

Të gjitha ndërtimet në territorin e Republikës së Shqipërisë bëhen në bazë të studimeve urbanistike rajonale dhe mjedisore, të masterplaneve, të planeve rregulluese të përgjithshme, të studimeve urbanistike pjesore në fazën e projektidesë, të projektit teknik dhe projektit të zbatimit.

Projekti, për të gjitha llojet e ndërtimeve mbitokësore e nëntokësore dhe të infrastrukturës inxhinierike në të gjithë territorin e vendit, bëhet në bazë të normave, kushteve teknike e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

#### Neni 5

Studimi urbanistik rajonal dhe mjedisor, master plani, plani rregullues i përgjithshëm, studimi urbanistik pjesor, vija kufizuese e ndërtimit dhe vija suburbane janë dokumente teknike që kushtëzojnë dhe përcaktojnë të gjitha marrëdhëniet teknike e ligjore në fushën e urbanistikës. Përmbajtja dhe mënyra e hartimit të tyre përcaktohen në Rregulloren e Urbanistikës, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

#### Neni 6

*(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr.8501, datë 16.6.1999, neni 1)*

Jashtë territoreve të urbanizuara lejohen të bëhen ndërtime vetëm në rastet kur ato përcaktohen në studimet rajonale dhe masterplanet e miratuar nga organi kompetent. Studimet rajonale dhe masterplanet hartohen duke përjashtuar për ndërtim tokat bujqësore të kategorisë së parë, të dytë, të tretë e të katërt, të përcaktuara me raport teknik nga drejtoria e bujqësisë dhe ushqimit në rreth, si dhe zonat e mbrojtura natyrore.

Në rastet e domosdoshme, miratimi i studimeve dhe ndërtimeve në tokat bujqësore të kategorisë së parë, të dytë, të tretë, të katërt dhe në zonat e mbrojtura natyrore bëhet vetëm me vendim të KRRTRSH-së.

### KREU III KOMPETENCAT E ORGANEVE SHTETËRORE NË FUSHËN E URBANISTIKËS

#### Neni 7

Organi më i lartë shtetëror për miratimin e studimeve urbanistike është Këshilli i Rregullimit të Territorit në Republikës e Shqipërisë (KRRTRSH).

#### Neni 8

KRRTRSH-ja është organ vendimmarrës dhe funksionon pranë Këshillit të Ministrave. Kryetar i KRRTRSH-së është Kryetari i Këshillit të Ministrave. Përbërja, numri i anëtarëve dhe masa e shpërblimit të tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 9

*(Ndryshuar paragrafi i parafundit me ligjin nr.9473, datë 28.5.2007, neni 1)*

KRRTRSH-ja miraton studimet e mëposhtme:

- Detyrat e projektimit për studimet, miratimi i të cilëve është në kompetencë të tij.
- Studimet urbanistike rajonale.
- Masterplanet e zonave me sipërfaqe mbi 10 hektarë.
- Studimet urbanistike rajonale dhe pjesore të zhvillimit të zonave turistike.
- Masterplanet e zhvillimit të zonave turistike.
- Planet e përgjithshme rregulluese, vijat kufizuese të ndërtimeve dhe kufirin suburban të

qyteteve që janë qendra administrative të një rrethi dhe të qyteteve të tjera me popullsi mbi 10 000 banorë.

- Studimet urbanistike të qendrave të qyteteve me popullsi mbi 50 000 banorë.
- Studimet urbanistike pjesore brenda qyteteve me sipërfaqe mbi 15 hektarë.
- Studimet e parqeve të qyteteve, të parqeve kombëtare dhe rezervateve natyrore të ruajtjes së biodiversitetit dhe të zonave natyrore të mbrojtura.
- Studimet rajonale për zona të porteve, të aeroporteve dhe për zonat strategjike.
- Projektidetë e studimeve të përgjithshme të infrastrukturës rrugore, hekurudhore, elektrike, për ujësjellës, për kanalizim, për telefon, për gaz e naftësjellës, brenda qyteteve dhe në zonat jashtë tyre.
- Sheshet e ndërtimit dhe projektet e objekteve brenda tyre me sipërfaqe mbi 0.5 hektar, që propozohen për t'u ndërtuar jashtë vijave kufizuese të qyteteve, fshatrave e qendrave të banuara, sipas përcaktimit në studimet rajonale dhe në masterplanet e zonave. Për sheshe me sipërfaqe mbi 0.5 hektar jashtë vijave kufizuese, nga këshilli i qarkut përkatës merret paraprakisht mendimi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.
- Lejet e ndërtimit për projektet e infrastrukturës rrugore kombëtare.
- Studimet urbanistike, sheshet dhe lejet e ndërtimit në zonat turistike, të cilat vihen në dispozicion të Komitetit të Zhvillimit të Turizmit.

#### Neni 10

*(Shfuqizuar me ligjin nr.9473, datë 28.5.2007, neni 2)*

#### Neni 11

Sekretaria teknike e KRRTRSH-së funksionon në ministrinë përkatëse që ndjek veprimtarinë e planifikimit të territorit pranë Drejtorisë së Planifikimit të Territorit. Detyrat e sekretarisë teknike përcaktohen me dispozita të veçanta të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 12

Ministria përkatëse që ndjek veprimtarinë e planifikimit të territorit nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, bashkërendon punën ndërmjet KRRTRSH-së, organeve shtetërore dhe atyre të pushtetit lokal në fushën e planifikimit të territorit. Kjo drejtori ka të drejtë të ushtrojë kontroll në organet e pushtetit lokal që merren me planifikimin e territorit, si dhe të studiojë e të përgatisë propozime të projekteve të akteve ligjore e nënligjore.

#### Neni 13

Institut i Studimeve dhe Projektive Urbanistike është organi shtetëror në nivel kombëtar, që harton studime e projekte urbane të përcaktuara në Rregulloren e Urbanistikës. Ky institut varet nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

#### Neni 14

*(Riformuluar me ligjin nr.8453, datë 4.2.1999, neni 1)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003, neni 2)*

- Organizatat e specializuara për urbanistikën, pranë njësive të qeverisjes vendore, janë:
- Këshilli i Rregullimit të Territorit, pranë këshillit të qarkut, bashkive dhe komunave (KRRT).
  - Njësia e urbanistikës (drejtori, sektor ose zyrë), në qark, në bashki dhe komuna.

#### Neni 15

*(Ndryshuar me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003, neni 3)*

Në kuptim të këtij ligji, qytete të kategorisë së parë janë: Shkodra, Durrësi, Elbasani, Fieri, Vlora, Korça, Saranda, Gjirokastra, Berati, Pogradeci, Lezha, Lushnja, Kukësi, Peshkopia, Laçi dhe Kavaja.

#### Neni 16

KRRT-ja funksionon si organ vendimmarrës pranë këshillave të qarqeve, Bashkisë së Tiranës dhe bashkive që janë të qyteteve të kategorisë së parë. Kryetari i KRRT-së është përkatësisht kryetari i këshillit të qarkut dhe kryetari i bashkisë.

KRRT-ja përbëhet nga 15 anëtarë, specialistë me përvojë në fushën përkatëse.

#### Neni 17

*(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003, neni 4)*

*(Ndryshuar fjali në paragrafin e parë me ligjin nr. 9843, datë 17.12.2007, neni 1)*

Anëtarë të KRRT-së së bashkisë të qyteteve të kategorisë së parë janë:

- kryetari i bashkisë;
- përgjegjësi i zyrës së urbanistikës;
- përgjegjësi i kadastrës urbane;
- inspektori i inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut, i propozuar nga kryeinspektori i këtij inspektorati;
- përgjegjësi i zyrës juridike;
- përgjegjësi i infrastrukturës publike;
- inspektori agjencisë rajonale të mjedisit;
- specialisti i gjelbërimit;
- tre specialistë urbanistë ose arkitektë të caktuar nga këshilli i bashkisë;
- dy specialistë urbanistë ose arkitektë, një specialist konstruktor dhe një inxhinier ndërtimi të propozuar nga prefektura.

Anëtarët e KRRT-së së bashkive dhe komunave janë:

- kryetari i bashkisë/komunës;
- përgjegjësi i zyrës së urbanistikës në bashki/komunë;
- përgjegjësi i zyrës juridike në bashki/komunë;
- përgjegjësi i infrastrukturës publike në bashki/komunë;
- dy përfaqësues nga këshilli bashkiak/komunal;
- dy specialistë (urbanistë/arkitektë/inxhinierë ndërtimi), të caktuar nga kryetari i bashkisë/komunës;
- dy specialistë (urbanistë/arkitektë/inxhinierë ndërtimi), të caktuar nga këshilli bashkiak/komunal.

Për komunat të cilat nuk mund të krijojnë KRRT-në me përbërjen e mësipërme, kompetencat e saj mund t'i ushtrojë KRRT-ja e qarkut.

#### Neni 18

*(Ndryshuar me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003, neni 5)*

Anëtarë të KRRT-së së qarkut janë:

- kryetari i këshillit të qarkut;
- drejtori i drejtorisë së urbanistikës në qark (sekretar i KRRT-së);
- drejtori i kadastrës në qark;
- kryetari i bashkisë qendër qarku dhe një specialist (urbanist/arkitekt/inxhinier ndërtimi), i propozuar nga bashkia qendër qarku;

- përgjegjësi i shërbimeve publike në qark;
- përgjegjësi i ateliesë së monumenteve të kulturës që mbulon qarkun;
- përfaqësuesi i agjencisë rajonale të mjedisit;
- përfaqësuesi i sektorit të rrugëve;
- një specialist i caktuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit;
- tre përfaqësues nga këshilli i qarkut;
- përfaqësuesi i bashkisë/komunës, për të cilën shqyrtohet dhënia e lejes përkatëse.
- një specialist (urbanist/arkitekt/inxhinier ndërtimi), i caktuar nga kryetari i qarkut;
- dy specialistë (urbanistë/arkitektë/inxhinierë ndërtimi), të caktuar nga këshilli i qarkut;
- një specialist (urbanist/arkitekt/inxhinier ndërtimi), i caktuar nga prefektura.

#### Neni 19

*(Ndryshuar me ligjin nr.9473, datë 28.5.2007, neni 3)*

KRRT-ja e Bashkisë së Tiranës përbëhet nga 9 anëtarë. Anëtarët e KRRT-së së Bashkisë së Tiranës janë:

- Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Kryetar i KRRT-së;
- 3 anëtarë, me propozimin e shumicës së Këshillit Bashkiak të Tiranës;
- 3 anëtarë, me propozimin e pakicës së Këshillit Bashkiak të Tiranës;
- 1 anëtar, përfaqësues i ministrit përgjegjës për planifikimin urban;
- 1 anëtar, që zgjidhet me 3/5 e votave të të gjithë Këshillit Bashkiak të Tiranës.

#### Neni 20

*(Ndryshuar me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003, neni 6;*

*zëvendësuar fjalët me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009, neni 1;*

*shfuqizuar shkronja "dh" në pikën 1 me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009, neni 2/1;*

*zëvendësuar fjalët në paragrafin e fundit të pikës 2 me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009, neni 2/2)*

1. KRRT-ja në qark ka kompetencë të shqyrtojë dhe të miratojë:
  - a) detyrat e projektimit për studimet urbanistike, që shtrihen në territorin e më shumë se një bashkie/komune, miratimi i të cilave është kompetencë e KRRT-së së qarkut në territorin brenda juridiksionit të saj;
  - b) platformën për zhvillimin e konkurseve për studimet urbanistike në kompetencë të saj;
  - c) planin strategjik, planin rajonal, masterplanet, në përputhje me programet e zhvillimit;
  - ç) vijën kufizuese të ndërtimeve dhe zonën suburbane të qyteteve;
  - d) vijën kufizuese të ndërtimit të fshatrave;
  - dh) shfuqizuar.
2. KRRT-të në bashki ose komunë kanë kompetencë të shqyrtojnë e të miratojnë:
  - a) detyrat e projektimit, studimet urbanistike, miratimi i të cilave është kompetencë e KRRT-së së bashkisë/komunës, në territorin brenda juridiksionit të saj;
  - b) platformën për zhvillimin e konkurseve për studime urbanistike në kompetencë të saj;
  - c) planin e përgjithshëm rregullues të qytetit dhe fshatit, planet e veprimt dhe rregulloret urbanistike, në përputhje me programet e zhvillimit rajonal;
  - ç) vijën kufizuese të ndërtimeve dhe kufirin e zonës suburbane të qyteteve;
  - d) planet rregulluese të fshatrave dhe studimet e pjesshme urbanistike brenda tyre;
  - dh) studimet e pjesshme urbanistike, në zbërthim dhe zbatim të masterplaneve të miratuara;
  - e) sheshet, lejet e ndërtimit dhe projektin e zbatimit, në zbatim dhe zbërthim të studimeve urbanistike të miratuara.

Në zonat turistike veprohet në përputhje me nenin 70 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar. Materialet që shqyrton KRRT-ja e qarkut, bashkisë/komunës mbi bazën e studimeve bashkë me oponencën përgatiten nga sekretaria teknike e KRRT-së, funksionin e së cilës e kryen përkatësisht njësia e urbanistikës në qark, bashki/komunë.

Materialet që kalojnë për kompetencë në KRRTRSH duhet të dorëzohen në sekretarinë e saj

teknike jo më vonë se 10 ditë nga zbardhja pas miratimit të tyre nga KRRT-ja e qarkut ose bashkisë/komunës.

#### Neni 21

*(Ndryshuar dhe shtuar me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003, neni 7)*

*(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr.9743, datë 28.5.2007, neni 4)*

KRRT-ja e qarkut dhe bashkisë mbledhet një herë në muaj dhe, me kërkesë të kryetarit të saj ose me kërkesën e 1/3 të anëtarëve, mbledhet edhe jashtë radhe. Mbledhja është e vlefshme kur në të marrin pjesë 2/3 e anëtarëve të saj. Vendimi i KRRT-së merret me shumicë votash dhe nënshkruhet nga kryetari i KRRT-së. Të gjithë anëtarët e KRRT së, pjesëmarrës në mbledhje, janë të detyruar të firmosin procesverbalin e mbledhjes pasi e lexojnë atë. Në mbledhjen e KRRT-së marrin pjesë pa të drejtë vote përfaqësuesit e pushtetit lokal të interesuar e përfaqësues të njëjve projektuese. Në rastet kur këshilli i qarkut ose këshilli bashkiak kanë vërejtje dhe nuk janë dakord me vendimet e marra nga KRRT-ja kanë të drejtë të kthejnë për rishqyrtim vetëm një herë vendimet e marra. Në rast se KRRT-ja nuk e ndryshon vendimin, ai mbetet në fuqi.

Vendimet e KRRT-së Tiranë merren me jo më pak se pesë vota pro, përveç rasteve të parashikuara në nenin 20 pika 2 shkronjat “c” dhe “dh”, për të cilat vendimet merren me jo më pak se 6 vota pro.

Në rastet kur përfaqësuesi i prefekturës ka vërejtje ligjore për vendimet e KRRT-së, prefekti ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e lejes nga këshilli vendor përkatës.

#### Neni 22

*(Ndryshuar me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003, neni 8)*

*ndryshuar pika 14 me ligjin nr.9843, datë 17.12.2007, neni 2;*

*zëvendësuar fjalët me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009 neni 1;*

*shfuqizuar pika 4 me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009, neni 3/1;*

*zëvendësuar fjalët në pikën 9 me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009 neni 3/2)*

Seksioni i urbanistikës në qark ka këto kompetenca:

1. Përgatit materialet për studimet në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit territorial, në bashkëpunim me bashkitë dhe komunat përkatëse dhe i paraqet për shqyrtim në KRRT.

2. Bashkërendon punën për hartimin e detyrës së projektimit të planit rajonal, të planit të përgjithshëm rregullues, të masterplaneve të zhvillimit territorial, të studimeve të pjesshme urbanistike, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, në juridiksionin e qarkut dhe i paraqet në KRRT.

3. Në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore që janë në juridiksionin e qarkut, harton, në përputhje me detyrën e projektimit, sipas pikës 2 të këtij neni, masterplanet e zhvillimit, planet e përgjithshme rregulluese, studimet e pjesshme urbanistike ose i porositi ato, në përputhje me ligjin, në institucionet projektuese, shtetërore ose private, të licencuara në fushën e studimeve urbanistike, në zbatim e zberthim të planeve strategjike dhe të politikave rajonale të miratuara, pasi ka marrë më parë rekomandimin e KRRT-së.

4. Shfuqizuar.

5. Propozon rregullore të urbanistikës për territore në juridiksionin e qarkut, në përputhje me ligjin, dhe ia paraqet për miratim KRRT-së.

6. Përgatit materialin për ndryshimet përkatëse, në studimet e miratuara, kur paraqiten kushte të reja.

7. Mban lidhje sistematike me sekretarinë teknike të KRRTSH-së dhe me zyrat e urbanistikës në bashki e komuna.

8. Ndihmon dhe bashkërendon punën me zyrat e urbanistikës në bashki e komuna për problemet teknike në zbatim të këtij ligji.

9. Përgatit vendimet e KRRT-së, dokumentacionin teknik, bashkë me kushtet urbanistike, të miratuara nga KRRT-ja, sipas nenit 6 të këtij ligji. Pas miratimit, 2 kopje origjinale të materialit ia

dorëzon kërkuesit ose bashkisë/komunës, në juridiksionin e së cilës ndodhet zona e studiuar, jo më vonë se 5 ditë pune pas marrjes së vendimit të KRRT-së.

10. Kontrollon nëse lejet e miratuara nga bashkitë dhe komunat janë dhënë në përputhje me studimet e miratuara nga KRRT-të përkatëse dhe, në rast shkeljeje të këtyre studimeve, njofton këshillin e zgjedhur përkatës.

11. Mban aktet e kontrollit për lejet e miratuara nga KRRT-ja e qarkut, për këto faza të realizimit të punimeve: piketimi i objektit, përfundimi i themeleve dhe përfundimi i karabinasë, si dhe arkivon dokumentacionin teknik të objektit dhe dokumente të tjera të tij.

Pas aktit të kolaudimit, nëse nuk janë evidentuar shkelje të vendimit, përgatit materialin për lejen e shfrytëzimit.

12. Mban kadastrën dhe statistikën urbane dhe, në bashkëpunim me zyrën përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, bën azhurnimin e planimetrisë së qyteteve, fshatrave dhe komunave, të cilat i arkivon çdo fund viti.

13. Dërgon, çdo 6 muaj, në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të dhëna statistikore për fushën e planifikimit të territorit.

14. Njofton brenda 5 ditë pune inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut për marrjen e masave përkatëse, kur vëren shkelje të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit, që kanë të bëjnë me KTP-në, KTZ-në dhe shkelje të rregullave të sigurimit teknik. Për rastet kur gjatë akteve të kontrollit vëren shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit, njofton në mbledhjen më të afërt KRRT-në, e cila merr menjëherë në shqyrtim këto shkelje. KRRT-ja vendos miratimin ose jo të ndryshimeve në projekt dhe njofton inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut për marrjen e vendimit përkatës.

#### Neni 22/1

*(Shtuar me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003, neni 9)  
(Ndryshuar pika 13 me ligjin nr.9843, datë 17.12.2007, neni 3)  
(Zëvendësuar fjalët me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009 neni 1;  
shtuar pika 6/1 me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009 neni 4/1;  
ndryshuar pika 9 me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009 neni 4/2)*

Njësia e urbanistikës në Bashkinë e Tiranës, në bashkitë e kategorisë I, bashkitë e tjera dhe komuna ka këto kompetenca:

1. Përgatit materialet për studimet në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit territorial brenda juridiksionit dhe i paraqet për shqyrtim në KRRT.

2. Drejton punën për projektimin e planit të përgjithshëm rregullues, të masterplaneve të zhvillimit territorial, të planeve të veprimit, të studimeve të pjesshme urbanistike. Përgatit dokumentacionin teknik dhe e paraqet në këshillin e bashkisë ose të komunës dhe në KRRT.

3. Harton ose porosin, në përputhje me ligjin, në institucionet projektuese, shtetërore ose private, të licencuara në fushën e studimeve urbanistike, planin e përgjithshëm rregullues, planet e veprimit, rregulloret e urbanistikës për qytetet/komunat, masterplanet, studimet e pjesshme, pasi ka marrë më parë rekomandimin e KRRT-së dhe ia paraqet asaj për miratim.

4. Mban lidhje sistematike me sekretarinë teknike të KRRTRSH-së.

5. Bashkërendon punën me zyrën e urbanistikës në qark.

6. Përgatit studimet urbanistike për sheshet e ndërtimit, për territore pronë shtetërore, me propozimin e këshillit të bashkisë/komunës dhe me miratimin e kryetarit të KRRT-së.

6/1. Siguron, me kërkesën e të interesuarit, përditësimet e infrastrukturës rrugore, kanalizime, elektrike, telefonike, intensitetin sizmik mbi bazën e studimit sizmologjik të marrë nga Instituti i Sizmologjisë (pikat 1, 2, 3 dhe 4 të formularit nr.3/1), si shërbim “në një ndalesë” dhe ia dërgon kërkuesit brenda 10 ditëve nga kërkesa.

7. Shqyrton kërkesat për sheshe dhe leje ndërtimi të çdo objekti dhe dokumentacionin përkatës, në përputhje me planin e përgjithshëm rregullues dhe studimin e pjesshëm urbanistik të miratuar dhe i paraqet ato në këshillin teknik dhe në KRRT.



8. Shqyrton kërkesat për prishje objektsh dhe prerje drurësh dhe i paraqet në KRRT.
9. Përgatit vendimet e KRRT-së dhe dokumentacionin e nevojshëm teknik, bashkë me kushtet urbanistike, sipas studimeve të miratuara.
- a) Pas miratimit nga KRRT-ja, kërkuesi është i detyruar të depozitojë, brenda një afati kohor prej 60 ditësh, projektin e zbatimit për objektin.
- b) Njësia e urbanistikës, brenda 5 ditëve nga depozitimi i projektit të zbatimit, shqyrton dokumentacionin e depozituar nga kërkuesi, vetëm për çështje të përmbushjes së formës, si dhe i dërgon njoftimin se do të fillojë shqyrtimi i konformitetit të projektit arkitektonik të zbatimit, me rregullat urbanistike dhe vendimin e KRRT-së.
- c) Kur njësia e urbanistikës në njësinë vendore, brenda afatit 5-ditor, nuk dërgon në adresë të kërkuarit njoftimin se do të fillojë shqyrtimi i konformitetit të projektit arkitektonik të zbatimit, dokumentacioni konsiderohet i pranuar në heshtje dhe njësia e urbanistikës detyrohet të fillojë shqyrtimin e konformitetit, sipas shkronjës “ç” të kësaj pike.
- ç) Njësia e urbanistikës, brenda 10 ditëve, njofton kërkuarin se projekti arkitektonik i zbatimit të objektit është në përputhje ose jo me normat urbanistike dhe vendimin e KRRT-së, si dhe detyrimin për pagesën e taksës.
- d) Njësia e urbanistikës shqyrton konformitetin vetëm të projektit arkitektonik të zbatimit të objektit me normat urbanistike dhe vendimin e KRRT-së. Ndërsa për sa i përket projektit konstruktiv dhe atij të instalimeve, projektuesit e veprës, nën përgjegjësinë e tyre profesionale, vetëdeklarojnë, në një deklaratë të posaçme që i bashkëlidhet projektit të depozituar, se kanë hartuar projektin konform të gjitha normave teknike në fuqi.
- dh) Në rast se njësia e urbanistikës konstaton se dokumentacioni i kërkuarit, për sa i përket projektit arkitektonik, ka të meta në përmbajtje, i dërgon njoftimin për plotësimin e tyre, duke i vendosur një afat, sipas Kodit të Procedurave Administrative.
- Me dërgimin e njoftimit të mësipërm, pezullohet llogaritja e afatit të zbardhjes së vendimit të KRRT-së, deri në plotësimin e të metave nga kërkuesi. Me plotësimin e tyre, kërkuesi rivendoset në afatin 10-ditor.
- e) Nëse njësia e urbanistikës, brenda afatit 10-ditor, nuk njofton kërkuarin për të meta në dokumentacionin ose detyrimin e pagesës së taksës, në përfundim të këtij afati dokumentacioni konsiderohet i pranuar në heshtje dhe njësia e urbanistikës është e detyruar të llogarisë detyrimin për pagesën e taksës, sipas nenit 51 të këtij ligji.
10. Mban aktet e kontrollit për këto faza të realizimit të punimeve: për piketimin e objektit, përfundimin e themeleve dhe të karabinasë, si dhe arkivon dokumentacionin teknik të objektit dhe dokumentet e tjera.
- Pas aktit të kolaudimit, nëse nuk janë vënë re shkelje, përgatit për miratim në KRRT materialin për lejen e shfrytëzimit.
11. Mban kadastrën dhe statistikën urbane në bashkëpunim me zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, bën azhurnimin e planimetrisë së qytetit/komunës, të cilën e arkivon në çdo fund viti;
12. Dërgon, çdo 6 muaj, në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të dhëna statistikore për fushën e planifikimit të territorit;
13. Njofton brenda 5 ditë pune inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut për marrjen e masave përkatëse, kur vëren shkelje të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit, që kanë të bëjnë me KTP-në, KTZ-në dhe shkelje të rregullave të sigurimit teknik. Për rastet kur gjatë akteve të kontrollit vëren shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit, njofton në mbledhjen më të afërt KRRT-në, e cila merr menjëherë në shqyrtim këto shkelje. KRRT-ja vendos miratimin ose jo të ndryshimeve në projekt dhe njofton inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut për marrjen e vendimit përkatës.
14. Përgatit, me propozimin e KRRT-së, materialin për ndryshimet përkatëse kur paraqiten kushte të reja.

#### Neni 23

*(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr.8453, datë 4.2.1999, neni 2)  
(Shfuqizuar me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003, neni 14)*

#### Neni 24

*(Ndryshuar me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003, neni 10)*

Njësia e urbanistikës (drejtori, sektor ose zyrë), në qark, në Bashkinë e Tiranës dhe në bashkitë e kategorisë I duhet të ketë strukturën tip, me këtë përbërje:

- sekretarinë teknike të KRRRT-së;
- urbanistikën studimore-projektuese;
- kadastrën urbane;
- urbanistikën ligjore;
- infrastrukturën inxhinierike dhe të vlerësimit të impaktit në mjedis;
- kontrollin teknik të projekteve.

Numri i punonjësve të urbanistikës caktohet, përkatësisht, nga këshilli i qarkut dhe këshilli bashkiak, ku përfshihen specialistë urbanistë, arkitektë, inxhinierë infrastrukture, inxhinierë topografë dhe juristë.

Numri i punonjësve të drejtorisë së urbanistikës në Bashkinë e Tiranës caktohet nga këshilli bashkiak, ku përfshihen specialistë urbanistë, arkitektë, inxhinierë mjedisi, inxhinierë ndërtimi, inxhinierë infrastrukture, inxhinierë topografë, juristë dhe ambientalistë.

Njësia e urbanistikës (drejtori, sektor ose zyrë) në bashki dhe komuna duhet të ketë strukturën tip, ku përfshihen:

- sekretaria teknike;
- kadastra urbane;
- urbanistika studimore;
- infrastruktura inxhinierike dhe e vlerësimit të impaktit në mjedis;
- urbanistika ligjore dhe e kontrollit teknik të projekteve.

#### Neni 25

*(Shtesë në paragrafin e parë me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003, neni 11)*

Pranë Drejtorisë së Urbanistikës në Bashkinë e Tiranës, seksioneve të urbanistikës në këshillat e qarqeve dhe zyrave të urbanistikës në bashkitë e qyteteve të kategorisë së parë ngrihet këshilli teknik, përbërja e të cilit miratohet përkatësisht nga këshilli i Bashkisë së Tiranës, këshilli i qarkut ose këshilli i bashkisë së qyteteve të kategorisë së parë. Këshilli teknik shqyrton dhe jep mendim për anën tekniko-ligjore, për materialet që paraqiten për shqyrtim në KRRRT. Përbërja, funksionimi, të drejtat dhe detyrat e këshillit teknik përcaktohen me akte nënligjore.

Anëtarët e këshillit teknik shpërblehen për punën e kryer. Masa e shpërblimit caktohet nga këshilli përkatës i qeverisjes vendore.

#### Neni 26

*(Shfuqizuar me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003, neni 14)*

#### Neni 27

*(Shfuqizuar me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003, neni 14)*

#### Neni 28

*(Ndryshuar fjalë në fjalinë e parë me ligjin nr.9843, datë 17.12.2007)  
(Zëvendësuar fjalët me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009, neni 1)*

Në rastet kur përgjegjësit a punonjësit e seksioneve dhe zyrave urbanistike vërejmë shkelje të këtij ligji, brenda dy ditë pune bëjnë njoftimet përkatëse pranë inspektoratit ndërtimor e urbanistik

të bashkisë/komunës/qarkut. Mospërbushja e këtij detyrimi nga personat përgjegjës, kur nuk ka vend për ndjekje penale, përbën shkelje të rëndë të disiplinës në punë.

Personat përgjegjës janë të detyruar të paguajnë dëmin e shkaktuar, si pasojë e shkeljeve të kryera, kur personat juridikë, fizikë, privatë dhe shtetërorë e kërkojnë këtë gjë. Në këto raste mosmarrëveshjet zgjidhen me rrugë gjyqësore.

#### KREU IV ADMINISTRIMI I TOKËS PËR NDËRTIME

##### Neni 29

Administrimi i tokës për ndërtime bëhet nëpërmjet planeve rajonale, masterplaneve, planeve rregulluese të përgjithshme dhe studimeve urbanistike pjesore. Përmbajtja e tyre përcaktohet në Rregulloren e Urbanistikës.

##### Neni 30

Në kuptim të këtij ligji, toka pronë private dhe toka pronë publike kanë të njëjtën vlerë për urbanizim. Mënyra e përdorimit të tyre për qëllime ndërtimi përcaktohet në studimet urbanistike rajonale, masterplanet, planet e përgjithshme rregulluese dhe studimet urbanistike pjesore.

##### Neni 31

Në zbatim të studimeve urbanistike të të gjitha llojeve, sipas fazave të realizimit të tyre në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore, bëhet shpronësimi në përputhje të plotë me studimin, me vlerësimin e pasurisë së paluajtshme pronë private dhe me procedurat përkatëse për shpronësimin.

##### Neni 32

Pronarët e tokave, brenda vijave kufizuese të ndërtimeve në qytete, fshatra e qendra të banuara, kanë të drejtë që, nëpërmjet organeve dhe personave të licencuar më parë, të kryejnë studime për territoret e tyre në pronësi vetëm pasi të kenë marrë nga organet e urbanistikës kriteret e kushtet urbanistike të përcaktuara në studimet në fuqi. Këto studime nuk janë të detyrueshme për përdorim nga organe shtetërore, por ato mund të paraqiten si alternativa të zgjidhjeve teknike për diskutim në KRRT-në në juridiksionin e së cilës ndodhet toka bashkë me studime, që pushteti lokal ka të drejtë të bëjë për të njëjtat territore.

##### Neni 33

Ndalohet urbanizimi pa kriter i zonave me vlerë natyrore, i tokave bujqësore dhe i tokave të zëna me pyll pronë private.

Pronarët e tokave bujqësore jashtë vijave kufizuese të ndërtimit të qyteteve, fshatrave e qendrave të banuara kanë të drejtë të kërkojnë urbanizimin e tokave të tyre vetëm mbi bazën e përcaktimeve në studimet rajonale, masterplanet dhe studimet e zonave suburbane, të miratuara nga organi kompetent.

##### Neni 34

Vendi i grumbullimit të mbeturinave të të gjitha llojeve, përfshirë edhe ato teknologjike a urbane të ndërtimit, në varësi të madhësisë së sheshit, si dhe të teknologjisë së përpunimit të tyre, miratohen nga KRRT-ja në juridiksionin e së cilës është zona. Ky përcaktim duhet të bëhet në nivelin e studimit rajonal dhe të masterplaneve. Në çdo rast materiali shqyrtohet e miratohet edhe nga agjencia rajonale e mbrojtjes së mjedisit dhe inspektorati sanitar shtetëror.

#### Neni 35

Këshilli i qarkut, këshilli i bashkisë dhe këshilli i komunës duhet të azhurnojnë me dokumentacion të rregullt ligjor territoret në pronësi publike të juridiksionit të tyre. Vetëm pasi të jenë kryer këto veprime mbi bazën e studimeve urbanistike, ato kanë të drejtë të shqyrtojnë e të propozojnë leje për ndërtim në këto territore në përputhje me ligjin, sipas kompetencave përkatëse.

#### Neni 36

*(Zëvendësuar fjalët me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009, neni 1)*

Planet rajonale, masterplanet, planet rregulluese të përgjithshme dhe studimet pjesore urbanistike, të hartuara nga organet e përcaktuara me ligj, depozitohen brenda 15 ditë pune nga data e përfundimit të tyre në sekretarinë teknike të KRRT-së të qarkut a bashkisë së qyteteve të kategorisë së parë dhe për një afat 30-ditor vihen në dispozicion të të interesuarve. Njoftimi bëhet me mjetet e informacionit publik. Të interesuarit për këto materiale paraqesin vërejtjet e tyre në seksionin e urbanistikës së nivelit lokal. Brenda afatit 30 ditë pune, organi projektues në bashkëpunim me seksionin a zyrën përkatëse të urbanistikës në rreth, në bashkitë e qyteteve të kategorisë së parë dhe Bashkinë e Tiranës, pasqyron vërejtjet dhe materiali përfundimtar paraqitet në mbledhjen më të afërt të KRRT-së përkatëse.

#### Neni 37

Planet rajonale dhe masterplanet përgatiten për periudha kohore mbi 20-vjeçare, ndërsa planet rregulluese të përgjithshme dhe studimet urbanistike pjesore hartohen për periudha kohe të caktuara 10-15-vjeçare, duke përcaktuar përparësitë e fazës së parë 5-vjeçare. Ato mund të ndryshohen me propozim të organeve të pushtetit lokal, duke motivuar ndryshimin e duke miratuar këto ndryshime nga organet që kanë në kompetencë miratimin e tyre.

Gjatë kohës që përgatitet ndryshimi i një studimi urbanistik të çfarëdolloj, deri në miratimin e tij përfundimtar, mbetet në fuqi studimi i mëparshëm.

#### Neni 38

*(Shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9743, datë 28.5.2007, neni 5)*

*(Shtuar paragrafi në fillim të nenit me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009, neni 5)*

Kërkuesi ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për miratim:

a) vetëm të sheshit të ndërtimit dhe të kushteve urbane të tij dhe pas miratimit të lejes së sheshit nga KRRT-ja, në një procedim të ri të kërkojë miratim të lejes së ndërtimit;

b) të sheshit dhe të lejes së ndërtimit në një procedim të vetëm administrativ;

Kur kërkuesi paraqet kërkesën, sipas shkronjës “a” të paragrafit të parë të këtij neni, afatet dhe procedura e përcaktuar në këtë ligj aplikohen më vete për shqyrtimin e kërkesës dhe miratimin e sheshit të ndërtimit dhe më vete për shqyrtimin e kërkesës dhe miratimin e lejes së ndërtimit.

Kur kërkuesi paraqet kërkesën, sipas shkronjës “b” të paragrafit të parë të këtij neni, kërkesa bëhet sipas formularëve nr.1, 3 dhe 3/1, pjesë e këtij ligji. Kërkesa shqyrtohet në një procedim të vetëm administrativ, sipas afatit të përcaktuar në nenin 45 të këtij ligji.

Paraqitja e kërkesës me shkrim për miratimin e sheshit të ndërtimit dhe të kushteve urbane të tij, si dhe të çdo studimi urbanistik, është e detyrueshme për çdo person fizik e juridik, vendas ose të huaj, i cili do të ndërtojë një strukturë ndërtimore mbitokësore e nëntokësore. Kërkesa për shesh ndërtimi bëhet sipas formularit nr.1, që i bashkëngjitet këtij ligji. Përcaktimet teknike të dokumentacionit dhe forma grafike e tyre jepen në Rregulloren e Urbanistikës.

Kërkesat e paragrafit të mësipërm nuk zbatohen në rastin e ndërtimeve të infrastrukturës rrugore publike.

#### Neni 39

*(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003, neni 12)*

Kërkesa për shesh ndërtimi të çfarëdolloj paraqitet, në zyrën e urbanistikës në bashkinë e qytetit ose në zyrën e urbanistikës në komunë, në varësi të vendndodhjes së sheshit. Zyrat e urbanistikës, sipas përkatësisë, pasi bëjnë shqyrtimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe, kur ai është në përputhje me kërkesat ligjore, ndjekin procedurat për paraqitje dhe shqyrtim në KRRT-në përkatëse.

Për çdo shesh ndërtimi, kërkesa duhet të jetë e bazuar në studimin urbanistik të miratuar të zonës në fjalë, ndryshe materiali kthehet deri në plotësimin e studimit, nëse është e mundur nga organi shtetëror ose nga vetë i interesuari, i cili mund të kryejë studimin urbanistik në organet e licencuara në përputhje me strategjinë e zhvillimit urbanistik të rrethit e të zonës. Sqarimet ai i merr nga zyrat përkatëse të urbanistikës. Personi i interesuar mund t'i kryejë studimet me shpenzimet e veta, duke respektuar kërkesat e ligjit.

#### Neni 40

Destinacioni i shesheve kryesore të ndërtimit dhe kushtet urbanistike të tyre përcaktohen në planet e përgjithshme rregulluese ose në studimet pjesore urbanistike të miratuara.

Kërkesa për miratim të destinacionit funksional dhe të kushteve urbanistike të sheshit mbi truall pronë private, bëhet vetem nga pronari i tij.

Për një shesh ndërtimi pronë publike mund të paraqiten disa kërkesa. Këshilli i qarkut, këshilli i bashkisë dhe këshilli i komunës i shqyrtojnë kërkesat në formë ofertash konkurruese, duke zgjedhur atë që plotëson më mirë kushtet financiare, ekonomike e sociale, urbanistike, arkitektonike, funksionale mjedisore dhe kushtet e tjera, të cilat kanë të njëjtën rëndësi në vlerësimin e ofertave.

#### Neni 41

Organet e pushtetit lokal, kur janë të interesuara për ndërtime në një zonë të caktuar në pronësi publike, për objekte me rëndësi publike e shoqërore shpallin konkurs. Shqyrtimi dhe zgjedhja e ofertave bëhet në përputhje me ligjin.

#### Neni 42

Këshilli i qarkut, i bashkisë apo komunës, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, janë të detyruar të vënë në dispozicion të Entit Kombëtar të Banesave sheshet e ndërtimit për ndërtim banesash për të pastrehët në territore pronë publike, sipas kërkesës së tij për një afat prej 2 vjetësh.

#### Neni 43

*(Zëvendësuar fjalët me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009, neni 1)*

Për truallin pronë publike, zyrat e urbanistikës në rreth, bashki apo komunë bëjnë publikimin e studimit të miratuar dhe të kërkesave për sheshe ndërtimi në territore pronë publike sipas vendndodhjes së tyre. Publikimi bëhet jo më pak së 20 ditë pune përpara asaj të caktuar për shqyrtimin e tyre në këshillin e qarkut, të bashkisë e të komunës. Sipas kompetencës, këshilli i qarkut, i bashkisë dhe i komunës shqyrton kërkesat, dokumentacionin, mendimin e zyrës së urbanistikës dhe vendos me shumicë votash dhënien e sheshit ofertës më të mirë.

Vendimi i këtyre këshillave shpallet dhe nënshkruhet nga kryetari i këshillit të qarkut, të bashkisë a të komunës.

Vendimi i KRRT-së për dhënien e sheshit të ndërtimit për pronat publike dhe kushtet urbanistike, mbi bazën e të cilit do të hartohet projekti për leje ndërtimi, pas përzgjedhjes që kanë bërë këshilli i qarkut, i bashkisë dhe i komunës, bëhet sipas formularit nr.2, bashkëngjitur këtij ligji. Përgjigjja për kërkesën e sheshit të ndërtimit si për truallin pronë private dhe atë pronë publike

merret përkatësisht në seksionin e urbanistikës në këshillin e qarkut, në zyrën e urbanistikës në bashki e komunë, ku është paraqitur kërkesa.

#### Neni 44

Nga data e paraqitjes së kërkesës për miratimin e sheshit me destinacionin funksional të tij, si dhe kushtet urbanistike deri në daljen e vendimit nuk duhet të kalojnë më shumë se dy muaj. Në rast se kërkuesi nuk është dakord me vendimin e KRRT-së, mund të ankohet në këshillin e qarkut dhe këshillin e bashkisë për rishqyrtimin e kërkesës. Rishqyrtimi i kërkesës dhe vendimi i KRRT-së është i formës së prerë.

#### Neni 45

*(Ndryshuar fjalia e parafundit me ligjin nr.9743, datë 28.5.2007, neni 5)  
(Shtuar paragrafët në fund të nenit me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009, neni 6)*

Çdo person fizik e juridik, vendas ose i huaj që do të ndërtojë në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të pajiset me leje ndërtimi. Ky është dokumentacioni i vetëm ligjor mbi bazën e të cilit lejohet ndërtimi. Leja e ndërtimit i jepet personit juridik ndërtues të licencuar.

Si në rastin kur toka është pronë private, ashtu dhe kur ajo është pronë publike, personi juridik ndërtues duhet të paraqesë kontratën e lidhur me pronarin e tokës ose me personin që ka marrë sheshin e ndërtimit nga KRRT-ja

Kërkesa për leje ndërtimi bëhet sipas formularëve 3 dhe 3/1, pjesë e ligjit, përveç lejeve të ndërtimit për projektet e infrastrukturës rrugore. Formulari i kërkesës për projektet e infrastrukturës rrugore miratohet nga ministri përgjegjës. Në rregulloren e urbanistikës përcaktohen kërkesat teknike të dokumenteve dhe forma grafike e tyre.

- Shqyrtimi i kërkesës kalon në dy faza:

procedimi për shqyrtimin administrativ të kërkesës;

b) shqyrtimi dhe miratimi i lejes së ndërtimit nga organi kompetent, KRRT-ja vendore.

- Procedimi për shqyrtimin administrativ të kërkesës bëhet nga njësia e urbanistikës dhe këshilli teknik në njësinë vendore.

- Njësia e urbanistikës, brenda 5 ditëve, shqyrton dokumentacionin vetëm për çështje të përmbushjes së formës dhe dërgon në adresë të kërkuesit vërtetimin, ku përcaktohet data e marrjes në dorëzim të kërkesës, të dhënat që identifikojnë kërkesën dhe dokumentet bashkëlidhur, si dhe njoftimin se do të nisë procedura e shqyrtimit administrativ të kërkesës.

Në rast se gjatë shqyrtimit për çështje të formës vihen re mangësi në dokumentacionin e kërkuar, sipas këtij ligji, aplikimi nuk pranohet dhe kërkesa së bashku me dokumentet shoqëruese i kthehen mbrapsht kërkuesit me njoftimin se shqyrtimi administrativ i kërkesës nuk ka filluar.

Kur njësia e urbanistikës në njësinë vendore nuk dërgon në adresë të kërkuesit, brenda 5 ditëve, njoftimin se do të nisë procedurën e shqyrtimit administrativ të kërkesës, aplikimi konsiderohet i pranuar në heshtje dhe njësia e urbanistikës detyrohet të nisë procedurën e shqyrtimit administrativ të kërkesës.

- Me fillimin e procedimit për shqyrtimin administrativ të kërkesës, njësia e urbanistikës dhe këshilli teknik duhet të shqyrtojë kërkesën brenda 35 ditëve nga data, në të cilën kërkesa konsiderohet e pranuar, sipas këtij neni.

Në rast se gjatë procedimit për shqyrtimin administrativ të kërkesës, njësia e urbanistikës konstaton se dokumentacioni i kërkuesit ka të meta tekniko-ligjore në përmbajtje, i dërgon kërkuesit njoftimin për plotësimin e të metave, duke i vendosur një afat, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

Me dërgimin e njoftimit të mësipërm, pezullohet llogaritja e afateve të shqyrtimit, sipas këtij ligji, deri në plotësimin e të metave nga kërkuesi. Me plotësimin e tyre, kërkuesi rivendoset në afatin 35-ditor të procedimit për shqyrtimin administrativ të kërkesës.

Nëse edhe pas përfundimit të afatit të vendosur për plotësimin e të metave në njoftim kërkuesi nuk ka plotësuar të metat e konstatuara, atëherë njësia e urbanistikës ndërpret procedimin

për shqyrtimin administrativ të kërkesës dhe njofton kërkuuesin, duke i kthyer edhe dokumentacionin.

Njësia e urbanistikës dhe këshilli teknik, brenda afatit 35-ditor, duhet të shqyrtojë kërkesën dhe t'i njoftojë kërkuuesit përfundimin e procedimit të shqyrtimit administrativ të kërkesës, pranimin ose jo të saj.

- Kur njësia e urbanistikës, në përfundim të afatit 35-ditor, nuk dërgon në adresë të kërkuuesit njoftimin për:

a) mospranimin e shqyrtimit administrativ të kërkesës;

b) depozitimin për shqyrtimin dhe miratimin e lejes së ndërtimit në KRRT në përfundim të procedimit për shqyrtim administrativ të kërkesës;

atëherë kërkesa konsiderohet e pranuar në heshtje dhe dokumentacioni i përcillet për shqyrtim dhe miratim KRRT-së së njësisë vendore.

#### Neni 46

Nga data e miratimit të destinacionit të funksionit dhe të kushteve urbanistike të sheshit të ndërtimit, deri në paraqitjen e kërkesës për leje ndërtimi, për sheshe në pronë publike me sipërfaqe deri në 0.1 hektar nuk duhet të kalojnë më shumë se tre muaj dhe për sheshe me sipërfaqe mbi 0.1 hektar jo më shumë se 6 muaj. Në rast të shkeljes së këtyre afateve për sheshe pronë publike, zyra apo seksioni i urbanistikës vë në dijeni këshillin e bashkisë ose këshillin e qarkut dhe këshillin e komunës sipas vendndodhjes së sheshit, i cili vendos për shtyrjen e afatit ose për një shpërndarje të re të sheshit.

Për rastet e territoreve pronë private afati kohor i vendimit të KRRT-së për miratimin e destinacionit të funksionit të sheshit të ndërtimit dhe të kushteve urbanistike të tij, pavarësisht nga sipërfaqja, është 6 muaj. Në rast se ky afat kohor kalohet, kërkesa ripërsëritet. Kur shkelen afatet për vendimin e sheshit të ndërtimit, si për territorin pronë private dhe ato pronë publike, vendimi i KRRT-së bëhet i pavlefshëm.

#### Neni 47

Ndalohet kalimi ose transferimi në çdo formë i lejes së ndërtimit.

#### Neni 48

Leja e ndërtimit kërkohet për kryerjen e punimeve si vijon:

- ndërtime të reja të çdo lloji, mbi e nëntokësore, shtesa, impiante të ndryshme, rrugë, ura, porte, aeroporte, autostrada, hekurudha, punime infrastrukture, ujësjellës, kanalizim, telefoni, elektrik, tubacione gazi, naftë, avulli, varreza, kariera të materialeve të ndërtimit,

- ndërtime mbi themele ekzistuese,

- ndryshime të objekteve që prekin anën e jashtme të tij me elemente arkitektonike, si dhe kur bëhen ndërhyrje në konstruksion dhe në qëndrueshmërinë e objektit ekzistues,

- hapje dhe mbyllje dritarësh, hapje në katet e para të objekteve ekzistuese, përshtatje në shtimin e vëllimit të objektit në formë shtesash anësore ose ngritje kati shtesë,

- ripunim të rifiniturave të jashtme, suvatime, ngjyrosje etj.,

- rrethime të përkohshme dhe të përhershme,

- rrethime e ndërtime të përkohshme për periudhën e realizimit të punimeve të ndërtimit,

- ndërtime barakash, ekspozitash, panarësh, tribunash, reklamash etj.

- prerje drurësh,

- prishje ndërtesash.

#### Neni 49

*(Hequr fjalët në paragrafin e parë me ligjin nr.10 319, datë 16.9.2010, neni 1/a;  
shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 319, datë 16.9.2010, neni 1/b)*

Drejtoria e urbanistikës në Bashkinë e Tiranës dhe seksionet e urbanistikës në rrethet dhe qytetet e kategorisë së parë shqyrtojnë kërkesat për leje ndërtimi për:

- rrethim të përkohshëm për sheshet e ndërtimit, të miratuar me afat kohor 6 muaj,
- hapje porte në mur rrethues, rrethim oborri i përkohshëm dhe i përhershëm,
- hapje dere dhe dritare që nuk cenon arkitekturën dhe konstruksionin,
- leje për ndryshim destinacioni të objekteve ekzistuese,
- leje për prishje ndërtesash.

Këto kërkesa shqyrtohen nga këshillat teknike përkatëse sipas procedurës së përcaktuar në nenin 22 dhe miratohen nga kryetari i bashkisë a kryetari i këshillit të qarkut të kategorisë së parë.

Leja për prerje drurësh është kompetencë e KRRT-së.

Sekretaria teknike informon KRRT-në lidhur me lejet e miratuara për këto raste.

Kur ndonjë anëtar i KRRT ka vërejtje për këto leje, atëherë ato diskutohen në mbledhjen e tij dhe KRRT-ja ka të drejtën e anulimit të këtyre lejeve.

Leja për vendosjen e reklamave, në anë të rrugëve, jepet nga KRRT-ja e bashkisë, komunës apo qarkut, në përputhje me parashikimet e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, pas marrjes së autorizimit përkatës, nga autoritetit që ka në përgjegjësi administrimi rrugën ku kërkohet të vendosen reklamat. Reklamat duhet të jenë konform specifikimeve teknike të përcaktuara në Kodin Rrugor dhe në rregulloren për zbatimin e tij.

#### Neni 50

*(Zëvendësuar fjalët me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009, neni 1;  
ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009, neni 7)*

KRRT-ja miraton ose kundërshton dhënien e lejes së ndërtimit me shumicë votash. Vendimi për miratimin e lejes së ndërtimit del me firmën e kryetarit të KRRT-së. Ky vendim shoqërohet edhe me planimetrinë përkatëse, që nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari i KRRT-së.

KRRT-ja nuk ka të drejtë të miratojë lejen e ndërtimit në rastet kur:

- Projekti i paraqitur ka ndryshuar destinacionin e sheshit të ndërtimit, përcaktuar nga studimi urbanistik;
- projekti i paraqitur ka ndryshuar përmasat e sheshit të ndërtimit.

Nga data e paraqitjes së kërkesës për leje ndërtimi deri në datën e miratimit ose kundërshtimit të saj, nuk duhet të kalojnë më shumë së 45 ditë pune.

Në sekretarinë teknike të KRRT-së depozitohet i gjithë dokumentacioni teknik i paraqitur, që përfshin dokumentet sipas ligjit dhe projektin e plotë teknik, si dhe llogaritjet bazë të konstruksionit dhe preventivin. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal dhe në gjuhën shqipe.

#### Neni 50/1

*(Shtuar neni me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009, neni 8)*

Kalimi për miratim i lejes së ndërtimit, qoftë edhe nëpërmjet heshtjes, në shkelje të kushteve urbanistike për dhënien e lejes së ndërtimit, të parashikuara në këtë ligj, përbën mospërbushje të rregullt të detyrës.

Shkelje me dashje e dispozitave për kalimin për miratim të lejes së ndërtimit, qoftë edhe nëpërmjet heshtjes, passjell përgjegjësi penale, sipas ligjit.



#### Neni 51

*(Riformuluar me ligjin nr.8501, datë 16.6.1999, neni 2)*

*(Shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr.8682, datë 7.11.2000, neni 1)*

*(Shfuqizuar paragrafi i dytë me ligjin nr.8982, datë 12.12.2002, neni 26)*

*(Ndryshuar fjalia e fundit në paragrafin e parafundit me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009, neni 9)*

*(Shtuar paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 097, datë 19.3.2009, neni 1)*

Personi fizik dhe juridik, përpara marrjes së dokumentit të lejes së ndërtimit, duhet të paguaje 1 për qind të vlerës së investimit që do të kryejë sipas preventivit të objektit. Ky fond depozitohet për llogari të financimit të studimeve urbanistike në pushtetin vendor.

Shfuqizuar.

Pagesa bëhet menjëherë në seksionin e financës së këshillit të rrethit apo qytetit të kategorisë së parë me autorizim të sekretarisë teknike të KRRT-së. Dokumenti i lejes së ndërtimit i jepet personit fizik apo juridik jo më vonë se 1 ditë pas datës së depozitimit të dokumentit të pagesës në dosjen e objektit. Në rast se kërkuesi nuk kryen pagesën brenda 30 ditëve nga njoftimi për detyrimin ndaj shtetit, sipas ligjit, atëherë për çdo ditë vonesë i llogaritet kamata 0,2 për qind në ditë e shumës që duhet të paguajë, deri në 60 ditë. Nëse në përfundim të këtij afati kërkuesi ende nuk ka paguar detyrimin, kamata llogaritet 1 për qind në ditë deri në 30 ditë të tjera. Në rast të kundërt, KRRT-ja vendos masa të tjera të përshtatshme, deri në anulimin e vetë lejes së miratuar.

Përfshihen komunat që kryejnë investime me fondet e FZSHH-së nga pagesa e 1 për qind e vlerës së investimit sipas preventivit të objektit për llogari të financimit të studimeve urbanistike të pushtetit vendor dhe 1 për qind për rikonstruksionin e rrjeteve të infrastrukturës nga organet e pushtetit vendor.

Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, përpara marrjes së dokumentit të lejes së ndërtimit paguhet 0,1 për qind e vlerës së investimit, që depozitohet për llogari të financimit të studimeve urbanistike të pushtetit vendor, por, në çdo rast, jo më e vogël se vlera e nevojshme për të financuar studimet, që pushteti vendor duhet të bëjë për këto investime të infrastrukturës, përveçse kur është parashikuar ndryshe në ligje të veçanta.

#### Neni 52

Afati i vlefshmërisë së lejes të ndërtimit përcaktohet në vendimin e marrë nga KRRT dhe KRRTSRH. Kur objekti që ndërtohet ka nevojë për një kohëzgjatje më të madhe se ajo e miratuar, bëhet kërkesa përkatëse bashkë me argumentimin për zgjatjen e afatit të lejes. Në këtë rast, personat fizikë a juridikë nuk bëjnë pagesë shtesë.

#### Neni 53

*(Ndryshuar me ligjin nr.9743, datë 28.5.2007, neni 7)*

Leja e ndërtimit i jepet kërkuesit të saj sipas formularit nr.4, pjesë e ligjit, përveç lejeve të ndërtimit për projektet e infrastrukturës rrugore. Formulari i lejes së ndërtimit për projektet e infrastrukturës rrugore miratohet nga ministri përgjegjës. Për rastet kur sipërfaqja e sheshit është mbi 0.5 hektar, leja e ndërtimit plotësohet nga sekretaria teknike e KRRT-së, pasi është miratuar leja në KRRTSRH.

Formulari i lejes plotësohet nga sekretari i KRRT-së/KRRTSRH-së. Për objektet që prokurohen me fonde shtetërore, lejen e ndërtimit e merr organi që miraton fondin, përpara se të japë në sipërmarrje ndërtimin e objektit.

#### Neni 54

*(Ndryshuar fjalë në paragrafët e fundit dhe të parafundit me ligjin nr.9843, datë 17.12.2007, neni 5; shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 319, datë 16.9.2010, neni 2)*

Në lejen e ndërtimit përcaktohet detyrimi për pranimin e kontrollit të realizimit të ndërtimit nga drejtoria e urbanistikës në Bashkinë e Tiranës, nga seksioni i urbanistikës në rreth dhe në qytetet e kategorise së parë, nga zyra e urbanistikës në bashki e komunë, të cilat duhet të njoftojnë me shkrim sekretarinë teknike të KRRT-së për çdo kontroll. Kontrolli bëhet me dokument për:

- piketimin e objektit;
- përfundimin e themeleve;
- përfundimin e karabinasë për të gjithë objektin;
- përfundimin e sistemimit të jashtëm në sheshin e ndërtimit sipas projektit.

Çdo akt kontrolli depozitohet në dosjen e objektit. Përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë të gjitha rastet kur vërtetohet se sipërfaqja dhe volumi i objektit që ndërtohet është zmadhuar jashtë kushteve të projektit të miratuar në lejen e ndërtimit. Masa e dënimit me gjobë do të jetë sa vlera e ndërtimit jashtë projektit të miratuar. Vlera e gjobës për këtë kundërvajtje administrative caktohet nga inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut.

Në rastet kur KRRT apo inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut vendos prishjen e volumit që është ndërtuar jashtë projektit të miratuar, shpenzimet e prishjes mbulohen nga kundërvajtësi.

Inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut dhe/ose INUK-ja i drejtohet, sipas rastit, sekretarive teknike përkatëse të KRRT-së ose KRRTRSH-së, me kërkesë të veçantë, për t'u shprehur, brenda një afati 30-ditor, për volumin shtesë të objektit, që ndërtohet jashtë kushteve të projektit të miratuar në lejen e ndërtimit. Në përfundim të afatit 30-ditor, nëse KRRT-ja ose KRRTRSH-ja nuk shprehet me vendim, atëherë inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut ose INUK-së i lind e drejta për të vazhduar procedurat për prishjen e objektit.

#### Neni 55

Shitja e truallit pronë shtetërore ose publike bëhet në përputhje me ligjin nr.7980, datë 27.7.1995 "Për shitjen e trojeve". Në rastet e ndërtimeve në prona publike, në çastin e marrjes së lejes së ndërtimit, personi fizik e juridik paguan 50 për qind të vlerës së truallit dhe, kur përfundon karabinaja e katit të parë, paguhet edhe pjesa tjetër e kësaj vlere.

#### Neni 56

Në ngritjen e kantierit, personi fizik e juridik që zbaton punimet është i detyruar të ekspozojë në një vend të dukshëm tabelën me të dhënat për llojin e objektit, emrin e shoqërisë zbatuese, drejtorin e punimeve, përgjegjësën e zbatimit të punimeve, emrin e personit juridik a fizik projektues dhe afatin e përfundimit të punimeve.

#### Neni 57

Në lejen e ndërtimit përcaktohen kufiri i rrethimit të përkohshëm, lartësia dhe lloji i rrethimit për të mos penguar pamjen për qarkullimin rrugor dhe anën estetike dhe, në asnjë rast, nuk lejohet që rrethimi të zërë trotuarin. Përpara marrjes së lejes së ndërtimit, kërkuesi i saj deklaron me shkrim se do të mbajë pastër rrugët, trotuarin dhe mjedisin rreth objektit gjatë ndërtimit dhe me përfundimin e punimeve, do ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme, veçanerisht rrugët dhe trotualet e dëmtuar, si dhe linjat nëntokësore. Kur veprimet, në kundërshtim me kushtet e lejes së ndërtimit, të cilat shkaktojnë dëmtimin e mjedisit, KRRT ka të drejtë të pezullojë punimet dhe të kërkojë përmbushjen e detyrimeve sipas deklaramit, si dhe pagesën e shpenzimeve me vlerë të barabartë me punimet që do të kryhen deri në kthimin e mjedisit përreth në gjendjen e mëparshme.

Për rastet kur punimet ndërpriten nga vetë zotëruesi i lejes, mbaron afati i lejes së ndërtimit, si dhe kur për shkak të ndërprerjes së punimeve, faza e ndërtimit të objektit krijon shqetësime për funksionet dhe gjendjen e mjedisit rrethues, zotëruesi i lejes gjobitet. Në rast se punimet nuk vazhdojnë përsëri, atëherë këshilli i qarkut, këshilli i bashkisë ose këshilli i komunës i rekomandojnë KRRT, krahas heqjes së lejes së ndërtimit, edhe zgjidhje të tjera për të rivendosur funksionet dhe gjendjen normale të asaj zone.

#### Neni 58

Leja për ndërtime të objekteve të përkohshme jepet vetëm për rastet e fatkeqësive natyrore ose për raste të njehsuara me to. Ndërtimet e përkohshme kryhen me materiale të çmontueshme, pa përdorur struktura beton armeje, blloqe betoni, murature e soleta.

Leja për ndërtimin e këtyre objekteve të përkohshme jepet për një periudhë deri një vit.

#### Neni 59

*(Ndryshuar fjalia e dytë me ligjin nr.9843, datë 17.12.2007, neni 6)*

Objektet që paraqesin rrezik shembje me pasoja për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve, që nuk janë riparuar nga pronari brenda afatit maksimal të qëndrueshmërisë fizike të tyre, të përcaktuar në bazë të raporteve teknike të ekspertëve, shëmben në afatin që caktohet me vendim të KRRT-së nga vetë pronari. Me kalimin e këtij afati, ato prishen nga inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut, në bazë të vendimit të KRRT-së. Shpenzimet e shembjeve paguhen nga pronari i objektit. Urdhri i nënshkruar nga kryetari i KRRT-së për nxjerrjen e këtyre shpenzimeve është titull ekzekutiv.

#### Neni 60

Drejtoria e urbanistikës në Bashkinë e Tiranës, zyrat e urbanistikës në njësitë administrative të saj, zyrat e urbanistikës në bashkitë e tjera, seksionet e urbanistikës në këshillat e qarqeve dhe zyrat e urbanistikës në komuna kontrollojnë destinacionin e përdorimit të ndërtimeve në përputhje me atë të miratuar.

Çdo ndryshim i destinacionit të ndërtesave në përgjithësi, kalimi i ndërtesave private nga pronësia e një pronari tek një tjetër, dhe kur ky kalim bëhet duke ndryshuar destinacionin, bëhet pasi të merret leje në zyrat e përmendura më lart.

#### Neni 61

Në studimet rajonale, masterplanet, planet rregulluese të përgjithshme dhe studimet pjesore urbanistike, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave bëhet klasifikimi i zonave pyjore, zonave me vlerë mjedisore, parqeve pyll, brezave të gjelbëruar e territoreve të gjelbëruara që duhen ruajtur, mbrojtur e shtuar. Ky klasifikim, pas miratimit, ndalon çdo lloj ndryshimi, dëmtimi e zvogëlimi të sipërfaqeve të gjelbëruara nëpërmjet dhënies së shesheve të ndërtimit, ndryshimit të destinacionit të tyre, që shkaktojnë dëmtime në mbrojtjen, ruajtjen dhe shtimin e këtyre zonave.

#### Neni 62

KRRT-të e qarqeve, të bashkive të qyteteve të kategorise së parë, të Bashkisë së Tiranës dhe KRRT-TRSH nuk kanë të drejtë të miratojnë asnjë ndërtim të përhershëm ose provizor, jashtë funksionit të territorit të përcaktuar në studimet e miratuara, në territore pronë publike të tilla si:

- territore të objekteve social-kulturore,
- territore të gjelbërta,
- territore sportive,
- sheshe dhe hapësira ndërmjet blloqeve të ndërtuara të banesave;
- rrugë, sheshe publike dhe vendqëndrime, të përcaktuara dhe interpretuara në Rregulloren

e Urbanistikës. Ndërtimet që mund të bëhen janë vetëm ato të përcaktuara në studimin urbanistik në përputhje të plotë me funksionin e miratuar.

Për rastet e pronave të kthyera nga komisionet e kthimit dhe të kompesimit të pronave ish-pronarëve, kur këto prona gjenden në territore të tilla, KRRT-të e të gjitha niveleve nuk kanë të drejtë të ndryshojnë destinacionin e përcaktuar në studimin e miratuar. Në këto raste pronarët e tokave kanë të drejtë të kërkojnë kompesim sipas ligjeve në fuqi.

#### Neni 63

Kërkesa për të bërë prerje apo shkulje drurësh bëhet sipas formularit nr.6, që i bashkangjitet këtij ligji. Kjo kërkesë shqyrtohet nga KRRT në juridiksion të të cilit ndodhet zona ku do të priten ose do të shkulen pemët. Në rast se KRRT vendos miratimin e kësaj kërkesë, ai jep lejen e ndërtimit, e cila lëshohet vetëm pasi është bërë pagesa për çdo prerje apo dëmtim tjetër. Pagesa bëhet pranë ndërmarrjes në varësi të bashkisë, komunës apo rrethit që administron territoret e gjelbërta.

Personi fizik e juridik, para se t'i jepet leja për prerje drurësh, është i detyruar të bëjë mbjellje pemësh me trefishin e drurëve që do të priten, në një zonë ku do ta caktojë ndërmarrja e gjelbërimit ose pyjeve.

Leja për prerje drurësh është e vlefshme vetëm për një periudhë 3-mujore.

### KREU V NDËRTIMET NË ZONAT TURISTIKE

#### Neni 64

Zonat turistike bregdetare, liqenore dhe kontinentale janë të miratuara me dispozita të veçanta. Ato kanë kufirin gjeografik të shtrirjes së tyre, të miratuar nga organet përkatëse. Kriteret, që ndiqen për ndërtimet brenda këtyre kufijve, përcaktohen me ligj.

#### Neni 65

Zhvillimi i ndërtimeve në zona turistike përcaktohet në planet rajonale dhe masterplanet e zhvillimit turistik.

#### Neni 66

Zhvillimi i ndërtimeve në zona turistike bëhet duke ruajtur në maksimum natyrën dhe funksionet e tyre. Këto ndërtime zhvillohen si rregull në territore që dëmtojnë sa më pak gjelbërimin.

Nuk lejohet zhvillimi i një strukture turistike pa studim të miratuar të infrastrukturës inxhinierike.

#### Neni 67

Me qëllim që të mbrohen zonat turistike:

- Ndalohet marrja e materialeve tokësore brenda kufirit të zonës turistike, sikurse janë: dhe, zhavorr, rërë, gurë, dru etj.
- Ndalohet marrja e materialeve nga shtretërit e lumenjve, në zonat bregdetare dhe bregliqenore.
- Ndalohet kryerja e punimeve të tharjes, të bonifikimit, të krijimit të dambave dhe e punimeve të tjera bonifikuese, përveç rasteve të miratuara nga KRRTRSH, Këshilli Kombëtar i Ujërave dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bazë të dispozitave të ndikimit në mjedis.

Këto kushte vlejné dhe për punimet e mbrojtjes bregdetare që kryhen nga Ministria e Mbrojtjes.

#### Neni 68

Qytetet, fshatrat dhe qendrat e tjera të banuara që ndodhen brenda kufirit të zonave turistike, bregdetare, liqenore dhe kontinentale zhvillohen mbi bazën e planeve rregulluese të tyre. Bashkekzistenca me sistemet ekologjike natyrore zgjidhet nëpërmjet studimeve rajonale dhe të masterplaneve.

#### Neni 69

Krijimi dhe zgjerimi i porteve bregdetare tregtare, turistike dhe të peshkimit, si dhe të zonave industriale, tregtare e turistike përkatëse bëhet mbi bazën e masterplaneve të zhvillimit të zonave turistike.

#### Neni 70

Sheshet e ndërtimit për objektet turistike bregdetare, liqenore e kontinentale miratohen në përputhje me studimet urbanistike të miratuara nga KRRTRSH. Studimet dhe sheshet e ndërtimit të miratuara në këto zona, i vihen në dispozicion Komitetit të Zhvillimit të Turizmit për zgjedhjen e ofertave për investim. Lejet për ndërtimet në zonat turistike bregdetare, liqenore dhe kontinentale miratohen nga KRRTRSH. Procedura e plotësimit dhe dorëzimit të dokumentacionit bëhet në seksionin e urbanistikës së rrethit përkatës, pasi të jetë marrë më parë vendimi i Komitetit të Turizmit dhe i Agjencisë Kombëtare së Mjedisit.

### KREU VI

#### ADMINISTRIMI I ZONAVE DHE TERRITOREVE ME VLERA TË VEÇANTA KULTURORE, MJEDISORE, ARKEOLOGJIKE, MUZEALE E STRATEGJIKE

#### Neni 71

Në hartimin e studimeve rajonale, masterplaneve të zhvillimit territorial, planeve rregulluese e studimeve pjesore, territoret me vlera të veçanta mjedisore, historike, kulturore, arkeologjike, muzeale, ushtarake e strategjike evidentohen, përkufizohen e mbrohen në përputhje me dispozitat e veçanta.

#### Neni 72

Në hartimin e studimeve rajonale, masterplaneve të zhvillimit territorial, planeve rregulluese e studimeve pjesore, përcaktohen territoret me vlera mjedisore, sistemet ekologjike, parqet kombëtare, rezervatet e florës dhe të faunës, sipas klasifikimit dhe kriterëve për ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre, të parashikuara në dispozita të veçanta.

#### Neni 73

Zonat, komplekset dhe objektet ndërtimore ekzistuese me vlera arkeologjike, muzeale dhe historike duhet të respektohen në studimet urbanistike duke siguruar mbrojtjen e tyre sipas kërkesave të institucioneve të specializuara. Ndalohet çdo lloj ndërtimi deri në një distancë 200 m nga kufiri i zonave arkeologjike të vëna në mbrojtje. Ndërtimet në qytetet muze, në zonat e mbrojtura të tyre dhe në afërsi të monumenteve të veçantë, si dhe zonat rreth tyre, bëhen sipas përcaktimit të këtij ligji duke marrë më parë mendimin e institucioneve përkatëse.

## Neni 74

Ruajtja, mbrojtja dhe zhvillimi i strukturave dhe objekteve urbanistike - arkitektonike me vlera të veçanta pasqyrohen në studimet urbanistike dhe miratohen në KRRTRSH.

## KREU VII

### NDËRTIMET E KUNDËRLIGJSHME DHE ZËNIA ARBITRARE E TRUALLIT

## Neni 75

*(Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr.9843, datë 17.12.2007, neni 7; shtuar një fjali në fund të paragrafit të parë me ligjin nr.10 319, datë 16.9.2010, neni 3/a; shtuar një fjali në fund të paragrafit të fundit me ligjin nr.10 319, datë 16.9.2010, neni 3/b)*

Zënia arbitrare e truallit për çdo lloj ndërtimi, përveç dënimit me gjobë, shoqërohet edhe me detyrimin e prishjes së menjëhershme të objektit dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e kundërvajtësit. Shpenzimet e prishjes së objektit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme realizohen në bazë të vendimit për zhdëmtim, të dhënë nga inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut.

Vënia e gjobës, prishja e objektit dhe kthimi i truallit në gjendjen e mëparshme realizohen në bazë të vendimit të dhënë nga inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut. Ekzekutimi i vendimit bëhet nga inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut, me ndihmën e organeve dhe të subjekteve të specializuara, sipas legjislacionit në fuqi. Përfundim nga rastet e prishjes bëhet kur inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut çmon mundësinë e konfiskimit të objektit të kundërligjshëm, në favor të shtetit, sipas parashikimeve në kuadrin ligjor në fuqi, vetëm pas marrjes së miratimit teknik, sipas rastit, nga KRRT-ja/KRRTRSH-ja.

## Neni 76

Ndërtimet e bëra pa leje ndërtimi janë të kundërligjshme. Ndalohet hipotekimi dhe regjistrimi i tyre në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

Për efekt të zbatimit të planeve urbanistike nuk bëhet asnjë lloj zhdëmtimi apo shpronësimi për ndërtimet e kundërligjshme, si nga organet shtetërore, ashtu dhe nga privatët që zbatojnë planet urbanistike të miratuara nga organet kompetente.

## Neni 76/1

*(Shtuar neni me ligjin nr.10 319, datë 16.9.2010, neni 4)*

1. Subjekti që disponon mjete apo makineri që përdoren në fushën e ndërtimit është i detyruar të mos ofrojë shërbimin e tij, për persona fizikë apo juridikë, të cilët nuk janë të pajisur me leje ndërtimi. Për këtë qëllim, subjekti që disponon mjete apo makineri që përdoren në fushën e ndërtimit, kërkon paraprakisht, nga ndërtuesi, paraqitjen e lejes së ndërtimit.

2. Shkelja e detyrimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas nenit 81 të këtij ligji.

## Neni 77

*(Ndryshuar paragrafi i parë, shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr.8501, datë 16.6.1999, neni 3)*

Për ndërtimet e kundërligjshme të bëra deri në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, veprohet si vijon:

- Kur ndërtimet e kryera pengojnë realizimin e studimeve të miratuara të çdo niveli që janë në fuqi, KRRT vendos prishjen e tyre sipas fazave të realizimit të studimeve.

- Kur ato përbëjnë rrezik për mjedisin apo kanë zënë territoret publike, prishen menjëherë.

Për ndërtimet e kryera pa leje nga pronarët në pronën e tyre, kur plotësohen kushtet urbanistike, KRRT vendos për legalizimin e ndërtimit me kushtin e detyrimit të pagesës së gjobës të barabartë me 10 për qind të vlerës së investimit të realizuar, ndërsa për shtëpitë e banimit 4 për qind të kësaj vlere. Kjo vlerë investimi me kërkesë të seksionit a zyrës urbanistike përcaktohet nga ekspertët vlerësues të pasurive të paluajtshme. Shpërblimi i ekspertëve miratohet nga zyra a seksioni urbanistik dhe përballohet nga kundërvajtësi.

Legalizimi i këtyre ndërtimeve, përveç përcaktimit të mësipërm, bëhet duke përmbushur edhe detyrimet ligjore, sipas nenit 51.

#### Neni 78

*(Ndryshuar fjalia e dytë dhe e tretë me ligjin nr.9843, datë 17.12.2007, neni 8)*

Ndërtimet që kryhen pa leje ndërtimi në sheshin e miratuar, janë ndërtime të kundërligjshme. Seksioni i urbanistikës në bashki/komunë/qark, Drejtoria e Urbanistikës në Bashkinë e Tiranës, policia bashkiake dhe personat e tjerë të interesuar, kur vërejnë ndërtime të kundërligjshme, njoftojnë menjëherë inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë / komunës / qarkut, i cili, pas marrjes së njoftimit ose me nismën e vet, vendos menjëherë pezullimin e ndërtimit të kundërligjshëm dhe masën përkatëse, sipas nenit 81 të ligjit “Për urbanistikën” dhe legjislacionit në fuqi.

#### Neni 79

*( Ndryshuar fjalia e dytë, shfuqizuar fjalia e fundit me ligjin nr.9843, datë 17.12.2007, neni 9)*

Për ndërtimin e kundërligjshëm, të pezulluar sipas nenit 78, merr vendim KRRT e qarkut ose e Bashkisë së Tiranës në mbledhjen e tij më të afërt.

KRRT-ja jep lejen e ndërtimit, kur ndërtimi plotëson kërkesat e këtij ligji. Në rast të kundërt, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut merr vendim për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm.

#### Neni 80

*(Ndryshuar fjalia e parë me ligjin nr.9843, datë 17.12.2007, neni 10)*

Në rastet kur zbatimi i procedurave të neneve 75 dhe 79 pengohet nga kundërvajtësit, duke sjellë apo që mund të kenë pasoja për rendin publik, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut thërret në ndihmë forcat e rendit publik.

Në rastet kur kundërshtimi nga ana e kundërvajtësve përbën veprë penale, pa vonesë bëhet kallëzim për veprë penale oganit të ndjekjes penale.

### KREU VIII SANKSIONET

#### Neni 81

*(Ndryshuar me ligjin nr.9843, datë 17.12.2007, neni 11;  
hequr numri “75” në paragrafin e katërt me ligjin nr.10 319, datë 16.9.2010, neni 5/a;  
shtuar një fjali në fund të paragrafit të pestë me ligjin nr.10 319, datë 16.9.2010, neni 5/b  
shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 319, datë 16.9.2010, neni 5/c)*

Përveç detyrimeve që përmbajnë këto dispozita, shkelja dhe kryerja e veprimeve të kundërligjshme, që përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e urbanistikës, dënohen me gjobë si më poshtë:

- Për nenet 34, 56, 57, 58 me shumën 50 000 lekë deri në 200 000 lekë.
  - Për nenet 60, 61, 63 me shumën 200 000 lekë deri në 500 000 lekë.
  - Për nenet 66, 67, 73 me shumën 500 000 lekë deri në 2 000 000 lekë.
  - Për nenet 77, 78 me shumën 2 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë.
- Për nenin 54 masa e dënimit me gjobë është sa vlera e ndërtimit jashtë projektit të miratuar, që llogaritet sipas kostos mesatare të ndërtimit, të përcaktuar me udhëzim të Këshillit të Ministrave. Në rast konstatimi të mosrespektimit të përcaktimeve të parashikuara në nenin 75, vlera e dënimit me gjobë përllogaritet në masën 5 për qind të vlerës së ndërtimit të kryer.

Gjoha vendoset nga inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut.

Për shkelje të nenit 76/1, inspektorati ndërtimor e urbanistik i komunës/bashkisë/qarkut vepron si më poshtë:

1. Vendos dënimin me gjobë:

a) në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për vënien në dispozicion të mjeteve dhe makinerive vetëlëvizëse (transportierë të çdo tipi, makineri të çdo tipi për përgatitjen e betonit, makineri të çdo tipi për pompimin e llaçit e betonit, si dhe makineritë e çdo tipi që përdoren në procesin e gërmimit);

b) në masën 100 (njëqind) lekë/m<sup>2</sup>, për vënien në dispozicion të skelave, në varësi të sipërfaqes së mbulimit;

c) në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, për vënien në dispozicion të veglave të punës.

2. Vendos sekuestrimin e mjeteve dhe të makinerive për një afat deri në 6 muaj.

#### Neni 82

*(Shfuqizuar me ligjin nr.9843, datë 17.12.2007, neni 12)*

#### Neni 83

*(Ndryshuar fjalia e parë me ligjin nr.9843, datë 17.12.2007, neni 13)*

Ankimi në gjykatë kundër vendimeve të KRRT-ve dhe të inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut nuk pezullon ekzekutimin e tyre.

Në rast se, në bazë të vendimit përfundimtar të formës së prerë të gjykatës vendoset pranimi i padisë ose i ankimit, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë, nga organi që ka dhënë vendimin, shpërblimin për dëmin e shkaktuar.

#### Neni 84

*(Ndryshuar me ligjin nr.9843, datë 17.12.2007, neni 14)*  
*(Zëvendësuar fjalët me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009, neni 1)*

Gjobat, dëmshpërblimet dhe shpenzimet e prishjes, të përcaktuara në këtë ligj, paguhet nga kundërvajtësit brenda 5 ditë pune nga data e njoftimit të vendimit të inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut ose nga data kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati paguhet kamata 2 për qind në ditë pune deri në një muaj. Pas kalimit edhe të këtij afati (një muaj), inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut kërkon ekzekutimin e tij, sipas procedurave të ligjit "Për kundërvajtjet administrative" dhe më pas në rrugë gjyqësore, sipas ligjeve në fuqi. Gjobat, shpërblimet dhe shpenzimet paguhet në zyrën e financës së organit të pushtetit vendor.

#### **Dispozita kalimtare**

*(Shtuar neni me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009, neni 10)*

1. Ngarkohen institucionet kompetente, shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, energjisë elektrike, telekomunikacionit, Instituti Sizmologjik dhe Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të depozitojnë pranë njësive vendore përkatëse të gjitha të dhënat e përditësuara dhe materialin e përditësuar hartografik mbi rrjetet infrastrukturore, si dhe të bëjnë përditësimin periodik 6-mujor të të dhënave mbi rrjetet infrastrukturore dhe t'ia vënë



atë në dispozicion njërive vendore përkatëse. Për kalimin e informacionit të mësipërm nuk aplikohet tarifë.

2. Pika 1 e nenit 4 të këtij ligji hyn në fuqi pasi institucionet dhe shoqëritë e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni kanë bërë kalimin e të dhënave hartografike, sipas afatit 3-mujor.

3. Dispozitat e parashikuara në këtë ligj nuk zbatohen për kërkesat e paraqitura para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilat janë depozituar ose janë në fazë shqyrtimi nga njësitë vendore.

#### Neni 85

*(Shtuar numri 1/1 me ligjin nr.10 319, datë 16.9.2010, neni 6)*

Formularët bashkëngjitur nr.1, 1/1, 2, 3, 3/1, 4,5, 6, 7, 8 dhe 9 janë pjesë integrale e këtij ligji.

#### Neni 86

Ligji nr.7693, datë 6.4.1993 "Për urbanistikën" dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohet.

#### Neni 87

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Ligji nr.8405, datë 17.9.1998 shpallur me dekretin nr.2222, datë 28.9.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.23, faqe 897*

**Ligji nr.8453, datë 4.2.1999 shpallur me dekretin nr.2313, date 11.2.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.5, faqe 151*

**Ligji nr.8501, datë 16.6.1999 shpallur me dekretin nr.2399, date 29.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.20, faqe 664*

**Ligji nr.8682, datë 7.11.2000 shpallur me dekretin nr.2797, datë 17.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.37, faqe 1808*

**Ligji nr.8991, datë 23.1.2003 shpallur me dekretin nr.3682, datë 10.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.5, faqe 152*

**Ligji nr.9743, datë 28.5.2007**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.74, faqe 2220*

**Ligji nr.9843, datë 17.12.2007 shpallur me dekretin nr.5565, datë 4.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.180, faqe 5605*

**Ligji nr.10 078, datë 16.2.2009 shpallur me dekretin nr.6080, datë 4.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.22, faqe 1392*

**Ligji nr.10 097, datë 13.3.2009 shpallur me dekretin nr.6124, datë 8.4.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.46, faqe 2279*

**Ligji nr.10 319, datë 16.9.2010 shpallur me dekretin nr.6698, datë 4.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.135, faqe 7421*

**K Ë R K E S Ë**  
**PËR MIRATIMIN E DESTINACIONIT DHE KONDICIONEVE**  
**URBANE TË SHESHIT TË NDËRTIMIT**

**OBJEKTI** \_\_\_\_\_

SEKRETARISË TEKNIKE TË K.RR.T. NË KËSHILLIN E RRETHIT \_\_\_\_\_

Kërkuesi ..... \_\_\_\_\_

*Emri                      Mbiemri*

Adresa ..... \_\_\_\_\_

Adresa e sheshit të ndërtimit ..... \_\_\_\_\_

Sipërfaqja e sheshit.....| | | | | ■ (m<sup>2</sup>) ose .....| | | | | ■ (ha)

Pozicioni topografik (kufizimet) me relief të harruar nga organe ose individë me licencë gjeodezike..... \_\_\_\_\_

- Veriu..... \_\_\_\_\_
- Jugu..... \_\_\_\_\_
- Lindje..... \_\_\_\_\_
- Perëndim..... \_\_\_\_\_
- Dokumenti i pronësisë së sheshit (private ose publike)..... \_\_\_\_\_

Studimi urbanistik për vendosjen e objektit ose objekteve:

- Volumi.....| | | | | ■ (m<sup>3</sup>)
- Sipërfaqe e ndërtimit .....| | | | | ■ (m<sup>2</sup>)
- Koeficienti i shfrytëzimit të truallit..... | | ■
- Lartësia e Përgjithshme.....| | | | | (m<sup>2</sup>)
- Numri maksimal i kateve mbi e nën tokë..... | | | | |
- Fotokopje e licencës së urbanistit që ka bërë studimin

Bashkë me këtë kërkesë paraqesë:

- Relievi i zonës shkalla 1:500 dhe relieve ndihmëse 1:1000, 2000, 5000
- Azhornimet në planimetri, shkalla 1:5999
- Infrastruktura rrugë, kanalizime, elektrike, telefoni.
- Plan vendosja e objektit që do të ndërtohet ku evidentohen konturi i ndërtimit, distancat nga kufiri i pronës dhe nga pronat e objektet kufitare si dhe lidhja me rrugën dhe distancën nga aksi i rrugës

pronës dhe nga pronat e objektet kufitare si dhe lidhja me rrugën dhe distancën nga aksi i rrugës

- Vija kryesore e ndërtimit
- Pikat e lidhjeve në infrastrukturën e rrjetit publik.
- Intensiteti sizmik i sheshit të ndërtimit mbi bazën e studimit sizmologjik dhe mikrozonimit sizmik
- Dokumenti i pronësisë për pronësinë private nga zyra e hipotekës
- Dokumenti që vërteton që prona është publike dhe i është dhënë kërkuesit.
- Mendimi i zyrës së urbanistikës sipas përkatësisë

SHËNIM: Ky formular përdoret edhe për rastet kur kërkohet miratimi i studimeve urbanistike.

**K E R K U E S I**

Formulari 1/1

**LIDHJA E OBJEKTIT  
ME INFRASTRUKTURËN RRUGORE**  
*(Shtuar formulari 1/1 me ligjin nr.10 319, datë 16.9.2010, neni 6)*

**OBJEKTI:**

---

1. Lidhja e sheshit të ndërtimit të objektit me rrugën (hyrja – dalja):

Pika e lidhjes

---

---

---

---

---

Shënim i autoritetit që administron dhe mirëmban rrugën

---

---

---

2. Mendimi i zyrës së urbanistikës sipas përkatësisë

---

---

---

---



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË RRETHIT \_\_\_\_\_

SEKRETARIA TEKNIKE E KRRT

VENDIM I KRRT NR. \_\_\_\_ DATË \_\_\_\_/\_\_\_\_/199\_\_

PËR MIRATIMIN E DESTINACIONIT TË SHESHIT TË NDËRTIMIT DHE KONDICIONEVE URBANE TË TIJ

Z. \_\_\_\_\_  
Emri Mbiemri

KRRT e Rrethit me Vendimin nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/199\_\_ miratoi sheshin e ndërtimit, destinacionin e funksionit të tij dhe kondicionet urbane etj.

**OBJEKTI** \_\_\_\_\_

Sipërfaqja e sheshit ..... [ ] [m<sup>2</sup>]; ose ..... [ ] [ha].  
 Sipërfaqja e ndërtimit ..... [ ] [m<sup>2</sup>]  
 Koeficienti i shfrytëzimit të territorit ..... [ ]  
 Numri i kateve mbi tokë ..... [ ] Numri i kateve nën tokë ..... [ ]  
 Volumi i objektit në ..... [ ] [m<sup>3</sup>]  
 Lartësia e Përgjithshme ..... [ ] [m] Numri maksimal i kateve ..... [ ]  
 Distanca e volumit nga aksi i rrugës ..... [ ] [m]  
 Distanca e volumit nga trotuari ..... [ ] [m]  
 Distanca e volumit nga kufiri i pronës:  
 Veriu ..... [ ] [m]  
 Jugu ..... [ ] [m]  
 Lindja ..... [ ] [m]  
 Perëndimi ..... [ ] [m]  
 Loji i mbulesës ..... \_\_\_\_\_  
 Hyrja kryesore nga ..... \_\_\_\_\_  
 Hyrjet e shërbimit nga ..... \_\_\_\_\_  
 Intensiteti Sizmik i sheshit të ndërtimit [ ] [ballë]  
 Kondicione të veçanta ..... \_\_\_\_\_

Afati ligjor i këtij vendimi është deri më datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/199\_\_:

- për pronën publike : për sipërfaqe sheshi deri 0.1 ha ..... 3 muaj.
- për sipërfaqe sheshi mbi 0.1 ha ..... 6 muaj.
- për pronën private : pamvarësisht nga madhësia e sheshit 6 muaj.

SEKRETARI I KRRT

KRYETARI I KRRT

(.....)

(.....)

Date \_\_\_\_/\_\_\_\_/199\_\_

**KËRKESË  
PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË OBJEKTIT**

OBJEKTI \_\_\_\_\_

**SEKRETARIË TECHNKE TË K.A.B.T. NË KËSHILLIN E RRËZBIT** \_\_\_\_\_

Kërkuesi ..... \_\_\_\_\_  
Emri Mbiemri

Adresa ..... \_\_\_\_\_

Adresa e sheshit të ku do të ndërtohet objekti ..... \_\_\_\_\_

Pronë publike .....  Pronë private .....  (plotëso me kryq)

Konfirmimi nga kadastra urbane e sheshit të ndërtimit ..... \_\_\_\_\_

Sipërfaqja e sheshit ... [ ][ ][ ][ ][ ][ ] [m<sup>2</sup>]; Sipërfaqja e ndërtimit [ ][ ][ ][ ][ ][ ] [m<sup>2</sup>]

Vëllimi i objektit ..... [ ][ ][ ][ ][ ][ ] [m<sup>3</sup>]

Vlera sipas projektit të zbatimit ..... [ ][ ][ ][ ][ ][ ] [mln/lekë]

Koeficienti i shfrytëzimit të truallit ..... [ ][ ][ ][ ][ ][ ]

Lartësia e Përgjithshme ..... [ ][ ][ ][ ][ ][ ] [m]

Numri maksimal i kateve mbi tokë ..... [ ][ ][ ][ ][ ][ ] e nën tokë ..... [ ][ ][ ][ ][ ][ ]

Objekti është projektuar nga ..... \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 199\_\_  
Emri Mbiemri numri i licensës data

Objekti do të zbatohet nga ..... \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 199\_\_  
Emri Mbiemri numri i licensës data

Bashkë me këtë kërkesë parqes:

- Projektin e plotë teknik të objektit ose objekteve.
- Grafikon e punimeve të ndërtimit.
- Formularin 3/1 të plotësuar sipas kërkesës së ligjit.
- të dhënat e studimeve gjeologo-inxhinierike.
- të dhënat e studimeve inxhiniero-sizmiologjike për objektet mbi 8 kat, të marra nga Instituti i Sizmiologjisë.

Kontrata me firmën që do të bëjë ndërtimin ose personin fizik e juridik të licensuar në fushën e ndërtimit.

Përsa parashtrorj në kërkesën time deklaroj se janë të vërteta dhe origjinale

Mendimi i zyrës së Urbanistikës sipas përkatësisë \_\_\_\_\_

**KËRKUESI**

**LIDHJA E OBJEKTIT ME INFRASTRUKTURËN INXHINIERIKE**  
*(Ndryshuar formular 3/1 me ligjin nr.10 078, datë 16.2.2009, neni 11)*

OBJEKTI \_\_\_\_\_

1. Lidhja e sheshit të ndërtimit të objektit me linjën e ujësjellësit publik:

Pika dhe distanca e lidhjes \_\_\_\_\_

Shënim i ndërmarrjes së ujësjellësit që administron ujësjellësin publik \_\_\_\_\_

2. Lidhja e sheshit të ndërtimit të objektit me rrjetin publik të kanalizimeve të ujërave të

zeza:

Pika dhe distanca e lidhjes \_\_\_\_\_

Shënim i ndërmarrjes së kanalizimeve të ujërave të zeza që administron rrjetin publik \_\_\_\_\_

3. Lidhja e sheshit të ndërtimit të objektit me rrjetin elektrik publik:

Pika dhe distanca e lidhjes \_\_\_\_\_

Shënim i ndërmarrjes elektrike që administron rrjetin elektrik publik \_\_\_\_\_

4. Lidhja e sheshit të ndërtimit të objektit me rrjetin telefonik publik:

Pika dhe distanca e lidhjes \_\_\_\_\_

Shënim i ndërmarrjes së telekomit që administron rrjetin telefonik publik \_\_\_\_\_

5. Verifikimi i sheshit të ndërtimit nga:

Inspektorati sanitar shtetëror i rrethit \_\_\_\_\_

Agjencia rajonale e mbrojtjes së mjedisit, shoqëruar me lejen e mjedisit për ato raste kur është e parashikuar në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit” \_\_\_\_\_

Ndërmarrja e mbrojtjes kundër zjarrit \_\_\_\_\_

Bashkëlidhur formularit, gen-plani i objektit që do të ndërtohet për çdo rast dhe studimi përkatës, si dhe miratimi i lejes së ndërtimit për punimet e infrastrukturës për çdo rast.

KËRKUESI

(.....)

Datë ...../ ...../ 200...



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË RRETNIT \_\_\_\_\_

SEKRETARIA TEKNIKE E KRRT

## LEJE NDËRTIMI

SUBJEKTIT NDËRTUES \_\_\_\_\_ ME NR. LICENSE \_\_\_\_\_

ME VENDIM TË KRRT NR. \_\_\_\_\_ DATË \_\_\_\_/\_\_\_\_/199\_\_

ËSHTË MIRATUAR

NUK ËSHTË MIRATUAR

LEJA E NDËRTIMIT PËR: \_\_\_\_\_

OBJEKTI \_\_\_\_\_

AFATI KOHOR I KËSAJ LEJE ËSHTË DERI ME DATË \_\_\_\_/\_\_\_\_/199\_\_

*(Koha e lejes fillon që nga momenti kur firmoset nga Kryetari dhe sekretari i KRRT.)*

Leja e ndërtimit jepet me këto kushte:

1. të respektohet destinacioni i sheshit për ndërtimin e objektit \_\_\_\_\_ dhe kondicionet urbanistike të dhëna në vendimin e KRRT nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/199\_\_
2. të respektohet tradha e punimeve sipas projektit.
3. të rrethohet sheshi sipas projektit dhe të mbahet pastër ambienti përreth.
4. Për çdo ndërhyrje për lidhje me rrjetin e infrastrukturës publike sipas projektit të miratuar nga ndërmarrja përkatëse e infrastrukturës të jetë i pranishëm specialisti i zonës ose përfaqësuesi i ndërmarrjes përkatëse për të mos krijuar shqetësime në rrjetin publik.
5. Gjatë zbatimit të punimeve objekti do të kontrollohet nga Drejtoria, Seksioni apo Zyra e Urbanistikës, sipas përcaktimeve në nenin 51 të këtij ligji.
6. Për çdo problem gjatë zbatimit të punimeve të informohet institucioni apo ndërmarrja me të cilin lidhet problemi që mund të lindë.
7. Në rast shkelje të kushteve ligjore të kësaj leje do të merren masa konform ligjit deri në pezullimin e saj.

SEKRETARI I KRRT

KRYETARI I KRRT



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË RRETHIT \_\_\_\_\_  
SEKRETARIA TEKNIKE E KRRT

## LEJE PËR NDËRTIM TË PËRKOHSHËM

SUBJEKTIT NDËRTUES \_\_\_\_\_ ME NR. LICENSE \_\_\_\_\_

ME VENDIM TË KRRT NR. \_\_\_\_\_ DATË \_\_\_\_/\_\_\_\_/198\_\_

ËSHTË MIRATUAR .....

NUK ËSHTË MIRATUAR .....

OBJEKTI I PËRKOHSHËM \_\_\_\_\_

AFATI KOHOR I KËSAJ LEJE ËSHTË BËRI ME DATË \_\_\_\_/\_\_\_\_/198\_\_

*(Koha e lejes fillon qe nga momenti kur firmoset nga Kryetari dhe sekretari i KRRT.)*

Leja e ndërtimit jepet me këto kushte:

1. Të bëhet ndërtimi me materiale të zmontueshme pa përdorur struktura beton arme, blloqe betoni, murature ose soleta sipas përcaktimeve në nenin 55.
2. Shkelja e kushteve të kësaj leje e bën lejen të pavlefshme.



# KËRKESË

## PËR PRERJE DRURËSH

OBJEKTI \_\_\_\_\_

SEKRETARISË TEKNIKE TË K.R.R.T. NË KËSHILLIN E RRETHIT \_\_\_\_\_

Kërkuesi ..... \_\_\_\_\_  
*Emri* *Mbiemri*

Adresa ..... \_\_\_\_\_

Adresa e sheshit të ku do të ndërtohet objekti ..... \_\_\_\_\_

Konfirmimi nga kadastra urbane e sipas regjistrimit të pasurisë ... \_\_\_\_\_

Sipërfaqja e sheshit të miratuar ..... [m<sup>2</sup>]; ose ..... [ha].

Sipërfaqe e sheshit e mbuluar me gjelbërim ..... [m<sup>2</sup>]

Pronësia e drurëve ... \_\_\_\_\_

Lloji i drurëve ... \_\_\_\_\_

Numri i drurëve ... [ ] [copë] ( ..... )  
*numri i drurëve me fjalë*

Mosha e drurëve ... [ ] [vjeçare] \_\_\_\_\_

Gjendja biologjike... \_\_\_\_\_

Lartësia e drurëve... [ ] [m] \_\_\_\_\_

Miratimi nga Agjensia Rajonale e Mbrojtjes së Mjedisit ... \_\_\_\_\_

Miratimi nga Ndërmarrja Pyjore ose e Gjelbërimit që e ka në pronësi ose në administrim për prerjen e drurëve, rigjelbërimin e zonës ku do të bëhet ndërtimi, si dhe mbjellja e drurëve në një zonë tjetër ... \_\_\_\_\_

Bashkëlidhur me kërkesën për prerjen e drurëve plani i sistemimit të sheshit të ndërtimit për rigjelbërimin pas ndërtimit dhe gen-plani i zonës që do të bëj mbjelljet e reja.

K Ë R K U E S I

(.....)



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË RRETHIT \_\_\_\_\_  
SEKRETARIA TEKNIKE E KRRT

## LEJE PËR PRERJE DRURËSH

SUBJEKTIT \_\_\_\_\_ ME NR. LICENSE \_\_\_\_\_

ME VENDIM TË KRRT NR. \_\_\_\_\_ DATË \_\_\_/\_\_\_/199\_\_

ËSHTË MIRATUAR.....

NUK ËSHTË MIRATUAR.....

OBJEKTI \_\_\_\_\_

*(Koha e lejes fillon që nga momenti kur firmoset nga Kryetari dhe sekretari i KRRT.)*

Leja e ndërtimit jepet me këto kushte:

1. Afati kohor i lejes është 3 muaj.
2. Numri i drurëve që do të priten \_\_\_\_\_ [copë], (.....)  
numri i drurëve me tjalte
3. Identifikimi i tyre sipas planit bashkëlidhur.
4. Mos respektimi i kushtit të gjelbërimit të zonës sipas projektit të miratuar ju ngarkon me përgjegjësi ligjore.

# KËRKESË

## PËR PRISHJE NDËRTIMI

OBJEKTI \_\_\_\_\_

SEKRETARISË TEKNIKE TË K.R.R.T. NË KËSHILLIN E RRETHIT \_\_\_\_\_


Kërkuesi .....  
Emri Mbiemri


Adresa .....


Adresa e ndërtimit që do të priset ... \_\_\_\_\_

Pozicioni në lidhje me sheshin e ndërtimit të objektit të ri .....

Specifikime të objektit që do të priset:

Numri i katëve ..... 

Lartësia e Përgjithshme .....  [m]

Volumi i objektit në .....  [m<sup>3</sup>]

Lloji i mbulesës ..... \_\_\_\_\_

Miratimi nga Agjensia Rajonale e Mjedisit për evadimin e mbeturinave ndërtimore në vëndin e caktuar ... \_\_\_\_\_

Miratimi nga Inspektorati Sanitar ... \_\_\_\_\_

Bashkëlidhur me kërkesën keni dhe raportin teknik të eksperteve për gjëndjen fizike dhe ndërtimore të objektit që do priset.

KËRKUESI



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË RREHIT \_\_\_\_\_  
SEKRETARIA TEKNIKE E KRRT

## LEJE PËR PRISHJE NDËRTIMI

SUBJEKTIT \_\_\_\_\_ ME NR. LICENSE \_\_\_\_\_

ME VENDIM TË KRRT NR. \_\_\_ DATË \_\_\_/\_\_\_/198\_\_

OBJEKTI \_\_\_\_\_

- DO TË PRISHET PËR NJË AFAT KOHOR \_\_\_\_\_ [muaj]
- NUK ËSHTË MIRATUAR

*(Koha e lejes fillon që nga momenti kur firmoset nga Kryetari dhe sekretari i KRRT.)*

Për mos respektimi i këtij afati prishja do të bëhet nga organet shtetërore duke ju ngarkuar shpenzimet juve.

Pozicioni i ndërtimit që do të prishet është:

Kufizimi nga:

Veriu .....	_____	_____	_____	[m]
Jugu .....	_____	_____	_____	[m]
Lindja .....	_____	_____	_____	[m]
Perëndimi .....	_____	_____	_____	[m]

Gjatë ekzekutimit të prishjes të merren masa të rrepta për sigurimin e jetës së punonjësve që do të ekzekutojnë prishjen si dhe banorëve përreth.

Të sigurohet shkëputja e rrjetit të infrastrukturës elektrike, ujësjellës, kanalizim për të evituar avaritë që mund të krijohen.

SEKRETARI I KRRT

KRYETARI I KRRT

(.....)

(.....)

Data ...../...../199...

929

**VENDIM**  
**Nr.722, datë 19.11.1998**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË URBANISTIKËS**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.401, datë 25.6.2004)*

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.545, datë 12.8.2004)*

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.574, datë 14.7.2010)*

*I përditësuar*

Në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullores së urbanistikës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.593, datë 13.12.1993 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”, shfuqizohet.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**

*Vendim i KM nr.722, datë 19.11.1998 botuar në Fletoren Zyrtare ekstra korrik*

*Vendim i KM nr.401, datë 25.6.2004 botuar në Fletoren Zyrtare nr.45, faqe 3209*

*Vendim i KM nr.545, datë 12.8.2004 botuar në Fletoren Zyrtare nr.59, faqe 3830*

*Vendim i KM nr.574, datë 14.7.2010 botuar në Fletoren Zyrtare nr.103, faqe 5212*

**RREGULLORE E URBANISTIKËS**

**I. LLOJET, PËRMBAJTJA DHE PROCEDURAT E HARTIMIT TË STUDIMEVE URBANISTIKE**

**A. Emërtimi dhe territori që përfshin studimi urbanistik**

1. Masterplani: Është studim urbanistik me një temë të caktuar dhe përfshin të gjithë territorin kombëtar ose pjesë të veçanta të tij.
2. Studimi urbanistik rajonal dhe mjedisor: Është studim urbanistik kompleks dhe përfshin territorin e një ose më shumë rretheve.
3. Plani rregullues i përgjithshëm: Është studim urbanistik kompleks për një territor të kufizuar dhe përfshin territorin e një qyteti, së bashku me zonën suburbane (periferike) të shtrirjes perspektive të një fshati, të një qendre të banuar, të një zone pushimi, të një territori industrial etj.
4. Studimi urbanistik pjesor: Është studim urbanistik i detajuar, që bazohet në parashikimet e planit rregullues të përgjithshëm dhe përfshin zona ose pjesë të territorit të tij, në të cilat parashikohen ndërhyrje rregulluese.
5. Planimetria e sheshit të ndërtimit: Është material grafik që nxirret nga studimi urbanistik pjesor dhe i bashkëngjitet vendimit për miratimin e sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij.

**B. Përmbajtja dhe mënyra e hartimit të studimeve urbanistike**

6. Masterplani ka për qëllim krijimin e bazave për zhvillimin urbanistik dhe territorial të territorit për të cilin hartohet (p.sh. krijimin e bazave për zhvillimin e vendbanimeve, infrastrukturës, turizmit, industrisë etj.).
7. Masterplani hartohet nga organet e specializuara për këtë qëllim.
8. Masterplani që hartohet për gjithë territorin kombëtar porositet nga Këshilli i Ministrave. Në rastet kur masterplani hartohet për një pjesë të territorit kombëtar dhe përfshin disa rrethe, porositet nga Këshilli i Ministrave me propozim të këshillave të rretheve që merren në studim dhe kur përfshin në një rreth porositet nga këshilli i rrethit që studiohet.

9. Masterplani kryhet mbi bazën e detyrës së projektimit.

10. Detyra e projektimit hartohet nga investitori (porositësi), në bashkëpunim me institucionet e specializuara.

11. Detyra e projektimit duhet të përmbajë:

- të dhënat mbi pozitën gjeografike dhe kufijtë e shtrirjes së territorit kombëtar që merret në studim në harta në shkallën 1:50 000 - 1:10 000;

- të dhënat gjeografike me përshkrim dhe me planimetri në harta në shkallën 1:50 000 - 1:10 000;

- të dhënat sizmologjike, të mbështetura në hartën e rajonizimit sizmik në shkallë 1:500 000;

- të dhënat klimatike dhe hidrologjike me përshkrim dhe me vizatime në formë grafikësh të elementeve klimatike dhe skema të hartave në shkallë 1:10 000 - 1:50 000;

- të dhënat hidrologjike me përshkrim dhe planimetri në harta në shkallmn 1:50 000- 1:10 000;

- të dhëna hidroteknike me përshkrim dhe me planimetri në hartë në shkallë 1:50 000-1: 10 000;

- të dhëna morfologjike dhe gjeomorfologjike me planimetri dhe harta në shkallën 1: 50 000 - 1:10 000;

- të dhëna pedologjike me planimetri dhe harta në shkallën 1:50 000 - 1:10 000;

- të dhëna mbi komunitetet bimore, shtazore dhe ekosistemet e zonës së përfshirë nga studimi,

- elementet që parashikon normativa shtetërore në drejtim të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);

- studime mbi mbrojtjen e mjedisit;

- të dhëna mbi shfrytëzimin e tokës me përshkrim dhe harta;

- të dhëna arkeologjike dhe historike, zonat muze në mbrojtje dhe zonat nën mbikëqyrje,

- të dhënat mbi infrastrukturën e rrjeteve inxhinierike të rrugëve, ujësjellësve, elektrikut, kanalizimeve dhe telefonisë me planimetri në harta në shkallën 1:50 000 - 1:10 000;

- studime urbanistike mbi qendrat e banuara me përshkrim dhe planimetri;

- të dhëna demografike mbi qendrat e banuara;

- studime ekonomike;

- të dhëna që lidhen me temën e caktuar të studimit.

12. Masterplani hartohet për një periudhë kohore mbi 20-vjeçare.

13. Përpara miratimit të masterplanit merret miratimi i organeve të pushtetit lokal, territoret e rretheve të cilave preken nga këto studime.

14. Studimi urbanistik rajonal dhe mjedisor është studim kompleks që ruan dhe mbron vlerat natyrore, mjedisore e peizazhistike dhe siguron vazhdueshmërinë e zhvillimit të qyteteve, fshatrave, qendrave të banuara dhe qendrave të prodhimit industrial, bujqësor etj. në territoret e rretheve për të cilat hartohet.

15. Studimi urbanistik rajonal dhe mjedisor përmban:

a) objektivat që do të udhëheqin politikën territoriale të zonave urbane, rurale, industriale, bujqësore e të shërbimeve në kuadrin e përgjithshëm të rregullave brenda territorit të rajonit;

b) zgjedhjen e modelit territorial duke përcaktuar udhëzimet dhe kriteret metodologjike për përcaktimin e zonave socio-ekonomike, të cilat krijojnë sektorë funksionalë dhe do t'i nënshtrohen planifikimit të planeve më të detajuara;

c) përcaktimin e problemeve kryesore për secilën nga zonat e sipërpërmendura dhe për problemet e caktuara, mënyrën e koordinimit me territoret jashtë rajonit;

d) marrjen parasysh të zonave me karakter historik dhe veçori të spikatura ambientale dhe peizazhistike, duke specifikuar territoret që do të trajtohen nga planet lokale, si parqe natyrore, zona të mbrojtura etj.;

e) normat kryesore për hartimin e programeve të mbrojtjes dhe përdorimit të tokave, sistemeve hidrogeologjike, hidrologjike, pyjore, të burimeve bujqësore, energjetike, të karrierave etj.;

f) elementet që parashikon normativa shtetërore në drejtim të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);

g) lokalizimin e veprave publike dhe infrastrukturave lokale, rajonale, kombëtare, bazë për shërbime të interesit rajonal, si rrugët e komunikacionit tokësor, ujqor, ajror, rrjetet e furnizimit me ujë, me energji elektrike, të telefonisë, të kanalizimit, vendet e hedhjes së mbeturinave, fushat e depozitimit, si dhe zonat me destinacion të veçantë;

h) specifikimin e prioriteteve në kuadrin rajonal dhe lokal, sipas sektorëve dhe objektivave të vendosur në programin e zhvillimit;

i) koordinimin me parashikimet e programit ekonomik – financiar.

16. Porositësi është Këshilli i Ministrave, për rastin kur studimi prek disa rrethe dhe këshilli i rrethit për rastin kur përfshin një rreth.

17. Studimi urbanistik rajonal dhe mjedisor hartohet mbi bazën e detyrës së projektimit. Detyra e projektimit hartohet nga porositësi (investitori) në bashkëpunimin me institucionet e specializuara. Detyra e projektimit duhet të përmbajë:

- të dhëna mbi pozitën gjeografike dhe kufijtë e shtrirjes së rajonit që merret me studim në harta në shkallën 1:50 000 – 1:10 000;

- të dhënat inxhiniero-gjeologjike dhe topografike të hedhura në hartë në shkallën 1:50 000-1:10 000;

- të dhënat sizmologjike në shkallën 1:500 000 deri 1:100 000;

- të dhënat klimatike për rajonin dhe rrjeti i stacioneve nga merren këto të dhëna (temperatura, erërat, reshjet, lagështia etj.);

- të dhënat hidrogjeologjike me përshkrim dhe planimetri në harta në shkallën 1:50 000-1:10 000,

- të dhënat hidroteknike me përshkrim dhe me planimetri në hartë në shkallën 1:50 000-1:10 000

- të dhënat morfologjike dhe geomorfologjike me planimetri dhe harta në shkallën 1:50 000-1:10 000;

- të dhënat pedologjike me planimetri dhe harta;

- të dhënat mbi komunitete bimore, shtazore dhe ekosistemet e zonës së përfshirë nga studimi;

- elementet që parashikon normativa shtetërore në drejtim të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);

- studime mjedisore;

- të dhëna mbi shfrytëzimin e tokës me përshkrim dhe harta;

- të dhëna mbi historinë e zhvillimit ekonomik-shoqëror të rajonit mbi zonat muze në mbrojtje dhe zonat nën mbikëqyrje;

- të dhëna mbi ekonominë pyjore, parqet kombëtare, parqet periferike të qyteteve dhe zonat e pushimit të përbashkëta të banorëve të qyteteve e të fshatrave;

- të dhëna mbi zhvillimin demografik;

- të dhënat mbi zhvillimin faktik dhe në perspektivë të qyteteve, fshatrave dhe qendrave të banuara të rajonit;

- të dhëna mbi vëllimin e investimeve dhe ndërtimeve faktike e në perspektivë për çdo qytet, fshat apo qendër të banuar brenda territorit të rajonit;

- të dhëna mbi zhvillimin faktik e në perspektivë të industrisë;

- të dhëna mbi zhvillimin faktik e në perspektivë të bujqësisë e blegtorisë;

- të dhëna mbi infrastrukturën e rrjeteve inxhinierike, të rrugëve, ujësjellësve, elektrikut, kanalizimeve e telefonisë me planimetri dhe harta;

- të dhëna mbi vëllimin faktik të transportit dhe perspektivën.

18. Studimi urbanistik rajonal dhe mjedisor për karakterin kompleks që ka përbëhet nga:

- detyra e projektimit;

- relacioni i përgjithshëm;

- harta e gjendjes ekzistuese të rajonit në shkallën 1:25 000 – 1:5000;

- plani rajonal i qendrave dhe zonave të prodhimit industrial. Në këtë hartë përcaktohen:

vendet e ndërtimit dhe territoret e qendrave dhe zonave ekzistuese dhe të reja industriale, territoret mineralmbajtëse ose naftëmbajtëse ekzistuese ose të reja, ndërtimet e ndryshme që shërbejnë për ruajtjen e ambientit nga dëmtuesit industrialë që veprojnë në ajër, tokë dhe ujë;

- plani rajonal i zonave të prodhimit bujqësor. Në këtë plan përcaktohen territoret e kulturave bujqësore, si arat, pemishtet, vreshtat, ullishtet, pyjet, kullotat, parqet kombëtare etj., vendndërtimet e rezervuarëve dhe liqeneve që do të shërbejnë për ujitjen, territoret e ndërtimeve bujqësore;

- plani rajonal i qyteteve, fshatrave e qendrave të banuara. Në këtë plan përcaktohen territoret e zhvillimit të qyteteve, të fshatrave dhe qendrave të banuara ekzistuese, territoret e qyteteve, fshatrave e qendrave të banuara të reja, territoret e qendrave të pushimit, të plazheve, të qendrave turistike dhe qendrave shëndetësore;

- plani rajonal i sistemit të komunikacionit dhe të rrjetit rrugor. Në këtë plan përcaktohen rrugët automobilistike, hekurudhore, ajrore dhe ujore, që lidhin qytetet, fshatrat dhe qendrat e banuara me qendrat e prodhimit industrial e bujqësor. Në këtë plan mund të përfshihet edhe rrjeti i kolektorëve kryesorë të furnizimit me ujë, i kanalizimit, i largimit të ujërave të industrisë, i linjave të tensionit të lartë, i telefonisë etj.

- plani i territoreve me vlera mjedisore. Në këtë plan përcaktohen sistemet e mbrojtura, sistemet ekologjike, parqet kombëtare dhe lokale, rezervatat e florës e të faunës dhe klasifikimi i tyre sipas kritereve për ruajtjen e mbrojtjen sipas dispozitave të veçanta.

19. Plan i rregullues i përgjithshëm, si rregull, hartohet pas hartimit të studimit urbanistik rajonal. Ai zgjidh në tërësi problemet ndërtimore, ekonomike, higjieno-sanitare, inxhiniero-teknike të një qyteti, fshati apo qendre të banuar, parashikon zhvillimin urbanistik të qytetit, fshatit apo qendrës së banuar për një periudhë kohe të caktuar 10-15-vjeçare, duke përcaktuar përparësitë e fazës së parë 5-vjeçare, përcakton kufijtë gjeografikë të zhvillimit territorial të qytetit, fshatit ose të qendrës së banuar, si dhe periferisë së tyre.

20. Për të kursyer fondin e tokës e për të disiplinuar ndërtimet në planin rregullues të përgjithshëm paraqitet vija kufizuese e ndërtimeve me fazat e saj për zhvillimin perspektiv të qytetit, fshatit apo qendrës së banuar. Kufiri gjeografik i shtrirjes territoriale quhet vijë kufizuese e ndërtimeve.

21. Për të shfrytëzuar sa më drejt dhe sa më mirë territorin jashtë vijës kufizuese të ndërtimeve të qytetit dhe për të ruajtur të parapërgatitur territorin e zhvillimit perspektiv të tij përcaktohet zona suburbane me kufirin e saj. Zona suburbane përfshin një territor të caktuar gjatë perimetrit të qytetit, ku ndodhen fshatra dhe qendra të banuara të tjera, të destinuar, për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit për një perspektivë shumëvjeçare. Madhësia dhe gjerësia e kësaj zone përcaktohet në varësi të kushteve të relievit, të mjedisit natyror e panoramik, të dhënave gjeologjiko-inxhinierike e sizmike, të faktorëve e kërkesave të tjera të veçanta. Kufiri gjeografik i shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit për periudhën shumëvjeçare quhet vijë suburbane.

22. Vendimet në fushën e urbanistikës që marrin komuna ose komunat fqinje, në territorin e zonës suburbane, duhet të respektojnë rigorozisht studimin urbanistik që bëhet për këtë zonë në kuadrin e planit rregullues të përgjithshëm.

23. Zona suburbane është territor i komunës ose komunave dhe në të ardhmen mund të jetë pjesërisht ose tërësisht territor i bashkisë, prandaj organet e pushtetit lokal duhet të harmonizojnë vendimet për përdorimin e tokës, duke respektuar reciprokisht autonominë e tyre.

24. Plan i rregullues i përgjithshëm hartohet i plotë ose rishikohet.

25. Plan i rregullues i përgjithshëm hartohet i plotë në rastet:

a) kur është marrë vendimi nga Këshilli i Ministrave për të ngritur një qytet, fshat apo qendër të banuar të re;

b) kur lindin kushte të reja ekonomike-shoqërore që kërkojnë territore, hapësira dhe infrastrukturën bazë primare të qyteteve, fshatrave apo qendrave të banuara ekzistuese dhe kur paraprakisht këto territore e hapësira janë në masën mbi 25 % të sipërfaqes ekzistuese të qytetit, fshatit apo qendrës së banuar;

c) kur kërkohen ose lindin probleme të rëndësishme dhe transformime teknike në sistemin e infrastrukturës, sidomos të rrjetit rrugor;



d) kur ezaurohen parashikimet e planit rregullues të përgjithshëm para afatit të parashikuar.

26. Plani rregullues i përgjithshëm rishikohet në rastet:

a) kur shumica e të gjitha shtesave është më pak se 25 % e sipërfaqes brenda vijës kufizuese të ndërtimeve ekzistuese;

b) kur krijohen kushte të reja ekonomiko-shoqërore që kërkojnë territore dhe hapësira për një nga zonat funksionale të qytetit ose fshatit;

c) kur, për efekt të interesit shoqëror, kërkohen shpronësime të tokave pronë e personave fizikë e juridikë dhe për pasojë duhet bërë ndryshimi i vijës kufizuese të ndërtimeve.

27. Porositësi i planit rregullues të përgjithshëm është këshilli i bashkisë ose i komunës.

28. Plani rregullues i përgjithshëm (PRRP) përmban:

a) objektivat dhe strategjinë, të ndara sipas zonave, që bashkia ose komuna synojnë të arrijnë nëpërmjet PRRP-së.

b) përcaktimet që influencojnë mbi pronësinë e tokës dhe vlerësimin e saj. Për këtë jep:

- klasifikimin sipas funksioneve;

- përcaktimin e mënyrës së zbatimit nëpërmjet studimit urbanistik pjesor;

- intensitetin dhe tipologjinë e ndërtimeve që do të rezultojnë nga transformimet e brendshme në bazë të SUP;

c) klasifikimi në zona funksionale të territorit që përfshihet nga plani, duke u mbështetur në gjendjen ekzistuese, në përdorimet e mundshme, në dendësitë e banimit, në infrastrukturën inxhinierike e sociale, si dhe rregullat që duhen ndjekur brenda secilës prej tyre për të ndryshuar destinacionin e përdorimit; Këto zona përcaktohen në bazë të destinacionit mbizotërues të përdorimit;

d) shqyrtimin e zonave që do t'u nënshtrohen ndërhyrjeve të rikonstruksionit urbanistik, si dhe përcaktimin e zonave për shtrirjen e qytetit, kushtëzimet urbanistike dhe elementet kryesore që duhet të mbahen parasysh në secilën prej tyre gjatë hartimit të SUP;

e) strukturën e përgjithshme organike të territorit nëpërmjet elementeve përcaktuese të zhvillimit urban, veçanërisht nëpërmjet sistemit të përgjithshëm të komunikacionit rrugor, hekurudhor etj., të rrjetit të furnizimit me ujë, me energji elektrike, të kanalizimit dhe të imiantëve përkatëse, të rrjetit të komunikimit teknologjik, të hapësirave të lira të destinuara për parqe, gjelbërim publik e pajisje të tjera publike;

f) përcaktimin e ndërhyrjeve për vlerësimin dhe ruajtjen e burimeve ambientale, bujqësore, peizazhistike e historike, duke vendosur kushtëzimet për përdorimin e tyre, si dhe të elementeve që parashikohen normativisht shtetërore në drejtim të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);

g) studimin e situatës gjeologjike, hidrologjike dhe sizmike të territorit për të vlerësuar pajtueshmërinë e parashikimeve të planit me to;

h) parashikimet dhe drejtimet kryesore të vendosura prej mastërplanit dhe studimit urbanistik rajonal, në mënyrë që të koordinojnë parashikimet e tyre me përshkrimet e PRRP-së;

i) vlerësimin ekonomiko-financiar të operacioneve që propozon PRRP-ja;

j) kufizime në lidhje me ndërtimet për:

- territore apo zona me ndërtime që paraqesin interes ambiental, peizazhistik, historik e kulturor;

- mbrojtjen e funksionit të infrastrukturave dhe impianteve me interes publik;

- mbrojtjen nga situata të mundshme rreziku për të garantuar pacenueshmërinë e njerëzve apo objekteve;

k) përcaktimin e rrethanave, që do të kërkojnë rishikimin e PRRP-së, në funksion të popullsisë dhe indeksit të rritjes së saj, funksioneve dhe intensitetit të shfrytëzimit të truallit, si dhe të elementeve që kanë ndikuar në klasifikimin fillestar të territoreve të përfshira nga PRRP në zona funksionale;

l) territoret dhe afatet për hartimin dhe miratimin e SUP, nëpërmjet të cilave do të zbatohet PRRP.

29. Plani rregullues i përgjithshëm hartohet mbi bazën e detyrës së projektimit. Detyra e projektimit duhet të përmbajë:

- të dhëna për pozitën gjeografike dhe kufijtë e shtrirjes së territorit të qytetit, fshatit ose qendrës së banuar në harta në shkallën 1:5000 – 1:2000;
- të dhëna gjeologjike me përshkrim dhe planimetri në harta në shkallën 1:5000 – 1:2000;
- të dhëna sizmologjike me përshkrim dhe me planimetri në hartë në shkallën 1:10 000 deri 1:5 000;
- të dhëna klimatike dhe hidrologjike me përshkrim dhe me vizatime në formë grafikësh të elementeve klimatike dhe skema të hartave në shkallën 1:5 000 – 1:2 000;
- të dhëna hidrogeologjike me përshkrim dhe me planimetri në harta në shkallë 1 : 5000 - 1: 2000;
- të dhëna mbi komunitetet bimore, shtazore dhe ekosistemet e zonës së përfshirë nga studimi.
- elementet që parashikon normativa shtetërore në drejtim të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);
- studime mbi mbrojtjen e mjedisit;
- të dhëna arkeologjike dhe studime historike, zonat muze nën mbrojtje dhe zonat nën mbikëqyrje;
- të dhëna mbi infrastrukturën e rrjetit inxhinierik të rrugëve, ujësjellësve, elektrikut, kanalizimeve dhe telefonisë me planimetri në harta në shkallën 1:5 000 – 1:2 000;
- të dhënat demografike;
- të dhënat mbi aktivitetin ekonomik faktik dhe në perspektivë;
- të dhënat për zonën e banimit mbi gjendjen faktike dhe në perspektivë;
- si dhe të dhëna të tjera që lidhen direkt me studimin (p.sh. kur studiohet plani rregullues i përgjithshëm i një qyteti apo qendre turistike duhen të dhëna për zonat e pushimit etj.).

30. Plani rregullues i përgjithshëm i qytetit, fshatit apo qendrës së banuar, ekzistues hartohet në dy faza:

- a) projektideja
- b) projekti teknik i rrjetit rrugor.

31. Projekti i fazës së dytë bëhet pasi të jetë miratuar projektideja nga organi sipas kompetencës dhe kur kërkohet nga porositësi .

32. Plani rregullues i përgjithshëm i qytetit, fshatit apo qendrës së banuar të re hartohet në tri faza:

- a) studimi i përgjithshëm urbanistik për vendin e vendosjes së qytetit, fshatit apo qendrës së banuar të re;
- b) projektideja;
- c) projekti teknik i rrjetit rrugor.

33. Projektimi në fazën e dytë bëhet pasi të jetë miratuar studimi i përgjithshëm urbanistik.

34. Kalimi në fazën e tretë bëhet mbasi projektideja është miratuar nga organi sipas kompetencës dhe me kërkesë të porositësit.

35. Projektideja e planeve rregulluese të përgjithshme për qytetin duhet të përmbajë:

- a) për qytetet ekzistuese:
  - detyrën e projektimit;
  - relacionin e përgjithshëm;
  - hartën e rajonit në shkallën 1:50 000 – 1:10 000, ku të jenë evidentuar qendra e rrethit, qytetet e tjera, fshatrat dhe qendrat e banuara të rrethit, infrastruktura inxhinierike dhe zonat e objekteve të veçanta;
  - planimetrinë e gjendjes ekzistuese të ndërtimeve mbi dhe nën tokë, në momentin që hartohet plani rregullues i përgjithshëm;
  - vijën kufizuese të ndërtimeve dhe vijën suburbane;
  - skemën e rrjetit rrugor të qytetit;
  - skemën e zonimit funksional të qytetit;
  - skemën e fazave të rikonstruksionit të qytetit;
  - skemën e infrastrukturës së qytetit (ujësjellësit, kanalizimit, elektrikut, telefonisë);

- planimetrinë e terreneve të gjelbërta, të pushimeve të terreneve sportive e të lojërave për fëmijë, të parqeve periferike të qytetit, të vendeve të pushimit turistik etj.;
- planimetri mbi fazat e zhvillimit të ndërtimeve të qytetit për të gjitha zonat;
- hartën gjeologo-inxhinierike dhe të dhënat e mikrozonimit sizmik të territorit ku shtrihet studimi i planit rregullues të përgjithshëm;
- planimetrinë e shpërndarjes së objekteve social-kulturore;
- studimi i qendrës së qytetit, zhvillimi panoramik i qytetit apo rrugëve kryesore të tij;
- sipas karakterit të qytetit e veçorive dalluese të tij mund të paraqiten edhe materiale të tjera studimore, me paraqitjet grafike përkatëse.

b) për qytetet e reja:

- detyrën e projektimit;
- relacionin e përgjithshëm;
- studimin rajonal me pozicionin e qytetit;
- planin e rajonit me rrjetin rrugor, qendrat e banuara dhe qytetet më të afërta;
- hartën e studimit pedologjik e të shfrytëzimit bujqësor për çdo vendvendosje;
- hartën gjeologo-inxhinierike dhe të dhënat e mikrozonimit sizmik për çdo vendvendosje.

36. Plani rregullues i përgjithshëm i qytetit të ri për dy fazat e tjera në përmbajtje është i njëjtë me ato të qytetit ekzistues.

37. Sipas karakterit të problemit urbanistik, faktorëve e kërkesave qytet formuese, veçorive dalluese të relievit, klimës etj., mund të paraqiten dhe materiale të tjera studimore të shoqëruara me paraqitjet grafike përkatëse.

38. Projektideja e planeve rregulluese të përgjithshme për fshatin dhe për qendrën e banuar duhet të përmbajë:

- detyrën e projektimit;
- relacionin e përgjithshëm;
- planimetrinë e komunës, fshatrat dhe qendrat e tjera të banuara së bashku me infrastrukturën inxhinierike;
- planimetrinë e gjendjes ekzistuese të ndërtimeve mbi dhe nën tokë;
- planin rregullues të përgjithshëm të fshatit, vijën kufizuese të ndërtimeve;
- skemën e rrjetit rrugor të fshatit;
- skemën e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, elektrikut, telefonisë;
- planimetrinë në fazat e zhvillimit të ndërtimeve të fshatit për të gjitha zonat;
- sipas karakterit të fshatit e veçorive dalluese të tij, mund të paraqiten edhe materiale të tjera studimore me paraqitjet grafike përkatëse.

39. Projekti teknik i rrjetit rrugor hartohet mbi bazën e projektidesë së rrjetit rrugor të planit rregullues të përgjithshëm. Projekti teknik i rrugëve hartohet në reliev në shkallën 1:500 dhe në qytetet me reliev të aksidentuar në shkallën 1:200.

40. Projekti teknik duhet të përmbajë:

- planimetrinë e rrugës gjatë gjithë gjatësisë së kërkuar, ku të jepen këto të dhëna teknike:
  - a) koordinatat nga poligonet ose grafikisht nga objektet për akset dhe vertekstet e rrugëve,
  - b) kuotat e rrugëve;
  - c) pjerrësitë dhe distancat e rrugëve;
  - d) elementet kryesore të kthesave;
  - e) prerjet tërthore të rrugës;
  - f) vijat e ndërtimit.

41. Projekti i zbatimit të planit rregullues të përgjithshëm hartohet i pjesshëm mbi bazën e kërkesës dhe detyrës së projektimit të bashkisë apo komunës dhe investimeve të planifikuara për këtë qëllim. Projekti i zbatimit të rrugëve hartohet mbi bazën e projektit teknik të rrugëve sipas kërkesës së investitorit.

Projekti i zbatimit të rrugëve hartohet në reliev në shkallën 1:500 dhe për qytete me reliev të aksidentuar në shkallën 1:200.

42. Projekti i zbatimit të rrugëve duhet të përmbajë:

- planimetrinë e rrugës gjatë gjithë gjatësisë së kërkuar ku jepen këto të dhëna teknike:

- a) koordinatat nga poligonet ose grafikisht nga objektet për akset dhe vertekstet e rrugëve;
- b) kuotat e rrugëve;
- c) pjerrësitë dhe distancat e rrugëve;
- d) elementet kryesore të kthesave dhe elementet e hollësishme të kthesave;
- e) prerjet tërthore të rrugës;
- f) vijat e ndërtimit;
- g) hollësitë teknike të rrugëve;
- h) piketat e rrugëve;
- i) pusetat e çfarëdolloji projekti inxhinierik;
- j) izoipset e projektit të rrugës.

- Planin e prerjes gjatësore të rrugës, i cili përmban:

- a) kuotat e tokës;
- b) kuotat e rrugës;
- c) pjerrësitë e rrugës;
- d) distancat pjesore dhe progresive të piketave;
- e) elementët e hollësishme të kurbave vertikale;
- f) elementet kryesore të kthesave.

Shkalla më e përshtatshme është  $\frac{1:100}{1:1000}$

- Planet e prerjeve tërthore të rrugës që përmbajnë:

- a) profilin e tokës.
- b) profilin e rrugës.
- c) sipërfaqet germim mbushje,
- d) tabelat e volumeve.

Shkalla më e përshtatshme është  $\frac{1:100}{1:100}$  ose  $\frac{1:100}{1:200}$

- Preventivin e rrugës

43. Studimi urbanistik pjesor zbërthen më tej planin rregullues të përgjithshëm. Ai hartohet për një zonë funksionale të qytetit, një pjesë të saj, e deri për një shesh ndërtimi.

44. Studimi urbanistik pjesor përcakton qartë kondicionet urbanistike dhe kriteret e zgjidhjeve vëllimore dhe arkitektonike të ndërtimeve, duke respektuar treguesit kryesorë që jep plani rregullues i përgjithshëm.

45. Nëpërmjet studimit urbanistik pjesor bëhet zbatimi i planit rregullues të përgjithshëm.

46. Studimi urbanistik pjesor (SUP) tregon kufijtë e zonës së përfshirë prej tij dhe përmban:

a) nëndarjet parcelore, si edhe tipologjitë e ndryshme të ndërtimeve dhe vendosjen e tyre në lidhje me kufijtë e sheshit të ndërtimit;

b) trasimin e rrjetit të komunikacionit brenda zonës dhe lidhjet me atë të zonës përreth sipas parashikimeve të PRRP, rrjetin rrugor me profilat dhe kuotat e tij, si dhe kondicionet kryesore të altimetrisë;

c) karakteristikat dhe trasimin e rrjetit të furnizimit me ujë, të kanalizimeve, të energjisë elektrike, të telefonisë dhe të shërbimeve të tjera që parashikon plani;

d) hapësirat për veprat me interes publik (shkolla, objekte tregtare, objekte kulti, parqe publike, objekte sportive, objekte publike, ndërtesa me karakter rekreativ e kulturor, objekte shëndetësore etj.) me kushtëzimet urbanistike dhe arkitektonike për secilën prej tyre;

e) koeficientët e shfrytëzimit të territorit dhe kushtëzime të tjera urbanistike, si vëllimet, lartësitë, vijat e ndërtimeve dhe zonat mbrojtëse përgjatë rrugëve sipas përcaktimeve të PRRP-së;

f) ndërtimet që parashikohen për t'u shembur, rikonstruktuar apo restauruar, sipas parashikimeve të studimit pjesor, të shoqëruara edhe me tipologjinë e tyre;

g) përcaktimet për ndërtimet që do t'u nënshtrohen kushtëzimeve ose ndërhyrjeve të veçanta (objekte monumentale ose me interes të veçantë ambiental, zona arkeologjike etj.);

h) elementet që parashikon normativa shtetërore në drejtim të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);

i) listat sipas zërave kadastrorë të pronarëve për t'u shpronësuar ose që do t'u vihen kushtëzime të caktuara;

j) vlerësimin ekonomiko-financiar për zbatimin e SUP.

k) normat teknike dhe rregullat për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

Përmbajtja e SUP ndryshon në raport me veçoritë specifike të çdo zone.

47. Studimi urbanistik pjesor hartohet mbi bazën e detyrës së projektimit.

Detyra e projektimit duhet të përmbajë:

- planimetrinë e zonës funksionale të planit rregullues të përgjithshëm ku mbështetet studimi urbanistik pjesor (kur studimi urbanistik pjesor hartohet për një pjesë të saj) në shkallën 1: 5000 deri 1:1000;

- planimetrinë e zonës funksionale, për të cilën hartohet studimi urbanistik pjesor në shkallën 1:2000 deri 1:500;

- të dhëna inxhiniero – gjeologjike, topografike dhe sizmologjike;

- të dhëna demografike;

- azhurnimi i rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe ajror (ujësjellës, kanalizim, elektrik, telefonik etj.);

- të dhëna për monumentet me vlera historike, arkeologjike dhe ndërtimet e tjera karakteristike që ndodhen brenda studimit urbanistik pjesor;

- si dhe të dhëna të tjera të hollësishme sipas zonës funksionale që do të studiohet.

48. Studimi urbanistik pjesor, hartohet me dy faza:

a) projektideja;

b) projekti i zbatimit.

a- Projektideja e studimit urbanistik pjesor duhet të përmbajë:

- detyrën e projektimit të hartuar e të miratuar nga organi sipas kompetencës;

- relacionin e përgjithshëm, së bashku me kondicionet urbanistike;

- planimetrinë e zonës funksionale sipas planit rregullues të përgjithshëm ku të përcaktohet pjesa e saj ku do të kryhet studimi urbanistik pjesor në shkallën 1:5000 deri 1:1000;

- planimetrinë e zonës funksionale në shkallën 1:2000 deri 1:500, për të cilën hartohet studimi urbanistik;

- planin e zonimit funksional;

- skemën e rrjetit rrugor;

- projektidenë e infrastrukturës;

- planimetrinë me fazat e ndërtimit;

- fazat e rikonstrukcionit;

- planin e zonimit vertikal sipas lartësisë të kateve;

- pamjet arkitektonike dhe panoramike të ndërtimeve gjatë rrugëve kryesore;

- maketin, perspektivën ose aksonimetrinë ajrore të zonës ku shtrihet studimi urbanistik pjesor;

- projektin teknik të rrjetit rrugor;

- pasqyrën e treguesve teknik-ekonomikë.

b- Projekti i zbatimit të studimit urbanistik pjesor përmban:

- planin e zonimit funksional në shkallën 1:1 000;

- planin e piketimit dhe të kuotimit të objekteve në shkallën 1:1000 ose 1:500 dhe për zona me relief të aksidentuar në shkallën 1:200;

- rrjetin rrugor në shkallën 1:1000 ose 1:500 dhe për zona me relief të aksidentuar në shkallën 1:200;

- planin e sistemimeve në shkallën 1:1000 ose 1:500 dhe për zona me relief të aksidentuar në shkallën 1:200;

- projektin teknik të rrjetit inxhinierik në shkallën 1:1000 ose 1:500;

- planimetrinë e kateve përdhe të të gjitha ndërtimeve (për zonën e banimit, planimetritë e katit tip të banesave të fazës së parë) në shkallën 1:200;

- pamjet arkitektonike e panoramike të ndërtesave gjatë rrugëve në shkallën 1 : 200;

- projekti teknik i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

49. Planimetria e sheshit të ndërtimit, bashkë me kondicionet urbanistike, mbështetet në studimin urbanistik pjesor dhe shoqërohet me vendimin e KRRT-së së qarkut për dhënien e sheshit të ndërtimit që i jepet kërkuarit, person fizik apo juridik, vendas apo i huaj, që do të ndërtojë një strukturë ndërtimore mbi e nëntokësore.

50. Kur personi fizik e juridik, vendas apo i huaj që do të ndërtojë, ka një propozim konkret për vendin, së bashku me kërkesën për shesh ndërtimi që i drejtohet seksionit të urbanistikës në këshillin e rrethit, zyrës së urbanistikës në bashki ose zyrës së urbanistikës në komunë, sipas kompetencës do të paraqesë edhe planimetrinë e sheshit të ndërtimit bashkë me kondicionet urbanistike, që me porosinë e tij ia harton një organ projektues i licencuar. Seksioni i urbanistikës në këshillin e rrethit, zyra e urbanistikës në bashki ose zyra e urbanistikës në komunë, sipas kompetencës, ruan të drejtën që mbi këtë propozim të paraqesë mendimin e vet në KRRT.

51. Kur personi fizik e juridik, vendas apo i huaj që do të ndërtojë, nuk ka propozim konkret për vendin, paraqet vetëm kërkesën për shesh ndërtimi në seksionin e urbanistikës në këshillin e rrethit, në zyrën e urbanistikës në bashki ose zyrën e urbanistikës në komunë sipas kompetencës. Seksioni i urbanistikës në rreth, zyra e urbanistikës në bashki ose zyra e urbanistikës në komunë, sipas kompetencës, harton vetë ose porosit në ndonjë organ projektues të licencuar shtetëror ose privat planimetrinë e sheshit të ndërtimit bashkë me kondicionet urbanistike që mendon t'i japë kërkuarit dhe e paraqet për miratim në KRRT-në e rrethit.

52. Në planimetrinë e sheshit të ndërtimit do të jepen qartë të gjitha kondicionet urbanistike të përcaktuara nga studimi urbanistik, si sipërfaqja e sheshit të ndërtimit, vija kufizuese e ndërtimit, koeficienti i shfrytëzimit të territorit, funksioni i objektit, numri i kateve dhe lartësia e objektit mbi e nën tokë, pozicioni kadastral, distancat kundrejt fqinjëve e pronësisë, hyrjet, daljet, lidhja me rrugët, kondicione të veçanta (për objekte ose pozicione të veçanta ) etj. Planvendosja e objektit dhe të dhënat e tjera grafike do të punohen mbi gjendjen ekzistuese të situatës urbanistike.

53. Në planimetrinë e sheshit të ndërtimit duhet të përcaktohen qartë të gjitha rrjetet inxhinierike që furnizojnë objektin që do të ndërtohet (kanalizim, ujësjellës, elektrik, telefoni, mkz etj.) dhe miratimin e tyre nga ndërmarrjet përkatëse.

54. Planimetria e sheshit të ndërtimit, bashkë me kondicionet urbanistike, hartohet sipas modeleve 1 deri 6, në bazë të formateve A4- Ao ose shumëfishave të tyre. Përmasat e këtyre formateve në mm janë si më poshtë:

A4: 210 x 297

A2 : 297 x 420

A2 : 420 x 594

A1 : 594 x 840

Ao : 840 x 1181


55. Planimetritë e studimeve urbanistike hartohen sipas modeleve 7 deri në 11, në bazë të formateve standarde ose shumëfishave të tyre.

56. Për rastet urgjente të eliminimit të avarive të rrjetit inxhinierik nëntokësor ( në trotuare e rrugë) punimet kryhen me autorizim të lëshuar nga seksioni i urbanistikës ose zyra e urbanistikës, sipas kompetencave në mbështetje të planimetrisë përkatëse. Në autorizim shënohet koha e kryerjes së riparimit dhe detyrimet e ndërmarrjes që kryen punime në rrugë apo trotuare dhe kthimin e tyre në gjendjen e mëparshme. Në rast shkelje të këtyre përcaktimeve, vlejnjë sanksionet e parashikuara në ligjin “Për urbanistikën”.

Modeli nr.1: SHESHE NDËRTIMI BRENDA VIJËS KUFIZUESE TË NDËRTIMEVE  
 Formati vizatimit sipas standardeve ose shumëfishit të tyre


**PLANIMETRIA E SHESHIT TE NDERTIMIT TE  
 OBJEKTIT**

SIPERFAQJA E SHESHIT .... (Ha. ose M.2) SHKALLA 1 : 500 - 1 : 1000




**SKEMA E VENDOSJES SE SHESHIT**

Shkalla 1 : 2000 - 1 : 10 000



**POZICIONI KADASTRAL  
 KADASTRA URBANE (Nr. ....)**

Shkalla .....



**MIRATOHET**

KRYETARI I K.RR.T. TE BASHKISE


**KONDISIONE URBANISTIKE**

Vula e plote e organit projektues te licencuar  
 shtetror ose privat, ose personit fizik te  
 licencuar qe ka bere studimin dhe pergatitur  
 kete dokument

**Modeli Nr.2: SHESHE NDËRTIMI BRENDA VIËS KUFIZUESE TË NDËRTIMEVE**  
*Formati i vizatimit sipas standarteve ose shumëfishit të tyre.*


**PLANIMETRIA E SHESHIT TË NDËRTIMIT TË OBJEKTIT**

SUPERFACIA E SHESHIT ..... (Ha. ose M.2) SHKALLA 1 : 500 - 1 : 1000




**SKEMA E VENDOSJES SE SHESHIT**

Shkalla 1 : 2000 - 1 : 10 000



**POZICIONI KADASTRAL KADAstra URBANE (Nr.....)**

Shkalla



**MIRATOHJET**

KRYETARI I K.R.R.T.R. TË SHQIPËRISE

SIPAS KOMPETENCES

KRYETARI I K.R.R.T. TË RRETHIT  
OSE

KRYETARI I K.R.R.T. TË BASHKISE

**KONDIcione URBANISTIKE**

Vula e plotë e organit projektues të licencuar shtetëror ose privat, ose personit fizik të licencuar që ka bërë studimin dhe përgatitur këtë dokument



Modeli nr.3: Sheshe ndërtimi mbi 0.5 ha jashtë vijës kufizuese të ndërtimeve  
 Formati vizatimit sipas standardeve ose shumëfishit të tyre

**MIRATOHET**

KRYETARI I K.RR.T.R. TE SHQIPERISE

MINISTRI I BUJQESISE DHE USHQIMIT

KRYETARI I K.RR.T. TE RRETHIT

KONDIÇIONE URBANISTIKE.

Vula e plote e organit projektues te licencuar  
 shtetëror ose privat, ose personit fizik te  
 licencuar qe ka bere studimin dhe pergatitur  
 kete dokument

**PLANIMETRIA E SHESHIT TE NDERTIMIT**  
 SIPERFAQJA E SHESHIT .... (Ha. ose M.2)  
 SHKALLA 1 : 500 - 1 : 1000

Kufiri i sheshit  
 te ndertimit sipas  
 siperfaqes se sheshit

VINI BE  
 (C) DISTANCA AKSI I RRUCES VITE NDERTIMI  
 (C) DISTANCA AKSI I RRUCES KUFIRI SHESHIT  
 (C) DISTANCA KURILII PRONES OBRIENT

**POZICIONI KADASTRAL**  
**KADASTRA BUJQESORE**  
 Shkalla .....


**SKEMA E VENDOSJES**  
**SE SHESHIT NE RAJON**  
 (FRAGMENT I STUDIMIT RAJONAL)  
 Shkalla 1 : 10 000 - 1 : 25 000

Kufiri i sheshit te ndertimit  
 Sheshi i ndertimit  
 FSHATI

Modeli nr.4: SHESHE NDËRTIMI MBI 0.5 HA JASHTË VIJËS KUFIZUESE TË NDËRTIMEVE  
 Formati vizatimit sipas standardeve ose shumëfishit të tyre


**PLANIMETRIA E SHESHIT TE NDERTIMIT TE OBJEKTIT**

SIPERFAQJA E SHESHIT ... (Ha. ose M.2) SHKALLA 1 : 500 - 1 : 2000




KRYETARI I K.RR.T. TE RRETHIT

SKEMA E VENDOSJES SE SHESHIT NE RAJON (FRAGMENT I STUDIMIT RAJONAL)  
 Shkalla 1 : 10 000 - 1 : 25 000



POZICIONI KADASTRAL KADASTRA BUIQESORE  
 Shkalla .....



KONDISIONE URBANISTIKE

Vula e plote e organit projektues te licencuar shteteror ose privat, ose personit fizik te licencuar qe ka bere studimin dhe pergatitur kete dokument


**Modeli nr.5: Për Tiranën dhe qytetet e kategorisë së parë: SHESHE NDËRTIMI MBI 0.5 HA JASHTË VIJËS KUFIZUESE TË NDËRTIMEVE**

Formati vizatimit sipas standardeve ose shumëfishit të tyre

<p><b>PLANIMETRIA E SHESHIT TE NDERTIMIT TE OBJEKTIT</b></p>	<p><b>MIRATOHET</b></p>	<p><b>KRYETARI I K.RR.T. TE BASHKISE</b></p>	<p><b>KONDISIONE URBANISTIKE</b></p>
<p>SIPERFAQJA E SHESHIT .... (Ha. ose M.2) SHKALLA 1 : 500 - 1 : 1000</p>		<p>VENI RE                  (1) DISTANCA ALISTI RRUJES VDE NDERTIMI                  (2) DISTANCA ALISTI RRUJES KUFIRIT SHESHIT                  (3) DISTANCA KUFIRIT I PROMES OBIENT</p>	<p><b>POZICIONI KADASTRAL KADASTRA URBANE (Nr. ....)</b></p>
<p>Shkalla 1 : 2000 - 1 : 10 000</p>			<p>Vula e plote e organit projektues te licencuar shteteror ose privat, ose personit fizik te licencuar qe ka bere studimin dhe pergatitur kete dokument</p>

Modeli nr.6: Për Tiranën dhe qytetet e kategorisë së parë: SHESHE NDËRTIMI MBI 0.5 HA JASHTË VIJËS KUFIZUESE TË NDËRTIMEVE  
 Formati vizatimit sipas standardeve ose shumëfishit të tyre


**PLANIMETRIA E SHESHIT TE NDERTIMIT**  
**TE OBJEKTIT**  
 SIPERFAQJA E SHESHIT ..... (Ha, ose M.2) SHKALLA 1 : 500 - 1 : 2000



Vini re  
 (0) DISTANCA ANSI I RRUGES VJES NDERTIMI  
 (1) DISTANCA ANSI I RRUGES KUFIRI SHESHIT  
 (2) DISTANCA KUFIRI I PRONES OBIJEKT

Vije ndertimi

**SKEMA E VENDOSJES SE SHESHIT**  
 Shkalla 1 : 10 000 - 1 : 25 000



Sheshi i ndertimit

**MIRATOHET**


**KRYETARI I K.RR.T.R. TE SHQIPERISE**

**KRYETARI I K.RR.T. TE BASHKISE**



**KONDISIONE URBANISTIKE**

Vula e plote e organit projektues te licencuar shteteror ose privat, ose personit fizik te licencuar qe ka bere studimin dhe pergatitur kete dokument



**POZICIONI KADASTRAL**  
**KADASTRA URBANE (Nr. ...)**  
 Shkalla .....





MODELI NR.8: MËNYRA E PARAQITJES GRAFIKE TË STUDIMEVE URBANISTIKE  
Formati i vizatimit sipas standarteve ose shumëfishit të tyre

<b>EMËRTIMI I STUDIMIT SIPAS PËRCAKTIMEVE NË NENIN 20 TË LIGJIT “PËR URBANISTIKËN” SHKALLA.....</b>	<b>MIRATOHET</b>
<b>STUDIMI</b> 	SIPAS KOMPETENCES <b>KRYETARI I K.RR.T. TË RRETHIT OSE KRYETARI I K.RR.T. TË BASHKISË</b>
<b>SKEMA E VENDOSJES SË STUDIMIT</b> Shkalla 1 : 10 000 - 1 : 25 000 	Vula e plotë e organit projektues të licensuar shtetëror ose privat, ose personit fizik të licensuar që ka bërë studimin dhe përgatitur këtë dokument



MODELI NR.9: MËNYRA E PARAQITJES GRAFIKE TË STUDIMEVE URBANISTIKE  
Formati i vizatimit sipas standarteve ose shumëfishit të tyre

<b>EMËRTIMI I STUDIMIT SIPAS PËRCAKTIMEVE NË NENIN 20 TË LIGJIT “PËR URBANISTIKËN” SHKALLA.....</b>	<b>MIRATOHET</b>
<b>STUDIMI</b> 	<b>KRYETARI I K.RR.T.R. TË SHQIPËRISË  KRYETARI I K.RR.T. TË BASHKISË</b>
<b>SKEMA E VENDOSJES SË STUDIMIT</b> Shkalla 1 : 10 000 - 1 : 25 000 	Vula e plotë e organit projektues të licensuar shtetëror ose privat, ose personit fizik të licensuar që ka bërë studimin dhe përgatitur këtë dokument

MODELI NR.10: MËNYRA E PARAQITJES GRAFIKE TË STUDIMEVE URBANISTIKE  
Formati i vizatimit sipas standarteve ose shumëfishit të tyre

<b>EMËRTIMI I STUDIMIT SIPAS PËRCAKTIMEVE NË NENIN 20 TË LIGJIT "PËR URBANISTIKËN" SHKALLA.....</b>	<b>MIRATOHET</b>
<b>STUDIMI</b> 	<b>KRYETARI I K.RR.T. TË BASHKISË</b>
<b>SKEMA E VENDOSJES SË STUDIMIT</b> Shkalla 1 : 10 000 - 1 : 25 000 	Vula e plotë e organit projektues të licensuar shtetëror ose privat, ose personit fizik të licensuar që ka bërë studimin dhe përgatitur këtë dokument

MODELI NR.11: MËNYRA E PARAQITJES GRAFIKE TË STUDIMEVE URBANISTIKE  
Formati i vizatimit sipas standarteve ose shumëfishit të tyre

<b>PLANIMETRIA E SHESHIT TË NDËRTIMIT TË OBJEKTIT</b> SHKALLA.....	
INFRASTRUKTURA, NDËRMARRJET E UJËSJELLËSIT, KANALIZIMET, ELEKTRIKUT, TELEKOMIT, INSPEKTORIATIT SANITAR SHTETËROR TË RRETHIT, AGJENSIA RAJONALE E MBROJTJES SË MJEDISIT, NDËRMARRJA E MBROJTJES KUNDRA ZJARRIT	
	<b>DREJTORI I NDËRMARRJES PËRKATËSE</b>  Shënime:..... Firma, Vula
<b>SKEMA E VENDOSJES SË STUDIMIT</b> Shkalla 1 : 2 000 - 1 : 10 000 	Vula e plotë e organit projektues të licensuar shtetëror ose privat, ose personit fizik të licensuar që ka bërë studimin dhe përgatitur këtë dokument

## I. NORMAT, RREGULLAT DHE KUSHTET E PROJEKTIT URBANISTIK

57. Normat, rregullat dhe kushtet e projektimit urbanistik janë plotësimi teknik dhe praktik i domosdoshëm i studimeve urbanistike. Këto janë të detyrueshme për të gjithë organizmat projektues në fushën e projekteve urbanistike, shtetërore ose private, vendase ose të huaja të pajisura me licencë. Mbi bazën e tyre do të vlerësohen e miratohen projektet urbanistike nga organet përkatëse sipas kompetencës që jep ligji “Për urbanistikën”.

58. Masterplanet, studimet urbanistike rajonale dhe mjedisore, planet rregulluese të përgjithshme hartohen duke u mbështetur në eksperiencën botërore, si dhe në kërkesat e porositësit, duke iu nënshtruar diskutimit dhe gjykimit të organeve që janë të interesuara për to.

59. Normat, rregullat dhe kushtet e projektimit të planit rregullues të përgjithshëm ndryshojnë sipas llojit të qytetit, fshatit apo qendrës së banuar (p.sh. industrial, muze, malor, bregdetar etj.). Prandaj, për qytetet, fshatrat e qendrat e banuara bëhet klasifikimi :

- sipas lartësisë mbi nivelin e detit;
- sipas zonave klimatike;
- sipas numrit të banorëve;
- sipas funksionit (administrativ, industrial, muze, pushimi etj.)

### A. Plani rregullues i përgjithshëm për qytetet

60. Normat urbanistike janë në vartësi të madhësisë së qyteteve.

Qytetet klasifikohen sipas numrit të banorëve si më poshtë:

Grupi I deri 10 000, Grupi II 10 000 - 20 000, Grupi III 20 000 - 50 000, Grupi IV deri 50 000 - 100 000, Grupi V 100 000 - 200 000, Grupi VI mbi 200 000

Në grupin e parë, për ato qytete që janë qendra rrethi, normativat urbanistike për objektet social-kulturore, arsimore, shëndetësore, terrene spotive etj. do të llogariten në shkallë rrethi.

61. Në hartimin e planit rregullues të përgjithshëm duhet të parashikohet një shpërndarje e drejtë e zonave funksionale të qytetit, si:

- zona e qendrës së qytetit;
- zona e spitaleve (qytetet e grupit III dhe IV );
- zona e gjelbërt e qytetit;
- zona e terreneve sportive;
- zona universitare ose e institucioneve shkencore (qytetet e grupit IV);
- zona e varrezave publike;
- zona industriale;
- zona e bazave grosiste tregtare;
- zona mbrojtëse sanitare dhe zona e fidanishteve;
- zona e transportit të jashtëm të qytetit (stacionet hekurudhore, ujore e ajrore );
- zona e parkut zoologjik dhe botanik (për qytetet e grupit IV – VI);
- zona e pushimit;
- zona e plazhit (për qytetet pranë detit, liqenit dhe lumenjve);
- zona turistike;
- zona të veçanta (p.sh. në qytete të ndryshme mund të ketë zona muze, zonë ambasadash);
- ndërtime të përkohshme (pjesë përbërëse e zonave të ndryshme të qytetit).

62. Zonat funksionale të qytetit lidhen ndërmjet tyre nga rrjeti rrugor.

63. Rrugët në qytete ndahen në pesë kategori:

- rrugët e kategorisë së parë me 6 korsi kalimi janë shëtitoret dhe rrugët kryesore të trafikut të shërbimit urban për qytete të mëdha;

- rrugët e kategorisë së dytë me 4 korsi kalimi janë rrugët me trafik të rëndë (unazat) të qyteteve të mëdha dhe rrugët kryesore të shërbimit urban;

- rrugët e kategorisë së tretë me 3 korsi kalimi janë rrugët që ndajnë lagjet e banimit me njëra-tjetrën;

- rrugët e kategorisë së katërt me 2 korsi kalimi janë rrugët e brendshme të lagjes së banimit;

- rrugët e kategorisë së pestë me 1 korsi kalimi janë rrugët e brendshme të blloqeve të banimit.

64. Kategoritë e rrugëve brenda zonave të banimit janë:

- a) rrugë me një korsi kalimi dhe një brez parkimi;
- b) rrugë me një korsi kalimi dhe dy breza parkimi;
- c) rrugë me dy korsi kalimi dhe një brez parkimi;
- d) rrugë me dy korsi kalimi dhe dy breza parkimi;

Vija e ndërtimit për këto rrugë jepet me projekte të veçanta.

65. Gjerësia e trotuareve në rrugët shëtitore të qyteteve jepet me projekt të veçantë.

66. Distanca minimale e banesave ose objekteve nga bordura e rrugës, për rrugë qyteti të jetë:

jo më pak se 5m për rrugë me gjerësi deri 7m;

jo më pak se 7,5m për rrugë me gjerësi 7-15m;

jo më pak se 10 m për rrugë me gjerësi mbi 15m.

67. Ndalohet dalja në rrugët e kategorisë së parë nga rrugët e kategorisë së katërt dhe të pestë.

Distanca minimale e daljeve në rrugët e kategorisë së parë, të rrugëve të kategorisë së dytë dhe të tretë duhet të jetë 100 m, ndërsa në rrugët e kategorisë së dytë 50 m.

Ndalohet dalja e çdo rruge më afër se 50 m nga kryqëzimi.

68. Kryqëzimet e rrugëve të qyteteve bëhen:

- a) me disnivel për dy rrugë të kategorisë së parë;
- b) me disnivel për rrugë të kategorisë së parë me rrugë të kategorisë së dytë;
- c) për kategoritë e tjera kryqëzimi bëhet sipas në dispozicion.

69. Zona e banimit me qëllim që të sigurojë kushte jetese të shëndetshme për popullsinë, duhet të vendoset në territorin me klimë më të mirë të qytetit, në zgjedhjen e saj duhet të kihet parasysh:

- diellëzimi;
- temperatura e ajrit;
- drejtimi dhe shpejtësia e erës;
- lagështia e ajrit;
- rreshjet atmosferike.

Në këta tregues duhet të merren mesataret mujore, stinore dhe ato vjetore.

70. Elementet përbërëse të zonës së banimit janë:

- a) terrene banimi;
- b) terrene shoqërore;
- c) terrene të gjelbërta;
- d) terrene sportive;
- e) rrugë, sheshe, vendqëndrime.

71. Në terrenet e banimit përfshihen njësitë urbanistike të banimit dhe rrugët e brendshme midis tyre. Pjesë përbërëse e tyre janë parcelat e çerdheve, kopshteve, shkollave 8-vjeçare dhe shërbimeve të përditshme tregtare e komunale.

Terrenet e banimit ndahen në njësi strukturore urbanistike. Mbështetur në përvojën e ndërtimit të qyteteve tona dhe në madhësitë territoriale dhe të popullsisë së tyre njësitë strukturore të terreneve të banimit janë:

- grup banimi;
- bllok banimi;
- kompleks banimi;
- lagje banimi.

72. Grupi i banimit është njësi më e vogël me popullsi deri në 1000 banorë dhe me sipërfaqe deri në 1.5 ha për ndërtime shumëfamiljare dhe deri në 5 ha për ndërtime njëfamiljare. (Për qytete të kategorisë III-IV dhe rikonstruksionet e qyteteve). Grupi i banimit për ndërtesat shumëfamiljare përbëhet:



- sipërfaqe ndërtimi	4.5 m <sup>2</sup> /banorë
- sipërfaqe e lirë	10 m <sup>2</sup> /banorë
- territor banimi neto	14.5 m <sup>2</sup> /banorë
- shesh lojërash për fëmijë 0-6 vjeç	<u>1.3 m<sup>2</sup> /banorë</u>
Gjithsej	15.8 m <sup>2</sup> /banorë

73. Njësitë tregtare ose të shërbimit parashikohen në katet përdhese të banesave. Në treguesin 10m<sup>2</sup> /banorë sipërfaqe e lirë përfshihet norma 4m<sup>2</sup>/banorë gjelbërim. Pjesa tjetër është sipërfaqe e pandërtuar dhe rrugë deri në hyrjet e banesave.

74. Blloku i banimit është njësi urbanistike që përbëhet nga 3-4 grupe banimi me popullsi 3000–4000 banorë dhe sipërfaqe 6–8 ha për ndërtime shumëfamiljare dhe deri 30 ha për ndërtime njëfamiljare. Baza e organizimit të bllokut të banimit janë objektet shoqërore të kopshtit, çerdhes, njësitë e shërbimit tregtar komunal, si dhe terrenet sportive për fëmijë mbi 6 vjeç. Blloku i banimit për ndërtesat shumëfamiljare përbëhet nga:

- territori i banimit neto	14.5 m <sup>2</sup> /banorë
- shesh lojërash për fëmijë	1.5 m <sup>2</sup> /banorë
- sipërfaqe për objekte shoqërore	2.0 m <sup>2</sup> /banorë
- terrene sportive	0.5 m <sup>2</sup> /banorë
- rrugë dhe sheshe midis grupeve	<u>1.5 m<sup>2</sup>/banorë</u>
Gjithsej	20.0 m <sup>2</sup> /banorë

75. Kur shërbimet tregtare dhe komunale janë zgjidhur të veçanta, parcela e tyre llogaritet me treguesin 0.5 m<sup>2</sup>/banorë dhe i shtohet normativës së bllokut (20 m<sup>2</sup>/banorë).

76. Në ndërtimet njëfamiljare, për sipërfaqet e objekteve shoqërore dhe të terreneve sportive, përdoret e njëjta normativë. Treguesit e tjerë ndryshojnë në funksion të zgjidhjes së madhësisë së parcelave.

77. Kompleksi i banimit është njësi urbanistike që përbëhet nga disa blloqe banimi me popullsi 6000-8000 banorë dhe sipërfaqe nga 16-20 ha për ndërtime shumëfamiljare. Në përbërje të kompleksit merr pjesë shkolla 8-vjeçare. Kompleksi i banimi përbëhet:

- territor banimi neto	14.5 m <sup>2</sup> /banorë
- shesh lojërash për fëmijë	1.5 m <sup>2</sup> /banorë
- sipërfaqe për objekte shoqërore	2.0 m <sup>2</sup> /banorë
- sipërfaqe për terrene sportive	1.5 m <sup>2</sup> /banorë
- gjelbërim i organizuar (lulishte)	1.5 m <sup>2</sup> /banorë
- sipërfaqe rrugë dhe sheshe midis blloqeve	<u>3.0 m<sup>2</sup> /banorë</u>
Gjithsej	24.0 m <sup>2</sup> /banorë

78. Për shërbimet tregtare e komunale të zgjidhura të veçanta, normativa për territorin e tyre është m<sup>2</sup>/banorë dhe kjo i shtohet normativës së kompleksit të banimit (24.0 m<sup>2</sup> /banorë).

79. Në treguesin normativ për objektet shoqërore janë llogaritur sipërfaqet e nevojshme për parcelat e çerdheve e kopshteve që variojnë nga 0.3-0.4 ha për një çerdhe ose një kopësht dhe për parcelën e shkollës 8-vjeçare 0.6-1 ha.

80. Të gjitha këto norma janë mbështetur në studimin demografik, i cili ka përcaktuar grup-moshat përkatëse që kanë nevojë funksionale kopshtin, çerdhen apo shkollën. Nga kjo rezulton që bllokut të banimit për popullsinë e tij i duhet një çerdhe dhe një kopësht dhe kompleksit të banimit dy çerdhe, dy kopshte dhe një shkollë 8-vjeçare. Për këto objekte shoqërore është dhënë treguesi m<sup>2</sup>/për banorë në grupimet e mësipërme të terreneve të banimit.

81. Lagje banimi është njësi urbanistike më e madhe që përbëhet nga dy komplekse banimi me popullsi 12-16 mijë banorë dhe sipërfaqe 32-40 ha. Ka në përbërje të saj shërbime të përqendruara tregtare, komunale të shërbimit social, kopësht, çerdhe, dy shkolla 8-vjeçare, një shkollë të mesme, parkun e lagjes, terrene sportive të të gjitha grup-moshave, shërbimin shëndetësor dhe administrativ, sallë koncertesh, bibliotekë etj.

82. Kjo njësi urbanistike vlen për qytetet e kategorisë së IV-V-VI.

Për këtë kategori qytetesh në çdo 2-3 lagje duhet të ketë dhe qytete të shkallës së qytetit.

83. Për qytetet e kategorisë I,II,III ndarja bëhet më komplekse ose me blloqe banimi.

Objektet shoqërore respektive të bllokut, kompleksit apo lagjes, edhe kur këto njësi urbanistike nuk formojnë terrenet e banimit, në funksion të madhësisë së qytet, duhet të parashikohen për vetë funksionet e tyre të domosdoshme për jetën e banorëve (p.sh. shkollë e mesme, kinema, teatër etj.).

84. Rrugët e kategorisë së parë, të dytë dhe të tretë nuk duhet të përshkojnë grupin, bllokun, kompleksin dhe lagjen e banimit.

85. Sipërfaqet e nevojshme për parkimet e hapura dhe të mbyllura janë:

- për banesa kolektive,  $15\text{m}^2$ /për parkim dhe në vend parkimi për familje;
- për zonat masive sportive, vend parkimi/5veta;
- për parqe brenda qytetit, vend parkimi 10/veta;
- për parqe periferike të qytetit, vend parkimi/15 veta;
- për objekte kulti, vend parkimi/4 veta,
- për biblioteka, vend parkimi 25/veta,
- për qendra tregtare, 1 vend parkimi 3/veta;
- për qendra shëndetësore, 1 vend parkimi/25veta,
- për qendra spitalore, 1 vend parkimi/4 shtretër;
- për kinema, vend parkimi/4 vende;
- për teatër, vend parkimi/5 vende;
- për qendra qytetesh,  $0.02\text{ m}^2$  parkimi/banor zone;
- për objekte shoqërore,  $0.10\text{ m}^2$  parkimi/banor zone.

Shënim: Banor zone është numri i banorëve të një zone që i shërben objekti i mësipërm.

86. Terrenet e banimit realizohen me ndërtesa shumëfamiljare ose me ndërtesa njëfamiljare. Si në zona të lira ndërmjet ndërtesave ekzistuese, ashtu dhe në territore të reja ato vendosen mbi bazën e një studimi urbanistik.

87. Terrenet shoqërore përfshijnë parcelat e:

- ndërtesave administrative të lagjeve të qytetit;
- ndërtesave kulturore të lagjeve të qytetit;
- shkollave të mesme;
- ndërtesave shëndetësore;
- ndërtesave të shërbimit tregtar të lagjeve të qytetit;
- ndërtesave të shërbimit komunal të lagjeve të qytetit;
- monumenteve të kulturës.

88. Terrenet e gjelbërta përfshijnë sipërfaqet e:

- parqeve apo lulishteve të kompleksit të banimit,  $1 - 2\text{ m}^2$ /banorë;
- parqeve e lulishteve të qytetit,  $2\text{ m}^2$ /banorë;
- gjelbërimin rrugor e brigjeve ujore,  $1\text{ m}^2$ /banorë;
- gjelbërimin në objektet shoqërore,  $2\text{ m}^2$ /banorë;

89. Terrenet sportive, përfshijnë sipërfaqet e:

- terreneve sportive të lagjeve për grup-moshat III dhe IV,  $1.6\text{m}^2$ /banorë;
- objekteve të aktivitetit cilësor e spektakël (stadiume, pallate sporti, palestra, pishina etj.)

90. Rrugët, sheshet, vendqëndrimet përfshijnë sipërfaqet e:

- rrugëve kryesore të qytetit, së bashku me trotualet;
- rrugëve midis komplekseve;
- shesheve si hapësirave të lira;
- vendqëndrimeve të automjeteve, të hapura ose të mbyllura.

91. Normativat e projektimit urbanistik të zonës së banimit janë përmbledhur në tabelat nr.1 deri nr.4.

Në këto tabela jepen dendësia bruto e neto e banimit dhe koeficienti i intensitetit të ndërtimit neto "i".

- dendësia bruto e banimit është raporti midis numrit të banorëve me sipërfaqen e territorit bruto të njësisë urbanistike.

- dendësi neto e banimit është raporti midis numrit të banorëve me sipërfaqen e territorit të banimit neto.

- intensiteti i ndërtimit neto "i" është koeficienti që tregon intensitetin e ndërtimit në territorin e banimit. Ai shpreh raportin ndërmjet shumës së sipërfaqes së kateve të banimit mbi sipërfaqen e territorit të banimit.

Tabela 1

Elementët përbërës të zonës së banimit

Qytetet sipas numrit të banorëve	Terrene banimi m <sup>2</sup> /b	Terrene shoqërore m <sup>2</sup> /b	Terrene të gjelbëra m <sup>2</sup> /b	Terrene sportive m <sup>2</sup> /b	Rrugë shesh m <sup>2</sup> /b	Gjithsej m <sup>2</sup> /b
Deri në 10 000	52-46	5	3-4	4	6-7	70-66
10 000 - 20 000	46-41	5-6	4-5	4-3	7-8	66-63
20 000 - 50 000	41-36	6-7	5-6	3-2	8-9	63-60
50 000 - 100 000	36-30	7	6-7	2	9	60-55
100 000 - 200 000	30-27	8	7	2-2.4	9-10	55
Mbi 200 000	26.5	12	7	2.5	12	60

Tabela 2

Dendësia e popullsisë për blloqe e komplekse banimi

Numri i kateve të banesave	Dendësitë e banimit bruto e neto b/ha sipas sipërfaqes së lirë 12 m <sup>2</sup> /banorë			
	Bruto	Neto	Bruto	Neto
2	100-170	140-220		
3	280-300	500-530		
4	300-350	540-600		
5	360-380	650-750		
6	380-400	750-780		
8	420-440	780-820		
9	440-460	850-900		

Tabela 3

Tabela e të dhënave për ndërtime individuale me lartësi kati 2 - 3

Emërtimi	Banesa në rresht	Banesa të vendosura dy e nga dy	Banesa të veçanta
1.Sipërfaqja e parcelës në m <sup>2</sup>	150-190	200-300	300-500
2.Dendësi bruto banorë/ha	170	130	100
3.Dendësi neto banorë/ha	220	170	140
4.Intensiteti i ndërtimit e sip. të kateve sip. përgj. e parcelave	1.3-0.8	0.85-0.5	0.8-0.3

**Tabela 4**  
Elementët përbërës të kompleksit të banimit dhe lagjes

Madhësia e njësisë urbanistike	Terr.banimi		Terr.shoqërore		Terr.gjelbërta		Terr.sportive		Rrugë-sheshe		Gjithsej	
	Ha	m <sup>2</sup> /b	Ha	m <sup>2</sup> /b	Ha	m <sup>2</sup> /b	Ha	m <sup>2</sup> /b	Ha	m <sup>2</sup> /b	Ha	m <sup>2</sup> /b
Kompleksi 6000 - 8000 b	1.	12	2.5		3	5	1	2	2.1		16	25
	8.4	14	1.5	2.5	3	5	1	1.6	3.5		16.8	28
									2.4	4		
Lagje 12000 - 16000 b	1.	12	3.6	3	6	5	2	1.6	6		1.	27
	16.8							2	5		38.4	32
									7.2	6		

Dendësia e popullsisë B/Ha dhe intensiteti i ndërtimit neto sipas lartësisë së kateve (kompleksi banimi)

Treguesit tekniko-ekonomik	2 kate	3 kate	4 kate	5 kate	6 kate	8 kate	9 kate
Dendësia popullsisë	140-220	500-530	540-600	650-720	730-760	780-820	850-900
Intensiteti ndër neto	0.3-0.8	0.5-7	0.7-0.9	1-1.3	1.2-1.4	1.3-1.6	1.6-1.8

92. Zonat e qendrës të qytetit përbëhen nga tërësia e objekteve shoqërore të karakterit të qytetit, si p.sh. bashki, objekte kulturi, teatër, bankë, hotel, qendër tregtare, qendër biznesi, qendër administrative etj., së bashku me territoret e domosdoshme të tyre (vendqëndrime, sheshe, gjelbërim funksional etj.). Sipas madhësisë dhe karakterit të qytetit kjo zonë ka karakteristika dhe madhësi të ndryshme. Normativat për këtë zonë janë një shumatorë e normave të objekteve shoqërore dhe shesheve të tyre. Zona e qendrës së qytetit për vetë funksionin e saj duhet të jetë lehtësisht e arritshme si nga këmbësorët dhe nga automjetet. Në terrenin brenda saj ajo duhet të funksionojë vetëm për këmbësorët.

93. Zona e spitaleve përbëhet nga tërësia e objekteve shëndetësore me shtretër, si spital patolojik, pediatri, kirurgji, maternitet etj. Prandaj normativat për këtë zonë janë një shumatorë e normativave të objekteve shëndetësore përbërëse të saj. Madhësia e zonës së spitaleve është në funksion të madhësisë së qytetit. Në qytetet e kategorisë I, II, III kjo zonë duhet të jetë një e vetme, ndërsa në qytetet e kategorisë së IV, V, VI mund të ketë dy a më shumë zona spitalësh. Territori i zonës së spitaleve zihet me ndërtime në masën 15% të tij dhe pjesa tjetër shërben për gjelbërimin, rrugë dhe shërbime ekonomike.

94. Zona e spitaleve duhet të ketë lidhje të mirë me qendrën dhe rrugët kryesore të qytetit. Vendoset pranë zonave të gjelbërta (jo të pushimit masiv), larg varrezave, pularive, kryqëzimit të rrugëve të trafikut të rëndë, në vende të mbrojtura nga erërat e forta, zhurmat, tymërat, pluhurat dhe ndotësit industrialë. Territori i zonës së spitaleve duhet të ketë jo më pak se dy hyrje. Morgu duhet të ketë hyrje dhe dalje të veçantë.

95. Zona e gjelbërt e qytetit përbëhet nga:

- Gjelbërimi i përgjithshëm shoqëror ku hyn (sipas kategorisë së qytetit):

a) gjelbërimi i zonës së banimit;

b) gjelbërimi i zonës së pushimit.

- Gjelbërimi shoqëror i kufizuar (sipërfaqet e gjelbëruara të objekteve me funksion të ndryshëm, p.sh. çerdhe, shkolla, konvikte, spitale dhe gjelbërimi përreth ndërtimeve një familjare).

- Gjelbërimi i veçantë (kopshti botanik, zoologjik, gjelbërimi në rezidenca, fidanishte, breza sanitare). Sipas karakteristikave të veçanta të qyteteve të ndryshme këto grupime të gjelbërimit herë futen në zonën e gjelbërt të qytetit, herë krijojnë zona të veçanta, si zonë pushimi, zonë brezi sanitar dhe fidanishte, zonë parku zoologjik e botanik etj.

96. Gjelbërimi i përgjithshëm shoqëror :

a) gjelbërimi i zonës së banimit

- gjelbërimi në komplekse banimi 1.5 m<sup>2</sup> /banorë
- gjelbërimi në parqe e lulishte qyteti 1.5- 3.5 m<sup>2</sup>/ banorë
- gjelbërim në rrugë, shëtitore, brigje ujore 2 m<sup>2</sup>/ banorë
- Gjithsej 5 – 7 m<sup>2</sup>/ banorë

Për parqet dhe lulishten, pronë e personave fizikë e juridikë, privatë nuk jepet normativë urbanistike.

b) gjelbërim i zonës së pushimit

- park periferik 8-14m<sup>2</sup>/banorë

97. Gjelbërimi shoqëror i kufizuar, 1-2 m<sup>2</sup>/banorë përbëhet nga:

a) gjelbërim në objekte me përdorim të kufizuar (gjelbërimi i zonës së spitaleve përdoret vetëm nga të sëmurët, gjelbërim i zonës universitare nga studentët etj.);

b) gjelbërim në shtëpitë njëfamiljare.

98. Gjelbërimi i veçantë

- a) kopësht botanik 0.3 - 0.5 m<sup>2</sup>/banorë
- b) kopësht zoologjik 0.6 - 1 m<sup>2</sup>/banorë
- c) fidanishte, zonë mbrojtëse sanitare 0.8 - 2 m<sup>2</sup>/banorë.

99. Zona e terreneve sportive përbëhet nga terrenet sportive që klasifikohen në:

- a) terrene sportive të aktivitetit masiv;
- b) terrene sportive të aktivitetit spektakël.

Në terrene sportive të aktivitetit masiv hyjnë terrenet sportive dhe sheshet e lojërave për fëmijë të grupuar në katër grup-mosha:

- grupi i parë 0-3 vjeç;
- grupi i dytë 3-6 vjeç;
- grupi i tretë 6-16 vjeç;
- grupi i katërt 16 vjeç e lart.

100. Treguesi urbanistik për grupin e parë dhe të dytë është dhënë në normativën e grupit, bllokut dhe kompleksit të banimit, 1.25 m<sup>2</sup>/banorë.

101. Treguesi urbanistik për grupin e tretë dhe të katërt është dhënë në normativën 1.6 m<sup>2</sup>/banorë për kompleksin dhe lagjen e banimit. Kjo normativë shërben për qytetin, për aktivitetet masive sportive.

b- Treguesi urbanistik i terreneve sportive të aktivitetit spektakël është 1 m<sup>2</sup>/banorë për qytetet e kategorisë së IV, V, VI. Për qytetet e kategorisë I, II, III përdoren normat e objekteve të karakterit spektakël ( stadium, pallat sporti, pishinë, fusha sportive etj.) mbasi normativa e mësipërme nuk i përshtatet madhësisë së tyre.

102. Terrenet sportive vendosen në toka të papërshtatshme për ndërtime me reliev të rrafshët ose me pak pjerrësi. Duhet të jenë të mbrojtura nga era, të diellëzuara dhe pranë burimeve e pasqyrave ujore.

103. Zona universitare dhe e institucioneve shkencore përbëhet nga objektet arsimore profesionale dhe të arsimit të lartë ( që nuk bëjnë pjesë ndër objektet e zonës së banimit), si dhe institucionet kërkimore e shkencore të fushave të ndryshme. Me përjashtim të qyteteve të kategorisë së IV, V, VI ku këto formojnë zonë, në qytetet e tjera janë pjesë përbërëse e objekteve shoqërore të karakterit të qytetit, që përbëjnë zonën e qendrës së qytetit.

Madhësia e kësaj zone është në funksion të numrit të këtyre objekteve dhe treguesve urbanistikë të veçantë për secilin prej tyre. Zona universitare, për fluksin e madh të lëvizjes që ka, duhet të lidhet mirë me rrjetin rrugor të trafikut urban dhe të trafikut të jashtëm.

104. Zona e varrezave publike është territori i i varrezave, madhësia e të cilit është në varësi të madhësisë të qytetit. Sipërfaqja territorit të varrezave llogaritet me treguesin 1.5 m<sup>2</sup>/banorë të gjallë. Në këtë tregues është përfshirë edhe sipërfaqja e gjelbërimit dhe e rrugëve të brendshme të varrezave. Territori i zonës së varrezave duhet të jetë jashtë zonës së banimit, dhe jo më afër se 300 m nga shtëpia e fundit e qytetit, fshatit apo qendrës së banuar.

105. Zona industriale përbëhet nga territoret e objekteve industriale (në qytetet e kategorisë I, II, III hyjnë dhe territoret e bazave grosiste tregtare). Madhësia e saj varet nga lloji i qytetit (industrial, bujqësor-industrial etj.) Zona industriale duhet të lidhet me të gjitha rrugët e trafikut të

rëndë dhe trafikut të jashtëm. Pozicioni i saj kundrejt zonës së banimit përcaktohet duke pasur parasysh trëndafilin e erërave për qytetin, si dhe distancat dhe brezat mbrojtës sanitarë për të evituar dëmshmerinë nga ndotjet, zhurmat, derdhjet etj.

Rrjeti i infrastrukturës së zonës industriale duhet të jetë i pavarur nga ai i zonave të tjera të qytetit.

106. Zona e bazave grosiste tregtare, përbëhet nga territoret e depove të të gjitha kategorive. Si zonë e veçantë gjendet në qytetet e mëdhenj të kategorisë IV-V-VI. Sipërfaqja e kësaj zone si normë orientuese duhet të jetë 2-5% e sipërfaqes së përgjithshme të qytetit. Kjo zonë duhet të lidhet me rrjetin e trafikut të rëndë dhe transportin e jashtëm të qytetit.

107. Zona mbrojtëse sanitare dhe zona e fidanishtes llogariten si zonë e veçantë kur nuk është futur në zonën e gjelbërt të veçantë të qytetit.

Për zonën e fidanishtes norma e dhënë te zona e gjelbërimit të veçantë nga 08 – 2m<sup>2</sup>/banorë ndahet në:

- a) sipërfaqe për fidane drurësh dhe shkurresh dekorative, 0.6-1.5 m<sup>2</sup>/banorë;
- b) sipërfaqe për sera dhe lule dekorative, 02 –05 m<sup>2</sup>/banorë.

108. Madhësia e zonave mbrojtëse sanitare është në varësi të shkallës së ndotjes së objekteve industriale, relievit të vendit dhe trëndafilin të erërave.

Sipas gjerësisë, zonat mbrojtëse sanitare klasifikohen në pesë grupe:

- grupi i parë, me gjerësi të zonës mbrojtëse sanitare jo më pak e 700 m;
- grupi i dytë, me gjerësi të zonës mbrojtëse sanitare jo më pak 500 m;
- grupi i tretë, me gjerësi të zonës mbrojtëse sanitare jo më pak se 300 m;
- grupi i katërt, me gjerësi të zonës mbrojtëse sanitare jo më pak se 100 m;
- grupi i pestë, me gjerësi të zonës mbrojtëse sanitare jo më pak se 50 m.

109. Ministria Shëndetësisë dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit duhet të bëjnë kategorizimin e objekteve që sipas shkallës së ndotjes kërkojnë breza mbrojtës sanitarë sipas klasifikimit në pesë grupe.

110. Zona e transportit të jashtëm të qytetit përfshin stacionet hekurudhore të pasagjerëve dhe të mallrave, agjencitë e autobusave inter- urbane, portet ujore, aeroportet, rrugët nacionale (autostradat). Si normë orientuese kjo zonë zë një sipërfaqe që lëviz nga 3-11% të territorit të përgjithshëm të qytetit. Treguesit urbanistikë të kësaj zone i takojnë një faze të mëtejshme të studimit që duhet të kryhet në bashkëpunim me Ministrinë e Transporteve. Pjesët përbërëse të kësaj zone duhet të lidhen në mënyrë të shpejtë dhe komode me zonat funksionale të qytetit, si banim, pushim, industri etj., me anë të rrjetit të tyre rrugor.

111. Zona e parkut zoologjik dhe botanik është pjesë përbërëse e gjelbërimit të veçantë të qyteteve. Treguesit urbanistikë për këtë zonë janë dhënë më sipër në zonën e gjelbërimit. Në qytetet e kategorisë së V dhe të VI mund të përbëjnë dhe zonë të veçantë. Duhet të vendoset në zona me gjelbërim natyror të pasur në terrene me kushte të favorshme higjieno – sanitare, me vlera panoramike dhe pranë sipërfaqeve ujore (natyrore dhe artificiale), sipas studimeve përkatëse për këtë problem. Duhet të lidhen në mënyrë komode dhe të shpejtë me zonën e banimit nëpërmjet rrugëve të trafikut të lehtë. Kjo zonë nuk duhet të përshkohet nga rrugët e trafikut. Në kufi të saj, sipas studimit urbanistik zgjidhen vendqëndrimet e automjeteve të trafikut të lehtë dhe urban.

112. Zona e pushimit përbëhet nga territoret e pushimit masiv të banorëve. Në qytete të ndryshme ka karakteristika të ndryshme që lidhen me pozicionin gjeografik, me klimën, natyrën etj. Mund të jetë pjesë e zonës së gjelbërt të qytetit (dhënë më sipër dhe si tregues urbanistik), si parqe periferike, vende të ndryshme panoramike, pyje etj. Duhet të lidhet sa më mirë me zonën e banimit dhe të pajiset me objekte të ndryshme të shërbimit publik, si objekte argëtuese, kulturore, sportive, me sheshe të ndryshme lojërash për fëmijë e të rritur, objekte shërbimi tregtare, rrugë këmbësore, shkallare etj.

113. Zona turistike përbëhet nga zona me vlera të mëdha natyrore, peizazhistike, kulturore, sportive, shëndetësore pushimi etj.

- a) Përkufizimi i zonave turistike

Konsiderohen zona turistike ato që përdoren nga vizitorë për qëndrime të shkurtra ose eskursionë një ose disaditore; për pushim (plazhe detare, parqe pyjore, qendra alpine, brigje

liqenesh, rezervuarësh e lumenjsh etj.); për aktivitete sportive (gara, ngjitje alpinistike, ski, golf, eskursionë, gjueti, peshkim); për aktivitete kulturore (shfaqje, vizita në qendra e monumente historike, njohje të bukurive natyrore); për aktivitete biznesi (seminare, panaiere); për aktivitete shtetërore e politike (kongrese, konferenca); për shërbime shëndetësore (kura termale, qendra rehabilitimi).

b) Kriteret bazë të projektimit të zonave turistike janë:

- Në lidhje me ruajtjen:

Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisëve të çmuara dhe karakteristike natyrore e historiko-kulturore kundrejt urbanizimit:

Ruajtja e territoreve të aktiviteteve bujqësore, blegtorale, pyjore, detare, të prodhimit.

- Në lidhje me urbanizimin:

Urbanizimi i qyteteve dhe fshatrave ekzistuese, që ndodhen në zona turistike, kryhet në vazhdimësi të tyre ose me krijimin e fshatrave të vegjël të integruar në mënyrë harmonike me mjedisin;

Urbanizimi i bregdetit duhet të jetë i kufizuar vetëm për pajisje që lidhen drejtpërdrejt me të. Në një rrip me gjerësi 250-300 m nga niveli më i lartë i sipërfaqes ujore nuk lejohen ndërtime, përveç rasteve të veçanta që përbëjnë objekt justifikimi të qartë mbi bazën e motiveve urbanistike ekonomike ose detyrimeve topografike.

Ndërtimet nuk duhet të prekin brezat pyjorë.

- Në lidhje me rrugët:

Në bregdet, rrugët e reja transit duhet të ndërtohen në largësi nga vija e bregut jo më pak se 2000 m. Rrugët e shërbimit si rregull nuk vendosen gjatë bregut.

Në zona panoramike e malore rrugët e reja nuk duhet të vendosen jashtë kufirit pyjor.

Rrugët këmbësore duhet të bëjnë të mundur hyrjen e vizitorëve në vijën bregdetare dhe në territoret e zonave turistike.

c) Norma për projektimin e komplekseve turistike

Kategoria	Kategoria turistike e ulët dhe e mesme	Kategoria turistike e lartë dhe elit
Dendësia turistike e komplekseve turistike	100 - 150 vizitor për ha	50-100 vizitor për ha
Sipërfaqja mesatare e plazhit (ranor, gurale dhe shkëmbore)	Jo më pak se 6 m <sup>2</sup> /vizitor	Jo më pak se 10 m <sup>2</sup> /vizitor
Gjatësia e bregut të plazhit	Jo më pak se 0.5 ml/vizitor	Jo më pak se 0.7 ml/vizitor
Sipërfaqja e detit për vozitje	1 ha për anije me motor 0.5 ha për anije me vela	Idem Idem

d) Përbërja e zonave turistike

Kompleksi turistik përmban ndërtime :

- banimi (hotele, apartamente vila, bungaloë, rulo, çadra etj.);

- ndërtime shërbimi (restorant, bar, disko, dyqane, zyra, ambiente lojrash etj.);

- sheshe lojërash e sportesh, rrugë shërbimi e këmbësore;

- parqe e lulishte;

- parkime etj.

-Territoret e pyjeve, të sipërfaqeve ranore, gurale e shkëmbore, të pasqyrave ujore, të pajisjeve të përbashkëta të zonës turistike, të rrugëve të jashtme, të parkimeve qendrore, të veprave të pastrimit etj., nuk përfshihen në normën e dendësisë turistike.

114. Zona të veçanta nuk janë karakteristike për të gjithë qytetet. Si të tillë emërtohen territoret e karakterit unikal kombëtar dhe ndërkombëtar ku kryhet një veprimtari e një grupi të veçantë njerëzish, banorë apo jo të qytetit, për shembull zonë ambasadash, zonë reparti ushtarak, zonë panairesh ose territore që kanë rregullore të veçanta të trajtimit të tyre, si për shembull: zonë muze, zonë arkeologjike, zonë fetare etj. Për karakterin e tyre specifik, treguesi urbanistik i tyre nuk jepet në këtë rregullore.

115. Objekt ose ndërtim do të quhet çdo masë që formon vëllimin ose sipërfaqe ndërtimore, e cila krijon hije dhe ngrihet në lartësi, përveç pemëve ose gjelbërimeve të larta.

116. Në objekte përfshihen ndërtesa, mure, mure rrethuese, ndërtime të përkohshme, ndërtime transparente, reklama dhe që qëndrojnë në lartësi mbi 1.8 m. Për përcaktimin e distancave ndërmjet objekteve ose ndërtimeve merren në konsideratë tre faktorë kryesorë:

- orientimi;
- gjendje e fqinjësisë;
- kërkesat higjieno-sanitare.
- kërkesat për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

117. Në orientimin merret kusht bazë orientimi drejt jugut në kufij deri në 40 gradë të tij, si dhe tre orë diell në periudhën 22 mars-22 shtator.

118. Në gjendjen e fqinjësisë mbahet parasysh krijimi i hapësirave të nevojshme funksionale ndërmjet ndërtimeve.

119. Në kërkesat higjieno-sanitare përfshihen kërkesat për ndriçim, diellëzim, ajrim.

120. Në mbështetje të treguesve të mësipërm distancat ndërmjet objekteve duhet të jenë:

a) Kur ndërtesat vendosen karshi njëra-tjetrës dhe kanë një gjatësi deri 20 m distancë, distancat duhet të jenë:

- për ndërtesa me 1 kat, jo më pak se 4 metër;
- për ndërtesa me 2 kate, jo më pak se 6 metër;
- për ndërtesa me 3 kate, jo më pak se 8 metër;
- për ndërtesa me 4 kate, jo më pak se 10 metër;
- për ndërtesa me 5 kate, jo më pak se 12 metër;
- për ndërtesa me 6 kate, jo më pak se 14 metër;
- për ndërtesa me 7 kate, jo më pak se 16 metër;
- për ndërtesa me 8 kate, jo më pak se 18 metër;
- për ndërtesa me 9 kate, jo më pak se 20 metër;
- për ndërtesa me 10 kate, jo më pak se 24 metër;
- për ndërtesa me 11 kate, jo më pak se 24 metër;
- për ndërtesa me 12 kate, jo më pak se 26 metër.

b) Kur ndërtesat vendosen karshi njëra-tjetrës, kanë dritare dhe gjatësi mbi 20 m, distancat duhet të jenë:

- për ndërtesa me 1 kat, jo më pak se 6 metër;
- për ndërtesa me 2 kate, jo më pak se 9 metër;
- për ndërtesa me 3 kate, jo më pak se 13.5 metër;
- për ndërtesa me 4 kate, jo më pak se 18 metër;
- për ndërtesa me 5 kate, jo më pak se 20 metër;
- për ndërtesa me 6 kate, jo më pak se 22 metër;
- për ndërtesa me 7 kate, jo më pak se 24 metër;
- për ndërtesa me 8 kate, jo më pak se 26 metër;
- për ndërtesa me 9 kate, jo më pak se 27 metër;
- për ndërtesa me 10 kate, jo më pak se 28 metër;
- për ndërtesa me 11 kate, jo më pak se 29 metër;
- për ndërtesa me 12 kate, jo më pak se 30 metër.

c) Për përcaktimin e distancave ndërmjet dy ndërtesave me numër të ndryshëm katesh, distancat përcaktohen me interpolim, d.m.th. të dy ndërtesat konsiderohen me numër të njëjtë katesh, që është i barabartë me mesataren e shumës së numrit të kateve të tyre.

Shembull: në rastin e përcaktimit të distancës midis dy ndërtesave me lartësi 4 kate dhe 8 kate me gjatësi deri 20 m distanca do të përcaktohet si vijon:  $4 + 8 = 12$

$$12/2=6$$

Për lartësi të ndërtesës me 6 kate i referohemi tabelës së parë dhe gjejmë distancën jo më pak se 14 m.

d) Kur banesat shumëkatëshe vendosen përbri njëra-tjetrës dhe faqet në brinjë nuk kanë dritare, ato mund të jenë të larguara deri në 1 m ose në bashkim të plotë, me kusht që të merren



masa të caktuara për mbrojtjen nga zjarri, duke lënë nënkalime me përmasa 4m gjerësi dhe 5 m lartësi.

Në çdo rast, ndërtimet duhet të respektojnë kufirin e ndarjes së pronësisë dhe bashkimi i plotë mund të bëhet vetëm mbi bazën e marrëveshjes së pronarëve fqinjë.

e) Distanca e ndërtesave të banimit nga çerdhet, kopshtet, shkollat dhe objektet shëndetësore duhet të jenë jo më pak se 1.5 herë e lartësisë së ndërtesës më të lartë që qëndron nga jugu, ndërsa në drejtimet e tjera të horizontit zbatohen distancat e caktuara në pikat a, b dhe c.

121. Dalja konsol e mbi 50% të faqes së ndërtesës do të quhet faqe ndërtimi dhe do të merret parasysh në llogaritjen e distancës midis ndërtimeve.

122. Për ndërtimet gjatë rrugëve, çdo dalje konsol do të quhet faqe ndërtimi dhe nuk duhet të kalojë jashtë vijës së ndërtimit.

123. Kur pjerrësia e çatisë lejon mundësinë e shfrytëzimit të mbi 50% të sipërfaqes së përgjithshme të objektit që mbulohet dhe kur ka dritare në çati, për efekt të llogaritjes së distancave ajo konsiderohet një kat. Kur shfrytëzimi i çatisë është 30- 50 % dhe kur ka dritare në çati ajo konsiderohet si gjysmë kati.

Kur pjerrësia e çatisë është mbi 45 gradë dhe nuk ka dritare, për efekt të llogaritjes së distancave konsiderohet si gjysmë kati.

124. Kur lartësia e katit përdhe është mbi 5.0 m mbi kuotën e sistemuar, për efekt të llogaritjes së distancave lartësia e këtij kati konsiderohet si një kat e gjysmë dhe kur është mbi 6.0 m konsiderohet si dy kate.

125. Largësitë ndërmjet ndërtesave të banimit më të larta se 12 kate përcaktohen sipas studimeve urbanistike dhe projekteve të tyre.

126. Pavarësisht nga respektimi i distancave të dhëna në pikën 120, në çdo rast, duhet të kihet parasysh edhe respektimi i treguesve të shfrytëzimit të territorit për zonën e banimit.

127. Vleftat e koeficientit të shfrytëzimit të territorit “k” për objektet në:

- zonën e qendrës së qytetit	0.7 - 0.85
- zonën e spitaleve	0.6 - 0.75
- zonën industriale	0.5 - 0.7
- zonën e bazave grosiste tregtare	0.7 - 0.85

Koeficienti i shfrytëzimit të territorit është raporti midis sipërfaqes së ndërtimit dhe sipërfaqes së parcelës së objektit.

B. Plani rregullues i përgjithshëm për fshatrat dhe qendrat e banuara

128. Për planet rregulluese të përgjithshme të fshatrave dhe qendrave të banuara, kriteret dhe normat urbanistike për zonat e ndryshme të tyre do të merren në analogji me zonat e qytetit, duke reflektuar karakteristikat e veçanta të tyre.

129. Për zonën e banimit, përdoren treguesit urbanistikë të zonës së banimit të qytetit me ndërtime njëfamiljare.

130. Rrugët në fshatra ndahen në tre kategori:

- rrugë kryesore me gjerësi të pjesës së shtruar	7.5 m
- rrugë të dyta me gjerësi të pjesës së shtruar	5 m
- rrugica për kalimin e këmbësorëve me gjerësi të pjesës së shtruar	3 m

131. Për qendrat e banuara, në varësi të madhësisë së tyre, të përdoren normativat e qyteteve të kategorisë së I dhe II.

### III. RRUGËT JASHTË QENDRAVE TË BANUARA DHE NDËRTIMET GJATË TYRE

132. a) Sipas përcaktimit dhe klasifikimit të bërë në nenin 2 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, në rrugët e kategorisë “A”, autostrada, të kategorisë “B”, rrugë interurbane kryesore dhe të kategorisë “C”, rrugë interurbane dytësore, nuk lejohen hyrje-daljet, përveç atyre të përcaktuara në projektin e rrugës.

b) Ndalohet çdo lloj ndërtimi, me përjashtim të pikave të karburantit, në një distancë jo më të vogël se:

- i) 30 metra nga kufiri rrugor i rrugëve të kategorisë “A”;
- ii) 25 metra nga kufiri rrugor i rrugëve të kategorive “B” dhe “C”;

Pikat e karburantit vendosen në një distancë jo më të vogël se 10 m nga kufiri rrugor i rrugëve të kategorive “A”, “B” dhe “C”.

Në këtë kuptim, “kufi rrugor” konsiderohet fundi i pronësisë rrugore, referuar titujve të pronësisë dhe/ ose brezave të shpronësimit sipas projektit të miratuar.

Në mungesë të tyre, kufiri formohet nga vija e jashtme e hendekut të sigurimit të kanalit, kur ai ekziston, ose përkatësisht nga vija e sipërme/e poshtme e skarpatës, nëse rruga shtrihet në terren të pjerrët.

133. Qytetet, fshatrat e qendrat e banuara ekzistuese që ndodhen në buzë të rrugës kombëtare duhet të kenë parasysh:

- të kufizojnë shtrirjen e tyre gjatë rrugës kombëtare;
- në perspektivë, të përqendrojnë shtrirjen e tyre vetëm në njërën anë të rrugës kombëtare dhe normal me të;
- të ruhet trupi i rrugës kombëtare dhe perspektiva e zgjerimit të saj, të respektojnë rigorozisht vijën e kuqe të ndërtimeve;
- të ndërtojnë rrugët paralel me rrugën kombëtare, për të evituar lëvizjet e mjeteve të transportit të brendshëm të tyre;
- të përmirësojnë vazhdimisht trajtimin arkitektonik dhe sistemimin e objekteve gjatë rrugës kombëtare,
- të mirëmbajnë dhe përmirësojnë gjelbërimin gjatë rrugës kombëtare.

134. Kondicionet urbanistike për trasimin e autostradave, rrugëve kombëtare dhe hekurudhore

- Autostradat, rrugët kombëtare dhe hekurudhat të distancohen nga zonat prioritare turistike, arkeologjike, muze dhe ambientaliste.
- Autostrada, rrugët kombëtare ose hekurudha të kalojnë tangjencialisht me zonat prioritare turistike, arkeologjike, muze dhe ambientaliste kontinentale.
- Autostradat, rrugët kombëtare apo hekurudhat e reja të lidhin të gjitha qendrat e rretheve në të cilat ato kalojnë.
- Autostradat, rrugët kombëtare ose hekurudhat të kalojnë tangjencialisht me qytetet, fshatrat apo qendrat e banuara.
- Pika më e afërt e autostradës, rrugës kombëtare ose hekurudhës me qytetin, fshatin apo qendrën e banuar të kalojnë në kufirin e zonës suburbane (në vijën suburbane), të përcaktuar nga studimi urbanistik rajonal e mjedisor.
- Territori i qyteteve, fshatrave e qendrave të banuara, për asnjë rast, nuk ndahet nga traseja e autostradës, rrugës kombëtare ose hekurudhës.
- Ndalohet shfrytëzimi i brigjeve natyrore të lumenjve, përrenjve e elementeve të tjera natyrore ujore për trasimin e autostradave, rrugëve kombëtare e hekurudhave.
- Lejohet transversimi për lumenjtë e përrenjtë.
- Nuk lejohet transversimi i liqeneve dhe rezervuarëve.
- Traseja e autostradës, rrugës kombëtare apo hekurudhës nuk duhet të prekë rrugët e sotme kombëtare.
- Në rastet kur teknikisht është e detyrueshme të preken, të sigurohet qarkullimi i pandërprerë në rrugën ekzistuese.
- Kryqëzimi i autostradave, rrugëve kombëtare, rrugëve rajonale dhe rrugëve lokale me hekurudhat realizohet me mbikalim.

Drejtimi kryesor i lëvizjes në këto kryqëzime përcaktohet nga fluksi i lëvizjes sipas perspektivës shumëvjeçare dhe kategoria e rrugëve.

- Trasimi i rrjetit rrugor duhet të sigurojë kalimin e mjeteve nga njëra rrugë tek tjetra, në varësi të kategorive të tyre.

135. Ndërtimet në rrugët urbane (brenda qytetit, fshatit apo qendrës së banuar) duhet të respektojnë vijën e ndërtimeve.

Për të gjitha ndërtimet përgjatë rrugëve urbane që ndërlidhin autostradat apo rrugët interurbane kryesore e dytësore (unazat e jashtme dhe/ose rrugët hyrëse në qendrat urbane), përpara miratimit të lejes së sheshit të ndërtimit, subjekti duhet të pajiset me formularin 1/1 të ligjit nr.8405,

datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, së bashku me projektin teknik për hyrje-daljen e autorizuar, i cili miratohet nga enti përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e autostradave dhe rrugëve interurbane kryesore e atyre dytësore.

#### IV. NORMATIVAT E PROJEKTIMIT TË RRJETIT TË UJËSJELLËSIT

##### 136. Nivelet e projektimit të rrjetit të ujësjellësit

a) Për studimet urbanistike rajonale dhe mjedisore, studimi i rrjetit të ujësjellësit bëhet në fazën e skemëidësë;

b) Për planet rregulluese të përgjithshme, studimi i rrjetit të ujësjellësit bëhet në fazën e skemëidësë.

c) Për studime urbanistike pjesore, studimi i rrjetit të ujësjellësit bëhet në fazën e projektit teknik.

##### 137. Normat e përdorimit të ujit

a) Normat e përdorimit të ujit për qendrat e banuara.

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Normativa
1	Për qytete deri 10 000 banorë	Litra /banorë në ditë	200
2	Për qytete 10 001-50 000 banorë	“	250
3	Për qytete mbi 50 000 banorë	“	300
4	Për fshatra	“	100-150

Shënim 1 - Normat e paraqitura në tabelën e mësipërme përfshijnë sasinë e nevojshme të ujit për një banor si për përdorim vetjak për nevoja jetësore, ashtu edhe për përdorim publik.

b) Normat e përdorimit të ujit për zonat turistike.

Për zonat turistike, normat e përdorimit të ujit variojnë nga 400 litra/shtrat/ditë deri 500 litra/shtrat/ditë, në varësi të kategorisë së turizmit dhe të karakterit të zonës.

c) Normat e përdorimit të ujit për ujitjen e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe lagjen e rrugëve dhe shesheve.

Nr	Emërtimi	Njësia e matjes	Normativa për 1 m <sup>2</sup>
1	Për ujitjen e sipërfaqeve të gjelbëruara në qytet	litra/ ditë	1,5
2	Për ujitjen e sipërfaqeve të mbjella me lule	litra/ ditë	1,5
3	Për larje rrugësh dhe sheshesh në ditë me kohë të nxehtë	litra/ ditë	2
4	Për drurët e porsambjellë për 3 vitet e parë (me 8-10 ujitje në vit)	litra/ ditë/çdo dru	18-27

Shënim Normativat për drurët e porsambjellë në 3 vitet e para mund të përdoren edhe për fidanishtet e drurëve dhe shkurreve dekorative në shpërngultore 6-8 vjet.

- Për drurët dhe shkurret ekzistuese në sipërfaqe me 3-4 ujitje në vit, merret 80-100 litra.

- Për drurët në trotuarët e rrugëve e bulevardëve me 3-4 ujitje në vit merret 150 litra ujë për çdo rrënjë.

- Për qendrat e banuara nga 10 000-100 000 banorë, koeficienti orar i jonjëtrajtshmërisë merret 4, ndërsa për 100 000-200 000 banorë merret 2.

- Për ujitjen e fushave të golfit merret norma 4 l/m<sup>2</sup> në ditë.

##### 138. Kërkesat e ujit për mbrojtjen urbane

Gjatë punës për të kryer një studim apo planifikim urban duhen patur parasysh kërkesat e ujit për mbrojtjen urbane:

Hidrantet e jashtme të zjarrit të vendosen gjatë rrugës në afërsi të kryqëzimit të saj në largësi jo më shumë se 200 m nga njëri-tjetri, jo më afër se 5 m nga muret e jashtme të ndërtesave dhe jo më larg se 2 m nga bordura e rrugëve.

Zgjatja e kohës së shuarjes së zjarrit në qendrën e banuar pranohet 3 - 6 orë.

Rrjeti i jashtëm i furnizimit me ujë kontrollohet për rastin kundër zjarrit në kohën e konsumit maksimal të ujit në qendrën e banuar.

## V. ROLI DHE DETYRAT E ISP URBANISTIKE

139. Instituti i Studimeve dhe Projektmeve Urbanistike (ISPU) është organi i specializuar shtetëror në nivel kombëtar në fushën e planifikimit të territorit dhe studimeve e projekteve urbanistike në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. ISPU-ja është konsulent i KRRTRSH-së dhe hyn oponentica për të gjitha studimet e rëndësishme territoriale dhe urbanistike që hartohen nga institucione dhe organe të ndryshme studimore e projektuese vendase dhe të huaja, kundrejt pagesës nga i interesuari.

140. ISPU-ja ka këto detyra:

A. Në fushën e studimit dhe projektimit:

- planifikon territorin dhe përdorimin e tokës në Republikën e Shqipërisë;
- kryen studime, masterplane dhe studime rajonale për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

- kryen studime të infrastrukturës kombëtare dhe rajonale;
- studion dhe harton plane rregulluese të përgjithshme të qyteteve;
- bashkëpunon me organe dhe institucione të ndryshme studimore vendase dhe të huaja për të kryer studime të specializuara, si masterplane, studime urbanistike rajonale, plane rregulluese të përgjithshme etj:

- bashkërendon e sintetizon interesat e veprimtarisë së institucioneve qendrore dhe organeve të pushtetit lokal, ndërmarrjeve, sektorëve, individëve, ndërmarrjeve të përbashkëta, firmave të huaja, në fushën e realizimit të investimeve dhe të përdorimit të tokës mbi bazën e akteve ligjore, gjatë hartimit të studimeve urbanistike;

- bashkërendon studimet e institucioneve të tjera të specializuara, si p.sh. studimet sizmologjike, demografike, sociologjike, hidro-geologjike etj., të domosdoshme për studimet urbanistike të tij.

- trajton problemet e ruajtjes së ekuilibrit natyror, duke i bashkërenduar me interesat e shfrytëzimit dhe të vlerave të ndryshme, si ato ambientale, ekonomike, kulturore, shoqërore dhe trajton strategjinë e përgjithshme për to.

B. Në fushën e legjisllacionit:

- kryen studime në fushën e legjisllacionit të urbanistikës dhe harton aktet ligjore e nënligjore në bashkëpunim me organe dhe institucione të tjera të interesuara;

- propozon ndryshime të akteve ligjore dhe nënligjore pranë organeve qendrore të pushtetit legjisllativ dhe ekzekutiv;

- studion dhe harton akte teknike, metodika, rregullore e akte të tjera normative, në zbërthim të akteve legjisllative dhe të studimeve konkrete të kryera në ndihmë të organizmave të urbanistikës të pushtetit lokal.

141. Rregullat dhe normat urbanistike për personat me aftësi të kufizuar

### 1.1 Principet bazë

Rregullat dhe normat urbanistike për personat me aftësi të kufizuar PAK reflektojnë konceptin e projektimit pa barriera urbanistike duke arritur përshtatshmërinë e ndërtimeve dhe hapësirave publike për një integrim në jetën shoqërore të kësaj kategorie njerëzish njëlloj si të tjerët.

Referimi ndaj principeve bazë gjatë procesit të planifikimit do të sigurojë një shkallë të lartë përshtatjeje për PAK. Principet bazë për përshtatshmërinë formulohen si më poshtë:

- të jetë e mundur të arrihen të gjitha vendet, ndërtesat publike dhe ato të banimit;

- të jetë e mundur të hyet në të gjitha ndërtesat publike dhe ato të banimit;

- të jetë e mundur të përdoren të gjitha facilitetet publike dhe rregullimet mjedisore.

Këto principe duhet të interpretohen për të realizuar kërkesat e përgjithshme, të cilat duhet të merren parasysh në planifikimin dhe projektimin fizik si më poshtë:

- Mundësia e hyrjes- mjedisi ndërtimor duhet të projektohet për të dhënë mundësi hyrje për të gjithë njerëzit.

- Mundësia e arritjes – duhet të sigurohet në mjedisin ndërtimor që sa më shumë vende dhe ndërtesa të jetë e mundur, të arrihen nga çdokush.

- Mundësia e përdorimit- mjedisi ndërtimor duhet të projektohet që të përdoret e të shijohet nga të gjithë njerëzit.

- Orientimi – mjedisi ndërtimor duhet të projektohet që të jetë e lehtë të orientohesh dhe të gjesh rrugën në të.

- Siguria – mjedisi ndërtimor duhet të projektohet që njerëzit mund të lëvizin pa pasur frikën e kërcënimit të jetës apo shëndetit.

- Mundësia e punës – vendet e punës, zyrat dhe mjediset industriale së bashku duhet të projektohen për të lejuar pjesëmarrjen dhe kontributin e PAK.

Problemet e zakonshme që hasen për PAK në mjedisin ndërtimor janë:

- lëvizja përrreth, hapësira ndërmjet ndërtesave;

- hyrja në ndërtesa.

Këto kritere përbëjnë një bazë për projektimin e mjedisit në një mënyrë të tillë që pengesat dhe barrierat të shmangen.

### 1.2 Kërkesat e projektimit

Rrugët për PAK në mjedisin ndërtimor, urban duhet të projektohen për të mundësuar përdorimin e tyre gjatë lëvizjes në këtë mjedis. Ato duhet të jenë të lehta për t'i gjetur, të vazhdueshme, të lehta për t'i përdorur, të lira nga pengesa të paparashikuara me sipërfaqe të qëndrueshme dhe të dimensionuara përkatësisht.

Të paktën një hyrje në çdo ndërtesë duhet të jetë e lehtë për t'u gjetur dhe e lehtë për t'u përdorur nga çdo person që ka vështirësi në lëvizje dhe vështirësi në shikim.

Rrugët për tek dyert duhet të dimensionohen për të lehtësuar përdorimin për një karrige me rrota ose ndihmës të tjerë për të lëvizur.

Shenjat e vendosura mirë dhe të projektuara mirë janë të një rëndësie të madhe, për njerëzit për të gjetur rrugën e tyre brenda e jashtë ndërtesave. Projekti dhe vendndodhja janë veçanërisht të rëndësishme për personat me shikim dhe dëgjim të dëmtuar, si dhe për fëmijët. Shenjat, simbolet e tekstet informative duhet të paraqiten të tilla që të jenë të lehta për t'i kuptuar e lexuar, të përdoren tekste braille.

Vendndodhja e shenjave të jashtme në përgjithësi duhet të jetë e tillë që ana e poshtme e simbolit të informacionit të jetë min. 2.1 m mbi tokë.

Tabelat në hyrjen e një kompleksi godinash me një hartë orientuese të kompleksit, është udhëzues mjaft ndihmues për të gjithë vizitorët. Shkronjëzimi në shenja ose tabela instruksioni duhet i qartë me relief ose në braille.

Të vendosen piktogramet, të cilat janë figura ndërkombëtare.



## II.1 RREGULLAT

### II.1.1 Rrugët e praktikueshme për personat që kanë vështirësi lëvizjeje

Mjedisin ndërtimor duhet që për PAK për lëvizjet horizontale të lehtësojë përdorimin e karrigeve me rrota, si dhe lëvizshmërinë rreth e rrotull me ndihmën e aksesorëve të ndryshëm teknikë.

Për sigurimin e lëvizjes horizontale duhet të aplikohet ndërtimi i rrugëve të praktikueshme dhe lidhja e tyre me një nga rrugët e qarkullimit kryesor. Rruga e praktikueshme për PAK është rruga që përdoret zakonisht ose një nga rrugët e përdorshme. Ajo duhet të sigurojë lidhjen me hyrjen kryesore ose me një nga hyrjet kryesore dhe një shërbim të rregullt transporti. Këto kërkesa formojnë principet kryesore të arritshmërisë pa dallime sociale.

Kriteret dimensionale të lidhura me kuptimin e përshtatshmërisë janë kompetencë për të përcaktuar konfortin e përdoruesve. Rregullat teknike janë përcaktuar mbi bazën e dimensioneve në plan të zëna nga një karrige lëvizëse në pozicione të ndryshme. Shih fig.1.

Rrugët e praktikueshme duhet të shtrohen me materiale antirrëshqitëse, veshje me tulla, ploça, jo me hapësirë.

Gjerësitë e tyre duhet të përballojnë kryqëzimin e dy karrocave.

Në rastin e disniveleve përdoren rampat dhe në rastin e një disnivele më të madh se norma rekomandohet vendosja e një parmaku.

Rrugët këmbësore, si dhe kalimet trotuar – rrugë realizojnë vazhdimësinë e rrugëve të praktikueshme për të transversuar rrugën që nga trotuari.

Rrugët këmbësore krijojnë një komoditet max. për PAK nga siguria që ata gjejnë gjatë lëvizjes.

Rrugët urbane me trotuar kërkojnë sistemimin e kalimeve përpjendikulare me aksin e rrugës, konceptimin e panduseve, të cilët kërkojnë uljen e trotuarit në të gjithë gjerësinë e pandusit. Shtrimi i pandusit duhet të bëhet me materiale guri, çimento të realizuara me cilësi. Rekomandohet vendosje e elementeve të vegjël në formë kurriz peshku në planin e inklinuar, duke mos lënë shenja të puthitjes.

#### II.1.2 Parkimet

Të gjitha parkimet e automjeteve të jashtme dhe të brendshme duhet të përmbajnë një ose shumë vende të parkimit të sistemuar për PAK dhe i rezervuar përdorimi i tyre. Anash vendeve të parkimit të automjeteve të sistemuara duhet të ketë një rrip hyrjeje. Një vend i parkimit quhet i sistemuar për PAK kur ai përmban anash vendit të parashikuar për automjete një rrip i lirë nga të gjitha pengesat, i mbrojtur nga qarkullimi i makinave dhe i lidhur me një rrugë të praktikueshme në hyrje të objektit.

#### II.1.3 Rrugicat e drejtimit për personat që kanë vështirësi shikimi

Rrugicat e drejtimit formohen duke krijuar kontrast në reliev dhe ngjyrë me sipërfaqen përreth.

Rrugicat e drejtimit luajnë dy funksione: orientimi-nga tingulli diktues i fërkimit të bastunit.

Siguri në lëvizje- pasi mbi këtë rrugicë, ndalohet vendosja e çdo mobilimi urban.

Materiali që përdoret- pllaka antirrëshqitëse të vendosura përpjendikularisht me rrugicën.

Në hapësirat publike vendosen stacione me këmbalecë që përmbajnë tekste në reliev ose në alfabetin e të verbërve braille.

Për personat që nuk shohin është e nevojshme të sinjalizohet kufiri midis trotuarit dhe rrugës. Ky kufizues i tokës duhet të ngulet mbi trotuar, mbi panduse ose mbi rampat.

#### II.1.4 Mobilimi urban

Mobilimi urban i gjendur në trotuar ose i varur në mur, duke kufizuar trotuarin, duhet të gjendet jashtë rrugës së praktikueshme dhe gabaritet e tij duhet të korrespondojnë me lartësinë më të madhe se ajo e këmbësorit.

Pengesat të gjendura në lartësinë më pak se 2 m përbëjnë një rrezik për personat që nuk shohin ose shohin keq. Mbështetja e informacionit, të drejtuara këto në kokën e shtyllës, duhet të gjendet lart nga toka në mënyrë të tillë që të lexohet nga personat me karrige lëvizëse dhe nga fëmijët. Karakteret duhet të jenë të mëdha dhe kontraste për ata që nuk shohin mirë dhe informacionet kryesore do të duhet të jenë në reliev për të verbërit.

Në mjedisin urban vitrinat mbrojtëse, strehët e autobusëve, pemët të përshtatshme për t'u futur në rastin e një moti të keq, luajnë rolin mbrojtës për PAK.

Aparatet për tërheqjen e biletave, parkmetri duhet të vendosen jashtë rrugës së praktikueshme.

Mobilimi i konstruksioneve të vogla si kioska gazetash, kutia e letrave, kabinat telefonike duhet të përshtaten për një karrige lëvizëse. Numri i telefonit duhet të jetë përshtatur në reliev dhe në tipin braille.

### III.1 Normat urbanistike për personat që kanë vështirësi në lëvizje

#### III.1.1 Rrugët e praktikueshme

a).Dimensionimi i hapësirës për PAK




Fig.1

b).Gjeresite e rrugëve të praktikueshme




Fig.2




Fig.3

III.1.2.RAMPAT

a).Pjerrësia e rampave duhet  $\leq 5\%$  dhe në çdo 10m duhet një shesh pushim.Kur pjerrësia është  $\geq 4\%$  rampa shoqërohet me një bordurë rrore reshqitese.





Fig.4



### III.1.3. KALIMET TROTUAR- RRUGE PANDUSET

a). Panduset kane p jeresi  $\leq 5\%$  ne drejtimin perpendikular me rrugen dhe dy siperfaqe te inklinuara 8% te rakorduara me trotuarin.

a). Kur trotuari eshte i gjere Fig.5




Fig.5

b). Kur trotuari eshte i ngushte pandusi realizohet ne dy menyra:

1. Ulja e trotuarit Fig.6.

2. Mbingritja e rruges Fig.7.




Fig.6




Fig.7

### III.1.4. PARKIMET

1. Gjerësia e vendit të parkimit të sistemuar për PAK duhet 3.30m. Fig 8

2. Përshatja e parkimeve ekzistuese. Fig 9




Fig.8





Fig.9

### III.2.1. NORMAT URBANISTIKE PËR PERSONAT QË KANË VESHTIRESI SHIKIMI

#### III.2.1.1. RRUGICAT E DREJTIMIT

Gjerësia e rrugicave të drejtimit është min 0.30m. Këto duhet të kenë kontrast në relief dhe ngjyrë me sipërfaqen për rreth. Fig.10






Fig.10

### III.2.1.2.STACIONET ME KEMBALECA




Fig.11

### III.2.1.3.SINJALIZIMI I KUFIRIT MIDIS TROTUARIT DHE RRUGES.




Fig.12

#### IV.1. MOBILIMI URBAN

Mobilimi urban i gjendur ne trotuar ose i varur ne mur vendoset ne lartesine  $\geq 2m$ . Fig. 13




Fig.13

Ne mjedisin urban vitrinat mbrojtese, pemet e pershtateshme per tu futur PAK ne rastin e nje moti te keq, duhet te vendosen ne distance 200m. Fig.14




Fig.14

Aparatet per terheqjen e biletave duhet te vendosen jashte rruges se praktikueshme ne nje lartesi jo me te madhe se 1.30m.




Fig.15.

Kioskat e gazetave –lartesia e aparatit me e vogel se 0.80m.

Kutia e letrave-lartesia e te cares se kutise se letrave duhet te ndodhet 1.30m nga toka. Perpara ose anash rruges se praktikueshme duhet lene nje vend 0.80m 1.30m.Fig.16



Fig.16

Kabina telefonike duhet te vendosen ne lartesine 0.90m dhe 1.30m.  
Nje truall me dimensione 0.80m x 1.30m i lire nga te gjitha pengesat, i ndodhur perpara ose anash aparatit, duhet te jete i pershtatshem nga praktikueshme. Rekomandohet vendosja e nje ndenjese per personat qe lodhen shpejt.




Fig.17

V.I.HOLLESITE NDERTIMORE FIGURAT




Fig.18




Fig.19




Fig.20




Fig.21




Fig.22






Fig.23




Fig.24




Fig.25

## RREGULLAT DHE NORMAT ARKITEKTONIKE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

### I.1 Principet bazë

Rregullat dhe normat arkitektonike për personat me aftësi të kufizuar PAK reflektojnë konceptin e projektimit pa barriera arkitektonike, duke arritur përshtatshmërinë e ndërtimeve për një integrim të PAK-ve në jetën shoqërore.

Referimi ndaj principeve bazë gjatë procesit të projektimit do të sigurojë një shkallë të lartë përshtatshmërie për PAK. Principet bazë formulohen si më poshtë:

- të jetë e mundur të arrihen të gjitha ambientet e brendshme të një ndërtese publike ose banimi;
- të jetë e mundur të përdoren të gjitha fasilitetet e brendshme të ndërtesës.

Këto principe duhet të interpretohen për të realizuar kërkesat e përgjithshme, të cilat duhet të merren parasysh në planifikimin dhe projektimin fizik si më poshtë:

- Mundësia e hyrjes-mjedisi ndërtimor duhet të projektohet për të dhënë mundësi hyrjeje për të gjithë njerëzit.

- Mundësia e arrijtes- duhet të sigurohet në projektimin e mjedisit ndërtimor, që sa më shumë vende në ndërtesë të mund të arrihen nga çdo kush.

- Mundësia e përdorimit- mjedisi ndërtimor duhet të projektohet i tillë që të përdoret e të shijohet nga të gjithë njerëzit.

- Orientimi- mjedisi ndërtimor duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të jetë e lehtë të orientohesh e të gjesh rrugën në të.

- Siguria-mjedisi ndërtimor duhet të projektohet që të gjithë njerëzit të mund të lëvizin pa pasur frikën e kërcënimit të jetës apo të shëndetit.

- Mundësia e edukimit-mjediset e shkollave publike apo private të projektohen në mënyrë të tillë që të mundësojnë pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve në kontekste të integruara.

- Mundësia e punës-vendet e punës, zyrat dhe mjediset industriale së bashku duhet të projektohen për të lejuar pjesëmarrjen dhe kontributin e PAK.

### 1.2 Kërkesat e projektimit

Këto norma janë të domosdoshme, sepse pengesat janë të pranishme kudo. Disnivelet në sipërfaqe, bordurat e ndryshme, gjerësitë e dyerve dhe tualetet e papërshtatura, mund të përbëjnë barriera të pakapërcyeshme. Problemi është të merret parasysh se si një përdorues i një karrigeje me rrota do të lëvizë lirisht nga parkimi deri tek pjesa më e largët e një ndërtese, pa pengesë. Kjo nuk do të ishte e kushtueshme, nëse nevojat e personave me aftësi të kufizuar do të merreshin parasysh që në fazat e hershme të projektimit.

Nga projektimi i kujdesshëm për personat me aftësi të kufizuar do të përfitojnë të gjithë përdoruesit e ndërtesës.

Të gjitha ndërtesat, përveç kushteve për banim, edukim e punësim, duhet të sigurojnë përshtatshmëri për personat me aftësi të kufizuar.

### 1.3 Shenjat dhe informacioni

Në ndërtesat, kryesisht publike, vendosen shenjat për të indentifikuar:

- Hyrjet e përshtatura në ndërtesa;
- Ashensorët e përshtatur;
- Tualetet e përshtatura;
- Vendet e rezervuara për aftësinë e kufizuar;
- Ofrimin e një shërbimi special në ndërtesa.



Fig.1

#### 1.4 Dimensioni

Duke pasur parasysh përdorimin e karrigeve me rrota nga PAK në mjedisin ndërtimor duhet të parashikohen hapësira të nevojshme për manovrimin e tyre. Kjo hapësirë do të lejojë edhe përdorimin prej këtyre personave edhe të mjeteve të tjera ndihmëse mekanike ose të një asistenti. Në fig.2 dhe 3 jepen dimensionet e karrigeve me rrota dhe hapësirat që mund të arrihen për veprim nga vetë personat që shfrytëzojnë mjetet.




Fig.2




Fig.3

## II. NORMAT DHE HOLLËSITË NDËRTIMORE

Projektimi i ndërtimeve

Projektimi konsiston në përshtatshmërinë mbi bazën:

- e përdorimit të elementeve të përshtatshmërisë (rampa, parmakë, korimano etj.);
- e përshtatjes së ambienteve (tualetteve, ambienteve të gatimit etj.).

### II.1 Parkimi

Kërkohet që të ketë hapësira të veçanta parkimi të rezervuar për personat që kufizohen në përdorimin e karrigeve me rrota dhe mjeteve të tjera ndihmëse, sa më afër çdo hyrje, distanca max.50 m, në mënyrë që përdoruesi të lëvizë pa vështirësi. Duhet të merren masa, në zonat e parkimeve të hapura për mbulimin e hapësirës së parkingut të rezervuar për PAK, për t'i mbrojtur nga dielli dhe shiu.




Fig. 4

## II.2 Hyrjet

Për përdoruesit e karrigeve me rrota rëndësi të veçantë ka përshtatshmëria e hyrjes kryesore të ndërtesës. Disniveleli i krijuar zakonisht nga kuota e sistemuar e tokës natyrale dhe kuotës së dyshemesë në hyrje të ndërtesës duhet të shmangët për t'u shfrytëzuar edhe nga PAK. Hyrja (ose të paktën njëra hyrje në ndërtesat me shumë hyrje) duhet të jetë e projektuar e shoqëruar, krahas shkallëve, edhe me një rampë të pjerrët me parrmakë në të dy krahët. Duhet të shmangen pragjet e dyerve më të larta se 20 mm. Ngjyra e pragjeve duhet të jetë në kontrast me dyshemenë. Për të lehtësuar identifikimin e hyrjeve për personat me shikim të dëmtuar, dera ose korniza e derës duhet të lyhet me një ngjyrë në kontrast me murin rrethues.





Fig.5



### II.3 Rampat e pjerrëta – panduset

Rampat janë elemente të domosdoshme që shoqërojnë shkallët në hyrje të ndërtesave, si dhe në disnivelet brenda një kati.

Pjerrësia e rampave më e preferueshme është 1:20. Pjerrësia max. nuk duhet të kalojë 1:12. Vetëm në rikonstruksionet, ku shpesh herë zgjidhjet kushtëzohen nga hapësira e kufizuar, mund të pranohet një pjerrësi edhe prej 1:8, bile edhe 1:6 si një zgjidhje më e mirë sesa mungesa e rampit.

Panduset nuk duhet të kalojnë gjatësinë max. 6.0 m kur ka një pjerrësi 1:12. Kur ka rampa me të gjata ato duhet të shoqërohen me një shesh pushimi me gjatësi 1.3 m. Rampat e pjerrëta duhet të pajisen me buzë me lartësi 50 mm në anët e lira.




Fig. 7




fig.8

#### II.4 Shkallët

Shkallët shpesh janë i vetmi mjet për të lëvizur ndërmjet kateve. Pra është e rëndësishme që shkallët të projektohen në mënyrë të tillë që lejojnë përdorimin nga personat me aftësi të kufizuara. Numri maksimal i bazamakëve të shkallës për një palë shkallë duhet të kufizohet në 12. Kur nevojiten shkallë më të gjata duhet të përdoret një shesh pushim me gjatësi 1500 mm.

Projektimi i bazamakëve me buzë dhe boshllëk duhet të shmanget me qëllim që të minimizohet risku i pengimit.

Sipërfaqet e bazamakëve duhet të jenë prej një materiali jo të rrëshqitshëm dhe tapetet duhet të jenë të fiksuara mirë.

Për të ndihmuar personin me shikim të dëmtuar, duhet të vendoset një kontrast në ngjyrë midis shesh pushimeve, fillimit dhe fundit të shkallëve. Për më tepër edhe pamja ballore e çdo bazamaku duhet të jetë më e spikatur.




Fig.9

## II.5 Parmakët

Parmakët duhet të jenë gjithmonë të vendosur në të dy anët e çdo shkalle. Për të lehtësuar përdorimin e tyre nga PAK, parmakët duhet të jenë të vazhdueshëm.




Fig.10

### Parmakët mbështetës- korimanot

Për të ndihmuar njerëzit gjatë lëvizjes, korimanot duhet të vendosen kudo.

Një korimano duhet të jetë i lehtë për t'u kapur dhe preferohet të ketë një prerje tërthore me diametër afërsisht 40 mm.

Korimanot duhet të jenë të fiksuar mirë, fundi i tyre duhet të kthehet në drejtim të mureve në të dy skajet e shkallëve jo më pak se 300 mm dhe jo të dalë jashtë në hapësirë të lirë.

Korimanot horizontale duhet të montohen në lartësinë 900 mm mbi dysheme për përdoruesit PAK të përkohshëm dhe 700 mm mbi dysheme për përdoruesit e karrigeve me rrota.



fig.11





Fig.12

## II.6 Ashensorët

Ashensorët janë shpesh e vetmja mënyrë për shumë njerëz që të arrijnë vetë katet e ndryshme të një ndërtese, përveç katit përdhe. Ky akses ka rëndësi të veçantë për personat me aftësi të kufizuar dhe është i nevojshëm për PAK që të punësohen.

Ashensorët duhet të vendosen, pranë hyrjes kryesore të ndërtesës dhe të jenë të dukshëm.

Pajisja e ashensorit, jo gropa, duhet të jetë e mjaftueshme për përdoruesit e karrigeve me rrota, me përmasa minimale 1000 x 1300 mm dhe dyert jo më të ngushta se 800 mm. Përrreth kabinës vendoset korimanua me lartësi 800-900 mm.

Shenjat dhe kontrollet e ashensorit duhet të vendosen në mënyrë që të jenë të lehta për t'u përdorur. Ato duhet gjithashtu të jenë të kompletuara edhe me shkrimin brail për të verbërit.

## Ashensoret




fig.13




fig.14

### II.7 Hollet

Hollet duhet të dimensionohen me hapësira të mjaftueshme për përdorim nga personat me aftësi të kufizuar.

Në hyrjet e paraholleve të ndërtesave publike me një gjerësi 1800 mm kërkohet një gjatësi minimale 2300 mm. Në këto ndërtesa preferohen dyer automatike dyshe.




fig. 15





Fig.16

koridore te pershtatshme per perdoruesit e karrikeve me rrota



## II.8 Dyert


Projekti i dyerve dhe i hapësirës që i shoqëron ato përcaktojnë nëse një dhomë është e përshtatur për përdoruesit e karrigeve me rrota dhe të tjerët me lëvizje të dëmtuar. Gjerësia e derës, për përdoruesit e karrigeve me rrota duhet të jetë 900 mm, por jo më e vogël se 800 mm.

Pragjet duhet të shmangen kudo që të jetë e mundur ose të jetë një lartësi max. 20 mm. Një prag prej gome do të ishte më i përshtatshëm.

Dorezat duhet të jenë të lehta për t'i përdorur. Ato montohen afërsisht 800-900 mm mbi nivelin e dyshemesë. Një derë që mbyllet me anë të sustës duhet të pajiset me një dorezë tërheqëse që kapet lehtë nga PAK me gjatësi të paktën 300 mm.

Xhami ose dyert e xhamta duhet të shënohen me një shirit ose vizë me ngjyrë pak poshtë nivelin të shikimit.

Sidoqoftë edhe pse të shënuara dhe të mbrojtura, dyert e xhamta dhe vetratat duhet të shmangen në ndërtesat që frekuentohen nga persona me dëmtim të shikimit.



## II.9 Dritaret

Vendi dhe lartësia përkatëse e dritares janë të rëndësishme në mënyrë që përdoruesit e karrigeve me rrota të mund të shikojnë përtej dhe të hapin dritaret. Doretat të hapen dhe të mbyllen lehtë. Dritaret duhet të vendosen në mënyrë që të eliminojnë verbimin për personat me dëmtim të shikimit.

## Dritaret




Fig 21

### II.10 Tualetet

Preferohen tualetet unisex. Kjo lejon të përdoren tualetet e përshtatura nga secili sex. Aty ku ka tualete publike duhet të ketë të paktën një tualet unisex.

Të gjitha pajisjet duhet të jenë të mundshme për t'u përdorur nga personat me aftësi të kufizuar. Dyert kur hapen nga brenda duhet lënë një hapësirë e mjaftueshme 1100x700 për hapjen e derës. Të gjitha dyert duhet të jenë të hapshme edhe nga jashtë në rast urgjencash.

Kur është e mundur, preferohet të parashikohet nga njëra anë e ëc-së një hapësirë për një përdorues të karriges me rrota për të lehtësuar komandimin e lëvizjes së tij. Gjithashtu kërkohet të vendoset parrmak mbështetës i varur (i lëvizshëm) dhe mbështetës (korimano) horizontale.





Fig. 22

fig.23

### Tualete ambulante

Tek këto tualete dyert hapen nga jashtë ose janë rrëshkitëse. Këto tualete nuk janë të përshtatshme për përdoruesit e karrigeve me rrota.



### II.11 Ambientet e gatimit dhe të ngrënies

Hapësira nën sipërfaqen e përgatitjes për gatim duhet të jetë e lirë. Dimensionet e tryezës së punës duhet të jenë 800x600 mm me një lartësi 750-850 mm mbi nivelin e dyshemesë, në varësi të tipit të karriges me rrota që përdoret. Një karrige me rrotë kërkon një hapësirë të lirë të paktën 750 mm të gjerë të një tavoline buke dhe të paktën 500 mm të thellë nën të. Duhet të sigurohen edhe lehtësira për shmangien e djegies në ambientet e gatimit.




Fig.25




fig.26

## II.12 Pajisjet sanitare

Pajisjet sanitare preferohen të jenë prej porcelani. Kur pajisjet për larjen e duarve janë inoks, duhet të izolohet pjesa nën sipërfaqe për të shmangur djegiet.

Ndenjëset e ëc-së duhet të jenë solide dhe të fiksuara mirë.

Kur depozita e ëc-së është e montuar në hapësirën e një oxhaku, mbështetësja e mbrapme duhet të sigurohet pas ëc.

Varëset për mjetet ndihmëse të lëvizjes (patericat e bastunet) duhet të parashikohen në lartësinë nga 800 deri në 1040 mm, e ngjashme me varëset e rrobave.

Një pasqyrë dhe një raft janë të dëshirueshëm, gjithashtu edhe kutia mbajtëse e peshqirit prej letre ose edhe tharëset e duarve automatike, kur është e mundur.


## II.13 Banjat me dushe dhe me vaskë

Kur lëvizja për tek stoli i lëvizshëm (i vendosur në mur) tek ambienti i dushit është i kufizuar, atëherë dimensionet e kabinës së dushit duhet të rriten deri në 1600 mm në drejtim nga dera tek muri përballë saj dhe 1400 mm në drejtimin tjetër, për të mundësuar përdorimin e stolit të lëvizshëm të dushit.

Perdja e lëvizshme duhet të zbrësë deri në nivelin e dyshemesë dhe të jetë brenda kabinës së dushit.

Koka e dushit duhet të ketë mundësi fiksimi në lartësi të ndryshme, me mundësi lëvizjeje dhe tub fleksibël.


Vaskat duhet të kenë mishelator, me kokë dushi të lëvizshme me tub fleksibël.





## II.14 Kontrollët elektrike dhe sanitare

Vendndodhja dhe projekti i të gjithë çelësave dhe pajisjeve të kontrollit është veçanërisht i rëndësishëm për personat me lëvizshmëri dhe shikim të dëmtuar. Ato duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të arrihen dhe të përdoren lehtësisht nga PAK. Çelësat dhe pajisjet e kontrollit duhet të jenë të mëdha. Ato duhet të plotësohen edhe me shkrimin brail për t'u përdorur nga personat me dëmtim të shikimit. Gjithashtu rekomandohet të përdoren tregues me zë, llampa alarmi fleshuese, alarme vibruese, portative etj.



## II.15 Auditorët, qendrat e fesë, ambientet e konferencave, stadiumet

Në projektimet e tyre, dimensionet e pozicioneve të caktuara për përdoruesit e karrigeve me rrota në këto hapësira nuk duhet të jenë më pak se 900 x 1400 mm. Hapësirat duhet të jenë të tilla që të lejojnë përdoruesit e karrigeve me rrota të qëndrojnë së bashku me shoqëruesit.

II.16 Kushtet e përshtatshmërisë për personat me dëmtime të ndjeshmërisë.

Për persona me dëmtim të dëgjimit – në sallat me sipërfaqe më të madhe se 100 m<sup>2</sup> duhet të instalohen nyjet induktive ose sistem me rreze infra të kuqe. Këto duhet të jenë edhe në ambiente shërbimi kur personi me dëmtim të dëgjimit komunikon me personelin nëpërmjet sipërfaqeve të qelqit.

Llampa alarm fleshuese duhet të vendosen në ambiente publike.

Alarmer vibruese portative duhet të vendosen në dhoma hotelesh.

Për persona me dëmtime dëgjimi dhe shikimi - Hapësirat e mirëndriçuar janë të rëndësishme për të lexuar buzët dhe për të ndihmuar personat me dëmtim të pjesshëm të shikimit.

Për personat me dëmtim të shikimit – Të përdoren kontrastet e ngjyrave, sipërfaqet e prekshme të ashpra, tregues me zë, të eliminohen barrierat e panevojshme.

II.17 Sipërfaqet e dyshemeve dhe të mureve

Të brendshme dhe të jashtme

Të shmangen rrezatimet verbuese nga sipërfaqet e tavaneve, mureve e dyshemeve.

Zbukurimet e dyshemeve nuk duhet të jenë të ndërlikuara të shmangen tapetet me push të thellë.

Dyshemetë e mbaruara nuk duhet të jenë të rrëshkitshme sidomos në pjesët e hyrjeve.

Të shmangen ndryshimet e paparashikueshme të menjëhershme të nivelit.

Të sinjalizohen me drita, ngjyra ose strukturë të ndryshme, në nivele, tavanet e ulëta.

Të shmangen thyerjet në mure, vendosje radiatorësh e pajisjesh në korridore kur është e mundur.

## VI. SIMBOLET URBANISTIKE

Për të lehtësuar leximin dhe kuptimin e studimeve urbanistike përdoren:

1. simbolet që janë kompleksi i shenjave me të cilat paraqiten ndërtimet, kufijtë fizikë, qendrat e banuara, rrugët, kanalet etj.;

2. kuotat;

3. legjenda;

4. zonifikimi.

### 1. SIMBOLET

Simbolet brenda rrethit tregojnë pronë private.

Simbolet brenda katrorit tregojnë pronë publike.

Simbolet brenda trekëndëshit tregojnë pronë ushtarake.

A. OBJEKTE TË ARSIMIT E KULTURËS:

Kopësht



Shkollë 8 vjeçare



Shkollë e mesme



Shkollë e mesme profesionale



Universitet



Bibliotekë



Muze



Arkeologji



Teatër




Kinema



B. OBJEKTE TË KULTIT:


Kishë



Xhami



Institucion fetar




Manastir



C. VARREZA:

Varrezë



D. OBJEKTE TË SHPLODHJES:

Lodra për fëmijë



Park argëtimi



Pikë shplohje




Kopësht zoologjik



E. OBJEKTE SHËNDETËSORE:

Urgjencë



Ambulancë



Spital



Senatorium



Shtëpi pushimi



Farmaci



F. SHËRBIME PUBLIKE:


Bar



Birrari



Restorant



Pension



Hotel



G.OBJEKTE TREGTARE:

Dyqan



Supermarket



Magazinë



H.OBJEKTE PUBLIKE:

Postë-telegraf



Telefon



Bankë



Zyra administrative



Bashki



Radio Televizion





I.OBJEKTE SPORTIVE:







































Palestër		
Qendër sportive		
Pallat sporti		
Stadium		
Hipodrom		
Fushë patinazhi		
Fushë tenisi		
Fushë golfi		
Poligon qitje		
Fushë për ski		
Pishinë		
Sporte ujore		
Gjueti		
Gjueti e ndaluar		
Peshkim		
Peshkim i ndaluar		

J. SHËRBIME TRANSPORTI:

Pikë karburanti		
Taksi		
Vendqëndrim makinash		
Parkim		
Stacion autobusi		
Stacion hekurudhor		

Teleferik		
Aeroport civil		
Fushë helikopteri		
Port detar		
Port mallrash		

**K. TREGTI, ARTIZANAT, INDUSTRI:**

Tregti		
Artizanat		
Industri		
Industri veshmbathje		
Industri ushqimore		
Industri letre		
Industri kimike		
Industri qeramike		
Industri lëkure		
Industri ndërtimi		
Industri elektronike		
Industri gome		
Industri druri		
Industri mermeri		
Industri metal-mekanike		
Industri mineralesh		
Kantjer anijesh		
Industri peshkimi		
Industri plastike		

Industri tekstile



Industri qelqi



Kantinë



Industri e lehtë



Industri e mesme



Industri e rëndë



L. BURGJE:

Burg



M. SHËRBIME SHETËRORE USHTARAKE:

Rend publik



Polici rrugore



Polici financiare



Pikë kalimi kufitare



Roje pyjesh



Doganë



Zjarrfikës



Kazermë



Aeroport ushtarak



Port ushtarak




N. SIMBOLE TË PËRDORURA NË STUDIMET URBANISTIKE  
PJESORE DHE PLANIMETRITË E SHESHIT TË NDËRTIMIT:

Ndërtesë e projektuar



Ndërtesë ekzistuese



Ndërtesë që rindërtohet



Ndërtim në perspektivë



Kufizim i sheshit


Kolonadë

Shesh i hapur depozitimi

Ndërtim që prishet

Ndërtim nën tokë

Kalim nën ndërtesë



O. KUFINJTË:

Kufiri i prefekturës

Kufiri i rrethit


Kufiri i komunës

Kufiri i bashkisë

Kufiri shtetëror

Kufiri i zonës nën ruajtje (zonë me prioritet turistik etj)

Pemë të mbjella në rresht



P.QENDRAT E BANUARA:

deri 10 000 banorë

nga 10 000 - 20 000 banorë


nga 20 000 - 50 000 banorë

nga 50 000 - 100 000 banorë

nga 100 000 - 200 000 banorë

mbi 200 000 banorë

qendër e re



























Q. KANALIZIM:

Ujësjellës i nëndheshëm


Ujësjellës në viadukt





Gaz sjellës	
Ujra të bardha	
Ujra të zeza	
Impiant pastrimi i ujrave të zeza	
<b>R. RRUGË:</b>	
Autostradë	
Nyje autostrade	
Tunel autostrade	
Urë autostrade	
Rrugë kat.I	
Tunel për rrugë kat.I	
Urë për rrugë kat.I	
Rrugë e kat.II	
Tunel për rrugë të kat.II	
Urë për rrugë të kat.II	
Rrugë të kat.III-IV	
Tunel për rrugë të kat.III-IV	
Urë për rrugë të kat.III-IV	
Hekurudhë	
Nyje hekurudhore	
Tunel hekurudhor	
Urë hekurudhore	
Hekurudhë në trashe	
Hekurudhë në argjinaturë	
Teleferik	

Metro



Metro në transhe

Metro në viadukt



## 2. KUOTAT:

Kuotë altimetrike

▼ 0.00

Kuotë topografike

▼ 5.00

Kuotë e sistemimit

0.0

0.2

0.4



## 3. LEGJENDA

Legjenda përbëhet nga emërtime, simbole e shenja urbanistike dhe kompletton fletët e projekteve të studimeve urbanistike

## 4. ZONIFIKIMI (PËR ZONAT KRYESORE)

### a. zona të gjelbërta:

Gjelbërim publik



Gjelbërim privat



Gjelbërim në ruajtje



Park



Gjelbërim në rritje



Zonë agrikulturore



Pyll



Zonë gjahu




### b. Objekte shoqërore:

Objekte shoqërore



Zonë sportive



Zonë turistike hotelerie




Zonë spitalësh



Zonë transporti



Zonë hekurudhore



Zonë portesh



Zonë ushtarake



**c. Zonë banimi:**

Zonë banimi



Bërthamë e re urbane



Njësi të reja banimi me dendësi të ulët



Njësi të reja banimi me dendësi mesatare



Njësi të reja banimi me dendësi të lartë



Zonë rinovimi



Zonë mikse banimi dhe artizanati



Zonë banimi muze



Zonë banimi në ruajtje



Zonë në prishje



**d. Zona industriale:**

Zonë industriale



Zonë artizanati dhe industri e imët



Zonë e industrisë së lehtë



Zonë e industrisë së rëndë



Ndotje e lehtë



Ndotje e rëndë



**VENDIM**  
**Nr.358, datë 27.5.2001**

**PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE PËR NDËRTIMIN DHE PËRDORIMIN E INSTALIMEVE BREGDETARE PËR TRANSPORTIMIN DHE DEPOZITIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr.8450, datë 24.5.1999 “Për përpunimin, transportimin, tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të nenit 9 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të nenit 3 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të nenit 6 të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore” dhe të nenit 3 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Instalimet bregdetare të transportimit dhe të depozitimit të naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre përfshijnë rezervuarët e magazinimit (stokimit) të produkteve dhe pajisjet përkatëse të trajtimit të tyre si dhe infrastrukturën portuale detare (bovat, platformat, linjat, tubacionet, etj), së bashku me pajisjet që shërbejnë për transportimin e produkteve nga anijet për në depozitat ose anasjelltas (pontili).

2. Ndërtimi dhe përdorimi i instalimeve të reja bregdetare për transportimin, depozitimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, bëhet me leje koncensionit të Këshillit të Ministrave, pasi shoqëria kërkuese për të ushtruar këtë veprimtari të ketë plotësuar paraprakisht dokumentacionin e përcaktuar në këtë vendim.

3. Infrastruktura portuale detare e ngarkim-shkarkimit dhe e transportimit të naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, deri në lidhjen tokësore, me depozitat e magazinimit të këtyre produkteve, pavarësisht se cili është investitori për ndërtimin e saj, mbetet pronë e shtetit dhe përdorimi i saj nga subjektet e interesuara bëhet kundrejt qirasë. Procedura për administrimin e infrastrukturës portuale detare, kryhet në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Kriteret dhe vlera e qirasë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Administrimi i zonës portuale dhe i veprimtarisë në instalimet bregdetare të transportimit dhe të depozitimit të naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, në zbatim të legjislacionit fiskal, të legjislacionit portual, të legjislacionit për mbrotjen nga zjarri dhe mbrojtjen e mjedisit kryhet nga organi përkatës, në varësi të ministrisë përgjegjëse për transportit detar.

5. Shoqëritë që kërkojnë të ndërtojnë instalime të reja bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, së bashku me infrastrukturën portuale të ngarkim-shkarkimit për këto produkte, do të përdorin sipërfaqe ndërtimi në zonat e përcaktuara sipas vendimit nr.251, datë 20.4.2001 të Këshillit të Ministrave.

6. Instituti i Naftës dhe Gazit, si institucion i specializuar ose specialistë të licencuar në fushën e teknologjisë së instalimeve të impianteve dhe të depozitave bregdetare, bëjnë vlerësimin kundrejt një tarife të përcaktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për hidrokarburet, si dhe japin miratimin për projektin teknologjik për depozitimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, përfshirë edhe infrastrukturën portuale të ngarkim-shkarkimit për këto produkte.

7. Shoqëria që kërkon të ndërtojë instalime bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, duhet të ketë kërkesën, të shoqëruar edhe me këto dokumente:

- vendimin e gjykatës për regjistrimin e personit juridik;
- certifikatën e regjistrimit në zyrën e tatimeve dhe dokumentin e NIPT-it;
- studimin urbanistik për shesh ndërtimi dhe projekti ndërtimor, së bashku me vendimet e KRT-së përkatës, për miratimin e sheshit dhe të lejes së ndërtimit, në përputhje me ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, projektin teknologjik të instalimeve bregdetare për transportimin

dhe depozitimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre (rezervuarët e magazinimit të produkteve dhe pajisjet përkatëse të trajtimit të tyre, infrastrukturën portuale detare (bovat, platformat, linjat, tubacionet etj.), së bashku me pajisjet që shërbejnë për transportimin e produkteve nga anijet për në depozita ose anasjelltas (pontili), të miratuar nga specialisti i licencuar në fushën e teknologjisë së instalimeve të naftës dhe të gazit, Këshilli i Rregullimit të Territorit në njësitë e qeverisjes vendore ku ndodhet zona e ndërtimit, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe nga Drejtoria MNZ-së;

- licencën e drejtuesit teknik të realizimit të projektit të instalimit bregdetar dhe të vënies së tij në përdorim;

- vërtetimin bankar se shoqëria në çastin e depozitimit të kërkesës ka një kapital minimal prej jo më pak se 300 000 000 (treqind milionë) lekësh.

Kapaciteti i stacionit të depozitave duhet të plotësojë këto kushte:

a) Për depozitimin dhe transportimin e naftës bruto e të karburanteve dhe të lëndëve djegëse e të lëngëta:

- kur bëhet për një kategori produkti jo më pak se 10 000 m<sup>3</sup>

- kur bëhet për dy kategori produkti jo më pak se 15 000 m<sup>3</sup>

- kur bëhet për më shumë de dy kategori produkti jo më pak se 20 000 m<sup>3</sup>

Në të gjitha rastet, sasia maksimale e kapacitetit depozitues për një subjekt, pavarësisht nga numri i produkteve që do të transportojë dhe depozitojë, nuk duhet t'i kalojë 40 000 m<sup>3</sup>.

- kapaciteti magazinues i një depozite nuk mund të jetë më i vogël se 2 000 m<sup>3</sup>.

b) Për depozitimin dhe transportimin e hazit të lëngshëm:

- kur bëhet për një kategori produkti (propan, butan etj) jo më pak se 1 000 m<sup>3</sup>

- kur bëhet për më shumë se një kategori produkti jo më pak se 2 000 m<sup>3</sup>

Në të gjitha rastet, sasia maksimale e kapacitetit depozitues për një subjekt, pavarësisht nga numri i produkteve që do të transportojë dhe do të depozitojë nuk duhet t'i kalojë 4 000 m<sup>3</sup>.

8. a) Shoqëria që ndërton dhe/ose shfrytëzon instalimet e reja bregdetare të transportimit dhe depozitimit të naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre paraqet kërkesën e shoqëruar me projektet dhe me dokumentacionin përkatës, të plotësuar sipas pikës 7 të këtij vendimi, në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, e cila, pas verifikimit, i përcjell ato në Këshillin e Rregullimit të Territorit në Republikën e Shqipërisë.

Këshilli i Rregullimit të Territorit në Republikën e Shqipërisë dhe Këshilli Kombëtar i Ujërave, pas shqyrtimit të projektit dhe të dokumentacionit shoqëruar, bëjnë miratimin e sheshit të ndërtimit dhe të lejes së ndërtimit për pjesën tokësore dhe detare të instalimeve bregdetare, duke dhënë njëkohësisht edhe lejen për përdorimin e tokës.

Dokumentacioni i paraqitet Këshillit të Ministrave për dhënien e lejes së koncensionit, afati i së cilës do të jetë deri në 30 vjet, me të drejtë përsëritjeje.

b) Leja e koncensionit duhet të përmbajë:

- numrin dhe datën e vendimit të Këshillit të Ministrave, nëpërmjet të cilit është bërë miratimi i lejes së koncensionit;

- numrin dhe datën e vendimit të Këshillit të Rregullimit të Territorit në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet të cilit është bërë miratimi i kërkesës së shoqërisë për ndërtimin e instalimit bregdetar;

- emrin dhe selinë e shoqërisë që merr lejen e koncensionit, si dhe vendndodhjen e instalimeve bregdetare për të cilat jepet leja;

- llojin e lejes së tregtimit dhe afatin e saj, nëse shoqëria që do të ndërtojë dhe do të përdorë instalimet e reja bregdetare është e pajisur me leje tregtimi;

- afatin e vlefshmërisë së lejes së koncensionit dhe të drejtën për përsëritje;

- të drejtën e shoqërisë për transferimin e teknologjisë;

- afatin e përfundimit të ndërtimit të instalimit bregdetar dhe fillimin e vënies së tij në përdorim;

- të drejtën e shoqërisë të pajisur me leje koncensionit për të kërkuar shtyrjen e afatit të përfundimit të ndërtimit ose të vënies në përdorim të instalimit bregdetar, në rast të vendosjes së forcës madhore;

- të drejtën e organeve dhe të institucioneve shtetërore të ngarkuara me ligj për kontrollin e zbatimit të projektit nga shoqëria e pajisur me leje koncensionit, në cilësinë dhe afatin e përcaktuar në projekt;

- të drejtën e Këshillit të Ministrave për shfuqizimin e kësaj lejeje koncensionit, kur në kontrollet e ushtruara nga oragnet dhe institucionet shtetërore të ngarkuara me ligj janë vërejtur shkelje ose mosrespektime të detyrimeve themelore, sipas përcaktimeve në lejen e koncensionit;

- kategorinë e produktit të cilin do të depozitohet dhe transportohet shoqëria;

- llojin e detyrimeve financiare që do të ketë shoqëria ndaj shtetit dhe formën e pagimit të tyre;

- llojin dhe afatin e të dhënave që duhet të dërgojë shoqëria në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, në zbatim të urdhrin të ministrit përkatës.

c) Dokumenti i lejes së koncensionit përgatitet nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet, pasi për të të kenë dhënë mendim Ministria e Financave dhe ministria përgjegjëse për transportin detar. Ky dokument i bashkëlidhet vendimit të Këshillit të Ministrave që miraton lejen e koncensionit.

Leja e koncensionit hartohet në katër kopje, nga të cilat një kopje i dorëzohet zyrtarisht shoqërisë së cilës i jepet leja e koncensionit dhe nga një kopje arkivohet përkatësisht: në Këshillin e Ministrave, në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet dhe në ministrinë përgjegjëse për transportin detar.

9. Subjektet, të cilët janë në marrëdhënie kontraktuale me shtetin për depozitat në Portin e Durrësit, do të kenë përparësi në kërkesën që mund të bëjnë për ndërtimin e impianteve dhe të depozitave bregdetare në sipërfaqet e miratuara sipas vendimit nr.251, datë 20.4.2001 të Këshillit të Ministrave.

10. Për vënien në përdorim të instalimeve të reja bregdetare, leja bëhet e vlefshme pas verifikimit të zbatimit të projektit nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës dhe Gazit, i cili, pasi vëren se në këto instalime janë zbatuar kushtet dhe normat teknike, sipas legjislacionit në fuqi dhe të parashikuara në projektin e miratuar, jep vërtetimin përkatës, të miratuar nga ministri përgjegjës për hidrokarburet, i cili i bashkëlidhet lejes së koncensionit.

11. Shoqëritë e pajisura me leje koncensionit për ndërtimin dhe përdorimin e instalimeve bregdetare për depozitimin dhe transportimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre janë të detyruara të kenë në përdorim të pandërprerë instalimet e tyre bregdetare.

Këto shoqëri e realizojnë veprimtarinë e tyre për importimin, eksportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, nëpërmjet kontratës me shoqëritë e tregtimit me shumicë, që janë të pajisura me leje tregtimi, sipas dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, për të cilat duhet të garantojnë furnizimin normal me produktet përkatëse.

Një kopje e kësaj kontrate depozitohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Hidrokarbureve, brenda 10 ditëve nga data e lidhjes së saj.

Kryerja e pagesave për ndërtimin dhe përdorimin e instalimeve bregdetare për depozitimin dhe transportimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, shlyerja e detyrimeve të tjera kontraktuale, si dhe çdo detyrim doganor dhe fiskal që lidhet me këto veprimtari bëhet nëpërmjet dokumentacionit bankar.

12. Në rast të mosplotësimit të kërkesave të këtij vendimi nga shoqëria e pajisur me leje koncensionit, ndaj saj zbatohen sanksione në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” dhe të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncensionin dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”.

Ankimi kundër sanksionit të vendosur nga organi përgjegjës shtetëror bëhet në përputhje me kushtet dhe me procedurat e parashikuara në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

13. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Punëve Publike, Ministria e Transportit, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.36, faqe 1119*

**VENDIM**  
**Nr.836, datë 3.12.2004**

**PËR PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT  
TË RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.717, datë 22.11.2005)*

*I përditësuar*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 11 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, si organ vendimmarrës, kryesohet nga Kryeministri dhe ka këtë përbërje:

- |  |                  |
|--|------------------|
| - Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit  | zëvendëskryetar; |
| - Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës  | anëtar;          |
| - Ministri i Drejtësisë  | anëtar;          |
| - Ministri i Brendshëm   | anëtar;          |
| - Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit   | anëtar;          |
| - Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve   | anëtar;          |
| - Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave   | anëtar;          |
| - Një përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes  | anëtar;          |
| - Një përfaqësues nga Akademia e Shkencave   | anëtar;          |
| - Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, | sekretar.        |

2. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë përcaktohet në rregulloren që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Anëtarët e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë shpërblehen, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, me 20 000 (njëzet mijë) lekë.

4. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë të përballohet nga buxhetet e miratuara për çdo institucion përkatës që ata përfaqësojnë.

5. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.627, datë 24.12.1997 “Për krijimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nr.417, datë 3.9.1999 “Për shpërblimin e punës së anëtarëve të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohen

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

*Vendimi nr.836, datë 3.12.2004 botuar në Fletoren Zyrtare nr.101, faqe 6765*

*Vendimi nr.717, datë 22.11.2005 botuar në Fletoren Zyrtare nr.88, faqe 2846*

**RREGULLORE**  
**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË RREGULLIMIT**  
**TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Neni 1  
**Objekti**

Kjo rregullore përcakton organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRRTRSH).

Neni 2  
**Organizimi i KRRTRSH-së**

Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRRTRSH) është organ vendimmarrës dhe krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KRRTRSH-ja përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, anëtarët dhe sekretari i KRRTRSH-së.

Neni 3  
**Funksionimi**

KRRTRSH-ja kryesohet nga Kryetari dhe, në mungesë e me porosi të tij, nga zëvendëskryetari i KRRTRSH-së.

Kryetari miraton rendin e ditës të propozuar nga zëvendëskryetari i KRRTRSH-së.

KRRTRSH-ja si rregull mbledhet një herë në muaj. Në rastet kur shihet e arsyeshme, kryetari mund të mbledhë KRRTRSH jashtë rradhe.

Njoftimi për mbledhje të KRRTRSH-së bëhet të paktën pesë ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes.

KRRTRSH-ja i zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij.

Rendi i ditës dhe materiali që do të shqyrtohen në KRRTRSH, u vihet në dispozicion anëtarëve të KRRTRSH-së të paktën pesë ditë para se të bëhet mbledhja.

Rendi i ditës përmban:

- Tematikat që do të trajtohen;
- Datën dhe orën e caktuar për mbledhjen e KRRTRSH-së;
- Materialin e bashkëlidhur për çdo tematikë që do të shqyrtohet në mbledhje.

KRRTRSH-ja për çështjet që trajton, merr vendime me shumicë votash. Në rastet kur numri i votave është ndarë në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit vlen sa dy vota.

Në mbledhjen e KRRTRSH-së, sipas objektit dhe materialit, marrin pjesë pa të drejtë vote kryetari i KRRTR-së së njësisë vendore përkatëse, përfaqësues nga institucione shtetërore të interesuara, autorë të projektit, përfaqësues nga Shoqata e Arkitektëve dhe Shoqata e Ndërtuesve.

KRRTRSH-ja ka vullën e vet.



### Paraqitja e kërkesës dhe dokumentacioni shoqërues

Kërkesa për shqyrtim të materialeve në KRRTRSH, si dhe dokumentacioni përkatës paraqiten zyrtarisht në Sekretarinë Teknike pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, nëpërmjet njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, që ka në juridiksion territorin ku është kryer studimi, pas miratimit nga KRRT-të përkatëse.

Në rastin e investimeve publike, mund të paraqitet edhe nga institucionet shtetërore të interesuara, duke u miratuar më parë nga KRRT-ja e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore.

Kërkesa dhe dokumentacioni përkatës që shoqëron atë, duhet të jetë në përputhje me ligjin nr.8405 datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, me ndryshimet përkatëse dhe vendimin nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për urbanistikën” dhe dispozitave ligjore në fuqi, që kanë lidhje me objektin e shqyrtimit.

Sekretaria teknike ka për detyrë të verifikojë paraprakisht që dokumentacioni i materialit që paraqitet për shqyrtim në KRRTRSH duhet të jetë në origjinal, në katër kopje, i firmosur dhe i vulosur nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore, si dhe projektet të jenë të firmosura nga autorët e tyre, sipas licencave.

Kur studimet janë hartuar nga subjekte të huaja, materiali duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe.

Dokumentacioni i materialit që paraqitet për shqyrtim në KRRTRSH, duhet të përmbajë:

1. Për të gjitha llojet e studimeve dhe shesheve të ndërtimit, të përcaktuara në nenin 9 të ligjit nr.8405, datë 17. 9.1998 “Për urbanistikën” dhe përkufizimeve në nenin 1 të tij;

- Kërkesa për shqyrtim në KRRTRSH të studimit nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore. Për rastin e investimeve publike, kërkesa mund të bëhet edhe nga institucioni i interesuar shtetëror.

- Vendimi i KRRT-së së njësisë përkatëse të qeverisjes vendore për miratimin e studimit, në të cilin të përcaktohet emërtimi i studimit, sipërfaqja e sheshit të ndërtimit, pozicioni i zonës së studiuar.

- Studimi urbanistik i miratuar nga KRRT-ja përkatëse dhe i konfirmuar nga Kryetari i KRRT-së, sipas modelit përkatës në rregulloren për urbanistikën me/i; a) një relief të saktë topografik në shkallën 1:500 ose 1:1000 të territorit të studiuar; b) azhurnuar sipas gjendjes ekzistuese, ku të përcaktohen kufijtë e sheshit të ndërtimit dhe përmasat e tyre, si dhe sipërfaqja e sheshit të ndërtimit; c) skema rajonale e vendosjes së zonës së studiuar, si dhe pozicioni kadastral i saj. Materiali të përmbajë: a) projektidenë e objekteve të parashikuara në studim; b) materiale të tjera grafike që shpjegojnë zgjidhjen teknike; c) të dhënat e treguesit të nevojshëm sipas rregullores për urbanistikën, në varësi të llojit të studimit, si dhe pamje të gjendjes ekzistuese të zonës së marrë në studim.

- Projektidea e rrjetit të infrastrukturës inxhinierike të furnizimit me ujë, energji eiektrike, telefoni, ngrohje, kanalizim, si dhe trajtimit të mbeturinave të ngurta urbane.

- Relacioni teknik mbi studimin, në të cilin të jepen të dhëna lidhur me vendndodhjen e zonës së studiuar, lidhjen e tij me studime të kryera e miratuara më parë konform ligjit, të dhëna mbi zgjidhjen urbanistike, sipërfaqet sipas zonimit funksional, objektet e parashikuara dhe përshkrimi i tyre, të dhëna mbi projektin e infrastrukturës inxhinierike dhe lidhjen e saj me infrastrukturën ekzistuese, të dhëna mbi vërtetësinë e pronësisë nga zyra e regjistrimit të pasurive të Paluajtshme ose të dhëna mbi vërtetimin e lëshuar nga seksioni i kadastrës në lidhje me specifitime kadastrale të parcelës dhe pronësinë e tokës në rast se këto nuk sqarohen nga certifikata e pronësisë.

- Vërtetim nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit mbi kategorinë e tokës sipas bonitetit, mendim nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve, nëse territori është sipërfaqe pyjore.

- Oponenca e Institutit të Studimeve dhe Projektive Urbanistike dhe Ministrisë së Mjedisit për çdo studim.

- Oponenca e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, kur zona e studiuar ndodhet jashtë vijës kufizuese të ndërtimit.

- Oponenca e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, kur materiali që do të shqyrtohet në KRRTRSH ka të bëjë me territore në zona të shpallura monument kulture dhe zonave të mbrojtura rreth tyre.

- Oponenca të institucioneve të tjera, që gjykohet nga drejtoria përkatëse në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit se preken direkt ose indirekt nga projekti.

- Oponenca e Drejtorisë së Zhvillimit të Turizmit në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, kur studimi është në zonë me përparësi zhvillimi të turizmit.

2. Për të gjitha materialet, në zbatim të nenit 10 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” dhe nenit 6 të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”:

- Kërkesa për shqyrtim në KRRTRSH të materialit nga Policia e Ndërtimit ose këshilli i zgjedhur i njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, ose prefekturave përkatëse;

- Argumentimi teknik dhe ligjor për shqyrtimin e kërkesës për shfuqizim të vendimeve të marra nga KRRT-ja e njësisë vendore përkatëse. Dokumentacioni i miratimit të bërë nga KRRT-ja e kësaj njësie.

#### Neni 5

#### **Sekretaria teknike e KRRTRSH-së**

Sekretaria teknike e KRRTRSH-së është organ teknik këshillimor, e cila është krijuar në zbatim të nenit 11 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” dhe funksion në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, pranë Drejtorisë së Planifikimit të Territorit.

Kryetari i sekretarisë teknike të KRRTRSH-së është Zëvendësministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

Sekretaria teknike e KRRTRSH-së shqyrton paraprakisht materialet e paraqitura për miratim në KRRTRSH, duke i rekomanduar KRRTRSH-së mendimin teknik nëpërmjet konkluzioneve të saj për secilin material të paraqitur.

#### Neni 6

#### **Sekretari i KRRTRSH-së**

Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit është Sekretar i KRRTRSH dhe ka për detyrë:

Të koordinojë dhe të verifikojë nëse materialet e paraqitura për shqyrtim në KRRTRSH janë konform ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, vendimit nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së urbanistikës” dhe të dispozitave ligjore në fuqi që kanë lidhje me objektin e shqyrtimit. Nëse nuk janë në përputhje me kërkesat e dispozitave të kërkuara, i kthen ato për plotësim.

- Të koordinojë dhe kontrollojë procedurën administrative sipas kësaj rregulloreje dhe Kodit të Procedurave Administrative për materialet që do të shqyrtohen në KRRTRSH, para dhe pas vënies në dispozicion nga sekretaria teknike e KRRTRSH-së.

- Pas mbledhjes së KRRTRSH-së, përgatit vendimet e KRRTRSH-së për materialet e shqyrtuara e miratuara në KRRTRSH-ja dhe ndjek e koordinon zbatimin e vendimeve të marra.

#### Neni 7

#### **Vendimmarrja**

KRRTRSH-ja shqyrton materialet e paraqitura, jo më vonë se një muaj nga shqyrtimi i tyre në sekretarinë teknike të KRRTRSH-së.

KRRTRSH-ja merr vendime për miratimin e studimeve në zbatim të nenit 9 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998, merr vendime në zbatim të nenit 10 të po këtij ligji dhe vendos për njoftimet e bëra nga Policia e Ndërtimit në zbatim të nenit 6 të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”.

Në përfundim të çdo tematike, KRRTRSH-ja vendos:

- miratimin e materialit të paraqitur;
- miratimin me vërejtje për përmirësim;
- shtyrje për shqyrtim në mbledhjen më të afërt;
- mosmiratimin.

Kur KRRTRSH-ja e shtyn çështjen për shqyrtim, me qëllim pasqyrimin e vërejtjeve dhe sugjerimeve të bëra në mbledhje, njësia vendore përkatëse, së bashku me subjektin e interesuar, brenda 15 ditëve, reflektojnë vërejtjet dhe i paraqesin sipas konkluzioneve të arritura nga KRRTRSH-ja.

#### Neni 8

#### **Arkivimi i materialit të shqyrtuar në KRRTRSH**

Pas konfirmimit nga Kryetari i KRRTRSH-së, studimet shpërndahen në një kopje në institucionet dhe organet shtetërore, që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e tyre, si më poshtë:

- Në Arkivin e Këshillit të Ministrave;
- Në Arkivin e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit;

Këtu arkivohet edhe gjithë dokumentacioni i materialit të paraqitur për shqyrtim në KRRTRSH;

- Në Sektorin e KRRTRSH-së;
- Në Institutin e Studimeve dhe Projektive Urbanistike;
- Në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, për rastin e studimeve urbanistike, dhe shesheve të ndërtimit;
- Në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, për rastin e studimeve urbanistike e shesheve të ndërtimit në territore jashtë vijave kufizuese të ndërtimit;
- Në Drejtorinë e Zhvillimit të Turizmit në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, për rastin e studimeve urbanistike dhe shesheve të ndërtimit në zonat me përparësi zhvillimi të turizmit;
- Në njësitë përkatëse të qeverisjes vendore;
- Investitorit ose institucionit shtetëror të interesuar.

### UDHËZIM

**Nr.1, datë 24.1.2001**

#### **PËR FUNKSIONIMIN E KRRT-ve**

Mbështetur në nenin 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe deri në përcaktimin me ligj të një zgjidhjeje tjetër,

#### UDHËZOJ:

1. Të funksionojnë KRRT-të e ngritura në 13 bashkitë sipas përcaktimit të bërë në nenin 15 të ligjit “Për Urbanistikën”.
2. Në çdo bashki e komunë, ku aktualisht nuk ka zyrë apo seksion urbanistike, të përmirësohet struktura organizative për të mundësuar zbatimin e detyrave që rrjedhin nga ligjet e sipërpërmendura.
3. Në çdo rreth të funksionojnë KRR-të nën drejtimin e prefektit, në përputhje me nenin 75 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Anëtarë të KRRT-së janë personat e përmendur në nenin 18 të ligjit të urbanistikës, që i gëzojnë atributet e cituara në atë nen.
4. KRRT-ja në rreth funksionon në përputhje me nenin 21 të ligjit të urbanistikës me përjashtim të kompetencës për miratimin e shesheve dhe lejeve të ndërtimit e cila sipas ligjit nr.8652, nga 1 janari 2001 i kalon komunave dhe bashkive.

5. Kuptimi i nenit 72 pika 5/1 “c” e ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, deri në një zgjidhje tjetër ligjore do të jetë: Këshillat e komunave dhe bashkive janë plotësisht përgjegjëse për miratimin e shesheve dhe lejeve të ndërtimit vetëm në kushtet e ekzistencës së studimeve të plota apo pjesore të miratuara për zonat përkatëse nga organet e specializuara, sipas përcaktimeve në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” dhe aktet nënligjore të dalta për dhe në zbatim të tij.

6. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I RREGULLIMIT TË  
TERRITORIT DHE TURIZMIT  
**Bashkim Fino**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.7, faqe 209*

**UDHËZIM**  
**Nr.4, datë 11.8.2004**

**PER MËNYRËN E USHTRIMIT TË KOMPETENCËS PËR PLANIFIKIMIN E  
TERRITORIT NGA NJËSITË E QEVERISJES VENDORE**

Mbështetur në nenin 102 pika 4 të Kushtetutës, në nenin 12 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar dhe me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”,

nisur nga praktika e deritanishme dhe ndryshimet që solli ligji nr.8991, datë 23.1.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar”, duke pasur parasysh se:

1. Në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” neni 10, përcaktohet se planifikimi urban është funksion i vetë komunës apo bashkisë, ku në pikën 3/1 germa g thuhet: “...planifikimi urban, menaxhimi i tokës dhe strehimi sipas mënyrës së përcaktuar në ligj”. Pra planifikimi urban, si funksion i vetë njësisë së qeverisjes vendore, ushtrohet nga bashkia apo komuna, por gjithnjë sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

2. Ligji që përcakton mënyrën e planifikimit urban në Republikën e Shqipërisë, është ligji nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i cili përcakton rregullat, procedurën dhe mënyrën e ushtrimit të kompetencës në fushën e planifikimit territorial.

Në kuadër të decentralizimit për ushtrimin e kompetencës dhe të funksionit të planifikimit territorial nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, ligji nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” u ndryshua me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003.

3. Në rastet kur bashkia ose komuna, në pamundësi të ngritjes së strukturës tip të njësisë së urbanistikës, si rrjedhojë e këshillit teknik e më pas edhe e KRRT-së, kompetencën e planifikimit të territorit e delegon në qark, bazuar në nenin 13 pika 2 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ku thuhet: “Qarku ushtron të gjitha funksionet që i delegohen nga një ose më shumë komuna apo bashki, brenda territorit të tij, sipas një marrëveshjeje të lidhur midis tyre”.

Në pamundësi të ngritjes së formacionit të KRRT-së, sipas nenit 17 pika 2, për mungesë në strukturën organizative të saj dhe specialistësh të fushave përkatëse, kompetenca e planifikimit territorial delegohet në qark.

4. Ushtrimi i vendimmarrjes nga KRRT-të në bashki/komunë bëhet në përputhje me nenin 20 pika 2 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar”.

a) Për germat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 2 të nenit 20 të këtij ligji, shqyrtimi dhe miratimi nga KRRT-të e bashkisë/komunës nuk është përfundimtar, pasi për një rakordim me planet rajonale, masterplanet dhe me planet e zhvillimit rajonal, si dhe në përputhje me germat “a”, “b”,

“ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 20, miratimi përfundimtar bëhet nga KRRT-të e qarkut.

b) Për germat “a”, “c”, “ç” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 20, shqyrtimi dhe miratimi nga KRRT-të e qarkut nuk është përfundimtar, pasi për një rakordim me politikat kombëtare dhe qeveritare, si dhe në përputhje me nenin 9 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, miratimi përfundimtar bëhet nga KRRTRSH-ja.

c) Germa “e” e pikës 2 të nenit 20 përcakton kompetencën e KRRT-së së bashkisë apo komunës, për shqyrtimin dhe miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit, brenda vijës kufizuese të ndërtimit (vija e verdhë) të qytetit apo të fshatit.

ç) Germa “dh” e pikës 1 të nenit 20 përcakton kompetencën e KRRT-së së qarkut, për shqyrtimin dhe miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit jashtë vijës kufizuese të ndërtimit (vijës së verdhë) të qytetit apo të fshatit, në zbërthim dhe zbatim të masterplaneve.

5. Në nenin 9 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, përcaktohet se KRRTRSH-ja miraton studimet rajonale dhe pjesore të zonave turistike, pra të gjitha zhvillimet ndërtimore sipas procedurës së përcaktuar në nenin 70.

Për sa më lart, me qëllim saktësimin e vendimmarrjes së KRRT-ve të çdo niveli në fushën e planifikimit të territorit,

#### UDHËZOJ:

1. Në njësinë e qeverisjes vendore, ngritja e KRRT-ve të bëhet në përputhje me përcaktimet e neneve 17, 18, 24 dhe 25 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar.

2. Për ngritjen dhe funksionimin e KRRT-ve, komuna ose bashkia jo e kategorisë së parë:

a) duhet të ngrejë strukturën tip të njësisë së urbanistikës së saj, sipas përcaktimit të bërë në nenin 24 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar”;

b) duhet të sigurojë funksionimin e strukturave të administratës, përfaqësuesit e të cilëve janë anëtarë të KRRT-së, sipas përcaktimit të bërë në nenin 17 pika 2 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003;

c) duhet të sigurojë me specialistë të fushave përkatëse dhe të zgjedhur, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 17 pika 2 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003;

ç) duhet të ngrejë dhe të miratojë, me vendim të këshillit komunal apo bashkiak, këshillin teknik, sipas përcaktimit të bërë në nenin 25 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003.

3. Çdo komunë apo bashki që nuk realizon kërkesat e pikës 2 të këtij udhëzimi, duhet t’ia delegojë kompetencën e planifikimit të territorit, këshillit të qarkut përkatës, me miratim të këshillit komunal apo bashkiak.

Delegimi i kësaj kompetence të bëhet në përputhje me nenin 13 pika 2 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

Marrëveshja e bashkëpunimit nënshkruhet nga kryetari i komunës apo bashkisë dhe kryetari i këshillit të qarkut.

4. Në marrëveshjen e bashkëpunimit duhet të saktësohet:

a) Kryetari i komunës apo bashkisë që delegon kompetencën, të jetë i pranishëm në KRRT-në e qarkut, si përfaqësues i bashkisë apo komunës, kur ajo merr në shqyrtim çështje brenda territorit të komunës apo bashkisë, që ka deleguar kompetencën e planifikimit të territorit. Në këtë rast, ai merr pjesë në votim me cilësinë e anëtarit të KRRT-së.

b) Kërkesat për shesh dhe leje ndërtimi të depozitohen në njësinë e urbanistikës së komunës apo të bashkisë që ka deleguar kompetencën e planifikimit të territorit.

c) Të ardhurat që rrjedhin nga neni 51 i ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar, mbledhen nga qarku dhe disponohen vetëm për financimin e studimeve urbanistike, të kërkuara nga bashkia apo komuna që ka deleguar kompetencën e planifikimit të territorit.

ç) Të ardhurat që rrjedhin nga neni 16 i ligjit nr.8992, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, kalojnë në llogarinë e bashkisë apo komunës që ka deleguar kompetencën dhe administrohen nga këshilli i bashkisë apo komunës.

Kjo e ardhur përdoret me destinacion për ngritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës publike

për zonën e studiuar, brenda të cilës miratohet ngritja e strukturës ndërtimore.

d) Marrëveshja e bashkëpunimit ka vlefshmëri deri në përfundimin e mandatit të këshillit bashkiak apo komunal, me të drejtë rinovimi kur nuk përmbushen kërkesat e pikës 2 të këtij udhëzimi.

5. Të ardhurat e përcaktuara në pikën 3 germat “c” dhe “ç” të këtij udhëzimi, nuk mund të përdoren jashtë destinacionit të përcaktuar në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” dhe në ligjin nr.8992, datë 12.12.2002 “Për sitemin e taksave vendore”.

6. KRRT-ja e komunës apo e bashkisë, e ngritur në përputhje me pikën 2 të këtij udhëzimi, ushtron kompetencën e planifikimit të territorit, në përputhje me nenin 20 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003.

a) Për çdo studim urbanistik, sipas përcaktimit në germat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” pika 2 të nenit 20 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003, të miratuar nga KRRT-ja e komunës apo bashkisë, duhet të bëhet shqyrtimi dhe miratimi në KRRT-në e qarkut.

b) Për çdo studim urbanistik të përcaktuar në germat “a”, “c”, “ç” dhe “dh” pika 1 të nenit 20 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003, të miratuar nga KRRT-ja e qarkut, sipas rastit, në përputhje me nenin 9 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", duhet bërë miratimi në KRRTRSH.

7. KRRT-ja e komunës apo bashkisë, shqyrton dhe miraton vetëm sheshet dhe lejet e ndërtimit brenda vijës kufizuese të ndërtimit (vijës së verdhë) të qytetit apo të fshatit, sipas përcaktimit të bërë në germën “e” të pikës 2 të nenit 20 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003.

Vija kufizuese e ndërtimit (vija e verdhë) e qytetit ose e fshatit nuk është kufiri administrativ i komunës apo bashkisë.

8. Jashtë vijës kufizuese të ndërtimit (vija e verdhë) të qytetit ose të fshatit, nuk mund të shqyrtohet dhe miratohet shesh dhe leje ndërtimi, pa pasur studime rajonale ose masterplane të miratuara.

KRRT-ja e qarkut shqyrton dhe miraton shesh dhe leje ndërtimi, konform studimeve të miratuara, jashtë vijës kufizuese të ndërtimit (vija e verdhë) të qytetit ose të fshatit, sipas përcaktimit të bërë në germën “dh” të pikës 1 të nenit 20 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003.

9. Kur sipërfaqja e sheshit të ndërtimit jashtë vijave kufizuese të ndërtimit (vija e verdhë) të qytetit ose të fshatit, është mbi 0,5 ha, shqyrtimi dhe miratimi i sheshit të ndërtimit konform studimeve urbanistike, është kompetencë e KRRTRSH-së, sipas përcaktimit të bërë në nenin 9 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën".

Në këtë rast, pas miratimit të sheshit të ndërtimit në KRRTRSH, leja e ndërtimit jepet nga KRRT-ja e qarkut përkatës.

10. Në zonat turistike veprohet si vijon:

Zonat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.88, datë 1.3.1993 “Për miratimin e zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit”, konsiderohen zona turistike.

a) KRRT-ja e komunës ose e bashkisë, brenda kufirit administrativ të së cilës përfshihet zona turistike, nuk ka kompetencë vendimmarrjeje të planifikimit të territorit në territorin e zonës turistike, që ndodhet jashtë vijës kufizuese të ndërtimit (vijë e verdhë) të qytetit ose fshatit.

Kjo është përcaktuar edhe në paragrafin e dytë të pikës 2 të nenit 20 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003.

b) Miratimi i studimeve urbanistike në zonat turistike bëhet nga KRRTRSH. Materiali plotësohet dhe paraqitet në KRRT-ja e qarkut përkatës, i cili ia përcjell më pas KRRTRSH-së.

c) Kërkesa për shesh dhe leje ndërtimi, në zonat turistike sipas germës “a” të kësaj pike, depozitohen në sekretarinë teknike të KRRT-së së qarkut përkatës. Sheshi i miratuar nga KRRT-ja e qarkut shqyrtohet në Këshillin e Zhvillimit të Turizmit (KZHT). KRRT-ja e qarkut, mbi bazën e vendimit të KZHT-së, miraton lejen e ndërtimit.

ç) Kur sheshi i ndërtimit brenda zonës turistike është mbi 0.5 ha, miratimi i tij bëhet në KRRTRSH.

11. Ligji nr.8991, datë 23.1.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, ndryshuar me vendimin nr.2, datë 25.1.1999 të Gjykatës Kushtetuese dhe me ligjet nr.8453, datë 4.2.1999, nr.8501, datë 16.6.1999 dhe nr.8682, datë 7.11.2000” është botuar në Fletoren Zyrtare nr.5, faqe 152 të vitit 2003.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.88, datë 1.3.1993 “Për miratimin e zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit” është botuar në Fletoren Zyrtare nr.4 të vitit 1993.

12. Udhëzimi nr.3, datë 30.1.2002 “Mbi mënyrën ligjore që duhet ndjekur për planifikimin urban dhe dhënien e shesheve dhe lejeve të ndërtimit në bashki/komuna”, është revokuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr.8991, datë 23.1.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I RREGULLIMIT TË  
TERRITORIT DHE TURIZMIT**

**Bashkim Fino**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.57, faqe 3731*

## **VENDIM**

**Nr.337, datë 16.4.1996**

### **PËR FORCIMIN E KONTROLLIT NË NDRYSHIMET E RIKONSTRUKSIONET E AMBIENTEVE NË NDËRTESET EKZISTUESE NË BASHKËPRONËSI**

Me propozimin e Ministrit të Ndërtimit dhe Turizmit dhe Sekretariatit Shtetëror të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

1. Personat fizikë e juridikë shtetërorë ose privatë, vendas e të huaj, për ndryshime e rikonstruksione të ambienteve në ndërtesat ekzistuese në bashkëpronësi, marrin leje ndërtimi nga Këshilli i Rregullimit të Territorit (KRT) i rrethit.

2. Procedurat për marrjen e lejes së ndërtimit bëhen sipas përcaktimeve në ligjin nr.7693, datë 26.4.1993 “Për urbanistikën” si dhe ligjit nr.8015, datë 19.10.1995. Në rastet e ndërhyrjeve në elementet strukturore mbajtëse, dokumenteve i bashkëngjitet edhe miratimi i bashkëpronarëve në përputhje me dispozitat e Kodit Civil mbi bashkëpronësinë në ndërtesa.

3. Zyra e urbanistikës e rrethit dërgon në Policinë e Ndërtimit kopje të vendimeve të marra nga KRRT-ja e rrethit për lejet e ndërtimit të miratuara për ndryshimet e rikonstruksione në ambientet e ndërtesave në bashkëpronësi.

4. Zyra e urbanistikës në bashki e komuna kontrollon ndryshim e rikonstruksion të ambienteve në ndërtesat ekzistuese në bashkëpronësi.

Kur konstaton ndryshime e rikonstruksione pa leje të KRRT-së zbatohen sanksionet parashikuara në nenet 41 dhe 61 të ligjit për urbanistikën, bën pezullimin e punimeve, bën denoncimin në organet e policisë së rendit dhe, sipas rastit, kur shkelja përbën vepër penale bëhet denoncimi në gjykatë.

5. Policia e ndërtimit kontrollon ndryshimet dhe rikonstruksionet në fazë e zbatimit të projekteve dhe merr masat në përputhje me ligjin për policinë e ndërtimit.

Kur konstaton ndërtime të këtij lloji pa leje ndërtimi, kërkon menjëherë pezullimin e ndërtimit dhe paraqet me shkrim kërkesën në zyrën e urbanistikës të bashkisë apo komunës për të ndërhyrë sipas pikës 4 të këtij vendimi.

6. Në raste të denoncimeve nga persona që kanë konstatuar ndryshime e rikonstruksione që përbëjnë shkelje të këtij vendimi, në zyrat e urbanistikës në bashki e komuna ose në Policinë e Ndërtimit, këto të fundit brenda 24 orëve bëjnë veprifikimin dhe ndërhyjnë në marrjen e masave përkatëse sipas pikave 4 e 5 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.17, faqe 641*

**LIGJ**  
**Nr. 10 119, datë 23.4.2009**

**PËR PLANIFIKIMIN E TERRITORIT**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.10 258, datë 25.3.2010;  
ndryshuar me ligjin nr.10 315, datë 16.9.2010 për miratimin e aktit normativ nr.4, datë25.8.2010)*

*I përditësuar*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
- b) të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e privatë, duke bashkërenduar:
  - i) mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet;
  - ii) krijimin e garantimin e territoreve të ndërtueshme, të organizuara në mënyrë të harmonizuar e funksionale, duke i dhënë përparësi mundësisë së banimit për të gjitha shtresat ekonomike e sociale, krijimit të infrastrukturës fizike të përshtatshme për nxitjen e investimit në ushtrimin e veprimtarive ekonomike, sociale e kulturore, lehtësimit të përdorimit të sigurt të shërbimeve e komoditeteve publike, të transportit, komunikimit dhe infrastrukturës, përfshirë territoret e përshtatura;
  - iii) nxitjen e jetës ekonomike, shoqërore e kulturore në nivel kombëtar e vendor;
  - iv) garantimin e burimeve të furnizimit të mjaftueshëm dhe veçanërisht atij jetësor;
  - v) garantimin e kushteve të sigurisë së jetës dhe të shëndetit publik, rendit publik dhe sigurisë kombëtare;
  - vi) nxitjen e zhvillimit të balancuar rajonal për të siguruar shpërndarje të qëndrueshme të popullsisë në vend në bazë të burimeve;
- c) të nxisë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit;
- ç) të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me instrumentet planifikuese dhe ligjet mjedisore;
- d) të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë;
- dh) të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të hartojnë e të përditësojnë rregullisht instrumente të planifikimit, sipas kërkesave të tregut dhe nevojave sociale;



e) të sigurojë që autoritetet e planifikimit të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese, për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të territorit;

ë) të garantojë, sipas legjislacionit për ndërtimin, zbatimin e rregullave të sigurisë së ndërtimeve dhe të punimeve të ndërtimit për jetën dhe shëndetin e njerëzve.

## Neni 2

### **Objekti**

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e parimeve bazë, përgjegjësi, rregullave dhe procedurave për planifikimin e territorit.

## Neni 3

### **Përkufizime**

*(Shtuar pika 21/1 me ligjin nr.10 258, datë 25.3.2010, neni 1)*

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Planifikimi i territorit” është një veprimtari ndërdisiplinore për planifikimin e përdorimit të tokës, përcaktimin e kushteve për zhvillimin e territorit dhe të strukturave natyrore e të ndërtueshme në të.

2. “Instrumente të planifikimit” janë politikat, planet dhe rregulloret, që zbatohen në mënyrë të përgjithshme ndaj një territori, pjese të tij apo ndaj një tipi zhvillimi.

3. “Instrument i detyrueshëm” është instrumenti i planifikimit ose ato pjesë të tij, që përcaktojnë rregulla të detyrueshme për t’u zbatuar ose respektuar nga personat publikë apo privatë.

4. “Instrument orientues” është instrumenti i planifikimit ose ato pjesë të tij, që nuk kanë natyrë detyruese.

5. “Politikat territoriale”, në vijim politikat, është akti më i lartë i planifikimit të territorit, me anë të të cilit realizohen programet dhe veprimtaritë në këtë fushë, për të arritur objektiva e qëllime të identifikuara.

6. “Plani territorial”, në vijim plani, është një instrument zyrtar i miratuar planifikimi, që përmban tekst shpjegues, grafikë dhe harta, të cilat përbëjnë një tërësi të vetme e të pandashme, të zbatueshme për të gjitha veprimet e zgjidhjet e planifikimit.

7. “Rregullore” është instrumenti, që përmban rregullat e zbatueshme për përdorimin dhe zhvillimin ekzistues e të ardhshëm të tokës. Rregullorja përcakton normat e standardet për zhvillimin dhe procedurat, që garantojnë se propozimet për zhvillim të sektorit publik e privat përmbushin qëllimet dhe objektivat e planeve territoriale.

8. “Rregullore uniforme” janë rregullore të miratuara nga Këshilli i Ministrave, që përcaktojnë rregulla të unifikuara për formën dhe strukturën e instrumenteve kombëtare ose vendore të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit.

9. “Rregullore të kontrollit të zhvillimit” janë rregullore të miratuara nga autoritetet e planifikimit, për të disiplinuar kontrollin e zhvillimit, në bazë të instrumenteve të planifikimit në fuqi. Ato miratohen në bazë të rregulloreve uniforme dhe zbatohen në nivel kombëtar dhe vendor.

10. “Rregullore model të planifikimit” janë rregullore planifikimi të miratuara nga Këshilli i Ministrave, që synojnë të nxisin planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Këto zbatohen nga autoritetet vendore të planifikimit, në mungesë dhe deri në miratimin prej tyre të instrumenteve vendore të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit për territorin e tyre administrativ.

11. “Planifikimi kombëtar” është planifikimi, që shtrihet në të gjithë ose në një pjesë të territorit kombëtar.

12. “Planifikimi vendor” është planifikimi, që shtrihet në të gjithë ose në një pjesë të territorit vendor dhe përfshin territore nën juridiksionin e bashkisë, komunës dhe qarkut.

13. “Planifikimi ndërvendor” është planifikimi në nivel vendor, që ka shtrirje ose efekte në të gjithë ose në një pjesë të territorit të dy apo më shumë njësisive të qeverisjes vendore.

14. "Planifikimi i integruar" është planifikimi, gjatë të cilit harmonizohen në një instrument planifikimi interesat e përbashkët të autoriteteve kombëtare dhe vendore të planifikimit.

15. "AKPT"-ja është Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, e krijuar sipas nenit 9 të këtij ligji.

16. "Territor", sipas rastit dhe juridiksionit të autoriteteve përgjegjëse për planifikimin e tij:

a) kombëtar është hapësira gjeografike tokësore, nëntokësore, ujore e ajrore, përfshirë shtrirjen ndërkombëtare të përcaktuar të zonës bregdetare, që përkon me kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë;

b) vendor është hapësira gjeografike tokësore, nëntokësore, ujore e ajrore, që përputhet me ndarjet administrative-territoriale të njësisive të qeverisjes vendore, sipas legjislacionit në fuqi.

17. "Territor i përshtatur" është territori, që ofron përdorim të sigurt, të barabartë e të pavarur nga të gjithë personat, përfshirë personat me aftësi të kufizuara ose grupe të veçanta, për të cilët janë të nevojshme zgjidhje teknike apo pajisje të veçanta.

18. "Autoritetet e planifikimit" janë organet e institucioneve publike, në nivel kombëtar e vendor, që kanë përgjegjësi të caktuara në planifikimin e territorit, sipas legjislacionit në fuqi dhe i ushtrojnë ato sipas këtij ligji.

19. "Autoritetet e inspektimit" janë organet e përcaktuara në ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit".

20. "Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit" është institucion publik, që bën pjesë në rrjetin arkivor të Republikës së Shqipërisë, sipas ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat".

21. "Çështje të rëndësishme kombëtare në planifikimin e territorit" janë ato çështje që, sipas ligjit, njësohen ose lidhen me interesa publikë kombëtarë, që ndikojnë ose ndikohen nga zhvillimi/ruajtja e territorit.

21/1. "Zona kombëtare" janë zona, të cilat njësohen ose lidhen me interesa publikë kombëtarë, që ndikojnë ose ndikohen nga zhvillimi dhe ruajtja e territorit.

22. "Subjekti i kompetencave të përbashkëta" është një komitet, bord, ent, institucion ose ndërmarrje, i krijuar nga dy ose më shumë autoritete vendore dhe/ose kombëtare të planifikimit, për të kryer ose përmbushur detyra apo përgjegjësi të përbashkëta, sipas dispozitave të këtij ligji.

23. "Punim" është çdo veprim ose proces ndërtimi, gërmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi dhe prerje drurësh.

24. "Strukturë" është çdo objekt i ndërtuar ose i instaluar në territor, që ka vendosje të palëvizshme ose të përkohshme dhe, sipas rastit, përfshin tokën në, mbi dhe nën të cilën ndodhet struktura.

25. "Zhvillimi" është kryerja e çdo punimi në territor për ndryshimin e përdorimit të tokës e të strukturave në të, nënndarjen apo bashkimin e parcelave, ndërtimin e strukturave të reja, si dhe ndryshimin e strukturave ekzistuese.

26. "Përdorimi i tokës apo strukturave në të" është zhvillimi i lejuar, sipas një instrumenti në fuqi të planifikimit, që është kryer ose që propozohet të kryhet nga një zhvillues.

27. "Ndryshimi i përdorimit të tokës" është përdorimi aktual, që zëvendëson një përdorim të mëparshëm të tokës, fillimi i përdorimit ose rifillimi i tij pas një periudhe të mungesës së përdorimit ose përdorimi i njëjtë apo i ndryshëm, që i shtohet një përdorimi të mëparshëm të tokës, i cili vazhdon pavarësisht nga fillimi i përdorimit të ri të saj.

28. "Përdorimi i papërputhshëm" është përdorimi ekzistues ose i propozuar i tokës apo i strukturës në të, që nuk përputhet me kërkesat e një rregulloreje të përdorimit të tokës ose të ndryshimit të saj në çastin e hyrjes së saj në fuqi dhe i papërputhshëm me kushtet e kërkuara të sigurisë së mjedisit për përdorimet e autorizuara të tokës në afërsi të saj.

29. "E drejta për zhvillim" janë përdorimet dhe/ose intensiteti i ndërtimit të lejuar, për një parcelë, sipas instrumenteve të planifikimit.

30. "Infrastruktura publike" është tërësia e rrjeteve, instalimeve dhe e strukturave ekzistuese ose të parashikuara në territor, që synojnë realizimin e shërbimeve publike në fushat e transportit, të energjisë, administrimit të ujit, telekomunikacioneve, arsimit, shëndetësisë, administrimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit, administrimit të burimeve natyrore e kulturore, mbrojtjes kombëtare, civile e kundër zjarrit dhe në administrimin e rrjeteve, instalimeve e strukturave të tjera

të përdorimit publik. Infrastruktura publike ka karakter kombëtar ose vendor dhe realizohet me investime publike ose private.

31. “Kontrolli i zhvillimit” është procesi i shqyrtimit, në bazë të të cilit autoriteti përgjegjës i planifikimit vlerëson e vendos nëse një kërkesë për zhvillim ose kryerja e një zhvillimi përputhet me përcaktimet e detyrueshme të instrumenteve të planifikimit, rregulloreve të ndërtimit, kushteve të tjera specifike, të vendosura për realizimin e zhvillimit, apo ato të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

32. “Kërkesa për zhvillim” është kërkesa e paraqitur pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit, për lejimin e kryerjes së zhvillimit.

33. “Deklarimi paraprak i punimeve” është njoftimi i depozituar pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit për punime, që përjashtohen nga pajisja me leje, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

34. “Leja e zhvillimit” është akti i miratimit të së drejtës për zhvillim, sipas një kërkesë.

35. “Leja e ndërtimit” është akti i lejimit të punimeve për zhvillimin e tokës ose të strukturës në të.

36. “Miratimi i heshtur” është ekzekutimi i një akti ose ushtrimi i një të drejte, në rast se vendimi ose qëndrimi përkatës nuk jepet nga autoriteti përgjegjës ose përkatës i planifikimit, brenda afatit të parashikuar nga dispozitat përkatëse të këtij ligji, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në të.

37. “Leja e përdorimit” është akti i lejimit të përdorimit dhe/ose zënies së tokës apo strukturës së zhvilluar, për të cilin është kryer punimi.

38. “Zhvillimi i paautorizuar” është kryerja e çdo punimi të paautorizuar, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

39. “Instrumentet e veçanta të kontrollit të zhvillimit” janë instrumentet, që miratohen e zbatohen nga autoritetet e planifikimit, për të garantuar një interes publik. Instrumentet e veçanta të kontrollit të zhvillimit janë:

a) “Pezullimi i zhvillimit” është, sipas rastit, ndalimi i përkohshëm i zhvillimit ose shtyrja e shqyrtimit të kërkesave për leje zhvillimi, në të gjithë territorin ose në një pjesë të tij për një, disa ose çdo tip zhvillimi, në mënyrë që të ruhet territori në fjalë gjatë periudhës së hartimit të një instrumenti të planifikimit;

b) “Servituti publik” është barra ose e drejta, që i ngarkohet një pasurie të paluajtshme për përdorimin publik dhe dobinë e një interesi publik të veçantë. Ai nuk përjashton përdorimin e pasurisë së paluajtshme ose të një pjese të saj, që nuk cenon realizimin e servitutit publik;

c) “Rezervimi publik” është akti i autoritetit të planifikimit, që përcakton një numër të kufizuar pasurish të paluajtshme në pronësi private ose pjesë të tyre për një qëllim ose interes të veçantë publik, që kufizon ose përjashton zhvillimin e tokës dhe të strukturave në të;

ç) “E drejta e transferimit” është e drejta e kalimit të së drejtës së pronësisë së një pasurie të paluajtshme nga një njësi e qeverisjes vendore në favor të shtetit, për kryerjen e investimeve publike ose private në interes të infrastrukturës publike kombëtare;

d) “E drejta e preferimit” është e drejta, në dobi të një autoriteti të planifikimit, në kuptim të këtij ligji, për t’u preferuar në radhë para çdo personi privat në blerjen, sipas vlerës së tregut, të një pasurie të paluajtshme, në pronësi private, që është objekt shitjeje dhe ndodhet në një zonë preferimi, vendimtare për realizimin ose mbrojtjen e një interesi të veçantë publik;

dh) “E drejta e lënies” është e drejta e një pronari privat të një pasurie të paluajtshme, që i nënshtrohet një rezervimi publik të pasurisë së paluajtshme, për të njoftuar zyrtarisht autoritetin përgjegjës të planifikimit, në territorin administrativ të të cilit ndodhet pasuria në pronësi të tij, për ta blerë këtë pasuri.

40. “Zona” është një pjesë e territorit, me karakteristika ose përdorime të veçanta apo të njëjta, ekzistuese ose të planifikuara të tokës e të strukturave në të, sipas rregulloreve të përdorimit të tokës.

41. “Parcela” është pasuria e paluajtshme e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

42. “Nëndarja” është ndarja e një parcele në dy ose më shumë parcela, për qëllime zhvillimi, në përputhje me mënyrën e përcaktuar në instrumentet e planifikimit.

43. “Bashkim” është bashkimi i dy apo më shumë parcelave në një të vetme.

44. “Regjistri i planifikimit të territorit”, në vijim regjistri, është një inventar publik, i dokumentuar në mënyrë elektronike dhe në letër, në të cilin regjistrohen dhe administrohen, në mënyrë të pavarur nga autoritetet kombëtare dhe vendore, të dhënat për tokën, projektaktet dhe aktet e planifikimit, kërkesat për zhvillim dhe lejet e zhvillimit, të ndërtimit apo të përdorimit, së bashku me të drejtat apo kufizimet ligjore, që rrjedhin prej tyre, si dhe studime apo materiale të tjera me interes për publikun, sipas përcaktimeve të kreut V të këtij ligji.

45. “Sistem i informacionit gjeografik”, në vijim GIS, është një sistem i kompjuterizuar i regjistrimit të informacionit, i bazuar në koordinatat gjeografike të përfuara në një hartë dixhitale, për mbledhjen, përditësimin, ndryshimin, ruajtjen, përpunimin, depozitimin, kërkimin dhe rigjetjen e këtij informacioni për objekte gjeografike, karakteristikat e tyre dhe të dhëna të tjera për tokën, me qëllim dhënien e zgjidhjeve ndërvepruese ose vendimmarrëse ndihmuese për detyrat e projektimit, modelimit, analizës, kërkimit, menaxhimit dhe objektivave të tjerë në një hapësirë gjeografike.

46. “Bazë të dhënash GIS” është mbledhja dhe regjistrimi i të dhënave me koordinata gjeografike, të mbledhura e të organizuara rregullisht, në mënyrë të organizuar, sistemuar e metodike, në shtresa individuale të hartave të përgatitura me mjete dixhitale, sipas parimeve të GIS-it.

47. “Palë e interesuar” është një person fizik ose juridik, privat dhe çdo autoritet publik apo organ i tij, që ka një interes ose që mund të preket nga zhvillimi në territor apo nga një instrument i caktuar i planifikimit ose i kontrollit të zhvillimit.

48. “Dëgjimi publik” është takimi i hapur, i organizuar në vende të përshtatshme nga autoriteti i planifikimit, në bazë të njoftimit publik e efektiv të palëve të interesuara dhe/ose publikut, në përgjithësi ose që mund të preket, për të mbledhur vërejtjet e propozimet për projektin e instrumentit të planifikimit ose të kontrollit të zhvillimit para marrjes së vendimit.

49. “Njoftimi publik” është njoftimi paraprak, i kryer në kohë të mjaftueshme dhe me çdo mjet efektiv, i palëve të interesuara dhe/ose publikut, në përgjithësi, për kohën, vendin dhe qëllimin e dëgjimit publik, sipas këtij ligji.

50. “Vërejtje” është paraqitja e një mendimi kundërshtues për zgjidhjet e planifikimit ose një pretendim për mosrespektim të dispozitave ligjore apo nënligjore në procesin e planifikimit.

51. “Drejtimi i zhvillimit” është orientimi, nëpërmjet administrimit, mbikëqyrjes, analizimit e planifikimit, i zhvillimit në territor ose në pjesë të caktuara të tij, në bazë të premisave natyrore, ekonomike e njerëzore, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Drejtimi i zhvillimit është përgjegjësi e të gjitha niveleve të qeverisjes komunale/bashkiake, të qarkut dhe kombëtare.

#### Neni 4

#### **Parimet e planifikimit të territorit**

Planifikimi i territorit bazohet në këto parime:

a) zhvillimin e qëndrueshëm, ekonomik e social, i cili, në bazë të një metodologjie, që përfshin studime dhe parashikime sociale, kulturore e ekonomike, përcakton vizionin për zhvillimin e ardhshëm të territorit, duke marrë parasysh alternativat e zhvillimit strategjik, garanton brezat e sotëm e ato të ardhshëm për cilësi të lartë të mjedisit, zhvillim ekonomik të balancuar dhe të harmonizuar, kohezion ekonomik e social, përdorim racional të burimeve natyrore, njerëzore e materiale, zhvillimin dhe ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore;

b) bashkërendimin horizontal dhe vertikal ndërmjet autoriteteve kombëtare e vendore të planifikimit dhe palëve të interesuara, i cili garanton që instrumentet e planifikimit të miratohen, në përputhje me instrumentet e planifikimit të miratuara nga autoritetet e tjera dhe që ato të harmonizojnë interesat publikë e privatë, kombëtarë e vendorë;

c) shumëllojshmërinë, që garanton hartimin e instrumenteve të planifikimit, në bazë të shumëllojshmërisë së nevojave e burimeve njerëzore, materiale, të veprimtarisë ekonomike, trashëgimisë natyrore e kulturore;

ç) planifikimin e detyrueshëm për të gjitha autoritetet e planifikimit, sipas këtij ligji, i cili garanton zhvillimin e territorit dhe të shpërndarjes së burimeve financiare publike dhe realizimin e

nismës private, vetëm në bazë të instrumenteve të planifikimit, sipas niveleve të autoriteteve dhe kompetencave, të dhëna në bazë të ligjit dhe detyron, përveç përjashtimeve të përcaktuara në këtë ligj, që çdo punim, pavarësisht llojit e destinacionit të tij, të kryhet në zbatim e në përputhje me instrumentet e planifikimit në nivel kombëtar, ndërvendor dhe vendor;

d) vazhdimësinë, që garanton se ndryshimi i instrumenteve të planifikimit të bëhet, duke ruajtur ato pjesë të instrumentit planifikues, të cilave nuk u ka ndryshuar thelbi;

dh) transparencën, që garanton se instrumenti i planifikimit është hartuar e miratuar përmes informimit aktiv, të saktë e këshillimit në kohë, nëpërmjet transparencës, aksesit në informacion dhe pjesëmarrjes së gjerë të palëve të interesuara e të publikut, për të mbrojtur interesat e tyre në procesin e planifikimit;

e) shërbimin me një ndalesë dhe pranimin në heshtje;

ë) specifikën, që mbështetet, gjatë planifikimit të zhvillimit të territoreve konkrete, në karakteristikat specifike të tyre, natyrore apo të krijuara nga njeriu, të tilla si vendndodhja gjeografike, kushtet gjeologjike, kërkesat mjedisore për t'u respektuar, niveli aktual e i pritshëm i zhvillimit, lëvizjet e rritja demografike, trashëgimia natyrore, kulturore e arkitekturore, të drejtat e zhvillimit dhe të pronësisë;

f) delegimin e nëndelegimin e kompetencave dhe kontraktimin e shërbimeve;

g) efektivitetin, qëndrueshmërinë, eficientë, profesionalizmin dhe përgjegjshmërinë në procesin e planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit të territorit;

gj) subsidiaritetin;

h) harmonizimin me normat e standardet europiane në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit e të kritereve mjedisore;

i) përdorimin e territorit, që garanton përfitimin e shërbimeve të domosdoshme, të emergjencës e të zakonshme, nga të gjithë shtetasit dhe mundëson e lehtëson përdorimin për personat me aftësi të kufizuar;

j) çdo parim tjetër i përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe në legjislacionin në fuqi, që lidhet me planifikimin e territorit.

## KREU II AUTORITETET E PLANIFIKIMIT

### SEKSIONI I AUTORITETET KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE PËRGJEGJËSITË E TYRE

#### Neni 5

#### **Autoritetet kombëtare të planifikimit të territorit**

1. Autoritetet kombëtare të planifikimit të territorit janë:

a) Këshilli i Ministrave;

b) Këshilli Kombëtar i Territorit;

c) Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;

ç) çdo ministri, çdo organ tjetër publik qendror, që ka detyra dhe përgjegjësi në planifikimin e territorit, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe çdo organ tjetër, që është në varësi të tyre apo të Këshillit të Ministrave, kur i janë deleguar apo nëndeleguar detyra e përgjegjësi të caktuara për planifikimin e territorit dhe kontrollin mjedisor.

2. Autoritetet kombëtare të planifikimit të territorit ushtrojnë funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë përkatëse, që burojnë nga dhe/ose bazohen në legjislacionin në fuqi për çështje të rëndësishme kombëtare të planifikimit të territorit.

## Neni 6

### **Çështjet e rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit**

Çështjet e rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit përfshijnë:

a) karakteristika të veçanta kulturore, historike, ekonomike, sociale ose mjedisore të një apo disa strukturave, instalimeve, rrjeteve ose zonave, që synojnë drejtpërdrejt realizimin e interesave kombëtarë në pjesë të territorit, si: zonat, që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, zonat/ndërtimet me vlera të trashëgimisë natyrore e kulturore, monumentet kulturore, qendrat historike, zonat e parqet arkeologjike, pyjet e zonat e mbrojtura natyrore, monumentet natyrore, përfshirë karakteristika unike gjeografike, zonat me rrezik natyror, ekosistemet e rrezikuara dhe biodiversiteti, burimet minerare, natyrore dhe rrjetet, komplekset e parqet industriale, rrugët kombëtare, linjat hekurudhore dhe infrastruktura ndihmëse, instalimet e infrastrukturës kombëtare, sektori i energjisë e telekomunikacionit, aeroportet, portet e rrugët detare, zhvillimet në zonat ushtarake, zonat bregdetare, tokësore e detare, liqenore, lagunat, lumenjtë, digat e dambat, tokat bujqësore, zhvillime, struktura apo rrjete arsimore, shëndetësore, sociale, kulturore e artistike, sportive dhe çdo strukturë, rrjet apo zonë, të cilët, për shkak të veçorive të tyre, janë të rëndësishëm për kryerjen e veprimtarisë së institucioneve qendrore të shtetit, siç përcaktohet me ligj;

b) kërkesat minimale për mbrojtjen e shëndetit, të sigurisë së jetës dhe asaj publike dhe të përshtatshmërisë për lëvizje për personat me aftësi të kufizuar dhe kategori të tjera, që e kanë të nevojshme këtë gjë.

## Neni 7

### **Këshilli i Ministrave**

Krahas kompetencave të tjera të përcaktuara në këtë ligj, Këshilli i Ministrave:

a) miraton rregullore ndërtimi, për të garantuar sigurinë e cilësinë e jetës dhe të shëndetit publik;

b) merr masa për zbatimin e instrumenteve kombëtare të planifikimit të territorit nga autoritetet përgjegjëse të planifikimit;

c) nxit politikat e planifikimit e të zhvillimit në territor dhe mbështet hartimin e planeve territoriale kombëtare e vendore nga autoritetet përkatëse të planifikimit dhe siguron që ato të përmbushin standardet teknike e procedurale, të përcaktuara në këtë ligj;

ç) mbështet e zhvillon burimet e nevojshme njerëzore e profesionale për planifikimin e territorit, kontrollin e zhvillimit dhe administrimin e regjistrimit.

## Neni 8

### **Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT)**

*(Shtuar shkronja "d" me ligjin nr.10 258, datë 25.3.2010, neni 2)*

1. Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) është organi vendimmarrës përgjegjës për miratimin e instrumenteve kombëtare të planifikimit të territorit, sipas përcaktimeve të këtij ligji. KKT-ja funksionon pranë Këshillit të Ministrave. Kryeministri është Kryetar i KKT-së.

2. KKT-ja ka këto kompetenca:

a) vendos miratimin, miratimin me ndryshime, shtyrjen për shqyrtim të mëvonshëm ose mosmiratimin e instrumenteve kombëtare të planifikimit të territorit, sipas përcaktimeve të kreut IV seksioni I të këtij ligji;

b) vendos miratimin e përcaktimit të rëndësisë kombëtare të një çështjeje në planifikimin e territorit, sipas përcaktimeve të neneve 5 pika 2, 6 e 32 të këtij ligji;

c) shqyrton e miraton përputhshmërinë e instrumentit vendor me instrumentet e planifikimit në fuqi, sipas përcaktimeve të nenit 45 të këtij ligji;

ç) nxit hartimin e planeve territoriale kombëtare e vendore nga autoritetet përkatëse të planifikimit dhe siguron që ato të përmbushin standardet teknike e procedurale, të përcaktuara në këtë ligj;

d) miraton kërkesat për zhvillim dhe lejet e ndërtimit në:

i) zona kombëtare;

ii) prona shtetërore të patransferuara te njësitë e qeverisjes vendore;

iii) oborre që përdoren për shërbime të ofruara nga shteti për arsimin dhe shëndetësinë.

3. Përbërja, numri i anëtarëve dhe masa e shpërblimit të tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Mbledhjet e KKT-së janë të hapura, përveçse kur përcaktohet ndryshe me ligj.

#### Neni 8/1

*(Shtuar neni me ligjin nr.10 258, datë 25.3.2010, neni 3)*

1. Këshilli Kombëtar i Territorit është autoriteti përgjegjës, që ka kompetencë ekskluzive shqyrtimin përfundimtar të planeve zhvillimore dhe rregulluese të bashkive të kategorisë së parë, në territorin e vendit dhe miratimin e tyre.

2. Këshilli Kombëtar i Territorit e ushtron këtë përgjegjësi edhe në territore administrative të tjera, vetëm ku parashikohet zhvillimi i porteve të hapura ndërkombëtare, i centraleve energjetike, digave dhe dambave të larta, si dhe ndërtimeve të tjera me interesa strategjike për vendin.

3. Në kuptim të këtij neni, bashki të kategorisë së parë janë: Tirana, Shkodra, Durrësi, Elbasani, Fieri, Vlora, Saranda, Gjirokastra, Berati, Pogradeci, Korça, Lezha, Lushnja, Kukësi, Peshkopia, Laçi, Kamza dhe Kavaja.

#### Neni 9

#### **Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)**

1. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) është institucion qendror buxhetor publik, në varësi të Këshillit të Ministrave, që ka personalitet juridik dhe ushtron detyrat e përgjegjësitë e saj, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

2. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e AKPT-së, numrin e punonjësve, nivelet e pagave e të shpërblimit dhe marrëdhëniet e tyre të punës miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Struktura dhe organika e AKPT-së përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

4. Veprimtaria e AKPT-së drejtohet nga titullari, i cili emërohet, lirohet ose shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 10

#### **Përgjegjësitë e AKPT-së**

APKT-ja ka këto përgjegjësi:

a) mbështet bashkërendimin horizontal ndërmjet autoriteteve kombëtare në planifikimin e territorit, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësisë kombëtare të fushave e sektorëve të ndryshëm, duke mbledhur autoritetet përgjegjëse e palët e interesuara dhe duke asistuar në zgjidhjen e konflikteve ndërmjet tyre;

b) mbështet bashkërendimin vertikal ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe atyre vendore të planifikimit, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësisë kombëtare e vendore në fushën e planifikimit të territorit, duke mbledhur autoritetet përgjegjëse e palët e interesuara dhe duke asistuar në zgjidhjen e konflikteve ndërmjet autoriteteve kombëtare e vendore dhe palëve të interesuara;

c) përgatit e propozon, nëpërmjet Kryeministrit, aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, që lidhen me planifikimin e territorit;

ç) u ofron mbështetje teknike njësiteve të qeverisjes vendore për hartimin e politikave dhe të akteve për planifikimin dhe menaxhimin urban, si dhe kontrollin e zhvillimit;

d) mbështet zhvillimin e cilësive profesionale e teknike të autoriteteve kombëtare e vendore të planifikimit, nëpërmjet trajnimit dhe ndihmës së drejtpërdrejtë;

dh) kryen studime dhe vlerësime për zhvillimet në territor dhe, mbi këtë bazë, i sugjeron Këshillit të Ministrave përmirësimin e sistemit ligjor për planifikimin e territorit e instrumentet e kontrollit të zhvillimit ose nevojën e ndërmarrjes së proceseve planifikuese apo të masave të tjera të nevojshme;

e) informon publikun për proceset e planifikimit, ofron informacion dhe këshillon autoritetet e planifikimit për procedurat dhe rregullat e një procesi planifikimi të territorit;

ë) përgatit e boton manuale metodologjike për planifikimin e territorit, si dhe përgatit e ofron programe trajnimi për përgatitjen e dokumenteve të planifikimit;

f) harton dhe shpërndan standardet teknike të ngritjes dhe administrimit të regjistrit, sipas përcaktimeve të kreut V të këtij ligji;

g) mbështet autoritetet e planifikimit për mënyrën e regjistrimit dhe të administrimit në mënyrë të pavarur të të dhënave në regjistër dhe këshillon autoritetet e planifikimit për shpërndarjen efektive të tyre te palët e interesuara dhe procedurat e këshillimit;

gj) mbështet bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e planifikimit të territorit;

h) bashkëpunon me ministritë përgjegjëse për hartimin e përmirësimin e legjisllacionit, duke siguruar instrumentet e duhura institucionale dhe ligjore, për të nxitur financimin e infrastrukturës;

i) mbështet Kryetarin e KKT-së në organizimin e mbledhjeve dhe përgatit dokumentacionin që shqyrtohet në to;

j) ushtron përgjegjësi të tjera, të parashikuara shprehimisht në këtë ligj, në ligje të tjera e në aktet nënligjore.

## Neni 11

### **Ministritë dhe organet e tjera publike qendrore**

Ministritë dhe organet e tjera publike qendrore, të përcaktuara sipas shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, sipas përcaktimeve në këtë ligj dhe sipas rastit e kompetencës:

a) hartojnë instrumentet kombëtare të planifikimit;

b) hartojnë rregullore ndërtimi, për të garantuar sigurinë e cilësinë e jetës dhe të shëndetit publik;

c) marrin masa për zbatimin e instrumenteve kombëtare të planifikimit;

ç) mbështesin hartimin e planeve territoriale vendore nga autoritetet përkatëse dhe sigurojnë që ato të përmbushin standardet teknike e procedurale, të përcaktuara në këtë ligj;

d) nxisin drejtimin e zhvillimit dhe udhëheqin autoritetet vendore për procedurat dhe metodologjitë e planifikimit të territorit;

dh) inspektojnë zhvillimet konkrete në territor dhe marrin masa parandaluese e ndëshkuese;

e) regjistrojnë të dhënat e përgjithshme e individuale në regjistër, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

ë) zhvillojnë e nxisin veprimtarinë profesionale në fushën e planifikimit të territorit;

f) bashkëpunojnë me autoritetet e planifikimit të çdo niveli, sipas këtij ligji e raportojnë rregullisht, sipas hierarkisë;

g) informojnë publikun për të gjithë procesin planifikues e zhvillimet në territor dhe sigurojnë akses të plotë e të lehtë në të dhënat e regjistrit dhe format e burimet e tjera tradicionale, që janë të lidhura me këtë proces;

gj) sigurojnë zbatimin e legjisllacionit për mbrojtjen e qëndrueshme të mjedisit dhe studimet për vlerësimin strategjik mjedisor, kur ndërmarrin veprimtari të planifikimit kombëtar;

h) sigurojnë e zhvillojnë burimet e nevojshme njerëzore e profesionale për planifikimin e territorit, kontrollin e zhvillimit, menaxhimin e tokës e të mjedisit dhe administrimin e regjistrit.



SEKSIONI II  
AUTORITETET VENDORE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE PËRGJEGJËSITË  
E TYRE

Neni 12

**Autoritetet vendore të planifikimit**

1. Autoritetet vendore të planifikimit janë:
  - a) bashkia/komuna;
  - b) qarku;
  - c) organet, që janë në varësi të bashkisë/komunës/qarkut, kur këtyre u janë deleguar apo nëndeleguar detyra e përgjegjësi të caktuara për planifikimin e territorit.
2. Çdo bashki, komunë e qark cakton organe përgjegjëse për ushtrimin e veprimtarive të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit të territorit, sipas legjislacionit në fuqi dhe dispozitave të këtij ligji.
3. Autoritetet vendore të planifikimit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në të gjithë territorin e tyre administrativ.

Neni 13

**Funksionet, kompetencat e përgjegjësitë e bashkisë/komunës në planifikimin vendor**

1. Bashkitë dhe komunat ushtrojnë funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë përkatëse, që burojnë nga ligji nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe zbatojnë instrumentet kombëtare të planifikimit, si funksion i deleguar, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.
2. Bashkia dhe komuna, sipas shtrirjes së domosdoshme për zhvillimin e efektshëm, të frytshëm dhe të drejtë të territorit nën juridiksionin e tyre:
  - a) udhëheqin e orientojnë, në territorin e tyre administrativ, zhvillimin dhe mbrojtjen e territorit, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të instrumenteve vendore të planifikimit dhe integritit/përputhshmërisë së tyre me instrumentet kombëtare të planifikimit;
  - b) përcaktojnë standarde e kushte të hollësishme në rregulloret vendore të kontrollit të zhvillimit;
  - c) ushtrojnë kontrollin e zhvillimit për zbatimin e instrumenteve kombëtare e vendore të planifikimit në territorin e tyre administrativ dhe marrin masat e nevojshme, sipas ligjit, për të shmangur shkeljet mjedisore, të shëndetit e sigurisë publike e abuzimet në territor;
  - ç) administrojnë dhe marrin masa për një politikë aktive të menaxhimit të tokës dhe të zhvillimit në të, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
  - d) regjistrojnë të dhënat e përgjithshme e individuale, sipas mjeteve tradicionale të informimit dhe në regjistrin e planifikimit të territorit, sipas përcaktimeve të këtij ligji për territorin e tyre administrativ;
  - dh) zhvillojnë e nxisin veprimtarinë profesionale në fushën e planifikimit të territorit;
  - e) drejojnë e nxisin programe të ndërgjegjësimit e edukimit publik për përgjegjësinë e qytetarëve në mbajtjen pastër të mjedisit;
  - ë) bashkëpunojnë me autoritetet e planifikimit të çdo niveli, sipas këtij ligji e raportojnë rregullisht për gjendjen e planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit të territorit, nëpërmjet regjistrit dhe metodave tradicionale të informimit publik;
  - f) informojnë publikun për të gjithë procesin planifikues e zhvillimet në territor dhe sigurojnë akses të plotë e të lehtë në të dhënat e lidhura me këtë proces;
  - g) sigurojnë e zhvillojnë burimet e nevojshme njerëzore e profesionale për planifikimin e territorit, kontrollin e zhvillimit, përmirësimin e mjedisit dhe administrimin e regjistrit.

#### Neni 14

### **Funksionet, kompetencat e përgjegjësitë e qarqeve në planifikimin vendor**

1. Qarku ushtron funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë përkatëse, që burojnë nga ligji nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

2. Qarku harton dhe miraton instrumente të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit në nivel qarku, për ndërtimin dhe zbatimin e politikave rajonale.

3. Qarku ushtron përgjegjësitë e planifikimit të qëndrueshëm, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi, në mënyrën dhe shtrirjen që i është deleguar apo kontraktuar nga autoritetet kombëtare të planifikimit ose nga një apo disa njësi të qeverisjes vendore, pjesë përbërëse e territorit të tij administrativ.

4. Qarku, në ushtrimin e përgjegjësiave, sipas këtij neni, zbaton, sipas rastit, detyrimet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 13 të këtij ligji.

5. Aktet e planifikimit të qarkut respektojnë instrumentet kombëtare, të detyrueshme dhe nuk mund të cenojnë autonominë e bashkive e të komunave.

6. Veprimtaritë e planifikimit të qarkut synojnë të sigurojnë qëndrueshmëri dhe përputhshmëri të veprimeve ndërmjet komunave e bashkive, që ndodhen në territorin e qarkut dhe ndërmjet qarqeve, në rastet e efekteve ndërvendore.

#### SEKSIONI III

### **BASHKËPUNIMI, BASHKËRENDIMI DHE NDËRMJETËSIMI NDËRMJET AUTORITETEVE TË PLANIFIKIMIT**

#### Neni 15

### **Delegimi e nëndelegimi i përgjegjësiave dhe kontraktimi**

1. Autoritetet kombëtare dhe vendore të planifikimit mund t’u delegojnë ose nëndelegojnë organeve në varësi përgjegjësi të caktuara për planifikimin e territorit.

2. Autoritetet kombëtare mund t’u delegojnë, me marrëveshje, autoriteteve vendore të planifikimit përgjegjësi të caktuara për planifikimin e territorit.

3. Autoritetet kombëtare dhe vendore mund të kontraktojnë kryerjen e shërbimeve të ndryshme për planifikimin e kontrollin e territorit.

#### Neni 16

### **Subjekti i kompetencave të përbashkëta**

1. Autoritetet kombëtare dhe/ose vendore të planifikimit të territorit mund të krijojnë, sipas nevojës, subjekte të kompetencave të përbashkëta, të përkohshme apo të përhershme, me detyra dhe/ose përgjegjësi të paracaktuara, në mbështetje të objektivave të planifikimit të territorit.

2. Subjekti i kompetencave të përbashkëta krijohet në bazë të së drejtës së delegimit ose nëndelegimit të kompetencave dhe sipas një marrëveshjeje specifike, të lidhur ndërmjet autoriteteve deleguese.

3. Marrëveshja për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta përcakton, të paktën:

a) qëllimin dhe objektin e krijimit;

b) juridiksionin, kompetencat specifike të deleguara dhe aktet që mund të nxjerrë ose të zbatojë;

c) përbërjen e organeve me të drejta vendimmarrëse dhe rregullat e vendimmarrjes;

ç) kohëzgjatjen;

d) burimet dhe mbështetjen, që do të jepen për subjektin nga secila palë në marrëveshje;

dh) mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet autoriteteve deleguese.

Neni 17  
**Bashkërendimi**

1. Në ushtrimin e funksioneve, të kompetencave e përgjegjësive të tyre, sipas këtij ligji e ligjeve të tjera në fuqi, autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të territorit:

a) bashkërendojnë hartimin, miratimin, përditësimin dhe zbatimin e instrumenteve të planifikimit të territorit;

b) marrin parasysh, gjatë hartimit e miratimit të instrumenteve të planifikimit në territorin e tyre administrativ, instrumentet e miratuara ose në proces miratimi të autoriteteve të tjera të planifikimit, kur ekzistojnë lidhje apo mbivendosje ndërmjet tyre;

c) kujdesen që t'u lënë autoriteteve, që varen prej tyre, lirinë e domosdoshme të vlerësimit, për përmbushjen e përgjegjësive të tyre në këtë fushë.

2. Çështjet kombëtare dhe ato vendore në procesin e planifikimit të territorit trajtohen, rregullohen dhe zgjidhen në përputhje dhe bashkërendim ndërmjet tyre, nëpërmjet këshillimit e ndërmjetësimit, duke mundësuar zgjidhjen më të përshtatshme e të mundshme të secilës çështje.

Neni 18  
**Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve në fushën e planifikimit  
dhe të kontrollit të zhvillimit të territorit**

1. Autoritetet vendore të planifikimit sigurojnë mbështetje të ndërsjellë dhe bashkëpunojnë me autoritetet kombëtare të planifikimit dhe ato vendore në kufij administrativë, për të shmangur veprimet e masat konfliktuale dhe për të siguruar rezultate të përputhshme me dispozitat e këtij ligji.

2. Kushtëzimi, kufizimi apo cenimi i një çështjeje të rëndësisë vendore në planifikimin e territorit bëhet vetëm për shkak të nevojës së trajtimit më të përshtatshëm të një çështjeje të rëndësisë kombëtare dhe vetëm në përputhje me nevojën apo situatën diktuese.

3. Autoritetet kombëtare dhe ato vendore të planifikimit të njësive vendore, që kufizohen me kufirin shtetëror, bashkëpunojnë me autoritetet e të njëjtit nivel të shteteve kufitare, kur masat që merren në fushën e planifikimit të territorit mund të kenë efekte të njëanshme ose të dyanshme brenda ose përtej kufirit.

Neni 19  
**Procedura e ndërmjetësimit**

1. Ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në zbatim të këtij ligji kryhet, sipas rastit, ndërmjet autoriteteve vendore të nivelit komunal, bashkiak, të qarkut ose çdo autoriteti vendor e kombëtar të përfshirë në to. Procedura e ndërmjetësimit fillon para çdo vendimmarrjeje që mund të përbëjë burim të mëtejshëm konflikti, kur dy apo më shumë autoritete përgjegjëse, me gjithë bashkërendimin e veprimeve ndërmjet tyre, kanë qëndrime kontradiktore thelbësore, që kanë efekte në planifikimin e territorit.

2. Secili nga autoritetet përgjegjëse të planifikimit ose ai që preket drejtpërdrejt nga vendimmarrja e një autoriteti tjetër të planifikimit ose mungesa e saj, i kërkon prefektit fillimin e zbatimit të procedurës për ngritjen e komisionit të ndërmjetësimit, sipas këtij neni, pas përpjekjeve, shqyrtimit e bashkërendimit paraprak, në grupe pune, me ekspertë të përbashkët.

3. Ndërmjetësimi kryhet nëpërmjet një komisioni ndërmjetësimi, të propozuar nga secila palë e përfshirë në mosmarrëveshje, i cili përbëhet në mënyrë të barabartë, si më poshtë:

a) në mosmarrëveshjen e nivelit komunal e bashkiak, nga përfaqësues të bashkive dhe/ose komunave të përfshira, të këshillit të qarkut dhe të prefektit;

b) në mosmarrëveshjen e nivelit të qarkut, nga përfaqësues të qarqeve të përfshira dhe të prefektëve;

c) në mosmarrëveshjen ndërmjet çdo autoriteti vendor dhe kombëtar të planifikimit, nga përfaqësues të autoriteteve të përfshira, të prefektit përkatës dhe të përfaqësuesit të AKPT-së, nëse ky institucion nuk ka qenë pjesë e mosmarrëveshjes apo nuk është shprehur më parë për të.

4. Prefekti thërret e drejton mbledhjen e komisionit të ndërmjetësimit deri në zgjedhjen e kryetarit. Anëtarët e komisioneve të ndërmjetësimit, sipas shkronjave “a”, “b” e “c” të pikës 3 të këtij neni, zgjedhin një kryetar e sekretar dhe funksionimi i këtyre komisioneve bëhet sipas ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”. Anëtarët e komisionit mund të asistohen në kushte të barabarta nga ekspertë të fushës, të cilët nuk kanë të drejtë vote. Komisioni dëgjon, me kërkesë, mendimet e propozimet e palëve të tjera të interesuara.

5. Komisioni i ndërmjetësimit, brenda 2 muajve nga krijimi i tij, formulon propozime zgjidhjeje e rekomandime. Zgjidhjet apo rekomandimet e komisionit të ndërmjetësimit botohen në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit. Vendimmarrja, që lidhet me çështjet objekt mosmarrëveshjeje, pezullohet gjatë afatit të mësipërm. Gjatë kësaj periudhe, janë të zbatueshme procedurat dhe rregullat për miratimin e pezullimit të zhvillimit, sipas neneve 64 e 70 të këtij ligji.

6. Mosgjethja e zgjidhjes dhe vendimmarrja e njëanshme, e kryer pas procedurës së ndërmjetësimit, përbën shkak për ankim në gjykatë, sipas afateve të përcaktuara me ligj dhe, sipas rastit, marrjen e masave, sipas parashikimeve të ligjit, kur vërehen shkelje të tij. Ankimi në gjykatë, për atë që nuk përcaktohet ndryshe me ligj, nuk ka efekt pezullimi të vendimmarrjes së mëtejshme.

### KREU III INSTRUMENTET E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

#### SEKSIONI I LLOJET E INSTRUMENTEVE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

##### Neni 20 **Politikat**

1. Politikat janë shprehja më e lartë e planifikimit të territorit, që pasqyrojnë përparësi e qëllime strategjike, objektiva, mjete e rezultate të pritshme, për të orientuar, drejtuar dhe nxitur proceset e mëtejshme të planifikimit të territorit.

2. Dokumentet e politikës përmbajnë:

- a) premiset bazë dhe objektivat e planifikimit e të zhvillimit përkatës të territorit, në përputhje me zhvillimin ekonomik, demografik, shoqëror, mjedisor, kulturor e historik;
- b) përparësitë dhe drejtimet kryesore të planifikimit të territorit, që mundësojnë realizimin e objektivave të përcaktuara, si dhe mjetet e mënyrat e bashkëpunimit ndërterritorial;
- c) masat zbatuese, planin e veprimit dhe buxhetin e nevojshëm për zbatimin e saj.

##### Neni 21 **Planet**

1. Planet mbështeten në politikat e miratuara dhe i vënë ato në zbatim në një territor të caktuar gjatë një periudhe të përcaktuar kohore.

2. Planet, në përputhje me territorin objekt të planifikimit, përmbajnë elementet e mëposhtme:

- a) kufijtë e territorit që përfshijnë;
- b) vizionin, synimet dhe objektivat kryesorë të përdorimit të territorit;
- c) bazën e të dhënave, analizën e gjendjes ekzistuese dhe parashikimet për zhvillimin demografik, punësimin dhe komoditetet e domosdoshme për t'i mbështetur ato;
- ç) studimin e vlerësimit strategjik mjedisor;
- d) relacionin shpjegues, të arsyetuar e të bazuar ligjërisht dhe rregullat e detyrueshme, të propozuara nga instrumenti i planifikimit, si dhe të drejtat apo kufizimet ligjore, private apo publike, që rrjedhin prej tyre;
- dh) programet strategjike të investimeve publike, përfshirë kërkesat financiare të nevojshme për shpenzimet kapitale, të funksionimit e të mirëmbajtjes dhe strategjitë e programet financiare, për

të siguruar burime të nevojshme për blerjen dhe funksionimin e komoditeteve;

e) shpërndarjen territoriale të përdorimeve ekzistuese e të ardhshme të tokës, zonave apo strukturave, sipas problematikës së trajtuar në plan;

ë) programin e rehabilitimit të personave të zhvendosur, si pasojë e zbatimit të planit.

#### Neni 22

### **Rregulloret e planifikimit**

Rregulloret e planifikimit janë:

a) rregulloret e përdorimit të tokës, që përcaktojnë kategoritë e lejuara, të kushtëzuara apo të ndaluara të përdorimit të tokës ose të strukturave, brenda një zone, përfshirë llojet e punimeve e të veprimtarive, që lejohen, kufizohen dhe/ose ndalohen dhe kushtet, normat e rregullat e tjera të detyrueshme ose orientuese, që plotësohen për përdorimin e tokës, përfshirë kategoritë e përdorimeve të papërputhshme, si dhe të drejtat apo kufizimet ligjore, private ose publike, që rrjedhin prej tyre;

b) rregulloret, që specifikojnë intensitetin e zhvillimit, përfshirë densitetin e banimit, raportin e sipërfaqes për kat, pengesat, kufizimet e lartësisë dhe kritere të tjera, si dhe të drejtat apo kufizimet ligjore, private apo publike, që rrjedhin prej tyre;

c) rregulloret e nënndarjes e të bashkimit të parcelave, që përcaktojnë kushtet për bashkimin dhe nënndarjen e parcelave, mbështetjen e zhvillimit dhe të interesave në parcela, për të siguruar shërbimet publike dhe rrugët, përmasat minimale të parcelave dhe metodat për shpërndarjen e alokimit e kostos, në vlerë apo në natyrë, për infrastrukturën e nevojshme, shpërndarjen e kostos së ndikimit në infrastrukturën publike, sipas zonës dhe llojit të zhvillimeve, në përputhje me legjislacionin e fushës;

ç) rregulloret e tjera të zbatimit të politikave të tokës për zhvillim të qëndrueshëm.

#### Neni 23

### **Klasifikimi i instrumenteve të planifikimit**

Instrumentet e planifikimit ndahen, në përputhje me objektin e tyre, në:

a) të përgjithshme, që trajtojnë shumë çështje e sektorë me lidhje komplekse e të përgjithshme ndërmjet tyre, sipas territorit e rëndësisë;

b) ndërsektoriale, që trajtojnë çështje të dy apo më shumë sektorëve të tillë, si, por jo vetëm, transporti, furnizimi me ujë, kullimi, turizmi e çështje të tjera, me ndërthurje tematike dhe/ose territoriale ndërmjet tyre;

c) sektoriale, që trajtojnë çështje të një sektori të caktuar ose fushe të përgjegjësisë së autoriteteve vendore dhe kombëtare.

#### Neni 24

### **Unifikimi i strukturës dhe formës së instrumenteve të planifikimit**

Këshilli i Ministrave miraton rregullore uniforme për instrumentet e planifikimit, për realizimin e uniformitetit e të njëtrajtshmërisë së formës e të strukturës, sipas llojit, klasifikimit e nivelit të tyre. Këto rregullore nuk përcaktojnë apo kufizojnë politika për autoritetet e planifikimit. Bashkërendimi, këshillimi, dëgjimi publik dhe botimi në regjistër i tyre kryhen nga AKPT-ja, sipas dispozitave të neneve 36 e 37 të këtij ligji.

## SEKSIONI II RREGULLORET E NDËRTIMIT

### Neni 25 **Rregulloret e ndërtimit**

Rregulloret e ndërtimit përcaktojnë normat dhe kushtet teknike bazë, të detyrueshme të projektimit, zbatimit të punimeve, përdorimit, mirëmbajtjes, prishjes dhe heqjes së strukturave dhe zhvillimin e infrastrukturës publike, materialet, cilësinë dhe përdorimin e tyre, me qëllim garantimin e sigurisë dhe të cilësisë së jetës e të shëndetit, konservimin e energjisë, mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimin e rregullave për përshtatjen e strukturave e të territoreve për individët me aftësi të kufizuar, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe legjislacionit të fushës në fuqi.

## SEKSIONI III NIVELET E INSTRUMENTEVE TË PLANIFIKIMIT

### Neni 26 **Planifikimi kombëtar**

1. Instrumentet kombëtare të planifikimit përcaktojnë ose orientojnë zhvillimin e ardhshëm, në të gjithë territorin kombëtar ose në një pjesë të tij, kushtet e zhvillimit të strukturave, të përfshira në to dhe vendndodhjen e përbërësve kryesorë të infrastrukturës publike kombëtare.

2. Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) zbatohet në të gjithë territorin kombëtar. Hartimi dhe miratimi i tij mbështeten në planet kombëtare, ndërsektoriale dhe sektoriale, në rastet kur këto janë miratuar më parë.

3. Planet kombëtare të llojeve të tjera, sipas përcaktimeve në këtë ligj, hartohen e miratohen në përputhje me PPK-në.

4. Objektivat e planifikimit kombëtar janë:

A) përcaktimi i parimeve dhe i drejtimeve për një zhvillim të qëndrueshëm e të balancuar të territorit;

b) krijimi i kushteve territoriale për zhvillimin rajonal;

c) drejtimi i krijimit dhe zhvillimit të infrastrukturës publike kombëtare;

ç) krijimi i kushteve për ruajtjen e ekosistemeve, biodiversiteteve, burimeve natyrore mbi e nën tokë dhe të pasurisë natyrore e kulturore, balancimin e efekteve të sistemeve të banimit dhe veprimtarive ekonomike dhe mbrojtjen e zhvillimin e sipërfaqeve të gjelbra e sipërfaqeve të tjera të kultivueshme;

d) orientimi i objektivave për planifikimin ndërvendor e vendor.

### Neni 27 **Planifikimi vendor**

1. Instrumentet vendore të planifikimit përcaktojnë zhvillimin e ardhshëm në të gjithë ose në një pjesë të territorit vendor, kushtet e zhvillimit të strukturave të përfshira në to dhe vendndodhjen e përbërësve kryesorë të infrastrukturës publike, për trajtimin e çështjeve të rëndësishme, vendore e kombëtare, të deleguara.

2. Instrumentet vendore të planifikimit të territorit hartohen dhe miratohen, në përputhje me instrumentet kombëtare të planifikimit të territorit, si dhe me instrumentet e planifikimit të njësisë kufizuese të qeverisjes vendore, për çështje të rëndësishme së përbashkët.

3. Instrumentet vendore të planifikimit mund të përfshijnë territoret me përdorim rural dhe mund të përcaktojnë politika, që udhëzojnë ose drejtojnë mbrojtjen e zhvillimin e tyre. Këto politika janë në përputhje me ato që miratohen nga autoritetet përgjegjëse kombëtare, për ruajtjen dhe zhvillimin e tokës bujqësore dhe të trashëgimisë kulturore.

4. Objektivat e planifikimit vendor janë:
- a) përcaktimi i parimeve dhe i drejtimeve të zhvillimit të territorit në nivel vendor;
  - b) balancimi i nevojave dhe interesave kombëtarë e vendorë për zhvillimet në territor;
  - c) krijimi i kushteve për një zhvillim, të qëndrueshëm e të balancuar, në territor, duke marrë parasysh, në mënyrë proporcionale, nevojat e zhvillimit ekonomik, social, kulturor dhe karakteristikat, kapacitetet e vlerat natyrore e mjedisore në përgatitjen e instrumenteve të planifikimit;
  - ç) drejtimi i zhvillimit të sistemeve të banimit e sistemeve të tjera të ndërtueshme dhe drejtimi i territoreve/zonave urbane;
  - d) përcaktimi i intensitetit e shtrirjes së ndërtimit;
  - dh) planifikimi i masave për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen, zhvillimin dhe përdorimin më të mirë të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme, peizazheve dhe hapësirave të gjelbra;
  - e) përcaktimi i rregullave të përgjithshme për përdorimin e tokës dhe të zonave ujore;
  - ë) përcaktimi i vendndodhjes së rrugëve, linjave hekurudhore, burimeve ujore, aeroporteve, porteve, transmetimit të energjisë, vendeve për trajtimin e mbetjeve dhe të infrastrukturës tjetër publike e servituteve publike;
  - f) identifikimi i zonave natyrore të mbrojtura;
  - g) mbrojtja e zonave natyrore dhe rregullat për përdorimin e tyre dhe, kur është e domosdoshme, bërja e propozimeve për përmirësimin e tyre, përcaktimin e zonave të reja të mbrojtura ose përfundimin e regjimit të mbrojtjes, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
  - gj) përcaktimi i zonave çlodhëse e zbatimëse dhe përcaktimi i rregullave për përdorimin e tyre;
  - h) krijimi i kushteve normale e të arritshme të jetesës dhe i territoreve të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar.

#### Neni 28

#### **Planifikimi ndërvendor**

Instrumentet ndërvendore të planifikimit synojnë nxitjen e bashkërendimit ndërmjet njërive të qeverisjes vendore dhe përcaktojnë zhvillimin e ardhshëm në të gjithë ose në një pjesë të territorit të dy apo më shumë njërive të qeverisjes vendore për realizimin e objektivave të caktuar vendorë, të rëndësisë ose interesit të përbashkët.

#### Neni 29

#### **Planifikimi i integruar**

Instrumentet e planifikimit të integruar përcaktojnë zhvillimin e ardhshëm, për realizimin e zhvillimit të balancuar e të integruar ndërmjet nivelit vendor dhe kombëtar dhe krijimit të objektivave të rëndësisë dhe interesit të përbashkët të një apo më shumë autoriteteve kombëtare dhe vendore të planifikimit. Këto instrumente përdoren për zonat bregdetare, të trashëgimisë kulturore, natyrore, mjedisore e peizazhit, si dhe në zona të tjera të rëndësisë ose interesit të përbashkët.

### SEKSIONI IV

### KOHËZGJATJA E INSTRUMENTEVE TË PLANIFIKIMIT

#### Neni 30

#### **Kohëzgjatja e instrumenteve të planifikimit**

1. Planet territoriale dhe/ose rregulloret e planifikimit janë objekt ndryshimi, kur është e domosdoshme dhe në çdo rast objekt rishqyrtimi të plotë çdo 10 vjet. Sipas rastit, ato ribëhen sipas së njëjtës procedurë të ndjekur për miratimin e tyre. Procesi për shqyrtimin e plotë të tyre fillon 2 vjet para përfundimit të afatit të mësipërm. Rregulloret e ndërtimit përditësohen periodikisht, për të

pasqyruar teknologjitë, praktikat dhe mundësitë e reja, që rrisin sigurinë dhe cilësinë e jetës dhe të shëndetit.

2. Rregulloret model të planifikimit përgatiten nga AKPT-ja, për t'u përdorur nga autoritetet vendore të planifikimit, të cilat nuk kanë miratuar ose nuk përdorin plane territoriale vendore.

3. Pas kalimit të afatit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, rregulloret model të planifikimit janë të zbatueshme deri në datën e miratimit të instrumentit vendor të ndryshuar ose të rishqyrtuar të planifikimit.

4. Instrumentet e planifikimit, në kuptim të këtij ligji, ndryshohen në rastet kur:

a) ka zhvillime të paparashikuara demografike, si rezultat i ndryshimeve gjeopolitike dhe gjeostrategjike, si dhe zbulime shkencore në sipërfaqe ose në burimet minerare nëntokësore apo substancat e gazit, që e bëjnë të nevojshëm planifikimin e kontrolluar në vendosjen e rrjeteve të qendrave të reja urbane në zona tashmë të planifikuara si rurale ose natyrore, në kuadër të Planit të Përgjithshëm Kombëtar;

b) ndodhin zhvillime të paparashikuara, për shkak të një force madhore, si: tërmete, vullkane, përmbytje, rrëshqitje masive të tokës, aksidente me origjinë njerëzore të paparashikuara, ndotje kimike dhe detare e zhvillime të tjera të ngjashme, të cilat, sipas të dhënave shkencore, ndryshojnë realisht ekosistemin e territorit të prekur, destinacionin e tij dhe vënë në rrezik jetën, shëndetin dhe pasuritë e banorëve ose të shtetit;

c) zhvillime ekonomike e sociale të paparashikuara ose kriza globale të përgjithshme apo sektoriale të veçanta ndryshojnë faktikisht prirjen e investimeve të planifikuara në një ose më shumë sektorë, duke vënë në rrezik ekonominë e vendit ose sektorët e tij strategjikë.

## KREU IV PROCESI I PLANIFIKIMIT

### Neni 31

#### **Procedurat administrative dhe afatet**

1. Për aq sa nuk është përcaktuar ndryshe në këtë ligj, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe/ose të ligjeve në fuqi për procedurat administrative të vendimmarrjes.

2. Afatet e përcaktuara në këtë ligj llogariten si më poshtë:

a) kur afati është caktuar me ditë, përjashtohet dita kur është nxjerrë apo njoftuar akti, nga i cili duhet të fillojë afati;

b) afati, që është caktuar në muaj ose në vite, mbaron me kalimin e asaj dite të muajit të fundit, që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji;

c) kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi ose në një ditë kur administrata, që do të zbatojë aktin, është e mbyllur apo funksionon me orare të reduktuara, afati mbaron në ditën pasardhëse të punës.

## SEKSIONI I PLANIFIKIMI KOMBËTAR

### Neni 32

#### **Përcaktimi i rëndësisë kombëtare të një çështjeje në planifikimin e territorit**

1. KKT-ja, me propozimin e AKPT-së, përcakton një çështje si të rëndësisë kombëtare në planifikim, në përputhje me këtë nen, me nenin 6 dhe me dispozitat e këtij ligji.

2. AKPT-ja, kryesisht ose me kërkesë të një ministrie apo të një organi tjetër qendror ose vendor, ndërmerr nismën për përcaktimin e rëndësisë kombëtare të çështjes. Projektakti botohet në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit dhe përmban:



- a) llojin, tiparet dhe veçoritë, që karakterizojnë çështjen konkrete të rëndësisë kombëtare dhe kufijtë apo vendin në territor që lidhen me të;
  - b) bazën ligjore, ku bazohet ky përcaktim;
  - c) synimet dhe objektivat, që kërkohen të arrihen dhe arsyet e rrethanat ekonomike e teknike, që e bëjnë të domosdoshëm këtë përcaktim;
  - ç) pezullimin e zhvillimit, sipas neneve 64 e 70 të këtij ligji, kur vlerësohet se ka një rrezik të qartë ose të mundshëm ndaj vlerave, karakteristikave apo funksioneve kombëtare të objektit apo të zonës;
  - d) autoritetin e planifikimit, që ngarkohet me përgjegjësinë e hartimit të instrumentit të planifikimit dhe afatet;
  - dh) autoritetin, ku do të depozitohen vërejtjet dhe propozimet e palëve të interesuara, përshkrimin e procesit të programeve të këshillimeve dhe afatet.
3. Në rastet kur ka një rrezik të qartë e emergjent ndaj interesave, karakteristikave apo funksioneve kombëtare të objektit apo të zonës, për të cilin propozohet përcaktimi si i rëndësisë kombëtare në planifikim, AKPT-ja vendos pezullimin e zhvillimit, sipas nenit 64 të këtij ligji, deri në miratimin e përcaktimit të çështjes. Vendimi për pezullimin e zhvillimit botohet në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit.
4. Bashkërendimi, këshillimi dhe pjesëmarrja e palëve të interesuara kryhen sipas procedurës së thjeshtuar, të përcaktuar në nenin 50 të këtij ligji.
5. Gjatë procesit të përcaktimit të çështjeve të rëndësisë kombëtare, AKPT-ja, së bashku me autoritetin përgjegjës, kryen një proces dëgjimi publik, për të kërkuar vërejtjet apo propozimet nga të gjitha palët e interesuara. Në mbështetje të vërejtjeve apo propozimeve të marra, AKPT-ja, së bashku me ministrinë përgjegjëse të linjës, ndryshon projektaktin ose jep arsyet e argumentuara të moskryerjes së një ndryshimi të tillë. Projektakti, së bashku me ndryshimet dhe/ose argumentimin e moskryerjes së ndryshimit, përcillet nga AKPT-ja për miratim në KKT brenda 30 ditëve nga data e organizimit të dëgjimit publik.
6. Brenda 10 ditëve nga marrja e tij, vendimi përkatës i KKT-së botohet në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit.

### Neni 33

#### **Nisma për hartimin e instrumentit kombëtar të planifikimit dhe rregulloreve të ndërtimit**

1. Nisma për hartimin e instrumentit kombëtar sektorial të planifikimit merret e miratohet nga ministri përgjegjës për çështjen/çështjet kombëtare të sektorit në fjalë.
2. Nisma për hartimin e rregulloreve të ndërtimit, të përcaktuara në nenin 25 të këtij ligji, merret nga ministri përgjegjës për çështjet e ndërtimit. Rregulloret e ndërtimit hartohen, bashkërendohen e këshillohen në përputhje me përcaktimet në legjisllacionin për ndërtimin dhe me procedurat e parashikuara në këtë seksion, për instrumentet kombëtare sektoriale të planifikimit dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave. Bashkërendimi, këshillimi i tyre dhe pjesëmarrja e palëve të interesuara kryhen sipas procedurës së përcaktuar në nenet 36 e 37 të këtij ligji.
3. Nisma për hartimin e instrumentit kombëtar ndërsektorial e të përgjithshëm të planifikimit miratohet nga KKT-ja.
4. Çdo autoritet tjetër i planifikimit ose palë e interesuar mund t'i kërkojë, veçmas ose së bashku, autoritetit përgjegjës marrjen e nismës për hartimin e instrumentit kombëtar të planifikimit, sipas pikave të mësipërme të këtij neni.
5. Autoriteti kombëtar përgjegjës i planifikimit ose palët e interesuara hartojnë një studim, që përcakton faktet dhe analizon problemet për instrumentin kombëtar të planifikimit për t'u hartuar. Ndërmarrja e çdo nisme shoqërohet me njoftimin e palëve të interesuara dhe të dhënat për nismën, studimin e planin e veprimeve botohen në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit.
6. Përcaktimet e pikave të mësipërme të këtij neni zbatohen edhe për kërkesa, që lidhen me ndryshimin ose shfuqizimin e një instrumenti kombëtar të planifikimit, në pjesë të caktuara ose në tërësi.

#### Neni 34

### **Hartimi i instrumentit kombëtar sektorial të planifikimit**

1. Instrumenti kombëtar sektorial i planifikimit hartohet nën përgjegjësinë e bashkërendimin e autoritetit përgjegjës të planifikimit dhe në bashkërendim me autoritetet e tjera përgjegjëse në zhvillimin e territorit.

2. Akti për fillimin e hartimit të instrumentit kombëtar sektorial të planifikimit, në rastet kur nuk është marrë sipas shkronjës “d” të pikës 2 të nenit 32 të këtij ligji, merret me urdhër të ministrit përgjegjës, i cili miraton planin përkatës të veprimeve. Këshillimi për instrumentin kombëtar sektorial të planifikimit me të gjitha palët e interesuara kryhet sipas fazave të hartimit të tij.

3. Autoriteti përgjegjës për hartimin e instrumentit kombëtar sektorial të planifikimit siguron një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi, horizontal e vertikal, me çdo autoritet të planifikimit e palë të interesuar, në fillim të procesit dhe gjatë hartimit të instrumentit të planifikimit. Ky autoritet këshillohet me AKPT-në e palët e interesuara dhe i vë në dijeni periodikisht ato për ecurinë e procesit të hartimit. AKPT-ja ndihmon dhe propozon përmirësimet e nevojshme të planit të veprimeve dhe të projektit të instrumentit kombëtar sektorial të planifikimit.

#### Neni 35

### **Hartimi i instrumentit kombëtar ndërsektorial/të përgjithshëm të planifikimit**

1. Instrumentet kombëtare ndërsektoriale të planifikimit hartohen nën drejtimin e përgjegjësinë e grupeve të punës me ekspertë, sipas nenit 12 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”. Në përbërje të grupit apo grupeve të punës përfshihen përfaqësues të autoriteteve kombëtare të interesuara të planifikimit dhe të AKPT-së.

2. Instrumentet kombëtare të përgjithshme të planifikimit hartohen sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni dhe bashkërendohen nga komiteti ndërministror, i ngritur sipas nenit 11 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”. Komiteti ndërministror përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve kombëtare të planifikimit dhe të AKPT-së.

3. Autoriteti përgjegjës për hartimin e instrumentit kombëtar të planifikimit siguron një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi, horizontal e vertikal, me çdo autoritet të planifikimit e palë të interesuar, në fillim të procesit dhe gjatë hartimit të instrumentit kombëtar të planifikimit. Ky autoritet këshillohet me AKPT-në e palët e interesuara, të cilat i vë në dijeni periodikisht për ecurinë e procesit të hartimit. AKPT-ja ndihmon dhe propozon përmirësimet e nevojshme të planit të veprimeve dhe të projektit të instrumentit kombëtar të planifikimit.

#### Neni 36

### **Bashkërendimi dhe këshillimi**

1. Bashkërendimi e këshillimi i projektit të instrumentit kombëtar të planifikimit, sipas situatave specifike dhe kompleksitetit të tij, zhvillohen sipas fazave të mëposhtme:

- a) këshillimi i idesë ose i pjesëve të veçanta të projektit;
- b) këshillimi në tërësi i projektit.

2. Për sa kohë që nuk përcaktohet ndryshe në këtë ligj, autoriteti përgjegjës për hartimin e instrumentit zgjedh, sipas rastit, nëse do të kryejë bashkërendim dhe këshillim me një apo dy faza.

3. Afatet e shprehjes së qëndrimit nga autoritetet e tjera të planifikimit dhe palët e interesuara fillojnë të nesërmen e datës së botimit në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit të projektit përfundimtar të instrumentit kombëtar të planifikimit nga autoriteti përgjegjës për hartimin e tij dhe janë, si rregull, si më poshtë:

a) 30 ditë, në rastin e bashkërendimit e këshillimit të idesë ose të çdo pjese të veçantë të projektit;

- b) 60 ditë, për bashkërendimin e këshillimin tërësor të projektit.

4. Çdo autoritet i planifikimit, sipas sferës së juridiksionit dhe përgjegjësisë së përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, ose palë e interesuar ka të drejtë të paraqesë vërejtje apo propozime për

projektin e instrumentit kombëtar të planifikimit gjatë periudhës së bashkërendimit e këshillimit të tij. Vërejtjet apo propozimet botohen në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit.

5. Çdo vërejtje e bërë duhet të jetë e argumentuar dhe të shoqërohet me sugjerime të qarta, në mënyrë që t'i japë mundësi autoritetit përgjegjës për hartimin e instrumentit të kuptojë përmbajtjen e saj e të mund të bëjë ndryshimet përkatëse, për trajtimin në mënyrë të arsyeshme të vërejtjes.

6. Mosparaqitja e vërejtjeve apo propozimeve, brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, vlerësohet pranimit i heshtur i projektit të instrumentit kombëtar të planifikimit, përveç rasteve të pamundësisë për shkaqe të përligjura e të pavarura nga subjekti në fjalë, e cila duhet të njoftohet në mënyrë të argumentuar, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative, për rivendosjen në afat.

7. Për qëllimet e bashkërendimit e të këshillimit, autoriteti përgjegjës për hartimin e instrumentit shqyrton vërejtjet apo propozimet e autoriteteve të tjera të planifikimit, palëve të interesuara ose publikut, brenda 30 ditëve nga mbarimi i afateve të përcaktuara në këtë nen.

8. Në rastet kur, si pasojë e procesit të bashkërendimit e të këshillimit, vërejtjet apo propozimet e bëra prekin ndjeshëm elemente thelbësore dhe përmbajtjen bazë të projektit të instrumentit kombëtar të planifikimit, autoriteti përgjegjës për hartimin e instrumentit, kryesisht ose me kërkesë të autoriteteve të planifikimit dhe/ose propozim të palëve të interesuara, kryen një proces të dytë bashkërendimi ose këshillimi, sipas përcaktimeve të këtij neni. Ai shqyrton vërejtjet apo propozimet dhe ndryshon projektin, ose shpreh qëndrimin e tij të argumentuar të mospërfshirjes në projekt të vërejtjeve apo propozimeve para paraqitjes së tij për miratim.

9. Përmbledhja e vërejtjeve apo propozimeve, gjatë procesit të bashkërendimit dhe këshillimit, i bashkëlidhen projektit të instrumentit kombëtar të planifikimit, të paraqitur për miratim dhe botohet së bashku me të në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit.

#### Neni 37

#### **Dëgjimi publik**

1. Autoriteti përgjegjës për hartimin e instrumentit kombëtar të planifikimit organizon, brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit të parashikuar në pikën 3 të nenit 36 të këtij ligji, një ose më shumë seanca dëgjimi publik për secilën nga fazat e bashkërendimit e këshillimit, pas kryerjes së tyre, sipas nenit të lartpërmendur. Dëgjimi publik kryhet para çdo vendimmarrjeje planifikuese dhe përsëritet sipas nevojës për informimin e plotë të palëve të interesuara dhe zgjidhjen e konflikteve. Në ditën e botimit në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit të projektit të instrumentit kombëtar të planifikimit, autoriteti përgjegjës njofton vendin, datën dhe orën e çdo seance të dëgjimit publik. Njoftimi publik kryhet të paktën 30 ditë para një vendimmarrjeje publike e botohet në regjistër dhe në dy gazeta me qarkullim më të madh ose në organe të tjera të medias.

2. Palët e interesuara e publiku kanë të drejtë, gjatë periudhës nga data e njoftimit, sipas pikës 1 të këtij neni, deri në datën e përcaktuar të dëgjimit publik, të kenë akses në materialet e informacionet që lidhen me instrumentin kombëtar të planifikimit, përfshirë përmbledhjen e procesit të bashkërendimit e këshillimit, të kryer sipas nenit 36 të këtij ligji dhe në vërejtjet, propozimet e përfundimet e arritura gjatë këtij procesi. Aksesit i tyre sigurohet, paraprakisht, në kohë të mjaftueshme e në mënyrë efektive nëpërmjet regjistrit, sipas mjeteve tradicionale të informimit dhe në mjediset e autoritetit përgjegjës, gjatë orarit të tij zyrtar.

3. Në rastet kur projekti i instrumentit kombëtar të planifikimit rishikohet nga autoriteti përgjegjës, në bazë të vërejtjeve e propozimeve të bëra gjatë dëgjimit publik, për çështje thelbësore të përmbajtjes së tij, autoriteti përgjegjës i planifikimit organizon një dëgjim publik shtesë, sipas përcaktimeve të mësipërme të këtij neni.

4. Përmbledhja e vërejtjeve apo propozimeve gjatë procesit të dëgjimit publik i bashkëlidhen projektit të instrumentit kombëtar të planifikimit, të paraqitur për miratim dhe botohet së bashku me të në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit.

5. Personat fizikë apo juridikë, që ndodhen në zonën e planifikimit ose që kanë informacion apo të dhëna për të duhet, kur u kërkohet dhe për aq sa kanë mundësi të bëjnë një gjë të tillë, t'i

japin autoritetit përkatës të planifikimit ose çdo personi të autorizuar, pa kundërshtëpërblim, informacionin që disponojnë, i cili mund të nevojitet gjatë procesit të hartimit të instrumentit kombëtar të planifikimit. Autoriteti i planifikimit ose personi i autorizuar sigurojnë ruajtjen e administrimin e informacionit të marrë gjatë procesit të hartimit të instrumentit kombëtar të planifikimit dhe e bëjnë këtë informacion të disponueshëm për publikun.

#### Neni 38

### **Shqyrtimi i përputhshmërisë së instrumentit kombëtar të planifikimit me instrumentet ekzistuese**

AKPT-ja, kur ka arsye për të besuar se dispozitat e këtij ligji nuk janë zbatuar gjatë hartimit të një plani, mund të shqyrtojë, brenda 30 ditëve nga përfundimi i afateve të përcaktuara në nenet 36 e 37 të këtij ligji, përputhshmërinë e projektit përfundimtar të instrumentit kombëtar të planifikimit, të paraqitur për miratim, me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi në fushën e planifikimit të territorit dhe instrumentet e planifikimit në fuqi dhe ia përcjell autoritetit përkatës miratues përfundimet dhe propozimet përkatëse, për trajtimin e mangësive.

#### Neni 39

### **Shqyrtimi dhe miratimi i instrumentit kombëtar të planifikimit**

1. Kur KKT-ja vëren se bashkërendimi, këshillimi dhe dëgjimi publik nuk janë kryer sipas përcaktimeve të këtij ligji, refuzon shqyrtimin deri në përmbushjen e këtyre detyrimeve nga autoriteti përgjegjës, për hartimin e instrumentit kombëtar të planifikimit.

2. Instrumentet kombëtare të planifikimit miratohen nga KKT-ja. Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Planifikimit të Territorit miratohet nga Këshilli i Ministrave pas miratimit nga KKT-ja. Në rastet e mosmiratimit të një instrumenti kombëtar të planifikimit nga KKT-ja, projektakti me arsyet e mosmiratimit i kthehet, për rishqyrtim, autoritetit propozues të planifikimit, i cili, në bashkëpunim me AKPT-në, kryen procesin e duhur të rishqyrtimit.

3. Brenda 15 ditëve nga data e miratimit, instrumenti kombëtar i planifikimit, i miratuar, së bashku me materialet shoqëruese, botohen në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit.

4. Ndryshimi, rishikimi ose shfuqizimi i instrumentit kombëtar të planifikimit bëhen sipas së njëjtës procedurë, të përcaktuar në këtë ligj për hartimin e tij.

5. Instrumenti kombëtar i planifikimit i vihet në dispozicion publikut, në çdo kohë dhe gjatë të gjithë periudhës që qëndron në fuqi. Kushdo ka të drejtë të konsultojë instrumentin kombëtar të planifikimit të miratuar dhe shtojcat e tij. Aksesit i publikut sigurohet pranë çdo autoriteti përgjegjës të planifikimit, të AKPT-së dhe në institucionin e prefektit.

## SEKSIONI II

### PLANIFIKIMI VENDOR

#### Neni 40

### **Nisma për hartimin e instrumentit vendor të planifikimit**

1. Nisma për hartimin e instrumentit vendor të planifikimit merret nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore dhe paraqitet për miratim në këshillin e njësisë së qeverisjes vendore. Organet dhe institucionet që ndodhen nën juridiksionin e njësisë së qeverisjes vendore dhe palët e interesuara, kur e gjykojnë të nevojshme, i kërkojnë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore ndërmarrjen e nismës. Kërkesa shqyrtohet prej tij dhe, kur gjykohet e arsyeshme, paraqitet për miratim në këshillin e njësisë së qeverisjes vendore. Çdo kërkesë apo nismë shpjegohet, dokumentohet apo rishikohet gjatë një procesi këshillimi publik.

2. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore ose palët e interesuara hartojnë një studim, që përcakton faktet dhe analizon problemet për instrumentin vendor të planifikimit për t'u hartuar. Studimi botohet në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit nga njësia e qeverisjes vendore dhe i vihet në dispozicion publikut.

3. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore i paraqet këshillit kërkesën për nisjen e procesit, për hartimin e instrumentit vendor të planifikimit, i cili përmban:

- a) studimin që përcakton faktet dhe analizon problemet për instrumentin e paraqitur për shqyrtim dhe përmbledhjen e vërejtjeve apo propozimeve të palëve të interesuara;
- b) kufijtë e territorit, për të cilin hartohet instrumenti vendor i planifikimit;
- c) planin e veprimeve për sigurimin, sipas rastit, të bashkërendimit horizontal e vertikal dhe përfshirjen e palëve të interesuara.

4. Në rastet kur ka një rrezik të qartë e emergjent ndaj vlerave e karakteristikave të caktuara apo funksioneve vendore të objektit ose të zonës, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore vendos pezullimin e zhvillimit, sipas neneve 64 e 70 të këtij ligji, deri në shqyrtimin e miratimit e nismës nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore. Vendimi për pezullimin e zhvillimit botohet në regjistër dhe në organet e medias. Afati i pezullimit, sipas kësaj pike, nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë.

5. Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore vendos për fillimin e procesit të hartimit të instrumentit vendor të planifikimit. Ai mund të vendosë shtyrjen e shqyrtimit, në rastet kur vlerëson se faktet janë të pamjaftueshme, të pasakta ose të papërshtatshme, për nisjen e procesit për hartimin e instrumentit vendor të planifikimit. Në këto raste, këshilli organizon, të paktën, një seancë dëgjimi publik, për të marrë vërejtjet e propozimet e palëve të interesuara. Vendimi i këshillit botohet në regjistër.

6. Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore mund të vendosë, sipas rastit, vazhdimin e pezullimit të zhvillimit të vendosur sipas pikës 4 të këtij neni ose, kryesisht, pezullimin e zhvillimit, në përputhje me përcaktimet e neneve 64 e 70 të këtij ligji.

7. Përcaktimet e pikave të mësipërme të këtij neni zbatohen edhe për nisma, që lidhen me ndryshimin ose shfuqizimin e një instrumenti vendor të planifikimit, në pjesë të caktuara ose në tërësi.

#### Neni 41

### **Hartimi i instrumentit vendor të planifikimit**

1. Vendimi i këshillit vendor për hartimin e instrumentit vendor të planifikimit, së bashku me planin e veprimeve, i dërgohet AKPT-së brenda 15 ditëve nga miratimi i tij.

2. Brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, AKPT-ja i dërgon autoritetit vendor të planifikimit rekomandimet për përmirësimin e planit të veprimeve. Autoriteti vendor i planifikimit boton në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit planin përfundimtar të veprimeve brenda 15 ditëve nga data e marrjes së rekomandimeve nga AKPT-ja.

3. Autoriteti vendor i planifikimit e vë në dijeni çdo muaj AKPT-në për ecurinë e procesit të planifikimit.

4. Autoriteti përgjegjës për hartimin e instrumentit vendor të planifikimit siguron një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi, horizontal e vertikal, me çdo autoritet të planifikimit e palë të interesuar, përpara fillimit dhe gjatë hartimit të instrumentit vendor të planifikimit.

5. Pas përfundimit të hartimit, projektit përfundimtar të instrumentit vendor të planifikimit i bashkëlidhet, sipas rastit, propozimi për ndryshim të instrumenteve kombëtare dhe/ose vendore të planifikimit në fuqi, kur kjo është e nevojshme për zbatimin e instrumentit të paraqitur për shqyrtim e miratim.

6. Autoriteti vendor i planifikimit e afishon projektin përfundimtar në mjediset e institucionit dhe e boton atë në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit.

7. Përcaktimet e pikave të mësipërme të këtij neni zbatohen edhe për nisma, që lidhen me ndryshimin ose shfuqizimin e një instrumenti vendor të planifikimit, në pjesë të caktuara ose në tërësi.

#### Neni 42

### **Bashkërendimi dhe këshillimi**

1. Sipas rastit dhe me qëllim trajtimin e bashkërenduar të çështjeve të rëndësishme kombëtare e me interes të përbashkët, njësia e qeverisjes vendore bashkëpunon e bashkërendon veprimet me

autoritetet përgjegjëse kombëtare të planifikimit dhe njësitë e qeverisjes vendore kufizuese apo të përfshira, përpara marrjes së nismës për hartimin e instrumentit vendor të planifikimit.

2. Autoritetet kombëtare të planifikimit ose ato të njërive të qeverisjes vendore kufizuese janë të detyruara t'i japin, sipas kërkesës, njësisë së qeverisjes vendore informacionin që disponojnë, propozimet dhe të dhëna të tjera, që janë të domosdoshme për hartimin e instrumenteve vendore, ndërvendore apo të integruara të planifikimit. AKPT-ja mund të japë mbështetje dhe orientime për hartimin e instrumentit vendor të planifikimit.

3. Njësitë kufizuese të qeverisjes vendore duhet të vihen në dijeni individualisht për procesin e planifikimit, duke u ofruar mundësitë për t'u shprehur për të dhe për projektet e instrumenteve vendore të planifikimit në proces hartimi. Ato mund të japin, gjatë procedurës së hartimit, vërejtjet e propozimet përkatëse për çështje të rëndësishme të përbashkët.

4. Dispozitat e nenit 36 të këtij ligji zbatohen për bashkërendimin e këshillimit e instrumentit vendor të planifikimit.

#### Neni 43 **Dëgjimi publik**

Dispozitat e nenit 37 të këtij ligji zbatohen për dëgjimin publik të instrumentit vendor të planifikimit.

#### Neni 44 **Miratimi i instrumentit vendor të planifikimit**

1. Instrumentet vendore të planifikimit miratohen nga këshilli përkatës i njësisë së qeverisjes vendore. Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore miraton projektin e instrumentit vendor të planifikimit ose e rikthen për ripunim atë me vërejtjet përkatëse, në rastet kur vlerëson se:

a) nuk janë kryer bashkërendimi, këshillimi dhe dëgjimi publik ose nuk janë respektuar procedurat e tjera të detyrueshme të planifikimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

b) projekti ka mospërputhje me instrumentet e planifikimit ose me legjislacionin në fuqi.

Në këto raste, këshilli organizon, të paktën, një seancë dëgjimi publik për të marrë vërejtjet e propozimet e palëve të interesuara.

2. Pavarësisht përcaktimeve e detyrimeve të tjera me ligj, njëzia e qeverisjes vendore u dërgon, jo më vonë se 15 ditë pas miratimit të tij, AKPT-së dhe Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit, një kopje të instrumentit vendor të planifikimit, të miratuar, së bashku me vendimin e miratimit, si dhe çdo ndryshim të mëtejshëm të tij. Ato botohen në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit brenda 15 ditëve nga data e miratimit.

#### Neni 45 **Përputhshmëria e instrumentit vendor me instrumentet e planifikimit në fuqi**

1. Në rastet kur instrumenti vendor i miratuar i planifikimit duhet të harmonizohet me instrumente kombëtare në fuqi të planifikimit dhe mund të kërkojë ndryshime, për të siguruar përputhshmëri, njëzia e qeverisjes vendore u dërgon, brenda të njëjtit afat të përmendur në pikën 2 të nenit 44 të këtij ligji, ministrisë/ministrive përgjegjëse instrumentin vendor të planifikimit, të miratuar dhe projektin përfundimtar të propozimeve përkatëse për ndryshimin e instrumentit kombëtar të planifikimit, sipas pikës 5 të nenit 41 të këtij ligji.

2. Brenda 30 ditëve, ministria përgjegjëse shqyrton përputhshmërinë e instrumentit vendor të planifikimit me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi në fushën e planifikimit të territorit dhe me instrumentet kombëtare në fuqi të planifikimit dhe përmbajtjen e propozimeve të marra sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, ministria përgjegjëse merr nismën e ndryshimit të instrumentit kombëtar të planifikimit, në bazë të propozimeve ose të një pjese të tyre, të marra nga njëzia e qeverisjes vendore, që i bashkëlidhen nismës dhe e njofton atë njëkohësisht me autoritetet e tjera kombëtare të interesuara të planifikimit.

4. Brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, projekti i dërgohet për shqyrtim e miratim KKT-së nga ministria e linjës. KKT-ja e shqyrton projektaktin brenda 60 ditëve.

5. Në rast mosmiratimi ose miratimi të pjesshëm të ndryshimeve në instrumentin kombëtar përkatës të planifikimit, autoriteti vendor i planifikimit ndërmerr masat e nevojshme për rishikimin e ndryshimin e instrumentit vendor të miratuar të planifikimit dhe shmangien e mospërputhjeve.

6. Pjesët e instrumentit vendor të planifikimit, që nuk janë miratuar nga KKT-ja, sipas këtij neni, nuk hyjnë në fuqi dhe për pasojë autoriteti vendor i planifikimit nuk i boton ato në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit, nuk mund të shqyrtojë, në bazë të tyre, kërkesa e të japë leje, sipas këtij ligji, pas miratimit fillestar të tyre, sipas nenit 44 të këtij ligji. Pjesët e instrumentit vendor të planifikimit që mbeten në fuqi botohen në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit brenda 15 ditëve nga data e miratimit.

7. Gjatë shqyrtimit të përputhshmërisë ndërmjet instrumentit vendor e kombëtar të planifikimit, sipas këtij neni, ministria përgjegjëse ndjek afatet e përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 2 të nenit 50 të këtij ligji për bashkërendimin, këshillimin e dëgjimin publik.

8. E njëjta procedurë, e përcaktuar sipas pikave të mësipërme të këtij neni, zbatohet në rastin e shqyrtimit të përputhshmërisë së instrumentit vendor të planifikimit me instrumente ndërvendore apo të integruara të planifikimit në fuqi.

### SEKSIONI III PLANIFIKIMI NDËRVENDOR DHE I INTEGRUAR

#### Neni 46

#### **Hartimi e miratimi i instrumenteve të planifikimit ndërvendor dhe të integruar**

1. Instrumentet e planifikimit ndërvendor, të përmendura në nenin 28 të këtij ligji, hartohen, shqyrtohen dhe miratohen, sipas përcaktimeve të krerëve II e III dhe seksioneve II e IV të kreut IV të këtij ligji. Nisma për hartimin e tyre merret dhe procesi i hartimit deri në miratimin e tyre kryhet nga çdo autoritet vendor i interesuar i planifikimit ose sipas përcaktimeve të neneve 15 e 16 të këtij ligji. Instrumentet e planifikimit ndërvendor miratohen nga çdo autoritet vendor i planifikimit, i përfshirë në proces dhe në këto instrumente.

2. Instrumentet e planifikimit të integruar, të përmendura në nenin 29 të këtij ligji, hartohen, shqyrtohen dhe miratohen sipas përcaktimeve të krerëve II, III e IV të këtij ligji. Nisma për hartimin e tyre merret dhe procesi i hartimit deri në miratimin e tyre kryhet nga çdo autoritet i interesuar i planifikimit ose sipas përcaktimeve të neneve 15 e 16 të këtij ligji. Instrumentet e planifikimit të integruar miratohen në dy faza nga çdo autoritet vendor i planifikimit, i përfshirë në proces dhe më pas nga KKT-ja. Në të gjitha rastet, procesi përfshin këshillimin e duhur të palëve të interesuara.

### SEKSIONI IV DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

#### Neni 47

#### **Procedura e përbashkët për miratimin e planit territorial**

Etapat e përbashkëta për miratimin e planeve territoriale, sipas këtij ligji, janë:

- a) miratimi i planit të veprimeve;
- b) kryerja e studimeve, parashikimeve, projekteve, analizave dhe vlerësimeve, mbi të cilat do të mbështetet plani, kur këto nuk janë kryer më parë dhe/ose përditësimi apo përshtatja e atyre ekzistuese;
- c) kryerja e studimit të plotë të vlerësimit strategjik mjedisor;
- ç) kryerja e këshillimeve fillestare publike me palët e interesuara, për të identifikuar shqetësimet e çështjet më kryesore;

d) hartimi dhe miratimi i politikave, mbi të cilat do të mbështetet plani, kur këto nuk janë miratuar më parë, në rastet kur autoriteti i planifikimit ka vendosur në këtë mënyrë në aktin e miratimit të nismës për fillimin e hartimit të planit;

dh) hartimi i projektplanit;

e) bashkërendimi i projektplanit me autoritetet e interesuara të planifikimit;

ë) këshillime me palët e interesuara, nëpërmjet dëgjimeve publike, për të marrë qëndrimin e tyre për veprimtaritë e procesit të planifikimit;

f) miratimi i planit.

#### Neni 48

### **Vlerësimi strategjik mjedisor**

1. Çdo instrument planifikimi i nënshtrohet detyrimit të kryerjes së vlerësimit strategjik mjedisor, në bazë të kërkesave të legjislacionit mjedisor dhe standardeve europiane e ndërkombëtare.

2. Vlerësimi strategjik mjedisor kryhet gjatë procesit të hartimit dhe para miratimit të instrumentit të planifikimit.

3. Bashkërendimi e këshillimi me palët e interesuara dhe dëgjimi publik për vlerësimin strategjik mjedisor kryhen sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin mjedisor, sipas kritereve të mëposhtme:

a) zbatohen afatet e procedurat e parashikuara në këtë ligj ose në legjislacionin mjedisor, kur përcaktohen shprehimisht në njërin prej tyre;

b) për afate të ndryshme të parashikuara në këtë ligj dhe në legjislacionin mjedisor zbatohet vetëm afati më i gjatë.

#### Neni 49

### **Përputhshmëria ndërmjet instrumenteve të planifikimit**

1. Nëse dy apo më shumë instrumente të planifikimit janë miratuar për të njëjtin territor dhe përmbajnë dispozita të kundërta, është i vlefshëm ai që është miratuar i fundit në kohë, në përputhje me llojin, nivelin e klasifikimin e tyre, sipas dispozitave të seksionit I dhe seksionit III të kreut III të këtij ligji.

2. Çdo instrument i një autoriteti të planifikimit mund të përcaktojë rregulla të detyrueshme, për t'u respektuar në instrumentet e një autoriteti tjetër, në përputhje me sferën e juridiksionit dhe të përgjegjësive, të përcaktuara sipas këtij ligji dhe/ose legjislacionit në fuqi. Në veçanti:

a) instrumentet kombëtare, të integruara ose ndërvendore, mund të përcaktojnë rregulla të detyrueshme për instrumentet vendore, për çështjet e rëndësisë kombëtare të deleguara për t'u trajtuar në një instrument vendor ose kur këto përbëjnë rregulla të detyrueshme për mbrojtjen e interesit kombëtar e që lidhen me kryerjen e funksioneve dhe/ose përgjegjësive të veta, të përbashkëta apo të deleguara të njësive të qeverisjes vendore;

b) instrumentet vendore mund të përcaktojnë rregulla të detyrueshme për ato kombëtare, të integruara ose ndërvendore, në rastet kur këto rregulla lidhen me çështje të rëndësisë vendore dhe kur ato nuk shkaktojnë apo nuk kanë mundësi të shkaktojnë cenimin e trajtimit sipas ligjit të një çështjeje të rëndësisë kombëtare.

3. Mospërputhjet ndërmjet instrumenteve të nxjerra nga autoritete të planifikimit, që nuk varen drejtpërdrejt ndërmjet tyre, trajtohen dhe zgjidhen si konflikte juridiksioni ose kompetencash, pasi janë përdorur mjetet e mekanizmat e përcaktuar sipas këtij ligji.



Neni 50  
**Procedura e thjeshtuar**

1. Procedura e thjeshtuar, sipas këtij neni, zbatohet kur:
  - a) instrumentet e planifikimit, të kontrollit të zhvillimit dhe rregulloret e ndërtimit rishikohen apo ndryshohen për çështje, që nuk prekin aspektet themelore të tyre dhe nuk cenojnë vlerat natyrore, cilësinë e mjedisit, zonat e mbrojtura, biodiversitetin dhe trashëgiminë natyrore e kulturore;
  - b) rishikimi i tyre shoqërohet me kritere apo kushte më të hollësishme se instrumenti në fuqi;
  - c) shqyrtohet nisma për përcaktimin e rëndësisë kombëtare të një çështjeje në planifikimin e territorit.
2. Përdorimi i procedurës së thjeshtuar ka për efekt:
  - a) përjashtimin e miratimit të nismës, sipas neneve 33 e 40 të këtij ligji;
  - b) përgjysmimin e afateve të përcaktuara për bashkërendimin e këshillimin dhe dëgjimin publik në nenet 36 pika 3, 37, 42 pika 4 e 43 të këtij ligji;
  - c) përjashtimin e zbatimit të procedurës së ndërmjetësimit, sipas nenit 19 të këtij ligji.

**KREU V**  
**REGJISTRI I PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**

Neni 51  
**Regjistri i planifikimit të territorit**

1. Funkcionet themelore të regjistrimit janë:
  - a) regjistrimi i informacionit ligjor e fizik të të drejtave apo kufizimeve publike e private mbi tokën;
  - b) njoftimi, në formë e format të përshtatshëm, i projektakteve dhe akteve, të lidhura me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit;
  - c) çdo funksion tjetër, që mund t'i jepet me ligj.
2. Funksionimi e përdorimi i regjistrimit nuk shmangin nevojën për botimin e vazhdueshëm të veprimeve të planifikimit, sipas mjeteve të tjera tradicionale të informimit dhe në organet e medias.

Neni 52  
**Organizimi dhe funksionimi i regjistrimit**

1. Informacioni në regjistër organizohet sipas një rrjeti të integruar e shumëqëllimësh bazash elektronike kadastrale të të dhënave mbi tokën, të pavarura e ndërvepruese ndërmjet tyre. Autoritetet përgjegjëse ndërtojnë, administrojnë e mirëmbajnë bazën e tyre të të dhënave, pjesë përbërëse të regjistrimit, sipas një platforme teknike, strukture dhe standardeve të përbashkëta gjeodezike e GIS-it, për të siguruar përputhshmërinë e ndërveprimit ndërmjet tyre dhe shkëmbimin e përdorimit e informacionit të regjistruar në to.
2. Konsultimi i të dhënave të botuara në regjistër kryhet nëpërmjet komunikimit elektronik me internet. Konsultimi i të dhënave është publik, përveç atyre që mbrohen me ligj. Si rregull, konsultimi i regjistrimit është falas dhe përmbajtja e akteve të përfshira në të është publike. Për shërbime të caktuara, mund të zbatohet një tarifë, për të cilën publiku informohet paraprakisht.
3. Bazat e të dhënave GIS administrohen nga autoritetet e planifikimit dhe institucionet e tjera publike, në nivel kombëtar e vendor, sipas përgjegjësive të përcaktuara në këtë ligj dhe legjisllacionit sektorial në fuqi. Çdo autoritet i planifikimit regjistron të dhënat sektoriale në regjistër dhe i boton ato.
4. Autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit dhe institucionet e tjera publike kontribuojnë proporcionalisht në ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e regjistrimit.

Neni 53  
**Botimi në regjistër**

1. Janë të detyrueshme për botim, sipas rasteve dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj, të gjitha projektaktet ose aktet e miratuara, që lidhen me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit, përveç atyre llojeve, të cilat:

- a) përjashtohen me akte të Këshillit të Ministrave për shkaqe të përligjura;
- b) janë akte të brendshme të një autoriteti kombëtar ose vendor;
- c) janë akte, botimi i të cilave ndalohet nga legjislacioni në fuqi.

2. Botimi në regjistër, kur nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, është kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për hyrjen në fuqi të aktit.

3. Pavarësisht përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, mund të botohet në regjistër, me nismën e autoritetit përgjegjës të planifikimit, çdo akt tjetër që nuk është i detyrueshëm për botim, literaturë, metodologji, studime dhe çdo njoftim me interes për publikun.

4. Projektaktet dhe aktet që janë të detyrueshme për botim në regjistër botohen menjëherë.

Neni 54  
**Mbështetja për autoritetet vendore**

AKPT-ja mbështet autoritetet vendore, duke u ofruar asistencë teknike, trajnime dhe infrastrukturë, për botimin e të dhënave në regjistër.

Neni 55  
**Aktet nënligjore për regjistrin**

Në zbatim të dispozitave të mësipërme të këtij kreu, Këshilli i Ministrave:

a) miraton planin e veprimit, krijon kushtet për vënien në funksionim të programit informatik për administrimin e regjistrit dhe ngritjen e qendrave të asistencës në 12 qarqet dhe mbështet me burime financiare autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit dhe institucionet e tjera publike për krijimin dhe vënien në funksionim të regjistrit me dy faza:

i) regjistrimin dhe publikimin e të dhënave, të krijuara gjatë zbatimit të këtij ligji;

ii) regjistrimin dhe publikimin e të dhënave, të krijuara gjatë zbatimit të legjislacionit sektorial në fuqi;

b) miraton strukturën dhe standardet e përbashkëta gjeodezike dhe të GIS-it;

c) përcakton rregullat për krijimin, administrimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave, strukturën dhe formatet e regjistrimit;

ç) miraton llojet e projektakteve, akteve, kërkesave për zhvillim dhe lejeve që botohen në regjistër;

d) miraton rregullat e lidhjes në rrjet dhe të transferimit të ndërsjellë të të dhënave ndërmjet autoriteteve të planifikimit dhe institucioneve të tjera shtetërore;

dh) përcakton detyrimet e të drejtat e autoriteteve kombëtare e vendore të planifikimit për regjistrin;

e) miraton shërbimet dhe tarifatat përkatëse për to.

KREU VI  
**TRANSPARENCA**

Neni 56  
**Standardet e transparencës**

1. Ky kre përcakton standardet bazë të transparencës, që zbatohen ndaj të gjitha aspekteve të këtij ligji. Çdo autoritet i planifikimit mund të miratojë procedura që garantojnë nivele më të larta të standardeve të transparencës, pjesëmarrjes së publikut e të vendimmarrjes, por nuk mund të cenojnë

standardet bazë të vendosura nga ky kre ose rregulla të tjera, të përcaktuara në këtë ligj.

2. Çdo vendim i autoriteteve të planifikimit duhet të jetë në përputhje me proceduarat për pjesëmarrjen dhe aksesin e publikut në shqyrtimin e diskutimin e instrumenteve të planifikimit dhe vendimmarrjen për zhvillimin e territorit, sipas këtij ligji.

#### Neni 57

### **Pjesëmarrja e publikut në shqyrtimin e projekteve të instrumenteve të planifikimit**

1. Çdo person ka të drejtë të informohet dhe të bëjë vërejtje e propozime, me gojë ose me shkrim, gjatë hartimit, shqyrtimit, miratimit dhe ndryshimit të instrumenteve të planifikimit të territorit dhe për çështje të tjera të planifikimit e të kontrollit të zhvillimit të territorit, sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

2. Çdo person ka të drejtë të marrë pjesë në çështjet e planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit të territorit me kërkesa, opinione dhe mjete të tjera të ngjashme.

#### Neni 58

### **Aksesi i publikut në dokumentet e planifikimit**

1. Autoritetet e planifikimit i sigurojnë çdo personi e pale të interesuar akses të gjerë, për të konsultuar dhe për të marrë, pa pagesë ose kundrejt një pagese të përshtatshme, sipas kostos së riprodhimit, një kopje të dokumenteve të mëposhtme:

a) instrumentet e planifikimit dhe rregulloret e kontrollit të zhvillimit, të miratuara nga autoritetet e planifikimit;

b) studime planifikuese, propozime e miratime të zhvillimit dhe vërejtje e propozime për çdo projektakt të planeve dhe të rregulloreve të kontrollit të zhvillimit, që përdoren për zbatimin e këtij ligji;

c) kushtet e procedurat, që zbatohen për kërkesat për zhvillim, lejet e zhvillimit, të ndërtimit dhe të përdorimit, deklaratimet paraprake të punimeve, njoftimet e palëve, ankimet ndaj vendimeve të marra, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Çdo palë e interesuar ka të drejtën për akses e informim të gjerë pa pagesë, qoftë edhe para çdo veprimi publik, në të gjitha studimet e planifikimit, planet, rregulloret, propozimet e zhvillimit dhe miratimet e zhvillimit, përfshirë ato të zbatuara nëpërmjet “miratimit të heshtur”.

3. Çdo dokument vihet në dispozicion për informim ose jepet një kopje e tij, në bazë të kërkesës së paraqitur me shkrim, në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare dhe Kodin e Procedurave Administrative.

4. Çdo autoritet i planifikimit duhet të afishojë ose të shpallë publikisht rregullat e tij për sigurimin e aksesit në dokumentet zyrtare në fushën e planifikimit, tarifat e zbatueshme dhe mënyrën e vendin e paraqitjes së kërkesave për akses të publikut në këto dokumente.

5. Çdo autoritet i planifikimit boton në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit projektaktet dhe aktet e nxjerra prej tij, gjatë procesit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit.

## KREU VII

### KONTROLLI I ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

#### SEKSIONI I

### INSTRUMENTET E PËRGJITHSHME TË KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

#### Neni 59

### **Rregulloret e kontrollit të zhvillimit të territorit**

1. Rregulloret e kontrollit të zhvillimit të territorit normojnë procesin, në bazë të të cilit autoritetet vendore të planifikimit, sipas shkronjave “a” e “c” të pikës 1 të nenit 12 të këtij ligji,

vlerësojnë e vendosin nëse një kërkesë për zhvillim ose kryerja e zhvillimit përputhet me përcaktimet e instrumenteve të planifikimit, sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore. Ato përcaktojnë:

a) procesin dhe mënyrën e zbatimit të instrumenteve kombëtare e vendore të planifikimit, realizimin e politikave kombëtare dhe vendore për mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e trashëgimisë natyrore e kulturore, mbrojtjen e shëndetit, të sigurisë dhe të mirëqenies;

b) procesin dhe mënyrën e kontrollit të zhvillimit në territor, nëpërmjet rregulloreve model të planifikimit;

c) rregulla të hollësishme, formatin dhe studimet/projektet për kërkesat për zhvillim, lejet dhe inspektimin, sipas fazave të ndryshme të punimeve;

ç) tipologjitë, rastet e procedurat, kur zhvillimi i tokës dhe strukturave në të:

i) kryhet në bazë të lejes së zhvillimit dhe/ose të ndërtimit;

ii) kryhet në bazë të lejes së infrastrukturës;

iii) kryhet në bazë të deklaramit paraprak të punimeve;

iv) përjashtohet nga detyrimi i pajisjes me leje dhe nga deklarimi paraprak i punimeve;

d) përmbajtjen bazë e rezultatet e studimeve mjedisore, që duhet të kryhen për shqyrtimin e kërkesës për zhvillim, sipas përcaktimeve të legjisllacionit për vlerësimin strategjik mjedisor dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis;

dh) procedurat për inspektimin e vazhdueshëm të territorit brenda juridiksionit të çdo autoriteti vendor të planifikimit, për të identifikuar zhvillimet, që janë në kundërshtim me instrumentet në fuqi të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit dhe marrëdhëniet e bashkëveprimin ndërmjet autoriteteve kombëtare e vendore të inspektimit.

2. Autoritetet vendore të planifikimit janë përgjegjëse për kontrollin e zhvillimit të territorit nën juridiksionin e tyre, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligj. Ato zbatojnë instrumentet kombëtare të detyrueshme të planifikimit, rregulloret kombëtare të kontrollit të zhvillimit dhe rregulloret e ndërtimit për territorin e tyre administrativ.

#### Neni 60

### **Rregulloret kombëtare të kontrollit të zhvillimit të territorit**

1. Autoritetet kombëtare të planifikimit miratojnë rregulla të kontrollit të zhvillimit, për zbatimin e instrumenteve kombëtare të planifikimit dhe të rregulloreve të ndërtimit, sipas rëndësisë e natyrës së çështjeve, në përputhje me rregulloret uniforme të kontrollit të zhvillimit, të miratuara sipas nenit 62 të këtij ligji.

2. Procesi i hartimit, shqyrtimit, bashkërendimit, këshillimit dhe miratimit të këtyre rregulloreve është i njëjtë me atë të përcaktuar për instrumentet kombëtare të planifikimit, sipas kreut IV seksionet I e IV të këtij ligji.

#### Neni 61

### **Rregulloret vendore të kontrollit të zhvillimit**

1. Autoritetet vendore të planifikimit miratojnë rregullat e kontrollit të zhvillimit, sipas rëndësisë e natyrës së çështjeve, në përputhje me rregulloret uniforme të kontrollit të zhvillimit, të miratuara sipas nenit 62 të këtij ligji dhe rregulloret kombëtare të kontrollit të zhvillimit, sipas nenit 60 të këtij ligji.

2. Procesi i hartimit, shqyrtimit, bashkërendimit, këshillimit dhe miratimit të këtyre rregulloreve është i njëjtë me atë të përcaktuar për instrumentet vendore të planifikimit, sipas kreut IV seksionet II e IV të këtij ligji.

#### Neni 62

### **Njëtrajtshmëria e strukturës dhe formës së instrumenteve të kontrollit të zhvillimit**

Këshilli i Ministrave miraton rregullore uniforme të kontrollit të zhvillimit, me qëllim realizimin e njëtrajtshmërisë së formës e të strukturës së instrumenteve të kontrollit të zhvillimit.

Këto rregullore nuk përcaktojnë apo kufizojnë politika për autoritetet e planifikimit. Bashkërendimi, këshillimi, dëgjimi publik dhe botimi në regjistër i tyre kryhen nga AKPT-ja, sipas dispozitave të neneve 36 e 37 të këtij ligji.

## SEKSIONI II INSTRUMENTET E VEÇANTA TË KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT

### Neni 63

#### **Instrumentet e veçanta të kontrollit të zhvillimit**

1. Instrumentet e veçanta të kontrollit të zhvillimit në territor, në kuptim të këtij ligji, janë:

- a) pezullimi i zhvillimit;
- b) servituti publik;
- c) rezervimi publik;
- ç) drejta e transferimit;
- d) drejta e preferimit;
- dh) drejta e lënies.

2. Zbatimi i instrumenteve të veçanta të kontrollit të zhvillimit kryhet kur është i domosdoshëm realizimi i një qëllimi apo përdorimi publik të dokumentuar dhe rezulton të jetë metoda e vetme, e përshtatshme për realizimin e tij.

### Neni 64

#### **Pezullimi i zhvillimit**

1. Pezullimi i zhvillimit përdoret, në proporcion me rrethanat që e diktojnë atë, vetëm kur rezulton se instrumente të tjera në fuqi nuk do të jepnin një zgjidhje të përshtatshme.

2. Pezullimi i zhvillimit nuk zbatohet për:

- a) zhvillime të autorizuar, formalisht ose në heshtje, me leje zhvillimi, sipas legjislacionit në fuqi, para hyrjes në fuqi të vendimit për pezullimin e zhvillimit;
- b) punimet e mirëmbajtjes.

3. Autoriteti i planifikimit mund të vendosë pezullimin e zhvillimit, gjatë miratimit të nismës për hartimin e instrumentit të planifikimit ose gjatë procesit të hartimit të tij. Kur ekzistojnë kushtet për nisjen e procedurës së pezullimit të zhvillimit, autoriteti i planifikimit bën publike faktet, që shprehin nevojën për ndërhyrje urgjente. Vendimi për pezullimin e zhvillimit përcakton arsyet e përdorimit të këtij instrumenti, territorin e përfshirë ose pjesë të caktuara të tij, llojet e lejeve apo të çështjeve të lidhura me to, dhënia e të cilave pezullohet, strukturat që nuk mund të prishen, afatin dhe shkallën apo nivelin e pezullimit, sipas tipit të zhvillimit. Në rastin e zhvillimeve që kryhen sipas procedurës së deklarimit paraprak të punimeve, vendimi për pezullimin e zhvillimit përcakton kufizimin ose ndalimin e ndryshimeve madhore apo themelore, me rezultat rritjen e vlerës së strukturave ekzistuese.

4. Pezullimi i zhvillimit mund të vendoset për një periudhë kohore deri në 12 muaj. Ai mund të zgjatet edhe për 6 muaj të tjerë, për shkaqe specifike të përligjura. Pezullimi i zhvillimit mbaron para afatit të përcaktuar për të gjithë territorin e përfshirë ose pjesë të caktuara të tij, kur kushtet e kërkuara për miratimin e tij pushojnë së ekzistuari. Në çdo rast, ai mbaron në datën kur instrumenti i planifikimit hyn në fuqi.

5. Në rastet kur pezullimi i zhvillimit qëndron në fuqi për një periudhë më të gjatë se 12 muaj, palët e prekura nga zbatimi i tij kanë të drejtë të kompensohen financiarisht, në masën e humbjes apo dëmit të shkaktuar realisht, nga zbatimi i këtij instrumenti. Kërkesa për kompensim financiar bëhet me shkrim pranë autoritetit të planifikimit, që ka vendosur pezullimin e zhvillimit. Vlerësimi i masës së kompensimit kryhet sipas vlerës së tregut. Kur palët nuk arrijnë marrëveshje për masën e kompensimit, bëhet ankim në gjykatë, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Ndryshimi i vendimit për pezullimin e zhvillimit, sipas përcaktimeve të mësipërme të këtij neni, mund të ketë, për efekt, përjashtimin nga pezullimi të pjesëve të territorit të përfshirë ose të tipave të caktuar të zhvillimit, për një pjesë ose për të gjithë periudhën e pezullimit të zhvillimit.

Neni 65  
**Servituti publik**

1. Servituti publik mund të përcaktohet nga instrumenti vendor apo kombëtar i planifikimit ose nga një kërkesë për zhvillim. Kur servituti bazohet në një instrument në fuqi të planifikimit, ai zbatohet ndaj një kërkesë për zhvillim.

2. Servituti publik qëndron në fuqi pa afat, në qoftë se akti që e krijon atë nuk përcakton një afat përfundimi.

3. Të drejtat dhe detyrimet mbi servitutin publik janë ato të përcaktuara në Kodin Civil e legjislacionin në fuqi, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj. Sipas nevojës dhe rrethanave, autoriteti i planifikimit mund të miratojë rregulla më të hollësishme.

4. Servituti publik mund të krijohet për zbatimin e një qëllimi publik të ardhshëm edhe kur nuk është bërë kërkesë për zhvillim.

5. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që i nënshtrohet servitutit, nuk ndërhyt në përdorimin e synuar të servitutit publik.

6. Çdo servitut publik, i vendosur mbi parcela të caktuara, transferohet në parcelat e reja të krijuara në të njëjtën vendndodhje fizike, si pasojë e një procesi nëndarjeje dhe/ose bashkimi të parcelave.

7. Servitutet publike, që vendosen për interesa publike, nuk përbëjnë objekt dëmshpërblimi. Pronari mund të kërkojë dëmshpërblim, kur nga vendosja e një servituti publik rrjedh ndryshimi në gjendjen e mëparshme të tokës apo strukturës, që shkakton një dëm të drejtpërdrejtë, material e të sigurt. Kërkesa për dëmshpërblim duhet t'i dorëzohet autoritetit përgjegjës, brenda 6 muajve nga data e shkaktimit të dëmit. Dëmshpërblimi, në mungesë të marrëveshjes ndërmjet palëve, caktohet nga gjykata, e cila merr parasysh vlerën e shtuar që i sjell ndërtimit realizimi i një instrumenti të caktuar të planifikimit dhe përdorimin e zakonshëm të tokës para vendosjes së servitutit publik.

Neni 66  
**Rezervimi publik**

1. Qëllimi dhe interesi publik, për të cilët kryhet rezervimi publik i pasurisë së paluajtshme, në pronësi private, përcaktohen në përputhje me instrumentet në fuqi të planifikimit.

2. Autoriteti i planifikimit vë në dijeni pronarët e pasurive të paluajtshme, që mund të preken nga vendimi për rezervimin publik të tokës, për qëllimin dhe arsyet e marrjes së një mase të tillë, të paktën 60 ditë para datës së miratimit të vendimit.

3. Rezervimi publik i tokës vendoset pa kundërshtim për një periudhë kohore deri në 18 muaj, për rastet kur nuk i shkaktohet dëm subjektivit.

4. Autoriteti i planifikimit fillon procedurën e shpronësimit vetëm pasi të ketë ndërmarrë masa për negociimin dhe blerjen me marrëveshje të pasurisë së paluajtshme të përcaktuar për t'u rezervuar për një qëllim publik, ose kur nuk është arritur, sipas rastit, marrëveshje me pronarin e saj, sipas neneve 68 e 69 të këtij ligji.

5. Shpronësimi nuk mund të jetë me shtrirje më të madhe sesa kërkohet, për të plotësuar interesin publik.

6. Pronari kompensohet për shpronësimin e pasurisë, në përputhje me legjislacionin civil dhe atë për shpronësimet.

Neni 67  
**E drejta e transferimit**

1. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të vendosë transferimin e pasurisë së paluajtshme publike, pronë e njësisive të qeverisjes vendore, në favor të shtetit për realizimin e investimeve në infrastrukturën publike kombëtare, në përputhje me instrumentet në fuqi të planifikimit.

2. Akti i kalimit të pronësisë nga njësisia e qeverisjes vendore në favor të shtetit kryhet përkundërt pagimit të vlerës reale të tokës dhe/ose strukturave në të, sipas kushteve të tregut në

çastin e transferimit të pronësisë. Kompensimi i vlerës kryhet me fonde të Buxhetit të Shtetit ose me fonde të investitorit privat që do të kryejë investimin me interes publik.

3. Njësia e qeverisjes vendore njoftohet nga ministria përgjegjëse e linjës të paktën 60 ditë para propozimit të marrjes së vendimit, sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Përcaktimi i vlerës apo mënyrave të kompensimit konsultohet ndërmjet autoriteteve kombëtare e vendore të përfshira në proces dhe, në rast mosmarrëveshjeje, vlera e kompensimit caktohet nga gjykata. Padia dhe shqyrtimi gjyqësor nuk përbëjnë shkak për ndërprerjen ose pezullimin e transferimit të pronësisë në favor të shtetit.

5. Vlera e kompensimit të pronës së transferuar paguhet brenda 6 muajve nga data e vendimit. Ndryshimet në regjistrin e pasurive të paluajtshme kryhen vetëm pas pagimit të vlerës së kompensimit.

## Neni 68

### **E drejta e preferimit**

1. E drejta e preferimit ushtrohet për pasuri të paluajtshme, në pronësi private ose pjesë të tyre, sipas zonave të preferimit, të përcaktuara nga autoriteti i planifikimit. Kjo e drejtë nuk mund të ushtrohet:

a) për blerje të pasurisë së paluajtshme, që rregullohet sipas kuadrit ligjor për bashkëpronësinë;

b) kur pronari ia shet pasurinë e paluajtshme bashkëshortit ose një të afërmi, me lidhje gjaku apo martesë, deri në shkallë të dytë;

c) kur pasuria e paluajtshme është në proces blerjeje nga një institucion publik ose për llogari të tij;

ç) për pasuritë e paluajtshme, për të cilat janë pranuar kërkesa për zhvillim, që janë në proces shqyrtimi, deri në datën e miratimit të zonës së preferimit;

d) për ndërtime të kryera prej të paktën 10 vjetësh.

2. Përpara nënshkrimit të një kontrate shitjeje, pronari i një pasurie të paluajtshme, në pronësi private, njofton, me anë të shërbimit me “përgjigje të marrë”, autoritetin përgjegjës të planifikimit, që ka miratuar zonën e preferimit ose organin e autorizuar prej tij, në territorin e juridiksionit të të cilit ndodhet pasuria e paluajtshme, për qëllimin e shitjes nga ana e tij, kushtet dhe çmimin. Autoriteti përgjegjës i planifikimit duhet të shprehet për ushtrimin e së drejtës së preferimit, përdorimin ose përdorimet konkrete publike, të propozuara për pasurinë, që mbulohet nga kjo e drejtë dhe nisjen e procedurës së marrëveshjes për kushtet e blerjes.

3. Në rast refuzimi të ushtrimit të së drejtës së preferimit, të mosarritjes së marrëveshjes për çmimin ose në mungesë të përgjigjes nga autoriteti përgjegjës i planifikimit, brenda 60 ditëve nga data e njoftimit, pronari gëzon të drejtën e shitjes së pasurisë së paluajtshme pas këtij afati, pavarësisht së drejtës së preferimit, sipas këtij neni. Në këto raste, autoriteti i planifikimit nuk mund ta ushtrojë përsëri të drejtën e preferimit mbi të njëjtën pasuri të paluajtshme, për një periudhë prej 5 vjetësh.

4. Pronari mund ta tjetërsojë pasurinë e paluajtshme, sipas kushteve të pikës 3 të këtij neni, vetëm me një çmim të njëjtë ose më të favorshëm për të se çmimi i propozuar për autoritetin e planifikimit. Pronari vërteton plotësimin e këtij kushti për çregjistrimin e së drejtës së preferimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

5. Noteri nuk mund të redaktojë akte noteriale për shitjen e pasurisë së paluajtshme, sipas këtij neni:

a) nëse shitësi i saj nuk paraqet konfirmimin, me shkrim, të autoritetit të planifikimit, për mosushtrimin e së drejtës së preferimit ose mosarritjen e marrëveshjes për çmimin e ofruar;

b) në rastet e mungesës së përgjigjes nga autoriteti i planifikimit, sipas pikës 3 të këtij neni, noteri duhet t'i kërkojë shitësit ofertën me shkrim, që i është dorëzuar autoritetit të planifikimit, sipas këtij neni.

6. Në çdo rast, kur autoriteti përgjegjës i planifikimit ushtron të drejtën e preferimit për realizimin e interesit publik, ai duhet të paguajë vlerën brenda 6 muajve nga data e përgjigjes, sipas pikës 2 të këtij neni dhe duhet të marrë masat për çregjistrimin e vendimit për miratimin e së drejtës

së preferimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme të zonës përkatëse të preferimit.

7. Pasuria e blerë nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së preferimit përdoret vetëm për interesin publik konkret, për të cilin është preferuar. Nëse autoriteti përgjegjës i planifikimit vendos ta shesë pasurinë e blerë me preferim gjatë 5 vjetëve të para, ai është i detyruar të njoftojë ish-pronarin e saj ose trashëgimtarët e tij, nëse kanë interes ta rimarrin atë pasuri.

#### Neni 69

#### **E drejta e lënies**

1. Në rastin e ushtrimit të rezervimit publik të pasurisë së paluajtshme, pronari i saj mund të njoftojë, me anë të shërbimit, me “përgjigje të marrë”, autoritetin përgjegjës të planifikimit, në territorin e juridiksionit të të cilit ndodhet pasuria e paluajtshme, në pronësi të tij, për ushtrimin e së drejtës së lënies së saj. Njoftimi përmban ofertën e shitjes, kushtet dhe çmimin.

2. Brenda 60 ditëve, autoriteti i planifikimit ia njofton vendimin pronarit. Nëse ai vendos ta blejë pasurinë e paluajtshme, afatet dhe mënyra e pagimit të çmimit përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve. Në mungesë të saj, autoriteti i planifikimit duhet të paguajë çmimin brenda 6 muajve nga data e marrjes së vendimit.

3. Në rast refuzimi, autoriteti i planifikimit duhet të vendosë, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, revokimin e vendimit të rezervimit publik të pasurisë së paluajtshme në fjalë ose të përdorë, sipas rastit, procedurën e shpronësimit, sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 70

#### **Autoritetet dhe procedura e zbatimit të instrumenteve të veçanta të kontrollit të zhvillimit**

1. Në rastet kur instrumentet e veçanta të kontrollit të zhvillimit, sipas neneve 65, 66 e 68 të këtij ligji, nuk miratohen më parë si pjesë e një plani territorial, vendor ose kombëtar, ato shqyrtohen sipas procedurës së mëposhtme:

a) autoriteti i planifikimit përgatit një studim, që përcakton faktet dhe formulon qëllimin e interesin publik, që duhet realizuar, në përputhje me përcaktimet e këtij seksioni dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Studimi botohet në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit;

b) autoriteti i planifikimit organizon, të paktën, një seancë dëgjimi publik, jo më vonë se 30 ditë nga data e botimit të studimit në regjistër;

c) vendimi për zbatimin e instrumentit të veçantë të kontrollit të zhvillimit botohet në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit dhe i njoftohet, brenda 15 ditëve nga miratimi i tij, pronarit të pasurisë së paluajtshme, që preket nga zbatimi i tij në rastet e servitutit publik dhe të rezervimit publik dhe, për aq sa një gjë e tillë është e mundur, për pezullimin e zhvillimit dhe përcaktimin e zonave të preferimit.

2. Kompetencat dhe procedura për miratimin e zbatimin e instrumenteve të veçanta të kontrollit të zhvillimit, të përcaktuara në këtë seksion, rregullohen si më poshtë:

a) pezullimi i zhvillimit miratohet, ndryshohet ose revokohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me propozimin e kryetarit të saj, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 4 të nenit 40 të këtij ligji. Ai rregullohet në nivel kombëtar, sipas nenit 32 të këtij ligji. Bashkërendimi, këshillimi dhe pjesëmarrja e palëve të interesuara kryhen sipas procedurës së thjeshtuar, të përcaktuar në nenin 50 të këtij ligji;

b) kategoritë e servituteve publike dhe rregullat për zbatimin e tyre përcaktohen nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore dhe zbatohen nga kryetari i saj ose zyrtari i autorizuar prej tij me delegim, sipas procedurës së parashikuar për lejet e zhvillimit në seksionin III të këtij kreu. Në nivel kombëtar, autoritetet përgjegjëse janë KKT-ja dhe ministri;

c) ushtrimi i së drejtës së rezervimit publik të pasurisë së paluajtshme kryhet pas bashkëveprimit e bashkëpunimit ndërmjet autoritetit vendor dhe kombëtar ose anasjelltas. Ushtrimi i së drejtës së rezervimit publik të pasurisë së paluajtshme është, sipas rastit, kompetencë e ministrit ose e kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore. Ai zbatohet sipas procedurës së parashikuar për lejet



e zhvillimit në seksionin III të këtij kreu, ose sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, kur nuk është miratuar si pjesë e një plani territorial;

ç) miratimi i zonave të preferimit kryhet nga autoriteti, që miraton planin territorial, si pjesë e tij. Kur bëhet veçmas, miratimi bëhet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore ose KKT-ja, sipas procedurës së thjeshtuar, të përcaktuar në nenin 50 të këtij ligji;

d) vendimmarrja, negocimi dhe transaksionet e mundshme, si pasojë e ushtrimit të së drejtës së lënies dhe të preferimit, ushtrohen, sipas nivelit përkatës, nga autoriteti i planifikimit, në bazë të legjislacionit në fuqi.

3. Vendimet për miratimin e servitutit publik, të rezervimit publik të tokës dhe të së drejtës së preferimit botohen në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit dhe regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

4. Këshilli i Ministrave nxjerr akte nënligjore për zbatimin e instrumenteve të veçanta të kontrollit të zhvillimit, sipas këtij seksioni.

### SEKSIONI III LEJA E ZHVILLIMIT

#### Neni 71

#### **Lejet e zhvillimit, deklaratat paraprake dhe përjashtimet**

1. Çdo person fizik ose juridik, vendas apo i huaj, që synon të kryejë një zhvillim të ri në Republikën e Shqipërisë, në territore në pronësi të tij ose në pronësi private apo publike, për të cilat ai gëzon të drejta ligjore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duhet të pajiset me leje zhvillimi, në përputhje me përcaktimet e këtij kreu dhe me instrumentet kombëtare e vendore në fuqi të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit, për çdo zhvillim të tokës ose të strukturave në të apo për kryerje të punimeve për zhvillimin e tyre, përveç rasteve kur kjo gjë përjashtohet sipas këtij ligji.

2. Leja, sipas llojeve të përcaktuara në dispozitat e këtij kreu, i jepet:

a) pronarit ose pronarëve, përfaqësuesit të tyre ose personit fizik apo juridik, të autorizuar prej tij, sipas ligjit për kryerjen e punimeve;

b) në rast bashkëpronësie, njërit ose më shumë bashkëpronarëve apo përfaqësuesit të tyre;

c) personit që realizon një projekt, investim apo objekt me interes publik, sipas ligjit, si pasojë e një shpronësimi ose për shkak të përdorimit të së drejtës së transferimit, sipas nenit 67 të këtij ligji.

3. Çdo person fizik ose juridik përjashtohet nga detyrimi për t'u pajisur me leje për punime, të cilat kanë:

a) madhësi, natyrë dhe efekt të vogël apo të kufizuar të zhvillimit;

b) kohëzgjatje ose karakter të përkohshëm të tij;

c) mirëmbajtje të strukturave;

ç) zhvillim për qëllime bujqësore;

d) shfrytëzim të pyjeve, që rregullohet me ligj të veçantë.

Tipologjitë dhe rastet kur zhvillimi i tokës dhe i strukturave në të përjashtohet nga detyrimi për t'u pajisur me leje përcaktohen në rregulloret e kontrollit të zhvillimit, sipas nenit 59 e në vijim të këtij ligji. Në këto raste, zhvillimi i tokës dhe i strukturave në të kryhet me ose pa njoftim paraprak të autoritetit përgjegjës të planifikimit. Njoftimi kryhet nëpërmjet një deklarami paraprak të punimeve, sipas formës së përcaktuar nga rregulloret e kontrollit të zhvillimit.

4. Të gjitha llojet e lejeve të përcaktuara në këtë ligj përfshihen në fushën V pika 2 të shtojcës së ligjit nr.10/081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë". Ato jepen në përputhje me dispozitat e këtij kreu.

#### Neni 72

#### **Leja e zhvillimit**

1. Lejet e zhvillimit klasifikohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit e të miratimit të tyre, si më poshtë:

a) leje zhvillimi për çdo punim, me përjashtim të atyre të përmendura në shkronjën “b” të kësaj pike, të cilat shqyrtohen e miratohen sipas procedurës së përcaktuar në nenet 73 deri në 75 të këtij ligji;

b) leje zhvillimi për punime me rrezikshmëri të lartë për mjedisin, sigurinë apo shëndetin publik ose sigurinë e jetës, për të cilat ndiqen kriteret e procedura e veçantë, të parashikuara në nenin 76 të këtij ligji.

2. Leja e zhvillimit jepet në bazë të një kërkesë për zhvillim, që shqyrtohet sipas këtij ligji.

3. Miratimi i lejes bëhet me vendim të autoritetit përgjegjës të planifikimit ose me “miratim në heshtje”, sipas dispozitave të këtij ligji.

#### Neni 73

#### **Kërkesa për zhvillim**

1. Kërkesa për zhvillim përmban:

a) dokumentin që vërteton identitetin e kërkuarit;

b) dokumente që vërtetojnë:

i) të drejtat e pronësisë së kërkuarit dhe të drejtën e tij, për të kërkuar një zhvillim në pronën apo territorin e përcaktuar në kërkesë, përfshirë kufizimet e mundshme mbi pasurinë e paluajtshme, që burojnë në bazë të neneve 64, 65, 66 e 68 të këtij ligji;

ii) marrëveshjet me bashkëpronarët ose palë të treta, kur kjo gjë është kusht paraprak për fitimin e së drejtës së zhvillimit të pronës;

c) qëllimin, natyrën dhe përshkrime të mjaftueshme të zhvillimit të kërkuar, si dhe afatet për kryerjen e punimeve të zhvillimit;

ç) çdo dokument, analizë, studim, projekt, vlerësim të parashikuar në rregulloret e kontrollit të zhvillimit, që argumentojnë se kërkesa për zhvillim është në përputhje me rregullat e detyrueshme të zhvillimit në atë territor;

d) dokumente të tjera të përcaktuara në aktet nënligjore dhe në rregulloret e kontrollit të zhvillimit të territorit, të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

2. I gjithë dokumentacioni i nevojshëm për paraqitjen e një kërkesë për zhvillim, sipas këtij ligji, është i disponueshëm në mjediset e caktuara për publikun të autoritetit përgjegjës të planifikimit dhe në regjistër.

#### Neni 74

#### **Paraqitja dhe shqyrtimi i kërkesës për zhvillim**

*(Shtuar paragraf në fund të pikës 8 me ligjin nr.10 258, datë 25.3.2010, neni 4)*

1. Kërkesa për zhvillim dorëzohet:

a) pranë bashkisë/komunës, në territorin e së cilës kërkohet zhvillimi;

b) pranë secilës bashki/komunë kur zhvillimi i kërkuar parashikohet të ndodhë në territorin e më shumë se një njësie të qeverisjes vendore ose është i pandashëm, sipas dy apo më shumë territoreve të tilla.

2. Shqyrtimi i kërkesës për zhvillim dhe miratimi i lejes së zhvillimit është një akt administrativ që nxirret nga kryetari i bashkisë/komunës ose zyrtari i autorizuar prej tij me delegim, me mbështetjen profesionale dhe teknike të stafit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit.

3. Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës në bashki/komunë shqyrton, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së saj në dorëzim, dokumentacionin vetëm për çështje të përmbushjes së formës dhe i jep ose dërgon në adresë të kërkuarit vërtetimin e pranimit, ku përcaktohet data e marrjes në dorëzim të kërkesës, si dhe të dhëna që identifikojnë kërkesën dhe dokumentet bashkëlidhur. Kur autoriteti përgjegjës nuk dërgon në adresë të kërkuarit përgjigje, sipas afatit të kësaj pike, kërkesa konsiderohet e pranuar në heshtje dhe vijon shqyrtimi i saj. Bashkia/komuna e shpall kërkesën në mjediset e saj publike dhe e boton në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit brenda afatit të mësipërm.

4. Kur vërehen mangësi në dokumentacionin e detyrueshëm të kërkesës për zhvillim, njësia e qeverisjes vendore njofton me shkresë kërkuuesin, për plotësimin e dokumentacionit, sipas mangësive të vëna re dhe rrugën që duhet të ndjekë për t'i plotësuar ato. Ajo i jep kërkuuesit një afat jo më shumë se 30 ditë nga përfundimi i afatit të përmendur në pikën 3 të këtij neni, për plotësimin e tyre. Në rast se kërkuesi nuk i plotëson këto mangësi brenda afatit të mësipërm, kërkesa nuk pranohet dhe kërkuesi i dërgohet vërtetimi i mospranimit me shkaqet përkatëse. Riparaqitja e kërkesës pas refuzimit trajtohet si kërkesë e re.

5. Brenda 5 ditëve nga data e pranimit të kërkesës nga autoriteti përgjegjës, sipas pikave 3 e 4 të këtij neni, kërkuesi bën njoftimin publik, në vende të dukshme, në afërsi të parcelës, ku do të kryhet zhvillimi dhe brenda saj. Kërkesa për zhvillim dhe njoftimet e bëra nga kërkuesi në parcelë dhe përreth saj qëndrojnë të shpallura deri në përfundimin e procesit të shqyrtimit dhe të marrjes së vendimit.

6. Brenda 20 ditëve nga botimi i saj në regjistër, sipas pikës 3 të këtij neni, çdo autoritet kombëtar dhe/ose vendor i interesuar i planifikimit dhe palë e interesuar shprehin vërejtjet, propozimet ose pretendimet e veta. Palët e interesuara kanë të drejtë të konsultojnë të gjitha studimet, që bëhen për shqyrtimin e kërkesës për zhvillim. Mosshprehja e një qëndrimi brenda afatit të mësipërm vlerësohet si mungesë kundërshtimi ndaj kërkesës. Vërejtjet e marra, sipas kësaj pike, i bashkëlidhen kërkesës për zhvillim dhe shqyrtohen nga strukturat përgjegjëse për kontrollin e zhvillimit dhe nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore ose zyrtari i autorizuar prej tij me delegim.

7. Miratimi ose refuzimi i çdo kërkesë për zhvillim kryhet vetëm pas shqyrtimit e vlerësimit ligjor e teknik të saj nga strukturat përgjegjëse për kontrollin e zhvillimit dhe çështjet juridike të autoritetit përgjegjës të planifikimit. Jo më vonë se 20 ditë nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 6 të këtij neni, përgjegjësit e strukturave të mësipërme shqyrtojnë e vlerësojnë praktikën e kërkesës për zhvillim, nënshkruajnë raportin, me propozimin për pranimin me ose pa vërejtje a kushte apo refuzimin e saj dhe e botojnë atë në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit, si dhe ia përcjellin praktikën për vendimmarrje kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore ose zyrtarit të autorizuar prej tij me delegim.

8. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore ose zyrtari i autorizuar prej tij me delegim shqyrton, jo më vonë se 10 ditë nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, sipas rastit, përputhshmërinë e kërkesës vetëm me:

a) instrumentet vendore dhe kombëtare të planifikimit në fuqi dhe kërkon, për zhvillimin e propozuar, zbatimin e kriterëve të parashikuara në këto instrumente;

b) rregulloret model dhe me kriteret e përcaktuara në instrumentet kombëtare të detyrueshme të planifikimit, nëse zhvillimi i propozuar vendoset në një zonë, për të cilën autoriteti vendor i planifikimit nuk ka miratuar një instrument vendor të planifikimit.

Në rastet kur zhvillimi është projektuar në zona kombëtare, në prona shtetërore të patransferuara te njësitë e qeverisjes vendore dhe në oborre që përdoren për shërbime që ofrohen nga shteti për arsimin dhe shëndetësinë, kërkesa për zhvillim i përcillet për miratim KKT-së.

9. Përpara çdo vendimi për një kërkesë zhvillimi, sipas shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni, autoriteti përgjegjës i planifikimit organizon të paktën një dëgjim publik, me të gjitha palët e interesuara, për të marrë vërejtjet dhe propozimet e tyre.

#### Neni 75

#### **Vendimmarrja për kërkesën për zhvillim**

*(Shtuar një paragraf në fund të pikës 1 me ligjin nr.10 258, datë 25.3.2010, neni 5)*

1. Pas shqyrtimit të kërkesës për zhvillim, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore ose zyrtari i autorizuar prej tij me delegim merr vendim të arsyetuar për kërkesën si më poshtë:

a) kërkesa është miratuar;

b) kërkesa është miratuar me kushte të vëna nga autoriteti përgjegjës, të cilat, pa cenuar thelbin e saj, kërkojnë zbatimin e rregullave të detyrueshme, të parashikuara në instrumentet e planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit;

c) kërkesa është refuzuar, si pasojë e mosplotësimit të një ose më shumë kriterëve të instrumenteve të detyrueshme të planifikimit e të kontrollit të zhvillimit.

Vendimi përmban në pjesën e arsytimit shkaqet e refuzimit. Në këtë rast, kërkuesi mund të plotësojë kriteret dhe të paraqesë një kërkesë të re për zhvillim.

Në të njëjtën mënyrë, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore ose zyrtari i autorizuar prej tij shpall vendimin e marrë nga KKT-ja për rastet e përcaktuara në paragrafin e fundit të pikës 8 të nenit 74.

2. Në kushtet e lejes së zhvillimit, në varësi të llojit të strukturës, përcaktohet detyrimi për pranimin e kontrollit të realizimit të zhvillimit, sipas fazave të përcaktuara në rregulloret e kontrollit të zhvillimit.

3. Bashkia/komuna i kthen përgjigje me shkrim kërkuetit, së bashku me një kopje të vendimit të marrë, për pranimin apo refuzimin e kërkesës për zhvillim, jo më vonë se 55 ditë pas marrjes në dorëzim të kërkesës për zhvillim. Vendimi për miratimin ose refuzimin e kërkesës për zhvillim botohet në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit brenda të njëjtit afat. Në mungesë të përgjigjes, brenda afatit të mësipërm, si dhe kur nuk janë bërë vërejtje ose pretendime, sipas pikës 6 të nenit 74 të këtij ligji, kërkesa për zhvillim e, për pasojë, leja e zhvillimit vlerësohen, paraprakisht, të miratuara në heshtje, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 72 të këtij ligji.

4. Brenda 5 ditëve pas përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, zhvilluesi bën njoftimin në vende të dukshme, në afërsi të parcelës, ku do të kryhet zhvillimi dhe brenda saj, në regjistër, si dhe në një gazetë. Në mungesë të vërejtjeve ose pretendimeve nga palë të interesuara, brenda 10 ditëve nga data e botimit dhe e njoftimit nga zhvilluesi, leja e zhvillimit vlerësohet përfundimisht e miratuar në heshtje, me përjashtim të rasteve të përcaktuara sipas shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 72 të këtij ligji. Struktura përgjegjëse për kontrollin e zhvillimit duhet të lëshojë lejen përkatëse të zhvillimit të miratuar në heshtje, jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i afatit të përcaktuar në këtë pikë dhe ta botojë atë në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit.

5. Brenda 10 ditëve nga data e marrjes së lejes së zhvillimit, zhvilluesi vendos në kantier tabelën me të dhëna për lejen e dhënë dhe fillon punimet jo më parë se 30 ditë nga data e marrjes së lejes. Për zhvillimet, për të cilat rregulloret e ndërtimit përcaktojnë pajisjen me leje ndërtimi, afatet e mësipërme të kësaj pike llogariten nga data e marrjes së lejes së ndërtimit.

6. Gjatë periudhës nga data e miratimit të lejes deri në datën e fillimit të punimeve mund të bëhet ankim administrativ dhe më pas ankim gjyqësor, sipas legjislacionit në fuqi.

7. E drejta për zhvillim ushtrohet brenda 1 viti nga data e marrjes së lejes së zhvillimit, sipas këtij neni ose nenit 76 të këtij ligji. Për zhvillimet, për të cilat rregulloret e ndërtimit përcaktojnë pajisjen me leje ndërtimi, afati i mësipërm i kësaj pike llogaritet nga data e miratimit të lejes së ndërtimit. Me kalimin e afatit të mësipërm, bëhet kërkesë e re për zhvillim dhe/ose ndërtim. Afatet minimale dhe maksimale për kryerjen e punimeve të ndryshme përcaktohen në rregulloret e kontrollit të zhvillimit.

8. Autoriteti i planifikimit siguron, gjatë fazës së shqyrtimit të kërkesës për zhvillim dhe pas marrjes së vendimit përkatës, kushtet e përshtatshme për informimin e vënien në dispozicion të palëve të interesuara dhe të autoriteteve të inspektimit në mjediset e institucionit të dokumentacionit, që shoqëron kërkesën për zhvillim, përfshirë vërejtjet e propozimet e bëra mbi të.

## Neni 76

### Procedura e veçantë

1. Miratimi në heshtje i lejes, sipas pikave 3 e 4 të nenit 75 dhe pikës 4 të nenit 77 të këtij ligji, nuk zbatohet për punime të përcaktuara në rregulloret e kontrollit të zhvillimit ose të ndërtimit që, për shkak të natyrës e vëllimit të tyre, kanë rrezikshmëri të lartë për:

- a) mjedisin;
- b) sigurinë apo shëndetin publik;
- c) sigurinë e jetës;

- c) trashëgiminë kombëtare e kulturore;
- d) bllokimin e sistemit natyror të kullimit;
- dh) zonat e mbrojtura ose të ndotura.

2. Para shqyrtimit administrativ të kërkesës së zhvillimit për punimet e mësipërme, autoriteti vendor përgjegjës i planifikimit i dërgon për miratim, sipas përcaktimeve të rregulloreve të kontrollit të zhvillimit, ministrit përgjegjës të linjës kërkesën për zhvillim, menjëherë pas botimit në regjistër, sipas pikës 3 të nenit 74 të këtij ligji. Stafit teknik i ministrisë, pas shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit, harton raportin teknik që i dorëzohet ministrit për shqyrtim brenda 30 ditëve nga marrja në dorëzim e kërkesës dhe e boton në regjistër. Ministri përgjegjës i linjës shprehet brenda 10 ditëve nga afati i mësipërm.

## SEKSIONI IV LEJA E NDËRTIMIT

Neni 77

### **Leja e ndërtimit**

*(Shtuar dy paragrafë në fund të pikës 2 me ligjin nr.10 258, datë 25.3.2010, neni 6)*

1. Lëshimi i lejes së ndërtimit kryhet vetëm pas shqyrtimit e verifikimit të përputhshmërisë së kërkesës me rregulloret e ndërtimit në fuqi dhe/ose me përcaktimet e lejes të zhvillimit.

2. Çdo leje ndërtimi jepet në bazë të një kërkesë të veçantë, e cila mund të kryhet njëkohësisht me kërkesën për zhvillim, kur lejohet nga rregulloret e kontrollit të zhvillimit.

Lejet e ndërtimit në zona kombëtare dhe në prona shtetërore të patransferuara te njësitë e qeverisjes vendore miratohen nga KKT-ja.

Lejet e ndërtimit në oborre që përdoren për shërbime që ofrohen nga shteti për arsimin dhe shëndetësinë, për ndërtime me karakter jopublik, miratohen nga KKT-ja.

3. Afatet minimale dhe maksimale për kryerjen e punimeve të ndryshme vendosen në lejen e ndërtimit, në përputhje me rregulloret e kontrollit të zhvillimit.

4. Leja e ndërtimit lëshohet sipas kërkesave të neneve 72 deri në 76 të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për ndërtimin.

## SEKSIONI V LEJA E INFRASTRUKTURËS

Neni 78

### **Leja e infrastrukturës**

1. Leja e infrastrukturës jepet për punimet në rrjetet e infrastrukturës publike, kombëtare ose vendore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe për strukturat që lidhen me funksionimin e tyre në fushën e transportit, të energjisë, administrimit të ujit, telekomunikacioneve, mbrojtjes së tokës, mbrojtjes e sigurisë publike e kombëtare.

2. Ajo miratohet nga ministri përgjegjës i linjës për infrastrukturën kombëtare dhe kryetari i bashkisë/komunës për atë vendore, sipas procedurës të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, në rastet kur infrastruktura publike është e parashikuar në një instrument të planifikimit në fuqi.

3. Autoriteti përgjegjës, sipas pikës 2 të këtij neni, mund të miratojë, sipas rrethanave e rëndësisë, projekte infrastrukture që zërthejnë parashikimet e kriteret e instrumenteve të planifikimit në fuqi për aq sa i është deleguar nga autoriteti miratues i tyre.

4. Për këto punime, autoriteti përgjegjës, sipas pikës 2 të këtij neni, pasi ka verifikuar përputhshmërinë e projektit me instrumentet e detyrueshme të planifikimit, të kontrollit të zhvillimit dhe rregulloret përkatëse të ndërtimit në fuqi, bën njoftim publik, përfshirë botimin në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit dhe pret pretendimet dhe vërejtjet e autoriteteve të tjera planifikuese ose të palëve të interesuara brenda afatit të përcaktuar në pikën 6 të nenit 74 të këtij ligji. Kur autoriteti përgjegjës e gjykon të nevojshme të kryejë një proces shqyrtimi e miratimi të projektit me dy faza për projekte të mëdha, afati, sipas fjalisë së mësipërme, është i zbatueshëm për

secilën fazë veçmas. Me kalimin e këtij afati, autoriteti përgjegjës i planifikimit merr vendim për nisjen e punimeve dhe kryen njoftimin publik brenda 60 ditëve nga data e botimit. Njoftimi publik përmban të gjitha elementet dokumentuese të një kërkesë për zhvillim dhe botohet në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit. Punimet fillojnë jo më parë se 60 ditë nga data e hyrjes në fuqi të vendimit.

## SEKSIONI VI LEJA E PËRDORIMIT

### Neni 79 Leja e përdorimit

1. Në fund të procesit të zhvillimit, autoriteti përgjegjës i planifikimit lëshon lejen e përdorimit të strukturës që konfirmon, sipas rastit, përfundimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes së zhvillimit dhe/ose lejes së ndërtimit apo zbatimin e kriterëve të instrumenteve të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit, për rastet e punimeve që kryhen me deklaram paraprak të punimeve.

2. Leja e përdorimit lëshohet, kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes, sipas fazave të përcaktuara në rregulloret e kontrollit të zhvillimit si, por jo vetëm, për themelin, karabinanë, punimet mekanike, hidraulike, të izolimit, rifiniturave dhe të sistemimeve të jashtme.

3. Në rastet e refuzimit të lejes së përdorimit, lëshohet akti i konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili, në pjesën e arsytimit u referohet dokumenteve e akteve të kontrollit të përmendura në pikën 2 të këtij neni, të dhënave dhe argumenteve të hollësishme mbi mospërputhjet e konstatuara, rëndësinë e tyre, përshkruan mënyrën se si është arritur në këtë përfundim dhe jep sugjerime për sigurimin e përputhshmërisë nga zhvilluesi.

4. Leja e përdorimit shqyrtohet e jepet sipas procedurës dhe afateve të përcaktuara në legjislacionin për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit.

5. Brenda afateve të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, autoriteti përgjegjës i planifikimit njofton, zyrtarisht, nëpërmjet shërbimit “me përgjigje të marrë”, aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë së punimeve me lejen e zhvillimit, të ndërtimit dhe/ose deklarimin paraprak të punimeve. Në njoftim përmenden edhe sanksionet e zbatueshme. Njoftimi mund të bëhet nëpërmjet komunikimit elektronik, kur kjo gjë është pranuar në kërkesë sipas adresës së dhënë. Në këtë rast, njoftimi vlerësohet se është marrë në datën, kur konsultohet prej marrësit, sipas konfirmimit elektronik. Në mungesë të këtij të fundit, njoftimi vlerësohet se është marrë brenda 8 ditëve nga dërgimi prej autoritetit të planifikimit.

6. Në rastet kur nuk është marrë vendim brenda afateve të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, leja e përdorimit vlerësohet e miratuar në heshtje dhe lëshohet nga autoriteti përgjegjës i planifikimit brenda 15 ditëve nga përfundimi i tyre, me kërkesë të të interesuarit dhe botohet në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit.

7. Leja e përdorimit për punimet e infrastrukturës publike lëshohet sipas procedurës dhe afateve të përcaktuara në nenin 78 të këtij ligji.

8. Punimet e kryera në zbatim të këtij ligji, që ndryshojnë pronësinë, regjistrohen, sipas ligjit, në regjistrat e pasurive të paluajtshme, në bazë të lejes së përdorimit, të lëshuar sipas përcaktimeve të këtij ligji.

## SEKSIONI VII VËZHGIMI, INSPEKTIMI, KUNDËRVAJTJET E DËNIMET

### Neni 80 Vëzhgimi i zhvillimeve në territor

1. Çdo autoritet i planifikimit, në përputhje me sferën e tij të juridiksionit dhe të përgjegjësi, kryen vëzhgime për zhvillimet në territor, me qëllim studimin dhe vlerësimin e këtyre

zhvillimeve, parashikimin e rreziqeve apo të tendencave, parandalimin e zhvillimeve të dëmshme apo për ndërmarrjen e politikave, miratimin e instrumenteve apo të kryerjes së veprimeve të përshtatshme, për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit.

2. Autoritetet e planifikimit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimet ndërmjet tyre dhe bashkëveprojnë e shkëmbejnë informacione e të dhëna.

3. Çdo autoritet i planifikimit përgatit, brenda fundit të muajit mars të çdo viti, raportin vjetor për zhvillimet në territor të vitit të mëparshëm, për çështjet dhe territorin e tij administrativ dhe e boton në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit.

4. AKPT-ja, bazuar në raportet e autoriteteve të tjera, si dhe në vëzhgimet e kryera prej saj, përgatit dhe boton, brenda fundit të muajit qershor të çdo viti, raportin kombëtar për zhvillimet në territor të vitit të mëparshëm, i cili botohet në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit.

5. Këshilli i Ministrave përcakton strukturën e unifikuar të raporteve të përmendura në pikat e mësipërme të këtij neni.

## Neni 81

### **Inspektimi**

1. Inspektimi ka për mision bazë parandalimin e zhvillimeve të paautorizuara në territor apo të shkeljeve të kushteve të lejeve, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.

2. Inspektimi për zhvillimet në territor kryhet sipas ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” dhe dispozitave të këtij ligji.

3. Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësisë, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar.

4. Aktet e nxjerra nga autoritetet e inspektimit gjatë veprimtarisë së tyre ose të ankimit botohen në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit.

5. Të dhënat e përmbledhura dhe konkluzionet e veprimtarisë së inspektimit janë pjesë e raportit vjetor mbi zhvillimet në territor.

## Neni 82

### **Kundërvajtjet administrative**

Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative si më poshtë:

1. Moskryerja e procesit të dëgjimit publik dhe këshillimit të kërkuar për hartimin e miratimin e instrumenteve të planifikimit e të kontrollit të zhvillimit dënohet me gjobë nga 10 000 lekë deri në 50 000 lekë.

2. Miratimi i lejes së zhvillimit, lejes së ndërtimit, lejes së infrastrukturës apo lejes së përdorimit, në kundërshtim me këtë ligj, qoftë edhe me pranimin në heshtje, dënohet me gjobë nga 50 000 lekë deri në 200 000 lekë; mosveprimet e pambështetura në ligj, me pasojë miratimin në heshtje në kundërshtim me ligjin, dënohen me gjobë nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë.

3. Mosbotimi në regjistër i akteve, për të cilat botimi është i detyrueshëm, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, dënohet me gjobë nga 20 000 lekë deri në 100 000 lekë.

4. Mosdeklarimi paraprak i punimeve që përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me leje, sipas pikës 3 të nenit 71 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 lekë deri në 150 000 lekë.

5. Moskryerja e afishimit të kërkesës për zhvillim, sipas pikës 5 të nenit 74 të këtij ligji, ose të lejes në parcelë dhe përreth saj, ku kryhen punimet, sipas pikave 4 e 5 të nenit 75 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 lekë deri në 200 000 lekë.

6. Shkelja e afatit të fillimit të punimeve, sipas pikës 5 të nenit 75 të këtij ligji, e vlefshmërisë ose e afateve të lejes, sipas neneve 75 pika 7 dhe 77 pika 3 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 lekë deri në 300 000 lekë.

7. Shkelja e kushteve të lejes:

a) pa pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe e vëllim ndërtimor dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 300 000 lekë;

b) me pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe e vëllim ndërtimor dënohet me gjobë nga 200 000 lekë deri në:

i) 5 për qind të vlerës totale të punimeve, sipas përcaktimeve në leje deri në 5 milionë lekë;

ii) 10 për qind të vlerës totale të punimeve, sipas përcaktimeve në leje mbi 5 milionë lekë.

8. Kryerja e punimeve pa leje:

a) pa pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe e vëllim ndërtimor dënohet me gjobë nga 300 000 lekë deri në 30 për qind të vlerës totale të punimeve të kryera pa leje si më poshtë:

i) deri në 10 për qind për punime me vlerë deri në 5 milionë lekë;

ii) deri në 20 për qind për punime me vlerë nga 5 deri në 10 milionë lekë;

iii) deri në 30 për qind për punime me vlerë mbi 10 milionë lekë;

b) me pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe e vëllim ndërtimor dënohet me gjobë nga 400 000 lekë deri në 60 për qind të vlerës totale të punimeve të kryera pa leje si më poshtë:

i) deri në 20 për qind për punime me vlerë deri në 5 milionë lekë;

ii) deri në 40 për qind për punime me vlerë nga 5 deri në 10 milionë lekë;

iii) deri në 60 për qind për punime me vlerë mbi 10 milionë lekë.

9. Hyrja në objekt ose përdorimi i objektit pa lëshimin e lejes së përdorimit, sipas nenit 79 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 3 000 000 lekë.

10. Vazhdimi i punimeve me gjithë vendimin administrativ për pezullimin ose ndërprerjen e tyre dënohet me gjobë nga 2 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë.

11. Vlera e punimeve të kryera pa leje, sipas pikave 7 shkronja “b” dhe 8 të këtij neni, llogaritet sipas kostos mesatare të ndërtimit, të përcaktuar me udhëzim të Këshillit të Ministrave. Rregulloret e kontrollit të zhvillimit, sipas nenit 59 të këtij ligji, bëjnë nënndarje të masës së gjobës, në përputhje me vlerat minimale e maksimale të përcaktuara në këtë nen.

## Neni 83

### **Ekzekutimi i dënimeve**

1. Gjodat e përcaktuara sipas nenit 82 të këtij ligji vendosen nga autoriteti vendor përgjegjës i inspektimit.

2. Autoriteti kombëtar i inspektimit vendos gjodat e përcaktuara, sipas nenit 82 të këtij ligji, për shkeljet e konstatuara në nivel kombëtar, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Autoriteti kombëtar i inspektimit kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij ligji nga autoriteti vendor i inspektimit dhe ushtron detyrat e tij për çështje të rëndësishme kombëtare në planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit, kur konstaton shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe kur ato nuk janë ushtruar nga autoriteti vendor i inspektimit.

3. Masa e gjobës përcaktohet, në çdo rast, në përpjesëtim të drejtë me natyrën e kundërvajtjes së konstatuar, me përgjegjësinë dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje të zyrtarit ose të kundërvajtësit dhe me faktin nëse kundërvajtësi është përsëritës apo jo.

4. Në rast përsëritjeje të kundërvajtjes, kundërvajtësi dënohet me dyfishin e vlerës së gjobës.

5. Procedurat e konstatimit të kundërvajtjes, të njoftimit të kundërvajtësit, vendimit, ankimit dhe masave të tjera administrative, kundrejt shkeljeve të këtij ligji, rregullohen sipas ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” dhe dispozitave të këtij ligji.

6. Për punimet e kryera pa leje ose në shkelje të kushteve të lejes, sipas këtij ligji, autoritetet e inspektimit, krahas dënimit për kundërvajtjet e konstatuara, sipas nenit 82 të këtij ligji, i kërkojnë kundërvajtësit të paraqesë pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit, sipas seksioneve III, IV e V të këtij kreu, një kërkesë për pajisjen me leje të punimeve të paligjshme ose të kryera në shkelje të kushteve të lejes fillestare. Kundërvajtësi paraqet, së bashku me kërkesën për zhvillim, dokumentin



që vërteton pagimin e gjobës së vënë, sipas nenit 82 të këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e vendimit për kundërvajtjen administrative.

7. Gjatë shqyrtimit, sipas seksioneve III, IV e V të këtij kreu, të kërkesës për leje të punimeve të paligjshme ose të kryera në shkelje të kushteve të lejes fillestare, sipas pikës 6 të këtij neni, autoriteti përgjegjës i planifikimit merr parasysh faktet e rrethanat e mëposhtme:

- a) natyrën e shtrirjes e zhvillimit të paautorizuar;
- b) dëmin ndaj mjedisit natyror ose të ndërtuar dhe shkallën e dëmit të shkaktuar ndaj pronarëve apo poseduesve fqinjë të tokës;
- c) përfitimet e zhvillimit të paautorizuar;
- ç) masat e mundshme alternative, që mund të merren, për të korrigjuar ose kthyer në gjendje të ligjshme zhvillimin e paautorizuar;
- d) shkallën e përgjegjësisë së çdo personi, që posedon tokën, ku është kryer ose po kryhet një zhvillim i paautorizuar dhe të çdo personi që po kryen ose ka kryer zhvillimin e paautorizuar;
- dh) shpenzimet e pritshme për ta sjellë zhvillimin në gjendje të ligjshme dhe aftësinë e tyre për të kryer këto shpenzime;
- e) nëse, në të gjitha rrethanat dhe në përputhje me interesin publik, është e domosdoshme, e përshtatshme dhe e favorshme për të refuzuar pjesërisht ose tërësisht zhvillimin e paautorizuar;
- ë) çdo çështje tjetër, që autoriteti përgjegjës i planifikimit mund ta gjykojë të përshtatshme.

8. Në vendimin për miratimin ose refuzimin e pjesëshëm apo të plotë të lejes, autoriteti përgjegjës i planifikimit kërkon kryerjen e një ose të të gjitha veprimeve të mëposhtme, për të korrigjuar kundërvajtjet e vëna re:

- a) shemb, prish ose heq të gjithë ndërtimin ose pjesë të tij;
- b) ngre ose ringre një ndërtim në tërësi ose në pjesë të caktuara;
- c) i ofron aksesin e duhur një zhvillimi të paautorizuar ose një zhvillimi pranë tij, të cilit i është hequr, penguar ose bërë i papërshtatshëm aksesin nga zhvillimi i paautorizuar;
- ç) vë në dispozicion tokë për ndërtimin dhe funksionimin e shërbimeve publike;
- d) përmirëson zhvillimin e paautorizuar;
- dh) rikthen tokën, për aq sa është e mundur, në shfaqjen e gjendjen e saj përpara kryerjes së zhvillimit të paautorizuar, përfshirë mbjelljen ose rimbjelljen e çdo peme ose bimësie tjetër;
- e) heq dhe transporton në një vend të përcaktuar çdo mbeturinë ose grumbull mbeturinash të materialeve të braktisura në tokë ose të lëna mbi të, si rezultat i një zhvillimi të paautorizuar;
- ë) bën të parrezikshëm e të sigurt çdo mbeturinë ose grumbull mbeturinash të materialeve të braktisura në tokë ose të lëna mbi të, si rezultat i një zhvillimi të paautorizuar;
- f) pushon së përdoruri çdo tokë ose strukturë në të ardhmen ose për çdo qëllim të caktuar;
- g) kryen ose ndërmerr çdo veprim tjetër, që vlerësohet se do të ndihmojë për të korrigjuar, përmirësuar ose ndaluar shkeljen.

9. Në rastin e refuzimit të kërkesës për zhvillim, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 75 të këtij ligji ose të mosrespektimit apo refuzimit nga kundërvajtësi të veprimeve të përmendura në pikën 8 të këtij neni, kundërvajtësi, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit të refuzimit të lejes ose të afatit të kërkuar, për kryerjen e veprimeve të mësipërme, është i detyruar, me shpenzimet e tij, ta kthejë tokën apo strukturën në gjendjen para kryerjes së punimeve të paligjshme ose të kryera në shkelje të kushteve të lejes fillestare.

10. Moszbatimi i detyrimit brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 9 të këtij neni, përbën shkak për marrjen e masave të mëposhtme:

- a) dënimin e kundërvajtësit, sipas kushteve të pikës 4 të këtij neni dhe detyrimin për pagimin e shpenzimeve për kthimin e tokës apo të strukturës në gjendjen para kryerjes së punimeve të paligjshme ose të kryera në shkelje të kushteve të lejes fillestare;
- b) futjen në kantier të përfaqësuesve të autorizuar të autoritetit përgjegjës të planifikimit, për kthimin e tokës apo të strukturës në gjendje të ligjshme, sipas përcaktimeve të shkronjës “a” të kësaj pike.

11. Kur një zhvillim është kryer prej të paktën 10 vjetësh, refuzimi i lejeve ose i deklaratës paraprake të punimeve nuk mund të shërbejë si bazë për parregullshmërinë e zhvillimit fillestar, në kuptim të këtij ligji. Ky rregull nuk zbatohet kur:

a) zhvillimi, për shkak të natyrës dhe vendndodhjes së tij, u shkakton përdoruesve ose të tretëve rreziqe vdekjeprurëse ose plagosje, që shkaktojnë gjymtim apo paaftësi të përhershme;

b) një procedurë prishjeje e ndërtimit është në proces në planin administrativ ose për shkak të një vendimi gjyqësor, që nuk ka marrë formë të prerë ose nuk është ekzekutuar;

c) zhvillimi ndodhet në zona të mbrojtura, sipas ligjit;

ç) zhvillimi është në pronë publike;

d) zhvillimi është kryer pa leje.

12. Të ardhurat nga gjobat dhe interesat arkëtohen e administrohen sipas legjislacionit në fuqi.

## SEKSIONI VIII

### ANKIMI

#### Neni 84

#### **Ankimi ndaj vendimeve të autoriteteve kombëtare të planifikimit**

Autoritetet vendore të planifikimit apo palët e interesuara mund të ankohen në gjykatë:

a) për përcaktimin e rëndësisë kombëtare të një çështjeje në planifikim, kur pretendojnë se ekzistojnë mospërputhje me kërkesat e këtij ligji apo konflikt me përgjegjësitë e njësisë të qeverisjes vendore, të dhëna me ligj, pasi kanë ndërmarrë më parë procedurën e ndërmjetësimit, sipas këtij ligji, në rastin e autoriteteve vendore të planifikimit;

b) ndaj një instrumenti të detyrueshëm të planifikimit apo rregulloreje të kontrollit të zhvillimit, nëse ky instrument nuk është i nevojshëm për realizimin e qëllimit, për të cilin është nxjerrë.

#### Neni 85

#### **Ankimi ndaj instrumentit vendor të planifikimit**

1. Palët e interesuara ose çdo autoritet kombëtar i planifikimit paraqesin kundërshtimet e tyre pranë këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, ndaj një instrumenti vendor të planifikimit dhe zbatimit të tij ndaj tyre.

2. Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore shprehet brenda 45 ditëve.

3. Çdo palë mund të ankohet në gjykatë për mosveprimin e këshillit në afat apo çdo vendim të këshillit në lidhje me ankimin.

#### Neni 86

#### **Ankimi administrativ dhe gjyqësor**

1. Çdo person ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj. Në përfundim të ankimit administrativ, bëhet ankim në gjykatë i cili nuk pezullon ekzekutimin e vendimmarrjes administrative.

2. Për procedurat e ankimit zbatohen rregullat dhe afatet, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## KREU VIII

### DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

#### Neni 87

#### **Ngritja e AKPT-së, rregulloret dhe regjistri**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të marrë masat e duhura administrative e financiare dhe të nxjerrë aktet nënligjore, të nevojshme për fillimin e funksionimit të AKPT-së, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Me ngritjen e saj, AKPT-ja kryen të gjitha funksionet, që i janë ngarkuar me ligj strukturës administrative përkatëse në ministrinë që mbulon çështjet e planifikimit të territorit.

2. AKPT-ja, me ngritjen e saj, harton projektaktet nënligjore:

a) për rregulloret uniforme të planifikimit, sipas nenit 24 të këtij ligji, brenda datës 1 dhjetor 2009;

b) për rregulloret model të planifikimit, sipas nenit 88 të këtij ligji, rregulloret uniforme të kontrollit të zhvillimit, sipas nenit 62 të këtij ligji dhe regjistrin, sipas nenit 55 të këtij ligji, brenda datës 1 maj 2010;

c) zbaton planin e saj të punës për kalimin në sistemin e ri të planifikimit të territorit, në përputhje me këtë ligj, përfshirë hartimin e metodologjive, ofrimin e informimit, trajnimit e këshillimit të nevojshëm.

#### Neni 88

### **Rregulloret model të planifikimit**

1. Rregulloret model të planifikimit janë instrumenti i vetëm, mbi të cilin mbështetet autoriteti vendor i planifikimit, për shqyrtimin e kërkesave për zhvillim dhe dhënien e lejeve, derisa të ketë miratuar instrumentet vendore të planifikimit, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Rregulloret model të planifikimit kufizojnë intensitetin e ndërtimit mbi atë që mbizotëron në një zonë të caktuar dhe ndryshimet nga përdorimet ekzistuese të tokës.

3. AKPT-ja harton projektregulloret model të planifikimit dhe i boton ato në Buletinin e Njoftimeve Publike.

4. Brenda 30 ditëve nga botimi i tyre, AKPT-ja organizon seanca dëgjimi publik dhe mbledh vërejtjet e propozimet e palëve të interesuara. AKPT-ja shqyrton vërejtjet e propozimet e bëra dhe ndryshon rregulloret model të planifikimit ose jep arsyet e mosndryshimit të tyre.

5. AKPT-ja dorëzon në Këshillin e Ministrave, për miratim projektregulloret model të planifikimit, brenda 60 ditëve pas seancës së fundit të dëgjimit publik.

6. Rregulloret model të planifikimit, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, botohen dhe janë të disponueshme për autoritetet vendore të planifikimit, për të gjitha palët e interesuara dhe për publikun.

#### Neni 89

### **Hartimi i planeve të përgjithshme territoriale**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të fillojë hartimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar jo më vonë se 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe ta miratojë atë jo më vonë se 2 vjet nga data e fillimit të efekteve të plota të këtij ligji.

2. Ngarkohen autoritetet vendore të planifikimit, që kanë popullsi mbi 10 mijë banorë në territorin e tyre administrativ, të fillojnë hartimin e planeve të përgjithshme territoriale vendore jo më vonë se 1 vit nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe t'i miratojnë ato jo më vonë se 2 vjet nga data e fillimit të efekteve të plota të këtij ligji.

3. Ngarkohen autoritetet vendore të tjera të planifikimit të fillojnë hartimin e planeve të përdorimit të tokës jo më vonë se 1 vit nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe t'i miratojnë ato jo më vonë se 2 vjet nga data e fillimit të efekteve të plota të këtij ligji dhe të zbatojnë rregulloret model të kontrollit të zhvillimit.

4. Për instrumentet e planifikimit, të përmendura sipas pikave të mësipërme të këtij neni, që janë në proces hartimi, zbatohen dispozitat e këtij ligji, pas hyrjes së tij në fuqi, për pjesën e mbetur të procesit hartues, shqyrtues ose miratues dhe përputhshmërisë me rregulloret uniforme dhe instrumentet kombëtare të planifikimit.

5. Planet territoriale vendore, të miratuara deri në 2 vjet nga data e fillimit të efekteve të plota të këtij ligji, hyjnë në fuqi pas miratimit të tyre nga KKT-ja.

Neni 90  
**Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9, 24, 55, 62, 70 pika 4, 80 pika 5, 87 e 88 të këtij ligji.

Neni 91  
**Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut**

Para dhe pas fillimit të efekteve të plota të këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, AKPT-ja ndërmerr, sipas një plani veprimesh, programe trajnimi, edukimi e ndërgjegjësimi të publikut, duke përdorur të gjitha format e komunikimit, për të përmirësuar interesimin publik dhe bashkëpunimin në lehtësimin e kushteve të jetesës dhe aftësitë e zyrtarëve të autoriteteve të planifikimit për të zbatuar dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe për të informuar publikun për përmbajtjen e tyre, funksionet e autoriteteve publike, sipas tyre dhe përgjegjësitë e të drejtat e palëve të interesuara e të publikut në këtë drejtim.

Neni 92  
**Fillimi i efekteve të plota të ligjit dhe shfuqizimi i ligjit ekzistues**  
*(Zëvendësuar fjalët në shkronjën "b" të pikës 1 me akt normativ nr.4, datë 25.8.2010, neni 1/1;  
zëvendësuar fjalët në pikën 3 me akt normativ nr.4, datë 25.8.2010, neni 1/2)*

1. Efektet e plota të këtij ligji fillojnë sipas fazave të mëposhtme:
  - a) për dispozitat e krerëve III e IV të këtij ligji, me hyrjen në fuqi të rregulloreve uniforme të planifikimit, sipas nenit 24 të këtij ligji, por, në çdo rast, jo më vonë se data 1 mars 2010;
  - b) për dispozitat e krerëve V e VII të këtij ligji, me hyrjen në fuqi të rregulloreve model të planifikimit, sipas nenit 88 të këtij ligji, rregulloreve uniforme të kontrollit të zhvillimit, sipas nenit 62 të këtij ligji dhe akteve nënligjore për regjistrin, sipas nenit 55 të këtij ligji, por, në çdo rast, jo më vonë se data 15 janar 2011.
2. Derisa të miratohen aktet nënligjore të mësipërme, zbatohen ligji dhe aktet nënligjore në fuqi, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë kre.
3. Ligji nr. 8405, datë 16.9.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar, shfuqizohet në tërësi në datën 15 janar 2011.

**Dispozitë kalimtare**  
*(Shtuar me ligjin nr.10 258, datë 25.3.2010, neni 7)*

Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, bashkitë e kategorisë së parë, të parashikuara në pikën 3 të nenit 2 të këtij ligji, depozitojnë për shqyrtim planet zhvillimore rregulluese, kur planet nuk i janë nënshtruar shqyrtimit dhe miratimit nga KRRTRSH-ja, sipas ligjit nr.8405, datë 16.9.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar.

Neni 93  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6160, datë 7.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.56, datë 8.5.2009, faqe 2591*

**Ligji nr.10 258, datë 25.3.2010 shpallur me dekretin nr.6502, datë 12.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.45, datë 21.4.2010, faqe 1698*

**Ligj nr.10 315, datë 16.9.2010 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.4, datë 25.8.2010, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar”shpallur me dekretin nr.6695, datë 4.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.135, datë 7.10.2010, faqe 7407*

## **VENDIM**

**Nr.460, datë 16.6.2010**

### **PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E REGJISTRIT TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

#### **I. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I REGJISTRIT TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**

1. Regjistri i Planifikimit të Territorit është një inventar elektronik dhe shkresor publik për informacionin lidhur me planifikimin e territorit, që krijohet, ruhet, mirëmbahet, administrohet dhe përditësohet në mënyrë të pavarur nga autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit dhe institucionet e tjera publike. Regjistri përmban:

- a) informacion për planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit;
- b) projektakte dhe akte të planifikimit të territorit, të përdorimit e të pronësisë së tokës;
- c) kërkesat për zhvillimin e tokës dhe lejet e zhvillimit, së bashku me të drejtat ose kufizimet ligjore, që rrjedhin prej tyre.

Informacionet e mësipërme duhet të regjistrohen në portalin web të regjistrit, i cili është një rrjet i integruar dhe shumëfunksional për shkëmbimin elektronik të informacionit.

2. Informacioni në Regjistrin e Planifikimit të Territorit mirëmbahet dhe përditësohet nga autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit, institucionet e tjera publike, që krijojnë një bazë të dhënash të pavarur për të përmbushur përgjegjësitë e tyre në përputhje me nenin 51 të ligjit nr.10 119, datë 29.4.2009 “Për planifikimin e territorit”. Personat juridikë mund të kontribuojnë me informacion për planifikimin e territorit në portalin web të regjistrit.

3. Informacioni elektronik në portalin web të regjistrit administrohet, mirëmbahet dhe përditësohet në një rrjet të integruar e shumëqëllimësh bazash të dhënash, të pavarura e ndërvepruese ndërmjet tyre. Aksesit në Regjistrin e Planifikimit të Territorit sigurohet përmes portalit të rrjetit, që përfaqëson pikën qendrore për përfundimin e shërbimeve që ofrohen nga ky Regjistër.

4. Të dhënat hapësinore dhe informacionet për planifikimin e territorit në format elektronik regjistrohen në portalin web të regjistrit nga autoritetet e planifikimit, institucionet e tjera publike, sipas strukturës dhe standardeve të parashikuara në vendimin nr.459, datë 16.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”, si dhe të udhëzimeve të ministrit që mbulon planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit, në lidhje me strukturën, përmbajtjen dhe formatin e të dhënave të kërkuara.

5. Informacioni elektronik në Regjistrin e Planifikimit të Territorit krijohet, ruhet, administrohet, mirëmbahet dhe përditësohet në mënyrë të decentralizuar nga autoritetet e planifikimit, institucionet e tjera publike, si dhe personat juridikë që kontribuojnë proporcionalisht

në ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e këtij regjistri. Këto autoritete kanë të drejtë të ndryshojnë dhe të përditësojnë informacionin që disponojnë ose t'ua delegojnë këtë kompetencë personave juridikë që mund të caktohen prej tyre.

6. Autoritetet e planifikimit të territorit, institucionet e tjera publike, si dhe personat juridikë, që regjistrojnë informacion në portalin web të regjistrimit, garantojnë që ndërveprimi i komunikimeve elektronike ndërmjet bazave të të dhënave të sigurojë mbrojtjen e të dhënave personale. Mbrojtja e këtyre të dhënave ka për qëllim moslejimin e përfuturit të informacionit në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe me aktet e nxjerra nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

7. Autoritetet e planifikimit të territorit, institucionet e tjera publike, si dhe personat juridikë, që regjistrojnë informacion në portalin web të regjistrimit, garantojnë që ndërveprimi i komunikimeve elektronike ndërmjet bazave të të dhënave të sigurojë mbrojtjen e informacionit për sigurinë kombëtare, sipas ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””. Mbrojtja e informacionit për sigurinë kombëtare ka për qëllim moslejimin e përfuturit të informacionit në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””.

8. Arkitektura e rrjetit të portalit web të regjistrimit lejon ndërveprimin e informacionit të regjistruar, ndërmjet vetë bazave të pavarura të të dhënave, si dhe ofrimin e shërbimeve për publikun, nëpërmjet aksesit në një portal qendror. Arkitektura e këtij rrjeti lejon që informacioni i regjistruar në portalin web të regjistrimit të administrohet, të ruhet, të mirëmbahet dhe të përditësohet nga çdo krijues i tij.

9. Portali web i regjistrimit përbën një rrjet ndërveprimi ndërmjet bazave të të dhënave, që i ofrojnë publikut shërbimin e zbulimit, të shikimit dhe të shkarkimit elektronik të informacionit të regjistruar në Regjistrin e Planifikimit të Territorit. Portali qendror lejon ofrimin e këtyre shërbimeve për përdoruesit e rrjetit nga çdo bazë të dhënash, që është pjesë e këtij regjistri. Ky portal lejon shpërndarjen dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet bazave të pavarura të të dhënave.

10. Shërbimi i zbulimit në portalin web të regjistrimit i krijon mundësinë përdoruesit të kërkojë dhe të gjejë informacionin elektronik, të ruajtur në regjistër, nëpërmjet përdorimit të një grupi kriteresh kërkimi.

11. Shërbimi i shikimit të portalit web të regjistrimit i krijon mundësinë çdo përdoruesi për të shikuar çdo informacion elektronik, që ofrohet nga regjistri.

12. Shërbimi i shkarkimit të portalit web të regjistrimit i krijon mundësinë përdoruesit për të përfutur në mënyrë elektronike të dhëna ose pjesë të tyre të paracaktuara, si dhe për të pasur akses të drejtpërdrejtë në shërbimet e rrjetit për të përfutur informacion nga regjistri.

13. Ngritjen dhe funksionimin e qendrave të asistencës së regjistrimit të Planifikimit të Territorit në 12 qarqe të territorit të Republikës së Shqipërisë. Qendrat e asistencës sigurojnë asistencë teknike për autoritetet e planifikimit, institucionet e tjera publike, si dhe personat juridikë, sipas nevojës, nën drejtimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit për regjistrimin, ruajtjen, administrimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e informacionit për planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

14. Qendrat e asistencës, gjithashtu, duhet të garantojnë akses të informacionit elektronik, që përfshihet në regjistër, nëpërmjet portalit web, duke mundësuar zbulimin, shikimin dhe shkarkimin e informacionit të kërkuar nga publiku. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit boton rregulla për mënyrën e aksesimit nga publiku të këtyre shërbimeve në qendrat e asistencës.

15. Qendrat e asistencës asistojnë autoritetet e planifikimit, institucionet e tjera publike, si dhe personat juridikë, me qëllim që regjistrimi i të dhënave në portalin web të Regjistrimit të kryhet në përputhje me parashikimet e vendimit nr.459, datë 16.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”, si dhe me udhëzimet e ministrit që mbulon planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit për strukturën, përmbytjen dhe formatin e të dhënave.

## II. INFORMACIONI QË REGJISTROHET DHE PUBLIKOHET NË REGJISTËR

1. Autoritetet e planifikimit dhe institucionet e tjera publike, për realizimin dhe monitorimin

e detyrave në fushën e planifikimit të territorit, duhet që, brenda një afati kohor të përcaktuar, të ndërtojnë, të menaxhojnë dhe të mirëmbajnë informacionin për planifikimin e territorit, të cilin janë të detyruar ta dërgojnë në Regjistrin e Planifikimit të Territorit.

2. Sistemi i informacionit të Regjistrit të Planifikimit të Territorit, sipas nenit 55 të ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, ndërtohet në dy faza:

a) Regjistrimi dhe publikimi i të dhënave të krijuara gjatë zbatimit të ligjit;

b) Regjistrimi dhe publikimi i të dhënave të krijuara gjatë zbatimit të ligjit sipas legjislacionit sektorial në fuqi.

3. Duke përmbledhur të dyja fazat në një të vetme, regjistri do të përmbajë të dhënat e mëposhtme, që i përkasin planifikimit të territorit, për:

a) gjendjen aktuale të territorit, bazuar në regjistrin e pronave të paluajtshme;

b) rrjetet e infrastrukturës publike, për ndërtesat dhe për territoret e tyre;

c) statusin ligjor të territorit, bazuar në dokumentet e planifikimit të territorit e të përdorimit të tokës;

ç) zona të veçanta, me regjim ligjor të veçantë, të përcaktuar në bazë të legjislacionit apo të rregulloreve sektoriale, si zona të mbrojtura, me rrezikshmëri etj.

d) trashëgiminë kulturore dhe ruajtjen natyrore, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi dhe në rregulloret për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore e ruajtjen e natyrës;

dh) hartimin, miratimin dhe monitorimin e instrumenteve të planifikimit e të kontrollit të zhvillimit të territorit.

Struktura, përmbajtja dhe formati për këto të dhëna do të përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

4. Në mbështetje të nenit 21 të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të dhënat për statusin aktual të territorit, të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të pikës 3 të këtij kreu, janë të detyrueshme për hartimin e planeve territoriale nga ana e autoriteteve kombëtare dhe vendore të planifikimit.

5. Autoritetet kombëtare dhe vendore të planifikimit të territorit janë të detyruara me ligj që të publikojnë informacionin e përcaktuar në pikën 3, të këtij kreu, secila sipas fushës së veprimit dhe kompetencës, për shikim, zbulim dhe shkarkim prej publikut.

### III. RREGULLAT PËR SIGURINË DHE RUAJTJEN E TË DHËNAVE ELEKTRONIKE

1. Autoritetet e planifikimit dhe institucionet e tjera publike shpërndajnë e shkëmbejnë të dhënat nëpërmjet përdorimit të sistemeve të komunikimeve elektronike. Ato i depozitojnë dhe i transferojnë këto të dhëna, me qëllim mbrojtjen, garantimin e sigurisë dhe paprekshmërinë e tyre.

Këto sisteme sigurojnë:

a) rikuperimin e të dhënave në çdo kohë;

b) sigurimin dhe mbrojtjen e të dhënave ndaj aksesit të paautorizuar;

c) paprekshmërinë e të dhënave gjatë shkëmbimit të ndërsjellë të tyre.

2. Autoritetet e planifikimit dhe institucionet e tjera publike e depozitojnë të gjithë informacionin për planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit në një server të bazës së të dhënave, të mirëmbajtur prej tyre.

3. Çdo person juridik, që mirëmban serverin ku regjistrohet informacioni i Regjistrit të Planifikimit të Territorit, kryen dublikimin elektronik (back-up) për të gjitha të dhënat e serverit me qëllim rikuperimin e tyre në çdo kohë. Për informacionin e regjistruar në Regjistrin e Planifikimit të Territorit, autoritetet e planifikimit detyrohen të mbajnë një kopje të njëjtë me informacionin e regjistruar në këtë regjistër brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të tyre.

4. Çdo person, që mirëmban serverin ku ndodhet informacioni i regjistruar në Regjistrin e Planifikimit të Territorit, zbaton masat e sigurisë për parandalimin e aksesit të padëshiruar që mund të sjellë dëmtime të këtyre të dhënave në server nëpërmjet transmetimit të viruseve.

5. Çdo person, që mirëmban serverin ku ndodhet informacioni i regjistruar në Regjistrin e Planifikimit të Territorit, zbaton standardet e sigurisë për sigurimin dhe mbrojtjen e paprekshmërisë të së dhënave, nëpërmjet përdorimit të protokolleve të përshtatshme për shkëmbimin e informacionit.

6. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit harton rregullat për garantimin e sigurisë dhe paprekshmërinë e të dhënave në bazën e të dhënave të Regjistrit të Planifikimit të Territorit, të cilat miratohen me udhëzim të ministrit që mbulon planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

#### IV. RREGULLAT PËR STANDARDET E PROGRAMEVE KOMPJUTERIKE

1. Programet kompjuterike, që do të përdorin autoritetet e planifikimit për sistemet apo mjetet e komunikimeve elektronike në bazat e të dhënave, duhet të jenë sipas standardeve të hapura (open standards). Këto programe duhet të sigurojnë ndërveprimin ndërmjet bazave të të dhënave të autoriteteve të planifikimit me bazat e tjera të të dhënave, që nuk janë pjesë përbërëse e Regjistrit të Planifikimit të Territorit.

2. Për arsye të ndërveprimit ndërmjet vetë bazave të të dhënave, programet kompjuterike, që do të përdoren nga autoritetet e planifikimit dhe institucionet publike, duhet të garantojnë regjistrimin e të dhënave dhe të metadave, në përputhje me vendimin nr.459, datë 16.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”, të cilat duhet të jenë të shkëmbyeshme nëpërmjet bazave të të dhënave.

3. Programet kompjuterike garantojnë kodimin e të dhënave personale, që parashikohen si të tilla në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe të informacionit për sigurinë kombëtare, sipas parashikimeve të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””.

#### V. FINANCIMI PËR KRIJIMIN DHE PËR VËNIEN NË FUNKSIONIM TË REGJISTRIT TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

1. Shpenzimet e nevojshme për krijimin dhe për mirëmbajtjen e të dhënave të planifikimit të territorit, përfshirë dhe Regjistrin e Planifikimit të Territorit, për shkëmbimin e vazhdueshëm elektronik të informacionit nëpërmjet portalit web qendror, që përfshin baza të pavarura të dhënash, rrjete sistemesh, pajisje, si dhe për ngritjen e mirëmbajtjen e portalit web me aplikacione software të planifikimit të territorit, përballohen nga buxhetet e autoriteteve kombëtare dhe vendore të planifikimit, si dhe nga buxhetet e institucioneve të tjera publike.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për mirëmbajtjen dhe funksionimin e pajisjeve të nevojshme kompjuterike hardware dhe software për funksionimin e portalit qendror të Regjistrit të Planifikimit të Territorit dhe të aplikacioneve software për autoritetet kombëtare dhe vendore të planifikimit të territorit, nëpërmjet portalit qendror. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit krijon sportele në 12 qarqe të Republikës së Shqipërisë, të pajisura me pajisje hardware dhe software. Këto sportele kanë mundësinë për t’u lidhur, nëpërmjet internetit, me portalin web të Regjistrit. Shpenzimet për kryerjen e funksioneve do të mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

3. Autoritetet kombëtare dhe vendore të planifikimit duhet të parashikojnë shpenzimet e nevojshme për krijimin dhe vënien në funksionim të Regjistrit të Planifikimit të Territorit, parashikime të cilat ua paraqesin organeve të ngarkuara me ligj, për përfshirjen e tyre në projektbuxhetet e çdo viti buxhetor.

4. Shpenzimet korrente të kërkuara nga autoritetet planifikuese për administrimin e bazës së pavarur të të dhënave, që ato mirëmbajnë si pjesë e Regjistrit të Planifikimit të Territorit, përfshirë punonjësit shtesë, si dhe për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike hardware dhe software në nivel lokal, do të financohen nëpërmjet fondeve të pakushtëzuara, të miratuara në ligjin vjetor për njësitë e qeverisjes vendore. Shuma e fondeve të parashikuara për autoritetet vendore, në lidhje me Regjistrin e Planifikimit të Territorit, i shtohet totalit të transfertës së pakushtëzuar.

5. Shpenzimet kapitale të autoriteteve planifikuese për ngritjen e informacionit që ato kërkojnë të përfshijnë në Regjistrin e Planifikimit të Territorit për zhvillimin e masterplaneve, konvertimin e informacionit në formate dixhitale, përfshirë edhe formatin GIS, si dhe për blerjen e pajisjeve kompjuterike hardware dhe software nga autoritetet e planifikimit vendor do të përballohen nga:



a) transfertat, nga fondi për zhvillimin e rajoneve nga Buxheti i Shtetit, autoriteteve të planifikimit vendor, në përputhje me një formulë korresponduese, sipas së cilës 80% e shpenzimeve kapitale të planifikuara do të përballohen nga fondi për zhvillimin e rajoneve dhe 20% nga kontributi i vetë autoriteteve vendore;

b) financime të huaja nga projekte dhe programe;

c) burime të tjera të lira të ardhurash të pushtetit vendor.

## VI. BOTIMI NË REGJISTRIN E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

1. Autoritetet e planifikimit dhe institucionet e tjera publike detyrohen të botojnë në Regjistrin e Planifikimit të Territorit të gjitha projektaktet ose aktet e miratuara, që lidhen me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

2. Projektaktet ose aktet e parashikuara në pikën 1 të këtij kreu, *inter alia*, përfshijnë:

a) projektakte të rëndësisë kombëtare;

b) projekte dhe projekte përfundimtare të instrumenteve të planifikimit;

c) propozime dhe/ose kundërshtime për projektin e instrumenteve të planifikimit;

ç) vendime miratimi të planifikimit të instrumenteve, që përfshijnë politika, strategji, rregulla të planifikimit ose pjesë përbërëse të tyre, si dhe materiale plotësuese;

d) vendime për miratimin e instrumenteve të veçanta të kontrollit të zhvillimit të territorit;

dh) vendime për pezullim zhvillimi;

e) vendime të rëndësisë kombëtare;

ë) studime dhe planveprime të projekteve të instrumenteve të planifikimit të territorit;

f) kërkesa për zhvillim së bashku me dokumentet e kërkuara për paraqitjen e këtyre kërkesave;

g) raporte që përmbajnë propozimet për miratime të kërkesave për zhvillim;

gj) vendime për miratimin ose refuzimin e kërkesave për zhvillim;

h) njoftimet për zhvillim që planifikohen nga zhvilluesi;

i) njoftime për dhënie lejeje zhvillimi-ndërtimi-infrastruktura ose përdorimi;

j) raportin vjetor të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, si dhe raporte të çdo autoriteti tjetër përgjegjës të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit;

k) projektakte ose akte që lidhen me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

Struktura, përmbajtja dhe formati i të dhënave përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

3. Autoritetet e planifikimit, institucionet e tjera publike dhe personat juridikë mund të botojnë në portalin web të regjistrin dokumente të tjera që lidhen me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

Projektaktet dhe aktet që janë të detyrueshme për botim, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij kreu, botohen menjëherë në Regjistrin e Planifikimit të Territorit.

4. Autoritetet kombëtare dhe vendore të planifikimit, që miratojnë projektakte dhe akte në zbatim të neneve 65, 66, 67, 68 e 69 të ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, janë të detyruara që, përveç botimit të tyre në portalin web të regjistrin, të njoftojnë zyrën përgjegjëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

5. Projektaktet ose aktet e miratuara, që lidhen me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit dhe që klasifikohen “sekret shtetëror” në kuptim të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, nuk duhet të zbulohen, të shikohen ose të shkarkohen për përdorim nga publiku. Shikimi, zbulimi dhe shkarkimi i tyre nga publiku trajtohen sipas ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””.

6. Botimi në bazën e të dhënave dhe në letër i projektakteve ose i akteve në portalin web të regjistrin sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij kreu, ka të njëjtën vlefshmëri ligjore, nëse botimi i tyre realizohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

## VII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Regjistri i Planifikimit të Territorit krijohet më qëllim organizimin dhe vënien në funksionim të tij, në dy faza:

a) Regjistrimi dhe botimi i të dhënave në zbatim të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”;

b) Regjistrimi dhe botimi i të dhënave të krijuara në zbatim të legjislacionit sektorial.

Nëse gjatë procesit të regjistrimit dhe të botimit të të dhënave lind nevoja për ndryshime ligjore, këto ndryshime duhet të jenë të harmonizuara me dispozitat ligjore që i takojnë Regjistrin të Planifikimit të Territorit.

2. Faza e parë përfshin regjistrimin elektronik dhe botimin e informacionit për planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit nga autoritetet e planifikimit. Regjistrimi dhe botimi i këtij informacioni kryhen sipas standardeve të parashikuara në vendimin nr.459, datë 16.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”, si dhe me udhëzim të ministrit që mbulon planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

3. Faza e dytë përfshin regjistrimin dhe botimin në bazat e të dhënave të informacionit të institucioneve shtetërore që nuk është objekt i ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, por që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

4. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në bashkëpunim me qendrat e asistencës në 12 qarqe të Republikës së Shqipërisë, si dhe autoritetet e planifikimit, marrin masa për krijimin e portalit qendror të Regjistrin të Planifikimit të Territorit.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, autoritetet e planifikimit dhe institucionet e tjera publike, marrin masa për krijimin e strukturave përkatëse për ngritjen dhe funksionimin e bazës së të dhënave të tyre, si dhe për shkëmbimin e informacionit për planifikimin e territorit nëpërmjet portalit web të regjistrin.

6. Nën drejtimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit krijohen komitetet ad-hoc, përbërja e të cilave përcaktohet me urdhër të Kryeministrit, sipas propozimit të ministrit që mbulon planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

7. Komitetet ad-hoc, të krijuara sipas pikës 6 të këtij kreu, ushtrojnë funksione këshillimore për Bordin e Gjeoinformacionit. Këto komitete kanë të drejtë t'i paraqesin rekomandime, me shkrim, Bordit të Gjeoinformacionit, në lidhje me:

a) monitorimin e zbatimit të standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS sipas përcaktimeve të vendimit nr.459, datë 16.6.2010, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”;

b) ndryshimin e strukturës të së dhënave dhe të *metadatave*;

c) paraqitjen e propozimeve Bordit të Gjeoinformacionit për pranimin e standardeve të reja gjeodezike dhe GIS, si dhe për përditësimin e tyre.

8. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit bashkërendon veprimtarinë e saj me institucionet shtetërore, përgjegjëse për regjistrimin e informacionit, lidhur me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit, të krijuar sipas legjislacionit sektorial në fuqi, si dhe përgatit, në bashkëpunim me to, planin e veprimit për fazën e dytë.

9. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit miraton manuale dhe rregullore për autoritetet e planifikimit, institucionet e tjera publike, si dhe personat juridikë, për regjistrimin e informacionit në portalin web të regjistrin.

10. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit është organi mbikëqyrës që kontrollon mënyrën e regjistrimit dhe të botimit të informacionit në portalin web të regjistrin nga autoritetet qendrore dhe vendore të planifikimit të territorit, si dhe i udhëzon këto autoritete të regjistrojnë të dhënat e tyre në përputhje me standardet e kërkuara.

11. Deri në datën e fillimit të efekteve të plota të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në bashkëpunim me qendrat e asistencës në 12 qarqe të Republikës së Shqipërisë, të marrë masa për trajnimin e personelit administrativ, të ngarkuar me regjistrimin, ruajtjen, administrimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e informacionit në portalin web të regjistrin.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet e tij sipas parashikimeve të shkronjës “b” të nenit 92 të ligjit nr.10119, datë 23.4 2009 “Për planifikimin e territorit”.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.90, datë 15.7.2010, faqe 4609*

**LIGJ**  
**Nr.9780, datë 16.7.2007**

**PËR INSPEKTIMIN E NDËRTIMIT**  
*(Ndryshuar me ligjin nr.10 240, datë 25.2.2010;  
ndryshuar me ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010)*

*I përditësuar*

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1  
**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë respektimin e normave, standardeve dhe legjislacionit në fushën e ndërtimit, urbanistikës dhe rezervave ujore, në të gjithë territorin e vendit, në mënyrë të decentralizuar dhe në përputhje me parimin e subsidiaritetit, në bazë të ndarjes administrative.

Neni 2  
**Objekti**

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i organeve për inspektimin ndërtimor e urbanistik, i organizimit, i rregullave të funksionimit dhe i përgjegjësive të tyre.

Neni 3  
**Organizimi i inspektimit ndërtimor**

Kontrulli e zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës kryhet nga:

1. Inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës.
2. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar.

Inspektorati ndërtimor e urbanistik ngrihet në nivel qarku, në përputhje me nenet 6, 7 dhe 18 të këtij ligji.

#### Neni 4

### **Përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës**

Pranë çdo bashkie/komune ngrihet inspektorati ndërtimor e urbanistik, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, ushtron përgjegjësinë e kontrollit dhe zbatimit të ligjshmërisë e të standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës dhe ato të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera, brenda territorit administrativ të bashkisë/komunës.

Struktura e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës miratohet nga këshilli vendor përkatës, me propozimin e kryetarit të bashkisë/komunës.

Inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i bashkisë/komunës.

Për përmbushjen e përgjegjësisë të parashikuara me ligj, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës mbështetet nga policia bashkiake/komunale dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga bashkia/komuna.

#### Neni 5

### **Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës**

*(Shtuar fjalët në pikën "e" me ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010, neni 1/a;*

*shtuar shkronja "ë" me ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010, neni 1/b)*

Gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës merr masat e mëposhtme:

- a) vendos përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;
- b) vendos gjopa sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;
- c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit;
- ç) vendos pezullimin e punimeve në ndërtim në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;
- d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;
- dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;
- e) jep informacionin e kërkuar Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar brenda një afati kalendarik 10-ditor, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij Inspektorati.
- ë) merr vendim zhdëmtimi në ngarkim të subjektit kundërvajtës, për shpenzimet e prishjes së objektit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme.

#### Neni 6

### **Bashkëpunimi dhe delegimi i përgjegjësisë dhe detyrave për inspektimin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës**

Bashkia/komuna mund t'i delegojë qarkut, në të cilin ajo është pjesë përbërëse, përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, sipas një marrëveshjeje të lidhur midis palëve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Bashkia/komuna mund t'i ushtrojë përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në nenet 4 dhe 5, në bashkëpunim me një ose disa njësi vendore, në bazë të një marrëveshjeje ose kontrate, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 7

### **Inspektorati ndërtimor e urbanistik i qarkut**

Këshilli i qarkut, në funksion të përgjegjësive dhe detyrave të deleguara në zbatim të neneve 6 dhe 18 të këtij ligji, merr vendimin për ngritjen e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të qarkut.

Struktura, numri i punonjësve dhe pagat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të qarkut miratohen nga këshilli i qarkut, me propozimin e kryetarit.

Për përmbushjen e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara me ligj, inspektorati ndërtimor e urbanistik i qarkut bashkëpunon me Policinë e Shtetit dhe pajiset nga këshilli i qarkut me mjetet dhe makineritë e nevojshme.

#### Neni 8

### **Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar**

Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar është institucion qendror buxhetor publik, me statusin e personit juridik, në varësi të ministrisë përgjegjëse në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar drejtohet nga Kryeinspektori, i cili emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

Mënyra e organizimit, funksionimit, si dhe pagat e punonjësve të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Struktura dhe organika e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

#### Neni 9

### **Përgjegjësitë e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar**

*(Shtuar shkronja "dh" me ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010, neni 2)*

Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, nëpërmjet Kryeinspektorit dhe inspektorëve, ushtron këto përgjegjësi:

a) ushtron përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut për ndërtimet në zonat dhe objektet me rëndësi kombëtare, kur konstaton shkelje të ligjshmërisë në fushën e urbanistikës dhe kur ato nuk janë ushtruar nga inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut.

Zonat dhe objektet me rëndësi kombëtare, në kuptim të këtij ligji, janë zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, zonat/ndërtimet me vlera të trashëgimisë kulturore, parqet dhe zonat arkeologjike, të cilat gëzojnë mbrojtje, sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, zonat e mbrojtura mjedisore, monumentet e natyrës, rrugët kombëtare, linjat hekurudhore dhe instalimet e infrastrukturës kombëtare, aeroportet, zonat bregdetare, liqenore, lagunat, lumenjtë, zonat me rrezik natyror;

b) kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij ligji nga inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut;

c) ushtron përgjegjësitë e parashikuara shprehimisht në ligje të tjera;

ç) kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e rezervave ujore;

d) kontrollon përmbushjen e kërkesave ligjore për materialet dhe produktet e ndërtimit që hidhen në treg.

dh) kontrollon, me kërkesë të inspektoratit të mjedisit, përmbushjen e kërkesave ligjore për shfrytëzimin e karrierave të nxjerrjes së materialeve të ndërtimit dhe për pusët e ujit.

#### Neni 10

### **Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar**

1. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 9 shkronjat "a" dhe "b" të këtij ligji, merr masat e mëposhtme:

a) vendos gjoba ndaj kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektorateve ndërtimore dhe urbanistike në nivel bashkie/komune/qarku për veprime ose mosveprime në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me këtë ligj;

b) u propozon organeve përkatëse marrjen e masave disiplinore ndaj kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektorateve ndërtimore dhe urbanistike në nivel bashkie/komune/qarku, të përmendura në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni;

c) ushtron detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut, të parashikuara në nenin 5 të këtij ligji për ndërtimet në zonat dhe objektet me rëndësi kombëtare, të përkufizura në shkronjën "a" të nenit 9 të këtij ligji;

ç) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqjen e licencës profesionale personale dhe të shoqërisë, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit;

d) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të vëna re gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në shkronjën "d" të nenit 9 të këtij ligji, merr masat e parashikuara në dispozitat ligjore në fuqi në fushën e produkteve të ndërtimit.

3. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në shkronjën "ç" të nenit 9 të këtij ligji, merr masat e mëposhtme:

a) vendos përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e rezervave ujore;

b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore, në fushën e rezervave ujore dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit pa leje, të shfrytëzimit të kundërligjshëm të inerteve, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit;

ç) vendos pezullimin e punimeve në ndërtim në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e rezervave ujore;

d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;

dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 10/1

*(Shtuar neni me ligjin nr.10 240, datë 25.2.2010, neni 1;  
ndryshuar pika 2 me ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010, neni 3)*

1. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, përveç detyrave të tjera, të parashikuara në këtë ligj, ka të drejtë të ushtrojë përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut, sipas shkronjës "d" të nenit 5 të këtij ligji, për ndërtime të kundërligjshme në territorin e bashkisë/komunës/qarkut, që nuk përfshihen në zonat dhe objektet me rëndësi kombëtare, sipas këtij ligji, vetëm në rastet kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

2. Ushtrimi i përgjegjësive, sipas pikës 1 të këtij neni, kryhet vetëm kur në kantierin, objekt inspektimi, nuk ka filluar apo nuk është në proces një inspektim nga inspektorati vendor, si dhe kur vërtetohet një nga rrethanat e mëposhtme:

a) ushtrimi i përgjegjësive kërkohet nga vetë inspektorati ndërtimor e urbanistik vendor i komunës/bashkisë ose nga kryetari i komunës apo bashkisë përkatëse, për shkak të pamundësisë financiare për ushtrimin e kësaj përgjegjësie nga inspektorati vendor;

b) inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut nuk e ka inspektuar këtë territor më parë ose nuk është shprehur me vendim për këtë ndërtim, në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj;

c) vendimi i inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut për prishje të ndërtimit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar brenda afatit ligjor të caktuar në këtë ligj.

Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, gjatë ushtrimit të kësaj detyre, për të provuar kundërligjshmërinë e ndërtimit, sipas rastit, kërkon dokumentacion të plotë nga zyra e urbanistikës pranë komunës/bashkisë/qarkut. Zyra e urbanistikës pranë komunës/bashkisë/qarkut, brenda 15 ditëve, i paraqet INUK-së, dokumentacionin e plotë ligjor, që vërteton kundërligjshmërinë e ndërtimit. Nëse zyra e urbanistikës pranë komunës/bashkisë/qarkut nuk kthen përgjigje brenda afatit 15-ditor, INUK-ja kryen inspektim në kantier, objekt inspektimi, për të verifikuar ligjshmërinë e ndërtimit.

Në rast se pas inspektimit, INUK-ja konstaton se ndërtimi është i kundërligjshëm, vepron sipas nenit 13 të këtij ligji.

Gjatë ushtrimit të kësaj detyre, Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar ka përgjegjësinë të bëjë kallëzim penal për veprën penale të konstatuar dhe të paraqesë kërkesë për heqje licence, nëse punimet kryhen nga subjekte të pajisura me leje dhe licencë.

3. Fjala “ndërtim”, sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 2 të këtij neni, i referohet gjendjes aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme, në çastin e ushtrimit të inspektimit nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar.

4. Ushtrimi i përgjegjësive, sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 2 të këtij neni, bëhet kryesisht ose me kërkesë të subjekteve publike ose private të interesuara.

#### Neni 10/2

*(Shtuar neni me ligjin nr.10 240, datë 25.2.2010, neni 1)*

1. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar ka përgjegjësi ekskluzive, në përputhje me këtë ligj, për ndërtimet e kundërligjshme, të përhershme apo të përkohshme, të ngritura mbi sipërfaqen ujore, përkatësisht mbi shtratin e lumenjve, liqeneve dhe deteve, pavarësisht nëse kanë ose jo pikë lidhjeje me bregun e lumit, liqenit ose detit. Në rastet kur inspektorati ndërtimor urbanistik vendor konstaton ekzistencën e ndërtimeve të tilla, ia përcjell çështjen për kompetencë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar.

2. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar kryen inspektimin, sipas pikës 1 të këtij neni, në njërin nga rastet e mëposhtme:

a) periodik, të pakën 1 herë në vit, në çdo mjedis të vënë në dispozicion të të tretëve nga shteti shqiptar, në bazë të marrëveshjeve koncesionare shtetërore;

b) brenda 15 ditëve pune, kur autoriteti kontraktor ose organi shtetëror i autorizuar, sipas rastit, depoziton një kërkesë me shkrim për rikthimin e ligjshmërisë së mjediseve të dhëna me koncesion shtetëror;

c) brenda 15 ditëve pune, kur administrata detare njofton se në mjediset ujore të porteve të shpallura zhvillohen ndërtime pa lejen përkatëse ose në kundërshtim me parashikimet e bëra në to;

ç) me kërkesë me shkrim të bashkisë/komunës/qarkut.

3. Fjala “ndërtim”, sipas pikës 1 të këtij neni, i referohet gjendjes aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme, të përhershme/të përkohshme, në çastin e ushtrimit të inspektimit nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar. Shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni përfshijnë edhe rastet e koncesioneve për ndërtime digash, hidrocentralesh dhe hidrovresh.

4. Ministritë e linjës depozitojnë në Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e marrëveshjes koncesionare, kopje të plota të këtyre marrëveshjeve dhe përcaktime konkrete të mjediseve, në kuptim të pikës 1 të këtij neni, ku parashikohet të operojë koncesionari.

5. Në përfundim të çdo inspektimi, sipas pikës 2 të këtij neni, kopja e plotë e procesverbalit dhe/ose vendimit përkatës i dërgohet, për dijeni, autoritetit kontraktor ose organit shtetëror të autorizuar, sipas rastit, për inspektime, në përputhje me shkronjën “a” dhe çdo kërkuesi për inspektime, në përputhje me shkronjat “b”, “c” ose “ç” të pikës 2 të këtij neni.

### Neni 10/3

*(Shtuar neni me ligjin nr.10 240, datë 25.2.2010, neni 1)*

Ushtrimi i përgjegjësive, sipas neneve 10/1 e 10/2, kryhet sipas së njëjtës procedurë, të përcaktuar në nenet 12, 13 e 14 të këtij ligji.

### Neni 11

#### **Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit ndërtimor e urbanistik**

Kryeinspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik në nivel bashkie /komune /qarku/kombëtar dhe inspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.

Inspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik në nivel bashkie/komune/qarku mund të kenë arsimin e mesëm profesional në fushën e ndërtimit.

### Neni 12

#### **Ushtrimi i kontrollit**

Për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, kryeinspektorët /inspektorët kanë të drejtë të hyjnë dhe të ushtrojnë kontroll në mjediset ku kryhet ndërtimi. Subjekti që kontrollohet (sipas rastit, investitori, projektuesi, zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi, kolaudatori, prodhuesi i materialeve të ndërtimit) dhe të gjithë personat e tjerë të përfshirë në procesin e ndërtimit janë të detyruar të ndihmojnë në kryerjen e kontrollit, si dhe në shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

Kryeinspektori/inspektori duhet të identifikohet me dokument zyrtar.

Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin përkatës. Mbajtja e procesverbalit është e detyrueshme në çdo rast kontrolli dhe nënshkruhet si nga kryeinspektori/inspektori që kryen kontrollin, ashtu dhe nga subjekti i kontrolluar, kur ky i fundit është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Një kopje e procesverbalit i jepet subjektit të kontrolluar.

Kur subjekti i kontrolluar nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin ose nuk është i pranishëm, ky fakt pasqyrohet në procesverbal dhe i jepet një kopje e procesverbalit brenda 5 ditëve nga data e kontrollit. Nëse identiteti dhe adresa e subjektit të kontrolluar nuk dihen, një kopje e procesverbalit të konstatimit afishohet për 10 ditë në vendpublikimet e bashkisë/komunës/qarkut përkatës dhe në kantierin e ndërtimit. Me kalimin e këtij afati, vlerësohet se subjekti i kontrolluar është njoftuar për rezultatin e kontrollit.

### Neni 13

#### **Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet**

Brenda 10 ditëve nga marrja e kopjes së procesverbalit ose e njoftimit për rezultatin e kontrollit, inspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut/kombëtar nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, i cili nënshkruhet nga kryeinspektori.

Pezullimi i punimeve në ndërtim ka afat deri në 10 ditë. Inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut/kombëtar merr vendimin për shkeljen e konstatuar brenda afatit 10-ditor të sipërpërmendur.

Vendimet e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut/kombëtar parashikojnë afate për zbatimin e tyre deri në 60 ditë, sipas llojit të shkeljes. Përjashtimisht, vendimet për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm kanë afat deri në 30 ditë për zbatimin e tyre.



#### Neni 14

### **Ankimi administrativ dhe gjyqësor**

Kundër vendimit të inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut për marrjen e masave dhe dhënien e sanksioneve administrative lejohet ankimi administrativ dhe gjyqësor, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi. Ankimi administrativ dhe gjyqësor kundër vendimit të inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Kundër vendimeve të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar lejohet ankim i drejtpërdrejtë në gjykatë brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi gjyqësor kundër vendimit të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Në rast se, në bazë të vendimit përfundimtar të formës së prerë të gjykatës, vendoset pranimi i padisë, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë nga inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut/kombëtar që ka dhënë vendimin, dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar.

#### Neni 15

### **Kundërvajtjet administrative të kryeinspektorëve/inspektorëve dhe gjobat**

*(Shtuar pika 7 me ligjin nr.10 240, datë 25.2.2010, neni 2;  
ndryshuar pika 7 me ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010, neni 4/a;  
shtuar pika 8 me ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010, neni 4/b)*

Veprimet ose mosveprimet e kryeinspektorëve/inspektorëve të inspektoratit ndërtimor e urbanistik në nivel bashkie/komune/qarku, si dhe të inspektorëve të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, që janë në kundërshtim me parashikimet e dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit në fushën e ndërtimit, të urbanistikës dhe të rezervave ujore, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë.

Kundërvajtjet e mëposhtme administrative dënohen me gjobë si më poshtë:

1. Mosushtrimi i funksionit të kontrollit të territorit në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës në masën 200 000 lekë.
2. Shtrembërimi i rezultateve të kontrollit në fushën e ndërtimit, urbanistikës dhe rezervave ujore në masën 200 000 lekë.
3. Mosrespektimi i afateve për marrjen e vendimeve të parashikuara në këtë ligj në masën 20 000 lekë.
4. Mosrespektimi i afateve të zbatimit të vendimeve të parashikuara në këtë ligj në masën 150 000 lekë.
5. Mosrespektimi i afatit për marrjen e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm në masën 20 000 lekë.
6. Mosrespektimi i afatit të zbatimit të prishjes së objektit të kundërligjshëm në masën 150 000 lekë.
7. Mosrespektimi i afatit për dhënien e informacionit dhe pengimi në përmbushjen e detyrave, në masën 100 000 lekë.
8. Mosparaqitja e kërkesës për heqje licence të mbikëqyrësit të punimeve, pranë organeve kompetente, në masën 50 000 lekë.

Gjoha vendoset me vendim të Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar. Kundër vendimit të masës së gjobës mund të bëhet ankim i drejtpërdrejtë në gjykatë brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.

#### Neni 16

### **Unifikimi i praktikave**

Këshilli i Ministrave merr vendim për unifikimin e praktikave të inspektimit ndërtimor e urbanistik në ushtrimin e kompetencave të tyre.

## Neni 17

### **Dispozitë kalimtare për transformimin e Policisë së Ndërtimit**

1. Policia e Ndërtimit transformohet në Inspektorat Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

2. Struktura e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar miratohet brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Deri në daljen e urdhrit për strukturën, Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar do të funksionojë sipas strukturës ekzistuese. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar do të ushtrojë përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik në nivel bashkie/komune/qarku deri në ngritjen e tyre.

3. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar transferon praktikat dokumentare administrative, të cilat janë në shqyrtim dhe ndjekje nga Policia e Ndërtimit për administrimin e ndjekjen në vazhdim të tyre nga inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut.

## Neni 18

### **Krijimi i inspektorateve ndërtimore e urbanistike të njësisve vendore**

1. Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, këshillat bashkiakë/komunalë marrin vendimin për ngritjen e inspektoratit ndërtimor e urbanistik përkatës, si dhe për delegimin në qark të përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj për bashkinë/komunën, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji. Struktura, numri i punonjësve dhe pagat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës miratohen brenda të njëjtit afat 3-mujor nga këshilli i njësisë vendore, me propozimin e kryetarit përkatës.

2. Në rastin e delegimit të përgjegjësive dhe detyrave, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, nga bashkitë/komunat në qark, marrëveshja midis palëve duhet të nënshkruhet brenda afatit 3-mujor të parashikuar në pikën 1 të këtij neni. Këshilli i qarkut merr vendimin për ngritjen e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të qarkut brenda 2 muajve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes.

3. Në rast se me mbarimin e afatit 3-mujor, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, bashkitë/komunat nuk kanë zbatuar detyrimet ligjore të parashikuara në këtë pikë, përgjegjësitetë dhe detyrat e këtyre të fundit, të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, së bashku me funksionin e tyre të planifikimit urban dhe menaxhimit të tokës, i transferohen qarkut, në të cilin njësisia vendore është pjesë përbërëse. Brenda dy muajve nga data e mbarimit të afatit 3-mujor të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, këshilli i qarkut merr vendimin për ngritjen e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të qarkut.

## Neni 19

### **Shfuqizime**

Ligji nr.8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”, i ndryshuar dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji shfuqizohen.

## Neni 20

### **Dispozitë e fundit**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 8 dhe 16 të këtij ligji.

### **Dispozitë kalimtare**

*(Shtuar me ligjin nr.10 240, datë 25.2.2010, neni 3)*

1. Autoritetet kontraktore/organi shtetëror i autorizuar, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas rastit, depozitojnë pranë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar kopje të plota të marrëveshjeve koncesionare në fuqi, ku parashikohen të kryhen ose janë kryer ndërtime në

mjedise, sipas nenit 10/2 të këtij ligji dhe, kur i disponojnë në dosje, edhe lejet përkatëse, të dhëna për këtë qëllim nga organet përgjegjëse.

2. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në bazë të të dhënave që disponon, sipas pikës 1 të këtij neni e të materialeve arkivore që administron, krijon regjistrin e të dhënave për ndërtimet e kryera ose eventuale në mjedisin e caktuar, sipas nenit 10/2 të këtij ligji, në të cilin do të kryejë përditësime pas çdo inspektimi, si dhe ka detyrim për mirëmbajtjen e tij.

#### Neni 21 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5423, datë 23.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**Ligj nr.9780, datë 16.7.2007 shpallur me dekretin nr.5423, datë 23.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.95, faqe 2720*

**Ligji nr.10 240, datë 25.2.2010 shpallur me dekretin nr.6466, datë 18.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.30, faqe 1009*

**Ligji nr.10 323, datë 23.9.2010 shpallur me dekretin nr.6707, datë 6.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.136, faqe 7438*

#### UDHËZIM Nr.17, datë 13.8.2007

### PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË INSPEKTORATIT NDËRTIMOR E URBANISTIK KOMBËTAR GJATË PERIUdhËS KALIMTARE TË TRANSFERIMIT TË PËRGJEGJËSIVE DHE DETYRAVE NË INSPEKTORATET NDËRTIMORE E URBANISTIKE VENDORE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr.9000, datë 31.1.2003 “Për funksionimin dhe organizimin e Këshillit të Ministrave” dhe në ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”,

#### UDHËZOJ:

1. Në zbatim të nenit 17 pika 1 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, Policia e Ndërtimit transformohet, me hyrjen në fuqi të ligjit, në Inspektorat Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar dhe ushtron si i tillë të gjitha përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në nenet 9 dhe 10 të ligjit në fjalë.

2. Në zbatim të nenit 17 pika 2 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, deri në miratimin e strukturës së re, me urdhër të Kryeministrit, Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar do të funksionojë sipas strukturës së Policisë së Ndërtimit.

3. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar do të ketë vulën e tij të re, e cila do të ketë këtë paraqitje:

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit  
Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar

4. Degët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar do të kenë vulën e tyre të re, e cila do të ketë këtë paraqitje:

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit  
Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar

Dega Tirana-Qytet  
Dega Tirana-Rreth  
Dega Durrës  
Dega Elbasan  
Dega Lezhë  
Dega Shkodër  
Dega Gjirokastrë  
Dega Sarandë  
Dega Kavajë  
Dega Korçë  
Dega Dibër  
Dega Kukës  
Dega Berat  
Dega Fier  
Dega Vlorë

5. Vula e kërkuar sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, do të jetë për përdorim të përhershëm nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar.

6. Vulat e kërkuara sipas pikës 4 të këtij udhëzimi, do të përdoret përkohësisht nga degët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar. Vula do të përdoret nga degët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar deri në transferimin e plotë të kompetencave të tyre në Inspektoratet Ndërtimore e Urbanistike të bashkive/komunave/qarqeve, pjesë përbërëse të territorit të kompetencave të tyre, në përputhje me nenin 17 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

7. Në zbatim të nenit 17 pika 2 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, deri në ngritjen e inspektorateve ndërtimore e urbanistike të bashkive/komunave/qarqeve, përgjegjësitë dhe detyrat e këtyre inspektorateve vendore të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” do të ushtrohen nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar nëpërmjet degëve të tij.

8. Në zbatim të nenit 17 pika 2 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, titullari i Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar do të emërtohet Drejtor i Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar dhe kryetarët e degëve do të emërtohen (sipas strukturës ekzistuese) kryetarë të degës së Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, sipas degës përkatëse.

9. Përgjegjësitë dhe detyrat e Policisë së Ndërtimit të parashikuara në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” dhe në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, do të ushtrohen nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar në përputhje me nenin 17 pika 2 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, deri në ngritjen e inspektorateve ndërtimore e urbanistike të bashkive/komunave/qarqeve.

10. Me ngritjen e Inspektorateve ndërtimore e urbanistike në nivel bashkie/komune/qarku, përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, nenet 4 dhe 5, transferohen nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar në inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut të ngritur. Transferimi i përgjegjësisë dhe detyrave do të bëhet që në ditën që Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar (ose dega e tij) ka marrë njoftim për ngritjen e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut përkatës.

11. Transferimi i praktikave dokumentare administrative, të cilat, në zbatim të ligjit “Për inspektimin e ndërtimit”, hyjnë në fushën e përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj për Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut që ngrihet, do të kryhet brenda një afati 10-ditor nga dita e marrjes së njoftimit të ngritjes së inspektoratit vendor.

12. Gjatë ushtrimit të përgjegjësisë dhe detyrave në zbatim të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar dhe degët e tij do të nxjerrin akte administrative në përputhje me këtë ligj. Kundër vendimit të degës së Inspektoratit

Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, gjatë periudhës kalimtare, ushtrohet ankim administrativ pranë Drejtorit të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar.

13. Formularët e unifikuar të këtyre akteve administrative do të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili do të unifikojë procedurën e ushtrimit të kontrollit në nivel vendor dhe kombëtar. Deri në miratimin e vendimit të sipërpërmendur, Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar do të mbajë akte administrative sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,  
TRANSPORTIT DHE TELEKUMUNIKACIONIT  
**Sokol Olldashi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.108, faqe 3140*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE,  
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK KOMBËTAR  
DEGA \_\_\_\_\_

NR. \_\_\_\_\_

**VENDIM  
PËR PRISHJEN E OBJEKTIT**

Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_

Në bazë të Proçes-Verbalit Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ me nr.serie \_\_\_\_\_, të mbajtur nga inspektori/inspektorët i Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar \_\_\_\_\_ në subjektin juridik/fizik \_\_\_\_\_, ka rezultuar se është kryer kundravajtja \_\_\_\_\_, parashikuar në nenin/et \_\_\_\_\_, e ligjit Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ « Për \_\_\_\_\_ »

**PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin/et \_\_\_\_\_, të ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007, « Për inspektimin e ndërtimit » dhe në nenin/et \_\_\_\_\_, e ligjit Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ « Për \_\_\_\_\_ »

**VENDOSA:**

Dënimin për prishje të objektit \_\_\_\_\_ ndaj kundravajtësit \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim administrativ dhe gjyqësor, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara nga në dispozitat ligjore në fuqi.

**KRYETARI**

( \_\_\_\_\_ )

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE,  
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK KOMBËTAR  
DEGA \_\_\_\_\_

NR. \_\_\_\_\_

**VENDIM  
PËR PEZULLIMIN E PUNIMEVE NË NDËRTIM**

Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_

Në bazë të Proces-Verbalit Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_ me nr.serie \_\_\_\_\_ të mbajtur në subjektin juridik/fizik \_\_\_\_\_, nga inspektori/ët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar \_\_\_\_\_ ka rezultuar se është kryer kundravajtja e mëposhtme:

1 \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin/et \_\_\_\_\_, të ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007, « Për inspektimin e ndërtimit » dhe në nenin/et \_\_\_\_\_, të ligjit Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ « Për \_\_\_\_\_ »

**VENDOSA:**

Pezullimin e punimeve të ndërtimit në objekt, për afatin 10 ditor, në përputhje me nenin 13 të ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007 «Për inspektimin e ndërtimit», dhe në nenin/et \_\_\_\_\_ të ligjit Nr. \_\_\_\_\_ "Për \_\_\_\_\_ »

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim administrativ dhe gjyqësor, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara nga në dispozitat ligjore në fuqi.

**KRYETARI**

( \_\_\_\_\_ )

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE,  
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK KOMBËTAR  
DEGA \_\_\_\_\_

NR. \_\_\_\_\_

**VENDIM  
PËR DËNIM ME GJOBË**

Nr. \_\_, Datë \_\_\_\_\_

Në bazë të Proces-Verbalit Nr. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_ me nr. serie \_\_\_\_\_  
të mbajtur nga inspektori/ët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik  
Kombëtar \_\_\_\_\_ në subjektin juridik / fizik  
\_\_\_\_\_, ka rezultuar se është kryer  
kundravajtja \_\_\_\_\_,  
parashikuar  
në nenin \_\_\_\_\_, ligji Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ « Për \_\_\_\_\_ »

**PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin/et \_\_\_\_\_, e ligjit Nr. 9780, datë  
16.07.2007, « Për inspektimin e ndërtimit » dhe në nenin/et \_\_\_\_\_, të ligjit  
Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ « Për \_\_\_\_\_ »

**VENDOSA:**

Dënimin me gjobë në masën \_\_\_\_\_ ( \_\_\_\_\_ ) lekë kundravajtësin  
\_\_\_\_\_ me adrese \_\_\_\_\_

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim administrativ dhe gjyqësor, sipas rregullave dhe  
afateve të përcaktuara nga në dispozitat ligjore në fuqi.

**KRYETARI**

( \_\_\_\_\_ )



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE,  
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK KOMBËTAR  
DEGA \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_

### **PROÇES-VERBAL**

I mbajtur me datë \_\_\_\_\_ nga inspektori/ët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar  
\_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ subjektin  
juridik/fizik \_\_\_\_\_,  
me adresë \_\_\_\_\_ gjatë ushtrimit  
të kontrollit u konstatuan kundërvajtjet e më poshtme:

---

---

---

---

---

---

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në nenin 12, të ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007, «Për inspektimin e ndërtimit », u  
mbajt ky proces-verbal dhe subjekti i  
kontrolluar \_\_\_\_\_  
(pranon të nënshkruaj \_\_\_\_, nuk pranon të nënshkruaj \_\_\_\_, nuk i njihet identitetit \_\_\_\_)

Inspektorët

Subjekti i kontrolluar

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

**VENDIM**  
**Nr.862, datë 5.12.2007**

**PËR UNIFIKIMIN E PROCEDURAVE TË KONTROLLIT TË TERRITORIT NGA**  
**INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK KOMBËTAR E AI VENDOR**  
*(Ndryshuar me vendim të KM nr.625, datë 28.7.2010)*

*I përditësuar*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar (më poshtë INUK), e ai vendor, si më poshtë vijon:

a) Kryeinspektorët/inspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik vendor, në mbështetje të nenit 12 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit":

- i) kanë të drejtë të hyjnë e të ushtrojnë kontroll në mjediset, ku kryhet ndërtimi;
- ii) pajisen dhe identifikohen me dokument zyrtar, ku përcaktohet pozicioni i vendit të punës, i cili i paraqitet subjektit, mbi të cilin do të ushtrohet kontrolli;
- iii) kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e objektit në terren, sipas lejes së ndërtimit të dhënë nga organi i autorizuar i qeverisjes vendore, si dhe të kontrollojnë dosjen me dokumentacionin, teknik e ligjor të objektit.

b) Inspektorati ndërtimor e urbanistik vendor:

i) zbaton vendimet e marra nga organi i qeverisjes vendore në fushën e ndërtimit, brenda territorit nën juridiksionin e tij.

ii) kryen kontrole në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga kryeinspektori, si dhe në bazë të njoftimeve të marra nga institucionet qendrore dhe ato vendore, subjektet, fizike e private.

iii) ka të drejtë të kryejë një apo më shumë kontrole në të njëjtin objekt, sipas problematikave, teknike e ligjore të objektit, që ndërtohet. Kryeinspektori përcakton numrin e kontrollit të tij.

iv) përfshin në kontrollin e tij ndërtimin e një objekti të ri, prishjen e objektit, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën, tokësore e nëntokësore, si dhe prishjen e objekteve, që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve, në përputhje me nenin 59 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar.

c) Inspektorati ndërtimor e urbanistik vendor realizon kontrole nëpërmjet:

- i) një grupi inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë;
- ii) një grupi inspektimi të përbashkët, i cili ka në përbërje një inspektor të INUK-ut dhe një inspektor ndërtimor e urbanistik vendor, kur kontrolli ushtrohet në ndërtimet në zonat e objektet, me rëndësi kombëtare.

2. Kryeinspektori/inspektori vendor, gjatë kontrollit të ushtruar për zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi, i vlerëson shkëlqje të punimeve në ndërtim:

a) mospërputhjen e objektit në ndërtim, me kërkesat e lejes së ndërtimit e të projektit teknik të zbatimit, të miratuar e konfirmuar nga organi i autorizuar si:

i) ndërtimi i volumeve të tepërta, në lartësi ose në gjerësi të objektit (shtesë kati ose shtesë anësore);

ii) ndryshime të përmasave në gjatësi, gjerësi, lartësi më të mëdha ose më të vogla se ato të miratuara;

iii) ndryshime në arkitekturën e fasadës së objektit, krahasuar me projektin e miratuar;

iv) rrethimi i objektit nuk është bërë sipas planorganizimit të miratuar.

b) mosrespektimin e kuotave të lartësisë së kateve me ato të miratuara.

- c) mungesat e masave të sigurimit teknik të objektit dhe të mbrojtjes së jetës së njerëzve.
- ç) ndotjen e mjedisit nga ndërtimi i objektit.

3. Inspektorati ndërtimor e urbanistik vendor, në bazë të planit të punës verifikon:

a) vendosjen e tabelës së objektit me leje ndërtimi, të dhënat përkatëse, sipas nenit 56 të ligjit nr.8405, datë 17.9.2007 “Për urbanistikën”. Kjo tabelë duhet të ketë përmasa 3m x 3m dhe duhet të përmbajë gjithashtu, këto të dhëna:

- i) emërtimin e objektit, sipas lejes së ndërtimit;
- ii) lejen e ndërtimit;
- iii) emrin e projektuesit;
- iv) emrin e inxhinierit mbikëqyrës të punimeve në objekt;
- v) datën e fillimit dhe të mbarimit të punimeve në objekt;
- vi) planimetrinë e sheshit të ndërtimit të objektit, në lidhje me objektet përreth;
- vii) pamjen tridimensionale të objektit.

Tabela me këto të dhëna duhet të figurojë në objekt, sipas formës dhe dimensioneve, të paraqitura në aneksin shoqëruar të këtij vendimi.

b) Dosjen e dokumentacionit teknik e ligjor, që ndodhet në objekt si:

- lejen e ndërtimit, së bashku me vendimet e KRRT-së;
- projektin teknik të zbatimit të objektit, i konfirmuar nga drejtoria/zyra e urbanistikës;
- studimin gjeologjik dhe atë sizmik;
- lejen mjedisore, të miratuar nga agjencia e mjedisit;
- miratimin e ndryshimeve në projekt, në rastet kur ka të tilla;
- licencimin e pjesëmarrësve në ndërtim (licenca e shoqërisë, drejtuesi teknik, mbikëqyrësit, inxhinieri i zbatimit të punimeve dhe inxhinierë të tjerë pjesëmarrës në punime);
- aktin e piketimit të objektit;
- aktkontrollin e kuotës 0,00, në përfundim të kësaj faze;
- verifikimin e të gjitha punimeve të kryera deri në ditën e kontrollit, në përputhje me projektin e miratuar;
- dokumentacionin e ndërtimit, në raport me ligjin e trashëgimisë kulturore, arkeologjike, turistike, si dhe me ligjet e tjera, kur objekti ndërtohet në këto zona, si dhe përcaktimin e detyrimeve të objektit, nëse ka një natyrë të tillë;
- mbajtjen e librit të masave të objektit;
- verifikimin e procesverbaleve të punimeve të maskuara;
- certifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura, si hekuri, betoni;
- aktin e kontrollit të përfundimit të karabinasë së objektit, në përfundim të kësaj faze;
- aktin e kolaudimit të fazës së përfundimit të punimeve të karabinasë;
- masat e sigurimit teknik të punimeve të ndërtimit dhe pajisjen me mjete për mbrojtjen e jetës së punëtorëve;
- zbatimin e planit të organizimit të punimeve në objekt;
- masat teknike të ruajtjes së objekteve përreth;
- aktet e inspektimit, të kryera gjatë zbatimit të objektit.

4. Kryeinspektori/inspektori i inspektoratit ndërtimor e urbanistik vendor, pas kontrollit në objekt, mban procesverbalin, ku pasqyrohen gjendja aktuale, mangësitë dhe detyrat për subjektin ndërtues, si dhe zbaton procedurat ligjore për shkeljet e vëna re, në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

Inspektorati ndërtimor e urbanistik vendor, brenda 10 ditëve nga dita e njoftimit të subjektit ndërtues nxjerr vendimin përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kur gjatë ushtrimit të kontrollit në objekt kryeinspektori/inspektori i inspektoratit ndërtimor e urbanistik vendor vëren shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, ai merr vendimin përkatës, pas kalimit të afatit 10-ditor, të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

5. Vendimi për pezullimin e punimeve në ndërtim merret në rastin kur është i nevojshëm një afat kohor paraprak për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës, si dhe marrjen e vendimit për prishjen e objektit. Gjatë periudhës 10-ditore të vendimit të pezullimit të punimeve në ndërtim, subjekti ndërtues është i detyruar të

ndërpresë punimet në objekt dhe inspektori vendor përkatës është përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi.

Një vendim i tillë merret, kur:

- a) mungon tabela me informacionin përkatës të objektit;
- b) nuk është dorëzuar dosja në inspektoratin ndërtimor e urbanistik vendor, para fillimit të punimeve në objekt;
- c) mungon formulari i lejes së ndërtimit;
- ç) mungon konfirmimi i drejtorisë/zyrës së urbanistikës për projektin e zbatimit;
- d) mungon inxhinieri mbikëqyrës i punimeve, kur parashikohet nga legjislacioni në fuqi;
- dh) mungojnë certifikatat e cilësisë së produkteve të ndërtimit (e betonit, hekurit etj.);
- e) mungojnë akti i piketimit, akti i përfundimit të themeleve (kuota 0,00) akti i përfundimit të karabinasë së objektit, sipas përfundimit të çdo fazë punimesh;
- ë) mungojnë masat e sigurimit teknik në objekt dhe mjetet mbrojtëse të jetës së punëtorëve;
- f) mungon ose ndodhet i paplotësuar libri i masave në objekt;
- g) mungojnë procesverbalet e punimeve të maskuara.

Vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim mbahet sipas formës së parashikuar në aneksin shoqërues të vendimit.

6. Vendimi i dënimit me gjobë merret në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e ndërtimit e të urbanistikës dhe nuk pengon marrjen e një vendimi të dytë për pezullimin e punimeve në ndërtim, e vendimit për plotësimin e dokumentacionit, teknik e ligjor, dhe të vendimit për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm.

Vendimi i dënimit me gjobë mbahet sipas formës së parashikuar në aneksin shoqërues të vendimit.

7. Vendimi për plotësimin e dokumentacionit teknik e ligjor, ka afat 60 ditë dhe ka si efekt të tij pezullimin e punimeve në ndërtim. Ky vendim zbatohet, kur:

- a) plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor kërkon proces miratimi nga KRRT-ja vendore;
- b) vendimi i pezullimit të punimeve të ndërtimit për plotësimin e dokumentacionit teknik e ligjor, ka rezultuar i pamjaftueshëm dhe subjekti ndërtues kërkon zgjatjen e afatit, duke e argumentuar në mënyrë zyrtare.

Vendimi për plotësimin e dokumentacionit teknik e ligjor, mbahet sipas formës së parashikuar në aneksin shoqërues të vendimit.

8. Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm merret në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e ndërtimit e të urbanistikës.

Vendimi për prishje merret, gjithashtu, në të gjitha rastet, kur nuk respektohet vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim, nuk plotësohet dokumentacioni, teknik e ligjor, dhe kur ka parregullsi në zbatimin e punimeve në objekt, brenda afatit kohor të parashikuar në vendimin përkatës.

Vendimi për prishje shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë, si dhe përgatitet kallëzimi penal për kundërvajtësin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm mbahet sipas formës së parashikuar në aneksin shoqërues të vendimit.

9. Inspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar në mbështetje të neneve 9, shkronja “a” e 10, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, ushtrojnë përgjegjësitë dhe detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik vendor, për ndërtimet në zonat dhe objektet me rëndësi kombëtare, kur vërejnë shkelje të ligjshmërisë në fushën e urbanistikës, të cilat nuk janë dënuar nga inspektorati ndërtimor e urbanistik vendor. Inspektorët e INUK-së kanë të drejtë të hyjnë e të ushtrojnë kontroll në mjediset, ku kryhet ndërtimi, në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”.

Në këtë rast, këta inspektorë e ushtrojnë kontrollin e territorit në fushën e urbanistikës, në përputhje me procedurën e unifikuar në pikën 1, të këtij vendimi.

Informacioni/dokumentacioni i nevojshëm për ushtrimin e kontrollit nga inspektorët e INUK-së, merret pranë drejtorisë/zyrës së urbanistikës të njësisë vendore, të cilat duhet të krijojnë të gjitha lehtësitë, për dhënien e informacionit/dokumentacionit në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar realizon kontrole nëpërmjet:

- a) një grupi inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë;
- b) një grupi inspektimi të përbashkët, i cili ka në përbërje një inspektor të INUK-së dhe një inspektor të inspektoratit ndërtimor e urbanistik vendor;
- c) një grupi inspektimi të përbashkët, i cili ka në përbërje një inspektor të INUK-së dhe një specialist të ministrive/institucioneve publike, përgjegjëse për inspektimin, sipas kompetencave përkatëse.

Objekti i kontrollit të ushtruar nga inspektorët e INUK-së, sipas paragrafit të parë, të kësaj pike, është i unifikuar me parashikimet e pikave 2 e 3 të këtij vendimi.

Përbajtja e procesverbalit të kontrollit, procedura e njoftimit të subjektit ndërtues dhe afati i nxjerrjes së vendimit kryhen sipas parashikimeve të pikës 4 të këtij vendimi.

Vendimet e pezullimit të punimeve në ndërtim, vendimet e dënimit me gjobë dhe vendimet për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm merren në përputhje me parashikimet e pikave 5,6,7 e 8, të këtij vendimi.

10. Inspektorët e INUK-së, në mbështetje të neneve 9, shkronja “b” e 10, pika 1, shkronjat “a”, “b”, e “d” të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, ushtrojnë kontrollin e zbatimit të këtij ligji nga kryeinspektorët/inspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik vendor.

Gjatë ushtrimit të këtij kontrolli inspektorët e INUK-së marrin masat dhe vendimet e parashikuara në ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

Informacioni/dokumentacioni i nevojshëm për kontrollin e kryeinspektorëve/inspektorëve të inspektoratit ndërtimor e urbanistik vendor merret pranë këtij inspektorati, si dhe pranë drejtorisë/zyrës së urbanistikës së njësisë vendore, të cilat duhet të krijojnë të gjitha lehtësitë, për dhënien e informacionit/dokumentacionit në fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës.

Inspektorët e INUK-së, në mbështetje të dokumentacionit të paraqitur dhe në prani të inspektorëve vendorë, kur kërkohet nga INUK-ja, verifikojnë në objekt dhe mbajnë procesverbal, ku pasqyrohen shkeljet e vëna re, si dhe marrin vendimet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Inspektorët e INUK-së përcjellin, për miratim, pranë kryeinspektorit, vendimet e marra ndaj kryeinspektorëve/inspektorëve vendorë, kur gjatë ushtrimit të kontrollit kanë vënë re shkelje të legjislacionit në fuqi.

11. Kryeinspektori/inspektorët e INUK-së ushtrojnë përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në nenet 9 shkronja ç”, dhe pika 10, pika 3 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, në fushën e rezervave ujore.

Në këtë rast këta inspektorë e ushtrojnë kontrollin në fushën e rezervave ujore, në përputhje me procedurën e unifikuar të pikës 1, shkronja “a”, nënndarjet “i”, dhe “iii”, e shkronja “b”, nënndarjet “i”, “iii”, si dhe me dispozitat ligjore në fushën e rezervave ujore.

INUK-ja realizon kontrole nëpërmjet:

- a) një grupi inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë;
- b) një grupi inspektimi të përbashkët, i cili ka në përbërje një inspektor të INUK-së dhe specialistë të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe/ose të organeve të varësisë.

Në çdo kontroll, inspektorët e INUK-së, në bashkëpunim me specialistët e autoriteteve të ujit, mbajnë procesverbalet për situatën e kontrolluar, në të cilin pasqyrojnë mangësitë dhe detyrat për subjektin e kontrolluar, duke zbatuar, njëkohësisht, edhe procedurat ligjore përkatëse.

Vendimet e pezullimit të punimeve në ndërtim, vendimet e dënimit me gjobë dhe vendimet për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe vendime të tjera vendosen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, të ndryshuar, dhe me legjislacionin në fuqi.

12. Kryeinspektori/inspektorët e INUK-së ushtrojnë përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në nenin 9, shkronja “d”, dhe 10, pika 2, të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, në fushën e produkteve të ndërtimit.

Në këtë rast kur inspektorët e INUK-së ushtrojnë kontrollin e produkteve të ndërtimit, që hidhen në treg, veprojnë në përputhje me parashikimet e pikës 1, shkronja “a”, nënndarjet “i” dhe “iii”, të këtij vendimi dhe me dispozitat ligjore në fushën e produkteve të ndërtimit.

INUK-ja realizon kontrole nëpërmjet:

a) një grupi inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë;

b) një grupi inspektimi të përbashkët, i cili ka në përbërje një inspektor të INUK-së dhe specialistë për materialet dhe produktet e ndërtimit.

38. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve, të çimentimit në formacionet shkëmbore (KTZ 34-81).
39. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të veprave në rrugët hekurudhore (KTZ 36-81).
40. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për mbushje dhe gjermim në hekurudha (KTZ 37-81).
41. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të shtresave në rrugë, autostradë, etj. (KTZ 38-81).
42. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve me pilota UKS (KTZ 39-81).
43. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve me shpërthim me mina elektrike (KTZ 40-81).
44. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve me shpërthime elektrike (KTZ 41-82).
45. Kushte teknike të zbatimit të punimeve të montimit të pajisjeve elektrike në nënstacionet elektrike (KTZ 42-82).
46. Kushte teknike të zbatimit dhe të marrjes në dorëzim të punimeve të furrave të pjekjes së tullave (KTZ 43-82).
47. Kushte teknike të zbatimit dhe të marrjes në dorëzim të punimeve të kullave të ftohjes prej betonarmeje në formë hiperbolike (KTZ 44-82).
48. Kushte teknike të zbatimit dhe të marrjes në dorëzim të punimeve për ndërtimin e silloseve beton arme (KTZ 45-84).
49. Kushte teknike të zbatimit dhe të marrjes në dorëzim të punimeve për ndërtimin e digave të mesme prej dheu me lartësi deri 50 m (KTZ 46-84).
50. Kushte teknike të zbatimit dhe të marrjes në dorëzim të punimeve për ndërtimin e tuneleve (KTZ 47-84).
51. Kushte teknike të zbatimit dhe të marrjes në dorëzim të punimeve të termoizolimit të taracave me skorjet e Selenicës (Vlorë) dhe banesa, vepra shoqërore dhe industriale (KTZ 48-88).
52. Kushte teknike të shmangieve të lejuara në ndërtim-montim (KTZ 49-89).
53. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për saldimin e konstruksioneve dhe tubave prej viniplasti (PVC) (KTZ 201-80).
54. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për saldimin e konstruksioneve dhe tubave prej alumini e lidhjeve të tij (KTZ 202-80).
55. Zbatimi i punimeve për montimin e pompave stacionare dhe ventilatorëve centrifugalë të veprave industriale (KTZ 203-80).
56. Zbatimi dhe marrja në dorëzim për montimin e pajisjeve hidraulike statike (KTZ 204-80).



57. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e elevatorëve dhe të transportjerëve në veprat industriale (KTZ 205-80).
58. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për saldimin e çeliqueve inoksidabël në veprat industriale (KTZ 206-80).
59. Zbatimi dhe marrja në dorëzim i punimeve për montimin e sistemeve të ventilimit (KTZ 207-80)
60. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të ashensorëve dhe ngritësve të ngarkesave (KTZ 208-80).
61. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të linjave të tubacioneve teknologjike dhe të avullit dhe të ujit të nxehtë mbitokësor (KTZ 209-80).
62. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e kompresorëve me piston horizontal në veprat industriale (KTZ 210-80).
63. Zbatimi i punimeve për përdorimin e mekanizmave dhe pajisjen e ngritjes së ngarkesave (KTZ 211-81)
64. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për saldimin e tubave dhe të konstruksioneve prej bakri dhe lidhjeve të tij (KTZ 212-80).
65. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për saldimin e plumbit në veprat industriale (KTZ -81).
66. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e tubacioneve të turbinave të H/C (KTZ 214-81).
67. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit dhe portave të H/C (KTZ 215-81).
68. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e udhëzuesve të portave të H/C (KTZ 216-81).
69. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e rezervuarëve sferikë (metalikë) (KTZ 217-80).
70. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e mullinjve cilindrikë të bluarjes (KTZ 218-81).
71. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e furrave rrotulluese horizontale për pjekje klinkeri (KTZ 219-81).
72. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e vinçit me peshëngritje 6 ton (KTZ 220-81).
73. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të vinçit urë (KTZ 221-81).
74. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të vinçit Cjap (KTZ 222-81).
75. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të shnekëve (KTZ 224-81).
76. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të makinave metal punuese (KTZ 228-81).
77. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për montimin e tubacioneve të gazsjellësit (KTZ 235-81).
78. Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të vinçave shtyllë (direk). (KTZ 238-81).

## KUSHTET TEKNIKE TË PROJEKTIMIT

1. Kriteria projektimi për veprat e industrisë mekanike, të pasurimit të mineraleve, depove e stallave (KTP 1-78).
2. Kriteria projektimi e ndërtimi në zona sizmike (KTP 2-78).
3. Kriteria projektimi. Klasifikimi i veprave ekonomike e shoqërore (KTP 3-78).
4. Kriteria projektimi. Kategorizimi dhe kalasifikimi i veprave hidroteknike (KTP 4-78).
5. Kriteria projektimi. Klasifikimi i dherave joshkëmbore që shërbejnë si bazament për veprat inxhinierike (KTP 5-78).
6. Kriteria projektimi. Përcaktimi i ngarkesave në objektet shoqërore ekonomike (KTP 6-78).
7. Kriteria projektimi. Përcaktimi i ngarkesës së erës (KTP 7-78).
8. Kriteria projektimi. Përcaktimi i ngarkesës së borës (KTP 8-78).
9. Kriteria projektimi. Llogaritja e mureve dhe themeleve me teorinë e gjendjes kufitare. (KTP 9-78).
10. Kriteria projektimi. Llogaritja e konstruksioneve prej çeliku (KTP 10-78).
11. Kriteria projektimi. Llogaritja e rrjetit të jashtëm të furnizimit me ujë (KTP 11-78).
12. Kriteria projektimi. Llogaritja e rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë dhe kanalizimet (KTP 12-78).
13. Kriteria projektimi të sistemeve të ngrohjes qendrore dhe të ajrimit (KTP 13-78).
14. Kriteria projektimi. Instalimet e ndriçimit në veprat ekonomiko-shoqërore (KTP 14-78).
15. Kriteria projektimi. Instalimet elektrike në mjediset me rrezik zjarri (KTP 15-78).
16. Kriteria projektimi. Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike (KTP 16-78).
17. Kriteria projektimi. Mbrojtja reale dhe automatike. (KTP 17-78).
18. Kriteria projektimi të linjave ajrore të tensionit të lartë (KTP 18-78).
19. Kriteria projektimi të impiantit shpërndarës dhe të nënstacioneve me tension mbi 1000V (KTP 19-78).
20. Kriteria projektimi të hekurudhave (KTP 20-78).
21. Kriteria projektimi për urat e tombinat prej betoni e beton armeje në hekurudhat (KTP 21-78).
22. Kriteria projektimi për rrugët automobilistike (KTP 22-78).
23. Kriteria projektimi për urat e tombinat prej betoni dhe beton armeje në rrugët automobilistike (KTP 23-78).
24. Kriteria projektimi. Tunelet hidroteknike (KTP 24-78).
25. Udhëzime teknike projektimi. Mbi përmbajtjen e projekteve sipas fazave të projektimit të veprave të ndërtimit.
26. Simbolet në llogaritjen e konstruksioneve të ndërtimit.
27. Standardet e "Paraqitjes grafike të projektieve dhe simbolet në Vizatimet e Ndërtimit".
28. Metodika e përcaktimit të përshkueshmërisë së formacioneve me metoda direkte në terren.
29. Metodika e përcaktimit soliditetit të dherave në shtupje njëboshtore.
30. Udhëzuesi i studimeve gjeologo-inxhinierike për ura, viadukte mbikalime e nënkalime hekurudhore.
31. Hidroizolimi në banesa, objekte social-kulturore dhe ekonomike.
32. Hidroizolimi në veprat e artit rrugor, hekurudhore dhe hidrocentrale.
33. Klasifikimi i veprave dhe ndërtesave ekonomike dhe shoqërore.
34. Veprat ekonomike dhe shoqërore. Kriteret bazë llogaritëse.
35. Llogaritja e konstruksioneve prej guri të veprave shoqërore dhe ekonomike me teorinë e gjendjes kufitare.
36. Mbi ngarkesat dhe veprimet në rrugët automobilistike.
37. Mbistruktura dhe nënstruktura prej betoni dhe betoni të armuar të zakonshëm në veprat e artit rrugor dhe hekurudhore (përfshirë dhe çernierat).
38. Tunelet hidroteknike.

39. Konstruksione prej betoni dhe betoni të armuar në veprat hidroteknike me teorinë e gjendjes kufitare.
40. Vlerësimi i agresivitetit të ujit natyror, nëntokësor dhe sipërfaqësor.
41. Veprat hidroteknike në lumenj. Kriteret themelore të projektimit.
42. Llogaritja e konstruksioneve prej betoni dhe betoni të armuar të zakonshëm në veprat ekonomike dhe shoqërore me teorinë e gjendjes kufitare.
43. Llogaritja e konstruksioneve b/arme të paranderur në veprat ekonomike dhe shoqërore.
44. Studimi gjeologo-inxhinierik për projektimin e veprave hidroenergjitike.
45. Studimet gjeologo-inxhinierike për projektimin e objekteve nëntokësore (të tuneleve).
46. Llogaritja e konstruksioneve prej betoni dhe betoni të armuar të zakonshëm në veprat ekonomike dhe shoqërore me teorinë e gjendjes kufitare.
47. Llogaritja e konstruksioneve prej guri të veprave ekonomike e shoqërore me teorinë e gjendjeve kufitare.
48. Llogaritja e konstruksioneve prej betoni dhe betoni të armuar në veprat hidroteknike me teorinë e gjendjeve kufitare.
49. Projektimi i veprave të artit, rrugore dhe hekurudhore prej betoni dhe beton armeje të zakonshme.
50. Studime gjeologo-inxhinierike për projektimin e veprave shoqërore kulturore.
51. Studime gjeologo-inxhinierike për projektimin e veprave ekonomike.
52. Përcaktimi i vetive fizike të dherave me metoda laboratorike.
53. Përcaktimi i vetive gjeoteknike të dherave presiometër.
54. Llogaritja e konstruksioneve metalike të veprave shoqërore dhe ekonomike me teorinë e gjendjes kufitare.
55. Udhëzues teknik projektimi. Studime gjeologo-inxhinierike të vendburimeve të materialeve rrethanore të ndërtimit për veprat hidroteknike dhe hekurudhore.
56. Kushte teknike projektimi të bazave e themeleve të objekteve inxhinierike me gjendjen kufitare.
1. Kusht teknik projektimi të bazave e themeleve industriale e ekonomiko-shoqërore me gjendjen kufitare.
2. Kusht teknik studimeve gjeologo-inxhinierike për projektimin e objekteve industriale dhe ekonomiko-shoqërore me gjendjen kufitare.
3. Kusht teknik i projektimit të bazave e themeleve të thella masive e me pilota me gjendjen kufitare.
4. Kusht teknik i studimeve gjeologo-inxhinierike për projektimin e bazave e themeleve masive e me pilota të objekteve inxhinierike me gjendjen kufitare.
57. Udhëzues për llogaritjen e oxhaqeve në veprat industriale.
58. Udhëzues për llogaritjen e themeleve nën makineri (Pjesa teorike Vol.1).
59. Udhëzues për llogaritjen e themeleve nën makineri. Shembuj llogaritës.
60. Detyra tip të projektimit në ndërtim për veprat shoqërore dhe banesat.
61. Detyra tip të projektimit në ndërtim për studimet urbanistike.
62. Detyra tip të projektimit për veprat industriale.
63. Detyra tip të projektimit për vepra të industrisë së material ndërtimit.
64. Detyra tip të projektimit për H/C, tunele dhe vepra detare.
65. Detyra tip të projektimit për veprat hekurudhore, rrugore dhe urat.

**VENDIM**  
**Nr.363, datë 18.7.2002**

**PËR VENDOSJEN E Oponencës Teknike Për Projektet  
E Ndërtimit të Objekteve**

*(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.206, datë 16.4.2004)*

*I përditësuar*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 6, 8 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” , me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Për të gjitha projektet e ndërtimit të objekteve, që realizohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga persona fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj vlera e preventivuar e të cilave është jo më pak se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, të bëhet oponencë teknike.

2. Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve të bëhet nga institutet studimore, shtetërore në varësi të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit. Kjo ministri, në raste të veçanta, mund të autorizojë, në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht edhe institute ose ente të tjera publike.

3. Kërkesa për oponencë teknike në institutet shtetërore dhe institucionet a entet e tjera jopublike, të përcaktuara nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, të bëhet nga investitori. Me miratimin e kërkesës palët lidhin një marrëveshje, kushtet e së cilës miratohen nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

4. Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve bëhet në çdo fazë të hartimit të projektit, në varësi të qëllimit për të cilin do të përdoret. Oponenca teknike paraqitet nga investitori te organi përkatës në fazën e programimit të investimeve, të nxjerrjes së lejes për shesh e të lejes së ndërtimit dhe në fazën e miratimit të projektit të zbatimit.

4/1. Tarifat për oponencën teknike të projekteve të jenë sipas lidhjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit miraton objektin e oponencës teknike, sipas llojit të ndërtimeve dhe fazave të projektit. Në çdo rast, ajo shprehet për nivelin e plotësimit të kërkesave të kushteve teknike, të projektimit e të zbatimit, të detyrës së projektimit apo termave të referencës, të kërkesave urbanistike, mjedisore të destinacionit dhe vlerësimit ekonomik të veprës, si dhe për sigurinë, rezistencën, qëndrueshmërinë e veprës dhe tregues të tjerë teknikë.

6. Ngarkohen ministrinë, institucionet qendrore dhe të gjitha organet e tjera të investituese për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

*Vendim i KM nr.363, datë 18.7.2002 i pabotuar*

*Vendim i KM nr.206, datë 16.4.2004 botuar në Fletoren Zyrtare nr.23, faqe 1204*

## TARIFAT PËR OPONENCËN TEKNIKE PËR PROJEKTET E NDËRTIMIT TË OBJEKTEVE

Tarifat për oponencën teknike për projektet e ndërtimit të objekteve i referohen tarifës në përqindje të projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, si më poshtë:

<b>Kushtimi (milion/lekë)</b>	<b>Tarifa (në%)</b>
100,00	7.0
150,00	6.5
200,00	6.0
300,00	5.5
Mbi 300,00	5.0

### **VENDIM**

**Nr.808, datë 4.12.2003**

### **PËR DHËNIEN E DËSHMISË SË AFTËSISË PËRDORUESVE TË MAKINERIVE TË RËNDA TË NDËRTIMIT**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.736, datë 1.7.2009)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe të nenit 6 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

### **VENDOSI:**

1. Personi fizik, që ushtron profesionin e manovruesit të makinerive të rënda të ndërtimit, duhet të jetë i pajisur me dëshmi aftësie.
2. Shfuqizuar.
3. a) Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shfrytëzimit të Transportit Rrugor të ngrihet komisioni i posaçëm për dhënien e dëshmisë së aftësisë, për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit.  
b) Kushtet dhe kriteret për dhënien e dëshmisë së aftësisë përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit përcaktohen në rregulloren, që do të hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, dhe do të miratohet nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
4. Kurset teorike e praktike, për përgatitjen e manovratorëve të makinerive të rënda të ndërtimit të zhvillohen nga subjektet juridike private, që plotësojnë kushtet e parashikuara në rregulloren e përmendur në shkronjën "b" të pikës 3 të këtij vendimi.
5. Shfuqizuar.
6. Përdorimi i makinerive të rënda pa dëshminë e aftësisë përbën dhe ndëshkohet si shkelje e rregullave të sigurimit teknik në ndërtim.
7. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Fatos Nano**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.101, faqe 4360*

*Vendim i KM nr.736, datë 1.7.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.116, faqe 5588*

**URDHËR**  
**Nr.44, datë 4.2.2004**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “ PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR  
DHËNIEN E LEJEVE TË MANOVRIMIT PËRDORUESVE TË MAKINERIVE TË RËNDA  
TË NDËRTIMIT DHE DISIPLINIMI I PËRDORIMIT TË MAKINERIVE TË NDËRTIMIT”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 24 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" dhe të pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.808, datë 4.12.2003 "Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit"

**URDHËROJ:**

Miratimin e rregullores "Për procedurat dhe kriteret për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit", bashkëlidhur këtij urdhri.

Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Drejtoria e Policisë së Ndërtimit dhe të gjitha institucionet dhe subjektet e interesuara për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**  
**Bashkim Fino**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.25, faqe 1282*

**RREGULLORE**  
**Nr.1, datë 4.2.2004**

**PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR DHËNIEN E LEJEVE TË MANOVRIMIT  
PËRDORUESVE TË MAKINERIVE TË RËNDA TË NDËRTIMIT DHE DISIPLINIMI I  
PËRDORIMIT TË MAKINERIVE TË NDËRTIMIT**

**KREU I**  
**QËLLIMI, OBJEKTI I RREGULLORES DHE FUSHA E VEPRIMIT**

Neni 1

**Qëllimi i rregullores**

Kjo rregullore ka për qëllim vendosjen mbi baza unike e ligjore të aktivitetit të administrimit dhe të përdorimit të makinerive të ndërtimit, sipas karakteristikave teknike e të sigurisë në punë, në sheshet dhe objektet e ndërtimit (me përjashtim të rregullave të lëvizjes në rrugë automobilistike).

Neni 2

Kjo rregullore përcakton dhe e shtrin fushën e veprimit të saj në:

- 1.Vendosjen e rregullave për përgatitjen dhe kontrollin e aftësive profesionale, si dhe pajisjen me leje manovrimi të manovratorëve të makinerive të rënda të ndërtimit.
- 2.Vendosjen e rregullave të administrimit dhe të përdorimit të makinerive të ndërtimit.

## KREU II KOMISIONI I POSAÇËM PËR DHËNIEN E LEJEVE TË MANOVRIMIT

### Neni 3

1. Lejet e manovrimit jepen nga Komisioni i Posaçëm për dhënie e lejeve të manovrimit që funksionon pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.808, datë 4.12.2003.

2. Komisioni i Posaçëm për dhënie e lejeve të manovrimit për makineritë e rënda të ndërtimit është organi i vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë që ka të drejtën e dhënies së lejeve për ushtrimin e veprimtarisë në këtë fushë.

3. Komisioni drejtohet nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit si kryetar apo ndonjë person i autorizuar prej tij.

### Neni 4

1. Ngritja, përbërja dhe shpërblimi i anëtarëve të këtij Komisioni bëhet me urdhër të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

2. Komisioni merr vendime për personat fizikë që plotësojnë kërkesat për marrjen e lejes së manovrimit. Në rastin e një votimi të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

3. Vendimi i Komisionit për dhënie e lejeve të manovrimit firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit prezent në ditën e mbledhjes, por jo më pak se 70% e anëtarëve.

4. Komisioni mbledhet si rregull jo më pak se 1 (një) herë në muaj.

### Neni 5

1. Komisioni thirret në mbledhje nga kryetari i tij. Në mungesë të kryetarit dhe me autorizim të tij mbledhjet mund të drejtohen nga njëri prej anëtarëve të Komisionit.

2. Në mbledhjet e tij Komisioni shqyrton edhe informacione e kërkesa të organeve të administratës publike për probleme të disiplinimit të përdorimit të makinerive të ndërtimit. Këto kërkesa në çdo rast duhet të jenë paraqitur në mënyrë zyrtare në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

3. Mbledhjet e Komisionit janë të mbyllura dhe në to mbahet protokoll.

## KREU III KOMISIONI TEKNIK I VLERËSIMIT

### Neni 6

Për të provuar aftësitë profesionale (teorike dhe praktike) të manovratorëve të makinerive të rënda të ndërtimit, që kërkojnë të pajisen me leje manovrimi, pranë Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë, krijohet Komisioni Teknik i Vlerësimit të tyre i përbërë nga inxhinierë mekanikë me përvojë.

Vlerësimi i këtij Komisioni për çdo aplikant i përcillet Komisionit të Posaçëm për dhënie e lejeve të manovrimit për makineritë e rënda të ndërtimit pranë MRRTT-së.

## KREU IV SEKRETARIA E KOMISIONIT

### Neni 7

Të gjitha kërkesat dhe dokumentacionet e nevojshme të personave fizikë të interesuar, dorëzohen pranë sektorit të licencave nëpërmjet Zyrës së Protokoll-Arkivit në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

#### Neni 8

1. Sekretaria verifikon rregullshmërinë ligjore të dokumentacioneve në zbatim të kësaj rregulloreje dhe harton materialin përfundimtar të mbledhjeve të tij.

2. Sekretaria ka të drejtën e komunikimit zyrtar me subjektin e interesuar për plotësimin e dokumentacionit sipas kësaj rregulloreje deri në marrjen e lejes së manovrimit.

3. Dokumentet së bashku me kërkesën quhen zyrtarisht të dorëzuara nga data kur personi fizik i interesuar ka plotësuar dokumentet në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

4. Sekretaria jep përgjigjet për miratimin e lejeve të manovrimit nga Komisioni, pas zbardhjes së vendimit.

#### Neni 9

Sekretaria e Komisionit mban lidhje të vazhdueshme, jep e merr informata në rrugë zyrtare me të gjitha institucionet që kanë të bëjnë me aktivitetin e personave fizikë në fushën e disiplinimit të përdorimit të makinerive të ndërtimit.

#### Neni 10

1. Sekretaria e Komisionit përgatit lejet e manovrimit në 2 kopje origjinale sipas formatit të propozuar nga Komisioni dhe të miratuar nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, mbi bazën e vendimit të Komisionit (formati i bashkëlidhet kësaj rregulloreje).

2. Lejet e manovrimit firmosen nga kryetari i Komisionit.

Një kopje origjinale i dorëzohet personit fizik. Gjithashtu një kopje origjinale e lejes së manovrimit së bashku me praktikën arshivohet pranë sektorit të licencave dhe regjistrohen në një libër themeltar regjistrimi në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

#### Neni 11

Nuk lejohet transferimi i lejes së manovrimit nga një person fizik tek tjetri.

#### Neni 12

Lejet e manovrimit që emërtohen në zbatim të kësaj rregulloreje, janë subjekt i tarifës të miratuar nga Ministria e Financave dhe derdhen në llogarinë e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

Në sektorin e licencave së bashku me dokumentacionin, kërkesën dhe lejen e manovrimit, arshivohet dhe mandati i arkëtimit për pagesën sipas tarifës së caktuar.

Lejet e manovrimit tërhiqen pranë sektorit të licencave në MRRTT.

Leja e manovrimit ka afat vlefshmërie të përhershëm.

### KREU IV

#### E DREJTA E PËRDORIMIT, KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE TË MANOVRIMIT DHE EMËRTIMET E TYRE

#### Neni 13

Drejtuesit e subjekteve ndërtuese janë përgjegjës për administrimin e makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit pranë tyre, si dhe për kualifikimin e personelit përdorues të tyre.

#### Neni 14

E drejta për të përdorur makineritë e rënda të ndërtimit, u jepet personave që kanë zhvilluar kursin teorik dhe praktik (me pagesë) për makineritë në fjalë. Për zhvillimin e këtyre kurseve, Ministria autorizon me kërkesën e tyre, subjektet shtetërore dhe private.



Kushtet, afatet dhe programet për zhvillimin e kurseve jepen në shtojcën bashkëlidhur.

Lista e kursantëve që kanë mbaruar përgatitjen teoriko-praktike, e shoqëruar me vlerësimin “i aftë” nga subjekti që ka zhvilluar kursin, i dërgohet Komisionit të Posaçëm të dhënies së lejeve të manovrimit në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe Komisionit Teknik të Vlerësimit pranë Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë.

Në bazë të kësaj liste Komisioni Teknik i Vlerësimit pranë Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë merr në provim personat përkatës.

#### Neni 15

Të gjithë manovratorët që punojnë me makineri të rënda ndërtimi, me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, do të pajisen me lejet e reja të manovrimit, brenda vitit 2004 sipas dy grupeve:

1. Rinovim i lejes për manovratorët e pajisur më parë me leje manovrimi për makineritë e rënda të ndërtimit, të cilët do të paraqiten në provim para Komisionit Teknik të Vlerësimit, vetëm për rregullat e sigurimit teknik për makineritë e tipeve të reja.

2. Pajisja me leje të re e të gjithë manovratorëve që punojnë si të tillë, por që nuk kanë kaluar në prova dhe nuk janë pajisur me leje manovrimi deri ditën e daljes të kësaj rregulloreje, do të paraqiten në provim para Komisionit Teknik të Vlerësimit vetëm pasi të kalojnë kursin teorik të përshpejtuar përgatitor.

Kursi teorik i përshpejtuar përgatitor me pagesë do të përfshijë sistemet e reja hidraulike dhe rregullat e sigurimit teknik në punë me një program prej 12 orësh (dy ditë nga 6 orë) dhe do të zhvillohet pranë Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë nga inxhinierët me përvojë për makineritë e rënda të shoqërive të ndërtimit.

3. Kategoritë e manovratorëve të këtij neni nuk u nënshtrohen kurseve teorike dhe praktike për makineritë në fjalë, nga subjektet shtetërore dhe private, të autorizuar nga Ministria.

#### Neni 16

1. Personat që do të pajisen me leje manovrimi në zbatim të kësaj rregulloreje duhet të paraqesin pranë MRRTT-së dokumentet si më poshtë vijon:

A) Kërkesë me shkrim nga aplikanti në formë autobiografie (Curriculum Vitae) me të dhënat kryesore:

a) Emri, atësia, mbiemri, kombësia, vendlindja, ditëlindja, adresa, numri i telefonit, vendi i punës në qoftë se punon dhe 2 fotografi 3x4 cm;

b) Vërtetim nga gjykata dhe prokuroria ku kryen veprimtarinë;

c) Vërtetim nga organi i qeverisjes lokale për vendbanim;

d) Kopje të dëftesës së shkollës të noteruar;

e) Raport shëndetësor për shikimin dhe dëgjimin;

f) Vërtetim nga subjekti shtetëror apo privat i autorizuar nga MRRTT, që ka kryer kursin teorik dhe praktik për makinerinë në fjalë;

g) Vërtetim vlerësimi nga Komisioni Teknik i Vlerësimit pranë Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë;

h) Deklaratë se njohin dhe do të zbatojnë dispozitat e kësaj rregulloreje dhe rregullat e sigurimit teknik.

2. Manovratorët të përcaktuar në pikën 1 të nenit 15 të kësaj rregulloreje, krahas dokumentacionit sipas pikave a), b), c), e), g) dhe h) të pikës 1 të këtij neni, do të paraqesin edhe:

a) kopje të lejes së manovrimit (të noteruar).

3. Manovratorët të përcaktuar në pikën 2 të nenit 15 të kësaj rregulloreje, krahas dokumentacionit sipas pikave a), b), c), d), e), g) dhe h) të pikës 1 të këtij neni, do të paraqesin edhe:

a) kërkesën e shoqërisë ku punon, llojin e makinerisë që ka në përdorim ose dokumentin e pronësisë së makinës.

## Neni 17

Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet e lejeve të manovrimit për to, të jenë si më poshtë:

a) Makineri gjurmimi e ngarkimi dherash: Ekskavatorë, makineri gjurmuese dragë, lopata ngarkuese, ngarkues të kombinuar (me goma dhe me zinxhirë), manovratorët emërtohen ekskavatoristë.

b) Makineri gjurmimi, transporti, nivelimi e ngjeshje dherash: Buldozerë, traktorë, skrepër, nivelues (greidera), rulo kompresorë, shtruese asfalto betoni (me goma dhe me zinxhirë), manovratorët emërtohen buldozeristë.

c) Makineri ndërtimi mbi bazë automjeti: autovinca, autobetonierë, autobetonpompa, autobitumatriçe, autosonda, manovratorët emërtohen automakinistë.

Përdoruesit e makinerive të ndërtimit me rrota gome, përveç lejes së manovrimit duhet të jenë pajisur detyrimisht edhe me leje drejtimi (patentë) automjetesh të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, konform nenit 122 të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor” i Republikës së Shqipërisë.

## Neni 18

E drejta për të përdorur makineritë e tjera të ndërtimit të mesme e të lehta (të gjitha ato që nuk përfshihen në emërtesën e makinerive të rënda) u jepet personave fizikë që kanë zhvilluar kursin teorik dhe praktik për makinerinë në fjalë dhe pasi të kenë dhënë provim pranë Komisionit Teknik të ngritur pranë subjekteve ndërtuese. Në Komision duhet të jetë detyrimisht dhe një inxhinier mekanik.

## KREU V DISIPLINIMI I PËRDORIMIT TË MAKINERIVE TË NDËRTIMIT DHE RREGULLA TË SIGURIMIT TEKNIK

## Neni 19

Subjektet ndërtimore ua dorëzojnë me procesverbal makineritë, vetëm përdoruesve të pajisur me leje manovrimi të cilët e shfrytëzojnë, mirëmbajnë dhe përgjigjen për dëmet që shkaktohen për faj të tyre. Procesverbal i firmoset nga drejtuesit e shoqërisë dhe nga përdoruesi marrës në dorëzim.

## Neni 20

Procesverbal i marrjes në dorëzim të makinerisë dhe leja e manovrimit janë dokumente teknike që duhet të mbahen detyrimisht nga përdoruesi gjatë gjithë kohës që shfrytëzon makineritë. Ato paraqiten sa herë që kërkohet nga personat e ngarkuar për kontroll. Ndalohet shfrytëzimi i makinerisë nga përdoruesit pa qenë të pajisur me këto dokumente.

## Neni 21

Për mjetet ngritëse, si vinç-kullë, vinç-derik, vinç-stacionerë, ashensorë zmontimi dhe montimi në objektin e ri, do të bëhet me specialistë, nën mbikëqyrjen e drejtuesit teknik të shoqërisë dhe një inxhinier mekanik i pajisur me licencë, të cilët do të asistojnë dhe do të kontrollojnë të gjitha regjistrimet dhe provat që duhet të plotësojnë këto makineri (prova pa ngarkesë dhe me ngarkesë) për të qenë të gatshme për punë. Në përfundim të provave mbahet një procesverbal ndërmjet drejtuesit teknik të subjektit, specialistëve të montimit, inxhinierit mekanik dhe manovratorit.

## Neni 22

Përdoruesi çdo ditë para fillimit të punës provon gjendjen teknike të makinerisë duke e vënë atë në lëvizje. Nëse konstaton ndonjë mungesë ose defekt, ndalon makinerinë dhe lajmëron personat përgjegjës. Ndalohet fillimi dhe vazhdimi i punës me makineri të defektuara dhe me mungesa.

## Neni 23

Subjektet ndërtimore janë të detyruara të japin udhëzime mbi rregullat e sigurimit teknik dhe rregullat e shfrytëzimit të makinerive që janë në përdorim jo më pak se një herë në tre muaj.

## Neni 24

Në rastin kur makineria punon me ndërresa, kontrolli i gjendjes teknike të makinerisë bëhet në praninë e dorëzuesit dhe marrësit në dorëzim. Marrësi në dorëzim, në qoftë se bindet se makineria është në gjendje të mirë, fillon punën, në të kundërtën lajmëron menjëherë përgjegjësën për gjendjen teknike të saj. Shënimet mbi gjendjen teknike të makinerisë bëhen në librin e dorëzimit të turnit, me të cilin pajiset çdo makineri që punon me ndërresa.

## Neni 25

Personeli inxhiniero-teknik, si dhe manovratorët e makinerive në shoqëritë ndërtimore, janë të detyruar që para vënies në shfrytëzim të makinerive dhe pajisjeve, të njohin dhe të zbatojnë, rregullat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe sigurimit teknik të tyre, si dhe të kryejnë provat e plota teknike dhe teknologjike.

## Neni 26

Subjektet ndërtimore organizojnë punën për mirëmbajtjen dhe riparimin e makinerive në ofiçinat e tyre apo në ofiçina të specializuara, duke ruajtur gjendjen teknike për punë të sigurt pa defekte e avari, që mund të shkaktojnë aksidente në objektet e punës.

## Neni 27

Subjektet ndërtimore organizojnë punën me makineri në objektet që ndërtojnë sipas një planorganizimi të hartuar e të miratuar prej tyre duke pasur parasysh: kapacitetet teknike, zonat e lëvizjes dhe të manovrimit, thellësitë e gërmimit, këndet e skarpateve, rrugët e kalimit, distancat nga objektet e ndërtuara, shenjat kufizuese për njerëzit etj.

## Neni 28

Përdoruesit e makinerive të ndërtimit mbajnë përgjegjësi për gjendjen teknike të makinerisë që përdorin dhe duhet të sigurojnë punë me regjim teknik normal, pa avari dhe me siguri të plotë për jetën e tyre dhe të personave të tjerë që punojnë rreth tyre. Ata nuk zbatojnë asnjë urdhër apo nuk marrin asnjë iniciativë për të punuar në kundërshtim me rregullat teknike dhe rregullat e sigurimit teknik.

## Neni 29

Për shkeljen e rregullave të administrimit dhe të përdorimit të makinerive, kanë përgjegjësi sipas rastit, disiplinore, materiale ose penale personat fajtorë, si dhe personat që kanë urdhëruar të punohet në kundërshtim me rregullat teknike dhe rregullat e sigurimit teknik.

## Neni 30

Në rast se makineria, si rezultat i përdorimit të saj jo të rregullt, shkakton avari që shoqërohen dhe me viktime, njoftohet menjëherë organi i prokurorisë dhe merren masa për të ruajtur vendin ku ka ndodhur avaria për të mos bërë ndryshime. Përfshihen rastet kur duhen nxjerrë personat e dëmtuar nga avaria për t'u dhënë ndihmën mjekësore, si dhe për të likuiduar vatrën që mund të zmadhojë dëmin.

## Neni 31

Përdorimi i makinerive të rënda, pa lejen e manovrimit përbën dhe ndëshkohet si shkelje e rregullave të sigurimit teknik në ndërtim.

## Neni 32

Për shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje, me kërkesë të motivuar të Drejtorisë së Policisë së Ndërtimit dhe institucioneve dhe subjekteve të interesuara, Komisioni i Posaçëm për dhenien e lejeve të manovrimit, gëzon të drejtën e marrjes së masave disiplinore me heqjen e lejes për një periudhë 6-mujore, njëvjeçare deri në heqjen e lejes së manovrimit përgjithmonë.

Masat e marra i njoftohen personit ndaj të cilit është marrë masa dhe subjektit juridik ku ai punon.

Personi ndaj të cilit është marrë masa përkatëse ka të drejtën e ankimit te Ministri i Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, brenda 10 ditëve, nga data e njoftimit.

## SHTOJCA

### PËR KRITERET, AFATET DHE PROGRAMET PËR ZHVILLIMIN E KURSEVE PËR LEJE MANOVRIMI PËR MAKINERITË E RENDA TË NDËRTIMIT

#### SUBJEKTET QË AUTORIZOHEN

(Kushtet që duhet të plotësojnë subjektet)

Të jenë persona juridikë të regjistruar në gjykatë.

Të jenë të licencuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të kenë si drejtues teknik ose në stafin e shoqërisë një inxhinier mekanik.

Të kenë klasë për zhvillimin e kurseve të pajisura me mjete didaktike si pankarta, nyje, agregate etj.

Të kenë në pronësi makineri të rënda ndërtimi nga të gjitha llojet, me mbi 10 copë gjithsej.

#### KURSET E KUALIFIKIMIT (AFATET DHE PROGRAMET E KURSEVE)

Kursi teorik duhet të përfshijë një periudhë kohe jo më të vogël se 32 orë.

Në program të përfshihen njohuri për:

- Makineritë e ndërtimit
- Motorrët
- Sistemet e frenimit
- Sistemet e lëvizjes
- Sistemet hidraulike
- Sistemet e ngritjes (polispaset, kavot, cilindrat, pultet e komandimit, pompat hidraulike, shpërndarësit etj.)
- Manovrimin e makinerive
- Mirëmbajtjen (shërbimet teknike, ndërrimin e filtrave, vajrave etj.)
- Rregullat e sigurimit teknik etj.

Për zhvillimin e praktikës kryhet një stazh në punë si ndihmës nën drejtimin e një manovratori me përvojë për një periudhë kohe jo më të vogël se dy muaj.

**VENDIM**  
**Nr.679, datë 22.10.2004**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE PËR PËRDORIMIN E BETONEVE STRUKTURE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullave teknike për përdorimin e betoneve strukturore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministritë, institucionet dhe personat fizikë a juridikë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.78, faqe 5803*

**RREGULLA TEKNIKE**  
**PËR PËRDORIMIN E BETONEVE STRUKTURE**

1. Të përgjithshme

Në zbatim të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 18, janë hartuar rregullat teknike për përdorimin e betoneve strukturore.

Ky material shërben për të përcaktuar kushtet operative për ruajtjen e karakteristikave të kërkuara gjatë përdorimit të betoneve strukturore nga subjektet prodhuese. Zhvillimet e teknologjisë së prodhimit të materialeve të ndërtimit dhe të përdorimit të tyre, kërkojnë njohje dhe prezantim të kushteve operative të këtyre materialeve në përputhje me standardet europiane dhe rregullat teknike të harmonizuara.

Rregullat teknike të parashikuara në këtë material trajtojnë:

- betonin e zakonshëm dhe betonet me rezistencë të lartë,
- dhe evidentojnë tregues rreth jetëgjatësisë së përdorimit të strukturave betonarme, të cilat janë rezultat i studimeve dhe eksperimentimeve në këtë fushë, edhe në nivel ndërkombëtar;
- përdorimin e betonit për qëllime strukturore, të armuar ose jo, të zakonshëm ose të paranderur, me përjashtim të betoneve të lehtë.

2. Përcaktime

2.1 Me termin “Beton”, do të kuptojmë përcaktimin në vartësi të klasës së ekspozimit, të dimensionit nominal dhe maksimal të inerteve, të klasës së konsistencës dhe parashikimit të kohës në përdorim, duhen mbajtur parasysh zgjedhjet e llojit dhe të klasës së çimentos.

2.2 Me termin “përbërje”; do të kuptojmë raportet çimento, inert, ujë, aditiv (shtesa) dhe shtesa eventuale, të përcaktuara në mënyrë që të kënaqë kërkesat dhe të minimizojë fenomenet e veçimit të inerteve dhe të kapilaritetit të betonit të freskët.

2.3 “Punueshmëri” e përcaktuar edhe me termin “konsistencë” në standardet në fuqi, është një tregues i përmbajtjes dhe të sjelljes së betonit në intervalin e kohës, nga momenti i prodhimit deri në vendosjen në kallëpe në vepër ose në intervalin ndërmjet procesit të prodhimit dhe atij përfundimtar nëse kërkohet.

3. Punueshmëria

Subjekti prodhues duhet të mbajë parasysh që punueshmëria e betoneve përcaktohet nga lloji i strukturës që betonohet, nga mënyra e vendosjes në objekt, koha dhe distanca e transportit.

Karakteristikat e kërkuara të jetëgjatësisë dhe rezistencës mekanike mund të jenë efektive të arrira, vetëm nëse transporti, vendosja në vepër dhe stazhionimi janë respektuar me korrektësi.

Në recepturën e përbërjes së betonit duhet të përcaktohen karakteristikat e brumit të freskët në përputhje me rezistencën mekanike dhe jetëgjatësinë e betonit të ngurtësuar.

Vetitë e betonit të freskët të lidhura me punueshmërinë janë:

a) Stabiliteti ose aftësia e brumit për t'i qëndruar veprimit të jashtëm. Uniformizimi i shpërndarjes së përbërësve.

b) Lëvizshmëria ose lehtësia me të cilën brumi rrjedh në kallëpë ose forma deri sa të arrijë në nivelin e arsyeshëm.

c) Kompaktësia ose lehtësia me të cilën brumi vendoset në kallëpe ose formë dhe lehtësia e daljes së ajrit që ai përmban;

Lëvizshmëria dhe stabiliteti duhet të jenë në raport me konsistencën ose qëndruar të brumi, dhe varen nga përmbajtja e ujit, temperatura dhe prezenca e shtesave të ndryshme.

Në rastet kur konsistenca nuk paraqet të gjithë treguesit e punueshmërisë së përzierjes, në teknologjinë e betonit është pranuar që punueshmëria e betonit të freskët të kontrollohet nëpërmjet matjes së konsistencës, duke qenë kështu mënyra më e thjeshtë dhe e shpejtë e kontrollit.

### 3.1 Matja e konsistencës

Për matjen e konsistencës duhen mbajtur parasysh se:

- Konsistenca, si punueshmëri, është rezultat i shumë vetive reologjike, e për pasojë nuk është e ndjeshme vetëm nga përcaktimet sasiore, por edhe nga vlerësimet relative mbi bazë të sjelles së betonit dhe metodave përcaktuese të provave.

- Asnjëra nga metodat e provave të propozuara ose në përdorim për matjen e konsistencës nuk është plotësisht e pranueshme, prandaj treguesit e betonit të freskët duhet të ndryshohen nga metoda në metodë.

- Lidhur me këtë në përgjithësi ndjeshmëria maksimale e çdo metode i perket fushave të ndryshme të punueshmërisë dhe sipas veçantisë së strukturës dhe kushteve të vendosjes në vepër, zgjidhet metoda e pranueshme e kontrollit të klasës së konsistencës.

Metodat e matjes së konsistencës janë:

1. ulja e konusit Abrahams;
2. prova Vèbè;
3. treguesi i kompaktësisë;
4. treguesi i shtrirjes (përhapjes).

Mbi këto metoda është i bazuar klasifikimi i betonit në funksion të konsistencës, (Tabelat 1-4).

Tabela nr.1: Klasa e konsistencës sipas uljes së konusit

Klasa e konsistencës	Ulja e konusit në mm	Emërtimi
S 1	Nga 10 në 40	i njomë
S 2	Nga 50 në 90	plastik
S 3	Nga 100-150	gjysmë i rrjedhshëm
S 4	Nga 160-210	i rrjedhshëm
S 5	> 210	shumë i rrjedhshëm

Tabela nr.2: Klasa e konsistencës sipas metodës Vèbè

Klasa e konsistencës	Koha Vèbè në sek
V 0	≥ 31
V 1	Nga 30 deri 21
V 2	Nga 20 deri 11

V 3	Nga 10 deri 6
V 4	Nga 5 deri 3

Tabela nr.3: Klasa e konsistencës sipas treguesit të kompaktësisë

Klasa e konsistencës	Treguesi i kompaktësisë
C 0	$\geq 1.46$
C 1	Nga 1.45 deri 1.26
C 2	Nga 1.25 deri 1.11
C 3	Nga 1.10 deri 1.04

Tabela nr.4: Klasa e konsistencës sipas treguesit të shtrirjes

Klasa e konsistencës	Shtrirja në mm
FB 1	$\leq 340$
FB 2	nga 350 deri 410
FB 3	nga 420 deri 480
FB 4	nga 490 deri 550
FB 5	nga 560 deri 620
FB 6	$\geq 630$

Metoda më e përdorur për matjen e konsistencës së betonit është ajo e uljes së konusit. Në paraqitje, kemi tri forma të uljes së konusit, sipas figurës nr.1.




Figura nr.1: Format e uljes së konusit

Forma e parë, me ulje të konusit në mënyrë uniforme pa prishje të masës së betonit, tregon përbërje të përshtatshme të përzierjes.

Forma e dytë, me ulje asimetrike (prerje), shpesh tregon mungesën e kohezionit dhe manifestohet me lehtësinë që ka brumi për t'u shpërbërë. Në rast se prova përsëritet dhe rezultati nuk ndryshon, atëherë betoni nuk duhet lejuar të vendoset në vepër.

Forma e tretë me ulje përgjithësisht të shtrirë, tregon për një përzierje të varfër ose përzierje me shumë ujë.

Përzierjet shumë të thata të betoneve kanë një ulje shumë të vogël të konusit, gati zero; në këtë rast është më mirë të përdoret metoda Vëbë.

Përzierjet me konsistencë plastike e gjysmë të rrjedhshme janë shumë më të ndjeshme ndaj metodës së uljes së konusit.

Ka raste që për përziejat e varfra, të afta për të qëndruar, një ulje e rregullt e konusit për momentin mund të shndërrohet në një ulje asimetrike ose të shtrirë. Në këtë rast, duhet vërtetuar fenomeni për të evituar vlerat e ndryshme të uljes së konusit për kampione të së njëjtës përzierje.

Për betone të rrjedhshme dhe shumë të rrjedhshme është e preferueshme metoda e matjes së konsistencës me anë të provës së shtrirjes.

Në përgjithësi, koha dhe zgjedhja e njëres prej metodave të provës, rekomandon një interpretim me kujdes të rezultateve, kur ato janë jashtë kufijve të mëposhtëm;

- ulja e konusit <10mm >210 mm
- koha Vëbë < 5 sek >30 sek.
- treguesi kompaktësisë < 1. 04 >1. 45
- shtrirja <340 mm > 620 mm

### 3.2 Faktorët që influencojnë në punueshmërinë e përzierjes

Gjatë punueshmërisë së betonit, duhet mbajtur parasysh se ajo influencohet nga shumë faktorë; nga përmbajtja e ujit, karakteristikat kokrrizore të inerteve, koha e transportit, temperatura e mjedisit, karakteristikat e çimentos, si dhe nga shtesat (aditivët).

### 3.3 Humbja e punueshmërisë

Meqenëse punueshmëria është një veti e betonit të freskët që zvogëlohet gradualisht gjatë hidratimit të çimentos, subjekti prodhues duhet të ketë parasysh që:

- brumi ta ruajë punueshmërinë jo vetëm në momentin e transportit, por sidomos gjatë kohës së hedhjes në vepër të tij;
- nëse intervali i kohës ndërmjet prodhimit, transportit dhe vendosjes në vepër nuk është i shkurtër, e për më tepër nëse temperatura e ambientit është e lartë, punueshmëria fillestare duhet të jetë më e madhe se ajo që kërkohet për t'u vendosur në vepër; në praktikë në kantiere ndodh që përpara hedhjes në kallëpe i shtojnë ujë ose superfluidifikantë;
- të mbahet parasysh se humbja e punueshmërisë është një fenomen që vihet re në orën e parë ose maksimumi në dy orët e para nga momenti i prodhimit të betonit.

Në grafikun e figurës nr.2 tregohet ecuria e humbjes së punueshmërisë së një betoni me konsistencë fillestare të rrjedhshme (shiko tabelën. nr.1)




Figura nr.2: Ecuria e humbjes së punueshmërisë së brumit të betonit

Përshpejtimi i humbjes së punueshmërisë mund të verifikohet, pa ndryshimin e periudhës së ngurtësimit, me përdorimin e shtesave (aditive) që zvogëlojnë sasinë e ujit.

Nisur nga kushtet fillestare, temperatura e përbërësve influencon mbi sasinë e ujit të nevojshëm për formimin e brumit dhe punueshmërinë fillestare të tij. Në mënyrë orientuese, në tabelën e mëposhtme tregohen vlerat e punueshmërisë së një betoni në funksion të temperaturës së mjedisit.



Temperatura °C	Punueshmëria sipas uljes së konit në cm
5	15
10	13
20	9
30	6
40	5

Në veçanti vërehet se për temperatura 40 – 50 °C, ulet punueshmëria e betonit dy herë, krahasuar me temperaturën 20 °C

#### 4. Staxhionimi

Subjekti që merret me prodhimin e materialeve të ndërtimit, gjatë procesit të ngurtësimit të betonit së bashku me kujdesin që duhet treguar gjatë transformimit të tij në material me rezistencë mekanike, duhet kujdesur edhe për mënjanimin e lindjes së plasaritjeve. Me këtë përkujdesje gjatë periudhës së staxhionimit pas vendosjes në vepër, betoni fiton karakteristikat e tij sidomos në sipërfaqen e tij.

Kujdesi që duhet treguar gjatë fazës së fillimit të ngurtësimit të betonit lidhet me:

a) shmangien e tharjes së sipërfaqes së betonit si shkak i parë, sepse uji është i nevojshëm për hidratimin e çimentos dhe për zhvillimin e reaksionit pucolanik, në rastin e përdorimit të çimentove me përzierje, dhe shkak i dytë, evitimi i krijimit të porozitetit në sipërfaqen e ngurtësuar të betonit. Tharja e menjëhershme krijon premisa për depërtim në armaturë e për rrjedhojë aktivizimin e substancave agresive të pranishme në ambient.

Në punimet e shtresave dhe të ngjashme me to, humbja e lagështisë në fazën në të cilën brumi është akoma plastik mund të krijojë plasaritje. Në përgjithësi, kujdesi për tharjen e sipërfaqes (staxhionim i kujdesshëm) kërkon ngjeshjen e mirë të shtresës së betonit pranë armaturës, mënjanimin e plasaritjeve dhe garantimin e realizimit të rezistencës mekanike të dëshiruar të betonit.

b) shmangien e ngrirjes së ujit të brumit të çimentos përpara se betoni të arrijë një shkallë ngurtësimi të pranueshme.

c) mënjanimin përgjatë zonës ku kryet betonimi, të tronditjeve dhe lëvizjeve të ndryshme të shoqëruara me ndryshime temperature, pasi kanë prirje për të krijuar plasaritje.

Sjellja e betonit gjatë procesit të staxhionimit varet:

a) Nga përbërja e tij;

- raporti u/ç, tipi dhe klasa e çimentos, si dhe tipi dhe klasa e shtesave.

Një beton i prodhuar me raportin u/ç të ulët, por me një çimento me ngurtësim të shpejtë, e arrin më shpejt rezistencën sipërfaqësore të betonit e cila siguron një zvogëlim të shkallës së depërtueshmërisë në shtresën mbrojtëse të armaturës, prandaj kërkon një kohë më të vogël të staxhionimit krahasuar me betonet e prodhuara me çimento që hidratohen me ngadalë, ose betone që janë prodhuar me çimento me shtesa në sasi të konsiderueshme të natyrës pucolanike.

b) nga temperatura e tij:

Kjo mund të rritet gjatë reaksionit ekzotermik ndërmjet çimentos dhe ujit. Shpejtësia ngurtësimit është e ndryshueshme, gjë që varet edhe nga temperatura e pëzierjes së betonit, p.sh. në temperaturë 35°C, shpejtësia e ngurtësimit është sa dyfishi krahasuar me temperaturën 20°C dhe në temperaturë 10°C, sa gjysma e temperaturës 20°C.

Temperatura e betonit në vepër varet nga kushtet mjedisore, (temperatura, lagështia relative, prezenca ose mungesa e erës) nga temperatura e përbërësve të betonit, dozimi materialeve, tipi dhe klasa e çimentos, përmasat e elementit strukturor dhe sistemi i izolimit të kallëpit të armaturës.

Elementet me seksion të ngushtë të kallëpit dhe pa izolim termik, të ekspozuar që në fillim në mjedis me temperaturë të ulet dhe të përgatitur me çimento me nxehtësi hidratimi të ulët, e kanë të nevojshme kujdesin dhe mbikëqyrjen gjatë staxhionimit.

Në rastin e fenomenit të ngricave, përpara se betoni të arrijë një rezistencë të nevojshme në shtypje ( $\geq 5 \text{ N/mm}^2$ ), materiali pëson një dëm të përhershëm.

Pragut të vlerës ( $\geq 5 \text{ N/mm}^2$ ) i korrespondon një shkallë hidratimi e mjaftueshme për të realizuar një vetëtharje të shoqëruar me formimin e një volumi poresh që krijohet nga largimi i ujit, në mënyrë që betoni të mund të ngurtësohet pa u dëmtuar.

Koha e nevojshme që i duhet betonit për të arritur një vlerë të mjaftueshme rezistencë në shtypje, duhet të përcaktohet eksperimentalisht.

c) Nga kushtet mjedisore gjatë dhe pas staxhionimit:

Në kushtet e staxhionimit, subjekti prodhues duhet te ketë parasysh:

Një lagështi e ulët relative e ajrit, qëndrimi në diell dhe era e fortë, shpejtojnë tharjen e betonit jo shumë të mbrojtur në periudhën fillestare të dehidratimit.

Deri në momentin që hidratimi i çimentos nuk është zhvilluar për 10-20 orë, avullimi i ujit nga sipërfaqja e ekspozuar e betonit bëhet si në një sipërfaqe të lagur, përderisa uji i djersitjes del nga sipërfaqja. Për këtë ka rëndësi të veçantë që, gjatë 24 orëve të para pas hedhjes në vepër, tharja të mos tejkalohet, nëse duam që të mos kemi plasaritje nga tkurrja plastike.

Sasia efektive e ujit që mund të humbasë një sipërfaqe betoni e ekspozuar dhe e lagur, mund të gjykohet sipas figurave nr.3 dhe 4.




Figura nr.3: Presioni parcial i avujve të ujit në funksion të temperaturtës




Figura nr.4: Shpejtësia e avullimit në funksion të shpejtësisë së erës dhe presionit parcial të avullit

Shënim. Diagramet e figurave nr.3 dhe 4 janë marrë nga botimi i Komitetit European të Betonit (CEB) “Betonet strukturore jetëgjata”.

Faktorët vendimtarë që përcaktojnë shpejtësinë e avullimit janë shpejtësia e erës dhe diferenca  $\Delta p$  ndërmjet presionit parcial të avullit mbi shtresën e ujit në sipërfaqen e betonit dhe presionit parcial të ajrit të ambientit.

Përdorimin e diagramës mund ta ilustrojmë me një shembull në të cilin temperatura e ujit dhe e betonit të jetë 27 °C dhe lagështia relative  $L_R$  mbi shtresën e ujit të jetë 100% (pika A e fig. 3); për ajër në temperaturën 25°C dhe  $L_R = 70%$  (pika B), diferenca  $\Delta p$  rezulton  $(27 - 16,5) = 10,5$  mm hg.

Nëse arrihet një shpejtësi e erës nën 2 m/sek, figura nr.4 na jep një shpejtësi avullimi 0,39 kg/m<sup>2</sup>h.

Nuk mund të jepet një rregull i përgjithshëm rreth shpejtësisë së avullimit nga sipërfaqja e betonit në fazën fillestare të ngurtësimit, duke pasur parasysh vartësinë e kësaj shpejtësie nga lloji i betonit e veçanërisht nga tendenca në tharje e tij. Për betone të përgatitur me çimento Portland të zakonshme, standardi i ACI (Instituti Amerikan i Betonit) rekomandon kujdes të veçantë, nëse shpejtësia e avullimit është afër 1kg/m<sup>2</sup> h. Në rastin e çimentove me shtesa, të cilat dërsitin (avullojnë ) më pak ujë, ky prag është shumë më i ulët.

Pra një avullim i ngadalësuar i ujit të përzierjes zvogëlon riskun e tkurrjes plastike të betonit, por nuk duhet gjithashtu të harrojmë që ajo të shpie në formimin e një betoni me strukturë poroze, veçanërisht në afërsi të sipërfaqes.

#### 4.1 Kontrolli i diferencës së temperaturës gjatë staxhionimit.

Për të kontrolluar diferencën e temperaturës gjatë staxhionimit duhet te mbahet parasysh:

- Stabilizimi i saktë i kufijve të pranueshëm të diferencës së temperaturës, që janë të pranueshme në seksionin gjatësor të elementit në fazën e ngurtësimit, nuk është i mundur, pasi ato varen jo vetëm nga përzierja e brumit dhe karakteristikat e zhvillimit të rezistencës, por edhe nga forma gjeometrike e elementit strukturor dhe nga shpejtësia e arritjes së ekuilibrit termik me ambientin, pas heqjes së kallëpit.

- Respektimi i limiteve të mëposhtme për të kufizuar nderjet e betonit me origjinë termike;

- a) një diferencë temperature jo më shumë se 20°C mbi seksionin e elementit pas heqjes së armaturës, gjatë ftohjes;

- b) një diference temperature jo më shumë se 10-15°C përgjatë nyjeve të ndërtimit dhe për struktura me përmasa të ndryshueshme.


#### 4.2 Staxhionimi i zakonshëm

Subjekti prodhues duhet të mbajë parasysh percaktimin e “zakonshëm” të staxhionimit i cili kryhet në temperaturën e ambientit në intervalin e temperaturave 5-35°C, duke përjashtuar çdo ndërhyrje të jashtme si ngrohje ose ftohje.

##### 4.2.1 Efekti i kohës dhe i lagështirës

Në kushtet e temperaturës dhe të lagështisë konstante zhvillohet një reaksion hidratimi me ecuri të rregullt. Zhvillimi i rezistencës në shtypje të betonit në funksion të klasës së çimentos, në krahasim me çdo faktor tjetër të përbërjes, paraqet një ecuri tipike si në figurën nr.5.

Ngurtësimi dhe fortësimi i brumit të çimentos varet nga prezenca e vazhdueshme e ujit. Betoni në momentin e hedhjes në vepër përmban një sasi uji të lirë që siguron hidratimin e çimentos. Procesi i hidratimit (pra ngurtësim) mund të rritet në mënyrë të konsiderueshme kur tensioni i avujve në poret e brumit të çimentos i afrohet vlerave të ngopjes ( $L_R > 90%$ ).



Klasa e çimentos, A 32.5, B;42.5, C 52.5, sasia e çimentos 350 kg/m<sup>3</sup> U/Ç 0.50

Figura nr.5 Shembuj të zhvillimit të rezistencës në shtypje të betonit me përbërje të njëjtë, në raport me tri klasa çimentoje

Rezistenca në shtypje N/mm<sup>2</sup>




Figura nr.6 Efektet e kushteve të ndryshme të staxhionimit në lagështi mbi zhvillimin e rezistencës së betonit, prova mbi mostra kubike me brinjë 10 cm. CNR,Boll. Ufficiale

Në figurën nr.6 është treguar zvogëlimi i zhvillimit të rezistencës së mostrave të betonit të ruajtura në ambient të thatë ose me lagështi relative mesatare( 50 dhe 75 %) krahasuar me atë të mostrave të trajtuara në ambient me lagështi (L<sub>R</sub> > 95%).

Mostrat e lëna për hidratim ditët e para në ambient me lagështi (kurba I) paraqesin në fakt një zhvillim më të lehtë të rezistencës krahasuar me atë të mostrave të ruajtura në ambient me lagështi për një kohë më të zgjatur.

Efektet e lagështisë së staxhionimit në mënyrë sasiore evidentohen në dokumentin e CEN -it ku trajtohet realizimi i strukturave (CEN/TC 104 doc.179 1995).

Kohëzgjatja e staxhionimit varet kryesisht nga kushtet klimatike të rajonit ku është hedhur betoni. Një ndarje ndërmjet klasave klimatike jepet në tabelën nr.5.

Tabela nr.5 Klasat klimatike

<b>Klasa klimatike</b>	<b>Përkufizimi</b>	<b>Lagështia relative mesatare</b>
L	e lagësht	> 80%
K	e kufizuar	nga 65-80%
Th	e thatë	nga 45-65%
ShTh	shumë e thatë	< 45 %

Staxhionimi i duhur duhet të zgjasë derisa hidratimi të arrijë një gradë të tillë që të sigurojë një rezistencë relative sipas koeficientëve të paraqitur në tabelën nr.6.

Tabela nr.6-Vlera e përputhshmërisë së rezistencës(\*) së betonit në fund të periudhës së staxhionimit

<b>Klasa klimatike</b>	<b>Raporti i përputhshmërisë</b>
L	0,10
K	0,40
Th	0,50
ShTh	0,69

(\*) Përputhshmëria e rezistencës është raporti ndërmjet rezistencës mesatare të betonit në fund të periudhës së staxhionimit me rezistencën mesatare 28-ditore të betonit të përgatitur, i staxhionuar dhe provuar në përputhje me S SH EN ISO 2735/2 dhe S SH EN ISO 7 4102/1.

Përsa i përket përcaktimit të kohës optimale për mbajtjen e staxhionimit të zakonshëm, ai është një problem kompleks.

Për të realizuar këtë, do të jetë ajo e përcaktimit të vlerës limit të depërtueshmërisë që duhet të arrihet në shtresat sipërfaqësore të betonit në kufijtë e staxhionimit të duhur.

Në gjendjen aktuale nuk janë përcaktuar dhe pranuar akoma vlerat limit të depërtueshmërisë dhe mënyrat sipas së cilës maten vetitë e shtresave sipërfaqësore të betonit të përgatitur, si dhe kohëzgjatja e staxhionimit të duhur, e cila mund të përcaktohet me referim të rezistencës mekanike në sipërfaqe.

Pra duhet mbajtur parasysh se nuk ka një korrespondencë të ngushtë ndërmjet depërtueshmërisë dhe rezistencës.

Prandaj, nëse rëndësia e veprës ose kushtet ekstreme të ekspozimit e kërkojnë, atëherë rekomandohet të kryhen prova të depërtueshmërisë në laborator sipas S SH EN ISO 7031, ose standarde të tjera të barasvlefshme me të, mbi mostra të ngjashme me strukturën, që janë stazhionuar në kushte të “njëjta”, ose nga karrota e nxjerrë nga e njëjta strukturë.

Në tabelën nr.7 është paraqitur koha minimale e staxhionimit, në ditë, rekomanduar nga SSH EN 206-1, për strukturat e ekspozuara në ambient të thatë, të lagësht ose me agresivitet të dobët.

Kur kushtet e ekspozimit janë më të vështira, koha e staxhionimit në ditë, e paraqitur në tabelën 7, duhet të rritet për të qenë të sigurtë që shtresa mbrojtëse e armaturës është pothuajse e paarritshme nga depërtimi i substancave që gjenden në ambientin e ekspozimit.

Tabela nr.7

Zhvillimi i rezistencës së betonit	I shpejtë			mesatar			I ngadaltë		
	5	10	15	5	10	15	5	10	15
<b>Kondicioni ambjental gjatë staxhionimit</b>									
1. I paeksponuar direkt në diell $L_R$ e ajrit rreth $\geq 80\%$	2	2	1	3	3	2	3	3	2
2. I ekspozuar mesatarisht në diell ose nga erërat me shpejtësi mesatare $L_R > 50\%$	4	3	2	6	4	3	8	5	4
3. I ekspozuar në diell të nxehtë ose në erëra me shpejtësi të madhe $L_R < 50\%$	4	3	2	8	6	5	10	8	5

Shpejtësia e zhvillimit të rezistencës së betonit mund të vlerësohet sipas tabelës nr. 8 (S SH EN 206-1). Vlerat e dhëna në tabelë janë relative edhe për çimenton Portland 42.5R dhe 32.5R.

Shpejtësia e rritjes së rezistencës	Raporti U/Ç	Klasa e rezistencës së çimentos
E shpejtë	< 0.5	42.5R
Mesatare	0.5 – 0.6	42.5R
E lehtë	Në të gjitha	klasat

Treguesit relativë të dhënë më sipër mbi kushtet e staxhionimit, për të arritur një mosdepërtueshmëri të shtresës sipërfaqësore nuk marrin në konsideratë aspektet e sigurisë strukturore, në relacion me atë që duhet të përcaktohet një kohë minimale për të arritur rezistencën e dëshiruar pas disarmimit.

#### 4.3 Staxhionimi i përshpejtuar me avull me trysni të ulët

Ndërmjet llojeve të ndryshme të staxhionimit të përshpejtuar, që në mënyrë esenciale realizohet nëpërmjet një sasive nxehtësie, ai më i përhapuri është duke ngrohur nëpërmjet trajtimit me avull.

Ai konsiston në efektin e kombinuar të nxehtësisë me lagështinë mesatare, ndaj betonit të freskët të hedhur në formë, pra të avujve të ujit në trysni të ambientit.

Një trajtim i përshtatshëm mund të realizohet për 24 orë ose edhe në kohë më të shkurtër duke realizuar një rezistencë mekanike rreth 60% të rezistencës 28-ditore trajtuar në kushte normale (20° C dhe lagështi relative 100%)

Në rastin kur betoni staxhionohet në temperaturë më të rritur, rezistenca është më e ulët se ajo e staxhionuar në kushte normale. Trajtimi i betonit me avull me presion të ulët realizohet duke u ndarë në disa faza; faza e parastaxhionimit, faza e rritjes së temperaturës, faza e mbajtjes së temperaturës konstante dhe faza e ftohjes. Fig nr.7.

## Temperatura e avullit në element




Figura nr.7 Shembulli i staxhionimit me avull me presion të zakonshëm (temperatura fillestare e brumit 13 °C

- 1-parastaxhionimi nga 2 deri 6 h
- 2- ngrohje jo më shumë se 20°C/h
- 3-periudha e temperaturës maksimale
- 4-ftohje jo më pak se 10 °C

Karakteristikat e fazave kanë një influencë përcaktuese në rezistencën përfundimtare. Gjithashtu trajtimi me avull varet edhe nga lloji i çimentos së përdorur.

Është e nevojshme që më përpara, të kryen prova eksperimentale mbi kampionë të ndryshëm për të përcaktuar veprimet e trajtimit të parashikuar duke pasur parasysh rregullat dhe kufijtë e secilës fazë të parashikuar në S SH EN 206-1.

Përdorimi i shtesave superfluidifikante në betonet me raport shumë të ulët u/ç , kërkon një grafik staxhionimi të ndryshëm me avull me presion të ulët, pasi përdorimi i tyre ndikon në rritjen e rezistencës mekanike në intervalin e 24 orëve të para.

## 5. PËRSHKRIME PËR BETONIN

### 5.1 Specifikimi i betonit

Specifikimi i betonit zakonisht bëhet nga projektuesit teknologë si “përzierje e projektuar” në përputhje me vetitë e kërkuara (beton me cilësi të garantuar) dhe duke pasur parasysh:

- Sipas kërkesës së përdoruesit, betoni mund të specifikohet edhe si “përzierje e porositur” (beton me përbërje sipas kërkesës), duke përshkruar përbërjen në bazë të rezultateve të provave paraprake, të zbatuara sipas procedurave të përcaktuara ose në bazë të eksperiencës afatgjatë me betone që kanë karakteristika të ngjashme. Me “përzierje të projektuar”, kuptohet një beton, për të cilin projektuesi ka përgjegjësinë të përcaktojë qartë vetitë e kërkuara dhe karakteristikat e mëvonshme dhe për të cilat prodhuesi është përgjegjës, si për prodhimin dhe furnizimin e një përzierje në përputhje me vetitë e kërkuara, ashtu dhe për karakteristikat e mëvonshme. Me “përzierje të porositur” kuptohet një beton, për të cilin projektuesi përcakton paraprakisht, përbërjen e përzierjes dhe materialet që do të përdoren.

- Në rastin e një betoni me përbërje sipas kërkesës, detyrimisht duhet të paraqitet një dokumentacion i provave paraprake të kryera, për të garantuar që përbërja e kërkuar, është e përshtatshme për të kënaqur të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me vetitë e brumit të betonit të përgatitur dhe të ngurtësuar, duke pasur parasysh materialet përbërëse të përdorura dhe kushtet e veçanta të kantierit.

Të dhënat kryesore, që janë tregues në të gjitha rastet, për betonet me veti të garantuara përfshijnë:

- a) klasën e rezistencës.

- b) përmasat maksimale nominale të agregatëve,
- c) përshkrimin e përbërjes së betonit në bazë të qëllimit të përdorimit (p.sh. klasën e ekspozimit ambiental, beton i thjeshtë ose i armuar, normal ose i paranderur);
- d) klasën e konsistencës,
  - e.1) Karakteristikat e betonit të ngurtësuar:
    - rezistenca ndaj penetrimit të ujit deri në fazën e përshkueshmërisë,
    - rezistenca ndaj ciklit ngrirje-shkrirje,
    - rezistenca ndaj aksioneve të kombinuara të ngrirjes dhe agjentëve shkrirës,
    - rezistenca ndaj veprimeve kimike,
    - kërkesa teknike shtesë.
  - e.2) Karakteristikat e përzierjes:
    - lloji i çimentos,
    - klasa e konsistencës,
    - përmbajtja e ajrit,
    - çlirimi i nxehtësisë gjatë hidratimit,
    - kërkesa të veçanta në lidhje me agregatet,
    - kërkesa të veçanta në lidhje me rezistencën ndaj reaksionit alkal-silic,
    - kërkesa të veçanta në lidhje me temperaturën e përzierjes,
    - kërkesa teknike shtesë.

Në rastin e betonit të parapërgatitur në fabrikë, merren në konsideratë kushtet shtesë në lidhje me transportin dhe procedurat e kantierit (koha dhe frekuenca e shpërndarjes, transporti me autobetonierë ose transportier shirit etj).

## 5.2 Betoni i ngurtësuar

### 5.2.1 Rezistenca në shtypje

Rezistenca në shtypje e betonit duhet të shprehet nëpërmjet rezistencës karakteristike, e përcaktuar si vlera mesatare (luhatja 5%) e të gjitha vlerave të mundshme të rezistencave të matura mbi mostrat e betonit. Rezistenca duhet të përcaktohet me metodat e parashikuara në standardet si më poshtë.

Klasat e rezistencës në shtypje

Betoni është i klasifikuar në bazë të rezistencës në shtypje, e shprehur si rezistencë karakteristike  $R_{ck}$  ose  $f_{ck}$ . Rezistenca  $R_{ck}$  përcaktohet në bazë të vlerave të marra nga provat në shtypje pas 28 ditësh mbi kubikët me brinjë 150 mm; ndërsa rezistenca karakteristike  $f_{ck}$  përcaktohet në bazë të vlerave të marra nga provat në shtypje pas 28 ditësh mbi cilindrin me diametër 150 mm dhe lartësi 300 mm; vlerat e paraqitura në tabelë, të shprehura në  $N/mm^2$ , rezultojnë të përfshira në njërin prej klasifikimeve të mëposhtme:

- beton jostrukturor 8/10 – 12/5
- beton i zakonshëm 16/20 – 45/55
- beton me karakteristika të larta 50/60 – 60/75
- beton me rezistencë të lartë 70/85 – 100/115

Klasat e rezistencës për betonet normale

Klasa e rezistencës	$f_{ck}$ N/mm <sup>2</sup>	$R_{ck}$ N/mm <sup>2</sup>	Kategoritë e betonit
K 8/10	8	10	Jo strukturorë
K12/15	12	15	
K16/20	16	20	Të zakonshëm
k20/25	20	25	
K25/30	25	30	
K30/37	30	37	
K35/45	35	45	
K40/50	40	50	



K45/55	45	55	
K50/60	50	60	Veti të larta
K55/67	55	67	
K60/75	60	75	
K70/85	70	85	Rezistencë e lartë
K80/95	80	95	
K90/105	90	106	
K100/115	100	115	

### 5.2.2 Rezistenca në tërheqje

Rezistenca në tërheqje e betonit duhet të jetë e përshkruar dhe e matur ose si rezistencë “indirekte” ( për lindje të plasaritjeve,  $f_{ct,sp}$ , prova braziliane; në përkulje,  $f_{ct,n}$ , prova mbi tri pika; respektivisht S SH UNI 6135 dhe S SH UNI 6130) ose si rezistencë direkte (prova aksiale,  $f_{ct}$ , RILEM CPC7 ose S SH ISO 4108), ose standarde të tjera të barasvlefshme me to.

Rezultatet e marra me metodat e provave të sipërshënuara mund të kenë ndryshime shumë të vogla nga njëra-tjetra.

Klasat e rezistencës në tërheqje

Betoni mund të klasifikohet në bazë të rezistencës së tij karakteristike në tërheqje  $f_{ctk}$ , siç jepet në tabelën e mëposhtme:

Klasat e rezistencës në tërheqje aksiale për betonet me peshë normale

Klasa e rezistences në tërheqje	$f_{ctk}$ N/mm <sup>2</sup>
T 1.0	1.0
T 1.5	1.5
T 2.0	2.0
T 2.5	2.5
T 3.0	3.0
T 3.5	3.5
T4.0	4.0

### 5.2.3. Energjia prej thyerjes

Në mungesë të provave specifike të tërheqjes direkte ose indirekte , energjia e thyerjes mund të vlerësohet me relacionin e mëposhtëm

$$G_F = 0.2\alpha_F f_{cm}^{0.7} \text{ (J/m}^2 \text{ ose N/m)}$$

ku  $\alpha_F = (10 + 1.25d_a)$ , ku  $d_a$  varion nga 8 deri në 32 mm, dimensionimi maksimal i agregatit.

Shprehja e mësipërme vlen për betonet e përgatitura pa shtesa pluhur silici, duke qenë këta të fundit të karakterizuar nga një qëndrueshmëri më e vogël (energji më e vogël në thyerje) dhe një ndjeshmëri më e vogël ndaj dimensionit maksimal të agregatit.

Ky përcaktim është në përputhje me rekomandimet e RILEM TC50 (Materiale dhe struktura rekomanduese, vol.18,1985).

### 5.2.4 Rezistencat karakteristike

Rezistencat karakteristike të betonit janë dhe duhet të shprehen si më poshtë:

- Rezistenca e betonit nëpërmjet rezistencës karakteristike  $R_{ck}$  ose  $f_{ck}$ , siç është treguar më lart, dhe përcaktohet në bazë të vlerave të marra pas 28 ditësh mbi kubikët me brinjë 150 mm ose cilindrat 150/300 mm (raporti diametër / lartësi).

- Rezistenca mesatare në shtypje  $f_{ctm}$  mund të shprehet gjithashtu, për afërsisht, me rezultatet e provës në shtypje indirekte pas 28 ditësh ose nëpërmjet relacionit ( FIP – CEB Model Code 90 dhe EC2):

$$f_{ctm} = 0.30 f_{ck}^{2/3} = 0.27 R_{ck}^{2/3} \quad (\text{N/mm}^2)$$

Rezistenca karakteristike në shtypje  $f_{ck}$  (nëse kërkohet) mund të merret e barabartë me  $0.70 f_{ctm}$ .

#### 5.2.5 Standardet e referimit dhe metodat e provave

Procedurat dhe metodat për përgatitjen dhe ruajtjen e mostrave dhe për kryerjen e provave, janë objekt i standardeve të mëposhtme ose me standarde të tjera të barasvlefshme me to:

S SH UNI 6126 dhe 6128, përcakton respektivisht mënyrat për marrjen e kampioneve të betonit në kantier dhe për ruajtjen në laboratorin e betoneve eksperimentale;

S SH UNI 6127 dhe 6129, përcakton mënyrat për përgatitjen dhe staxhionimin e mostrave të betonit respektivisht të marra në kantier dhe të përgatitura në laborator;

S SH UNI 6130, i referohet formave dhe dimensioneve të mostrave të betonit për provat e rezistencës mekanike dhe armaturave respektive. Ky standard përshkruan përdorimin, në rrugë normale, të mostrave kubike për shkatërrimin në shtypje në drejtim të tërthortë të plasaritjes, të mostrave prizmatike me seksion katror për shkatërrimin në shtypje në drejtim të tërthortë të plasaritjes, të mostrave prizmatike me seksion katror për shkatërrimin në shtypje në drejtim të tërthortë të përkuljes.

Për proven e shkatërrimit në shtypje dhe tërheqjes indirekte, parashikohet që, në raste të veçanta, mund të shfrytëzohen mostra cilindrike me lartësi sa dyfishi i diametrit;

S SH UNI 6131, përcakton kriteret dhe mënyrat për marrjen e kampioneve të betonit dhe përgatitjen e mostrave;

S SH UNI 6132 dhe 6134, përcakton procedurat që duhen ndjekur për përcaktimin e rezistencës në shtypje të mostrave për këtë qëllim dhe, respektivisht, të mbetjeve të prizmeve të shkatërruar nga përkulja;

S SH UNI 6133, kryerja e provave në tërheqje direkte dhe indirekte;

S SH UNI 6186, ka të bëjë me presat hidraulike të projektuara dhe të ndërtuara posaçërisht për provat në shtypje mbi materialet, si betoni, të cilat paraqesin deformime të vogla para shkatërrimit;

Duke iu referuar provave të shkatërrimit në shtypje, besueshmëria dhe përsëritja e rezultateve, janë të lidhura me metodat e realizimit të saktësuara në standardet.

Në veçanti:

Deformimet e rrafshëtisë në sipërfaqen e mostrës, mbi kufirin që përcakton standardi ( $100 \mu\text{m} = 0.10 \text{ mm}$ ), mund të shkaktojnë një zvogëlim të dukshëm të rezistencës të marrë nga prova

Shpejtësia e rritjes së ngarkimit më shumë nga ajo e parashikuar në standard ( $0.5 \pm 0.20 \text{ N/mm}^2/\text{s}$ ), shkakton një rritje të rezistencës në shtypje dhe zvogëlimi i ngarkimit, ulje të saj.

Për matjen e rezistencës në shtypje përdoren zakonisht kubikët, por si alternativë mund të përdoren dhe mostra cilindrike ose prizmatike. Në këtë rast, nevojitet rrafshimi dhe eventualisht lëmimi i sipërfaqes ose mbulimi me një shtresë të hollë çimento, me rezistencë dhe ashpërsi të përshtatshme.

Gjatë shtypjes nuk është e këshillueshme të procedohet duke vendosur ndërmjet kampioneve dhe pllakave të presës, materiale të deformueshme: në këtë mënyrë do të konstatoheshin vlera më të uëta të rezistencës, meqënëse përhapja gjatësore e shtresës së deformueshme synon ta thyeje përsëgjati.

Vlerat e rezistencës në shtypje për kampionin varen nga gjeometria dhe dimensionet e mostrave. Për të pasur parasysh këto ndikime, duhen përdorur koeficientët e konvertimit të raportuar në tabelat e mëposhtme:

Koeficientët e konvertimit ndërmjet rezistencës në shtypje të matur në kube me dimensione të ndryshme

<b>Brinja (mm)</b>	<b>100</b>	<b>150</b>	<b>200</b>	<b>250</b>	<b>300</b>
Treguesit e rezistencës në shtypje të kubikëve	110%	100%	95%	92%	90%

Koeficientët e konvertimit ndërmjet rezistencës në shtypje të matur në cilindra me dimensione të ndryshme dhe me raport të njëjtë  $h/d = 2.00$

<b>Raporti h/d (mm/mm)</b>	<b>100/200</b>	<b>150/200</b>	<b>200/400</b>	<b>250/500</b>	<b>300/600</b>
Treguesit e rezistencës në shtypje në cilindrato me dimension H/d	110 %	100 %	95 %	92 %	90 %

Koeficientët e konvertimit ndërmjet rezistencës në shtypje të kubikëve me brinjë  $l = 150$  mm dhe cilindrave me diametër  $D = 150$ mm,  $h = 300$  mm

Rez. Kubit $< 25 \text{N/mm}^2$	R cilindrit = 0.80 R kubit
Rez.kub $\leq 25$ e $< 60$ $\text{N/mm}^2$	R cilindrit = 0.83 R kubit
Rez Kubit $\geq 60 \text{N/mm}^2$	R cilindrit = 0.85 R kubit

Koeficientët e konvertimit ndërmjet rezistencës në shtypje të matur mbi cilindrato që kanë diametër të njëjtë, por me raport të ndryshëm h/d

Raporti h/d	1.00	2.00	4.00
Treguesit e rezistencës në shtypje të cilindrave me raport h/d	118 %	100 %	92 %

Koeficientët e konvertimit të treguar në tabelat e mësipërme nuk kanë lidhje mes tyre.

Në përgjithësi mostrat e mëdha japin rezistencë më të vogël se mostrat e vogla, mostrat cilindrike rezistencë më të vogël se mostrat kubike dhe mostrat e holla një rezistencë më të vogël se mostrat e trasha.

Përveç kësaj, sa më e madhe të jetë rezistenca në shtypje e betonit në provë, aq më shumë raporti i konvertimit tenton drejt njësisë.

## 6. JETËGJATËSIA DHE JETA NË PËRDORIM

### 6.1 Jetëgjatësia e betonit dhe jetëgjatësia e strukturës

Për të realizuar jetëgjatësinë e betonit dhe jetëgjatësinë e strukturës duhet te mbahen parasysh rregullat e mëposhtme:

- Për efektet e jetës në përdorim, duhet bërë dallimi ndërmjet jetëgjatësisë potenciale të betonit, i marrë si material për t'u përdorur në kushte ambientale të veçanta, dhe jetëgjatësisë së vërtetë të betonit në vepër, pra me vetitë që ai ka në kontekst me strukturën.

- Duke u nisur nga ajo, që çdo fenomen dëmtimi që manifestohet në një strukturë, është pasojë e mospërputhjes ndërmjet cilësive lokale të betonit dhe kushteve lokale të ekspozimit, duket qartë se jeta në shërbim që është e lidhur me betonin si material, do të mund të ishte me të vërtetë e lidhur me strukturën, në qoftë se cilësia e betonit nuk do të rrezikohej, nëse konditat e ekspozimit të matura në vëndin e ndërtimit, nuk do të pësojnë me kalimin e kohës ndryshime të rëndësishme.

- Faktorët që ndikojnë negativisht në ndryshimet cilësore lokale të betonit mund ta kenë origjinën:

a) nga kompleksiteti i arkitekturës dhe projektit të zgjedhur;

b) nga adoptimet jo të përshtatshme gjatë zbatimit të punimeve, ose kur janë të përshtatshme nuk janë zbatuar në mënyrë korrekte;

c) nga kontrolli i pamjaftueshëm i cilësisë;

d) nga përdorimi i materialeve të papërshtatshme në ndërhyrjet e restaurimit.

Siç specifikohet në këtë paragraf, përbërja e betonit ka si qëllim realizimin e një materiali me depërtueshmëri të vogël, pra është e rëndësishme për qëndrueshmërinë e strukturës që të evitohen:

a) prezenca e boshllëqeve e shkaktuar nga ngjeshja e papërshtatshme ose nga një shpërndarje johomogjene e betonit në kallëp;

b) formimi i plasaritjeve nga tkurrja plastike;

c) ndërprerja e parakohshme e staxhionimit mbrojtës;

d) reduktimi i shtresës mbrojtëse të hekurit nën kufirin minimal të parashikuar.

- Për të arritur qëndrueshmërinë, betoni duhet të ketë një koeficient të depërtueshmërisë  $K$ , më të vogël ose të barabartë me  $1.10^{-11}$  m/s ose një rezistencë të depërtimit të ujit sipas ISO 7031 – 1994, ose standarde të tjera të barasvlefshme me të, me vlerë maksimale jo më të madhe se 50 mm dhe vlerë mesatare jo më të madhe se 20 mm.

Duhen konsideruar kështu ekuivalente dy kufijtë e mëposhtëm, që janë të lidhur me padepërtueshmërinë e një betoni:

- koeficienti i depërtueshmërisë  $K \leq 1.10^{-11}$  m/s

- thellësia mesatare e depërtimit të ujit  $\leq 20$  mm

- Vlera mesatare e depërtimit jo më shumë se 20 mm, në të cilën materiali ruan një padepërtueshmëri të përshtatshme, nuk ka shpjegim fizik, por është një konkluzion mbi bazën e kërkimeve eksperimentale. Kontrolli i depërtueshmërisë nëpërmjet provave të depërtimit të ujit, është i nevojshëm vetëm në rastin e punimeve me rëndësi të veçantë, duke mbajtur parasysh kërkesat që rrjedhin nga studimet laboratorike, të cilat zbatohen në fazën e zgjedhjes së raportit të përgatitjes së betonit, si dhe verifikimet e cilësisë së betonit në punë gjatë marrjes së karrotës. Në praktikën e zakonshme, kontrolli i cilësisë së betoneve jetëgjatë është akoma më i thjeshtë, ai duhet të bazohet në matjen e rezistencës në shtypje (rezistenca karakteristike).

- Kriteri ka si pikë referimi relacionin depërtueshmëri–raport ujë/çimento- rezistencë mekanike. Zvogëlimi i raportit ujë/çimento, zvogëlon volumin e poreve kapilare ose të depërtueshme nga substancat në ambientin e ekspozimit dhe si pasojë zvogëlon depërtueshmërinë, ndërkohë që rrit rezistencën mekanike. Edhe pse nuk ka një relacion të shprehur mirë të rënies lineare të grafikut midis depërtueshmërisë dhe rezistencës, kontrolli i qëndrueshmërisë nëpërmjet rezistencës rezulton mjaft i pranueshëm. Shkalla e besueshmërisë është padyshim më e madhe se nga kontrolli që rrjedh prej matjes së raportit ujë/çimento, duke marrë parasysh që metodat për vlerësimin e dozimit të ujit dhe çimentos në një beton nuk janë të thjeshta e mbi të gjitha nuk janë mjaft të sakta.

- Tabela 11 tregon se rezistenca karakteristike për jetëgjatësi pothuajse gjithmonë do të jetë më e lartë krahasuar me rezistencën që merret në përgjithësi në konsideratë në llogaritjet strukturore. Në të njëjtat rrethana, klasa e betonit që do të parashikohet në projekt, përcaktohet në bazë të kërkesave për jetëgjatësi, edhe se në një farë mënyre do të rezultojë mjaft e madhe në krahasim me kërkesat statike.

- Ndërprerja e parakohshme e staxhionimit ka efekte negative të dukshme mbi depërtueshmërinë, sepse shkakton një ulje të shkallës të hidratimit të lidhësave. Në temperaturë të

zakonshme shpejtësia e hidratimit të çimentos ulet në vlera të papërfillshme, nëse lagështia relative brenda përzierjes zbret nën 80 %.

- Kur stazhonimi mbrojtës ndërpritet dhe uji që nuk ka reagu akoma është larguar për shkak të tharjes së shpejtë të betonit për të ekuilibruar lagështinë e tij të brendshme me atë të ajrit, poroziteti i krijuar mundëson depërtimin e substancave që gjenden në ambient- pra poret që përcaktojnë depërtueshmërinë, të cilësuar edhe si pore kapilare – do të rezultojnë mjaft më të larta, pavarësisht nga përdorimi i raportit të ulët ujë/çimento. Për këtë, depërtueshmëria do të jetë më e madhe tamam në pjesët më të skajshme, pra në ato zona të strukturës, të cilat janë parashikuar të ngadalësojmë depërtimin e agjentëve të jashtëm. Përveç faktorëve të përmëndur, në qëndrueshmërinë e strukturës influencojnë mikroklima dhe detajet e projektit.

- Mikroklima përfaqëson kushtet e ekspozimit, që ekzistojnë në të vërtetë në kontakt me sipërfaqen e strukturës. Kjo mund të jetë e ndryshme nga makroklima dhe në referim me strukturën, e ndryshme nga zona në zonë; për shkaqe të ndryshme ndikojnë detajet e projektit dhe situatat e veçanta që manifestohen gjatë shërbimit. Prandaj natyra dhe shkalla e dëmtimit në kohë, varen nga pajtueshmëria e madhe ose e vogël midis mikroklimës dhe cilësive të pjesshme të betonit në vepër.

- Persa i përket gjendjes aktuale të njohurive, nuk është e mundur që të merren vendime nga një analizë e riskut, të projektosh në funksion të jetës në shërbim nuk përjashton apriori nevojën e kryerjes së ndërhyrjeve të mirëmbajtjes me qëllim ruajtjen e funksionit të konstruksionit.

- Qëllimi është që në çdo rast të kufizohen efektet shkatërruese nga depërtimi i substancave potencialisht agresive që janë të pranishme në ambientin e ekspozimit dhe kështu të zvogëlohet numuri, intensiteti dhe rëndësia e ndërhyrjeve të mirëmbajtjes.

#### 6.1.1 Jetëgjatësia

Proceset që rrezikojnë qëndrueshmërinë e një strukture betoni të armuar, të ekspozuar në ambient natyral, duke bërë përjashtim për relacionin alkal-agregat, janë:

1. veprimet kimike, 2. korrozioni i armaturës dhe 3. ciklet e ngrirje shkrirjes.

- Agjentët agresivë që kanë efekt shkatërrues për nyjet lidhëse të betonit, janë të paraqitur në tabelën 9, bashkë me shkallën e veprimit të shkaktuar nga koncentrimi i tyre.

Tabela nr.9

Agjentët agresivë Në ujë	Shkalla e veprimit		
	e dobët XA1	e mesme XA2	e fortë XA3
PH	6,5-5,5	5,5-4,5	4,5-4,0
CO <sub>2</sub> agresiv (mg CO <sub>2</sub> /l)	15-30	30-60	60-100
Jonet amon (mg NH <sub>4</sub> <sup>+</sup> /l)	15-30	30-60	60-100
Jonet magnez (mg MG <sup>2+</sup> /l)	100-300	300-1500	1500-3000
Jonet sulfat (mg SO <sub>4</sub> <sup>2-</sup> /l)	200-600	600-3000	3000-6000
Agjentët agresivë në terren			
Jonet sulfat (mg SO <sub>4</sub> <sup>2-</sup> /lkg te terrenit të tharë	2000-6000	6000-12000	>12000

Korrozioni i hekurit në beton është një proces elektrokimik i përbërë nga një anodë ku hekuri tretet, një katodë ku prodhohen jone OH<sup>-</sup> dhe konsumohet oksigjeni i gaztë dhe një elektrolit për kalimin e rrymës.

Derisa pH i fazës së lëngët që përshkon poret e nyjeve është në nivelin e tij natyral, pra në intervalin 13 – 13,8 dhe koncentrimi i joneve klorur, shprehur si përqindje në peshë mbi përmbajtjen e çimentos, nuk e tejkalon kufirin kritik, varion nga 0,2 deri 0,4 %, reaksioni anodik është i

kontrolluar nga një shtresë e hollë prej oksidi ferrik pasiv nga karakteristikat, tamam për të ndërtuar një barrierë efikase ndërmjet metalit dhe poreve të lëngut. Por kur alkaliniteti i lëngut të poreve neutralizohet nga anhidridi karbonik i ajrit dhe pH zbret më poshtë se 11,5 ose kur në fazën e lëngët koncentrimi i klorureve që depërtojnë nga ambienti i jashtëm kalon nivelin kritik, shtresa e hollë pasive shkatërrohet dhe mund të fillojë procesi i korrozionit aktiv.

Koncentrimi në volum i anhidritit karbonik në ajër është rreth 0,03 – 0,04 në zonat rurale, por mund të arrijë deri 0,4% në disa zona urbane.

- Depërtimi i anhidritit karbonik kryhet sipas një zone avancimi mjaft të qartë dhe në reaksion janë të përziera të gjitha fazat e hidratimit të brumit të çimentos. Anhidridi karbonik reagon si acidi karbonik, prandaj reaksioni zhvillohet nëse në poret e betonit është prezent një lagështi minimale. Duke pasur parasysh se në praktikë, për të arritur pjesën e avancuar të karbonatimit, anhidridi karbonik duhet të përhapet nëpërmjet shtresës së betonit tashmë të karbonatuar, në rast se poret janë plot me ujë, shpejtësia e karbonatimit ndodh me atë ngadalësi me të cilën anhidridi karbonik përhapet nëpërmjet fazës së lëngët. Jonet klorur depërtojnë në nyjet lidhëse të betonit me difuzion dhe avancojnë më shpejt se procesi i karbonatimit.

- Depërtimi ndodh si në betonin e ngopur me ujë ashtu dhe në atë të tharë pjesërisht. Kloruret reagojnë vetëm me aluminatin trekalçik për të formuar kloraluminatin trikalçik të hidratuar, por reaksioni është më pak determinues për sa i takon ngadalësimin të depërtimit.

- Faktorët ambientale që nxisin procesin e korrozionit janë anhidridi karbonik dhe/ose kloruret; përse kohë që metali është në pasivitet, ndihmojnë për të mbajtur aktiv procesin e lagështisë relative të ajrit, që ndodhet brenda betonit dhe furnizimin me oksigjen, i domosdoshëm për të mbajtur aktiv reaksionin katodik.

- Shpejtësia e korrodimit rritet me rritjen e temperaturës dhe lagështisë relative të brendshme të betonit: ajo bëhet e dukshme kur kjo e fundit kalon 75%, arrin maksimumin në rreth 95%, ndërsa bie me shpejtësi dhe bëhet e papërfillshme gjatë mbingopjes, për shkak të shpejtësisë së ulët me të cilën oksigjeni përhapet në poret e mbushura ose pothuajse të mbushura me ujë.

Përshtetimi i mësipërm sugjeron se faktori kontrollues për shpejtësinë e korrozionit është mbi të gjitha rezistenca specifike e betonit: janë konsideruar kritike vlerat e rezistencës specifike më të vogla se 5000 – 10000  $\Omega$ cm.

Në kushtet e një klime të thatë, kur rezistenca specifike e betonit mund të kalojë 100.000  $\Omega$  cm, procesi i korrozionit është i frenuar edhe në prezencë të një koncentrimi të lartë të klorurit, edhe pse poroziteti pa ujë lehtëson depërtimin e oksigjenit.

Përveç procesit të korrozionit, edhe procesi i ngrirje shkrirjes dhe ai kimik influencohen nga shkalla e mbingopjes së betonit, pra dhe nga kushtet e lagështisë së ambientit të ekspozimit.

Në të gjitha proceset e dëmtimit është prezent uji: faktor i rëndësishëm është gjendja e lagështisë në beton, që mbahet konstante kur lagështia e jashtme është në gjendje të pandryshueshme. Kur kjo e fundit është e paqëndrueshme, duhet pasur parasysh se betoni merr ujë nga ambienti më shpejt sesa e largon atë dhe për pasojë lagështia mesatare e brendshme tenton të jetë më e lartë se lagështia e ambientit.

Ky parim vlen edhe për strukturat në ambiente detare, në zonat bregdetare, dhe kjo do të thotë që edhe gjatë periudhës jo të lagësht, betoni vazhdon të jetë pothuajse i ngopur. Influenca nga lagështia e brendshme e betonit në lloje të ndryshme të proceseve është e evidentuar në tabelën 10.

Tabela nr.10

Lagështia relative $L_R$ e betonit	Reaksioni i karbonatimit	Korrozioni i hekurit në beton		Ciklet e ngrirje shkrires	Veprimi kimik
		•	◆		
Shumë e ulët <45%	1	0	0	0	0
e ulët 45-65%	3	1	1	0	0
E mesme 65-85%	2	3	3	0	0
E lartë 85-98%	1	2	3	2	1
Shumë e lartë	0	1	1	1	3

0 = rrezik i parëndësishëm

1 = rrezik i pranueshëm

2 = rrezik i mesëm

3 = rrezik i lartë

- beton i karbonatuar

- beton i ndotur nga kloruret

Substancat natyrale më të zakonshme që aktivizohen në prezencë të lagështisë së betonit janë: anhidridi karbonik, i nevojshëm për karbonatimin, oksigjeni, i nevojshëm për korrozionin, jonet e klorurit, që nxisin korrozionin duke e nxjerrë jashtë funksionit hekurin e armaturës, acidet, që zgjidhin nyjet e çimentos, sulfatet, që japin reaksion bymues me çimenton, alkalet e çliruara nga hidratimi i çimentos, që mund të reagojnë eventualisht me disa tipe agregatesh.

Masat mbrojtëse që duhet të adoptohen në rastin e reaksionit alkal – agregat dhe në rastin e veprimeve nga substancat që vijnë nga ambiente jonatyrale (p.sh. nga punimet dhe shkarkimet industriale) kërkojnë zgjidhje të situatave të veçanta. Për reaksionet alkal – agregat është i këshillueshëm konsultimi me një ekspert kompetent për fushën përkatëse.

Për betonin, si material, përbërja dhe komponentet e aftë për të garantuar qëndrueshmërinë janë të përcaktuar kryesisht mbi bazën e kërkimeve laboratorike duke studjuar sjelljen e mostrave dhe nganjëherë të elementeve strukturore gjeometrike dhe kufizimin e përmasave, gjithnjë në kampione të përgatitur me kujdes dhe të ruajtur në kushte ekspozimi të përcaktuara dhe të kontrolluara mirë.

Kriteret mbi bazën e të cilëve përcaktohet qëndrueshmëria e betonit i referohen tipit dhe përmbajtjes së çimentos, raportit ujë/çimento dhe shtresës mbuluese të hekurit.

Këto kritere janë të përbashkëta për të gjitha standardet që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë: me rritjen e intensitetit të veprimit rritet përmbajtja minimale e çimentos, ulet raporti u/ç dhe rritet shtresa mbuluese e hekurit. Megjithatë, duhet pasur parasysh se kontrolli i cilësisë së betonit është bazuar mbi rezistencën karakteristike në shtypje, sa më e madhe është qëndrueshmëria aq më e madhe është rezistenca karakteristike.

Në tabelën 11 dhe 12 janë dhënë respektivisht përshkrimet për rezistencën referuar ekspozimit në ambient dhe klasave të ekspozimit në funksion të kushteve ambientale.

Tabela nr.11  
(çimento Portland 32.5R,  $d_{max}$  aggr.20-32 mm)

$U/C_{max}$	Përmbajtja minimale e çimentos ( $kg/m^3$ )	Rezistenca karakteristike minimale $R_{ck}(N/mm^2)$	Klasat e ekspozimit Sipas tabelës. 12
0,60	280	30	XC1, XC2
0,55	300*	37	XC3, XF1, XA1, XD1
0,50	320*	37-40	XS1, XD2, XF2 XA2, XF3, XC4
0,45	350*	45	XS2, XS3, XA3, XD3, XF4

Kur ambienti është objekt i cikleve të ngrirje-shkrirjes së përshkruar, përdoren agregate që nuk ngrijnë dhe shtesa aerante.

Shfaqja e flluskave të ajrit e ul rezistencën mekanike potenciale të brumit, por ndërkohë kjo mund të shmanget duke modifikuar raportin e përbërjes ose duke reduktuar raportin u/ç dhe/ose duke rritur përmbajtjen e çimentos.

Për zgjedhjen e trashësisë minimale të shtresës mbuluese të hekurit, i referohemi klasës së ekspozimit të betonit (tabela 12).

Tabela nr.12 – Klasat e ekspozimit ne funksion te kushteve ambientale (S SH EN 206-1)

Emërtimi i klasave	Pershkrimi i ambientit te ekspozimit	Shembuj te kushteve ambientale ( titull informativ)
<b>1 – asnje risk nga korrozioni i armaturave ose nga veprimi mbi betonin</b>		
X0	shume i thatë	brënda ndërtesave me lagështi relative shumë të ulët
<b>2 – korrodimi i armaturës i shkaktuar nga karbonatimi i betonit</b>		
XCI	i thatë	brënda ndërtesave me lagështi relative të ulët
XC2	i lagësht, rrallëhere i thatë	pjesë të struktures në kontakt me lëngjet themelet
XC3	lagështi mesatare	brënda ndërtesave me lagështi nga mesatare në të lartë; betoni në pjesët e jashtme i mbrojtur nga shiu
XC4	periodikisht i thatë dhe i lagur	sipërfaqet në kontakt direkt me ujin të papërfshira në klasën XC2
<b>3- korrozioni i shkaktuar nga kloruret</b>		
XD1	lagështi mesatare	sipërfaqe të ekspozuara ndaj spërkatjeve direkte të ujit me përmbajtje kloruri
XD2	i lagur, rrallëhere i thatë	pishina; beton i ekspozuar ndaj ujit industrial me përmbajtje kloruri
XD3	periodikisht i thatë dhe i lagur	pjesë të urave; dysheme; soleta të parkimeve për automjeteve
<b>4 – korrozioni i shkaktuar nga kloruret e ujit të detit</b>		
XS1	ekspozimi ndaj kriprave detare por jo në kontakt direkt me ujin e detit	struktura në bregdet ose në afërsi të tij
XS2	i zhytur	pjesë të strukturave detare
XS3	në zonat detare, në zonat objekt i spërkatjeve	pjesë të strukturave detare
<b>5 – veprimi nga ciklet ngrirje/shkrirje</b>		
XF1	shkallë mesatare e mbingopjes, në mungese të agjentëve shkrirës	sipërfaqe vertikale të ekspozuara në shi dhe ngrica
XF2	shkallë mesatare e mbingopjes, në prezencë	sipërfaqe vertikale të punimeve rrugore të ekspozuara ndaj ngricave dhe agjentëve shkrirës në ambient



	të agjentëve shkrires	mjegulle
XF3	shkallë e lartë e mbingopjes, në mungese të agjentëve shkrires	siperfaqë horizontale të ekspozuara në shi dhe ngrica
XF4	shkallë e lartë e mbingopjes, në prezencë të agjentëve shkrires	bazamente rrugësh e urash të ekspozuar ndaj agjentëve shkrires, sipërfaqe vertikale dhe horizontale të ekspozuara ndaj sperkatjeve ujore me përmbajtje të agjentëve shkrires dhe ndaj ngricave
<b>6 – veprimi kimik</b>		
XA1	agresivitet i dobët (sipas tabelës 9)	
XA2	agresivitet i mesëm (sipas tabelës 9)	
XA3	agresivitet i fortë (sipas tabelës 9)	

Për punimet në të cilat klasat e ekspozimit kërkojnë një beton me rezistencë karakteristike minimale që ndryshon në kufijtë nga 37÷40 N/mm<sup>2</sup>, rekomandohet një shtresë mbuluese hekuri minimumi 30 mm; për punimet në të cilat klasat e ekspozimit kërkojnë një beton me rezistencë minimale > 40 N/mm<sup>2</sup>, shtresa minimale e rekomanduar është 40 mm.

Për të siguruar vlerat minimale të përcaktuara, konstruktori duhet të parashikojë një shtresë hekuri me trashësi nominale më të madhe se të paktën 5 mm të vlerës minimale të përshkruar.

Në kushtet e një agresiviteti kimik, të cilët janë pasqyruar qartë në tabelën 9, dhe për strukturat në det, të vendosura në zonat detare ose që janë objekt i sperkatjeve, rekomandohet (CEB 1995) një përmbajtje minimale e çimentos prej 370 kg/m<sup>3</sup> dhe një raport u/ç prej 0,4

## 6.2 Jeta në përdorim

Gjatë jetës në përdorim duhet mbajtur parasysh elementet e mëposhtme;

- Jeta në shërbim është koha gjatë së cilës strukturat dhe/ose materialet ruajnë vetitë e tyre, duke mbajtur nivelin e sigurisë dhe të efikasitetit funksional të projektit, për çfarëdo veprimi dhe kushtesh ambientale të parashikuara, që bëhen të vlefshme me një mirëmbajtje normale.

- Në përputhje me të dhënat e literaturës, betonet e qëndrueshëm të specifikuar në tabelën 11 do të duhet të sigurojnë një jetë në shërbim për rreth 40 – 50 vjet, me kusht që struktura të jetë e konstruktuar sipas rregullave teknike dhe t'i qëndrojë kushteve të ekspozimit të parashikuara në projekt.

- Pjesa më e madhe e informacioneve që janë të disponueshëm për momentin, kanë të bëjnë me jetën në shërbim të strukturave që janë objekt i karbonatimit (konstruksionet e banesave dhe të infrastrukturës nuk janë të ekspozuara ndaj cikleve të ngrirje-shkrires ose ambienteve detare) dhe të strukturave objekt i depërtimit të klorureve (konstruksionet në det, infrastrukturat rrugore dhe autostradat të ekspozuara në veprimet e ngrirjes në të cilat, për të shkrires akullin, përdoren kripëra shkriresë).

- Hapat e ndjekura për të stabilizuar jetën në shërbim të strukturave që janë objekt i karbonatimit dhe depërtimit të klorureve, bazohen në tezat e mëposhtme:

- çdo fenomen shkatërrimi i vrojtuar tregon papajtueshmërinë ndërmjet cilësisë së betonit dhe kushteve lokale të ekspozimit;

- qëndrueshmëria referuar korrozionit të armaturës varet vetëm nga sjellja e betonit të shtresave të jashtme, jo të bërthamës së betonit;

- Shtresa mbuluese e hekurit nuk është një barrierë që mban jashtë strukturës substancat fuqimisht agresive, prandaj problemi nuk qëndron në ndalimin e hyrjes së substancave agresive, por në cilësinë e shtresës mbuluese të hekurit, si material dhe si hedhje dhe trashësia e saj të jetë e tillë që koha që i duhet substancave agresive për të arritur në armaturë dhe për të filluar procesin e korrozionit, të jetë e barabartë me jetën në punë të dëshiruar;

- depërtimi i substancave agresive fillon që në momentin në të cilin struktura është disarmuar;

- për çdo strukturë ekziston një shkallë shkatërrimi e papranueshme për funksionimin e saj. Humbja e funksionit mund të jetë përsa i takon sigurisë, destinacionit të përdorimit ose thjesht estetikës, siç është rasti i ndërtesave me fasadë betoni.

Nga këto teza rezulton se:

- Koha e nevojshme që efektet e shkatërrimit të armaturës nga korrozioni të arrijnë nivelin e prishjes i cili konsiderohet i papranueshëm, rezulton e ndarë në dy periudha të veçanta. E para ( $t_0$ ) është koha e përdorur nga  $CO_2$  ose Cl për të arritur armaturën, pra për të depërtuar shtresën e hekurit; e dyta ( $t_1$ ) është koha gjatë së cilës manifestohen dëme të papranueshme. Në përgjithësi jeta e dëshiruar në punë është e bazuar mbi zgjatjen e  $t_0$ .

Kontributet e pjesës së dytë nuk janë marrë në konsideratë sepse varen nga mikroklima dhe mbi të gjitha nga përgjigjja zonale e betonit, që mund ta shpejtojë progresin e dëmeve.




Figura nr. 8: Diagrama e jetës në punë të betonit

Shkatërrimi me kalimin e kohës është një fenomen që duhet marrë parasysh, prandaj rekomandohet, në veçanti për punimet në infrastrukturë dhe për punimet e një rëndësie të veçantë, realizimi i një programi inspektimi sistematik me qëllim që të identifikohet dhe përcaktohet shkalla e fenomeneve të degradimit dhe të vendoset koha e ndërhyrjeve mesatare periodike prej të cilave struktura mund të rikthehet në gjendjen fillestare.

Është e vështirë që shkalla e dëmtimit të rezultojë e njëjtë në çdo pjesë të strukturës: diferencat mund të vinë nga ndryshimet e mikroklimës, nga efektet e vlerësuara në mënyrë jokorrekte të detajeve të projektit, nga ndryshimet e vetive të betonit, nga ekzistenca e pjesëve të parashikuara për mirembajtje.

Të dhënat e mbledhura mbi gjendjen e konservimit të strukturave të ekspozuara në kushte të ndryshme ambientale, kanë demonstruar se procesi i depërtimit të  $CO_2$  e Cl mund të interpretohet me një përafërsi të pranueshme, duke u mbështetur në ligjin e thjeshtë të difuzionit. Diagrama e figurës 8 tregon vitet e jetës në punë në funksion të klasës së rezistencës dhe të një trashësie të caktuar të shtresës mbuluese të hekurit.

Për kloruret është përcaktuar një nivel kritik 0,4% mbi peshën e çimentos. Për të kufizuar shpejtësinë e depërtimit të klorureve duhen përdorur betone me klasë rezistence të lartë, që do të thotë të përdoren raporte të ulta u/ç, superfluidificante, çimentoja preferohet e tipit 42,5 R, përmbajtja e çimentos është mirë të jetë mbi  $300 \text{ kg/m}^3$ . Përmbajtja e lartë e çimentos e ul

shpejtësinë e depërtimit në radhë të parë sepse i jep betonit një kapacitet të lartë të kombinimeve në kontakt me substancat agresive, në radhë të dytë sepse krijon një rritje të volumit të pjesëzave të çimentos, duke zvogëluar proporcionalisht kontaktin agregat-pjesëza të çimentos, që duket që është hallka e “dobët” e një zinxhiri rezistent.

Mbi bazë të konsideratave të mësipërme, rezulton se një rritje të trashësisë së shtresës mbuluese të hekurit nuk mund ta kompensojë as rritja e raportit u/ç, as rritja e përmbajtjes së çimentos.

#### 7. BETONI ME VETI TË LARTA DHE ME REZISTENCË TË LARTË

Për të përcaktuar karakteristikat fiziko – mekanike të disa betoneve, mund t’u referohemi rregullave teknike që janë të vlefshme për betonet që kanë rezistencë karakteristike  $R_{ck} \leq 55 \text{ N/mm}^2$  dhe mund të aplikohen të dhënat që përmbahen në paragrafin e mëposhtëm 8.3.

- Për betonet që kanë rezistencë karakteristike  $R_{ck} > 75 \text{ N/mm}^2$  (betone me rezistencë të lartë – R.L) dokumentacionet e projektit, që duhen prezantuar në Këshillin e Rregullimit të Territorit, duhet të përfshijnë modelimin e materialit, të kryer mbi bazën e dokumenteve specifike teorike dhe eksperimentale, për më tepër një arsyetim të përshtatshëm të rregullave të kalkulimeve të adoptuara.

- Përdorimi i betoneve në struktura komplekse, të ngarkuara shumë ose me dimensione të mëdha, ose të ekspozuara në kushte ambientale ekstreme, i përcakton si betone “me veti të larta”, që karakterizohen nga:

- rezistencë e lartë, shpejtësi në ngurtësim dhe punueshmëri;
- deformime nga tkurrja dhe viskoziteti;
- kompaktësi (ngjeshje) e madhe, në aspekte pozitive për qëndrueshmërinë.

Është tashmë praktikë të përcaktohet në  $50 \text{ N/mm}^2$  pragu i “vetive të larta” ( $f_{ck} \geq 50 \text{ N/mm}^2$ ;  $R_{ck} \geq 60 \text{ N/mm}^2$ ), ndërsa për betonet e klasës superiore, ( nga K 60/75 deri në K 100/115), flitet për “rezistencë të lartë”. Në veçanti deri në klasën K 60/75, janë sigurisht akoma të vlefshme metodat e llogaritjes dhe të rezultateve eksperimentale, frut i studimeve të kryera në të kaluarën mbi betonet e zakonshëm.

Siç është thënë në paragrafin 5.2.1, betoni me rezistencë të lartë që trajtohet në këtë material, përfshin klasat superiore nga K 60/75 deri në K100/115, me një numër klasash që prezantojnë rezistencën karakteristike në shtypje pas 28 ditësh të maturimit të lagështisë. Numri i parë i është referuar rezistencës së mostrave cilindrike me diametër 150 mm dhe lartësi 300 mm, i dyti rezistencës së mostrave kubike me brinjë 150 mm. Kur mostrat janë me dimensione të ndryshme nga ato të përcaktuara, mund të përdoren koeficientët e konvertimit që sugjerohen në paragrafin 6.2.5, të cilët japin një përafërsi të pranueshme.

Për prodhimin, maturimin dhe shkatërrimin e mostrave, adoptohen metodat që përdoren për betonin e zakonshëm ose konvencional, me shënimin për t’u përdorur vetëm në kallëpe metalikë.

Në raport me të dhënat nga mostrat e betonit konvencional, rezultatet e matjeve janë shumë të ndjeshme në varësi nga metodat e provave, për këtë rekomandohet që metodat e përcaktuara nga standardet të mbikëqyren rigorozisht.

Në mënyrë që të bëhet e mundur arritja e një standardi të kërkuar është e nevojshme që:

- teknikët e laboratorit të kenë një dokument eksperience në sektorin e betoneve V.L dhe R.L.;

- laboratorit i caktuar për analizimin e provave të betonit të freskët në kantier, duhet të jetë i pajisur me aparatura të një niveli teknik të përshtatshëm dhe mbi të gjitha me funksionim të garantuar.

Për një përdorim korrekt të betoneve V.L. dhe R.L duhet hartuar një plan për sigurimin e cilësisë, në të cilin duhet të përshkruhen në detaje karakteristikat e brumit të freskët dhe të atij të ngurtësuar që duhen kontrolluar, mënyrat dhe frekuenca e kontrolleve, vlerat kufi që duhen respektuar dhe laboratorit përgjegjës i provave. Është gjithashtu e domosdoshme, që në planin për sigurimin e cilësisë, të jenë të përcaktuara masat që duhen adoptuar në rastin e shmangieve nga vlerat kufi dhe, gjithashtu personat përgjegjës për marrjen e vendimeve përfundimtare.

Metoda e projektimit të betoneve V.L. dhe R.L nuk ndryshon në thelb nga ajo që përdoret për betonet e zakonshëm. Meqënëse në gjendjen aktuale të njohurive, nuk është e mundur që projektimi i brumit të bazohet në karakteristikat e materialeve përbërës, raporti i përbërjes zgjidhet në bazë të punueshmërisë, qëndrueshmërisë, rezistencës për një staxhionim të dhënë dhe anës ekonomike.

Studimi i përzierjeve të provës kërkon një punë mjaft të madhe të laboratorit dhe përcaktimi i raporteve optimale është mjaft më i vështirë se sa për betonet e zakonshëm. Në veçanti duhet kontrolluar me shumë kujdes përshtatshmëria midis çimentos dhe shtesave, veprim mjaft kompleks, kur përdoret një kombinacion shtesash me funksione të ndryshme.

#### 7.1 Materialet përbërës

Përbërja e betonit me rezistencë  $R_{ck} > 55 \text{ N/mm}^2$ , karakterizohet në mënyrë të veçantë nga përdorimi:

- i çimentove të klasave 42,5 R dhe 52,5R me një dozim të lartë;
- i raportit u/ç që në përgjithësi është  $\leq 0,35$ ;
- i superfluidifikantit dhe eventualisht nga shtesa të tjera;
- i mineraleve shtesë (hira fluturues, skorie të granuluara në furrë, pluhur silici).

##### 7.1.1 Çimento

Subjektet prodhuese duhet të kenë parasysh se;

- Faktorët që ndikojnë në rezistencën fillestare dhe atë përfundimtare të çimentos janë përbërja e klinkerit dhe imtësia e bluarjes. Faktor i rëndësishëm i përbërjes është raporti ndërmjet silikatit trekalcik ( $C_3S$ ) dhe silikatit bikalcik ( $C_2S$ ): i pari hidratohet më shpejt, duke çliruar një sasi të konsiderueshme të nxehtësisë, i dyti në mënyrë më të ngadaltë. Prandaj një klinker me përmbajtje të madhe të  $C_3S$  premtun një arritje të shpejtë të rezistencës, ndërkohë që ai që përmban kryesisht  $C_2S$ , e arrin rezistencën me shpejtësi më të vogël, por rezistenca përfundimtare është gjithashtu e kënaqshme.

- Bluarje e imët do të thotë një sipërfaqe specifike më e madhe pra një shpejtësi më e madhe e hidratimit: për pasojë, faktori i imtësisë influencon veçanërisht në përfundimin e rezistencës fillestare.

- Përgjithësisht preferohet të përdoret një sasi çimento minimalisht e domosdoshme për të arritur rezistencën e dëshiruar. Kriteri është i vlefshëm, përveçse për motive të dukshme ekonomike, mbi të gjitha për të kufizuar sasinë e energjisë së çliruar gjatë procesit të hidratimit, si dhe për të kontrolluar tkurrjen, pra dhe plasaritjet e shkaktuara nga tkurrja. Për një rezistencë të dhënë, përmbajtja optimale e çimentos është e kushtëzuar nga karakteristikat e rërës dhe të agregatit të madh. Megjithatë, një tejkalim i çimentos mund të ketë nevojë për një sasi të tillë uji, që mund të sjellë një rënie të rezistencës përfundimtare.

##### 7.1.2 Raporti ujë/çimento

Raportet u/ç në përgjithësi ndodhen në intervalin 0,35 – 0,22; kufiri 0.35 për raportin u/ç i korrespondon vlerës për të cilën sistemi i poreve kapilare bëhet i ndërprerë mbas afërsisht një dite të staxhionimit në ambient me lagështi. Arritja e ndërprerjes kapilare mbas disa orësh staxhionimi bën të mundur, që strukturat që kanë pësuar një cikël staxhionimi të mbrojtur me kohëzgjatje konform standardeve, të kenë në momentin e heqjes nga forma karakteristika të kënaqshme qëndrueshmërie .

Një porozitet kapilar i ulët dhe i ndërprerë siguron që shpejtësia e depërtimit të substancave që përmban ambienti i ekspozimit të jetë mjaft i ulët.

##### 7.1.3 Shtesat

- Për të mbajtur punueshmërinë e kërkuar në raportet e ulta u/ç të përshkruara, është i domosdoshëm përdorimi i superfluidifikanteve, prej nga aktiviteti duhet të jetë aq më i madh sa më i vogël është raporti u/ç. Së bashku me superfluidifikantët përdoren shpesh edhe ngadalësues për të ngadalësuar humbjen e punueshmërisë së brumit, aerantë kur struktura është e ekspozuar ndaj cikleve të ngrirje-shkrirjes, dhe nganjëherë frenues të korrozionit të armaturës.

- Për shkak të përmbajtjes së lartë të çimentos, përzierjet e betonit V.L dhe R.L kanë tendencën të ngurtësohen mjaft shpejt, pavarësisht nga temperatura pak a shumë e moderuar e ambientit. Me ngadalësuesit shtyhet fillimi i stadit në të cilin procesi i hidratimit bëhet i shpejtë,

duke provokuar ngurtësimin e masës, megjithatë pikërisht përzierjet e ngadalësuara kanë tendencë më të madhe të tkurrjes plastike, përmbajtja e lartë e çimentos është faktor i reduktimit të kapilaritetit sipërfaqësor dhe, nëse ngurtësimi është i vonuar, aq më e madhe është koha në dispozicion për çfaqjen e plasaritjeve nga tkurrja plastike.

- Rreziku i plasaritjeve është konkret në rastin e strukturave të përbëra nga elemente me sipërfaqe horizontale, veçanërisht në rastin e lastrave dhe dyshemeve. Subjekti prodhues këshillohet në këto raste të shfrytëzojë menjëherë mbas hedhjes së, përzierjes elemente të staxhionimit që formojnë në sipërfaqe të betonit një membranë mbrojtëse. Me zvogëlimin e humbjes së lagështisë nga sipërfaqja e ekspozuar e brumit rreziku i plasaritjes bëhet shumë i vogël.

- Aspektet e qëndrueshmërisë nga ngrica të betoneve R.L nuk janë plotësisht të përcaktuara. Në betonet konvencionale aerantet e përmirësojnë rezistencën ndaj ngricës në varësi të dimensioneve të flluskave të ajrit që përmban betoni, të distancës ndërmjet flluskave dhe të përshkueshmërisë së brumit të ngurtësuar. Në shpejtësinë e shpërbërjes ndikojnë përmbajtja e lagështisë së brumit në momentin që arrihet temperatura e ngrirjes, numri i cikleve dhe shpejtësia e ngrirje-shkrirjes, prania e kripërave kundër ngrirjes në ambientin e ekspozimit dhe sasia e tyre në material.

- Në betonet R.L, mbase për shkak të prezencës së shtesave të tjera ose për motive të tjera akoma të pasqaruara, flluskat e ajrit të futura me aerantët arrijnë dimensione më të mëdha dhe kështu, për sasi të njëjta përmbajtjeje ajri, distanca reciproke është më e madhe se ajo e rekomanduar për rezistencën ndaj ngricës të betoneve të zakonshëm. Nga ana tjetër, nuk është përcaktuar akoma nëse betonet R.L kërkojnë për rezistencën ndaj cikleve të ngrirje-shkrirjes një sistem flluskash ajri me të njëjtat karakteristika me ato që kërkohen për betonet e zakonshëm.

- Duhet pasur parasysh që qëndrueshmëria ndaj ngricës është edhe funksion i shpërndarjes dimensionale të poreve në brumin e çimentos. Meqënëse temperatura e ngrirjes së ujit që ndodhet në pore ulet duke zvogëluar dimensionet e poreve, në dimensionet tipike të poreve të betoneve R.L. ekziston mundësia që temperaturat e ulta të ambientit nuk mjaftojnë për ngurtësimin e ujit në përbërjen e betonit. Gjithashtu, për shkak të zvogëlimit të përshkueshmërisë së betonit, ka shumë pak mundësi që përmbajtja e ujit në momentin e ngrirjes të arrijë shkallën e kërkuar të ngopjes, sepse rritja e volumit që shoqëron kalimin e gjendjes lëng – masë e ngurtë, i jep shkas fenomeneve të rrezikshme. Është reale të supozosh se strukturat me beton R.L. me raportin u/ç të barabartë ose më të vogël se 0.3 nuk e arrijnë kurrë ngopjen kritike, në qoftë se ato vendosen në mënyrë korrekte në punë.

- Në stadin aktual të eksperiencës, përdorimi i aerantëve është kërkesë për betonet me rezistencë jo më të madhe se  $70 \text{ N/mm}^2$ , megjithatë duhet pasur parasysh nga subjekti prodhues se për sa përmendëm më sipër, është e arsyeshme që ndërmjet provave të kryhet edhe rezistenca e cikleve të ngrirje-shkrirjes të materialit edhe kur klasa e rezistencës së betonit është më e madhe se kufiri i sipërpërmendur dhe, edhe kur temperaturat e ekspozimit të arritura në muajt e dimrit nuk janë më tepër se poshtë zeros.

- Aktualisht, frenuesi i korrozionit i favorshëm për përdorim, nisur nga rezultatet e mira laboratorike dhe ecurinë pozitive të vrojtuar në aplikimet e para praktike, është nitriti i kalciumit. Pikërisht kjo përzierje, është gjithashtu edhe një përshpejtues i ngurtësimit. Megjithatë nëse kushtet e vendosjes në punë nuk përputhen me punueshmërinë e kërkuar të brumit, solucioni i nitritit të kalciumit duhet të shtohet në fund të punimeve.

- Duhet mbajtur parasysh, gjithashtu se volumi i solucionit që përdoret, rreth 25 litra për  $\text{m}^3$  të brumit, është një masë e rëndësishme në sasinë e përgjithshme të ujit të nevojshëm për brumin dhe për këtë ka shumë mundësi, që pikërisht para se të shtohet ky ujë, punueshmëria gjatë përzierjes në betonierë të jetë shumë e vështirë. Problemi zgjidhet me përdorimin e ngadalësuesve ose me shtimin e një sasive të madhe të shtesave që ulin konsistencën (superfluidifkantë) : zgjatja e kohës së ngurtësimit balancon efektin përshpejtues të nitritit.

- Në teknologjinë e betoneve V.L. dhe R.L. praktika e ridozimit të shtesave që ulin konsistencën në fund të punës, me qëllim kompensimin e humbjes së punueshmërisë, është mjaft e përdorshme.

- Kur shtesat përfshijnë edhe aerantë për qëndrueshmërinë ndaj ciklit të ngrirje- shkrirjes, rekomandohet të kontrollohet efekti i dozës së shtuar të superflidifikantëve për përmbajtjen e ajrit. Pikërisht ky efekt çfaqet në mënyra të ndryshme sipas llojit të brumit dhe natyrës së përbërësve.

#### 7.1.4 Minerale shtesë

Mineralet shtesë luajnë një rol të rëndësishëm në karakteristikat e betoneve.

- Minerale shtesë shpesh kritike për ndikimin në vetitë e betoneve V.L dhe R.L, duhet të përdoren për të përmirësuar karakteristikat e rezistencës mekanike apo për të përmirësuar qëndrueshmërinë. Pjesa më e madhe e të dhënave nga literatura ka të bëjë me përdorimin e hirave fluturues, të skorieve të granuluara të furnaltave dhe të shtesave kuarcore. Ky i fundit është një nënprodukt i prodhimit të silicit metalik të lidhjes ferro – silic të prodhuar nga silici amorf (85 – 98%), në pjesëza sferike me diametër sa gjysma e diametrit të kokrrizave të çimentos.

- Hirrat fluturuese dhe skorjet e granuluara e ngadalësojnë rritjen fillestare të rezistencës por ndikojnë në përfundimin e rezistencës përfundimtare. Brenda disa kufijve ngadalësimi fillestar mund të kompensohet duke rritur shkallën e imtësisë dhe duke vepruar mbi kushtet e staxhionimit. Me skorjet e granuluara të furnaltës efekti negativ mbi rezistencën fillestare është i rëndësishëm kur përmbajtja e shtesave është e lartë dhe temperatura e staxhionimit është relativisht e pranueshme. Duke zëvendësuar një pjesë të çimentos me pluhur silici, arrihet një përmirësim i rezistencës gjatë staxhionimit me një rritje të kënaqshme të rezistencës përfundimtare, prandaj përdorimi i pluhurit të silicit eviton përdorimin e dozave shumë të larta të çimentos.

- Mënyra më e thjeshtë për të përfunduar një beton me rezistencë mbi 80 N/mm<sup>2</sup> dhe punueshmëri të përshtatshme është shtesa e pluhurit të silicit. Veprimin pozitiv të pluhurit të silicit mbi rezistencën e ndihmojnë, përveç reagimit të spikatorit të materialit përballë hidroksidit të kalciumit që është dukshëm superior në krahasim me shtesat e tjera të përmendura, edhe efekte të natyrës thellësisht fizike të rikorrigjuara në dimensionet submikronike të pjesëzave. Në fazën fillestare pjesëzat e pluhurit të silicit e përshpejtojnë procesin e hidratimit të çimentos sepse reagojnë si qendra për hidratet gjatë formimit: për pasojë rezistenca në një ditë është më e madhe se në rastin e mungesës së shtesave.

- Si kontribut mbi rezistencën përfundimtare është konsideruar i rëndësishëm efekti mbushës (efekti “filler”): pjesëzat e pluhurit të silicit, për shkak të dimensioneve të vogla, të mund të futen në boshllëqet ekzistuese ndërmjet pjesëzave të çimentos, kështu produkti i reaksionit silic amorf – hidroksid kalciumi i bën shumë kompakte nyjet lidhëse. Në këtë mënyrë zvogëlohet ndjeshëm depërtueshmëria dhe, në pjesët e kontaktit brumë – agregat, arrihet një përmirësim i ndjeshëm i forcës lidhëse, duke ndikuar në pakësimin e produkteve të padëshirueshme (hidroksid kalciumi dhe ettringite) në zonën e ndërmjetme.

- Hirrat fluturuese dhe skorjet e granuluara përmirësojnë qëndrueshmërinë ndaj veprimit të sulfatëve, luajnë rol në reduktimin e reaksionit alkal / agregat, zvogëlojnë nxehtësinë e çliruar në procesin e hidratimit dhe sjellin zvogëlimin e depërtueshmërisë.

- Në prani të hirrave fluturuese kërkesa për ujë rezulton më e vogël për një punueshmëri të dhënë. Në fund të aktivitetit pocolanik, përbërja e hirrave fluturuese duhet të jetë e natyrës siliko – aluminoze, me një përmbajtje të ulët të oksideve bazikë (CaO).

- Betonet me hirra fluturuese kanë qëndrueshmëri ndaj cikleve të ngrirje-shkrirjes nëse në brumin e freskët mund të realizohet dhe të mbahet një sistem flluskash me dimensionet dhe distancat e kërkuara. Ky objektivi mund të arrihet, me një sasi normale aerantësh, vetëm në rastet kur përmbajtja e karbonit të hirrave fluturuese është e barabartë ose më e vogël se vlera e dhënë nga standardi evropian EN 450.

- Hirrat fluturuese dhe skorjet e granuluara të furnaltave duhet të përdoren vetëm me çimenton portland dhe nuk duhet të shtohen asnjëherë në një çimento me shtesa të tjera. Mospërdorimi nuk ka të bëjë me pluhurin e silicit, që zakonisht është përdorur në kombinacionet me çimenton portland dhe me hirrat fluturuese.

- Pluhuri i silicit, i cili ka një sipërfaqe specifike rreth 50 herë më shumë se ajo e çimentos, zotëron një veprim të qartë pocolanik, prandaj e përmirëson mjaft qëndrueshmërinë e betonit në pjesën më të madhe të veprimeve kimike. Veçanërisht është efikas veprimi mbi përshkueshmërinë, që rezulton mjaft i vogël në krahasim me atë të një betoni me të njëjtën rezistencë në shtypje që nuk

përmban pluhur silici. Edhe duke supozuar se poroziteti total mbetet pothuajse i palëvizshëm, çimento me pluhur silici jep shkas, duke u hidratuar, për një brumë me pore më të shpërndara dhe kështu me dimensione më të vogla.

- Me një zvogëlim të dukshëm të poreve dhe një raport të ulët u/ç, betonet me pluhur silici do të mund të ishin rezistente ndaj ngricave pa përdorimin e aerantëve ose me një sistem flluskash me karakteristika të ndryshme nga ato të betoneve të zakonshëm.

- Duke pritur që studimet laboratorike dhe rezultatet e kërkimeve të japin përgjigje definitive është e rekomandueshme, siç është evidentuar deri tani, që provat për cilësinë e betonit të parashikojnë kontrollin e rezistencës ndaj ngrirjes.

- Përmbajtja e pluhurit të silicit përgjithësisht kufizohet në intervalin 5 – 10% (përqindja në peshë i referohet totalit çimento+shtesa). Kryerja e provave për të stabilizuar përbërjen optimale duhet si për koston për njësi të materialeve, disa herë më e madhe se ajo e çimentos, ashtu dhe për të arritur punueshmërinë e dëshiruar, e cila kërkon një zgjedhje të kujdesshme të përmbajtjes së substancave që rrisin rrjedhshmërinë, nëse është e nevojshme të kombinuara me shtesa të tjera. Rekomandohet që ulja e konit të betonit që përmban pluhur silici të jetë 20-25 mm më e madhe se ajo që do të kërkohej në rastin e një betoni me punueshmëri të njëjtë por pa shtesa minerale.

- Rreziku i plasaritjeve nga tkurrja në tharje është më i madh në prezencë të pluhurit të silicit, sepse prezenca e një materiali me një sipërfaqe të madhe specifike si pluhuri i silicit shkakton një zvogëlim të mëtejshëm të kapilaritetit mjaft më të ulët për betonet V.L, dhe R.L.

- Staxhionimi i betoneve me pluhur silici duhet të trajtohet me shumë kujdes; një tharje e parakohshme shkakton humbje më të madhe të rezistencës në krahasim me atë që mund të ndodhte në një beton me raport të barabartë u/ç pa përmbajtje të pluhurit të silicit.

- Të dhënat e literaturës sugjerojnë që, për betonet R.L me raport u/ç rreth 0,30 në përmbajtje të pluhurit të silicit, zgjatja e kohës së staxhionimit të lagësht, mbi 7 ditë, nuk ka efekte të dukshme përsa i përket rezistencës, sepse brumi i ngurtësuar bëhet i pakalueshëm nga uji. I njëjti fenomen ndodh mjaft më vonë me betonet që përmbajnë shtesa më pak aktive se sa pluhuri i silicit.

#### 7.1.5 Agregatet

Agregati ka një rol kyç në prodhimin e betonit R.L sepse kufizon rezistencën potenciale që përfitohet.

Nuk njihen as mekanizma nëpërmjet të cilëve të manifestohen veprime kufizuese as veti fizike dhe kimike të materialeve vërtet të pranueshme. Agregatet e zakonshme me karakteristika të mira lejojnë që të arrihet një rezistencë deri 120 – 140 N/mm<sup>2</sup>, por vetëm me disa tipe agregatesh është e mundur të arrihet rezistenca prej 170 N/mm<sup>2</sup>.

Opinion i pranuar është që faktor mbizotërues të jetë forca e lidhjeve që stabilizon kontaktin mes agregatit dhe brumit të çimentos dhe jo rezistenca mekanike e gurëve që me disa përjashtime, rezultojnë përgjithësisht të përshtatshëm. Forca lidhëse e pjesëve të kontaktit ka lidhje me mineralogjinë dhe strukturën sipërfaqësore të gurit dhe me përbërjen e brumit.

Një tregues rreth natyrës së pjesëve lidhëse mund të nxirret nga kurba sforçim – deformim e betonit, duke ndjekur një provë të ngarkim-shkarkimit brenda intervalit elastik. Shtimi (shtrirja) i cikleve të paqëndrueshëm varet nga karakteristikat mekanike të gurëve dhe nga lidhjet ndërmjet pjesëve: nëse rezistenca mekanike e gurëve është brenda kufijve normalë të pranimit, shtimi më i madh ose më i vogël (isteresi) është tregues i një force lidhëse më të dobët ose më të fortë.

Nga të dhënat e literaturës rezulton se për të mbajtur rezistencën optimale preferohet të përdoren agregate me dimension maksimal nominal mjaft të ulët, deri në 10 -12 mm, sepse ulet në këtë mënyrë tensioni mes pjesëve të kontaktit, meqënëse pjesa sipërfaqësore e agregatit është më e madhe për njësi vëllimi.

Duhet nënvizuar gjithashtu se në betonet R.L përqendrimet e tensioneve në sipërfaqet e kontaktit janë më të ulta sepse diferenca midis modulit të elasticitetit të agregatit dhe brumit është më e vogël. Megjithatë zvogëlimi i dimensionit nominal sjell një rritje të përmbajtjes optimale të çimentos dhe ka gjithashtu një efekt negativ mbi rezistencën në tërheqje nga shtypja. Megjithëse tendenca është ndaj zgjedhjes së dimensioneve maksimale nominale nën 20 mm, nuk mungojnë këtu rastet kur janë përdorur me sukses agregate deri në 19 -25 mm. Ashtu si në betonet e zakonshëm

agregati, përveçse influencon në rezistencën mekanike, është përcaktues edhe për modulën e elasticitetit, tërheqjen, viskozitetin dhe, në rastin e dyshemeve, edhe në rezistencën në grryerje.

Rëra influencon në nevojën e kërkesës për ujë, përmbajtjen e një agregati të madh dhe në punueshmërinë për finitura. Është e preferueshme që granulometria e saj të jetë e madhe me qëllim zvoglimin e aftësisë ngjitëse të brumit, përgjithësisht i lartë për shkak të përmbajtjes së lartë të çimentos, për këtë arsye sasia e materialit të imët nën 0.25 mm duhet të mbahet e ulët.

Për rërën preferohen materiale të përbërë nga pjesëza të rrumbullakta dhe me sipërfaqe të lëmuara; pra materiale që kërkojnë më pak ujë, për agregatet e mëdhenj preferenca është për gurët me strukturë sipërfaqësore me rrudha, pra për materiale që sigurojnë një lidhje më të mirë në pjesët e kontaktit.

Një gur me kënde dhe thepa ka efekt negativ mbi punueshmërinë, sepse rrit kërkesën për ujin që nevojitet dhe kështu shkakton një rritje të raportit u/ç që nga ana e tij do të çonte në një zvoglim të rezistencës së lidhjeve të kontaktit. Prandaj zgjedhja ndërmjet çakullit dhe zallit është një problem optimizmi.

Për të evituar ndarjen e agregatit të madh gjatë vendosjes në punë është e preferueshme të përdoret një granulometri e vazhduar. Kërkesat për pranimin e rërës dhe të agregatit të madh duhet të jenë konform standardeve S SH EN 206-1.

### 7.2 Punueshmëria e betoneve strukturore me rezistencë të lartë

Punueshmëria si element i rëndësishëm në prodhimin e betoneve ka karakteristikat si më poshtë:

- Përdorimi i betoneve strukturore me rezistencë të lartë shoqërohet zakonisht me një densitet të lartë të armaturës, për të siguruar një vendosje të përshtatshme në punë është e nevojshme që betoni të ketë punueshmëri të lartë. Është i zakonshëm përcaktimi i vlerës së uljes së konit më shumë se 200 mm.

- Punueshmëria e arritur nga sasi të larta të substancave shumë të rrjedhshme është nganjëherë më e ulët se ajo që rezulton nga përmbajtja e lartë e ujit, në të cilën brumi tenton të jetë më pak i punueshëm dhe kështu nevojitet në disa raste një përpunim më i zgjatur.

- Substancat me rrjedhshmëri të madhe influencojnë mbi punueshmërinë në funksion të kohës. Për të pasur punueshmërinë e dëshiruar në momentin e hedhjes, shpesh kërkohet një sasi shtesë në fund të procesit.

### 7.3 Vetitë mekanike të betoneve me veti të larta dhe rezistencë të lartë

#### 7.3.1 Rezistenca në shtypje

Metodat e përcaktimit të vetive kryesore të betoneve i referohen një materiali me rezistencë cilindrike më të vogël se  $45 \text{ N/mm}^2$ .

- Për betonin V.L dhe R.L raportet mes rezistencave të arritura në 7 dhe 28 ditë variojnë nga 0.80 deri në 0.90, ndërsa për betonin e zakonshëm variojnë nga 0.70 deri në 0.75; raportet tipike ndërmjet rezistencave në 7 dhe 95 ditë për betonin R.L janë të barabartë me rreth 0.73, për betonin me rezistencë mesatare në 0.65.

- Duhet pranuar se shpejtësia më e madhe e rritjes së rezistencës për betonet V.L dhe R.L i detyrohet në radhë të parë temperaturës më të madhe të brendshme që kërkon nxehtësi më të madhe hidratimi, dhe në radhë të dytë distancës më të vogël ndërmjet pjesëzave të çimentos për një raport të ulët raporti u/ç.

- Arritja e rezistencës pas 28 ditësh, për betonet V.L dhe R.L është në përgjithësi më e vogël e krahasuar me ato që vihen re në betonet e zakonshëm, kryesisht për shkak të mungesës së një sasive të tepërt uji për të shoqëruar hidratimin.

- Për një beton që përmban pluhur silici, përta i përket rezistencës pas 28 ditësh është më e vogël e krahasuar me atë të betoneve që kanë të njëjtin raport u/ç, por që nuk përmbajnë pluhur silici.

#### 7.3.2 Kurba sforcim – deformim

Diferencat thelbësore ndërmjet kurbave sforcim – deformim në shtypje të betoneve me  $R_{ck} > 55 \text{ N/mm}^2$  (në veçanti për betonet me  $R_{ck} > 75 \text{ N/mm}^2$ ) dhe të atyre të zakonshëm janë:

- një gjatësi më e madhe e vijës së drejtë (lineare) në kurbën ngjitëse;



- deformim pak me i madh në sforcimin maksimal;
- pjerrësi më e madhe e vizës zbritëse, tregues i një sjellje më të ndjeshme.

Përgjigjja më e qartë deri në tensionin maksimal është konsekuencë e përmirësimit të kontaktit brum-agregat; një linearitet më i madh i vizës së fillimit është tregues i faktit se në nivele të ulta të ngarkesës mikroplasaritjet janë më të vogla në pjesët e kontaktit.

Duke qënë se në betonet V.L dhe R.L diferenca e ashpërsisë ndërmjet brumit të çimentos dhe agregatit është më e vogël, si rrjedhojë shpërndarja e brendshme e tensioneve, rezulton më homogjene, pra me koncentrim tensionale më të vogla dhe me mikroplasaritje më pak.

Në rastin e kurbës tension – deformim duhet nënvizuar se në degën zbritëse, deformimi i matur është një deformim i “mesëm”, këtu jep një kontribut maksimal çarja progresive dhe lokalizimi i procesit plasaritës, në atë masë sa në degën zbritëse është më korrekte të flitet për kurbën sforcim – hapje e plasaritjes.

Betonet V.L dhe R.L janë më pak të fortë (kanë fortësi më të vogël), pra e humbin më shpejt rezistencën ndaj rritjes së deformimit në degën zbritëse dhe strukturat e tyre, pa armaturë, janë më pak të përkulshme, ose më pak të deformueshme.

Energjia e thyerjes është një parametër i materialit i lidhur ngushtë me rezistencën në tërheqje dhe me dimensionin maksimal të agregatit, i vlefshëm në modelimin e sjelljes në tërheqje të betonit (faza e plasaritjes).

Prezenca e pluhurit të silicit redukton në mënyrë drastike energjinë e plasaritjes, që kalon nga 100 – 200 J /m<sup>2</sup> në 50 – 100 J/m<sup>2</sup>.

### 7.3.3 Rezistenca në tërheqje

Rezistenca në tërheqje direkte, tenton të reduktohet në vlerat e 5% të rezistencës në ngjeshje mbi cilindrin f<sub>c</sub>.

Për vlerësimin e rezistencës në tërheqje direkte në funksion të rezistencës në ngjeshje vlen akoma relacioni i propozuar dhe i pranuar për betonet e zakonshme:

$$f_{ct} = 0,3f_{ck}^{2/3} = 0,27R_{ck}^{2/3} \text{ (N/mm}^2\text{)}.$$

ku f<sub>ct</sub> merret si rezistencë mesatare, rezistenca karakteristike vlerësohet me 0,9 f<sub>ct</sub>.

Për vlerësimin e rezistencës në tërheqje indirekte për humbje të plasaritjes, (prova braziliene) standardet DIN 1045(1992) japin relacionet e mëposhtme, të vlefshme për të gjithë betonet me f<sub>ck</sub> nga 35 deri në 115 N/mm<sup>2</sup>:

$$f_{ct,sp} = 0,59 \sqrt{f_c} \text{ (N/mm}^2\text{)} .$$

ku f<sub>c</sub> përcaktohet mbi cilindrat me d = 150 mm dhe h = 300 mm. Megjithatë një vlerësim analog merret me relacionin e dhënë në Model Code 90:

$$f_{ct,sp} = 1,11f_{ct} = 0,33f_c^{2/3} \text{ (N/mm}^2\text{)} .$$

Rezistenca në tërheqje indirekte nga përkulja, (prova në tre pika) është rreth 1.4 – 1.6 herë e rezistencës në tërheqje direkte; veçanërisht sipas Model Code 90:

$$f_{ct,fl} = 1,50f_{ct} = 0,40 f_c^{2/3} \text{ (N/mm}^2\text{)}.$$

Vihet në dukje se, duke qënë efekti i dimensioneve të provave shumë i fortë në provën indirekte në këputje, mostrat kampione duhet të përgatiten rigorozisht sipas standardit S SH UNI 6130.

### 7.3.4 Moduli i elasticitetit

Moduli i elasticitetit duhet të shihet i lidhur ngushtë me vetitë e brumit të çimentos dhe ato të agregatit; përveç kësaj, meqënëse përzierjet e betoneve me R<sub>ck</sub>> 55N/mm<sup>2</sup> që përmbajnë shtesa

kimikate dhe shpesh shtesa pocolanike, përveç se karakterizohen nga një raport i ulët u/ç dhe përmbajtjes së llojeve të veçanta të agregateve, efektet mbi modulën e elasticitetit mund të jenë të kënaqshme.

Megjithatë, për agregatet e zakonshme vazhdon të jetë i vlefshëm si vlera e modulit të elasticitetit ( $\sigma_c \leq 0,5f_c$ ) e njëjta shprehje tashmë e adopuar më gjerësisht për betonet e zakonshëm (Model Code 90, EC2).

$$E_c = 9500f_c^{2/3} \text{ (N/mm}^2\text{)}$$

të cilës i korrespondon vlera tangente me origjinën;

$$E_{c0} = 1,2E_c \approx 11000f_c^{1/3} \text{ (N/mm}^2\text{)}$$

me  $f_c$  nënkuptohet rezistenca mesatare në shtypje.

Koeficienti i Poisson i betoneve V.L dhe R.L në fushën elastike mund të variojë nga 0,18 deri në 0,24 në funksion të nivelit të rezistencës.

Mbi bazë të këtyre vlerave moduli Poisson është i krahasueshëm me vlerat që merren për betonet e zakonshëm.

### 7.3.5 Tkurrja

Tkurrja, për betonet me rezistencë në shtypje deri në 80 – 85 N/mm<sup>2</sup>, shpejtësia fillestare e tkurrjes është më e madhe, ndërsa mbas tre muajve të parë, tkurrja për betonet me rezistencë të ulët dhe të lartë është përafërsisht e njëjtë.

Në fakt për shkak të rritjes relative të përmbajtjes së çimentos dhe sasisë relative të ulët të ujit, në betonet me rezistencë të lartë ka tendencë të ketë epërsi “tkurrja e brendshme” (vetëtharja e detyruar prej bashkimit të ujit në hidrate) në krahasim me tkurrjen prej “tharjes” (shkëmbimi i ujit me ambientin e ekspozuar), fenomeni i parë është më i shpejtë se i dyti, i cili duke qenë i natyrës difuzive, është më i ngadaltë. Megjithatë prezenca e pluhurit të silicit tenton të shpejtojë edhe tkurrjen nga tharja.

Epërsia e procesit të vetëtharjes shpjegon edhe faktin se përse tkurrja tenton të jetë përafërsisht proporcionale me volumin në përqindje të ujit, në krahasim me raportin u/ç, edhe pse është më i pranueshëm zvogëlimi i raportit u/ç nëpërmjet përdorimit të “superfluidifikantëve” në krahasim me rritjen e përmbajtjes së çimentos.

### 7.3.6 Rrëshqitja viskoze

Rrëshqitja viskoze, merret si deformim që ndryshon në kohë nën ngarkesa konstante, rezulton më e vogël në betonet e zakonshëm. Në veçanti në mostrat e pangurtësuar koeficienti i viskozitetit (raporti ndërmjet deformimit viskoz dhe deformimit elastik fillestar) rezulton rreth 25 – 50% më i ulët.

Gjithashtu koeficienti i viskozitetit duhet të mbahet konstant (viskoelasticiteti linear) deri në përqindjen më të lartë të rezistencës në shtypje ( $\sigma \leq 0,7f_c$  për betonet R.L. ;  $\sigma \leq 0,5f_c$  për betonet e zakonshëm).

Deformacionet e vogla viskoze të vërejtura mund të shpjegohen me:

- ngurtësimin e përshpejtuar prej pluhurit të silicit, që e redukton viskozitetin “vetjak” ose “atë bazë” (pra në mungesë të shkëmbimit të lagështisë me ambientin e ekspozimit) edhe pse vendosja nën ngarkesë është e parakohshme;

- mungesën e viskozitetit “nga tharja”.

Për viskozitetin (rrëshqitës) nga tërheqje ekziston kufi i përcaktuar; provat me 35% të rezistencës tregojnë që deformimi viskoz rritet me zmadhimin e raportit U/Ç dhe zvogëlimin e raportit Inert/çimento.

Përfundime:

Rregullat e mësipërme përdoren për realizimin e strukturave të betonuara në vend ose parafabrikate, të prodhuara në impiante të përqendruara ose linjat e prodhimit të parafabrikateve.

Materiali përshkruan konditat operative për ruajtjen e karakteristikave të veçanta të betonit në mbështetje të akteve ligjore e teknik në fuqi.

**VENDIM**  
**Nr.35, datë 18.1.2006**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PUNIMET E NDËRTIMIT TË SISTEMEVE TË KANALIZIMEVE, PËR LARGIMIN E UJËRAVE TË PËRDORIMIT SHTËPIAK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 25 të ligjit nr.9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” dhe të nenit 4 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullore për punimet e ndërtimit të sistemeve të kanalizimeve, për largimin e ujërave të përdorimit shtëpiak, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**RREGULLORE**  
**PËR PUNIMET E NDËRTIMIT TË SISTEMEVE TË KANALIZIMEVE PËR LARGIMIN E UJËRAVE TË PËRDORIMIT SHTËPIAK**

**TË PËRGJITHSHME**

**a) Hyrje**

Në godinat e banimit është i domosdoshëm largimi i ujërave të përdorimit shtëpiak që vijnë nga vende të ndryshme përdorimi. Regjimi i shkarkimit të këtyre ujërave është kryesisht i ndërprerë dhe temperatura e tyre është shumë e ndryshueshme e mund të arrijë deri në 100°C.

Tubat largojnë përgjithësisht ujin pa presion dhe paretet e tyre të brendshme mund të lagen krejtësisht ose pjesërisht.

Bashkësia e tubacioneve (tubo, rakorderi të ndryshme, pjesë speciale), me të cilat pajisen godinat e banimit për këtë qëllim, duhet t'i rezistojnë sforcimeve që ndodhin gjatë regjimit të shkarkimit. Tubacionet detyrimisht nuk duhet të jenë transparente, dhe mënyra e vendosjes varet nga natyra e materialit, tubacionet mund të jenë:

- me vendosje vertikale ose horizontale, që lejojnë largimin me gravitet;
- që i nënshtrohen sforcimeve të temperaturës dhe prurjeve shumë të ndryshueshme.

Kjo rregullore i përket si tubave që shërbejnë për largimin e ujërave të përdorimit shtëpiak, ashtu edhe tubacioneve të shkarkimit të ujërave të shiut në godina, dhe nuk përcakton përmasat e tyre.

Rregullorja i referohet tubacioneve të vendosura në brendësi të godinave apo edhe atyre jashtë godinës në masën që lejojnë kushtet klimaterike. Aparatet e ndryshme sanitare dhe ullukët e çative nuk janë objekt i kësaj rregulloreje. Gjithashtu, në këtë rregullore nuk janë marrë në konsideratë sistemet e largimit të ujërave të ndotura si pasojë e përdorimit të tyre industrial ose të këtij lloji.

Në rastet për të cilat rregullat teknike ose autoritetet lokale lejojnë zbatimin e sistemeve të

largimit me një tubacion të vetëm shkarkimi (një sistem i vetëm i largimit si për ujërat e përdorimit shtëpiak, ashtu edhe për ato të shiut) zbatohen njëlloj rregullat e cilësisë së këtij udhëzimi.

Largimi i ujërave të përdorimit shtëpiak duhet të jetë i tillë që mikrobet patogjene të ndodhura në ujë të mos rrezikojnë shëndetin e banorëve. Për këtë arsye, si dhe për të evituar erërat e padëshirueshme nga substancat që dekompozohen me shpejtësi, ujërat e përdorimit shtëpiak duhet të shkarkohen shpejt.

Ky udhëzim është adaptim nga UEA tc i marrëveshjeve teknike në ndërtim të Bashkimit European.

## PJESA E PARË TERMINOLOGJIA

### 1.1 Përcaktime të përgjithshme

#### 1.1.1 Ujërat e përdorimit shtëpiak

Janë ujëra, natyra e të cilave është ndryshuar gjatë largimit në rrjetin e tubacioneve dhe janë ndotur si pasojë e përdorimit të tyre shtëpiak, po ashtu edhe ujërat e shiut.

Ndërmjet tyre duhen përmendur:

- Ujërat e bëra të papastra si pasojë e përdorimit të tyre shtëpiak, ujërat e shtyra me presion që përmbajnë jashtëqitjet njerëzore dhe, kur është e domosdoshme, me autorizim për jashtëqitje shtazore, si dhe ujërat e shiut nëse nuk janë larguar në një tjetër rrjet.

Nuk konsiderohen ujëra të përdorimit shtëpiak, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje:

- Ujërat e zeza ose substancat që për nga natyra e tyre, për nga sasia dhe për nga koncentrimi mund të dëmtojnë, gjatë përdorimit, funksionimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve të shkarkimeve publike ose sistemet e shkarkimeve të godinave; përveç këtyre, nuk janë marrë në konsideratë produktet që mund të dëmtojnë jetën ose shëndetin e personave që punojnë me kanalizimet (ose që janë në kontakt me to) ose në sistemet e pastrimit, filtrimit dhe të eliminimit të ujërave të përdorura.

Ndërmjet tyre, në veçanti duhen përmendur:

a) Materialet e ngurta, substancat fibroze, bitumet, rëra, çimento, hirat, letrat e forta dhe kartonat, mbeturina inerte, plehëra, të brendshmet;

b) Substancat kimike të djegshme ose eksplozive, ose avujt e të cilave mund të bëhen eksplozive nëse përzihen me ajrin e kanalizimeve (p.sh. benzina ose benzoli), substancat toksike, si arsenik, cianogjen etj, si dhe radioaktive;

c) Substancat me veprim agresiv më të fortë se veprimi i ujërave të përdorimit shtëpiak;

d) Substancat e lëngshme, vajrat, acidet, sodat, emulsionet, fenolet, kripërat e metaleve të rënda, antibiotikët ose substanca identike, në masën që mund të çrregullojnë jetën biologjike në stacionet e pastrimit dhe në rrjetet e kanalizimeve;

e) Ujërat e përdorura dhe substancat që lëshojnë erëra të padëshirueshme, si dhe të gjitha gazet;

f) Ujërat e përdorura të infektuara, p.sh. ujërat e përdorura në spitale (salla infektive);

g) Substanca që prodhojnë efekte të dëmshme jo direkt, por me përzierje ose nga reaksioni i tyre me ujërat e përdorura;

Në rastet kur kemi të bëjmë me lëngje ose substanca të tilla, është e nevojshme të parashikojmë karakteristika speciale për materialet që do të përdoren për sistemet e largimit ose të parashikohet trajtim i përshtatshëm për ujërat e zeza.

#### 1.1.2 Sistemet e largimit

Bashkësia e tubave, rakorderive dhe e bashkuesve të kanalizimeve, si dhe mënyra e bashkimit ose fiksimit të tyre, të destinuara për largimin e ujërave duke u nisur nga aparatet shtëpiake dhe sanitare (përfshirë ose jo sifonet e tyre) deri në rrjetin kyesor të kanalizimeve.

#### 1.1.3 Tubat

Trupa bosh në formë cilindrike të hapura në fundet e tyre dhe me dimensione nominale të përcaktuara. Tubat e përkulshëm (fleksibël) nuk trajtohen në këtë udhëzim.

#### 1.1.3.1 Rakorderitë

Elemente të kanalizimeve që përdoren:

- për ndryshimin e drejtimit të kanalizimeve;  
- për bashkimin në dy ose më shumë pjesë të tubave (të të njëjtit diametër ose jo, të të njëjtit material ose jo);

- për bashkimin ndërmjet një tubi dhe aparati sanitar;

- ose për të lejuar mirëmbajtjen e kanalizimeve.

#### 1.2 Tipet e kanalizimeve

##### 1.2.1 Tubat (1)

1.2.2. Tubat (lidhjet) e rakordeve midis sifonit dhe degëzimit

##### 1.2.3 Degëzimi nën horizontal për shkarkime të veçanta (2)

Kanalizim nga pika e përdorimit deri te bashkimi me tubacionin kryesor.

##### 1.2.3.1 Degëzim nën horizontal për shkarkime shumëfishe (2b)

Kanalizim që mbledh ujërat nga shumë degëzime për shkarkim të veçantë dhe që i dërgon në kolonën e shkarkimit për në kolektorin kryesor.

##### 1.2.4 Kolona e shkarkimit (3)

Tubacioni vertikal me ose pa ndryshim drejtimi, që kalon në një ose më shumë kate me ajrosje, që del mbi çati, që dërgon ujërat e përdorimit shtëpiak në kolektorin kryesor më të afërt ose të nëndheshëm.

##### 1.2.5 Kullimet e ujërave të shiut (4)

Kullimet e ujërave realizohen me tubacione brenda ose jashtë muraturës, të destinuara për largimin e ujërave të shiut nga çatitë, ballkonet dhe llozhat.

##### 1.2.6. Kolektori kryesor (5)

Tubacioni më i afërt që është për grumbullim e ujërave të kolonave të shkarkimit dhe të degëzimeve nëntokësore.

##### 1.2.7 Kolektori kryesor nëntokësor (6)

Tubacioni i futur në tokë ose në themelet e godinës dhe që destinohet për derdhjen e ujërave të përdorimit shtëpiak në rrjetin kryesor të kanalizimeve.

##### 1.2.8 Tubi i ventilimit (7)

Tubacioni që nuk mbledh ujërat e përdorura dhe që destinohet për sigurimin e ventilimit të sistemit të largimit të ujërave.




Fig 1. Skema e largimit të ujrave me "rrjet unik". Pjesë të ndryshme instalimi




Fig 2. Kolona e shkarkimit me shumë ndryshime të drejtimit dhe ventilim sekondar direkt

Figurat 1 dhe 2 japin skematikisht shembuj që janë marrë për të ilustruar terminologjinë e paragrafit 1.2 dhe që ekzistojnë në vendet e ndryshme të BEA tc. Këto zgjidhje nga njëra anë nuk janë të kufizuara dhe nga ana tjetër nuk janë të gjitha të autorizuara në vendet e ndryshme të BEA tc, si norma lokale ose nacionale në përdorim.

### 1.3 Klasifikimi sipas materialeve

#### 1.2.1 Kanalizimet metalike:

- çelik i galvanizuar,
- çelik i riveshur me plastikë,
- gizë,
- alumini veshur me plastikë,
- bakër etj.

#### 1.3.2 Kanalizime prej materialesh plastike:

- PVC e paplastifikuar (polivinil kloruri jo i plastifikueshëm), PE Polietilen,
- PP Polipropien,
- PVC.CI (polivinil kloruri i kloruar),
- ABS (akrilotril butadien —stirene).

#### 1.3.4 Kanalizime të tjera

- Tuba me parete të përbëra (p.sh. metal - izolues termik — metal)

## PJESA E DYTË RREGULLAT E CILËSISË

### 2.1 Rregullat bazë

#### 2.1.1 Siguria

Zgjedhja e materialeve, sikurse edhe kushtet e instalimit duhet të jenë në përputhje me rregulloret në fuqi, në mënyrë të veçantë me ato që lidhen me risqet e përhapjes së zjarrit.

#### 2.1.2 Higjiena dhe funksionimi

Sistemet e largimit me gravitet duhet të garantojnë një shkarkim korrekt dhe të menjëhershëm të ujërave të përdorimit shtëpiak. Ato nuk duhet të favorizojnë formimin e algave, si dhe shpërndarjen e mikrobeve patogjene dhe për këtë arsye duhet të jenë opake (shiko 1.1). Ato duhet të jenë të qëndrueshme ndaj ujit dhe erërave. Për sa i përket dimensioneve të tubave, rakorderive dhe cilësisë së materialeve të elementeve bashkuese (xhuntave), shërbejnë standardet ISO/EN, rekomandimet dhe rregulloret kombëtare. Gjendja e sipërfaqeve të tubave dhe rakorderive duhet të jetë e kontrolluar (shiko 3.1.2). Duhet të verifikohet në veçanti që ato të jenë pa defekte që kompromentojnë cilësinë, që sipërfaqja e tyre e brendshme të mos ketë pjesë të dala dhe që pjesët fundore të tubit të jenë perpendikulare me aksin e tubit. Lyerja që duhet të aplikohet mbi tubacion nuk duhet të paraqesë mospërputhshmëri me tubin.

Kanalizimet duhet të jenë të qëndrueshme nga pikëpamja e formës, d.m.th. të ruajnë seksionin dhe drejtimin fillestar (3). Stabiliteti i formës varet kryesisht nga karakteristikat gjeometrike të kanalizimit dhe nga përbërja e materialit. Nëse stabiliteti i formës nuk është i siguar, duhen marrë masa të veçanta në vend për të kufizuar deformimet.

Duke pasur parasysh pjerrësitë e përdorura në përgjithësi për shkarkimet, ulja maksimale ndërmjet suporteve bashkuese të elementeve të kanalizimeve, nuk duhet të kalojë 3 mm. Për rrjedhim, nisur nga ky kusht, distanca ndërmjet suporteve mbetet fikse.

#### 2.1.3 Izolimi akustik

Sistemi duhet të konceptohet në mënyrë të tillë që zhurmat që krijohen gjatë funksionimit të zvogëlohen në maksimumin e mundshëm.

#### 2.1.4 Qëndrueshmëria

Qëndrueshmëria e kanalizimeve në vepër, duke parashikuar mirëmbajtje normale të mundshme dhe zëvendësime të pjesshme, duhet të përputhet me qëndrueshmërinë e godinave dhe të qëndrojë të paktën për 50 vjet në këto kushte. Kanalizimet duhet të kenë qëndrueshmëri të barabartë në çdo pikë. Në mënyrë të veçantë, rakorderitë dhe pjesët bashkuese të veçanta dhe proceset e punës për realizimin e tyre nuk duhet të krijojnë pika të dobëta.

##### 2.1.4.1 Faktorët e vjetërimit

Qëndrueshmëria e sistemit të largimit të ujërave duhet vlerësuar në përgjithësi duke pasur parasysh faktorët e mëposhtëm që veprojnë njëkohësisht ose në mënyrë individuale.

##### 2.1.4.1.1 Veprimet kimike

Sistemi i largimit të ujërave duhet të jetë rezistent ndaj ujërave të përdorimit shtëpiak, të përcaktuara në 1.1.1.

##### 2.1.4.1.2 Agjentët atmosferikë

Veprimi i rrezeve ultraviole për kanalizimet e vendosura në ambient të jashtëm

##### 2.1.4.1.3 Uji i kondensimit, i shiut, avulli i ujit

##### 2.1.4.1.4 Gazet atmosferike

Veprimi i gazeve CO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub>, O<sub>2</sub>, O<sub>3</sub>

##### 2.1.4.1.5 Temperatura dhe ndryshimet e temperaturës

Në regjim të ndërprerë shkarkimi, temperatura e ujit të përdorur shtëpiak konsiderohet e fiksuar në temperaturën 95 °C ± 1. Temperatura minimale konsiderohet minus - 15°C. Ndryshimet e shpeshta të temperaturës që merren në konsideratë për vlerësimin e goditjeve termike të kanalizimeve, janë të rendit (95°C-15°C).

#### 2.1.4.1.6 Goditjet

Goditjet që duhet të merren në konsideratë janë kur pjesët e tubacionit të ekspozuara ndaj goditjeve nuk janë të mbrojtura, të tilla janë ato që krijohen nga zënia e lokaleve (për kanalizimet e brendshme) ose nga sforcimet e jashtme (për kanalizimet e jashtme).

#### 2.1.5 Mirëmbajtja dhe riparimet

Konceptimi i sistemit të largimit, sikurse edhe vënia e tij në përdorim duhet të jenë të tillë, që mirëmbajtja periodike e kanalizimit të jetë e lehtë dhe e shpejtë. Duhet parashikuar në sistem, në pozicione të nevojshme, elemente që lejojnë këtë mirëmbajtje (tapa kontrolli ose shkarkuese).

Duhet të parashikohen rregullore praktike që të lejojnë zëvendësime eventuale të ndonjë elementi ose të një pjese të kanalizimit, përveç kësaj dimensionet e tubave dhe të rakorderive duhet të jenë konform standardeve ISO/EN ose, në mungesë të tyre, të standardeve dhe rregullave teknike kombëtare që lidhen me to (shih 3.1.3). Nëse është e domosdoshme, duhet të prodhohen dhe të kihet në përdorim elemente speciale që lejojnë zgjerimin ose zvogëlimin e sistemit, në një sistem që mund të përdoret ndryshe.

### 2.2. Rregulla plotësuese

#### 2.2.1 Parandalimi i dëmtimeve

Në rastet kur materialet e përdorura gjatë zbatimit të sistemit të kanalizimit (si për shembull ngjitës ose tretës), mbartin rrezikun e helmimit ose të ndezjes, duhet të merren masa në përputhje me rregulloret përkatëse, për të siguruar mbrojtjen e punëtorëve në kantiere ose në reparatet e prodhimit.

#### 2.2.2 Kontrolli i cilësisë

Prodhimi dhe kontrolli i elementeve përbërëse të tubacioneve të largimit duhet të jetë i tillë që cilësia dhe karakteristikat e tyre të jenë të qëndrueshme dhe t'i korrespondojnë kërkesave (shiko 3.3).

#### 2.2.3 Montimi

Montimi i elementeve përbërëse të sistemit duhet të jetë i thjeshtë dhe i sigurt në kushtet e zbatimit të tyre në kantier. Në masën që do të jetë e domosdoshme, prodhuesi duhet të marrë masa për të përgatitur montatorë të specializuar, si dhe për t'i pajisur me mjetet e nevojshme.

#### 2.2.4 Ndryshueshmëria e ndërsjellë

Programi i zbatimit të kanalizimeve duhet parashikuar në atë mënyrë që montimi i materialeve të ndryshme përbërëse të mos kërkojë përdorimin e pjesëve ndërmjetëse. Prandaj është e domosdoshme të merret në konsideratë dhe të shqyrtohet përputhshmëria kimike e materialeve të ndryshme. Nëse nuk është i mundur një bashkim direkt, duhet të parashikohen pjesë për bashkimin e tubave dhe rakorderive të tipeve të tjera.

## PJESA E TRETË PËRCAKTIMI I KARAKTERISTIKAVE

### 3.1 Prova të përgjithshme

#### 3.1.1 Aftësia mbajtëse

Konrolli i aftësisë mbajtëse në tërësi kryhet për çdo diametër nominal mbi elementet e montuara të paraqitura në formë skematike në figurën 3. Këto të fundit duhet të jenë të tilla që vlera e moszgjatimit  $\alpha^*$  dhe e deformimit  $\sigma^{**}$  t'i korrespondojnë së paku vlerave minimale të vendosura për bashkimet relative.

---

\*  $\alpha$  min = 2.861° (tag  $\alpha$  = 0,05) për diametra nominalë < DN 200;  $\alpha$  min = 1.718° (tag  $\alpha$  = 0,03) për diametra nominalë > DN 200 deri  $\geq$  DN 500.

\*\*  $\sigma$  min = 2 mm, nëse dimensionet e tubit e lejojnë këtë vlerë.






Fig.3

### 3.1.1.1 Bashkimi i tubacioneve (fig.3)

Montimi përfshin tri pjesë tubash dhe dy xhuntime (bashkime). Tubat e përdorur nuk duhet të kalojnë maksimumin e ovalitetit të pranuar (sipas limiteve të përcaktuara për materialin e përdorur). Montimi duhet të realizohet në tri mënyra të ndryshme:

E para - akset e tubacioneve janë në vijë të drejtë.

E dyta - aksi i tubit kryesor është i devijuar në një plan vertikal me një vlerë  $\sigma$  në raport me akset e tubave të tjerë.

E treta - aksi i tubit qendror krijon një kënd  $\alpha$  me akset e tubave të tjerë.

### 3.1.1.2 Bashkimi tub-rakorderi

Montimi përfshin një element të tubit dhe një rakorderi që sjell një bashkim.

Rakordi duhet të jetë i manovrueshëm në ekstremitetet e tubit <sup>(8)</sup>.

### 3.1.1.3 Aftësia mbajtëse e gazrave (erërave)

Si rregull i përgjithshëm, bashkimet me prezencë ujërash të ndryshme kanë edhe prezencë gazrash. Sidoqoftë, është e nevojshme të verifikohet kjo prezencë në rastin e bashkimeve me xhunto të paraformuara në elastomeri të barabarta me ato të përshtatura për kolektorët e shkarkimeve individuale të vaskave të ËC dhe urinoreve, si dhe në rastin e kontrolleve të pajisjeve dhe sifonëve të pozicionuar brenda muraturës ose dyshemesë në një fazë të dytë. Në këtë rast duhet të aplikohet metoda e mëposhtme e provave:

- mbyllja e ekstremiteteve të elementeve të përdorura;
- lyerja me ujë me sapun e pjesëve bashkuese mashkull-femër të tubave;
- aplikimi me progresion kostant të një presioni ajri prej 0,01 bar;
- mbajtja e presionit për 1 minutë;
- verifikohet nëse në xhuntot e bashkimit vërehen shfryrje që dallohen nga fluckat që krijohen.

Prova vlerësohet e kënaqshme në qoftë se nuk krijohen bulëza ajri në vendet ku janë bërë bashkimet e xhuntove.

#### 3.1.1.4 Aftësia mbajtëse ndaj ujit:

- mbyllet ekstremitetet e tubave të montuar;
- rimbushen me ujë tubat e montuar dhe largohet ajri nga pjesa e sipërme e tubit;
- aplikohet presion prej 0,5 bar sipas grafikut të paraqitur në fig.4, duke e rritur gradualisht dhe pa goditje në 15 minuta dhe duke mbajtur këtë presion për 15 minuta;
- shënohen humbjet eventuale që çfaqen në formë bulëzash uji përgjatë xhuntove;




Fig 4.

#### Shënim

Në montimin e paraqitur sipas fig.4, mbajtja e presionit në fund të provës kontrollohet gjithashtu duke manovruar rakordet në ekstremitetet e tubave. Prova konsiderohet e kënaqshme nëse nuk do të ketë humbje uji në vendet e bashkimit të xhuntove.

#### 31.2 Paraqitja

Është e nevojshme të vërohet paretet e brendshme dhe të jashtme të tubave dhe rakordeve me një ndriçues të përshtatshëm (ose p.sh. kundërdritë).

Duke pasur parasysh materialet e përdorura, duhet verifikuar parregullsitë e sipërfaqeve dhe e faqeve fundore që janë të rëndësishme për të përcaktuar cilësinë e tubave dhe që kanë ndikim në funksionimin e sistemit.

#### 3.1.3 Dimensionet

Kontrolli i dimensioneve dhe në veçanti ai i dimensioneve funksionale duhet të bëhet për çdo diametër nominal për 10 tuba ose për 10 rakorde (duke zgjedhur sipas dëshirës 5 bëryla ose 5 rakorde në formë T-je). Saktësia e matjeve duhet të jetë 0,1 mm.

Dimensionet e përcaktuara në këtë formë duhet të jenë konform me dimensionet e ndryshme dhe tolerancat e deklaruara nga kërkuesi dhe në përputhje me standardet ose rekomandimet e ISO/EN dhe në mungesë të tyre me standardet kombëtare.

#### 3.1.4 Rezistenca ndaj nxehtësisë

Në pritje që kërkimet e tanishme të përcaktojnë qartë një provë të përbashkët për qëndrueshmërinë e sistemit të kanalizimeve për derdhjet me temperaturë, janë vendosur provizorisht dy metoda provash A dhe B sipas përcaktimeve të mëposhtme.

##### 3.1.4.1 Metoda A

Për realizimin e kësaj prove duhet montuar një sistem sipas figurës 5 dhe duke e ngarkuar si më poshtë:

- 30 l/min, +95°C për një minutë;
- 1 minutë pushim;
- 30 l/min nga + 10 °C deri në 15°C (ujë rubineti) për 1 minutë.
- 1 minutë pushim.

Ky cikël duhet të përsëritet 1500 herë (100 orë gjithsej). Përveç kësaj, pas ciklit të fundit

duhet kryer një qarkullim uji me temperaturë 95°C për një kohë prej 20 minuta. Në vazhdim duhet mbushur me ujë nga sistemi duke e mbajtur nën vrotim për 15 minuta (prova e aftësisë mbajtëse), e nevojshme të matet treguesi i shigjetës h.




Fig.5 Tubacioni vendoset përballë në një mur fiks ose në një strukturë dhe montohet me qafore fiksuese. Vendosja e qaforeve ose e mbajtëseve të tjera bëhet sipas udhëzimeve të montimit. Kalimi i ujit të mbinxehur bëhet direkt pa dispozitiv të ndërmjetëm për ftohjen e tij. Në rastin e një tubacioni pa mundësi bymimi ose tkurrjeje të pjesëve të bashkuara, është e nevojshme të vendosen pjesët e nevojshme për efekte diletacioni.

#### 3.1.4.2 Metoda B

Prova kryet me një nga katër llojet e rakordeve A në skemën e montimit të paraqitur në figurën 6 në kushtet e mëposhtme:

a) kontrollohet aftësia mbajtëse e bashkimit me një provë të kryer me ajër me një presion prej 0.01 bar dhe një provë tjetër me ujë me presion 0.5 bar.

b) kryet cikli i provës 5 herë vazhdimisht:

- qarkullimi i ujit në 95°C për 15 minuta (prurje e njëjtë me 18 l/min);

- menjëherë pas kësaj, qarkullim i ujit të ftohtë ( $15 \pm 5^\circ\text{C}$ ) për 10 minuta prurja e njëjtë me 18 l/min.




Fig 6

Pas 5 cikleve kontrollohet përsëri mbajtja e presionit në bashkueset e ajrit me presion 0.01 bar dhe me ujë me presion 0.05 bar.

Për bashkimet me xhunto zgjatuese (teleskopike) duhet vepruar me tuba të cilët kanë kokë bashkuese ose me rakorde me kokë mashkull.

SIMBOLI	POZICIONI I TUBACIONIT	DIAMETRI NOMINAL DN	DISTANCA MBËSHTETËSE		
			CD 1	CD2	CD3
D1	HORIZONTAL	40	(*)		
		50	(*)		
D2	VERTIKAL	70		2M	
		100		2M	
		150		2M	
D3	HORIZONTAL	70			( <sup>1</sup> )
		100			( <sup>2</sup> )
		150			( <sup>3</sup> )

Rezultatet e provave me metodën A dhe B do të konsiderohen të kënaqshme nëse nuk rezulton asnjë humbje gjatë provës për aftësi mbajtëse, përpara dhe prapa goditjeve termike. Pas montimit, asnjë element nuk duhet të paraqesë ndryshime dimensionesh ose dëmtime të tjera që mund të dëmtojnë funksionimin dhe jetëgjatësinë; për bashkuesit e tipit zgjatues (teleskopike) me bashkuese unazore, kokat bashkuese nuk duhet të paraqesin pas zmontimit asnjë shenjë të lënë nga unaza.

### 3.1.5 Rezistenca kimike

Si rregull, në përgjithësi ujërat e përdorimit shtëpiak nuk përmbajnë substanca agresive. Më poshtë po paraqesim një analizë tipike të ujit të përdorimit shtëpiak.

PËRBËRËSIT	MG/L
POLISAHARIDE (AMIDE, CELULOZË, ETJ.)	50
STEARATE NATRIUMI	32
ACETAT NATRIUMI	56
TRI - STEARAT I GLICERINËS	15
URE	13
SULFAT AMONIAKAL	70
PROTEINA	90

Kërkohet që tubacionet e përbëra nga materiale të treguara sipas klasifikimit në 1.3, të jenë rezistente ndaj substancave të sipërpërmendura.

Përsa i përket tubave dhe rakordeve të përbëra nga materiale të tjera, ato duhet të vihen në dalje në kontakt me ujëra me përmbajtje të njëjtë si më sipër.

### 3.2 Prova specifike që lidhen me materialet

Prova të tjera për të përcaktuar llojin e materialit jepen në rregullore dhe udhëzime (direktiva) të veçanta.

### KONTROLI I CILËSISË

#### 3.3 Të përgjithshme

Me kontroll të cilësisë kuptohet si autokontrolli i prodhuesit, ashtu edhe mbikëqyrja nga një institucion i pavarur për të verifikuar përputhshmërinë me rregullat e treguara në pjesën e dytë të këtij udhëzimi. Prodhuesi duhet të ketë pajisjet e nevojshme për kontrollin e lëndës së parë që përdoret për prodhim, si dhe duhet të ndjekë kolaudimin e prodhimeve që shpërndahen.

#### 3.4 Autokontrolli

Prodhuesi duhet të kontrollojë në çdo njësi prodhimi cilësinë e elementeve të sistemit të tij të shkarkimit. Për këtë duhet që vazhdimisht të kryejë provat e treguara në 3.1.2 dhe 3.1.3.

1.2 Rrethimi i kantierit bëhet në përputhje me kushtet urbane, të përcaktuara nga organi i autorizuar.

1.3 Në vende të dukshme në kantier vendoset tabela e identifikimit të punimeve me të dhënat për objektin, destinacionin, lejen e ndërtimit, investitorin, subjektin projektues e mbikëqyrës dhe afatet e ndërtimit.

2. Përgjegjësi teknik i kantierit verifikon saktësinë e lidhjes së objektit me terrenin dhe të piketimit të tij. Ai është përgjegjës për zbatimin e përpiktë të projektit, sipas vizatimeve, përshkrimeve teknike e ndryshimeve të miratuara prej tyre, në përputhje me kërkesat e kushteve teknike të zbatimit, në fuqi, me specifikimet teknike të kontratës dhe sipas radhës teknologjike të punimeve.

2.1 Drejtori i punimeve njofton menjëherë mbikëqyrësin e punimeve për pasaktësitë, mospërputhjet, mungesat e të dhënave në vizatimet, përshkrimet e specifikimet teknike, paraqet propozimet e veta dhe pret udhëzimet e tij.

Mungesat, pasaktësitë a mospërputhjet nuk përbëjnë shkak për zgjidhje arbitrare apo justifikim të difekteve në punime.

3. Materialet dhe produktet e ndërtimit me standarde të detyrueshme vendosen në vepër kur janë shoqëruar me certifikatë cilësie, me rezultatet e provave dhe të analizave, që vërtetojnë ose vlerësojnë përputhshmërinë e tyre me standardet, që referohen në përshkrimet dhe specifikimet teknike.

3.1 Materialet dhe produktet e ndërtimit, që përdoren në punimet e ndërtimit, duhet të jenë të reja, të papërdorura dhe pa difekte nga veprimet ose mosveprimet e sipërmarrësit.

3.2 Përgjegjësi teknik i kantierit, për materialet me standarde të detyrueshme, merr kampione dhe njihet me rezultatet e testimit të tyre. Kur rezultatet janë më të ulëta se kërkesat e projektit dhe se standardet, projektuesi dhe investitori njofton menjëherë për vlerësimin e pasojave dhe korrigjimin e difekteve.

3.3 Kur kantieri prodhon vetë materiale e produkte ndërtimi, me standarde të detyrueshme, duhet të jetë i pajisur me leje nga organi i autorizuar. Edhe për këto materiale veprohet njëjloj sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.2 të këtij kreu.

3.4 Materialet dhe produktet e ndërtimit, që nuk pranohen nga mbikëqyrësi i punimeve, sepse nuk plotësojnë kërkesat e projektit dhe të kontratës, nuk vendosen në objekt.

4. Punimet e ndërtimit, që kanë të bëjnë me sigurinë e jetës e të shëndetit të njerëzve dhe mbrojtjen e mjedisit, merren në dorëzim me kontroll të dokumentuar në faza të ndërmjetme, sipas rregullave që përcaktohen në kushtet teknike të zbatimit.

Në planin e veprimit përcaktohen punimet, kontrolli i të cilave bëhet në prani të përfaqësuesve të investitorit dhe të subjektit projektues.

4.1 Mbikëqyrësi i punimeve njofton sipërmarrësin për difektet e vëna re dhe kohën e korrigjimit të tyre. Punimet me difekte nuk pranohen dhe nuk financohen deri në korrigjimin e tyre.

4.2 Punimet me difekte të pakorrigjuara, që nuk cenojnë sigurinë e veprës dhe pranohen nga investitori, financohen me çmime të reduktuara. Masa e reduktimit parashikohet në kontratë.

5. Sistemet e infrastrukturës (elektrike, ujë-gaz-ajërsjellës, kanalizim, sinjalizim, ngrohje-ventilim etj), të izolimit (nga uji-nxehtësia-zëri), të transportit (ashensorë, transportatorë etj.), të mbrojtjes nga zjarri a çdo sistem tjetër i lidhur në mënyrë të qëndrueshme me punimet e ndërtimit, merren në dorëzim pasi provohen pangarkesë, në përputhje me kushtet teknike në fuqi.

5.1 Provat pa ngarkesë kryhen nga sipërmarrësi në prani të përfaqësuesve të investitorit dhe të subjektit projektues. Ato dokumentohen në procesverbal, ku evidentohen metoda dhe ecuria e provës, të metat e vëna re e korrigjimet e tyre, si dhe parametrat e arritura.

6. Sipërmarrësi dhe drejtuesit e kantierit janë përgjegjës, sipas përkatësisë, për tërësinë e masave organizative, teknike e teknologjike, ekonomike e financiare, higjienike e mjedisore për

zbatimin e legjislacionit të punës e atë teknik, që garantojnë kryerjen e punimeve të ndërtimit në objekt dhe atyre ndihmëse në kantier, në kushte të sigurta për jetën e shëndetin e njerëzve dhe mbrojtjen e mjedisit.

6.1 Sipërmarrësi detyrohet të sigurojë në kantier:

- a) punëmarrës të aftë, të kontrolluar për shëndetin, me leje për ushtrim profesionale të veçanta (dëshmi, leje, autorizime), nga organet e autorizuar me ligj;
- b) materiale, pajisje, mjete mbrojtëse, kolektive e individuale, dhe tabela paralajmëruese;
- c) mbrojtjen e detyrueshme të skelave, të daljeve të jashtme të objektit, si dhe mbrojtjen e mekanizmave e të pajisjeve nga goditjet e rrymave elektrike;
- ç) mirëmbajtjen dhe kontrollin periodik të makinerive e të mekanizmave të instaluar në objekt, për punë pa rrezik;
- d) punonjës të kualifikuar dhe të autorizuar prej tij për instruktimin teknik dhe mbrojtjen në punë;
- dh) rregullore, urdhra e udhëzime në fuqi, për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë;
- e) librin e instruktimit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë të punëmarrësve.

6.2 Përgjegjësi teknik i kantierit ka këto të drejta dhe detyra:

- a) Të instruktojë dhe riinstruktojë të gjithë punonjësit, çdo fillim muaji, në përputhje me programin mujor të punës;
- b) Të instruktojë, veçanërisht, punonjësit e rinj, që fillojnë punë për herë të parë, skuadrat e individëve, që vijnë rishtaz në kantier, që fillojnë një proces të ri pune apo që vendosen në punime të veçanta me shkallë vështirësie;
- c) Të largojë menjëherë nga puna çdo punëmarrës, që nuk zbaton masat e sigurimit teknik e të mbrojtjes në punë, si dhe të pezullojë punën kur nuk garantohen masat mbrojtëse;
- ç) Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe të mekanizmave nga manovratorë të paaftë;
- d) Të hartojë aktin e marrjes në dorëzim të skelave të jashtme.

7. Drejtori i punimeve, sa herë që kërkohet, vë në dispozicion të mbikëqyrësit librin e kantierit, dokumentacionin e kontabilitetit teknik e të furnizimit të objektit me materiale e produkte ndërtimi, bën njoftime brenda kohës së duhur për inspektimin e punimeve të maskuara, për marrjen e kampionëve, kryerjen e provave, të analizave që parashikohen në rregullat teknike ose kërkohen shtesë nga mbikëqyrësi, paraqet fotografitë, kasetat filmike dhe çdo dokument tjetër, që provon saktësinë dhe cilësinë e produkteve e të punimeve.

7.1 Drejtori i punimeve, me urdhër të mbikëqyrësit, prish dhe ribën me shpenzimet e sipërmarrësit, brenda periudhës së korrigjimit të difekteve, punimet që rezultojnë me shkelje të kushteve teknike të zbatimit, standardeve e specifikimeve teknike, përshpejton kryerjen e punimeve tej grafikut dhe kohës normale të punës, pa asnjë kompensim, në raste të veçanta.

7.2 Mbikëqyrësi njofton vazhdimisht sipërmarrësin për porositë, urdhrat dhe udhëzimet e dhëna në ditarin e objektit, në zbatim të kontratës së punimeve dhe gjatë kolaudimit.

7.3 Sipërmarrësi siguron mjediset e përshtatshme dhe pajisjet e nevojshme për mbikëqyrësin, bashkëpunon për çmimet e reja të punimeve, që nuk përfshihen në kontratë e kërkesë-propozimet për ndryshimet e saj, si dhe merr prej tij aktin e përfundimit të punimeve e rezervat që do të parashtrihen për punimet gjatë kolaudimit.

8. Punimet e përfunduara dhe të marra në dorëzim në kantier paraqiten nga sipërmarrësi në situacione pjesore, sipas periudhave progresive të zhvillimit të punimeve, dhe në atë përfundimtar.

8.1 Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës.

8.2 Situacionet financohen nga investitori sipas kushteve që parashikohen në kontratë (sigurimi i kantierit, garancia e kontratës dhe e punimeve, paradhënia, periodiciteti, afatet e pagesës, ndalesat për vonesat, difektet e pakorrigjuara, gjobat), pasi kontrollohen e pranohen paraprakisht nga mbikëqyrësi i punimeve.

8.3 Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë.

8.4 Një pjesë e vlerës së përgjithshme të situacionit përfundimtar financohet, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, pas periudhës së garancisë së punimeve.

9. Në rastet kur sipërmarrësi nuk është në gjendje të respektojë afatin e kryerjes së punimeve për shkaqe që nuk varen prej tij, ai i paraqet mbikëqyrësit, të paktën dy muaj para përfundimit të afatit, një kërkesëpropozim për shtyrje afati dhe seksionit përkatës të urbanistikës një kërkesë për zgjatjen e afatit të lejës së ndërtimit.

9.1 Kushtet dhe detyrimet e palëve për ndërprerjen e punimeve përcaktohen në kontratë.

Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të ndërpresë punimet për arsye të ndikimit të kushteve klimatike në to, kundrejt një zgjatjeje korresponduese të afatit.

Ndërprerja ose zgjatja e punimeve, si pasojë e rezultatit të provave, nuk përbën shkak për zgjatjen e afatit të ndërtimit.

10. Mbikëqyrësi, me kërkesë të sipërmarrësit, vërteton në procesverbal datën e përfundimit të punimeve, sipas projektit, të ndryshimeve të urdhëruara e kushteve të kontratës.

10.1 Investitori ka të drejtë të organizojë kolaudimin paraprak të punimeve me ekspertë, përfitues e persona të tjerë të interesuar, që, së bashku me kolaudatorin, përcaktojnë detyra për riparimin e të metave dhe mënjanimin e mangësive në zbatim, si dhe propozojnë periudhat e garancisë së punimeve e të kolaudimit të riparimeve, financimin përfundimtar e garancinë për punimet.

Kolaudimi i objektit fillon jo më vonë se një muaj nga data e përfundimit të punimeve.

10.2 Sipërmarrësi është përgjegjës për drejtimin, mbajtjen në gatishmëri, riparimin, mirëmbajtjen, ruajtjen e punimeve të ndërtim-montimit të objektit e të kantierit, deri në nënshkrimin e procesverbalit të kolaudimit. Objekti merret në dorëzim në datën e nënshkrimit të procesverbalit të kolaudimit.

10.3 Sipërmarrësi, jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të procesverbalit të kolaudimit, heq ndërtimet e përkohshme dhe realizon punimet përfundimtare të sistemimit.

### KREU III DOKUMENTACIONI TEKNIK I PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

1. Gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në kantier hartohet e grumbullohet dokumentacioni teknik, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, i cili përmban:

a) Dokumentacionin topografik të faktit për vendosjen e objektit e të rrjeteve të infrastrukturës, për lidhjen e themeleve e të bazamenteve me tabanin, për kontrollin në plan e lartësi të objektit, të strukturave mbajtëse etj.

b) Dokumentacionin teknik për kontrollin dhe marrjen në dorëzim të strukturave, proceseve të ndërmjetme e rrjeteve, përpara se ato të bëhen të fshehta, të punimeve të montimit të strukturave, makinerive e pajisjeve teknologjike, provave pa ngarkesë, rezultateve dhe ndreqjes së të metave.

c) Dokumentacionin e vlerësimit dhe të vërtetimit të konformitetit të materialeve dhe produkteve, që hyjnë në procesin e ndërtimit.

2. Puna e kryer dhe çastet më të rëndësishme gjatë ndërtimit të objektit pasqyrohen në librin e kantierit, që mbahet në formën e ditarit të objektit e të raportit të punimeve.

2.1 Ditari i objektit pasqyron ngjarjet më të rëndësishme gjatë ecurisë së punimeve, deri në fund të periudhës së garancisë së tyre. Në të pasqyrohen ndryshimet e urdhëruara të projektit, testimet dhe rezultatet, masat suplementare për ndreqjen e difekteve dhe rastet kur punimet kryhen në kushte të veçanta.

2.2 Raporti ditor i punimeve jep të dhëna për motin, temperaturat, punimet e kryera, burimet njerëzore e teknike të përdorura, kontrollet për sasinë dhe cilësinë e punës së kryer, difektet e korrigjimet e tyre, punimet dhe proceset e ndërmjetme, marrë në dorëzim nga zbatuesi.

2.3 Ditari mbahet një i vetëm për objektin, ndërsa raporti ditor mbahet i veçantë për çdo nënobjekt, nënsipërmarrës e zbatues.

3. Libri i instruktimit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë hapet menjëherë me fillimin e punimeve dhe mbahet në çdo kantier ose objekt, sipas përcaktimit që bën sipërmarrësi. Në

libër pasqyrohen procesverbalet e instruktimit, emrat e punonjësve të instruktuar, atyre të aksidentuar, mbledhjet për sigurimin dhe mbrojtjen në punë, kontrollet, detyrat dhe masat e marra për zbatimin e tyre.

Udhëzimet për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë mbështeten në legjislacionin e punës dhe rregullat në fuqi.

4. Libri i masave mbahet për çdo objekt e nënobjekt, që ka preventiv dhe është dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve, gradualisht me zhvillimin e tyre.

5. Në regjistrin e kontabilitetit teknik në kantier pasqyrohen puna dhe materialet e përdorura në vepër, në përputhje me kërkesat e akteve, ligjore e nënligjore në fuqi.

6. Dokumentacioni teknik i kantierit vihet në dispozicion të personave që janë të autorizuar të kontrollojnë zbatimin e punimeve në objekt.

6.1 Libri i kantierit dhe i instruktimit për sigurimin teknik përbëhet nga fletë të numëruara e të vulosura nga sipërmarrësi.

6.2 Personat e autorizuar të investitorit, sipërmarrësit, administratës publike, që kane të drejtë kontrolli, shënojnë në librin e kantierit dhe në atë të instruktimit vërejtje për zbatimin e punimeve, akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe lënë detyra e kontrollojnë zbatimin e tyre.

Drejtuesit e kantierit marrin masa për ndreqjen e të metave dhe bëjnë shënimet përkatëse në libër.

7. Në rastet kur ndryshohet përgjegjësi teknik i punimeve në kantier, dokumentacioni teknik i hartuar dhe i grumbulluar si më lart i dorëzohet përgjegjësit pasardhës, në prani të sipërmarrësit dhe kjo pasqyrohet në ditarin e objektit.

8. Zbatuesi i punimeve, bazuar në dokumentacionin teknik të grumbulluar e përpunuar, në ndjekjen dhe kontrollin e punimeve harton deklaratën teknike për punimet e sipërmarrjes, e cila nënshkruhet nga drejtuesit teknikë e ligjorë të sipërmarrësit, përgjegjësi teknik i punimeve në kantier dhe i dorëzohet mbikëqyrësit, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i punimeve.

8.1 Në deklaratën teknike përcaktohet se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin e zbatimit, ndryshimet e miratuara dhe kushtet teknike të detyrueshme për zbatim, dhe se është ndërtuar tërësisht dhe nuk ka shmangie në drejtim të qëndrueshmërisë statike, funksionit e kushteve urbane, strukturat mbajtëse janë ndërtuar ose montuar me materiale e produkte ndërtimi të parashikuara në projekt, brenda standardeve e kushteve në fuqi, rrjeti i infrastrukturës, makineritë e pajisjet janë provuar dhe plotësojnë parametrat e parashikuara etj.

9. Në kantierin e punimeve krijohet e plotësohet gradualisht dosja teknike e objektit, ku sipas problematikës, mbahen:

a) Dokumentacioni administrativo-ligjor për sipërmarrësin, si person juridik, dhe sheshin e ndërtimit;

b) Projekti i zbatimit, përditësimet e ndryshimet, të miratuara gjatë zbatimit të punimeve, përshkrimet dhe specifikimet teknike;

c) Preventivi i punimeve, sipas llojeve e zërave në sasi të e çmimet përkatëse dhe ndryshimet e tij;

ç) Studimet inxhinierike për ndërtimin e objektit dhe përditësimet gjatë zbatimit të punimeve;

d) Dokumentacioni teknik për punimet topografike, për punimet që bëhen të maskuara, për punimet e proceset e ndërmjetme, që merren në dorëzim, për provat pa ngarkesë të sistemeve, për ndreqjet e të metave gjatë periudhës së garancisë së punimeve;

dh) Certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre;

e) Projektorganizimi i punimeve;

ë) Kushtet e përgjithshme e të veçanta të kontratës së sipërmarrjes;

f) Libri i kantierit, i sigurimit teknik e mbrojtjes në punë dhe libri i masave;

g) Regjistri i kontabilitetit;

gj) Deklarata teknike e punimeve.

9.1 Dosja teknike e objektit, pas kolaudimit të punimeve, i dorëzohet sipërmarrësit dhe ruhet në arkivin teknik të tij.

9.2 Investitori dhe mbikëqyrësi i punimeve krijojnë dosjen teknike të përbashkët, e cila arkivohet pranë investitorit.

9.3 Dosja teknike e objektit është dokument i rëndësisë së veçantë dhe ruhet sipas afateve të caktuara me ligj.

#### KREU IV TË TJERA

1. Ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, kur është e nevojshme, nxjerr norma e rregulla për mbajtjen e dokumentacionit teknik dhe organizimin e kantierit.

2. Ky udhëzim zbatohet edhe për punimet e ndërtimit me financime të huaja, për aq sa nuk bie në kundërshtim me kushtet e marrëveshjeve në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Fatos Nano

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.35, faqe 1298*

#### VENDIM Nr.514, datë 15.8.2007

#### **PËR INFORMATIZIMIN E LLOGARITJES SË KOSTOS DHE HARTIMIN E MANUALEVE TEKNIKE TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, të neneve 10 e 17 të ligjit nr.8464, datë 11.3.1999 “Për standardizimin”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Unifikimin e metodologjisë së llogaritjes dhe të formatit të paraqitjes së preventivave e të analizës së kostos për punimet e ndërtimit, sipas programeve kompjuterike të miratuara për lehtësimin e veprimtarisë së subjekteve, që zhvillojnë veprimtari në këtë fushë, lehtësimin e kontrollit tekniko-financiar të punimeve të ndërtimit dhe shmangien e informalitetit në veprimtarinë prodhuese, në tregun e ndërtimeve në Shqipëri.

2. Hartimi i çdo preventivi në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona, fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, vendas ose të huaj, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhet në përputhje me këtë vendim.

3. Metodologjia e llogaritjes së kostos, sipas këtij vendimi, është pjesë e dokumentacionit të çdo prokurimi, me fonde publike, në fushën e projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe e kontabilitetit teknik për çdo punim ndërtimi.

4. Nëse nuk përcaktohet ndryshe, termat e përdorura në këtë vendim kanë kuptimin, si më poshtë vijon:

a) punime ndërtimi, quhen të gjitha punimet e ndërtimit, sipas përkufizimit të bërë në kreun I të udhëzimit nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave;

b) subjekt licencues, është organizmi shtetëror, që pajis me licencë, teknike ose tatimore, subjektet private apo publike, që veprojnë në fushën e tregtimit të materialeve të ndërtimit dhe/ose të ndërtimit;



c) subjekt ndërtues, është subjekti i licencuar, që realizon një ose më shumë zëra pune, në zbatimin e punimeve të ndërtimit;

ç) subjekte deklaruese, janë të gjitha subjektet, private dhe/ose publike, që kryejnë veprimtari në fushën e prodhimit të materialeve të ndërtimit, të tregtimit të tyre ose në fushën e ndërtimit, sipas përkufizimit të bërë në kreun I të udhëzimit nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave dhe që, në bazë të këtij vendimi, detyrohen të paraqesin formularët e deklarimit të çmimit të materialeve të ndërtimit, që tregtojnë dhe/ose të zërave të punimeve të ndërtimit, që kryejnë;

d) program i miratuar për analizën e kostos, është çdo program kompjuterik, i certifikuar nga këshilli teknik i Institutit të Ndërtimit (IN), i miratuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, i cili është i regjistruar në Drejtorinë e Patentave dhe të Markave;

dh) manuali teknik i çmimeve për punimet e ndërtimit ose thjesht manuali i çmimeve të ndërtimit, është buletini periodik i çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe i analizave teknike të çmimeve, i detyrueshëm për zbatim, sipas pikës 2 të këtij vendimi;

e) buletini i çmimeve të materialeve të ndërtimit, është buletini periodik i çmimeve të materialeve të ndërtimit dhe i produkteve për ndërtim, të ofruara nga tregu përkatës, brenda vendit;

ë) formularë deklarimi, janë formularët, që plotësohen dhe dorëzohen çdo tre (3) muaj, nga subjektet deklaruese, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit, si dhe në fushën e ndërtimit e që mundësojnë administrimin e të dhënave, për llogaritjen e kostos së punimeve të ndërtimit. Formularët e deklarimit duhet të përmbajnë:

i) Për prodhuesit e materialeve të ndërtimit, në përputhje me licencën, që zotërojnë:

- analizën tekniko-financiare të prodhimit;
- skedën teknike të çdo materiali (analizat laboratorike);
- emrin dhe kodin e saktë të çdo materiali, sipas standardit të referimit;
- çmimin përkatës të çdo materiali.

ii) Për importuesit e materialeve të ndërtimit:

- skedën e teknike të çdo materiali, të importuar, sipas standardit të vendit të origjinës;
- emrin dhe kodin e saktë të çdo materiali, sipas standardit të referimit;
- çmimin përkatës të çdo materiali.

iii) Për ndërtuesit, që përdorin materialet e ndërtimit, sipas përdorimeve përkatëse:

- analizën tekniko-financiare të zërit të punës;
- specifikimet teknike të materialeve dhe të teknologjisë së përdorur.

f) materiale ndërtimi janë të gjitha materialet, që përdoren në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përfshirë lëndën e parë dhe materialet ndihmëse, në përputhje me standardet e miratuara dhe/ose në përputhje me direktivën europiane për produktet e ndërtimit.

5. Për përditësimin e analizave teknike të çmimeve dhe të manualeve të çmimeve për punimet e ndërtimit, në përputhje me metodologjinë dhe formatin e miratuar e të informatizuar, pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit krijohet Sektori i Standardizimit të Kostos (SSK). Ky sektor përbëhet nga 4 veta, nga të cilët, njëri me profesion "inxhinier ndërtimi", caktohet përgjegjës dhe 3 specialistë, nga të cilët 1 ekonomist, 1 inxhinier ndërtimi dhe 1 inxhinier mekanik.

6. Misioni dhe detyrat e SSK-së përcaktohen në rregulloren e brendshme të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, ku, përveç të tjerave, ky sektor kryen edhe detyrat, sa më poshtë vijon:

- administron programin e miratuar, duke respektuar të drejtën e autorit;
- administron formularët e vetëdeklarimeve dhe pasuron bazën e të dhënave të manualit;
- përditëson dhe pasuron manualet teknike të çmimeve të ndërtimit, përfshirë analizat teknike të tyre, si dhe buletinin e çmimeve të materialeve të ndërtimit, me të dhënat e përftuara nga administrimi i vetëdeklarimeve;

- informatizon të dhënat e përftuara nga formularët e vetëdeklarimeve, për krijimin në manual të kodit përkatës, për çdo material ndërtimi dhe për çdo proces pune ndërtimi, si dhe për përfshirjen e zërave të rinj të punimeve, jo më vonë se 10 ditë nga data e paraqitjes së tyre;

- boton buletin e çmimeve të materialeve të ndërtimit dhe manualin teknik të çmimeve të ndërtimit dy herë në vit respektivisht, jo më vonë se data 30 prill dhe 31 tetor, të çdo viti;
- ndërton dhe administron sistemin “on-line” të buletinit të çmimeve të materialeve të ndërtimit dhe të manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, duke e pasuruar atë në mënyrë të vazhdueshme me materialet dhe produktet e reja të ndërtimit, si dhe me zërat e rinj të ndërtimit, që vetëdeklarohen nga subjektet deklaruese;
- informon të gjitha subjektet licencuese, edhe pa kërkesën e tyre, për respektimin e detyrimeve;
- bashkëpunon me organet tatimore përkatëse për sanksionet e vendosura ndaj subjekteve, që nuk kanë përmbushur detyrimet, sipas këtij vendimi;
- përfshin në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit dhe/ose në buletin e çmimeve të materialeve dhe produkteve për ndërtim të gjitha deklaratimet e subjekteve, jo më vonë se 10 ditë nga data e deklaratimit të tyre pranë SSK-së;
- njofton me shkrim, subjektin deklarues brenda 10 ditësh, nga data e vetëdeklarimit, për kodin përkatës në buletin e materialeve të ndërtimit ose për refuzimin e tij, në rast mospërputhshmërie me standardet në fuqi.

7. Të gjitha subjektet e licencuara private, që kryejnë veprimtari në tregtimin e materialeve të ndërtimit apo të produkteve për ndërtimin detyrohen të paraqesin çdo tre muaj, respektivisht, në fund të çdo tremujori, pranë degës së tatimeve, ku ata janë të regjistruar, listën e çmimeve të materialeve apo produkteve, që tregtojnë. Lista e çmimeve dorëzohet në afatet e caktuara për dorëzimin e deklaratimit të TVSH-së. Mosdorëzimi i listës së çmimeve dhe shitja e materialit në treg me çmim më të lartë se ai i deklaruar në listën e çmimeve dënohen, sipas përcaktimeve në udhëzimin nr.9, datë 25.6.2007 të Ministrisë të Financave.

8. Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit detyrohen të paraqesin pranë SSK-së analizat teknike dhe çmimet për çdo zë pune në ndërtim, për materialet e reja dhe/ose për teknologjitë e reja, të përdorura prej tyre, për të cilat nuk ekziston një analizë teknike e çmimit. Analizat teknike do të përgatiten në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave, duke përdorur programin e miratuar.

9. Preventivat, pa përjashtim, për objektet e reja, me financimin, publik ose privat, të projektuara nga subjekte, shtetërore apo private, që ushtrojnë veprimtari në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, bazuar në analizat teknike të çmimeve për punimet e ndërtimit, të përfshira në manual.

10. Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit e që marrin pjesë në tendera publike, detyrohen të paraqesin analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave.

11. Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë programime të fondeve, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të llogarisin çmimet e zërave të punës, për të përcaktuar vlerën limit të objektit, në bazë të manualit të miratuar të çmimeve të ndërtimit, mbështetur në analizat teknike të çmimeve.

12. Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të kontrollojnë çmimet për zërat e punës, të ofertave të paraqitura në tender, me çmimet e bazuara në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve, të llogaritura, me programin e miratuar.

13. Për të shmangur informalitetin dhe për të vënë në barazi ligjore të gjithë tatimpaguesit, të gjitha detyrimet tatimore ndaj shtetit dhe detyrimet e tjera, të lidhura me veprimtarinë ndërtuese, në fushën e ndërtimit, përfshirë sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, të llogariten sipas vlerave faktike të punimeve, të zbërthyera sipas strukturës së kostos, në përputhje me udhëzimin nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave, bazuar në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në

manualin e çmimeve të ndërtimit.

14. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ka detyrimin të botojë manualin e çmimeve të ndërtimeve dhe të analizave teknike të çmimeve çdo gjashtë muaj. Manualët e çmimeve dhe analizat teknike të tyre do të jenë të ndara sipas tri rajoneve kryesore të vendit, përkatësisht veri, qendër dhe jug.

15. Të gjitha subjektet deklaruuese janë të detyruara të depozitojnë pranë SSK-së formularët e parë të deklarimit dhe një kopje elektronike të tyre, jo më vonë se 2 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Formularët e deklarimit, në formatin standard, sipas udhëzimit përkatës, që do të nxjerrë Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, dorëzohen pranë degëve të tatimeve, ku subjektet deklaruuese janë të regjistruara, në të njëjtën datë me dorëzimin e formularëve të deklarimit të TVSH-së. Formularët e deklarimit, në format të shtypur, duhet të jenë të nënshkruar dhe të vulosur nga subjektet deklaruuese.

16. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të përcaktojë, me përzgjedhje, brenda muajit gusht 2007, programin e miratuar, që do të adoptohet për t'u përdorur nga institucionet shtetërore, për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve të çmimeve. Kriteret e përzgjedhjes do të miratohen nga Task-Forca, e ngritur me urdhrin nr.110, datë 12.7.2007 të Kryeministrit.

17. Ngarkohen të gjitha institucionet shtetërore të planifikojnë investimet për vitin 2008, në bazë të çmimeve, të përcaktuara në manualin teknik të çmimeve dhe të analizave teknike të tyre. Për këtë qëllim buletini i parë me çmimet e materialeve të ndërtimit dhe manuali i parë teknik i çmimeve për punimet e ndërtimit, përfshirë analizat teknike të tyre, të përgatiten dhe të dalin në qarkullim, jo më vonë se data 30 gusht 2007.

18. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

19. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.114, faqe 3264*

**VENDIM**  
**Nr.42, datë 16.1.2008**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES  
SË LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT  
TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË USHTROJNË VEPRIMTARI NDËRTIMI**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.406, datë 22.4.2009;  
ndryshuar me vendim të KM nr.835, datë 15.7.2009)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.9, faqe 257*

*Vendim i KM nr.406, datë 22.4.2009 botuar në Fletoren Zyrtare nr.68, faqe 3113*

*Vendim i KM nr.835, datë 15.7.2009 botuar në Fletoren Zyrtare nr.130, faqe 6088*

## **RREGULLORE**

### **PËR KRITERET, PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE QË USHTROJNË VEPRIMTARI NDËRTIMI**

#### **KREU I**

#### **QËLLIMI, FUSHA E VEPRIMIT TË RREGULLORES DHE PËRKUFIZIME**

##### **1. Qëllimi dhe fusha e veprimit:**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i organit përgjegjës, procedurave, kriterëve për licencimin profesional për subjektet juridike që kryejnë veprimtari zbatuese ndërtimi, kategorizimi i punimeve për këto subjekte, klasifikimi i tyre, si dhe përcaktimi i të drejtave e përgjegjësive që ka subjekti i pajisur me licencë.

Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik ose fizik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë pavarësisht formës së organizimit të tij.

Subjekte private a publike që kryejnë investime në ndërtime me fonde private ose prokurojnë me fonde publike kanë detyrimin për kontraktim vetëm me subjekte të licencuar, sipas kësaj rregulloreje.

##### **2. Përkufizime:**

Në kuptim të kësaj rregulloreje termat kanë këto kuptime:

“Komision” është struktura e posaçme administrative, që krijohet nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit e asistohet nga stafi përgjegjës për veprimtaritë e ndërtimit në ministri, që ka autoritetin e vetëm për dhënie, ndryshimin a revokimin e licencave profesionale të shoqërive apo vendosjen e penaliteteve për subjekte që kryejnë veprimtari në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, brenda sferës së përgjegjësive që i janë dhënë sipas kësaj rregulloreje, në fushën e zbatimit në ndërtim.

“Licencë profesionale” është leja për ushtrimin e aktivitetit në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim me të cilin ka detyrimin të pajiset çdo subjekt juridik/fizik, privat ose publik, që dëshiron të ushtrojë veprimtari në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim dhe plotëson kushtet për t'u pajisur me një të tillë.

“Formati i lejes” miratohet me urdhër të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe njoftohen menjëherë me shkrim të gjithë institucionet qendrore në varësi të ministrit a Kryeministrit, institucionet të pavaruara, kryesisë së qarqeve, si dhe publiku nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të ministrisë.

“Arsimi universitar përkatës” është arsimi në degën dhe specialitetin e caktuar në diplomën e universitetin përkatës.

“K.T.Z” - kushte teknike të zbatimit të punimeve.

“STASH” - standarde shtetërore.

“Punë Publike” konsiderohet veprimtaria për realizimin e një vepre publike në përputhje me përcaktimin e ligjit për prokurimin publik.

“QKR” - Qendra Kombëtare e Regjistrimit të subjekteve tregtare.

“Kategori” - puna në zbatim sipas llojit dhe nënlojit të objekteve, që ndërtohen ose që i shërbejnë objektit të ndërtuar.

“Klasifikim” klasifikimi i subjekteve juridikë/fizikë në nivele për çdo kategori punimesh.

“Drejtues ligjor”-personi fizik apo personat fizikë (administrator për sh.p.k., drejtor, presidenti për sh.a., personi fizik) të përcaktuar si të tillë nga vendimi i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit/ ose në gjykatë.

“Drejtues teknik”- individi/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që është/janë përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

## KREU II

### ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURËS PËRGJEGJËSE PËR DHËNIEN, NDRYSHIMIN APO REVOKIMIN E LICENCAVE PROFESIONALE

#### 1. Krijimi i strukturës përgjegjëse

a) Me urdhër të ministrit përgjegjës për punët publike krijohet struktura e posaçme e quajtur komisioni i posaçëm i dhënies së licencave profesionale.

b) Komisioni ka autoritetin përgjegjës për shqyrtimin, miratimin e licencimit, ndryshimit të klasifikimit të lejes profesionale dhe sipas rastit revokimit të kësaj lejeje.

Përfundim kryhet vetëm për përditësimin e ndryshimeve apo shtesave të drejtuesit ligjor, kohëzgjatjes, emërimit, selisë apo mbylljes së subjektit. Përditësimi kryhet nga sektori i licencimit në përputhje me afatet dhe procedurat e kësaj rregulloreje.

c) Në urdhrin e krijimit të komisionit përcaktohet përbërja (kryetar, nënkryetar, sekretar dhe anëtarë), kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë sipas kësaj përbërjeje, masa e shpërblimit për pjesëmarrje dhe mënyra e informimit/raportimit te ministri. Detyrën e sekretarisë së komisionit e kryen sektori përgjegjës për licencimet në ministri;

ç) Shpërblimi për pjesëmarrjen e anëtarit në mbledhjen e komisionit të jetë nga 3 deri 5% të pagës së Sekretarit të Përgjithshëm në ministri. Kur, brenda të njëjtit muaj kalendarik, anëtarët e komisionit ndjekin më shumë se 1 mbledhje shpërblimi mujor për anëtarin pjesëmarrës caktohet nga 6% deri 9% të pagës së Sekretarit të Përgjithshëm. Kryetari shpërblehet me një shtesë të barabartë me 20%-30% të shpërblimit të anëtarit. Në çdo rast shpërblimi është i lidhur me pjesëmarrjen.

#### 2. Funkcionimi

a) Komisioni kryen përgjegjësitë në përputhje me këtë rregullore dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi, që përcaktojnë kriteret në këtë fushë. Si rregull brenda 20 ditëve kalendarike nga depozitimi i kërkesës në protokollin e ministrisë, komisioni duhet të shprehet me vendim për aplikim. Përfundim nga afati bëhet vetëm për rastet e caktuara sipas procedurës së kësaj rregulloreje.

b) Komisioni mblidhet të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji. Komisioni shqyrton dhe vendos për kërkesat, ankesat, informacionet në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

c) Sekretaria ka detyrimin t'i përcjellë kryetarit për komision në afatet e caktuara sipas kësaj rregulloreje çdo aplikim të dorëzuar deri 7 ditë kalendarike para fillimit të mbledhjes.

ç) Kryetari, në përputhje me afatet e shqyrtimit të aplikimeve sipas kësaj rregulloreje, cakton dhe nënshkruan rendin e ditës brenda ditës së premtë paraardhëse të së hënës së parë dhe të tretë të çdo muaji. Rendi i ditës u shpërndahet anëtarëve brenda orës 14:00 të kësaj dite. Rendit të ditës i bashkëlidhen propozimet dhe rekomandimet e sekretarisë për çështjet në shqyrtim.

#### 3. Procedura e shqyrtimit dhe vendimmarrjes në komision

a) Komisioni administron materialin e paraqitur nga sekretariatit teknik, shqyrton propozimet dhe rekomandimet e sekretariatit teknik, verifikon dokumentacionin sipas rastit dhe vendos për kërkesat. Kur gjykon komisioni, ka të drejtë të kërkojë nga aplikantët dokumente plotësuese, por kjo nuk ndikon në zgjatjen e afatit të trajtimit të aplikimit. Për këtë çështje disponohet me vendim.

b) Mbledhjet e komisionit drejtohen nga kryetari ose zëvendëskryetari në mungesë të kryetarit.

c) Kur konstatohen se ka aplikime të shumta në numër me autorizim të ministrit, brenda 2 ditëve pune, kryetari, ose në mungesë të kryetarit nënkryetari, thërret jashtë radhe mbledhjen për shqyrtimin e materialit të depozituar deri 7 ditë kalendarike para fillimit të mbledhjes. Në çdo rast, zhvillimi i mbledhjes jashtë radhe nuk përjashton mbledhjet e së hënës së parë dhe të tretë të muajit të caktuar sipas kësaj rregulloreje.

ç) Mbledhjet e komisionit zhvillohen të mbyllura dhe janë të vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Anëtari ka të drejtën e votimit “pro” ose “kundër”, abstenimi nuk lejohet

d) Në mbledhjet e Komisionit mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës dhe çdo njëri prej tyre ka të drejtë të njihet me një kopje të tij.

dh) Vendimi në komision merret me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Si rregull kryetari voton i fundit. Kur votimi rezulton i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

e) Sekretaria brenda 2 ditëve pune zbardh vendimet të cilat nënshkruhen, në çdo fletë, nga anëtarët e pranishëm në mbledhje, në 2 kopje, ku njëra dorëzohet në zyrën e protokollit, në përputhje me rregullat e parashikuara nga ligji nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, dhe rregulloret në zbatim të tij, ndërsa kopja tjetër në sektorin përkatës për licencimin në ndërtim.

ë) Sektori i licencimit, përgatit lejet brenda 1 dite pune për subjektet dhe kryetari i firmos ato brenda ditës. Në mungesë të kryetarit leja nënshkruhet nga nënkryetari.

#### 4. Përgjegjësitë e sekretarisë së komisionit

a) Përgjegjësitë e sekretarisë së komisionit kryhen nga sektori përgjegjës për licencimin në ndërtim që funksionon në strukturën përgjegjëse për licencimin në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Sekretaria ka këto përgjegjësi:

I. Brenda orës 11:00 të çdo dite, në përputhje me rregullat e parashikuara nga ligji nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe rregulloret në zbatim të tij, merr në dorëzim nga sektori i protokollit dhe administron të gjitha aplikimet e drejtuara në komisionin e dhënies së licencave.

II. Regjistron në regjistra të posaçëm në formë shkresore dhe elektronike çdo aplikim të ndarë sipas objektivit. Licencim fillestar, shtesa, revokim, kërkesa për sanksione.

III. Verifikon dokumentacionin e nevojshëm provues të çdo aplikimi dhe e inventarizon sipas formularëve standard.

IV. Kur aplikimi nuk shoqërohet me dokumentacionin provues, sipas kësaj rregulloreje apo dokumentin justifikues që provon kryerjen e pagesës sipas tarifës së miratuar (sipas lidhjes nr.1), sekretariati brenda 5 ditëve nga marrja në dorëzim, sipas pikës I të kësaj shkronje, i komunikon me shkrim aplikuesit kërkesën për plotësim dokumentacioni. Komunikimi kryhet në adresën e dhënë nga subjekti aplikues. Komunikimi me shkrim pezullon afatet e shqyrtimit të kërkesës. Njoftimi për plotësim dokumentacioni botohet dhe në faqen zyrtare të ministrisë.

V. Kur aplikimi rezulton se shoqërohet me dokumentacionin provues, sipas kësaj rregulloreje, brenda 7 ditëve nga marrja në dorëzim e kërkesës sipas pikës I të kësaj shkronje, sektori shqyrton kërkesën dhe sipas rastit i propozon komisionit:

- miratimin e kërkesës;
- miratimin me ndryshime të kërkesës;
- refuzimin e kërkesës.

Rekomandimi duhet të përmbajë shkakun ligjor dhe rrethanat apo argumentet në të cilat mbështetet. Ai nënshkruhet nga sekretari i komisionit dhe miratohet nga drejtori i drejtorisë përgjegjëse për licencimin.

VI. Përgatit projektrendin e ditës.

VII. Mban procesverbalet e mbledhjeve dhe i zbardh ato jo më vonë se 2 ditë pune.

VIII. Përgatit vendimet e komisionit në përputhje me konkluzionet e mbledhjeve.

IX. Kryen plotësimin e formularëve të licencave në dy kopje sipas vendimeve të komisionit dhe dërgimin nëpërmjet postës në adresën e aplikuesit.

X. Bën mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e të dhënave të regjistrave të subjekteve të licencuara dhe regjistrave të posaçëm.

XI. Arkivimin e dokumentacionit të aplikantëve shoqëruar me licencën e miratuar që përmban siglat e konceptuesit, miratuesit dhe kryetarit të komisionit, në përputhje me rregullat e

parashikuara nga ligji nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe rregulloret në zbatim të tij.

XII. Çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj, këtë rregullore apo urdhër të ministrit.

5. Përgjegjësitë, procedurat dhe afatet për përditësimin e të dhënave në regjistër që nuk sjellin ndryshime në klasifikim për subjektet juridike.

a) Brenda 30 ditëve, çdo subjekt i licencuar në zbatim ka detyrimin të depozitojë aplikimin për përditësimin e të dhënave që nuk sjellin ndryshim në klasifikim. I njëjti afat, me përjashtim të rastit kur përcaktohen afate të posaçme sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm dhe për aplikime të cilat sjellin ndryshime në klasifikimin e lejes. Aplikimet që nuk sjellin ndryshime në klasifikim së bashku me dokumentacionin provues shqyrtohen dhe miratohen nga sektori i licencimit.

b) Kur aplikimi është në mbështetje të kësaj rregulloreje, brenda 10 ditëve, subjektit i dërgohet njoftimi për pranimin e përditësimit për një ose më shumë elemente:

I. Ndryshim apo shtesë të drejtuesit /ve ligjor të shoqërisë;

II. Ndryshim emërtim shoqërie;

III. Zgjatjen e afatit të licencës së shoqërisë, kur aplikohet me të njëjtin staf inxhinierik;

IV. Mbyllja e aktivitetit të shoqërisë (çregjistrim i tyre), bashkime apo përthithje (që nuk shoqërohen me ndryshimin e grupit të drejtuesve teknikë).

Njoftimit për pranim i bashkëlidhet leja e përditësuar, e nënshkruar nga kryetari i komisionit në detyrë.

c) Kur aplikimi ka të meta ose dokumentacioni provues nuk është në formën e kërkuar ligjore brenda 10 ditëve, subjektit i dërgohet njoftimi me shkrim, për plotësim sipas rastit të dokumentacionit dhe/ose kërkesës. Kur subjekti nuk plotëson dokumentacionin dhe/ose kërkesën brenda 30 ditëve kalendarike nga njoftimi, aplikimi konsiderohet si i paqenë, kërkesa arkivohet dhe ndaj subjektit ose sipas rastit drejtuesit teknik në rastin e përgjegjësisë solidare komisioni fillon kryesisht procedimin, sipas kreut sanksione të kësaj rregulloreje.

6. Lëshimi i dublikatës

Kërkesat për lëshim dublikate trajtohen brenda 3 ditëve pune nga sektori i licencimit. Dublikata lëshohet me shënimin “Dublikatë”.

### KREU III

#### KATEGORIZIMI DHE KLASIFIKIMI I LICENCËS, ELEMENTET E SAJ, KUSHTET, KRITERET DHE KUFIZIMET

1. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.

II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente:

- Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri;

- Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë;

- Kapacitetet financiare.

b) Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nëkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t'u lidhur sipas ligjit për prokurimin publik me vlerë të përbashkët ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencura kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala “periudhë” kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje

me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

Përrjashtim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohe të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe / apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë / nënkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t'u lidhur, sipas ligjit të prokurimit publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence

c) Autoritetet kontraktore, në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në dokumentet e tenderit të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve, për periudhën 22 mars – 23 tetor me 2(dy) turne, për ndërtimin e objekteve në lartësi, dhe me 3(tri) turne, për ndërtimin e rrugëve dhe ndërtimeve të tjera.

ç) Autoritetet kontraktore për moszbatimin e kërkesave të përcaktuara në shkronjën “c” dhe për mosndjekjen e zbatimit të këtyre kushteve (kryerjen e punimeve me dy e tri turne), të përcaktuara në kontratën e nënshkruar, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose me përgjegjësi, sipas legjislacionit për prokurimin publik.

d) Autoriteti kontraktues kërkon ndërprejen e punimeve dhe prishjen e kontratës për çdo vonesë në grafikun e punimeve, që rrezikon përfundimin e punimeve në afatin përfundimtar, të përcaktuar në kontratën e nënshkruar. Në këtë rast edhe për moskryerje të punimeve sipas kushteve të përcaktuara në shkronjën “c” kërkohe heqja e licencës për shoqëri ndërtuese, në përputhje me këtë vendim dhe përrjashtimin e saj nga prokurimet publike, në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

2. Elementet e licencës:

a) Licenca përmban këto elemente:

I. Kategoritë e punimeve të ndërtimit (përcaktuar në lidhjen nr.2);

II. Klasifikimin me nivele për çdo kategori (përcaktuar në lidhjen nr.4);

III. Numrin e identifikimit;

IV. Datën e regjistrimit në Regjistrin Themeltar (e njëjtë me datën e marrjes së vendimit nga komisioni);

V. Emrat e drejtuesve ligjorë e teknikë;

VI. Selinë;

VII. Afatin e vlefshmërisë;

VIII. Elementet e sigurisë të përcaktuara me urdhër të ministrit;

IX. Të dhënat e plota të kategorive dhe klasifikimit, në pjesën e pasme të licencës (Lidhjet 2 e 4 të kësaj rregulloreje).

b) Formulari i licencës miratohet nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Kushtet, kriteret dhe kufizimet

a) Aplikimi për licencë dhe dokumentet shoqëruese të saj, sipas kësaj rregulloreje, dërgohen me postë rekomande dhe lajmërimarrjeje në emër të komisionit. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose i njërsuar me origjinalin. Në aplikim shënohet dhe adresa e saktë për komunikim mes subjektit dhe komisionit.

Shoqëritë e huaja që aplikojnë për licencim njehsojnë licencën që disponojnë nga vendi i origjinës duke zbatuar të njëjtat procedura për kategorizimin dhe klasifikimin, si dhe shoqëritë shqiptare.

b) Për të vlerësuar/demonstruar aftësinë e mjaftueshme profesionale, financiare dhe kapacitetin profesional të drejtuesit teknik të shoqërisë, gjykohe mbi dokumentacionin e plotësuar



nga aplikuesi, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në këtë rregullore. Në rastet kur gjykohet nga komisioni kërkohen edhe dokumente apo informacione plotësuese nga ente publike ose private.

c) Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë.

Shoqëritë e licencura jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë.

Si rregull përgjegjësitë e drejtuesit teknik të shoqërisë për këtë periudhë (nga kontraktimi deri në shqyrtimin e kërkesës) mbulohen nga drejtuesi i ri i kontraktuar deri në vendimmarrjen e komisionit.

Kur komisioni vendos mospranim të kërkesës ose në mungesë të dokumentacionit të plotë sekretariati teknik dërgon njoftim për plotësim dokumentacioni, sipas paragrafit VI, shkronja "a", pika 4 e kreut II të kësaj rregulloreje, shoqëria detyrohet të pezullojë punimet menjëherë deri në licencimin sipas rregullave dhe procedurave të caktuara në këtë rregullore.

Kur shoqëria dhe drejtuesi kanë kontratë me afat të caktuar, shoqëria jo më vonë se 30 ditë para mbarimit të afatit njofton komisionin për drejtuesin e ri teknik ose zgjatjen e kontratës për një afat të ri. Bashkëlidhur njoftimit aplikimi dhe dokumentacioni provues sipas kësaj rregulloreje. Kur në Komision nuk ka njoftim nga shoqëria apo drejtuesi teknik nuk njofton për mbarimin e kontratës sipas afatit, kontrata për periudhën në vijim do të quhet si pa afat të caktuar. Përgjegjës sipas ligjit mbetet drejtuesi teknik i shoqërisë.

ç) Afati kohor për të kërkuar shtesë të kategorive apo rritje të klasifikimit me të njëjtët drejtues teknikë me të cilët shoqëria disponon licencë është jo më parë se një vit nga aplikimi paraardhës.

#### KREU IV

#### DREJTUESI TEKNIK I SHOQËRISË DHE PAPAJTUESHMËRIA ME KËTË DETYRË

##### 1. Drejtuesi teknik i shoqërisë

a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimi. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 vjet nga diplomimi.

b) Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

c) Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë rregullohen sipas kontratës individuale të punës.

##### 2. Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit

Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punëmarrje tjetër publike.

Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit.

Kur personat që pranojnë të kryejnë detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë për zbatim disponojnë licencë profesionale mbikëqyrjeje e kolaudim punimesh zbatimi, ata kanë detyrimin për evidentimin e këtij fakti në dokumentacionin e paraqitur për aplikim, si dhe dorëzimin e kopjes origjinale të këtyre licencave pranë arkivës së sektorit përgjegjës për licencimin, përpara ose në çastin kur shoqëria në fjalë merr licencën.

Licencat profesionale për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, i kthehet personit sapo ai shkëput marrëdhëniet si drejtues teknik me shoqërinë.

## KREU V MËNYRA E KLASIFIKIMIT TË SHOQËRIVE

### 1. Klasifikimi i shoqërive

a) Shoqëria vendoset paraprakisht në nivelin (klasën) e pasqyruar në lidhjen nr.4, ku përfshihet vlera e punimeve të kryera gjatë 4 viteve të fundit për kategorinë që klasifikohet. Shoqëria qëndron në të njëjtin nivel klasifikimi apo zbret në një më të ulët në varësi të pikëve që përfiton nga përvoja e drejtuesit teknik të shoqërisë për kategorinë që klasifikohet dhe pikët nga kapaciteti financiar nëpërmjet bilanceve, të llogaritura si në vijim.

I. Llogaritja e pikëve për përvojën e drejtuesit teknik, (vlerësimi maksimal 20 pikë) për çdo kategori kryhet nga komisioni mbështetur në:

- Vitet e punës mbas diplomimit në degën universitare me 1 pikë për çdo 5 vjet përvojë (nga viti i diplomimit deri në atë të aplikimit) dhe jo më shumë se 5 pikë gjithsej.

- Punët e kryera në zbatim të objekteve ndërtimore, të cilat vlerësohen nga komisioni (jo më shumë se 15 pikë).

Kur e njëjta shoqëri ka më shumë se 1 drejtues teknik për të njëjtin kategori punimesh për efekt të kategorizimit vlen pikësimi i drejtuesit teknik me pikësimin më të madh :

*Shembull: Kur drejtuesi teknik me eksperiencën më të madhe për atë kategori ka 14 vjet që është diplomuar, ai merr 2.8 pikë dhe i shtohen pikët (nga 1 deri 15) që komisioni vlerëson për eksperiencën e tij, bazuar në punët që ka kryer.*

II. Llogaritja e pikëve për kapacitetin financiar kryhet bazuar në bilancet “pozitive” (kur shoqëria ka rezultuar me fitim). Pikët llogariten si mesatare e pikëve për 4 vitet e fundit, ku për secilin vit “pozitiv” përfitohen 20 pikë (vlerësimi maksimal 20 pikë).

*Shembull: Në rast se shoqëria ka 2 vjet që është krijuar dhe vetëm për 1 vit nga këto ka pasur bilanc me fitim, atëherë ajo do të përfitojë ;  $1 \times (20 \text{ pikë}) / 2 \text{ vitet} = 10 \text{ pikë}$ .*

Shoqëria qëndron në të njëjtin kategori, vetëm kur vlerësohet nga 21 pikë e lart me kusht që nga drejtuesi teknik të ketë përfituar të paktën 11 pikë. Në rast të kundërt ajo zbret në një nivel klasifikimi më të ulët.

## KREU VI DOKUMENTET QË SHOQËROJNË APLIKIMIN PËR LICENCË PROFESIONALE, NDRYSHIME DHE PËRDITËSIME

### 1. Dokumentacionin për pajisje me licencë shoqërie për herë të parë

a) Kërkesa e shoqërisë për pajisje me licensë sipas formularit të paraqitur në lidhjen nr.6. Kërkesës i bashkëlidhet dhe dokumentacioni i mëposhtëm provues:

I. Kopje e njësuar e vendimit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit/gjykatë dhe (aktit të themelimit + statusit).

II. Kopje e njësuar e diplomës së drejtuesit apo drejtuesve teknikë të shoqërisë.

III. Kur drejtuesi teknik është diplomuar me mesatare note nga 9:0 e lart ose ekuivalent dhe kërkon të vendoset si drejtues teknik 3 vjet nga diplomimi kopje e njësuar e listës së notave.

IV. Dokumentacion teknik justifikues (origjinal ose i njësuar) për veprimtarinë e kryer nga drejtuesi teknik, vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma publikë ose privatë. Kur vërtetimi lëshohet nga institucion privat bashkëshoqërohet dhe me vërtetim të subjektit publik që konfirmon faktin.

V. Kontrata midis drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik.

VI. Vetëdeklarimi i drejtuesve ligjorë, nëse është në hetim apo procedim penal me cilësinë e të pandehurit për vepra penale që kanë lidhje me ushtrimin e detyrës, (sipas formatit të lidhjes nr.7/1).

VII. Vetëdeklarim i drejtuesit/ve teknik, nëse është në hetim apo procedim penal me cilësinë e të pandehurit për vepra penale që kanë lidhje me ushtrimin e detyrës apo ka qenë i dënuar, si dhe për gjendjen në lidhje me punëmarrje të tjera, (sipas formatit të lidhjes nr.7/2).

### 2. Dokumentacioni për ndryshim ose shtesë të drejtuesit ligjor:

a) Kërkesa për ndryshimin e drejtuesit ligjor apo shtesë të tij sipas formularit të paraqitur në lidhjen nr.6, shoqërohet edhe me:

I. Kopje të noterizuar të vendimit të gjykatës ose të QKR, ku përcaktohet ndryshimi i drejtuesit ligjor.

II. Vetëdeklarimi i drejtuesit/ve teknik, nëse është në hetim apo procedim penal me cilësinë e të pandehurit për vepra penale që kanë lidhje me ushtrimin e detyrës apo ka qenë i dënuar, si dhe për gjendjen në lidhje me punëmarrje të tjera, (sipas formatit të lidhjes nr.7/2).

3. Dokumentacioni për ndryshim të drejtuesit teknik:

a) Kërkesa për ndryshimin e drejtuesit teknik apo shtesë të tij sipas formularit të paraqitur në lidhjen nr.6, shoqërohet edhe me:

I. Kopje të njësuar të diplomës së drejtuesit apo drejtuesve teknikë që shtohen në shoqëri. Kur drejtuesi teknik është diplomuar me mesatare note nga 9:0 e lartë dhe kërkon të vendoset si drejtues teknik 3 vjet nga diplomimi, diplomës t'i bashkëlidhet kopje e njësuar e listës së notave.

II. Kontrata/t midis drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik të ri.

III. Vetëdeklarimi i drejtuesit/ve teknik, nëse është në hetim apo procedim penal me cilësinë e të pandehurit për vepra penale që kanë lidhje me ushtrimin e detyrës apo ka qenë i dënuar, si dhe për gjendjen në lidhje me punëmarrje të tjera, (sipas formatit të lidhjes nr.7/2).

IV. Dokumentacion teknik justifikues (origjinal ose i njësuar për veprimtarinë e kryer nga drejtuesi teknik), vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma publike ose private. Kur vërtetimi lëshohet nga institucion privat bashkëshoqërohet dhe me vërtetim të subjektit publik që konfirmon faktin.

V. Bilancet e katër viteve të fundit

Kur komisioni njoftohet nga drejtuesi teknik që largohet, brenda 7 ditëve njoftohet shoqëria me shkrim për këtë largim dhe për detyrimin për plotësim sipas kësaj rregulloreje.

4. Dokumentacioni për ndryshim emërtim shoqërie:

a) Kërkesa për ndryshimin e emrit të shoqërisë, kryhet brenda 30 ditëve nga marrja e certifikatës nga QKR-ja për këtë ndryshim, hartohet sipas formularit të paraqitur në lidhjen nr.6 dhe shoqërohet me kopjen e njësuar ose origjinal të aktit.

5. Dokumentacioni për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë, çregjistrimi

Kur shoqëria ndërtimore nuk kryen veprimtari, sipas ligjit në fuqi, brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit në QKR apo gjykatë për mbyllje subjekti, ka detyrimin të paraqesë pranë sektorit përgjegjës për licencimin, kërkesën shoqëruar me vendimin e QKR-së apo gjykatës. Në këtë rast drejtuesi ligjor dhe drejtuesi teknik kanë përgjegjësi solidare për njoftimin.

6. Ndarjet apo bashkimet e shoqërive:

a) Ndarja:

Kur shoqëria ndërtimore ndahet, akti i ndarjes i depozituar në QKR përcakton dhe çështje të drejtave dhe detyrimeve që trashëgojnë subjektet e reja të krijuara për elementet, punime të kryera nga shoqëria mëmë, kapacitetet inxhinierike dhe ato financiare. Dokumentacioni që duhet të dorëzohet në komision nga përfaqësuesit ligjorë të subjektit përbëhet nga:

I. Aplikimi për licencimin e shoqërisë/ve dhe shpalljen pa veprim të licencës së shoqërisë mëmë së cilit i bashkëlidhet.

- Akti i ndarjes i depozituar në QKR;

- Vendimi i ndarjes në QKR;

- Kontrata midis drejtuesve ligjorë dhe drejtuesve teknikë përkatës.

Dokumentacioni i mësipërm paraqitet në origjinal ose i njësuar me origjinalin.

Kur kontrata lidhet me drejtues të ri teknik dokumentacionit të mësipërm i bashkëlidhen vetëdeklarimi i drejtuesit teknik, nëse është në hetim apo procedim penal me cilësinë e të pandehurit për vepra penale që kanë lidhje me ushtrimin e detyrës apo ka qenë i dënuar, si dhe për gjendjen në lidhje me punëmarrje të tjera (sipas formatit të lidhjes nr.7/2) së bashku me Dokumentacion teknik justifikues (origjinal ose i njësuar për veprimtarinë e kryer nga drejtuesi teknik), vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma publikë ose privatë. Kur vërtetimi lëshohet nga institucion privat bashkëshoqërohet dhe me vërtetim të subjektit publik që konfirmon faktin.

b) Bashkimi:

Bashkimi i shoqërive i vendos automatikisht shoqërisë së re që krijohet shumatoren e kategorive që kanë shoqëritë që bashkohen dhe secilën kategori në nivelin e klasifikimit bazuar në shumën e punimeve të ngjashme dhe pikësimin e drejtuesve teknikë me pikësim më të lartë. Pikësimi për bilancet llogaritet si mesatare e pikësimit nga bilancet të çdo shoqërie që bashkohet. Dokumentacioni që duhet të dorëzohet në komision përbëhet nga:

I. Aplikimi për licencimin e shoqërisë së re të krijuar dhe mbylljen e licencave për shoqërinë së cilës i bashkëlidhen:

- akti i bashkimit të shoqërisë i depozituar në QKR;
- Vendimi i bashkimit në QKR.

Dokumentacioni i mësipërm paraqitet në origjinal ose i njësuar me origjinalin.

7. Rilicencimi i shoqërive ekzistuese në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

Brenda periudhës 6-mujore nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje shoqëritë që disponojnë licencë përpara miratimit të rregullores, duhet të ndjekin të njëjtat procedura kategorizimi e klasifikimi, si edhe ato që aplikojnë për herë të parë. Kërkesa e hartuar sipas formularit të paraqitur në lidhjen nr.6. shoqërohen me:

I. Vendimin e regjistrimit në QKR në rast se kanë marrë një të tillë nga koha e aplikimit parardhës për licencë.

II. Vetëdeklarimin e drejtuesit/ve teknik, nëse është në hetim apo procedim penal me cilësinë e të pandehurit për vepra penale që kanë lidhje me ushtrimin e detyrës apo ka qenë i dënuar, si dhe për gjendjen në lidhje me punëmarrje të tjera. (sipas formatit të lidhjes nr.7/2) së bashku me.

III. Dokumentacion teknik justifikues (origjinal ose i njësuar për veprimtarinë e kryer nga drejtuesi teknik), vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma publikë ose privatë. Kur vërtetimi lëshohet nga institucion privat bashkëshoqërohet dhe me vërtetim të subjektit publik që konfirmon faktin.

IV. Informacion nga shoqëria në lidhje me punët e kryera për 4 vitet e fundit. Informacioni shoqërohet edhe me:

- Situacione të punimeve të likuiduara, të vulosura nga entet publike shtetërore apo private. (orgjinale ose kopje të njësuara);

- Bilance të 4 viteve të fundit, (orgjinale ose kopje të njësuara)

- Akteve të kolaudimit apo marrjes në dorëzim të objekteve (orgjinale ose kopje të njësuara)

8. Ndryshimi i shkallës së klasifikimit për kategoritë e licencës që disponon:

a) Kërkesa për ndryshim të shkallës së klasifikimit shqyrtohet në rastet kur:

I. Ndryshohen drejtuesit teknikë gjë që çon në llogaritjen e pikësimit për drejtuesin teknik të ri apo shtimin/heqjen e nivelit, si edhe kategorisë që përfitohej si rezultat i këtij drejtuesi. Në këtë rast plotësohen dokumentet sipas kërkesave të pikës 3.

II. Kërkohet rritje nga vetë shoqëria me të njëjtët drejtues teknikë si rezultat i punimeve të ngjashme që ka kryer ndërkohë, rritjes së eksperiencës së drejtuesve teknikë si në vite, ashtu edhe në punë.

b) Dokumentet që duhet të plotësojë shoqëria, për këtë rast janë, kërkesa sipas formularit të përcaktuar në lidhjen nr.6, shoqëruar edhe me:

I. Informacion në lidhje me punët e kryera gjatë vitit/viteve të fundit, nisur nga aplikimi paraardhës. Informacioni shoqërohet me:

- Kopje të situacioneve të punimeve të likuiduara, të vulosura nga entet publike shtetërore apo private, (orgjinale ose kopje të noterizuara);

- Kopje bilancesh (orgjinale ose kopje të noterizuara);

- Akte kolaudimi apo marrjes në dorëzim të objekteve (orgjinale ose kopje të noterizuara);

Ky informacion vlen edhe për pikësimin e eksperiencës së drejtuesit/drejtuesve teknikë ekzistues.

## KREU VII SANKSIONE

1. Ndaj subjekteve të licencuara për shkelje të legjislacionit në fuqi apo kësaj rregulloreje aplikohen nga komisioni këto masa administrative :

a) Heqja e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e përkohshëm në zbatim, për periudha të ndryshme të shoqërive apo kategori të drejtuesve teknikë të shoqërive, në rastet kur:

I. Konstatohen ose provohen deklaramë (sipas parashikimeve në këtë rregullore) të rreme, dokumente të pavërteta të subjektit deklarues. Në këtë rast komisioni heq licencën për një periudhë 5 vjet.

II. Shoqëria kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këtë rregullore. Në këtë rast komisioni heq licencën për shoqërinë/drejtuesit për një periudhë 3 vjet.

III. Ka propozime të motivuara nga institucionet që kanë lidhje me procesin e ndërtimit, organet e qeverisjes qendrore apo vendore, për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim hiqet për një periudhë 3 vjet. Në këtë rast komisioni heq licencën e shoqërisë për një periudhë 3 vjet. Për këtë rast ngarkohen struktura të ministrisë për të verifikuar propozimin, të cilat brenda 30 ditëve hartojnë raportvlerësimin që shqyrtohet në mbledhjen e radhës së komisionit.

b) Për masat e marra njoftohet subjekti përkatës dhe institucionet që kanë lidhje me procesin e zbatimit të punimeve të ndërtimit. Gjithashtu për rastet e deklaramëve të rreme sanksioni administrativ shoqërohet dhe me kallëzim në organin e akuzës.

## KREU VIII ANKIMI

A) Për çdo vendim të komisionit, subjektet e interesuara, kanë të drejtën e ankimit te Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, brenda 30 ditëve, nga data e njoftimit. Titullari i ministrisë, pasi merr në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti, vendos brenda 10 ditëve:

- mospranimin e kërkesës dhe lënien në fuqi të vendimit të marrë nga komisioni.
- kthen për rishqyrtim vendimin e marrë në komision.

## KREU IX DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Pjesë e kësaj rregulloreje janë lidhjet 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7.

2. Pjesë të rregullores së miratuar me urdhrin nr.84, datë 8.0.2006 të ministrit për miratimin e rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për punët publike”, që kanë të bëjnë me licencimin në fushën e zbatimit të individëve apo shoqërive të ndërtimit, shfuqizohen.

3. Verifikimi i deklaramëve apo dokumenteve kryhet rast pas rasti.

4. Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në dispozitat e kësaj rregulloreje, licencat e dhëna sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e miratuar me urdhrin nr.84, datë 8.9.2006 të ministrit për miratimin e rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për punët publike”, mbeten në fuqi deri në paraqitjen për rivlerësim e konvertim në kategoritë dhe klasifikimin e përcaktuar në këtë rregullore.

5. Rikategorizimi dhe riklasifikimi i licencave të dhëna para hyrjes në fuqi të vendimit nr.42, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, përfundon 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

## **ANEKS**

***Lidhja 1            Tarifat***

***Lidhja 2 Kategoritë e punimeve të zbatimit***

***Lidhja 3 Shpjegime në lidhje me punimet e ndërtimit që përfshihen në secilën kategori***

***Lidhja 4 Klasifikimi i Shoqërive ndërtimore sipas niveleve***

***Lidhja 5 Arsimet universitare përkatëse që duhet të ketë drejtuesi/it teknik***

***Lidhja 6 Formularët që duhet të plotësojnë shoqëritë që aplikojnë***

***Lidhja 7 Deklarimet e personave.***

**LIDHJA 1**  
**TARIFA**

Për personat juridikë që pajisen me licencë profesionale zbatohen këto tarifa:

- |  |            |
|--|------------|
| 1. Licencë për herë të parë shoqërie                                   | 1 (një) €; |
| 2. Shtesë në licencë (kategori apo rritje të shkallës së klasifikimit) | 1 (një) €; |
| 3. Zgjatje afati licencë shoqërie                                      | 1 (një) €; |
| 4. Ndryshim dhe shtesë drejtuesi ligjor e teknik                       | 1 (një) €; |
| 5. Ndryshim i emrit të shoqërisë                                       | 1 (një) €; |
| 6. Nxjerrje të dhëna nga Regjistri Themeltar                           | 1 (një) €; |
| 7. Dublikatë personave juridikë  | 1 (një) €; |
| 8. Rilicencimi   | 1 (një) €; |

Subjekti aplikues sipas rastit, likuidon tarifën e mësipërme në një nga bankat e nivelit të dytë/postës shqiptare në llogari të ministrisë përgjegjëse për punët publike dhe ja bashkëlidh aplikimit.

## LIDHJA 2

### TABELA KATEGORIZIMI SIPAS PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM

#### PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P - 1	Punime gjurmimi në tokë.
N.P - 2	Ndërtime civile dhe industriale.
N.P - 3	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
N.P - 4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
N.P - 5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
N.P - 6	Diga dhe tunele hidroteknike.
N.P - 7	Ujshjellësa, gazshjellësa, vajshjellësa, vepra kullimi e vaditje.
N.P - 8	Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.
N.P - 9	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.
N.P - 10	Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.
N.P - 11	Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
N.P - 12	Punime të inxhinierisë së mjedisit.

#### PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

N.S - 1	Punime për prishjen e ndërtimeve.
N.S- 2	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
N.S- 3	Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë levizëse, transportues).
N.S.- 4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
N.S - 5	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.
N.S - 6	Sinjalistika rrugore jondriçuese.
N.S -7	Barriera dhe mbrojtje rrugore.
N.S - 8	Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.
N.S - 9	Punime strukturore speciale.
N.S - 10	Shtresa dhe mbistruktura speciale.
N.S - 11	Punime mbi shina dhe traversa.
N.S - 12	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
N.S - 13	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.
N.S - 14	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
N.S- 15	Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore.
N.S - 16	Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.
N.S - 17	Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane.
N.S - 18	Punime topogjeodezike.
N.S.- 19	Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë.
N.S.- 20	Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.



### LIDHJA 3

#### SHPJEGIME PËR KATEGORITË E NDËRTIMEVE (PUNIMEVE) TË PËRGJITHSHME

##### N.P. 1 Punime gjurmimi në tokë

Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjermohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.

##### N.P. 2 Ndërtime civile e industriale

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtëpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

##### N.P. 3 Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

N.P. 4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

##### N.P. 5 Punime nëntokësore

Konsiderohen. Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntoke që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi “goma” ose mbi “hekur”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntoksore, tunele.

##### N.P. 6: Diga dhe tunele hidroteknike.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, që janë të nevojshme për të ruajtur ujin e grumbulluar të zbatuar për çfarëdo lloj motivi, të lokalizuara në drejtim të rrjedhjes.

Përfshin diga të ndërtuara me çfarëdo lloj materiali.

##### N.P. 7: Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pishëm, ujësjellsat, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

N.P. 8 Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta të realizuara në ujëra të ëmbla ose të kripura, që i përkasin terminaleve “ujore” ose vepra mbrojtëse territori nga ujrat detare ose të ëmbla, e kompletuar me veprat lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe të tipit të veçantë për të pasur një shërbim të mirë të përdoruesit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar portet, molet, bankinat, panelet, platformat, pontilet, mbrojtje detare, shkëmbinj nënujore, ujësjellsat nënujore, vepra shkarkimi, si edhe punime të drenimit e thellimi në det të hapur, në pellg ujëmbledhës, të mbrojtjes kundër erozionit nga ujërat e ëmbla ose të kripura.

N.P. 9 Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e rregjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafrangmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.

N.P.10 Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, ose që janë të nevojshme për prodhimin e energjisë elektrike, të kompletuara me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit, përfshirë edhe të gjitha impiantet mekanike, elektromekanike elektrike, telefonike, elektronike, të nevojsh për funksionim, sigurim dhe asistencë.

Përfshin hidrocentralet dhe termocentralet.

N.P.11 Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte.

## SHPJEGIME PËR KATEGORITË E NDËRTIMEVE (PUNIMEVE) SPECIALE

N.S -1 Punime për prishjen e ndërtimeve

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

N.S-2 Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithëshme.

N.S-3 Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve transportuese, ashensorë, shkallë të lëvizshme, ngritëse dhe të transportit, komplet dhe të lidhur me çdo punim murature plotësuese ose ndihmëse që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithëshme.

N.S-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

N.S – 5 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike dhe ristrukturimi i impiantit automatik për sinjalistikën ndriçuese dhe sigurinë e trafikut rrugor, hekurudhor, të metrosë ose tramvajit, përfshi përpunimin e informacionit dhe të dhënave.

N.S - 6: Sinjalistika rrugore jodriçuese

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.

N.S – 7 Barriera dhe mbrojtje rrugore

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja ristrukturimi i elementeve si *guard rail*, në *jersey*, zvogëuesit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa.

N.S – 8 Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri

Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur.

Prodhimin në kantjer dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër.

Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.

N.S- 9 Punime strukturore speciale

Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për trasmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotave të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilota ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përfshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratorit nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve.

N.S- 10 Shtresa dhe mbistruktura speciale

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i shtresave (dyshemeve) të realizuara me materiale të veçanta, natyrale ose artificiale, të cilat janë me ngarkesa të konsiderueshme, si mund të jenë pistat aeroportuale.

N.S – 11 Punime në shina dhe traversa

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike ristrukturimi i binarëve për çfarëdo lloj hekurudhe, metroje, tramvaji, si edhe sistemin e frenimit dhe automatizimin e stacioneve të mallrave.

N.S - 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit

Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

N.S - 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S- 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të trasmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S.- 15 Pastrimi i ujrave detar, liqenore dhe lumorë

Konsiderohet pastrimi me mjete teknike speciale të veçantë të çfarëdo lloj uji dhe të transportit të materialeve që dalin nga pastrimi i tij në vende të caktuara me akte normative.

N.S.- 16 Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja, ristrukturimi i impianteve të ujit të pijshëm të ujërave që duhen pastruar, përfshirë edhe grumbullimin e biogazit dhe të prodhimit të energjisë elektrike e kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmës, të veçanta ose në rrjet.

N.S - 17 Ndërtimi i impiantëve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane

Konsiderohet zbatimi dhe mirëmbajtja e zakonshme ose jashtëzakonshme, e impiantit të djegies së mbetjeve e lidhur me sistemin e trajtimit të tymrave, e ripërdorimit të materialeve përfshirë makineritë e seleksionimit, kompostimin dhe prodhimin e derivateve të djegshme nga mbetjet, e kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmës, të veçanta ose në rrjet.

N.S - 18 Punime topogjeodezike

Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

N.S - 19 Sistemi i mbojtjes nga zhurmat në infrastrukturë

Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën me origjinë rrugore, hekurudhore, të barrierave metalike betonarme, dru xham, ose material plastik transparent, të mureve dopio, të mureve poroze ose të tullave poroze, gjithashtu edhe të veshjeve zëizoluese të pareteve të terrenit ose të tuneleve.

N.S- 20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë:

Përfshihen shpimet për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik. Shpimet për ujë dhe puse.

**LIDHJA 4**  
**KALSIFIKIMI PARAPRAK I SHOQËRIVE NDËRTIMORE SIPAS NIVELEVE PËR ÇDO**  
**KATEGORI PUNIMESH ZBATIMI**

<b>NIVELI I SHOQËRISË</b>	<b>SIPAS VLERAVE NË LEKË TË PUNIMEVE TË KRYERA PËR ÇDO KATEGORI PUNIMI</b>
A (edhe për herë të parë)	0- 20 milion lekë
B	21- 50 milion lekë
C	51 - 100 milion lekë
D	101 - 200 milion lekë
E	201 - 400 milion lekë
F	401 - 800 milion lekë
G	mbi 800 milion lekë

**LIDHJA 5**

<b>Nr.</b>	<b>Titulli i diplomës Universitare</b>	<b>Dega</b>
1	Ndërtim	Ndërtim para vitit 1971
2		Qytetare Industriale
3		Civile Industriale
4		Përgjithshëm
5		Strukturist
6		Transport e Infrastrukturë
7		Civile Industriale Ura
8		Rruga Ura
9		Rruga Ura e Vepra nëntokësore
10		Hidroteknik
11		Hidroteknik Rruga Ura
12		Gjeodezi
13		Mjedis
14		Arkitekturë para viteve 85
15	Mekanik	Degë të Inxhinierisë mekanike
16	Elektrik	Degë të inxhinierisë elektrike
17	Gjeologji	Gjeolog
18		Markshajder
19		Ndërtim miniere

LIDHJA 6  
FORMULARI 5/1

EMERTIMI I SHOQËRISË QË KËRKON LICENCIM

Rezidenca/adresa e plote, \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Telefon / mobil / e-mail \_\_\_\_\_

Përfaqësues ligjor \_\_\_\_\_

(emer, atësi, mbiemër)

Drejtues teknik (me të cilët kërkon të marrë licencën)

ekzistues/ iken/ shtohet

1. \_\_\_\_\_  
(emër, atësi, mbiemër, titull diplome, vit diplomimi)

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------	--------------------------

2. \_\_\_\_\_  
(emër, atësi, mbiemër, titull diplome, vit diplomimi)

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------	--------------------------

3. \_\_\_\_\_  
(emër, atësi, mbiemër, titull diplome, vit diplomimi)

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------	--------------------------

4. \_\_\_\_\_  
(emër, atësi, mbiemër, titull diplome, vit diplomimi)

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------	--------------------------

5. \_\_\_\_\_  
(emër, atësi, mbiemër, titull diplome, vit diplomimi)

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------	--------------------------

(vendosni shenje në kutinë në krah të aplikimit që kryeni)

APLIKON PËR:

**LICENIM PËR HERË TË PARË**

**SHTESË TË KATEGORIVE**

**RRITJE TË NIVELIT TË KLASIFIKIMIT**  
**NRYSHIM TË DREJTUESIT/DREJTUESVE TEKNIK**  
**NDRYSHIM TË DREJTUESIT LIGJOR**  
**DUBLIKATË TË LICENCES**  
**NDRYSHIM TË EMRIT TË SHOQËRISË**

<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>

## RILICENCIM ME FORMULARIN E RI TE LICENCAVE

*Deklaroj se angazhohem të njohë e të zbatoj në veprimtarinë e shoqërisë KTZ, STASH dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit si dhe të dërgojë informacion periodik për veprimtarinë e shoqërisë. Jam në dijeni të të gjitha pasojave që mund të kemë si rezultat i deklarimeve të rreme apo paraqitjes se dokumentave të pavërteta.*

*Drejtuesi ligjor*

---

**SHENIM: Per cdo informacion shtese per te cilin nuk ka vend per tu paraqitur, perdorni nje flete te bardhe dhe pasi ta nenshkruani, bashkelidheni ketij formulari**

LIDHJA 7  
VETDEKLARIMI 7/1

**“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se:**

***Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohem (ose në rast se ka – deklaroj : Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit \_\_\_\_\_ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit \_\_\_\_\_ (shoqëruar me motivin e ndjekjes)”.***

*Deklaruesi*

\_\_\_\_\_

*(emër, mbiemër, firma)*



VETDEKLARIMI 7/2

“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se:

Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohem (ose në rast se ka – deklaroj : Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit \_\_\_\_\_ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit \_\_\_\_\_ (shoqëruar me motivin e ndjekjes)”.

Nuk jam i punësuar në asnjë punëmarrje tjetër jashtë këtij subjekti ku aplikoj.

*Deklaruesi*

\_\_\_\_\_  
*(emër,mbiemër, firma)*

VETDEKLARIMI 7/3

“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se:

Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë dhe nuk ka asnjë penalizim të licencës aktuale të shoqërisë që drejtoj nga organet e policisë së ndërtimit (ose në rast se ka – deklaroj : Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit \_\_\_\_\_ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe kam penalizim të licencës aktuale \_\_\_\_\_ nga Dega e policisë së ndërtimit \_\_\_\_\_ (shoqëruar me masën dhe motivin e penalizimit)”.

*Deklaruesi*

\_\_\_\_\_

*(emër,mbiemër, firma)*

**VENDIM**  
**Nr.1035, datë 9.7.2008**

**PËR CAKTIMIN E TARIFËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTEVE, NGA MINISTRIA E  
PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, NË FUSHËN E  
PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË TRANSPORTIT**  
*(Ndryshuar me vendim të KM nr.1123, datë 13.11.2009)*

*I përditësuar*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për çmimet dhe tarifat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Caktimin e tarifës 1 (një) euro për pagesën e licencave, që u jepen, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, subjekteve, persona, fizikë dhe juridikë, privatë, për ushtrimin e veprimtarive:

A. Në fushën e punimeve të ndërtimit:

i. Licencë profesionale për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit në ndërtim.

ii. Licencë profesionale për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e projektimit të veprave ndërtimore.

B. Certifikatë për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve:

i) licencë për transport ndërkombëtar udhëtimesh;

ii) autorizim për shërbimin në një linjë të rregullt të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve, me autobus;

iii) autorizim për shërbimin në një linjë të rregullt të specializuar në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, me autobus, vajtje-ardhje.

C) në fushën e transportit detar:

i) leje për të vepruar në linja të rregullta ndërkombëtare detare;

ii) leje për ushtrimin e veprimtarisë së pilotimit dhe omerxhimit;

iii) leje për veprimtarinë e tërheqjes së mbeturinave të ngurta dhe vajore, në zonën portuale të Durrësit, Vlorës, Shëngjinit, Sarandës dhe në radat përkatëse;

iv) leje për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të shërbimit të pajisjeve të sigurimit të jetës në det.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.118, faqe 5228*

*Vendim i KM nr.1123, datë 13.11.2009 botuar në Fletoren Zyrtare nr.178, faqe 7875*

**URDHËR**  
**Nr.47, datë 29.3.2010**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROGRAMET  
PËR PËRGATITJEN TEORIKE-PRAKTIKE TË KANDIDATËVE, SI DHE DHËNIEN E  
DËSHMISË SË AFTËSISË PROFESIONALE PËR PËRDORUESIT E MAKINERIVE TË  
RËNDA PËR PUNIME NDËRTIMI DHE TOKE, SI DHE DISIPLINIMI I PËRDORIMIT TË  
MAKINERIVE TË NDËRTIMIT”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të pikës 2,b të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.808, datë 4.12.2003 “Për dhënien e lejeve të manovrimit të përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimit në tokë”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT  
DHE TELEKOMUNIKACIONIT**  
**Sokol Oldashi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.44, datë 20.4.2010, faqe 1652*

**RREGULLORE**  
**PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROGRAMET PËR PËRGATITJEN TEORIKO-PRAKTIKE  
TË KANDIDATËVE, SI DHE DHËNIEN E DËSHMISË SË AFTËSISË PROFESIONALE PËR  
PËRDORUESIT E MAKINERIVE TË RËNDA PËR PUNIME NDËRTIMI DHE TOKE, SI DHE  
DISIPLINIMI I PËRDORIMIT TË MAKINERIVE TË NDËRTIMIT**

**KREU I**  
**QËLLIMI, OBJEKTI I RREGULLORES DHE FUSHA E VEPRIMIT**

**Neni 1**  
**Qëllimi i rregullores**

Kjo rregullore ka për qëllim vendosjen mbi baza unike e ligjore të aktivitetit, administrimit dhe përdorimit të makinerive të rënda për punime ndërtimin dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre në zbatim të rregullave të sigurimit teknik.

**Neni 2**

Kjo rregullore përcakton kushtet, kriteret dhe shtrirjen e fushës së veprimit të saj në:

1. Kërkesën që duhet të plotësojë personi fizik (individi), i cili kërkon të pajiset me dëshminë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë, në përvetësimin e kurseve teorike e praktike që kryhen nga subjekte juridike private, si dhe organizimi i komisionit të marrjes në provim.

2. Vendosjen e rregullave të administrimit, organizimit dhe përdorimit të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë nga subjekte ose persona që i kanë në pronësi ose me qira.

### 3. Përkufizime

a) “Dëshmia e aftësisë profesionale” (DAP)- dokument që provon se personi zotëron njohuri të mjaftueshme teoriko – praktike për përdorimin e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë, ku hyjnë të gjitha makineritë teknologjike, të cilat janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë.

b) “Subjekti juridik privat”- që mund të jenë person juridik, subjekte juridike private ose subjekte ndërtuese, apo ente, të aftë që plotësojnë kushtet për të kryer zhvillimin e mësimëve teoriko - praktike, me qëllim kualifikimin e përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit, të cilët duhet të jenë të pajisur me licencë sipas nenit 5 të kësaj rregullore.

c) “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor” (DPSHTRR) është organi që jep dëshminë e aftësisë profesionale (DAP), nëpërmjet një komisioni të posaçëm me inxhinier mekanik të Drejtorisë së Kualifikim-Testimit.

## KREU II

### E DREJTA DHE KUSHTET E VEPRIMTARISË SË SUBJEKTIT PRIVAT

#### Neni 3

Subjekti juridik privat do të shërbejë për të kryer zhvillimin e kurseve të trajnimit të vazhdueshëm teoriko-praktikë, të aplikantëve që dëshirojnë të pajisen me dëshminë e aftësisë profesionale (DAP), si përdorues të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë.

Veprimtaria e subjektit privat është tërësia e funksionimit në zhvillimin e kurseve teoriko-praktike, në të gjitha komponentët bazë, që përfshijnë:

1. ambientet për zhvillimin e mësimdhënies së kursit teorik;
2. mjetet për kursin praktik;
3. mësuesit dhe instruktorët;
4. Të kenë, në pronësi ose me qira, makineri të rënda ndërtimi me tipat sipas nenit 6 të kësaj rregullore, respektivisht sipas kursit të trajnimit që do të zhvillojnë.

Subjekti privat, gjatë kryerjes së tij, duhet të mbajë dhe plotësojë rregullisht e me vërtetësi këto dokumente:

1. Regjistrin e evidentimit të aplikantëve për përdorues së makinerive të rënda të ndërtimit (amza).
2. Regjistrin e zhvillimit të kursit teorik në klasë, dhe atij praktik.

#### Neni 4

Drejtuesit teknikë të subjekteve private janë përgjegjës për administrimin dhe organizimin e përdorimit të makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë, në funksion të përgatitjes e kualifikimit profesional nëpërmjet kurseve teoriko-praktike të personelit përdorues të tyre.

#### Neni 5

1. Përgatitja teorike dhe praktike e përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit zhvillohet pranë subjekteve private, të cilave detyrimisht u kërkohet licencimi për këtë qëllim.

2. Licencimi i subjekteve private bëhet përpara se të fillojnë ushtrimin e kursit teoriko-praktik nga Drejtoria e Kualifikim-Testimit pranë DPSHTRR-së.

3. Subjektet juridike private licencohen duke plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 121, pikat 2, 5 dhe 7, të Kodit Rrugor dhe nenin 313, pika 3, të rregullores në zbatim të Kodit.

4. Licenca pezullohet dhe anulohet nga organi që e ka lëshuar, sipas nenit 121 pika 8 dhe 9 të Kodit Rrugor, si dhe rregullores në zbatim të tij.

Shkallët ajrore nuk mund të përdoren me pjerrësi më të vogla se 60 gradë dhe më të mëdha se 80 gradë, nga plani horizontal, pjerrësia duhet kontrolluar përmes pajisjeve me plumbçe të vendosura në pjesën e parë të shkallës.

Pjesët e shkallëve me elemente të ndara, që përbëjnë pjesën e sipërme, duhet të kenë një numër progresiv sipas radhës së montimit.

Përpara se shkalla të montohet në rrota duhet të përdoren veshje të forta dyshe për çdo rrotë të konturuara dhe të lidhura me zinxhir ose tirante.

6.25 Manovrat e shkallëve ajrore

Çdo operacion zhvendosjeje ose vendosjeje në pozicion pune, duhet të bëhet me shkallë të zbrazura.

Gjatë ngjitjes duhet të evitohen tronditje dhe përplasje, punëtorët dhe ngarkesat e mundshme që ato mund të mbajnë nuk duhet të jenë më shumë se 20 kg dhe veprohet kur shkalla është hapur plotësisht; ngarkesa duhet të përqendrohet në mesin e linjës së saj.

Në procesverbalet e kolaudit, duhet të tregohet numri maksimal i personave që mund të hipin njëkohësisht në shkallë. Ky numër nuk duhet tejkaluar në asnjë rast.

Ndalohet çdo sforcim ose tërheqje nga ana e gjithkujt që punon në majë të shkallës, e cila nuk duhet të mbështetet me skajet e sipërme të strukturave fikse.

Kur është e nevojshme të zhvendoset një shkallë ajrore në afërsi të linjave elektrike, duhet të evitohet çdo mundësi kontakti duke e ulur aq sa duhet pjesën e sipërme të shkallës.

7. Pajisjet e ngritjes

7.1 Çdo aparat ngritjeje ose çdo aksesor ngritjeje, përfshirë elementet e tyre përbërës, çengelat e tyre, mbërthimet e tyre dhe mbajtëset duhet të jenë:

a) të projektuara mirë dhe të ndërtuara për të pasur një rezistencë të mjaftueshme për përdorimin për të cilin janë destinuar;

b) të montuara dhe të përdorura në mënyrë korrekte;

c) të mbajtura në gjendje të mirë përdorimi;

d) të verifikuara dhe të nënshtuara provave dhe kontrolleve periodike në bazë të dispozitave ligjore në fuqi;



e) të manovrueshme nga punëtorë të kualifikuar që kanë një formim të përshtatshëm.

7.2 Çdo pajisje ngritjeje dhe çdo aksesor ngritjeje duhet të ketë të evidentuar në mënyrë të dukshme, treguesin e vlerës së ngarkesës së tij maksimale.

7.3 Pajisjet e ngritjes, si edhe aksesorët e tyre nuk mund të përdoren për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë destinuar.

8. Mjetet dhe makinat për gjermim dhe lëvizjen e materialeve

8.1 Të gjitha mjetet dhe makinat për gjermime dhe për lëvizje të materialeve duhet të jenë:

a) të projektuara mirë dhe të ndërtuara duke mbajtur parasysh, në masën e duhur, disa parime të ergonomisë;

b) të mbajtura në gjendje të mirë përdorimi;

c) të përdorura në mënyrë korrekte.

8.2 Drejtuesit dhe punëtorët e mjeteve dhe të makinave të gjermimit dhe të heqjes së materialit duhet të kenë një formim të përshtatshëm.

8.3 Duhet të merren masa paraprake për të evituar rënien e mjeteve dhe makinave të gjermimit dhe lëvizjen e materialeve në vendin e gjermuar ose në ujë.

8.4 Makinat e gjermimit dhe makinat për lëvizjen e materialeve, kur paraqitet nevoja, duhet të jenë të pajisura me struktura të qëndrueshme për të mbrojtur drejtuesin nga rreziku i shtypjes, në rast të përplasjes së makinës ose të rënies së objekteve.

9. Impiante, makina, pajisje

9.1 Impiantet, makinat dhe pajisjet, përfshirë këtu, mjetet me ose pa motor, duhet të jenë:

a) të projektuara mirë dhe të ndërtuara duke mbajtur parasysh, në masën e duhur, disa parime të ergonomisë;

b) të mbajtura në gjendje të mirë përdorimi;

c) të përdorshme vetëm për punët për të cilat janë projektuar;

d) të manovrueshme nga punëtorë që kanë marrë një formim të përshtatshëm.

9.2 Impiantet dhe pajisjet që janë nën presion duhet të verifikohen dhe t'u nënshtrohen provave dhe kontrolleve të rregullta, sipas akteve në fuqi.

10. Gjermimet, pusët, punimet nëntokësore, galeritë, rrëmihjet

10.1 Gjermimet dhe rrëmihjet

Në punimet e gjermimeve dhe të rrëmihjeve që realizohen pa përdorimin e ekskavatorëve mekanik, anët dhe pjesa ballore e zonës ku punohet duhet të kenë një pjerrësi të përcaktuar në raport me natyrën e terrenit, për të penguar shkarjen e tokës. Kur thellësia e gjermimit e kalon lartësinë 1,50 m, ndalohet gjermimi me dorë i themeleve për të mënjeluar shkarjen e mundshme të terrenit ku punohet. Kur për shkak të natyrës së veçantë të terrenit ose për shkak të shirave, depërtimit të ujit, ngrirjes dhe shkrires, ose për motive të tjera, ekziston frika e shkarjeve të tokës ose të rrëpirave, duhet të merren masa për vendosje të armaturës ose për përforcim të terrenit. Në punimet e gjermimit me mjete mekanike duhet të ndalohet prezenca e punëmarrësve në fushën e veprimit të ekskavatorit dhe në vendin e gjermimit.

Vendi i punës së ekskavatoristit, kur ky nuk është i pajisur me kabinë metalike, duhet të mbrohet me një strehë të fortë.

Punëmarrësve duhet t'u bëhet e qartë që ndalohet afrimi te buza e gropës së punës dhe, kur është e nevojshme, në vartësi të lartësisë së gjermimit ose të kushteve të afrimit në skajin e sipërm të gropës, zona e sipërme e rrezikut duhet të jetë të paktën e rrethuar me sinjalizime të nevojshme përgjatë zonës së gjermuar.

10.2 Pusët, gjermimet, galeritë

Në gjermimet e puseve dhe të transheve me thellësi më të madhe se 1,50 m, kur struktura e terrenit nuk jep garanci për qëndrueshmëri, edhe brenda pjerrësisë së lejuar, duhet që gjatë avancimit të punimeve të sigurohet vendosja e armaturave mbajtëse e mbrojtëse të nevojshme.

Panelet veshëse të mureve duhet të dalin nga buza, niveli i gjermimeve të paktën 30 cm. Në gjermimin e galerive, përveç rasteve kur bëhet fjalë për shkëmbinj që nuk përfaqësojnë rrezik shkëputjesh, duhen vënë armatura të përshtatshme për të evituar rrëshqitjet e kubesë, pjesës së sipërme dhe të mureve. Këto armatura duhet të vendosen pjesë-pjesë gjatë avancimit të punës; heqja e tyre mund të bëhet sipas progresit të veshjes me muraturë.

Armatura të përshtatshme dhe masa paraprake duhet të merren edhe në rastin kur në afërsi të këtyre gjurmëve ka ndërtime ose kryhen punime, themelet e të cilave mund të zbulohen ose dobësohen nga gjurmimet.

Në rastin e piktimit për themelet duhet të parashikohen masa paraprake për të evituar që lëkundjet e tokës gjatë punimeve, të cilat mund t'u shkaktojnë plasaritje dhe dëme objekteve që gjenden në afërsi, me një rreze rreziku mbi 3 m duhet të merren masa mbrojtëse për punëtorët që punojnë në gjurmime dhe ngarkime të materialit të gjurmuar, një rrugë për kalimin e kovës së ekskavatorit.

#### 10.3 Depozitimi i materialeve në afërsi të gjurmëve

Është e ndaluar të ndërtohen depozita materialesh pranë skajit të gjurmëve.

Kur këto depozita janë të nevojshme për kushtet e punës, duhen pajisur me masa mbrojtëse dhe mbështetëset e nevojshme.

#### 10.4 Prezenca e gazit në gjurmime

Kur bëhen punime brenda puseve, kanaleve, galerive, oxhaqeve dhe gropave në përgjithësi, duhen marrë masa të përshtatshme kundër rreziqeve që vijnë nga prezenca e gazeve ose e avujve helmuese, asfiksuese, të ndezshme ose eksplozive, sidomos në raport me strukturën gjeologjike të terrenit, në afërsi të fabrikave, depozitave dhe rafinerive, stacioneve të kompresimit dhe dekompresimit, tubave të metanit dhe tubave përcjellës të gazit, që mund t'i lenë vend infiltrimit të substancave të rrezikshme etj.

Kur nuk ka siguri ose ekziston frika e prezencës së gazeve toksike, asfiksuese ose mungesa e ajrit dhe nuk është e mundur të sigurohet një ajrim efikas ose një përmirësim i ajrit të ndotur, punëtorët duhet të jenë të pajisur me maska kundër gazit, duhet të jenë të pajisur me një rrip sigurie me tiranda që kalojnë poshtë sqetullës, të cilat lidhen me litarin e shpëtimit, i cili mbahet jashtë nga personeli vëzhgues, kjo për të mbajtur lidhje të vazhdueshme me punëtorët në brendësi dhe të jenë në gjendje të nxjerrin menjëherë jashtë punëtorët e goditur nga gazrat.

Mund të përdoren maska kundër gazit, në vend të dhënësve të oksigjenit, vetëm atëherë kur është konstatuar përqendrimi i gazrave ose avujve dëmtues dhe asfiksuese, ato ofrojnë garanci sigurie të një ajrimi të vazhdueshëm dhe efikas.

Kur konstatohet prezenca e gazrave të ndezshme dhe eksploziv, duhen marrë masa për përmirësimin e ambientit me ventilim të përshtatshëm; përveç kësaj duhet të ndalohen, edhe pas përmirësimit, nëse vërehen dalje gazi të rrezikshëm, përdorim të pajisjeve me flakë, trupave inkandeshent dhe pajisjeve që mund të provokojnë flakë ose mbingrohje e prirur për të ndezur gaz.

Në rastet e parashikuara në paragrafin e dytë, tretë dhe katërt të këtij neni, punëtorët duhet të jenë të dubluar gjatë zbatimit të punimeve.

### 11. Punimet për shembjen

#### 11.1 Përforcimi i strukturave

Përpara fillimit të punimeve të shembjes është e detyrueshme të procedohet me verifikimin e kushteve të stabilitetit (aftësisë mbajtëse) dhe të qëndrueshmërisë të strukturave të ndryshme që duhen shembur. Sipas rezultatit të këtij verifikimi duhen bërë punimet e forcimit dhe sigurisë, të nevojshme për të evituar rrëzime të paparashikuara gjatë shembjes.

#### 11.2. Radha e shembjeve.

Punimet e shembjes duhet të realizohen me kujdes dhe me rregull nga lart poshtë dhe duhet të kryhen në mënyrë të tillë që të mos dëmtojnë qëndrueshmërinë e strukturave mbajtëse dhe lidhëse, të atyre që mund të gjenden në afërsi, duke përdorur, ku duhet, mbështetëset paraprake.

Vazhdimësia e punimeve, kur bëhet fjalë për shembje të rëndësishme dhe të mëdha, duhet të bëhet në bazë të një programi të veçantë, i cili duhet të jetë i firmosur nga sipërmarrësi dhe nga administruesi i punimeve, nëse ka, dhe duhet të vihet në dispozicion të inspektorëve të punës.

#### 11.3 Masat e sigurisë

Shembja e mureve duhet të bëhet duke përdorur skelat e shërbimit të shkëputura nga objekti që shembet.

Është e ndaluar të kryhet punë nga punëtorët, mbi muret që do shemben.

Detyrimet për të cilat flet rreshti i mësipërm, nuk zbatohen kur bëhet fjalë për mure me lartësi më të vogël se 5 metra; në të tilla raste dhe për lartësitë nga 2 deri 5 m është i nevojshëm përdorimi i rripit të sigurimit.

#### 11.4 Lëvizja e materialit të shembur.

Materiali i shembur nuk duhet hedhur nga sipër, por duhet të transportohet ose të hidhet në tuba të posaçëm, skaji i poshtëm i të cilit nuk duhet të jetë në lartësi më të madhe se dy metra nga sipërfaqja e mbledhjes së mbeturinave. Tubat e sipërpërmendur duhet të ndërtohen në mënyrë që çdo element të përputhet - futet në elementin pasues; bashkimet e shkarkuesve duhet të përforcohen në mënyrë të sigurt. Dalja e sipërme e kanalit duhet të sistemohet në mënyrë të tillë që të mos bien aksidentalisht punëtorët.

Në se materialet e shembur janë të përbëra nga elemente të rënda ose që zënë shumë vend, materiali duhet zbritur në tokë me mjete të përshtatshme.

Gjatë punimeve të shembjes duhet parashikuar mënjanimi i ngritjes së pluhurit, duke spërkatur me ujë materialet që prishen dhe muret.

#### 11.5. Bllokimi i zonës së shembjes.

Në zonën e shembjes duhet të ndalohet kalimi dhe qarkullimi, duke e rrethuar zonën me kufizues të përshtatshëm.

Hyrja e mjetit, për te dalja e tubit të shkarkimit, për ngarkimin dhe transportin e materialit të shembur, lejohet vetëm pasi të jetë ndaluar shkarkimi nga lart.

#### 11.6 Shembja me përmbysje

Përveç zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore e lokale, shembja e pjesëve të strukturave që kanë lartësi nga terreni më të vogël se 5 metra mund të bëhet nëpërmjet përmbysjes me tërheqje ose shtytje.

Tërheqja dhe shtyrja duhet bërë në mënyrë graduale dhe pa shkëputje dhe duhet bërë vetëm mbi elemente strukturore të izoluar në mënyrë që në pjesën tjetër të ndërtesës që do të shembet të mos të shkaktohen shembje të papërshtatshme ose të paparashikuara të segmenteve të tjera.

Përveç kësaj duhet të merren masat e nevojshme për sigurinë e punës, të cilat janë: distancë e tërheqjes jo më e vogël se një herë e gjysmë e lartësisë së murit ose e strukturës që është për t'u shembur dhe largimin e punëmarrësve nga zona e interesuar.

Mund të procedohet me gërmimin e veprës, që është për t'u shembur, për të lehtësuar rënien, vetëm kur ajo të ketë mbështetës të përshtatshëm; heqja e mëtejshme e mbajtësve duhet të bëhet nga distanca me litarë.

Përmbysja me anë të shtyrjes mund të bëhet me pirun-krik vetëm për objektet me lartësi jo më të madhe se 3 metra, me pajisje mbështetëse në mënyrë që të mos lejojë kthimin e elementeve të prishura.

Duhet evituar brenda mundësive, lëkundja e terrenit nga shkaku i rënies së strukturave ose të blloqeve të mëdha, të cilat mund t'u shkaktojnë dëme ose plasaritje godinave pranë, ose për punëtorët që punojnë.

12. Konstruksionet metalike dhe prej çimentoje, armaturat dhe elementet parafabrikate të rëndë

12.1 Konstruksionet metalike ose të çimentos dhe elementet e tyre, armaturat, elementet parafabrikate ose mbajtëset e përkohshme dhe mbështetëset duhet të montohen dhe çmontohen vetëm nën mbikëqyrjen e një personi kompetent.

12.2. Duhet të parashikohen masa për të mbrojtur punëtorët nga rreziqet që vijnë nga ndjeshmëria dhe paqëndrueshmëria e përkohshme e një strukture.

12.3 Armaturat, mbajtëset e përkohshme dhe mbështetëset duhet të konceptohen dhe llogariten, montohen dhe qëndrojnë në mënyrë që të mund t'i durojnë sforcimet, të cilave mund t'u nënshtrohen.

#### 13. Mburojat dhe barakat

##### 13.1 Mburojat dhe barakat duhet të jenë:

a) të ndërtuara mirë, me materiale të përshtatshme dhe të forta e të pajisura me rezistencë të mjaftueshme;

b) me pajisje të përshtatshme që t'u lejojnë punëmarrësve mundësinë e riparimit në rast të shpërthimit të ujit ose dëmtimit të materialeve.

13.2 Ndërtimi, sistemimi, transformimi ose zbrëthimi i një vendi mbrojtës apo barake mbrojtëse duhet të bëhet vetëm nën vëzhgimin e një personi kompetent.

13.3 Të gjithë mburojat dhe barakat duhet të inspektohen me intervale të rregullta nga një person kompetent.

14. Punimet mbi çati.

14.1 Kur lartësia ose përkulja kalon vlerat e përcaktuara me rregullore, në raste nevojë, për të evituar një rrezik duhet të parashikohen pajisje kolektive për të evituar rënien e punëmarrësve, të pajisjeve, të objekteve të tjera ose të materialeve.

14.2 Kur punëtorët duhet të punojnë mbi një çati ose në afërsi të saj ose të çfarëdo sipërfaqeje të përbërë nga materiale të ndjeshme, nga të cilat është e mundur të rrëzohesh, duhet të merren masa paraprake për të evituar që punëtorët papritur duke ecur në sipërfaqe me material të ndjeshëm të bien në tokë.

## ANEKSI V

### ZBATIMI I MASAVE PËR PROMOVIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E SIGURISË DHE SHËNDETIT TË PUNËMARRËSVE NË PUNË

1. Përkufizime, me termat e mëposhtëm kuptojmë :

**Punëmarrës:** çdo person i punësuar nga një punëdhënës, përfshirë praktikantët me qëllim formimi ose qëllim futjen në tregun e punës, me përjashtim të personave të punësuar për të kryer punë shtëpie;

**Punëdhënës:** është çdo person fizik ose juridik, që punëson punëmarrës dhe që është përgjegjës për ndërmarrjen/kantierin;

**Përfaqësues i punëmarrësve:** është çdo person, që ka një funksion të veçantë në fushën e mbrojtjes së sigurisë e të shëndetit të punëmarrësve, i zgjedhur ose i caktuar, në përputhje me legjislacionin, për të përfaqësuar punëmarrësit për problemet e sigurisë dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë të punëmarrësve.

**Shërbime të parandalimit e mbrojtjes nga rreziqet:** një tërësi e përbërë prej personash, sistemesh e mjeteve, jashtë ose brenda ndërmarrjes, që kanë si objektiv përfundimtar aktivitetet për parandalimin dhe mbrojtjen nga rreziqet profesionale të ndërmarrjes;

**Mjeku kompetent:** mjeku, i cili ka:

Specializim në mjekësinë e punës ose në mjekësinë parandaluese për punëmarrësit e psikoteknikën ose në toksikologjinë industriale, ose në higjienën industriale ose në fiziologjinë dhe higjienën e punës, ose në klinikën e punës, ose në higjienën dhe mjekësinë parandaluese, ose në mjekësinë ligjore dhe të sigurimeve. Specializime të tjera të përcaktuara, në rastet kur është e nevojshme, me udhëzim të Ministrit të Shëndetësisë në marrëveshje me Ministrinë e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

**Profesionistë të lirë në mjekësinë e punës ose në mjekësinë parandaluese të punëmarrësve dhe psikoteknikën ose në toksikologjinë industriale ose në higjienën industriale ose në fiziologjinë dhe higjienën e punës;**

**Agjent:** substancë kimike, fizike ose biologjike, të pranishme gjatë punës, të cilat janë potencialisht të dëmshme për shëndetin;

**Parandalim:** tërësia e masave të marra ose të parashikuara në të gjitha fazat e ushtrimit të veprimtarisë në ndërmarrje, për parandalimin ose zvogëlimin e rreziqeve profesionale.

2. Detyrimet e punëdhënësit

2.1 Punëdhënësi i ndërmarrjes vlerëson të gjitha rreziqet për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve, përfshirë dhe atë grup punëmarrësish, të cilët janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të veçanta edhe në zgjedhjen e mjeteve të punës e të substancave ose preparateve kimike të përdorura dhe në sistemimin e vendeve të punës.

2.2 Gjatë vlerësimit, punëdhënësi përgatit një dokument që duhet të përmbajë: një relacion mbi vlerësimin e rrezeve për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës, në të cilin specifikohen kriteret e adoptuara për vlerësimin e tyre.

Përcaktimi i masave parandaluese e mbrojtëse dhe i mekanizmave për mbrojtjen individuale dhe programi i masave që konsiderohen të nevojshme për të garantuar përmirësimin në kohë të niveleve të sigurisë.

2.3 Dokumenti mbahet në kantierin e punës.

2.4 Punëdhënësi:

- emëron personelin e shërbimit të mbrojtjes dhe parandalimit brenda ose jashtë ndërmarrjes;
- emëron në rastet e nevojshme mjekun kompetent.

2.5 Punëdhënësi merr masat e nevojshme për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve, dhe në mënyrë të veçantë:

a) përcakton paraprakisht punëmarrësit e ngarkuar për zbatimin e masave të parandalimit të zjarrit dhe masat kundër zjarrit, të evakuimit të punëmarrësve në rast rreziku të rëndë e të papritur, të shpëtimit, të ndihmës së shpejtë, e gjithësi të drejtimit të emergjencës;

b) azhuron masat e parandalimit në bazë të ndryshimeve organizative e të prodhimit me rëndësi për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe në bazë të evoluimit të teknikës së parandalimit e të mbrojtjes;

c) në shpërndarjen e detyrave për punëmarrësit, merr parasysh kapacitetet dhe kushtet e tyre në lidhje me shëndetin dhe sigurinë;

d) vë në dispozicion të punëmarrësve mekanizmat e përshtatshëm e të nevojshëm për mbrojtjen individuale, pasi ka dëgjuar përgjegjësin e shërbimit të parandalimit e të mbrojtjes;

e) merr masat e nevojshme në mënyrë që vetëm punëmarrësit, të cilët kanë marrë udhëzimet e duhura mund të hyjnë në zonat me rrezik të lartë e specifik;

f) kërkon nga ana e punëmarrësve, zbatimin e rregullave në fuqi, si dhe të rregullave të brendshme të ndërmarrjes në fushën e sigurisë e të higjienës në punë, si dhe përdorimin e mjeteve të mbrojtjes kolektive e të pajisjeve për mbrojtjen personale të vëna në dispozicion;

g) kërkon nga ana e mjekut kompetent, zbatimin e detyrimeve të parashikuara me këtë rregullore, duke e informuar mbi proceset e rreziqet e lidhura me aktivitetin e prodhimit;

h) merr masat për kontrollin e situatave me rrezik në rast emergjence dhe jep udhëzime që punëmarrësit të largohen nga vendi i punës ose zona me rrezik të lartë, të papritur e të pashmangshëm;

i) informon, sa më shpejtë të jetë e mundur punëmarrësit e ekspozuar ndaj mundësisë së një rreziku të lartë e të menjëhershëm rreth rrezikut dhe masave të marra ose që duhen ndërmarrë për t'u mbrojtur;

j) eviton kërkesën ndaj punëmarrësve për rifillimin e aktivitetit të tyre në një situatë në të cilën vazhdon të jetë prezent rreziku i lartë e i drejtpërdrejt, me përjashtim të rasteve të motivuara;

k) u lejon punëmarrësve të verifikojnë, nëpërmjet përfaqësuesit për sigurinë, aplikimin e masave të sigurisë e të mbrojtjes së shëndetit dhe i mundëson përfaqësuesit për sigurinë të konsultojë informacionet dhe dokumentet e ndërmarrjes;

l) merr masat e përshtatshme parandaluese për të evituar që masat për punët teknike të marra, të shkaktojnë rrezik për shëndetin e popullsisë ose të dëmtojnë ambientin e jashtëm;

m) mban një regjistër ku shënohen me radhë kronologjike aksidentet në punë, të cilat sjellin mungesën në punë të paktën për një ditë. Në regjistër shënohen emri, mbiemri, kualifikimi profesional i të aksidentuarit, shkaqet dhe rrethanat, si dhe data e marrjes dhe lënies së punës. Regjistri ruhet në vendin e punës në dispozicion të organeve të kontrollit;

n) konsulton përfaqësuesin për sigurinë;

o) merr masat e nevojshme për parandalimin e zjarreve dhe të evakuimit të punëmarrësve, si dhe në rastet e një rreziku të lartë e të menjëhershëm.

2.6 Punëdhënësi kryen vlerësimin dhe përgatit një dokument në bashkëpunim me përgjegjësin e zyrës për parandalimin dhe mbrojtjen, si dhe me mjekun kompetent në rastet që është i detyrueshëm kontrolli shëndetësor, duke konsultuar paraprakisht përfaqësuesin për sigurinë.

2.7 Vlerësimi dhe dokumenti i mësipërm rihartohen në rast modifikimesh të rëndësishme të procesit prodhues me qëllim sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve.

2.8 Punëdhënësi ruan në kantier kartelën shëndetësore e të rreziqeve të mundshme për punëmarrësin që i nënshtrohet kontrollit mjekësor, ruan sekretin profesional, dhe i dorëzon një kopje punëmarrësit në momentin e mbylljes së raportit të punës, ose në momentin që punëmarrësi bën kërkesë për të pasur një kopje.

2.9 Punëdhënësi i ndërmarrjeve, të cilat kanë deri në 10 punëmarrës, është gjithsesi i detyruar të autocertifikojë me shkrim kryerjen e vlerësimit të rreziqeve dhe plotësimin e detyrimeve të lidhura me to. Autocertifikimi duhet t'i dërgohet përfaqësuesit për sigurinë.

### 3. Detyrimet e punëmarrësve

3.1 Çdo punëmarrës duhet të kujdeset për sigurinë e shëndetin e tij dhe të personave të tjerë të pranishëm në vendin e punës, mbi të cilët mund të bien efektet e veprimeve të tij, në përputhje me formimin dhe udhëzimet e mjetet e vëna në dispozicion nga punëdhënësi.

#### 3.2 Në mënyrë të veçantë punëmarrësi:

a) ndjekin dispozitat dhe udhëzimet e dhëna nga punëdhënësi, nga drejtuesit, dhe personat e caktuar, me qëllim mbrojtjen kolektive e individuale;

b) përdorin në mënyrë të rregullt makineritë, aparatet, instrumentet, substancat e preparatet e rrezikshme, mjetet e transportit e mjete të tjera të punës, si dhe mekanizmat e sigurisë;

c) përdorin në mënyrë të përshtatshme mekanizmat e mbrojtjes të vëna në dispozicion të tyre;

d) njoftojnë menjëherë punëdhënësin, drejtuesin ose përgjegjësin e tyre për mangësitë në mjetet e mekanizmat në shkronjat "b" dhe "c", si dhe kushte të tjera rreziku për të cilat janë në dijeni, dhe japin ndihmën e tyre, në rast urgjencë, për të eliminuar ose reduktuar këto mangësi ose rreziqe, duke njoftuar përfaqësuesin e punëmarrësve për sigurinë;

e) nuk lëvizin ose ndryshojnë pa autorizim pajisjet e sigurisë, të sinjalizimit ose të kontrollit;

f) nuk duhet të ndërmarrin me iniciativën e tyre veprime ose lëvizje, të cilat nuk hyjnë në kompetencën e tyre dhe mund të vënë në rrezik sigurinë e tyre dhe të punëmarrësve të tjerë;

g) u nënshtrohen kontrolleve shëndetësore të parashikuara për ta;

h) kontribuojnë, së bashku me punëdhënësin, drejtuesit dhe përgjegjësit në plotësimin e detyrimeve të vëna nga autoritetet kompetente ose detyrimeve të nevojshme, për mbrojtjen e sigurinë e punëmarrësve.

### 4. Zyra për mbrojtjen dhe parandalimin

4.1 Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2.9, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes;

4.2 Punëdhënësi, duke u konsultuar paraprakisht me përfaqësuesin për sigurinë, zgjedh për kryerjen e detyrave brenda ndërmarrjes një ose dy persona që varen nga ai, ndër të cilët dhe përgjegjësin e zyrës, i cili ka kapacitetet dhe përmbush kërkesat profesionale të duhura.

4.3 Punëmarrësit duhet të jenë në numër të mjaftueshëm, të kenë aftësitë e duhura, mjetet e nevojshme dhe kohën e duhur për të kryer detyrat e ngarkuara. Këta nuk mund të paragjykoen për veprimet e kryera gjatë zhvillimit të detyrave të ngarkuara.

4.4 Me përjashtim të rasteve të parashikuara në 4.2, punëdhënësi mund të ngarkojë persona të jashtëm (jashtë ndërmarrjes), të cilët kanë njohuritë e duhura profesionale për të integruar veprimet e parandalimit e të mbrojtjes;

4.5 Nëse aftësitë e personave të brendshëm të ndërmarrjes ose të njësisë së prodhimit nuk janë të mjaftueshme, punëdhënësi duhet të kërkojë persona jashtë ndërmarrjes, duke konsultuar paraprakisht përfaqësuesin për sigurinë.

4.6 Shërbimi i jashtëm duhet të jetë i përshtatur me karakteristikat e ndërmarrjes ose njësisë operative në favor të së cilës do të kryejë aktivitetin e saj dhe në referim me numrin e punëmarrësve.

4.7 Përgjegjësi i jashtëm i shërbimit duhet të ketë aftësitë dhe kërkesat profesionale të përmendura në pikën 5.

4.8 Përgjegjësi i shërbimit edhe pse punëdhënësi ka ngarkuar persona të jashtëm shërbimi për sigurinë, nuk çlirohet nga përgjegjësia e tij në këtë fushë.

4.9 Punëdhënësi i komunikon Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Inspektoratit Sanitar Shtetëror, emërimin e personit përgjegjës për mbrojtjen dhe parandalimin, brenda ose/dhe jashtë ndërmarrjes. Ky komunikim bëhet nëpërmjet një deklarate me të cilën deklarohen personat e emëruar:

- detyrat e kryera në fushën e mbrojtjes dhe parandalimit ;
- periudha në të cilën janë kryer këto detyra;
- kurrikulumi profesional.

5. Kërkesat profesionale të punonjësve dhe të përgjegjësve të shërbimit, të brendshëm ose të jashtëm, për mbrojtjen dhe parandalimin.

5.1 Aftësitë dhe kërkesat profesionale të përgjegjësve e të personave të shërbimit të brendshëm ose të jashtëm, për mbrojtjen dhe parandalimin, duhet të jenë në përputhje me rreziqet e pranishme në vendin e punës dhe me aktivitetet e kryera gjatë punës.

5.2 Për kryerjen e detyrave nga ana e subjekteve në pikën 5.1, është e nevojshme që subjekti në fjalë të ketë një diplomë jo më të ulët se ajo e shkollës së lartë dhe të ketë një certifikatë të frekuentimit, të kurseve specifike të përshtatshme me natyrën e rreziqeve të pranishme në vendin e punës dhe gjatë aktiviteteve të punës.

5.3 Kurset e formimit të përmendura në pikën 5.2 organizohen, nga struktura publike dhe private.

5.4 Për kryerjen e funksionit të përgjegjës të shërbimit për parandalimin e mbrojtjen, krahas kërkesave në pikën 5.2, është e nevojshme të disponojë një certifikatë të frekuentimit për kurset e formimit në fushën e parandalimit të mbrojtjes nga rreziqet, dhe të natyrës ergonomike e psiko-sociale, të organizimit e drejtimit të aktiviteteve teknike administrative, të teknikave të komunikimit në ndërmarrje dhe të raporteve me sindikatat.

5.5 Përgjegjësit dhe personat e shërbimit për mbrojtjen dhe parandalimin, duhet të kryejnë kurse përditësuese sipas termave të përcaktuara, të paktën një herë në 5 vjet.

6. Detyrat e zyrës për mbrojtjen dhe parandalimin

6.1 Zyra për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet profesionale është përgjegjëse për:

a) përcaktimin e faktorëve të rrezikut, vlerësimin e rreziqeve dhe përcaktimin e masave për sigurinë e higjienën në vendet e punës, në përputhje me normat në fuqi në bazë të organizimit të ndërmarrjes.

b) hartimin, në bazë të kompetencave të saj, të masave mbrojtëse dhe parandaluese dhe sistemet e kontrollit për këto masa;

c) hartimin e procedurave të sigurisë për aktivitetet e ndryshme të ndërmarrjes;

d) propozimin e programeve të informimit e formimit për punëmarrësit;

e) marrjen pjesë në konsultimet në fushën e mbrojtjes së shëndetit e sigurisë;

f) vënien në dispozicion të punëmarrësve informacionet.

6.2 Punëdhënësi vë në dispozicion të zyrës për parandalimin e mbrojtjen informacione në lidhje me:

a) natyrën e rreziqeve;

b) organizimin e punës, programimin e zbatimit e masave parandaluese e mbrojtjes;

c) përshkrimin e impianteve dhe të proceseve prodhuese;

d) të dhënat e regjistrimit të incidenteve dhe të sëmundjeve profesionale;

e) përshkrimet e organeve të ruajtjes.

6.3 Punonjësit e zyrës për mbrojtjen dhe parandalimin dhe përfaqësuesit e punëmarrësve për sigurinë duhet të ruajnë sekretin në lidhje me proceset e punës, për të cilat marrin informacione gjatë kryerjes së funksioneve të përmendura me këtë rregullore.

6.4 Zyra e mbrojtjes dhe parandalimit, vihet në punë nga punëdhënësi.

7. Kryerja e drejtpërdrejtë nga punëdhënësi e detyrave për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet

7.1 Punëdhënësi mund të kryejë drejtpërdrejt detyrat e zyrës për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, si dhe të parandalimit të zjarrit e të evakuimit, duke informuar paraprakisht përfaqësuesin e sigurisë, për kushtet e sigurisë të cituara në pikat që vijojnë;

7.2 Punëdhënësi, që ka për qëllim të kryejë këto detyra duhet të ndjekë kurset e formimit përkatëse në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës, të organizuara nga subjektet publike ose privatë dhe i vë në dispozicion strukturave përkatëse të kontrollit për territorin:

a) një deklaratë që vërteton aftësitë e kryerjes së detyrave për mbrojtjen e parandalimin nga rreziqet;

b) një deklaratë në lidhje me plotësimin e detyrave;

c) një relacion në lidhje me aksidentet dhe sëmundjet profesionale në ndërmarrje, të hartuar në bazë të të dhënave të regjistrimit të aksidenteve, ose në mungesë të këtij, të një dokumenti të ngjashëm të parashikuar nga legjislativi në fuqi;

d) certifikatë në lidhje me frekuentimin e kurseve të formimit në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës.

8. Mbledhja periodike për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet e mundshme.

8.1 Në ndërmarrje, subjekte ose në njësitë e prodhimit, të cilat kanë më shumë se 15 punëmarrës, punëdhënësi, drejtpërdrejt ose nëpërmjet shërbimit për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet e mundshme, organizon të paktën një herë në vit, një mbledhje, në të cilën marrin pjesë:

- punëdhënësi ose një përfaqësues i tij;

- përfaqësuesi i zyrës për mbrojtjen dhe parandalimin;

- mjeku kompetent, atëherë kur parashikohet prania e tij;

- përfaqësuesi për sigurinë.

8.2 Gjatë mbledhjes, punëdhënësi u jep pjesëmarrësve për shqyrtim:

a) dokumentin e vlerësimit të rreziqeve të mundshme;

b) përshtatshmërinë e mjeteve për mbrojtjen individuale;

c) programet për informimin dhe formimin e punëmarrësve për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të tyre.

8.3 Mbledhja kryhet gjithashtu kur ka ndryshime të rëndësishme në kushtet e ekspozimit të rrezikut, përfshirë programimin dhe futjen e teknologjive të reja, të cilat ndikojnë në shëndetin dhe sigurinë e punëmarrësve.

8.4 Në ndërmarrjet ose në njësitë e prodhimit, të cilat kanë deri në 15 punëmarrës, përfaqësuesi i punëmarrësve për sigurinë mund të kërkojë organizimin e kësaj mbledhjeje.

8.5 Punëdhënësi edhe nëpërmjet zyrës për parandalimin dhe mbrojtjen nga rreziqet, harton procesverbalin e mbledhjes, që vihet në dispozicion të pjesëmarrësve në mbledhje, për konsultim.

9. Evakuimi i punëmarrësve, ndihma e shpejtë

9.1 Dispozita të përgjithshme

Punëdhënësi:

a) organizon raportet e nevojshme me strukturat publike kompetente në fushën e ndihmës së shpejtë, shpëtimit, masave kundër zjarrit dhe drejtimin e emergjencës;

b) cakton paraprakisht punëmarrësit që do të zbatojnë masat e përmendura në pikën 2 të këtij aneksi;

c) informon të gjithë punëmarrësit, që mund të jenë të ekspozuar ndaj një rreziku të lartë e të menjëhershëm, rreth masave të marra dhe veprimet që duhet të ndërmerren;

d) programon ndërhyrjet, merr masat dhe jep udhëzime në mënyrë që punëmarrësit, në rast rreziku të lartë e të menjëhershëm që nuk mund të evitohet, të lënë aktivitetin e të sigurojnë vetveten duke u larguar nga vendi i punës menjëherë;

e) merr masat e nevojshme, në mënyrë që cilido punëmarrës, në rast rreziku të lartë e të menjëhershëm, për sigurinë e tij e të personave të tjerë dhe në pamundësi për të kontaktuar eprorin direkt kompetent, të marr masat e nevojshme për të evituar efektet e këtij rreziku, duke përdorur njohuritë e tij dhe mjetet teknike në dispozicion.

Në përcaktimin e personave, punëdhënësi mban parasysh madhësinë e ndërmarrjes, si dhe rreziqet specifike të ndërmarrjes ose njësiteve të prodhimit.



Punëmarrësit nuk mund të refuzojnë këtë emërim, me përjashtim të rasteve kur kanë motivacionet e duhura. Ata duhet të informohen, të jenë në numër të mjaftueshëm e të kenë në dispozicion mjetet e duhura, duke pasur parasysh madhësinë e ndërmarrjes dhe rreziqet specifike të saj dhe njësive të prodhimit.

Punëdhënësi nuk duhet t'u kërkojë punëmarrësve të rifillojnë aktivitetin në vendin e punës në një situatë në të cilën vazhdon rreziku i lartë e i menjëhershëm, me përjashtim të rasteve me motivimet e duhura.

#### 9.2 Të drejtat e punëmarrësve në rast rreziku të lartë e të menjëhershëm

Punëmarrësi i cili në rast rreziku të lartë e të menjëhershëm, që nuk mund të evitohet, largohet nga vendi i punës, pra nga zona e rrezikut, dhe nuk mund të paragjykohet për këtë veprim dhe duhet të mbrohet nga çdo efekt i dëmshëm.

Punëmarrësi që në rast rreziku të lartë e të menjëhershëm, që nuk mund të kontaktojë eprorin direkt kompetent, merr masat për të evituar efektet e këtij rreziku dhe nuk mund të paragjykohet për këto veprime me përjashtim të rasteve kur ka neglizhencë të rëndë nga ana e tij.

### 10. Ndihma e shpejtë

10.1 Punëdhënësi, duke marrë në konsideratë natyrën e aktivitetit dhe madhësinë e ndërmarrjes dhe të njësive të prodhimit, pasi ka marrë mendimin e mjekut kompetent, aty ku është e parashikuar, merr masat e duhura në fushën e ndihmës së shpejtë e të asistencës mjekësore e të emergjencës, duke pasur parasysh praninë e personave të tjerë në vendin e punës e duke vendosur raportet e nevojshme me shërbimet e jashtme, dhe për transportin e punëmarrësve të aksidentuar.

10.2 Punëdhënësi, kur nuk i përcakton vetë, emëron një ose më shumë punëmarrës për zbatimin e masave në pikën 10.1.

10.3 Karakteristikat minimale të mjeteve të ndihmës së shpejtë, kërkesat e personelit dhe formimi i tyre përcaktohen në lidhje me natyrën e aktivitetit, numrin e punëmarrësve dhe faktorëve të rrezikut.

### 11. Kontrolli shëndetësor

#### 11.1 Përmbajtja e kontrollit shëndetësor

Kontrolli shëndetësor kryhet në rastet e parashikuara me aktet në fuqi.

Kontrolli shëndetësor kryhet nga mjeku kompetent dhe përfshin:

a) kontrollin paraprak për të konstatuar nëse ka kushte të përshtatshme në punë ndaj të cilave rrezikohen punëmarrësit dhe nëse punëmarrësit janë të përshtatshëm nga ana shëndetësore për të kryer atë detyrë;

b) kontrole periodike për shëndetin e punëmarrësve dhe shprehjen e mendimit mbi përshtatshmërinë e punës.

Kontrollet përfshijnë analiza biologjike dhe diagnoza, të cilat janë të nevojshme sipas mjekut kompetent.

#### 11.2 Mjeku kompetent

##### 1. Mjeku kompetent:

a) bashkëpunon me punëdhënësin dhe zyrën për parandalimin dhe mbrojtjen, sipas organizimit të ndërmarrjes, njësive të prodhimit dhe situatave të rrezikut, të përgatitjes për zbatimin e masave për mbrojtjen e shëndetit dhe integritetit psikofizik të punëmarrësve;

b) kryen kontrole mjekësore;

c) shpreh mendimin për përshtatshmërinë e punëmarrësve për një detyrë specifike në punë;

d) përgatit dhe përditëson nën përgjegjësinë e tij kartelën shëndetësore dhe të rreziqeve, për çdo punëmarrës që i nënshtrohet kontrollit shëndetësor, nga të cilat duhet mbrojtur, që mbahet nga punëdhënësi duke ruajtur sekretin profesional;

e) u jep punëmarrësve informacione mbi kuptimin e kontroleve mjekësore që u nënshtrohen, e në rast të ekspozimit, ndaj substancave me efekt në periudhë kohe të gjatë, nevojën për kontrole mjekësore edhe pas lënies së punës, që sjell ekspozimin ndaj këtyre substancave. U jep informacione të ngjashme përfaqësuesve të punëmarrësve për sigurinë, kur këta bëjnë kërkesë;

f) informon çdo punëmarrës të interesuar mbi rezultatet e kontrollit shëndetësor dhe me kërkesë të punëmarrësit i jep një kopje të dokumenteve shëndetësore;

g) i komunikon në mbledhjet periodike, përfaqësuesit për sigurinë, rezultatet anonime kolektive të kontrolleve klinike e instrumentale të testeve të kryera dhe jep indikacionet e duhura në bazë të këtyre rezultateve;

h) së bashku me përgjegjësin e shërbimit për parandalimin dhe mbrojtjen nga rreziqet, viziton ambientet e punës të paktën dy herë në vit dhe merr pjesë në programimin e kontrolleve të ekspozimit të punëmarrësve, rezultatet e të cilave i jepen sa më shpejt për vlerësim dhe mendim të kompetentëve;

i) me përjashtim të kontrolleve të përmendura në shkronjën “b”, kryen vizitat mjekësore të kërkuara nga punëmarrësi, kur kjo kërkesë është e lidhur me rreziqet profesionale;

j) bashkëpunon me punëdhënësin në përgatitjen e shërbimit të ndihmës së shpejtë ;

k) bashkëpunon në aktivitetet e informimit dhe formimit.

2. Mjeku kompetent, mbi bazën e motiveve të argumentuara, mund të bashkëpunojë me mjekun specialist të zgjedhur nga punëdhënësi, i cili mbulon shpenzimet e mjekut specialist.

3. Kur mjeku specialist, në vijim të kontrolleve shëndetësore, shprehet për aftësinë për punë të pjesshme, të përkohshme ose totale të punëmarrësit, informon me shkrim punëdhënësin dhe punëmarrësin.

4. Për mendimin e shprehur në pikë 3 të mësipërme, mund të bëhet ankesë te struktura përkatëse brenda 30 ditëve nga komunikimi i vendimit, nga punëmarrësi Ky organ shprehet pas verifikimeve të mëtejshme lidhur me konfirmimin, modifikimin ose anulimin e vendimit.

5. Mjeku kompetent kryen detyrën e tij në cilësi të:

a) varësisë nga një strukturë publike ose private, të cilat kanë marrëveshje me ndërmarrjen për kryerjen e detyrave të përmendura në këtë aneks;

b) profesionistit të lirë;

c) varësisë nga punëdhënësi.

6. Në rastin kur mjeku kompetent është në varësi të punëdhënësit, ky i fundit i vë në dispozicion mjetet e nevojshme.

12. Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve.

12.1 Përfaqësuesi i punëmarrësve për sigurinë.

Në të gjitha ndërmarrjet, zgjidhet ose emërohet një përfaqësues për sigurinë.

Në ndërmarrjet që kanë deri në 15 punëmarrës në vartësi, përfaqësuesi për sigurinë mund të caktohet për më shumë se një ndërmarrje në të njëjtin territor, ose të njëjtat ndarje/zona/sectorë prodhimi.

Ky mund të zgjidhet ose emërohet nga punëmarrësit, në kuadrin e përfaqësuesve sindikalistë, ose përfaqësues të kontratës kolektive.

Në ndërmarrjet ose njësitë e prodhimit, me më shumë se 15 punëmarrës në varësi, përfaqësuesi për sigurinë zgjidhet ose emërohet nga punëmarrësit në kuadrin e përfaqësuesve sindikalistë në ndërmarrje. Në mungesë të këtyre përfaqësuesve, zgjidhet nga punëmarrësit e vetë ndërmarrjes.

Numri, mënyrat e emërimit ose të zgjedhjeve për përfaqësuesin për sigurinë, si dhe koha e punës së paguar dhe instrumentet për kryerjen e funksioneve, përcaktohen në kuadrin e kontratës kolektive.

Në rast të mungesës së kontratës kolektive të përmendur, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, pasi ka dëgjuar palët, përcakton me urdhër të saj, që publikohet brenda tre muajve nga data e komunikimit të mungesës së marrëveshjes, procedurat për caktimin e përfaqësuesit për sigurinë.

Në çdo rast numri minimal i përfaqësuesve është si vijon:

a) një përfaqësues në ndërmarrjet, ose njësitë e prodhimit me deri në 200 punëmarrës;

b) tre përfaqësues në ndërmarrjet ose njësitë e prodhimit me nga 200 deri në 1000 punëmarrës;

c) gjashtë përfaqësues në të gjitha ndërmarrjet ose njësitë e prodhimit mbi 1000 punëmarrës.

Mënyrat dhe përmbajtja specifike e formimit të përfaqësuesit për sigurinë përcaktohet me udhëzim të veçantë

## 12.2 Detyrat e përfaqësuesit për sigurinë.

Përfaqësuesi për sigurinë:

- a) mund të hyjë në vendet ku kryhen aktivitetet e punës;
- b) konsultohet paraprakisht dhe menjëherë për vlerësimin e rreziqeve, përcaktimin, programimin, realizimin dhe verifikimin e parandalimit dhe mbrojtjes në ndërmarrje ose në njësitë e prodhimit;
- c) konsultohet në emërimin e personelit për zyrën e parandalimit dhe mbrojtjes, në aktivitetet e parandalimit të zjarreve, të ndihmës së shpejtë, evakuimit të punëmarrësve;
- d) konsultohet për organizimin e formimit;
- e) konsulton informacionet dhe dokumentet e ndërmarrjes në lidhje me vlerësimin e rreziqeve dhe masave parandaluese përkatëse, si dhe ato në lidhje me substancat dhe preparatet e rrezikshme, makineritë, impiantet, organizimin e vendeve të punës, aksidentet dhe sëmundjet profesionale;
- f) merr informacione nga shërbimet e ruajtjes;
- g) merr një formim të përshtatshëm;
- h) promovon hartimin, përcaktimin dhe zbatimin e masave të parandalimit të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit dhe integritetit fizik të punëmarrësve;
- i) formulon vërejtjet e bëra në kontrollet dhe verifikimet e kryera nga autoritet kompetente;
- l) merr pjesë në mbledhjet periodike;
- m) bën propozime në lidhje me aktivitetet e parandalimit të rreziqeve;
- n) paralajmëron përgjegjësin e ndërmarrjes lidhur me rreziqet e vërejtura gjatë kryerjes së detyrave të tij;
- o) mund të bëjë ankesë tek autoritetet kompetente në rastet kur vëren se masat parandaluese të mbrojtjes nga rreziqet dhe mjetet e vëna në punë për zbatimin e tyre nuk janë të përshtatshme për të garantuar sigurinë dhe shëndetin gjatë punës.

Përfaqësuesi për sigurinë duhet të ketë në dispozicion kohën e duhur për kryerjen e funksioneve të tij pa pasur humbje në pagesë, si dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e funksioneve dhe përdorimin e kompetencave të njohura.

Mënyrat dhe procedurat për kryerjen e detyrave të mësipërme përcaktohen në kontratën e punës.

Përfaqësuesi për sigurinë nuk mund të paragjykohej për shkak të kryerjes së funksionit të tij, për të aplikohen të gjitha masat mbrojtëse të parashikuara nga ligji për përfaqësuesit e sindikatave.

Përfaqësuesi për sigurinë, mund të përdorë dokumentin e vlerësimit të rreziqeve, si dhe të regjistrit të aksidenteve në punë me qëllim kryerjen e detyrës.

## 13. Informimi dhe formimi i punëmarrësve.

### 13.1 Informimi i punëmarrësve.

Punëdhënësi merr masat që çdo punëmarrës të marr informacionet e duhura në lidhje me:

- a) rreziqet për sigurinë dhe shëndetin që lidhen me aktivitetet e ndërmarrjes në përgjithësi;
- b) masat dhe aktivitetet e marra për mbrojtjen dhe parandalimin;
- c) rreziqet specifike ndaj të cilave ekspozohet në kryerjen e detyrës, rregullat e sigurisë dhe rregullat përkatëse të ndërmarrjes;
- d) rreziqet e lidhura me përdorimin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme duke u bazuar në skedat e të dhënave të sigurisë, të parashikuara nga rregullat dhe aktet në fuqi dhe nga rregullat teknike dhe standardet;
- e) procedurat në lidhje me ndihmën e shpejtë, veprimet kundër zjarrit dhe evakuimin e punëmarrësve;
- f) përgjegjësin e shërbimit për sigurinë e mbrojtjen dhe mjekun kompetent;
- g) emrat e punëmarrësve të ngarkuar për zbatimin e masave të sigurisë.

### 13.2 Formimi i punëmarrësve.

Formimi i punëmarrësve duhet të kryhet në rastin e:

- marrjes në punë;
- transferimit ose ndryshimit të detyrave ;

- kur futen në përdorim teknologji ose makineri të reja, substanca të reja ose preparate të rrezikshme.

Kurset e formimit duhet të kryhen periodikisht në mënyrë të përsëritur në lidhje me evoluimin e rreziqeve, ose të rreziqeve të reja.

Përfaqësuesi për sigurinë ka të drejtën e një formimi të veçantë në fushën e shëndetit dhe sigurisë, lidhur me aktet në fuqi në fushën e sigurisë, shëndetit e rreziqeve specifike ekzistuese në ambientet dhe për punëmarrësit që ai përfaqëson, në mënyrë që t'i japë nocionet e përshtatshme mbi teknikat kryesore të kontrollit dhe parandalimit të rreziqeve.

Punëmarrësit e ngarkuar me aktivitetet për parandalimin e zjarreve dhe kundër zjarrit, për evakuimin e punëmarrësve në rast rreziku të lartë e të menjëhershëm, të shpëtimit e ndihmës së shpejtë, e gjithësi të drejtimit të emergjencës, duhet të formohen në mënyrën e duhur.

Formimi i punëmarrësve dhe i përfaqësuesve të tyre, duhet të kryhet në bashkëpunim me organizmat përkatës, gjatë orarit të punës dhe nuk mund të ketë kosto ekonomike për punëmarrësit.

Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, pasi ka dëgjuar Këshillin Kombëtar të Punës, mund të përcaktojë përmbajtjen minimale të formimit të punëmarrësve, përfaqësuesve për sigurinë dhe të punëdhënësve, siç është cituar në nenin 10, pika 3, duke marrë parasysh madhësinë dhe tipologjinë e ndërmarrjes.

#### 14. Vendet e punës

14.1 Në aplikimin e këtyre kërkesave të rregullores, me vend pune nënkuptohen :

a) të gjitha vendet e punës, ku punëmarrësit duhet të jenë ose duhet të shkojnë për qëllime pune dhe që janë nën kontrollin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të punëdhënësit.

14.2 Këto rregulla, kërkesa nuk aplikohen:

a) për mjetet e transportit;

b) në industrinë nxjerrëse;

c) në varkat e peshkimit;

d) në fushat, pyjet dhe terrenet e tjera që janë pjesë e një ndërmarrjeje bujqësore ose pyjesh, që janë të vendosura jashtë zonave të ndërtesave të ndërmarrjes.

14.3 Kërkesat për sigurinë dhe shëndetin.

Nëse përshtatshmëria e masave të pikës 14 kërkojnë një akt paraprak lejues, punëdhënësi duhet të fillojë menjëherë procedurat për lëshimin e këtij akti dhe t'u përgjigjet detyrimeve brenda 6 muajve nga data e lëshimit të tij.

Deri sa vendet e punës të përshtaten, punëdhënësi duke konsultuar paraprakisht përfaqësuesin për sigurinë, merr masat alternative, të cilat garantojnë një nivel sigurie të njëjtë.

14.4 Detyrimet e punëdhënësit.

Punëdhënësi merr masat në lidhje me:

a) rrugët për qarkullimin e brendshëm ose të jashtëm që të çon në dalje ose në dalje të emergjencës dhe që daljet e emergjencës të jenë të lira me qëllim që të lejohet përdorimi i tyre në çdo rast të nevojshëm;

b) vendet e punës, impiantet dhe mekanizmat i nënshtrohen mirëmbajtjes teknike, defektet e zbuluara eliminohen sa më shpejt të jetë e mundur, pasi mund të rrezikojnë sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve;

c) vendet e punës, impiantet dhe mekanizmat u nënshtrohen një pastrimi të rregullt, për të siguruar kushtet higjienike të përshtatshme;

d) impiantet dhe mekanizmat e sigurisë, të përcaktuar për parandalimin ose eliminimin e rreziqeve, i nënshtrohen mirëmbajtjes së rregullt dhe kontrollit për funksionimin e tyre.

15. Përdorimi i pajisjeve në punë.

15.1 Përkufizime

Në aplikimin e këtyre rregullave, kërkesave, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

a) pajisje pune është çdo makinë, aparat, instalim që përdoret në punë;

b) përdorim i një pajisje pune: çdo operacion pune i lidhur me një pajisje pune në përdorim ose jo, transporti, riparimi, transformimi, mirëmbajtja, pastrimi, çmontimi;

c) zonë e rrezikshme: çdo zonë brenda ose në afërsi të një pajisje pune, në të cilën prania e një punëmarrësi përbën rrezik për shëndetin ose sigurinë e tij.

ç) puna në lartësi: aktivitet pune e cila ekspozon punëmarrësin ndaj rrezikut të rënies nga një lartësi më e madhe se 2 metra, referuar një niveli të palëvizshëm.

#### 15.2 Detyrimet e punëdhënësit

Punëdhënësi vë në dispozicion të punëmarrësve, pajisje të përshtatshme, për punën që do të kryhet, për qëllimin dhe për sigurinë dhe shëndetin. Punëdhënësi vë në zbatim masa teknike dhe organizative të përshtatshme për të zvogëluar në minimum rreziqet e lidhura me përdorimin e pajisjeve të punës nga ana e punëmarrësve, për të parandaluar që këto mjete të përdoren për operacione ose në kushte për të cilat nuk janë të përshtatshme. Pajisjet e punës që vendosen për herë të parë në shërbim duhet të plotësojnë kërkesat e dhëna në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Në momentin e zgjedhjes së pajisjeve të punës, punëdhënësi merr në konsideratë:

a) kushtet dhe karakteristikat specifike të punës që do të kryhet;

b) rreziqet e pranishme në ambientin e punës;

c) rreziqe për shkak të vënies në punë të këtyre pajisjeve ;

ç) sistemet e komandave, të cilat duhet të jenë të sigurta, duke marr në konsideratë prishjet dhe sinjalizimet e parashikuara për përdorimin e projektuar të pajisjes.

Punëdhënësi merr masat e nevojshme në mënyrë që pajisjet e punës të jenë:

a) të instaluar në përputhje me udhëzimet e prodhuesit;

b) të përdoren në mënyrë të rregullt;

c) të mirëmbahen e të jenë të pajisura me udhëzuesit e përdorimit, aty ku është e nevojshme të jenë të vendosura në mënyrë të tillë që të reduktohen rreziqet për përdoruesit dhe personat e tjerë, duke siguruar në mënyrë të veçantë hapësirë të mjaftueshme midis elementeve të lëvizshme dhe elementeve fikse ose të rrethuar nga makineri lëvizëse dhe që energjia dhe substancat e përdorura mund të sillen ose të hiqen në mënyrë të sigurt.

Punëdhënësi siguron që në përdorimin e pajisjeve të punës të lëvizshme, pjesërisht të lëvizshme ose jo të lëvizshme:

a) të vendosen dhe të respektohen rregullat e qarkullimit për pajisjet e punës që lëvizin në një zonë të caktuar pune ;

b) të merren masa organizative për të evituar që punëmarrësit në këmbë të gjenden në zonën e aktivitetit të pajisjeve të lëvizshme ose pjesërisht të lëvizshme e që gjithsesi të merren masa të përshtatshme për të evituar që në rastet kur prania e punëmarrësve në këmbë të jetë e nevojshme për një realizim të mirë të punëve, këta të mos dëmtohen nga të tilla makineri;

c) Transporti i punëmarrësve mbi këto mjete të lëvizshme në mënyrë mekanike të bëhet në vende të sigurta, të parashikuara për këtë qëllim dhe nëse duhet të punohet gjatë lëvizjes, shpejtësia e këtyre makinerive të jetë e përshtatshme ;

d) Pajisjet e lëvizshme të punës, me motor me djegie, të përdoren në zonat në të cilat është e siguruar një sasi e mjaftueshme ajri pa rreziqe për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve.

Punëdhënësi merr masa që në përdorimin e pajisjeve për ngritjen e peshave të jetë e siguruar që:

a) aksesorët e ngritjes të jenë zgjedhur në funksion me peshën, me pikën e ngritjes, të mekanizmave të gançës, të kushteve atmosferike, si dhe duke mbajtur parasysh mënyrën dhe konfigurimin e rripit të lidhjes; që kombinimi i pjesëve pas ngritjes të jetë i dallueshëm në mënyrë që përdoruesi të njohë karakteristikat e gjithsecilës prej pjesëve, po kështu edhe në rastin kur pas përdorimit nuk zmontohen; pjesët e ngritura të jenë të depozituara në mënyrë që mos të dëmtohen ose prishen;

b) në rastin kur dy ose më shumë pajisje pune shërbejnë për ngritjen e peshave (që nuk janë të drejtuara, kontrolluara, që mund të lëvizin gjatë ngritjes) janë të instaluar në mënyrë që rrezet e tyre të ndërpriten, merren masat e përshtatshme për të evituar përplasjen midis ngarkesave e elementeve të pajisjeve ngritëse;

c) që punët të jenë të organizuara në mënyrë të tillë, që kur një punëmarrës lidh ose zgjidh me krahe një ngarkesë, këto operacione të kryhen në siguri të plotë dhe në mënyrë të tillë që punëtori të ketë kontrollin direkt ose indirekt të ngarkesës;

d) të gjitha veprimet e ngritjes të jenë të programuara në mënyrë të rregullt si dhe të kontrollohen në mënyrë korrekte që të sigurojnë mbrojtjen e punëmarrësve; në mënyrë të veçantë

për një ngarkesë që duhet ngritur në të njëjtën kohë nga dy ose më shumë pajisje, pa qenë të drejtuara, të aplikohet një procedurë përdorimi për të garantuar një koordinim të mirë midis operatorëve të përdorimit;

e) kur pajisjet e punës që shërbejnë për ngritjen e ngarkesave, nuk mund t'i mbajnë ngarkesat në rast ndërprerje të pjesshme ose totale të energjisë, merren masat e nevojshme për të evituar ekspozimin e punëmarrësve ndaj rreziqeve përkatëse; ngarkesat e varura nuk duhet të mbeten pa kontroll, me përjashtim të rasteve kur hyrja në zonën e rrezikut është e bllokuar dhe ngarkesa është e lidhur dhe fiksuar me sigurinë maksimale;

f) kur kushtet meteorologjike përkeqësohen deri në një pikë të tillë që mund të vënë në rrezik sigurinë e funksionimit, dhe rrezikun eventual ndaj punëmarrësve, përdorimi në hapësirë i pajisjeve të punës që shërbejnë për ngritjen e peshave, jo të drejtuara, duhet bllokuar dhe të merren masat e nevojshme mbrojtëse për punëmarrësit dhe në mënyrë të veçantë masa që pengojnë rënien e pajisjeve të punës.

Punëdhënësi, në përputhje me rregullat në fuqi, merr masat që pajisjet t'u nënshtrohen kontrolleve para instalimit dhe kontrolleve periodike e të jashtëzakonshme, me qëllim që të sigurojë instalimin korrekt dhe funksionimin e mirë.

Rezultatet e kontrolleve të mësipërme mbahen në dispozicion të strukturave të mirëmbajtjes, për 5 vjet nga data e fundit e regjistrimit ose deri në nxjerrjen jashtë pune të makinerisë, nëse kjo ndodh para kësaj periudhe. Një dokument që certifikon kryerjen e kontrollit të fundit duhet t'i shoqërojë makineritë e punës kudo që përdoren.

Kur makineritë që vihen në punë kërkojnë njohuri ose përgjegjësi specifike atëherë punëdhënësi siguron që:

a) përdorimi i tyre duhet t'i rezervohet vetëm punëmarrësve përgjegjës të ngarkuar ;

b) në rast riparimi, transformimi ose mirëmbajtjeje, punëmarrësi i interesuar për të punuar kualifikohet në mënyrë specifike për të kryer këtë detyrë.

### 15.3 Detyrimet e punëdhënësit në përdorimin e pajisjeve të punës në lartësi

Punëdhënësi, në rastet kur kryen punime të përkohshme në lartësi , të cilat nuk mund të realizohen në kushte sigurie dhe në kushte ergonomike të përshtatshme duke filluar që nga mungesa e vendit të përshtatshëm me qëllimin, zgjedh pajisjet e punës më të përshtatshme për të garantuar mbajtjen e kushteve të punës të sigurta, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

a) i jep prioritet masave mbrojtëse kolektive në lidhje me masat e mbrojtjes individuale;

b) dimensionon pajisjet e punës, të përshtatshme me natyrën e punës që duhet kryer, me sinjalizimet e parashikueshme dhe me qarkullim pa shkaktuar rrezik.

Punëdhënësi zgjedh mënyrën më të përshtatshme për hyrjen në vendin e punës të përkohshëm në lartësi, në raport me frekuencën e qarkullimit, me disnivele dhe kohën e nevojshme për këtë. Rrugët e hyrjes duhet të lejojnë evakuimin në rast rreziku. Kalimi nga një sistem i hyrjes në platformë, struktura provizore, skela, ura dhe anasjelltas nuk duhet të sjellë rrezik rënie.

Punëdhënësi vë në dispozicion në kryerjen e punëve në lartësi, përdorimin e një shkalle të kryqëzuar, nëse përdorimi i pajisjeve të tjera të punës, të cilat konsiderohen të sigurta, nuk vlerësohen si të tilla, për shkak të nivelit të vogël të rrezikut dhe kohës së shkurtër të përdorimit, ose të karakteristikave ekzistuese të skelës që nuk mund të ndryshohet.

Gjithashtu punëdhënësi vë në përdorim një ndenjësë në të cilën janë vendosur pajisjet e duhura për përdorimin dhe vlerësimin e rezultateve të rreziqeve dhe në mënyrë të veçantë, në funksion të kohës për kryerjen e punëve e të pengesave me karakter ergonomik.

Punëdhënësi, në lidhje me tipin e pajisjeve të punës të përzgjedhura, në bazë të pikëve të mëparshme, përcakton masat që do të zbatohen për të minimizuar rreziqet për punëmarrësit që janë të pranishme në pajisjet e përdorura, duke instaluar mekanizmat e mbrojtjes kundër rënies aty ku është e nevojshme. Këto mekanizma duhet të pozicionohen dhe të kenë një rezistencë të tillë që të evitojnë ose pengojnë rënien nga vendet e punës në lartësi dhe të parandalojnë sa të jetë e mundur dëmtime të mundshme të punëmarrësve. Mekanizmat e mbrojtjes kolektive kundër rënies mund të mos përdoren vetëm në pikat ku ka shkallë lëvizëse ose të fiksuara.

Punëdhënësi, në rastin kur kryerja e një pune me natyrë të veçantë kërkon mospërdorimin e përkohshëm të një mekanizmi mbrojtës kolektiv kundër rënies, merr masat e sigurisë së

barasvlershme dhe efikase. Puna kryhet pasi të jenë marrë këto masa. Kur punët me natyrë të veçantë kanë përfunduar krejtësisht ose pjesërisht, mekanizmat e mbrojtjes kolektive kundër rënieve mund të vendosen përsëri. Punëdhënësi kryen punët e përkohshme në lartësi vetëm në rastet kur kushtet meteorologjike nuk vënë në rrezik sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve.

15.4 Detyrimet e punëdhënësit në lidhje me përdorimin e shkallëve të montuara me pjesë të kryqëzuara.

1. Punëdhënësi siguron që shkallët e montuara të sistemohen në mënyrë që të garantojnë stabilitet gjatë përdorimit dhe sipas kriterëve të mëposhtme:

a) shkallët e kryqëzuara portative duhet të vendosen në një mbështetës të qëndrueshëm, rezistent, me dimensione të përshtatshme dhe të palëvizshme, në mënyrë që të garantojë pozicionin horizontal të pjesëve;

b) shkallët e kryqëzuara duhet të varen në mënyrë të sigurt dhe me përjashtim të shkallëve me kavo, në mënyrë të tillë që të evitohet zhvendosjen ose çfarëdo lloj lëvizje që shkakton lëkundje;

c) rrëshqitja e këmbës në shkallët lëvizëse gjatë përdorimit duhet të mënjanohet duke fiksuar elemente në pjesën e sipërme ose poshtë, ose me çdo mekanizëm tjetër kundër rrëshqitjes, ose duke përdorur çfarëdo zgjidhje tjetër efikase dhe ekuivalente;

d) Shkallët me pjesë horizontale lëvizëse të përdorura për hyrje duhet të jenë të tilla që të dalin jashtë nivelit të hyrjes në mënyrë të mjaftueshme, ose në të kundërt mekanizmat e tjerë të garantojnë kapjen e sigurt.

e) Shkallët me pjesë të përbëra nga më shumë se dy elemente jo stabël ose të lira duhet të përdoren në mënyrë që të sigurojnë ndalimin reciprok të elementëve të ndryshëm;

f) Shkallët me pjesë të lëvizshme duhet të fiksohen para përdorimit.

2. Punëdhënësi siguron që shkallët me pjesë të lëvizshme të përdoren në mënyrë që t'i lejojnë punëmarrësit të mbështetet e të kapet në mënyrë të sigurt në çdo moment.

15.5 Detyrimet e punëdhënësit në lidhje me përdorimin e skelave

Punëdhënësi kryen një analizë të llogaritjes të rezistencës e të stabilitetit për çdo skemë të përdorimit të skelave, nëse në relacionin e llogaritjeve të skelave nuk janë specifikuar struktura të ndryshme të përdorimit, me skemat përkatëse shpjeguese të përdorimit. Punëdhënësi nëpërmjet një personi kompetent në fushën e montimit, harton një plan montimi, përdorimi dhe zmontimi, në funksion të kompleksitetit të skelave të zgjedhura.

Ky plan mund të ketë formën e planeve të aplikimit të përgjithshëm të integruar me udhëzime e projekte të detajuara për skema të veçanta që përbëjnë skelat, dhe vihet në dispozicion të personit të ngarkuar për sigurinë dhe ruajtjen e punëmarrësve të interesuar.

Punëdhënësi siguron që:

a) rrëshqitja e elementeve mbështetës të një skele, të pengohet me anë të fiksimit në sipërfaqen e mbështetësit, ose me një mekanizëm antirrëshqitëse, ose me çfarëdo zgjidhje tjetër ekuivalente;

b) nivelet e vendosjes për të tillë elemente të mbështetjes të kenë një kapacitet mbajtës të mjaftueshëm;

c) skela të jetë e palëvizshme;

d) mekanizmat e nevojshëm duhet të pengojnë zhvendosjen e padëshiruar të skelave mbi rrota gjatë kryerjes së punëve në lartësi;

e) dimensionet, format, dhe pozicionimi i pjesëve të strukturës së skelave duhet të jenë të përshtatshme me natyrën e punës që duhet bërë, me ngarkesat që duhet të mbajë dhe të tilla që të lejojnë kryerjen e punimeve dhe lëvizjen e sigurt;

f) montimi i pjesëve të skelës duhet të jetë i tillë që të pengojë zhvendosjen e elementëve përbërëse gjatë përdorimit, si dhe prezencën e hapësirave boshe të rrezikshme midis elementeve që përbëjnë pjesët mbajtëse dhe pjesët vertikale së bashku për mbrojtjen kundër rënies.

Punëdhënësi duhet të evidentojë pjesët e skelave që nuk janë gati për përdorim, në veçanti gjatë montimit, zmontimit dhe transformimit, nëpërmjet shenjave të sinjalizimit për praninë e rrezikut duke e kufizuar me elemente e materiale që pengojnë hyrjen në zonën e këtyre skelave.

Punëdhënësi duhet të sigurojë që skelat të montohen, zmontohen dhe transformohen nën vëzhgimin e njërit prej punëmarrësve të përzgjedhur që ka një kualifikim të përshtatshëm për këto veprime.

Kualifikimi ka karakter teoriko-praktik dhe duhet të përfshijë:

- a) shpjegime në lidhje me nivelin e montimit, çmontimit ose transformimit të skelave;
- b) sigurinë gjatë operacioneve të montimit, çmontimit ose transformimit të skelave në lidhje me legjislacionin në fuqi;
- c) masat parandaluese për rrezikun e rënies së personave dhe objekteve;
- d) masat e sigurisë në rastin e ndryshimit të kushteve meteorologjike, që mund të ndikojnë në sigurinë e skelave;
- e) kushtet për ngarkesën e pranueshme;
- f) çfarëdo rreziku tjetër që mund të sjellin veprimet e montimit, çmontimit ose transformimit.

Punëmarrësit të cilët, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, kanë kryer për të paktën dy vjet montime, çmontime ose transformime të skelave duhet të marrin pjesë në kurset e formimit brenda dy vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti.

Punëmarrësit e përzgjedhur që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje kanë kryer të paktën për tre vjet montime, çmontime ose transformime të skelave, duhet të marrin pjesë në kurset e formimit të cituara në paragrafin e kualifikimit, brenda dy vjetëve pasardhës nga data e hyrjes në fuqi e këtij akti.

15.6 Detyrimet e punëdhënësit në lidhje me përdorimin e sistemit të gançimit e të pozicionimit të vendosjes së kavove.

Punëdhënësi përdor sisteme mbikëqyrjeje për pozicionimin e kavove në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

- a) sistemi përbëhet të paktën nga dy kavo të fiksuara të ndara nga njëra-tjetra, njëra për ngritjen dhe zbritjen e materialeve ( kavon e punës) dhe tjetra me funksion ndihmës (kavo sigurie). Pranohet përdorimi i një kavove në kushte të jashtëzakonshme në të cilat, përdorimi i kavos së dytë e bën punën më të rrezikshme dhe nëse janë marrë masat e nevojshme për të garantuar sigurinë;
- b) punëmarrësit duhet të pajisen me rrip sigurimi të lidhur me kavon e sigurisë;
- c) kavo pune e pajisur me mekanizëm të sigurt zbritje dhe ngritje dhe e pajisur me sistem vetëbllokues për të evituar rënien në rastin kur përdoruesi humbet kontrollin e lëvizjeve të tij. Kavolja e sigurisë duhet të jetë e pajisur me një mekanizëm të lëvizshëm kundër rënies e që ndjek lëvizjet e punëmarrësve;
- d) pajisje dhe aksesore të tjerë që përdoren nga punëmarrësit, që varen te rripat e sigurisë, te karriget ose instrumente të tjera të përshtatshme;
- e) punimet të programohen e të vëzhgohen në mënyrën e duhur, me qëllim që t'i shkohet në ndihmë punëmarrësit menjëherë në rast nevoje. Programi i punimeve përcakton një plan emergjence, tipologjinë operative, mekanizmat e mbrojtjes individuale, teknikat dhe procedurat operative, ganxhat, pozicionimin e punëmarrësve, metodat e zgjedhura, skuadrat e punës dhe pajisjet e punës;
- f) programi i punës duhet të jetë në vendet e punës me qëllim që të verifikohet ndjekja nga ana e organeve kompetente për ruajtjen e territorit.

Punëdhënësi u vë në dispozicion punëmarrësve të interesuar, mënyrën e kualifikimit të përshtatshëm me operacionet e parashikuara, në mënyrë të veçantë në drejtim të shpëtimit.

Formimi ka karakter teoriko –praktik dhe duhet të ketë lidhje me:

- a) teknikat operative dhe përdorimin e mekanizmave të nevojshëm;
- b) praktike specifike si mbi strukturat natyrale ashtu dhe të bëra vetë;
- c) përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale, karakteristikat e tyre teknike, mirëmbajtja, kohëzgjatja dhe ruajtja;
- d) elementet e ndihmës së shpejtë;
- e) rreziqet objektive dhe masat e parandalimit e të mbrojtjes;
- f) procedurat e shpëtimit.



Punëmarrësit, të cilët në datën e hyrjes në fuqi të këtij akti kanë kryer për të paktën dy vjet aktivitete me përdorimin e sistemit të hyrjes dhe pozicionimit nëpërmjet kavove duhet të marrin pjesë në kurset e formimit të cituara në pikën 4 brenda dy vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti.

#### 15.7 Informacione

Punëdhënësi siguron që punëmarrësit e caktuar, për çdo pajisje pune të vënë në dispozicion, të kenë çdo informacion dhe çdo udhëzues përdorimi të nevojshëm për sigurinë, që kanë lidhje me:

a) kushtet e përdorimit të pajisjeve, bazuar edhe në përfundimet e arritura nga eksperiencat e marra gjatë përdorimit të këtyre pajisjeve;

b) situatat anormale të parashikuara.

Punëdhënësi merr masat që t'i informojë punëmarrësit në lidhje me rreziqet ndaj të cilëve janë të ekspozuar gjatë përdorimit të pajisjeve të punës, mbi pajisjet e punës të pranishme në ambientin rrethues edhe pse mund të mos përdoren drejtpërdrejt prej tyre, si dhe në lidhje me modifikimet e bëra në këto mjete.

Informacionet dhe udhëzimet e përdorimit duhet të jenë të kuptueshme për punëmarrësit e interesuar.

#### 15.8 Formimi dhe ushtrimi praktik

Punëdhënësi siguron që:

a) punëmarrësit e ngarkuar për përdorimin e pajisjeve të punës të marrin një formim të përshtatshëm në lidhje me përdorimin e pajisjeve të punës;

b) punëmarrësit e ngarkuar për përdorimin e pajisjeve që kërkojnë njohuri dhe përgjegjësi të veçantë, kryejnë një praktikë të përshtatshme dhe specifike që i përgatit për përdorimin e mirë dhe të sigurt të këtyre pajisjeve si edhe në lidhje me rreziqet që mund t'u shkaktohen personave të tjerë.

#### 15.9 Detyrimet e punëmarrësve.

Punëmarrësit u nënshtrohen programeve të formimit ose të praktikës, të organizuara nga punëdhënësi. Punëmarrësit përdorin pajisjet e punës të vëna në dispozicion në përputhje me informacionin, formimin dhe praktikën e bërë.

Punëmarrësit:

a) kujdesen për mjetet e punës të vëna në dispozicion;

b) nuk i modifikojnë me iniciativë të tyre;

c) sinjalizojnë menjëherë punëdhënësin ose drejtuesin ose personin e caktuar, mbi defektet ose për gjërat që nuk shkojnë në pajisjet e punës të vëna në dispozicion.

#### 15.10 Lista e mjeteve që u nënshtrohet kontrolleve nga punëdhënësi

1. shkallët ajrore me pjerrësi të ndryshueshme;

2. urat e lëvizshme mbi karro- rrota;`

3. urat e varura të pajisura me krik -organello;

4. Pompat thithëse centrifugale me diametër të jashtëm të koshit më të madh se 50 cm;

5. Kavot dhe zinxhirë të impiantit dhe të aparateve ngritëse;

6. Kavot dhe zinxhirë të impiantit dhe të aparateve tërheqëse;

7. Vinça dhe pajisje ngritëse për peshat më të mëdha se 200 kg;

8. Mekanizmat tërheqës, pikëmbështetëse dhe mekanizmat sigurie për nivelet e pjerrëta;

9. Makina dhe pajisje për punimin e eksplozivëve;

10. Elementet e skelave;

11. Skela metalike të fiksuara;

12. Krik, për urat e varura;

13. Kavot e urave të varura;

14. Armaturat e gërmimeve;

15. Frenat e lëvizësive mbi shina;

16. Kordonët, fitilat e eksploziveve;

17. Materialet e mbledhura për ndërtimet skenike;

18. Ndërtime për skena;

19. Reflektorë dhe bateritë e akumulatorëve të lëvizshëm;

20. Teleferikët privatë;

21. Elevatoret e lëvizshëm;
22. Skelat e varura të motorizuara;
23. Kavot e skelave të varura të motorizuara
24. Ashensorët dhe mjetet ngritëse për shërbim privat;
25. Makineritë me presion normal;
26. Makineritë me presion me gaz;
27. Gjeneratorët dhe kontenitorët e avullit të ujit;
28. Gjeneratorët dhe kontenitorët e lëngjeve të mbinxehura;
29. Furrat për vajrat minerale;
30. Gjeneratorët me nxehtësi për impinatet ngrohëse me ujë të ngrohtë;
31. Kontenitorët për transportin e gazeve të kompresuara, të lëngshme ose të tretur;
16. Përdorimi i pajisjeve të mbrojtjes personale-PMP.

#### 16.1 Përkufizime

Me pajisje të mbrojtjes personale (PMP) nënkuptohet çdo lloj pajisje e përcaktuar për t'u veshur dhe për t'u mbajtur, nga punëmarrësi, për t'u mbrojtur kundër një ose më shumë rreziqeve që mund të dëmtojnë sigurinë ose shëndetin gjatë punës, si dhe çdo komponent ose element i përdorur për këtë qëllim.

Nuk janë pajisje të mbrojtjes personale:

- a) veshjet e zakonshme të punës;
- b) pajisjet e ndihmës së shpejtë e të shpëtimit;
- c) pajisjet e mbrojtjes personale të ushtrisë, policisë dhe të personelit për ruajtjen e rendit publik;
- d) pajisjet e mbrojtjes personale të transportit rrugor;
- e) materialet sportive;
- f) materialet për vetëmbrojtjen;
- g) aparatet e lëvizshme për të përcaktuar dhe sinjalizuar rreziqe dhe faktorë të rrezikshëm.

#### 16.2 Detyrimi i përdorimit

PMP-të duhet të përdoren kur rreziqet nuk mund të evitohen ose të reduktohen në mënyrë të mjaftueshme nga masa teknike të parandalimit, nga pajisjet e mbrojtjes kolektive, nga masat, metodat ose vendimet e organizmit në punë.

#### 16.3 Kërkesat e PMP

PMP duhet të jenë në përputhje me standardet, rregullat dhe aktet në fuqi.

PMP në përputhje me piken 16.1:

- a) duhet të jenë të përshtatshme për rreziqet që duhet të parandalojnë, pa sjell një rrezik me të madh;
- b) duhet të jenë të përshtatshme me kushtet ekzistuese në vendin e punës;
- c) duhet të mbajnë në konsideratë kushtet ergonomike ose të shëndetit të punëmarrësit;
- d) duhet të mund të adoptohen me përdoruesin sipas nevojave të tij.

Në rast të shumë rreziqeve, që kërkojnë përdorimin e më shumë PMP, këta të fundit duhet të jenë të pajtueshëm midis tyre dhe që të ruajnë efikasitetin ndaj rreziqeve përkatëse dhe në përdorimin e njëkohshëm.

#### 16.4 Detyrimet e punëdhënësit.

Punëdhënësi, në zgjedhjen e PMP-së

- a) kryen analizat dhe vlerësimet e rreziqeve që mund të evitohen me pajisje të tjera;
- b) përcakton karakteristikat e PMP-ve të nevojshme në mënyrë që këto të përshtaten me rreziqet e cituara në shkronjën "a", duke pasur parasysh burime të tjera të mundshme për rreziqe që mund të paraqiten nga përdorimi i këtyre PMP-ve
- c) vlerëson mbi bazën e informacioneve të vëna në dispozicion nga fabrikuesi i pajisjeve - PMP dhe rregullave të përdorimit, karakteristikat e PMP që gjenden në treg;
- d) sa herë që del në përdorim një model i ri i përmirësuar bën zëvendësimin e pajisjes.

Punëdhënësi përcakton kushtet, në të cilat PMP duhet të përdoret, në mënyrë të veçantë kohën e përdorimit, në funksion me:

- a) natyrën e rrezikut;

- b) frekuencën e ekspozimit ndaj rrezikut;
- c) karakteristikat e vendit të punës;
- d) funksionet e PMP.

Punëdhënësi:

- a) mban në funksion PMP dhe siguron kushtet higjienike, nëpërmjet mirëmbajtjes, riparimit dhe zëvendësimeve të nevojshme;
- b) siguron që PMP të përdoren vetëm për rastet e parashikuara, me përjashtim të rasteve specifike dhe të jashtëzakonshme, në përputhje me informacionet e fabrikuesit;
- c) jep informacione të kuptueshme për punëmarrësit;
- d) përcakton çdo PMP për përdorim personal, dhe kur kushtet kërkojnë përdorimin e të njëjtit PMP nga më shumë se një person, merr masat e nevojshme që ky përdorim mos të sjellë probleme higjienike e shëndetësore për përdoruesit e ndryshëm;
- e) informon paraprakisht punëmarrësit për rreziqet, nga të cilat i mbron PMP;
- f) siguron një formim të përshtatshëm dhe organizon, nëse është e nevojshme, një praktikë specifike për përdorimin korrekt dhe praktik të PMP.

Në çdo rast trajnimi është i domosdoshëm:

a) për çdo PMP, që në bazë të rregullave dhe direktivës përkatëse i përket kategorisë së tretë;

b) për pajisjet mbrojtëse të dëgjimit.

#### 16.5 Detyrimet e punëmarrësit

Punëmarrësit, përdorin PMP të vënë në dispozicion në përputhje me informimin dhe formimin e marrë nga trajnimi i organizuar posaçërisht.

Punëmarrësit:

- a) kujdesen për PMP të vëna në dispozicion të tyre ;
- b) të mos kryejnë modifikime me iniciativë të tyre.

Në fund të përdorimit, punëmarrësit ndjekin procedurat e ridorëzimit të PMP.

Punëmarrësit sinjalizojnë menjëherë, punëdhënësin ose drejtuesin ose personin e caktuar, për çdo defekt ose diçka që nuk shkon gjatë kohës së përdorimit të PMP.

Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, pasi ka dëgjuar mendimin e Këshillit Kombëtar të Punës duke mbajtur parasysh natyrën, aktivitetet dhe faktorët specifike të rreziqeve, përcakton:

- a) kriteret për përcaktimin dhe përdorimin e PMP;
- b) kushtet dhe situatat në të cilat, në kuadër të prioritetëve të masave për mbrojtjen kolektive, bëhet i nevojshëm përdorimi i PMP.

16.6 Treguesi i listës jo të plotë të aktivitetëve dhe sektorëve, për të cilët mund të jetë e nevojshme vënia në punë e pajisjeve të mbrojtjes personale PMP

Mbrojtja e kokës - Kaskat mbrojtëse në;

a) Punët e ndërtimit, në mënyrë të veçantë punët lart, poshtë ose në afërsi të skelave dhe vendeve të punës në lartësi, montimi dhe çmontimi i armaturës, punimet për instalimin dhe vendosjen e skelave dhe veprimet për heqjen e tyre.

b) Punimet në ura metalike, mbi objektet ndërtuese me strukturë metalike, në një lartësi të madhe, shtylla, kulla, ndërtime hidraulike dhe konstruksione metalike, furrat e shkrirjes së metaleve, të përpunimit të petëzimit dhe të hekurave, depozita të mëdha, ujësjellës të mëdha, kaldaja dhe centrale elektrike.

c) Punime në gërmime, nivele më të ulëta, përforcime, puse dhe galeri minierash.

ç) Punimet në dhe e shkëmbinj.

d) Punimet në miniera të nëndheshme, minierat në qiell të hapur dhe punimet e zhvendosjeve e grumbujve të sterileve-mbetjeve.

e) Përdorimi i nxjerrësve të bulonave.

f) Dhënie e shkëlqimit mineraleve, zbardhim pastrime.

g) Punime në ashensorë dhe mjete të tjera ngritëse, vinça dhe transportier;

h) Punime në afërsi të furrave shkrirëse, në impiantet e reduktimit të drejtpërdrejtë, në përpunimin dhe petëzimin e çelikut, në stabilimentet metalurgjike, në impiantet me përpunim të nxehtë dhe me stampim, si dhe fonderitë.

i) Punimet në furrat industriale, aparatet, depozita, pajisjet e shkarkimit të materialeve të panevojshme, materialet teknike për krijimin e konstruksioneve metalike.

j) Ndërtimet e anijeve.

k) Spostimet hekurudhore

Mbrojtja e këmbëve.

Këpucë sigurie me taban rezistent të pashpueshëm në;

a) Punimet restaurimi, ndërtime civile dhe punime rrugore.

b) Punime mbi skela.

c) Punime për prishje.

ç) Punime me beton ose me parafabrikate me montim ose çmontim të armaturave.

d) Punime në kantiere ndërtimi dhe zona depozitimi.

e) Punime mbi çati.

Këpucë sigurie me taban rezistent, të shpueshëm;

a) Punime mbi ura metalike, objekte ndërtimi me struktura të larta, shtylla dhe kulla, ashensorë dhe mjete të tjera ngritëse, ndërtime hidraulike çeliku, furra shkrirëse për metale, kontenitorët e mëdhenj, makineritë për dhënien e formave plastikës në të nxehtë, vinça, kaldaja dhe impiante elektrike.

b) Ndërtime furrash, instalimet e impianteve të nxehtë dhe të ajrimit, si dhe montimi i konstruksioneve metalike.

c) Punime të ndryshme dhe të mirëmbajtjes.

ç) Punime në furra shkrirëse, impiantet e reduktimit të drejtpërdrejtë, makineritë e dhënies së formës metaleve dhe plastikës, stabilimentet metalurgjike, impiantet e dhënies së formave të metaleve në të nxehtë dhe me stampë, impiantet e presimit në të nxehtë dhe me petëzim.

d) Punime në kariera guri, minierë në qiell të hapur, të transportimit të mbetjeve.

e) Punime të gdhendjes së gurëve.

f) Prodhim qelqi dhe xhami, përpunimi dhe dekori.

g) Përpunim të stampave në industrinë e qeramikës.

h) Punime të veshjeve mbrojtëse të furrave në industrinë e qeramikës.

i) Punime në industrinë e qeramikës së ndërtimit dhe në industrinë e materialeve të ndërtimit.

j) Lëvizje dhe depozitim.

k) Ndërtimi i anijeve.

l) Spostimet hekurudhore.

Këpucë sigurie me takë ose me taban rezistentë dhe të pa çpueshmë.

Punime mbi çati.

Këpucë sigurie me taban termoizolues.

Aktivitete mbi sipërfaqe dhe me masa shumë të ftohta ose shumë të nxehta.

Këpucë sigurie me lidhës që zgjidhen shpejt.

Në rast rreziku të depërtimit të masave inkandeshentë.

Mbrojtja e syve dhe e fytyrës.

Syze mbrojtëse ose maska mbrojtëse në;

a) Punime saldatimi, me gur smeril dhe makinë metal prerëse në të ftohtë.

b) Punime gdhende dhe çarje të materialeve të ndryshëm.

c) Punime të gdhendjes së gurëve.

ç) Përdorimin e nxjerrësve të bulonave.

d) Përdorimin e makinerive të heqjes së mbetjeve metalike ose druri të imta, gjatë procesit të përpunimit të tyre.

e) Stampimin e metaleve.

f) Copëzimin dhe eliminimin e ashklave.

g) Punime me rërë.

- h) Përpunimin e prodhimeve acide dhe alkalike, disinfektuese dhe detergjenteve gërryes.
  - i) Përdorimi i pompave për sprucim të lëngshëm.
  - j) Përpunimin i masave të rrjedhshme inkandeshente ose punime në afërsi të tyre.
  - k) Punime me ekspozimin të nxehtësisë rrezatuese.
  - l) Përdorimin e rrezeve laser.
- Mbrojtja e rrugëve të frymëmarrjes.
- Vetushqyes frymëmarrje në:
- a) Punime në depozita, në hapësira të ngushta dhe në furra industriale me gaz, ku ekziston rreziku i helmimit nga gazrat ose mungesa e oksigjenit.
  - b) Punimet në zonat e mbushjes së furrave të shkrirjes.
  - c) Punime në afërsi të aparateve konvertitore dhe përcjellësve të gazit të furrave shkrirëse.
  - ç) Punime në afërsi të hedhjes në forma të metaleve të shkrira, ku parashikohet lëshimi i gazeve nga metalet e shkrira.
  - d) Punimet e veshjeve të brendshme të furrave dhe të kovave ku derdhen materialet e shkrira të predispozuara për formimin e pluhurave.
  - e) Bojatisje me spruco pa ajrim të mjaftueshëm.
  - f) Punime në puseta, kanale dhe hapësira të tjera të nëndheshme të rrjetit të shkarkimit të ujërave të zeza.
  - g) Aktivitetet në impiantet frigoriferike që paraqesin rrezik të daljes së gazit ftohës.
- Mbrojtja e dëgjimit:
- Mbrojtës dëgjimi në:
- a) Punët në afërsi të presave metalike.
  - b) Punët me përdorim të instrumenteve pneumatikë.
  - c) Aktiviteti i personelit që punon në tokë, në aeroporte.
  - ç) Mjetet që punojnë me goditje dhe ngjeshjen e dheut.
  - d) Punime në tezgjah dhe zdrukthëtari.
- Mbrojtja e kraharorit, krahëve dhe e duarve.
- Veshje mbrojtëse në:
- a) Përpunimin e prodhimeve acide dhe alkaline, desinfektuesit dhe detergjentët gërryes.
  - b) Punët për përpunimin e masave të nxehta ose në afërsi të tyre ose me ekspozim të nxehtësisë.
  - c) Punimin e fletëve të xhamit.
  - ç) Punimin me rërë.
  - d) Punime në impiantet frigoriferike.
- Veshje mbrojtëse që digjen me vështirësi në:
- a) Punime saldimi në ambiente të mbyllura.
  - b) Përparëse lëkure.
  - c) Saldime.
  - ç) Shkrirjen e metaleve.
  - d) Dorashka.
  - e) Saldime.
  - f) Përpunim i objekteve të mprehta me majë, përjashto rastet kur ekziston rreziku që dorashka të mbetet në makinë.
  - g) Përpunimi në qiell të hapur i produkteve acide dhe alkaline.
- Veshje për mbrojtjen kundër ndryshimeve klimatike në:
- Punimet e ndërtimit në vende të hapura në kohë të ftohtë e me shi.
- Veshje të ndritshme, fosforeshentet në;
- Punime në të cilat duhet kuptuar prania e punëmarrësve në kohë.
- Pajisje të mbrojtjes kundër rënies në:
- a) Punime mbi skela.
  - b) Montimin e elementëve parafabrikate.
  - c) Punën mbi shtylla.
- Lidhje me litar sigurie në;

- a) Vendet e punës në kabina të ngritura në vinçe.
- b) Vendet e punës në kabinën e manovrave në transelevatorë.
- c) Vendet e punës mbi kullat e shpimit.
- ç) Punët në puse dhe rrjetet e shkarkimit.

17. Lëvizja me dorë e ngarkesave.

#### 17.1 Fusha e aplikimit

Këto rregulla aplikohen në ato aktivitete, të cilat sjellin lëvizjen me dorë të ngarkesave me rrezik, ndër të tjera të lezioneve dorso-lombare/dëmtim të shtyllës kurrizore, për punëmarrësin gjatë punës.

Nënkuptohen me:

a) lëvizje me dorë të ngarkesave, transportimi ose mbajtja e një ngarkese nga një ose më shumë punëmarrës, përfshirë, ngritja, ulja, tërheqja, sjellja ose spostimi i një ngarkese, e cila për karakteristika të saj ose për kushtet ergonomike jo të përshtatshme, mund të sjellin leziona dorso-lombare/dëmtim të shtyllës kurrizore;

b) lezionet dorso-lombare dëmtime në strukturën osteomiotendine e nerveovaskolari në nivelin dorso-lombare/ dëmtim i shtyllës kurrizore.

#### 17.2 Detyrimet e punëdhënësit

Punëdhënësi merr masat organizative të nevojshme ose përdor mjetet e nevojshme, në mënyrë të veçantë mjete mekanike, për të evituar nevojën e lëvizjeve me dorë të ngarkesave nga ana e punëmarrësve.

Kur nuk është e mundur shmangia e lëvizjeve me dorë të ngarkesave nga ana e punëmarrësve, punëdhënësi merr masat organizative të nevojshme, përdor pajisjet e duhura ose u vë në dispozicion punëmarrësve pajisjet e duhura për të zvogëluar rrezikun që sjell lëvizja me dorë e këtyre ngarkesave.

Në rastin kur lëvizja me dorë e një ngarkese nga ana e punëmarrësit nuk mund të evitohet, punëdhënësi bën organizimin e punës në mënyrë të tillë që lëvizja e ngarkesës të jetë e sigurt dhe të jetë sa më pak e dëmshme për shëndetin.

Në rastet e përmendura në pikën e mësipërme punëdhënësi:

a) vlerëson paraprakisht, nëse është e mundur, kushtet e sigurisë dhe shëndetit në lidhje me punën që do të kryhet, duke pasur parasysh karakteristikat e ngarkesës;

b) merr masat për të evituar ose reduktuar rrezikun e lezioneve dorso-lombare, duke mbajtur parasysh faktorët individuale të rrezikut, karakteristikat e ambientit të punës dhe kërkesat që paraqet ky aktivitet;

c) punëmarrësit që ushtrojnë aktivitetet e cituara në pikën 17, i nënshtrohen një kontrolli sanitar;

#### 17.3 Informacioni dhe formimi.

- Punëdhënësi u jep punëmarrësve informacione në lidhje me:

a) peshën e një ngarkese;

b) qendrën e gravitetit të ngarkesës ose anën më të rëndë, në rastin kur në një ambalazh përmbajtja nuk është e pozicionuar në qendër.

c) Lëvizjen korrekte të ngarkesave dhe rreziqet që mund të hasin punëmarrësit, nëse këto aktivitete nuk kryhen në mënyrën e duhur.

- Punëdhënësi u siguron punëmarrësve kualifikimin e duhur.

#### 17.4 Elementet e referimit.

Karakteristikat e ngarkesës.

Lëvizjet me dorë të ngarkesave mund të shkaktojnë rrezik për dëmtimin e dorso -lombare – shtyllën kurrizore, në rastet e mëposhtme:

- kur ngarkesa është shumë e rëndë (30 kg);

- është voluminoze dhe e vështirë për t'u kapur;

- nuk është në ekuilibër dhe përmbajtja e saj rrezikon të lëvizë;

- është në një pozicion të tillë në të cilin duhet mbajtur dhe drejtuar në një distancë nga kraharori ose me përkulje ose sforcim të kraharorit;

- për shkak të strukturës së jashtme dhe/ose të madhësisë, mund të sjellë dëmtime për punëmarrësit në mënyrë të veçantë në rast përplasje.

Sforcim fizik i nevojshëm

Sforcimi fizik i nevojshëm mund të paraqesë rrezik në dorso-lombare në rastet e mëposhtme:

- kur është i tepruar;
- kur kryhet vetëm me sforcim të kraharorit;
- mund të sjellë një lëvizje të rëndë të ngarkesës;
- kur kryhet me trupin në pozicion jo të qëndrueshëm.

Karakteristikat ambientit të punës.

Karakteristikat e ambientit të punës mund të ndikojnë në rritjen e rrezikut për dëmtimin e dorso-lombare në rastet e mëposhtme:

- kur hapësira e lirë, në veçanti në drejtim vertikal, është e pamjaftueshme për kryerjen e aktiviteteve të kërkuara;

- kur dyshemeja nuk është e niveluar dhe paraqet rrezik për t'u penguar ose për të rrëshqitur për këpucët e punëmarrësit;

- kur vendi ose ambienti i punës nuk i lejojnë punëmarrësit lëvizjen me dorë të ngarkesës në një lartësi të sigurt ose në një pozicion të mirë;

- kur dyshemeja ose sheshi i punës ka disnivel që vështirëson lëvizjen e ngarkesës nga një nivel në tjetrin;

- kur dyshemeja ose pika e mbështetjes nuk janë të qëndrueshme;

- kur temperatura, lagështira ose qarkullimi i ajrit nuk janë të përshtatshme.

Kërkesat lidhur me aktivitetin

Aktiviteti mund të sjellë rrezik për dëmtimin e dorso-lombare, nëse kërkon:

- sforcim fizik të shpeshtë ose shumë të zgjatur në mënyrë të veçantë në shtyllën kurrizore;

- periudha për shpërndarje fiziologjike të pamjaftueshme;

- distanca të mëdha për ngritjen, uljen ose transportin;

- një ritëm të detyruar të një procesi, që nuk mund të modulohet nga punëmarrësi.

Faktorë individualë të rrezikut

Punëmarrësi mund të ketë rrezik në rastet e mëposhtme:

- kur është i papërshtatshëm fizikisht për të kryer aktivitetin në fjalë;

- nga veshje, këpucë ose efekte të tjera personale të papërshtatshme që vesh punëmarrësi;

- pamjaftueshmëri ose papërshtatshmëri e njohurive ose formimit.

## 18. Mënyrat e vlerësimit të rreziqeve

### 18.1 Parime të përgjithshme

Vlerësimi i rrezikut nënkuptohet si një tërësi e veprimeve, si psh. kërkimit dhe përpunimit të të dhënave, që duhet të zbatohen për të arritur në një vlerësim të nivelit të rrezikut, të cilit i ekspozohet personeli dhe rreziqe të tjera të mundshme që varen nga ambienti rrethues në të cilin punohet.

Për të bërë vlerësimin e nivelit të rrezikut, duhet të kryhen një seri veprimesh të njëpasnjëshme, të cilat mund të përmblihen në:

1. identifikimin e burimeve të rrezikut të pranishme në procedurat operative të qendrës;
2. identifikimi i rreziqeve potenciale të ekspozuara në kryerjen e detyrave;
3. vlerësimi i natyrës së rreziqeve të ekspozuara.

### 18.2 Kriteret për vlerësimin

Harta e rreziqeve në ndërmarrje mund të ndërtohet nëpërmjet metodologjive të ndryshme. Më të përdorurat janë:

- Metoda për zonat homogjene: ndarja e ndërmarrjes në zona gjeografike duke përcaktuar sektorët, repartet, vendet e punës dhe procedurat për secilën zonë gjeografike duke përcaktuar të gjitha burimet e mundshme të rrezikut.

- Metoda për aktivitete homogjene: përcaktimi i të gjitha aktiviteteve të kryera në ndërmarrje, përcaktimi i tipologjive të rreziqeve për secilin nga këto aktivitete.

- Metoda për rreziqet homogjene: përcaktimi i të gjitha tipologjive të rreziqeve të mundshme, të pranishme në ndërmarrje dhe bashkimi këtyre rreziqeve me zonat dhe aktivitetet e ndërmarrjes.

Mënyra më e thjeshtë për të ndërtuar hartën e rreziqeve, e cila nuk nënkupton një njohje të thellë të ndërmarrjes në lidhje me problematikën e sigurisë, sipas mendimit më të përhapur, është metoda e nënndarjes gjeografike dhe e analizës së çdo elementi gjeografik të veçantë.

Vlerësimi i rrezikut të mbetur bëhet, duke i bashkuar çdo argumenti të rrezikut për çdo burim të përcaktuar, një probabilitet për ndodhjen e aksidentit të provokuar nga ky burim dhe një madhësi të dëmtimit që pritet prej tij.

Mundësia e ndodhjes vlerësohet në tre nivele me vlerë numerike, të ulët, të mesme dhe të lartë. Madhësia e dëmtimit të pritur fiksohet gjithashtu në tre nivele me vlerë të ulët, të mesme dhe të lartë.

Vlera e rrezikut potencial të një burimi, për çdo argument të mundshëm, përfaqësohet nga prodhimi i vlerës së madhësisë të dëmtimit potencial M me vlerën e probabilitetit të ndodhjes P në lidhje me atë rrezik.

Në tabelat 1 dhe 2 përshkruhen nivelet e madhësisë të dëmtimit dhe probabilitetet e mundshme.

Vlera e rrezikut, d.m.th. parametri që mund të shpreh me një të dhënë të vetme relacionin madhësi – probabilitet, llogaritet duke përpunuar të dy elementet në një diagramë kartesiane të ndarë në kuadrate, si më poshtë.

Tabela 1 - Shkalla e Treguesit “M” ( madhësia ose natyra e dëmtimit potencial)

VLERAT	KRITERET E VLERËSIMIT
I Lartë	Janë verifikuar dëmtime të pakthyeshme për personin (vdekje, humbje anatomike ose funksionale). Janë verifikuar dëmtime që kanë sjellë paaftësinë e përkohshme me prognozë > 30 ditë shërimi. Në kuadrin e aktivitetit është përcaktuar një tipologji aksidentesh gjatë një faze të aktivitetit që mund të shkaktojë dëmtime të rënda për personin ose gjera dhe/ose të prodhojë ndotje për ambientin. Janë paraqitur substanca /ose preparate kancerogjene dhe toksike, që digjen lehtësisht, që mund të shpërthejnë, shumë të dëmshëm për ambientin, substance biologjike të grupeve 3 ose 4.
I Mesëm	Janë verifikuar dëmtime që kanë sjellë paaftësinë e përkohshme me prognozë > 3 ditë shërim. Në kuadrin e aktivitetit është përcaktuar një tipologji aksidentesh gjatë një faze të aktivitetit që mund të shkaktojë dëmtime të moderuara për personin ose gjëra dhe/ose të prodhojë ndotje për ambientin. Janë të pranishme substanca dhe/preparate kancerogjene, agente biologjike të grupit 2, shumë toksike për pirjen dhe/ose kontaktin me lëkurën, të djegshme, dhe që mund të marr flakë me rritjen e temperaturës.
I Ulët	Janë verifikuar dëmtime që kanë sjellë paaftësinë e përkohshme me prognozë 3 ditë shërim. Në kuadrin e aktivitetit është përcaktuar një tipologji aksidentesh gjatë një faze të aktivitetit që mund të shkaktojë dëmtime të lehta për personin ose sendet. Janë të pranishme substanca dhe/preparate kancerogjene, agente biologjike të grupit 1, substanca dhe/preparate toksike për pirjen, të rrezikshme për frymëmarrjen dhe /ose kontaktin me lëkurën ose irritante.



Tabela 2 - Shkalla e Treguesit "P" ( probabiliteti – frekuenca e ngjarjes )

VLERAT	KRITERET
I Lartë	Janë regjistruar dëmtime për tipologjinë e marr në konsideratë ( aksidente, dëmtime të vogla, sëmundje profesionale ). Aktiviteti i punës kërkon një organizim të punës sepse paraqet interferime, mbulime të dyfishta, papërshtatshmërisë së aktiviteteve, etj. Ekziston një korrelacion midis aktiviteteve dhe/ose faktorit të rrezikut dhe përkeqësimit në dëmtimet dhe sëmundjet profesionale në një periudhë domethënëse (tre, pesë vjet). Janë sinjalizuar situata të rrezikut potencial të lartë.
I Mesëm	Faktori i rrezikut mund të provokojë dëmtim, dhe pse jo në mënyrë automatike ose të drejtpërdrejt. Është vënë re ndonjë episod, i cili për tipologjinë e marr në konsideratë ka shkaktuar dëmtimin. Aktiviteti i punës sjell nevojshmërinë e ndërhyrjes në mjetet e punës në funksionim. Ekziston një lidhje midis aktivitetit dhe/ose faktorit të rrezikut dhe anomalive në dëmtimin dhe/ose sëmundjet profesionale gjatë një periudhe domethënëse (tre, pesë vjet)
I Ulët	Faktori i rrezikut mund të provokojë një dëmtim vetëm në kushtet rastësore ose të papritura të ngjarjeve. Nuk janë vënë re ose janë vënë re vetëm episode të rralla. Nuk ka një lidhje midis aktivitetit të punës dhe faktorit të rrezikut. Ekziston një lidhje midis aktivitetit dhe dëmtimit/sëmundjes profesionale gjatë një periudhe domethënëse (tre, pesë vjet).

Diagrama e vlerësimit të rrezikut




Tabela e treguesve të rrezikut:

9	- SHUMË E LARTË	Zona në të cilën përcaktohen dhe programohen ndërhyrje për mbrojtjen dhe parandalimin për të zvogëluar si probabilitetin, ashtu dhe dëmtimin potencial .
6	- E LARTË	Zona në të cilën përcaktohen dhe programohen përmirësime me ndërhyrje për mbrojtjen dhe parandalimin për të zvogëluar kryesisht ose probabilitetin ose dëmtimin potencial.
2÷4	- E LEHTË	Zonë në të cilën verifikohet që rreziqet potenciale janë nën kontroll.
1	- JO E RËNDËSISHME	Zonë në të cilën rreziqet potenciale janë nën kontroll

Në vijim të procesit të vlerësimit, mund të arrihet, në një nga rezultatet e mëposhtme, për çdo ambient ose vend pune;

- Ambienti ose vendi i punës nuk paraqet asnjë lloj ekspozimi ndaj rreziqeve të asnjë lloji natyre; në këtë rast, nuk paraqiten probleme të lidhura me punimet;

- Ambienti ose vendi i punës paraqet praninë e një rreziku ekspozimi, natyra e të cilit hyn në kufijtë e pranueshme të përcaktuara nga rregullat në fuqi; në këtë rast, situata duhet mbajtur nën kontroll periodik;

- Ambienti ose vendi i punës paraqesin praninë e një rreziku ekspozimi; në këtë rast, duhet të merren masat e parandalimit dhe mbrojtjes.

#### 18.3 Kontrolli i rrezikut të mundshëm

Gjatë evidentimit të rreziqeve të mundshme, punëdhënësi duhet të vlerësojë:

- Nëse është i mundur parandalimi ose evitimi, për shembull, duke kontrolluar nëse detyra ose puna janë të nevojshme, me përdorimin e substancave ose mënyrave të ndryshme.

- Nëse rreziku nuk është i parashikueshëm ose i evitueshëm, të vendosë, nëse do t'i zvogëlonte në një nivel të tillë, që nuk ndikon tek siguria dhe shëndeti i punëmarrësve të ekspozuar, për shembull, duke zëvendësuar çdo gjë që është e rrezikshme me çka nuk është ose është më pak e rrezikshme. Për një orientim mbi kontrollin e rreziqeve që duhet të realizohen me këto masa, punëdhënësi duhet t'i referohet përmbajtjes specifike në legjislacionin në fuqi, standardeve , udhëzuesve të publikuar dhe kritereve të tjera të ngjashme të publikuara nga autoritetet.

- Nëse masat që mund të zbatohen përmirësojnë nivelin e mbrojtjes së punëmarrësve në fushën e sigurisë dhe shëndetit.

Kjo nënkupton adoptimin e një strategjie për zvogëlimin dhe kontrollin e rreziqeve në drejtim të aspekteve teknologjike, organizimit të punës, kushteve të punës, raporteve sociale midis personelit, me qëllim që rreziqet të luftohen që në burim; kjo sjell:

- përshtatjen e aktiviteteve të punës sipas individëve, në mënyrë të veçantë për sa i përket pozicionimit të vendeve të punës, zgjedhjes së mjeteve të punës dhe të metodave të prodhimit, duke kërkuar lehtësimin e punës monotone dhe atë që duhet të kryhet sipas afateve të përcaktuara, në mënyrë që të zvogëlohen efektet negative mbi shëndetin;

- përshtatjen me progresin teknik;

- transmetimin e udhëzimeve dhe informacioneve të përshtatshme për vartësit.

#### 18.4 Përditësimet/modifikimet

Rikontrolli dhe përditësimi i vlerësimit të rreziqeve të mundshme kryhet çdo vit sipas situatave ose ngjarjeve të ndryshme që e bëjnë të nevojshme.

Në mënyrë të veçantë vlerësimi përditësohet në vijim me:

- ndryshimet legjislative ose të rregulloreve ose të marrëveshjeve dypalëshe;

- ndryshimet e elementëve të aktiviteteve që zhvillohen dhe/ose të shërbimeve /produkteve;

- rezultatet e auditit dhe/ose ndryshimet e politikave;

- projektet për produktet e reja ose projektet për makineritë ose impiantet e reja, të ndryshuara ose të ndryshimeve të *lay-out*, të prodhimit ose ndryshimet e substancave/ preparateve të përdorura.

## **ANEKSI VI PËRMBAJTJA MINIMALE E PLANIT TË SIGURISË NË KANTIERET E PËRKOQSHME E TË LËVIZSHME.**

Seksioni 1 – Përmbajtja minimale e përgjithshme e planit të sigurisë e koordinimit (PSK).

1. PSK është specifik për çdo kantier të përkohshëm ose të lëvizshëm dhe me fisibilitet konkret; përmbajtja e tij është rezultat i zgjidhjeve të projektimit dhe organizimit në përputhje me aneksin V.

2. PSK përmban të paktën elementet e mëposhtme:

a) identifikimin dhe përshkrimin e objektit, duke specifikuar:

1. adresën e kantierit;

2. një përshkrim përmbledhës të zonës në të cilën është pozicionuar kantieri, i shoqëruar me skicë;

3. një përshkrim sintetik të objektit, duke iu referuar në mënyrë të veçantë zgjidhjeve të projektimit, arkitektonikë, strukturorë dhe teknologjikë;

b) përcaktimin e subjekteve që kanë funksionin e sigurisë, duke treguar emrat e përgjegjësve për punimet, të koordinatorit për sigurinë në fazën e projektimit, dhe nëse është emëruar, të koordinatorit për sigurinë në fazën e kryerjes së punimeve dhe emrin e punëdhënësve për subjektet zbatuese dhe punëmarrësit e vetëpunësuar para fillimit të punimeve;

c) një relacion në lidhje me përcaktimin, analizën dhe vlerësimin e rreziqeve konkrete duke iu referuar zonës dhe organizimit të kantierit, punimeve dhe ndërhyrjeve në to;

d) zgjidhjet e projektimit dhe të organizimit, procedurat, masave parandaluese dhe mbrojtëse, në referim me:

1. zonën e kantierit, në përputhje me seksionin 2, pikat 1 dhe 4;

2. organizimin e kantierit, në përputhje me seksionin 2 pikat 2 dhe 4;

3. punimet, në përputhje me seksionin 2 pikat 3 dhe 4;

e) përshkrimet operative, masat parandaluese e mbrojtëse dhe mekanizmat e mbrojtjes individuale, në referim me ndërhyrjet midis aktiviteteve, në përputhje me seksionin 3 pikat 1, 2 dhe 3;

f) masat e koordinimit, me përdorimin e përbashkët nga shumë subjekte dhe punëmarrësve të vetëpunësuar, si; zgjedhja e planifikimit të aktiviteteve për sigurinë, struktura, pajisje, infrastruktura, shërbime dhe mjete të mbrojtjes kolektive si në seksionin 2 pikat 4 dhe 5;

g) mënyrat e organizimit të bashkëpunimit dhe koordinimit, si dhe të informacioneve reciproke, midis punëdhënësve dhe punëmarrësve të vetëpunësuar;

h) parashikimi i organizimit për shërbimin e ndihmës së shpejtë, kundër zjarrit dhe evakuimit të punëmarrësve; PSK përmban dhe të dhëna telefonike të strukturave të parashikuara në territorin e shërbimit të ndihmës së shpejtë dhe të parandalimit të zjarreve;

i) parashikimin e kohëzgjatjes së punimeve, fazat e punimeve dhe kur e kërkon kompleksiteti i objektit, dhe të nënfazave të punimeve, që përbëjnë programin grafik të punimeve, si dhe përbërjen e kantierit të shprehur në njerëz – ditë;

l) vlerësimi i kostove të sigurisë, në bazë të seksionit 6.

3. Koordinatori për projektin specifikon në PSK, aty ku veçantia e punimeve e kërkon, tipin e procedurave plotësuese dhe të detajeve të PSK lidhur me vendimet e pavarura të subjektit zbatues, që duhet të specifikohen në POS.

4. PSK është i përbërë nga tabela specifike për projektin, në lidhje me aspektet e sigurisë, që përfshijnë të paktën një planimetri, dhe aty ku e kërkon veçantia e objektit, një profil altimetrik dhe një përshkrim i shkurtër i karakteristikave hidrologjike të terrenit ose referim i specifikimeve të relacionit të gatshëm, nëse ekziston.

5. Lista treguese dhe jo e kufizuar e elementeve esenciale të nevojshme për të përcaktuar përmbajtjen e PSK të cituar në pikën 2, është si më poshtë:

a) strukturat përfshijnë: skelat, skela prej tubash mbi rrota, ura mbi trekëmbësh, pjesa horizontale e skelave, parapete, rrugë kaluese, ura, armatura mbrojtëse të gërmimeve, banja, lokale

për t'u larë, dhoma zhveshje, mensa, dhomat e ngrënies, vende kurimi dhe pushimi; konvikte; dhoma mjekimi, infermieri, hapësira të mbyllura në kantiere;

b) pajisjet përfshijnë: centrale dhe impiantet e betonimit; betonierat, vinça, vinçat auto, krikat, elevatorë, makinat për lëvizjen e dheut, makinat speciale për lëvizjen e dheut dhe derivate, sharra elektrike disk, kthyes hekuri, impiantet elektrike të kantierëve, tokëzimet dhe mbrojtja kundër shkarkimeve elektrike, impiantet kundër zjarreve, impiantet e thithjes së tymrave, impiantet e transmetimit të ujit, gazit dhe çdo lloj tjetër energjie, rrjeti i shkarkimit të ujërave të zeza;

c) Infrastruktura përfshin: rrugët e transportit të mjeteve mekanike në kantier, rrugët e këmbësorëve; zonat e depozitimit të materialeve dhe mbeturinave të kantierit.

d) pajisjet dhe shërbimet e mbrojtjes kolektive përfshijnë, sinjalistikën e sigurisë, paralajmëruesit akustik, mjetet e ndihmës së shpejtë, ndriçimi i emergjencës, mjetet shuarjes së zjarrit; shërbimet për drejtimin e emergjencës.

Seksioni 2 – Përmbajtja minimale e PSK në lidhje me zonën e kantierit, organizimit të kantierit dhe punimeve.

1. Në lidhje me zonën e kantierit, PSK përmban analizën e elementëve kryesorë në lidhje me shtresat nëntokësore, burime ujore, mole, pemë, punime të ndërfutura ose mbi të cilët duhet ndërhyrë, infrastruktura, ndër të cilat, rrugë, linja hekurudhore, rrjeti ujqor, aeroporte, ndërtesa që kërkojnë kujdes të veçantë, si shkollat, spitalet, shtëpitë e pushimit për moshat e thyera, banesa; linjat ajrore dhe tubacionet e nëndheshme të shërbimeve, kantiere të tjera ose instalime për prodhim; qarkullimi, zhurma, pluhurat, fibra, tymra, avuj, gaze, erëra ose ndotës të tjerë të ajrit, rënien e materialeve nga lartësitë.

Në lidhje me elementet e mësipërme në PSK duhet të analizohen përkatësisht:

a) karakteristikat e zonës së kantierit;

b) prania a mundshme e faktorëve të jashtëm që sjellin rrezik për kantierin;

c) rreziqe të mundshme që shkaktohen nga punimet në kantier në zonat rreth tyre.

2. Në lidhje me organizimin e kantierit, PSK përmban dhe elementet që vijnë:

a) mënyrat e mundshme për hyrjen e mjeteve të furnizimit të materialeve;

b) pozicionin e impianteve të kantierit;

c) pozicionin e zonave të ngarkim – shkarkimit;

d) zonat e depozitimit të mjeteve dhe të depozitimit të materialeve dhe të mbeturinave;

e) zonat e mundshme të depozitimit të materialeve me rrezik zjarri ose eksplozim.

3. Në lidhje me punimet, koordinatori për projektin bën ndarjen e punimeve në fazë dhe kur kompleksiteti i objektit e kërkon, në nënfaza të punës, dhe kryen analizën e rreziqeve të mundshme, duke treguar kujdes për sa vijon:

a) mbi rrezikun e përplasjes së mjeteve që qarkullojnë në zonën e kantierit;

b) mbi rrezikun e shkarkesave elektrike

c) mbi rrezikun e zhurmës

d) mbi rrezikun nga përdorimi i substancave kimike.

4. Për çdo element të analizës në pikat 1, 2 dhe 3, PSK përmban:

a) zgjedhjet e projektimit dhe organizimit, procedurat, masat parandaluese e mbrojtëse të kërkuara për të zvogëluar ose eliminuar rrezikun në punë; kur është e nevojshme, prodhohen tabela dhe vizatime teknike shpjegues;

b) masat e koordinimit për realizimin e kërkesave të përmendura në shkronjën "a".

Seksioni 3 – Përmbajtja minimale e PSK në lidhje me ndërhyrjet për ndryshimin e punimeve dhe koordinimin e tyre

1. Koordinatori për projektimin kryen analizën e ndryshimit të punimeve, edhe kur bëhet fjalë për punimet, zbatimin nga i njëjti subjekt ose të punëmarrësve të vetëpunësuar, përgatit një program kohor për zbatimin e punimeve.

2. Në lidhje me ndërhyrjet për ndryshim punimesh, PSK mban shënimet operative për shtyrjen e afateve kohore të punimeve të ndryshuara dhe mënyrat e verifikimit në lidhje me këto shënime; në rastin kur vazhdon rreziku i ndryshimeve, merren masa parandaluese dhe mbrojtëse dhe pajisjet e mbrojtjes personale, për të zvogëluar këto rreziqe.

3. Gjatë kohës së një rreziku më të madh për shkak të ndërhyrjeve për ndryshim në punë, koordinatori për kryerjen e punimeve, kontrollon periodikisht, duke konsultuar paraprakisht drejtuesin e subjekteve zbatuese dhe të punëmarrësve të vetëpunësuar të interesuar, pajtueshmërinë e pjesës përkatëse në PSK me ecurinë e punimeve, duke përditësuar planin dhe në mënyrë të veçantë, nëse është e nevojshme, programin kohor për zbatimin e punimeve.

4. Masat për koordinimin në lidhje me përdorimin e përbashkët të strukturave, infrastrukturës, mjeteve, dhe shërbimeve të mbrojtjes kolektive, përcaktohen duke analizuar përdorimin e përbashkët nga shumë subjekte dhe punëmarrës të vetëpunësuar.

5. Koordinatori për zbatimin e punimeve, plotëson PSK me emrat e subjekteve zbatuese dhe të punëmarrësve të vetëpunësuar, të cilët duhet të zbatojnë çfarë është parashikuar në pikën 4 të seksionit 2 dhe në pikën 4 të seksionit 3, duke konsultuar paraprakisht subjektet zbatuese dhe punëmarrësit e vetëpunësuar të interesuar, tregon gjithashtu kronologjinë përkatëse të zbatimit dhe mënyrat e kontrollit.

Seksioni 4 – Përmbajtja minimale e planit rezervë të sigurisë –PRS.

1. PRS hartohet nga zbatuesi i punimeve, nën kujdesin e autoriteti kontraktor, si plani rezervë i planit të sigurisë dhe koordinimit, kur ai nuk është parashikuar në përputhje me pikën 3 të seksionit 3 dhe përmban të njëjtat elemente të PSK të cituara në pikën 2 të seksionit 1, me përjashtim të vlerësimit të kostos për sigurinë.

Seksioni 5 - Përmbajtja minimale e planit operativ të sigurisë

1. POS hartohet nga çdo punëdhënës i subjektit zbatues, në përputhje me nenin 9, dhe modifikimet e mëtejshme, për secilin kantier të interesuar;

Ky plan përmban të paktën elementët e mëposhtme:

a) të dhënat identifikuese për subjektet zbatuese:

1) emrin e punëdhënësit, adresën, të dhënat telefonike të zyrës qendrore dhe të zyrave të kantierëve;

2) aktivitetet specifike dhe çdo punim të kryer në kantier nga subjekti zbatues dhe punëmarrësit të vetëpunësuar nënkontraktues;

3) emrat e personelit për ndihmën e shpejtë, veprimet kundër zjarrit, evakuimin e punëmarrësve dhe të drejtimit të emergjencës në kantier, të përfaqësuesit të punëmarrësve për sigurinë e ndërmarrjes ose të territorit, i emëruar ose i zgjedhur;

4) emri i mjekut kompetent aty ku parashikohet;

5) emri i përgjegjësit për zyrën e parandalimit e të mbrojtjes;

6) emri i drejtorit teknik të kantierit dhe të përgjegjësit të kantierit;

7) numri dhe kualifikimet për çdo punëmarrës vartës të firmës zbatuese dhe të punëmarrësve të vetëpunësuar që punojnë në kantier për llogari të të njëjtit subjekt.

b) detyrat specifike, të lidhura me sigurinë, të kryera në kantier nga çdo person i emëruar për këtë qëllim nga subjekti zbatues;

c) përshkrimi i aktiviteteve të kantierit, mënyrat e organizmit dhe turnet e punës;

d) lista e skelave, urave kulle mbi rrota dhe e objekteve të tjera provizore me rëndësi, e makinerive dhe e impianteve që përdoren në kantier;

e) listën e substancave dhe preparateve të rrezikshme që përdoren në kantier me skadat përkatëse të sigurisë;

f) rezultatin e raportit të vlerësimit për zhurmën;

g) përcaktimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse, të plotësuara me ato të përfshira në PSK, dhe të adoptuara me rreziqet e lidhura me punimet në kantier;

h) procedurat plotësuese e të detajuara, të kërkuara nga PSK;

i) lista e pajisjeve të mbrojtjes personale të vëna në dispozicion të punëmarrësve në kantier;

l) dokumentet në lidhje me informacionin dhe formimin e dhënë, punëmarrësve në kantier.

2. Aty ku nuk parashikohet hartimi i PSK, PRS plotësohet me elementet e POS kur është e parashikuar.

Sesioni 6 – Llogaritja e kostos për sigurinë

1. Ku parashikohet hartimi i PSK, në koston për sigurinë llogariten për të gjithë kohën e punimeve në kantier, koston për:

- a) strukturat e parashikur në PSK;
- b) masat parandaluese e mbrojtëse dhe pajisjet e mbrojtjes personale të parashikuara në PSK për punimet e ndërhyrjes;
- c) impiantet e tokëzimit dhe mbrojtjes kundër shkarkimeve atmosferike, impiantet kundër zjarrit, impiantet e evakuimit të tymrave;
- d) pajisjet dhe shërbimet e mbrojtjes kolektive;
- e) procedurat e përfshira në PSK e të parashikuara për arsye sigurisë;
- f) ndërhyrjet për sigurinë që kërkohen për diferencat në hapësirë dhe kohë të punimeve ndërhyrëse;
- g) masat e koordinimit në lidhje me përdorimin e përbashkët të strukturave, pajisjeve, infrastrukturave dhe shërbimeve të mbrojtjes kolektive.

2. Llogaritja duhet të jetë koherente, analitike për çdo zë, në masë ose natyrë, me referimet në listën e çmimeve standard ose speciale, ose e bazuar në çmime ose lista zyrtare në fuqi në atë zonë ose në listën e çmimeve të masave të sigurisë të kërkuesit; në rastin kur nuk ka një listë çmimesh ose nuk është e aplikueshme, i referohet analizës së kostos së plotë të nxjerrë nga studimi i tregut. Zërat e kostos për sigurinë llogariten duke marrë në konsideratë koston e përdorimit, mirëmbajtjes, çmontimet dhe amortizimet e mundshme të tyre për kantierin e interesuar.

3. Kostot e sigurisë, të llogaritura në këtë mënyrë, përfshihen në vlerën totale të ofertës së punimeve dhe përbëjnë pjesën e kostos që nuk mund të ulet në ofertat e subjektit zbatues.

4. Për llogaritjen e kostos për sigurinë në lidhje me punimet që janë të nevojshme për shkak të varianteve të parashikuara gjatë punimeve, aplikohen dispozitat në pikat e mësipërme 1,2 dhe 3. Kostot për sigurinë të përcaktuara, përfshihen në vlerën totale, dhe përbëjnë pjesën e kostos së objektit që nuk mund të ulet.

5. Autoriteti kontraktor likuidon vlerën relative të kostove për sigurinë e parashikuar në bazë të avancimit të punimeve, pasi merr mendimin e koordinatorit për zbatimin e punimeve për sa është parashikuar.

## **ANEKSI VII - MBROJTJA E PUNËMARRËSVE KUNDËR RREZIKUT PËR SHKAK TË EKSPOZIMIT NDAJ SUBSTANCAVE KIMIKE DHE FIZIKE GJATË PUNËS**

1. Mbrojtja e punëmarrësve gjatë punës nga rreziku i ekspozimit ndaj amiantit.

1.1 Fusha e aktivitetit.

Rregullat e mëposhtme aplikohen në të gjitha aktivitetet e punës gjatë të cilave rrezikohet ekspozimi ndaj pluhurave që vijnë nga amianti ose nga materiale që përmbajnë amiant.

1.2 Përkufizimet

Në përputhje me këtë aneks, termi amiant u referohet fibrave të silikateve: actinolite, amosite, antofillite, crisotilo, crocidolite, tremolite

1.3 Vlerësimi i rrezikut

Në të gjitha aktivitetet e punës të cituara në pikën 1.1 të mëparshme, punëdhënësi bën vlerësimin e rrezikut të mundshëm të shkaktuar nga pluhurat që vijnë nga amianti dhe materialet me përbërje amiantin, me qëllim që të merren masat parandaluese dhe mbrojtëse për t'u zbatuar.

Ky vlerësim kërkon, në mënyrë të veçantë, të përcaktojë ndotjen e ambientit nga pluhuri i ardhur nga amianti ose materialet me përbërje amiantin, duke përcaktuar pikat e lëshimit të këtyre pluhurave dhe pikat me rrezik më të madh për zonat e punës, dhe përcaktimin e ekspozimit personal të punëmarrësve ndaj pluhurit të amiantit.

Nëse ekspozimi personal i punëmarrësve ndaj pluhurit të amiantit, i shprehur në numrin e fibrave për centimetër kub në raport me një periudhë referimi prej 8 orësh, e kalon 0,1 fibër për centimetër kub, punëdhënësi zbaton dispozitat e pikave 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.9, 1.14 të këtij aneksi, gjithsesi në rastet e aktiviteteve gjatë të cilave përdoret amiantit si lëndë e parë, pikat 1.4 dhe 1.9 aplikohen në çdo rast.

Në rast të aktiviteteve me hope dhe kur amianti përbëhet nga crisotilo, përcaktimi i ekspozimit personal të punëmarrësve zëvendësohet nga përcaktimi i dozës së akumuluar në raport me një periudhë referimi prej 8 orësh, në një periudhë totale kohe prej 40 orësh.

Nëse kjo dozë tejkalon 0,5 ditë – fibër për centimetër kub, punëdhënësi zbaton dispozitat në pikat 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.9, 1.14.

Llogaritja mund të nxirret nga kryerja e matjeve me instrumente gjatë aktivitetit, për të cilat, për shkak të karakteristikave të punimeve të kryera ose të natyrës dhe tipit të materialeve të përdorura, mund të thuhet se ekspozimi i punëmarrësve nuk kalon vlerat e cituara në pikat e mësipërme. Për këtë vlerësim mund të bëhen referime te të dhënat e marra nga aktivitete të së njëjtës natyrë të kryera në kushte të njëjta.

Punëdhënësi kryen vlerësim të ri, sa herë që verifikohen ndryshime në punime që mund të sjellin ndryshime të rëndësishme në ekspozimin e punëmarrësve ndaj pluhurit që vjen nga amianti ose nga materiale me përbërje amiantin, dhe ne raste të tjera tre vjet pas vlerësimit të fundit.

Vlerësime të reja kryhen çdo herë që organi i ruajtjes e kërkon duke paraqitur argumente të motivuara.

Punëmarrësit ose përfaqësuesi i tyre për sigurinë, konsultohen para kryerjes së vlerësimit të cituar në këtë nen dhe informohen për përfundimet, të cilat shënohen në një regjistër të posaçëm në dispozicion të tyre.

#### 1.4 Njoftimi

Punëdhënësi, që ushtron aktivitet, në të cilin ekspozimi i punëmarrësve ndaj pluhurit të amiantit rezulton i njëjtë ose më i madh nga vlerat e përcaktuara në pikën e mësipërme 1.3, njofton organet e ruajtjes në lidhje me rezultatet e vlerësimit të cituar nga i njëjti nen, së bashku me informacionet e mëposhtme:

- a) aktivitetet e kryera dhe vendimet e marra;
- b) llojet dhe masat kuantitative të amiantit të përdorur;
- c) prodhimet e fabrikua;
- d) numrin e punëmarrësve;
- e) masat mbrojtëse të parashikuara, duke specifikuar kriteret për mirëmbajtjen periodike dhe sistemin parandalues të përdorur.

Punëdhënësi, i cili në ushtrimin e aktivitetit përdorë si lëndë të parë amiantin, gjithashtu duhet të bëjë njoftimin pavarësisht nga niveli i ekspozimit të punëmarrësve.

Në rastin e aktiviteteve të reja, hapja e tyre u komunikohet organeve të ruajtjes me letër rekomande brenda 15 ditëve.

Punëmarrësit ose përfaqësuesit e tyre mund ta shikojnë dokumentacionin e njoftimeve të cituara në pikat e mësipërme.

#### 1.5 Informacionet për punëmarrësit

Në aktivitetet e përmendura në pikën 1.1, punëdhënësi, vë në dispozicion të punëmarrësve, dhe përfaqësuesve të tyre para se ata të fillojnë kryerjen e aktiviteteve, informacione në lidhje me:

- a) rreziqet për shëndetin, të shkaktuara nga ekspozimi ndaj pluhurave, që vijnë nga amianti ose nga materialet me përbërje amiantin;
- b) rregullat specifike higjienike që duhen ndjekur, përfshirë ato për mospirjen e duhanit;
- c) mënyrat e pastrimit ose të përdorimit të veshjeve mbrojtëse dhe pajisje mbrojtëse personale ;
- d) masat e kujdesit paraprak për të reduktuar ekspozimin në minimum.

Informacioni përsëritet në periudhë trevjeçare dhe gjithsesi çdo herë që ka ndryshime në punime që sjellin ndryshime të rëndësishme të ekspozimit.

Në aktivitetet që krijojnë kushtet e ekspozimit të cituara në pikën 1.3, duhet të japin informacion pas çdo periudhë njëvjeçare dhe përfshin vlerën limit të cituar në pikën 1.10 dhe nevojën e kontrollit të ekspozimit të punëmarrësve ndaj pluhurit të amiantit në ajër.

#### 1.6 Masat teknike, organizative, procedurale.

Në të gjitha aktivitetet e cituara në pikën 1.1 punëdhënësi:

- siguron që ndërtesat, vendet, impiantet në të cilat kryhen punimet e amiantit ose të materialeve me përbërje amiantin të kenë karakteristika të tilla që të mund t'i nënshtrohen pastrimit dhe mirëmbajtjes;

- siguron që në aktivitetet e punëve të ndryshme të përdoret sasi amianti jo më të mëdha se sasia e nevojshme e amiantit që do të përdoret, dhe në formë fizike, të mos akumulohet në vendet e punës në sasi më të mëdha se ajo e nevojshme, që të paraqesë rrezik;

- kufizon në minimumin e mundshëm numrin e punëmarrësve të ekspozuar ose që mund të ekspozohen ndaj pluhurit që vjen nga amianti ose nga materiale me përbërje amiantin, si edhe duke izoluar punimet në zona të caktuara paraprakisht.

- projektton, programon dhe ndjek punimet në mënyrë që mos të ketë lëshime të pluhurave të amiantit në ajër; nëse kjo nuk është teknikisht e mundur, eliminimi i pluhurit duhet të bëhet sa më afër pikës së lëshimit; kryhen matje të koncentrimit të pluhurit të amiantit në ajër, dhe verifikohet efikasiteti i masave të marra,

- vë në dispozicion të punëmarrësve:

1) veshje pune të përshtatshme ose mbrojtëse;

2) pajisje mbrojtëse për rrugët e frymëmarrjes për t'u përdorur gjatë përdorimit të produkteve që lëshojnë pluhur dhe në pastrime;

3) siguron që amianti në gjendje natyrale dhe materialet pluhur që e përmbajnë atë, të jenë të ruajtura dhe transportuara në ambalazhe të përshtatshme të mbyllura.

4) siguron që mbetjet e punimeve të mblidhen dhe të hiqen nga vendi i punës me ambalazhe të përshtatshme të mbyllura dhe jo lehtësisht të dëmtueshme, ose me veshje të përshtatshme me etiketë ku tregohet përmbajtja e amiantit.

Në rast të aktiviteteve që krijojnë kushte ekspozimi të cituar në pikën 1.3, punëdhënësi siguron gjithashtu:

a) që vendet në të cilat kryhen aktivitetet të jenë të kufizuara dhe me sinjalistikën e përshtatshme të sigurisë;

b) që në këto vende duhet të hyjnë ekskluzivisht punëmarrësit që kryejnë detyrat e tyre, ose që lejohet të hyjnë për motive pune;

c) vënien në dispozicion të punëmarrësve pajisjet mbrojtëse personale, për t'u përdorur sipas dispozitave të pikës 1.10.

#### 1.7 Masat higjienike

Në aktivitetet e përcaktuara sipas pikës 1.1, punëdhënësi:

a) siguron pastrimin e rregullt dhe sistematik të vendit, të mjeteve dhe impianteve, duke kryer heqjen e pluhurit nëpërmjet aspiratorëve të përshtatshëm;

b) përgatit zona të veçanta që u lejojnë punëmarrësve të ushqehen, dhe pushojnë pa u kontaminuar nga pluhuri i amiantit. Lejohet pirja e duhanit në këto ambiente.

Në rastin e aktiviteteve që krijojnë kushte ekspozimi si në pikën 1.3, punëdhënësi ndërkohë:

a) siguron që punëmarrësit të kenë kushtet higjienike të përshtatshme, të pajisura me dushe. Ku është e mundur, këto duhet të përdoren vetëm nga punëmarrësit, me rrugë të ndara për hyrjen dhe daljen nga zona e punës;

b) siguron që veshjet e punës dhe mbrojtjes të vendosen në vend të veçanta nga ai i destinuar për veshjet civile. Larja kryhet nga ndërmarrja me lavanderi të pajisur me një makinë të posaçme për këtë aktivitet. Transporti kryhet në ambalazhe të mbyllura dhe të etiketuara. Larja përfshihet në aktivitetet e cituara në pikën 1.1;

c) merr masat që pajisjet mbrojtëse personale të cituara në 1.6, të ruhen në vendet e nevojshme, të kontrollohen dhe pastrohen pas çdo përdorimi, duke mundësuar riparimin dhe zëvendësimin e pjesëve defektoze para çdo përdorimi. Pastrimi i këtyre pajisjeve kryhet nëpërmjet aspirimit.

#### 1.8 Kontrolli shëndetësor.

Punëdhënësi në përputhje me mendimin e mjekut kompetent, nëse është e nevojshme, merr masa parandaluese dhe mbrojtëse për çdo punëmarrës mbi bazën e rezultateve të kontrolleve klinike të kryera. Këto masa mund të parashikojnë edhe largimin e përkohshëm të punëmarrësit nga çdo lloj ekspozimi ndaj amiantit.

Kundër masave të marra në lidhje me punëmarrësit pjesëmarrës, mund të bëhet ankesë në organet përkatëse brenda 30 ditëve, duke informuar me shkrim punëdhënësin.

Ky organ rishqyrton vlerësimin e kontrolleve të kryera nga mjeku kompetent, duke urdhëruar, pas verifikimeve të mëtejshme, konfirmimin, modifikimin ose revokimin e masave të marra për punëmarrësit.



Mjeku kompetent vë në dispozicion të punëmarrësve ose të përfaqësuesit të tyre informacione të përshtatshme mbi vlerësimin e kontrolleve mjekësore, të cilave u nënshtrohen dhe nevojshmërinë e kontrolleve dhe pas lënies së aktivitetit ndaj ekspozimit të pluhurave që vijnë nga amianti ose materiale me përbërje amianti.

#### 1.9 Kontrolli për ekspozimin e punëmarrësve

Në të gjitha aktivitetet që krijojnë kushte ekspozimi të cituara në pikën 1.1, punëdhënësi kryen një kontroll periodik të ekspozimit të punëmarrësve ndaj pluhurit të amiantit në ajër. Në aktivitetet në të cilat amianti përdoret si lëndë e parë, ky kontroll kryhet gjithsesi pavarësisht nga niveli i ekspozimit.

Kontrolli kryhet nëpërmjet matjeve të koncentrimit të fibrave të amiantit në ajër, e shprehur si mesatare e ponderuar në raport me një periudhë referimi prej 8 orësh, duke përdorur metodat e marrjes dhe analizave të cituar në pikën e mëposhtme 1.15.

Për matjet, merren në konsideratë vetëm fibrat, të cilat kanë një gjatësi më të madhe se 5 micron, një gjerësi më të vogël se 3 micron dhe raporti gjatësi/gjerësi i të cilës të jetë me i madh se 3:1.

Matjet janë të programuara. Kampionet merren nga personeli me kualifikim të përshtatshëm. Kampionet analizohen në laboratorë publikë ose private me pajisjet e nevojshme dhe të autorizuar.

Marrja e kampioneve duhet të jetë në lidhje me ekspozimin personal të punëmarrësve dhe mund të përfshijë një ose me shumë analiza. Kjo kryhet në mënyrë që të lejojë vlerësimin e ekspozimit ditor të punëmarrësit dhe është bashkë me kampionet e ambientit nëse është e nevojshme për të identifikuar shkaqet dhe nivelin e ndotjes.

Nëse marrja e kampioneve nuk shtrihet gjatë periudhës së tetë orëve, kryhet gjithsesi një analizë për secilën fazë të ciklit të punës në mënyrë që të mund të llogaritet vlera e mesatares së ponderuar e koncentrimit të fibrave të amiantit në ajër për të gjithë periudhën 8 - orare. Në çdo rast, intervalet e marrjes së kampionit në kompleksitet nuk janë më pak se çdo dy orë.

Nëse një grup punëmarrësish kryejnë detyra të njëjta ose të ngjashme në të njëjtin vend dhe rreziku i ekspozimit është i njëjtë, për këtë arsye, marrja e kampioneve mund të kryhet mbi bazë grupi.

Matjet bëhen, normalisht çdo tre muaj dhe sa herë që ndodhin ndryshime që mund të provokojnë ndryshime të mëdha në ekspozimin e punëmarrësve ndaj pluhurit të amiantit. Frekuenca e matjeve mund të reduktohet deri në një herë në vit, me komunikim të organeve të ruajtjes, kur:

a) nuk ka asnjë ndryshim të rëndësishëm në vendet e punës;

b) rezultatet e dy matjeve të mëparshme nuk kanë tejkaluar gjysmën e vlerave të kufirit të cituar në pikën 1.10.

Në aktivitetet me karakter jo të vazhdueshëm, frekuenca e matjeve përshtatet me kushtet ekzistuese, duke marrë në konsideratë, në mënyrë të veçantë, numrin e ditëve të punës në vit dhe shpërndarjen e këtyre ditëve gjatë vitit. Kjo frekuenca është në çdo rast vjetore.

Punëmarrësit ose përfaqësuesit e tyre informohen mbi rezultatet e matjeve të kryera dhe mbi përmbajtjen e këtyre rezultateve dhe konsultohen para kryerjes së provave të kampionit.

#### 1.10 Tejkalmi i vlerave limit të ekspozimit

Vlerat e lejuara të ekspozimit ndaj pluhurave të amiantit në ajër të shprehur si mesatare të ponderuar në funksion të kohës së referimit prej 8 orësh, janë:

a) 0,6 fibër për centimetër kub për crisotilo;

b) 0,2 fibër për centimetër kub për të gjitha llojet e tjera të amiantit, të veçanta ose përzierje me përmbajtje crisotilo.

Në rastin e punimeve që mund të sjellin ndryshime të rëndësishme të koncentrimit të pluhurit të amiantit, ky koncentrim nuk duhet të kalojë 5-fishin e vlerave të cituara në pikat e mëparshme për matjet e kryera për një periudhë prej 15 minutash.

Nëse verifikohet një kalim i vlerave të lejuara të ekspozimit, të përcaktuara në pikat e mëparshme, punëdhënësi identifikon dhe merr masat e duhura menjëherë për të eliminuar shkaqet që kanë shkaktuar kalimin e vlerave.

Puna mund të vazhdojë në zonën me ndotje vetëm nëse janë marrë masat e përshtatshme për mbrojtjen e punëmarrësve dhe të ambientit. Nëse masat e mësipërme nuk mund të merren

menjëherë për motive teknike, puna mund të vazhdojë në zonat e caktuara vetëm nëse janë përshtatur masat për mbrojtjen e punëmarrësve dhe të ambientit duke marr parasysh mendimin e mjekut kompetent.

Për të verifikuar efikasitetin e masave, punëdhënësi bën matje të reja të koncentrimin të fibrës së amiantit në ajër, sapo gjykon së depozitimi i sasive anormale të fibrave të mëparshme nuk ndryshon, bën të njëjtat ndërhyrje.

Në çdo rast, nëse ekspozimi i punëmarrësve të interesuar, nuk mund të reduktohet me mjete të tjera dhe bëhet i nevojshëm përdorimi i pajisjeve të mbrojtjes personale, ky përdorim nuk mund të jetë i përhershëm dhe kohëzgjatja e tij për çdo punëmarrës, është e kufizuar me kohën minimale të nevojshme.

Struktura përkatëse informohet menjëherë e gjithësesi jo më vonë se 5 ditë nga rezultatet e marra dhe për masat që do të merren ose janë marrë. Pasi kanë kaluar 90 ditë nga koha në të cilën përcaktohet tejkalimi i vlerave të mësipërme, puna mund të vazhdojë në zonat e infektuara vetëm nëse ekspozimi i punëmarrësve rezulton sërish më i ulët se vlerat limit.

Punëdhënësi informon sa më shpejt të jetë e mundur punëmarrësit e interesuar dhe përfaqësuesit e tyre për ngjarjen, shkaqet dhe paraqet masat që mendon të marrë; në raste të veçanta ose urgjente, që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme dhe i informon sa më shpejt për masat e marra.

#### 1.11 Masat e emergjencës

Nëse verifikohen ngjarje që mund të provokojnë një rritje të madhe të ekspozimit ndaj pluhurit të amiantit, punëmarrësit duhet të lenë menjëherë zonën e infektuar. Mund të hyjnë në këtë zonë vetëm punëmarrësit për ndërhyrjet e nevojshme, me kusht që të përdorin pajisjet e përshtatshme të mbrojtjes.

Punëdhënësi i komunikon strukturave përkatëse, që të verifikojë këto raste dhe i referon masat e marra për të reduktuar në minimum rezultatet.

#### 1.12 Aktivitete pune, të veçanta

Në rastin e disa aktiviteteve të caktuara në punë, natyra e veçantë e të cilave parashikon që ekspozimi i punëmarrësve ndaj pluhurit të amiantit kalon vlerat e lejuara të cituara në pikën 1.10 dhe për të cilat nuk mund të zbatohen masat teknike të parandalimit për të zvogëluar ekspozimin e punëmarrësve, punëdhënësi merr masat e nevojshme për mbrojtjen e punëmarrësve. Në mënyrë të veçantë, përveç aplikimit të masave të përgjithshme në nenet e mësipërme:

a) u jep punëmarrësve veshje speciale dhe pajisje të mbrojtjes personale, të cilat përdoren gjatë këtyre punëve ;

b) siguron izolimin rigoroz të zonës së punës dhe instalimin e sistemeve të përshtatshme për qarkullimin e ajrit me filtra të rregullt;

c) siguron afishimin e tabelave përkatëse me shkrimin:

“Kujdes – zonë me rrezik të lartë – prani e mundshme e pluhurit të amiantit me koncentrim më të lartë se vlerat e lejuara të ekspozimit”;

d) përgatit një plan pune duke u konsultuar me punëmarrësit ose përfaqësuesin e tyre, i cili përmban të gjitha masat që garantojnë mbrojtjen e punëmarrësve dhe të ambientit dhe ua transmeton strukturave përkatëse.

#### 1.13 Shkatërrimi dhe largimi i amiantit

Punëdhënësi përgatit një plan pune para fillimit të shkatërrimit dhe largimit të amiantit ose të materialeve me përmbajtje amianti, nga ndërtesat, strukturat, aparatet dhe impiantet, si dhe mjetet e transportit. Ky plan parashikon masat e nevojshme për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve dhe mbrojtjen e ambientit të jashtëm.

Plani në mënyrë të veçantë, parashikon:

a) largimin e amiantit dhe të materialeve me përbërje amianti para aplikimit të teknikave të shkatërrimit, nëse është e mundur;

b) pajisja e punëmarrësve me pajisjet e mbrojtjes personale;

c) masa të përshtatshme për mbrojtjen dhe dekontaminimin e punëmarrësve;

d) masa të përshtatshme për mbrojtjen e të tretëve dhe për mbledhjen dhe përpunimin e materialeve ndotës;

e) përshtatjen, në rastet kur parashikohet tejkalimi i vlerave të lejuara të cituara në pikat 1.10 dhe 1.12, me nevojat e veçanta të punës me karakter të veçantë.

Kopja e planit të punës u dërgohet organeve të ruajtjes, së bashku me informacionet në lidhje me:

- a) natyrën e punimeve dhe kohëzgjatjen e mundshme;
- b) vendin ku kryhen punimet;
- c) teknikat e punës për të zbatuar çfarë parashikohet për largimin;
- d) natyra e amiantit në materialet termoizolues në rastin e shkatërrimit;
- e) karakteristikat e pajisjeve që mendohet të përdoret për të zbatuar gjatë shkatërrimit për mbrojtjen dhe dekontaminimin;
- f) materialet e parashikuara për termoizolimin.

Nëse organet e ruajtjes nuk lëshojnë udhëzime brenda 90 ditëve nga data e dërgimit të këtij dokumentacioni, punëdhënësit mund të vazhdojnë punimet, dhe përgjegjësitë mbeten të tyre, për sa i përket zbatimit të dispozitave të kësaj rregulloreje.

Dërgimi i dokumentacionit të përmendur në pikën 4 zëvendëson ato të përmendura në pikën 1.4.

Punëmarrësit ose përfaqësuesit e tyre kanë të drejtën të përdorin dokumentacionin në fjalë.

1.14 Regjistrimi i ekspozimit të punëmarrësve.

Punëmarrësit e ngarkuar për kryerjen e aktiviteteve në kushtet e ekspozimit të përmendur në pikën 1.4, regjistrohen në regjistrin ku shënohen nivelet e ekspozimit, lista e punëmarrësve të ekspozuar dhe kartelat shëndetësore të rrezikut.

Regjistri i sipërpërmendur përgatitet dhe përditësohet nga punëdhënësi, i cili është përgjegjës për mirëmbajtjen e tij.

Punëdhënësi:

- a) i dorëzon një kopje të regjistrit strukturave përkatëse, të cilave ia komunikon çdo tre vjet, si edhe çdo herë që ato bëjnë kërkesë në lidhje me ndryshimet e bëra;
- b) dorëzon, kur i kërkohet, strukturave përkatëse një kopje të regjistrit të mësipërm;
- c) u komunikon strukturave përkatëse të ruajtjes së territorit, mbylljen e raportit të punës me ndryshimet e bëra në komunikimet e mësipërme;
- d) u dorëzon regjistrin strukturave përkatëse të ruajtjes për territorin, në rastet e mbylljes së aktivitetit të ndërmarrjes;
- e) u kërkon strukturave përkatëse të ruajtjes për territorin, kopje të shënimeve individuale në rastin e marrjes në punë të punëmarrësve të cilët kanë eksperiencë punë në kushte të ekspozimit të përmendura në pikën 1.3.
- f) u komunikon punëmarrësve të interesuar nëpërmjet mjekut kompetent shënimet individuale përkatëse në regjistrin dhe në kartelën shëndetësore dhe të rreziqeve.

1.15 Aktivitetet e ndaluara.

Ndalohet përdorimi i aplikimit me spërkatje i amiantit. Ndalohen aktivitetet që sjellin inkorporimin e materialeve termoizolues ose zëizolues me dendësi të ulët ( më të ulët se 1g/cm<sup>3</sup>) që përmbajnë amiantin.

1.16 Metodatat e analizave për matjen e koncentrimin të fibrave të amiantit në ajër

Karakteristikat dhe mjetet për marrjen e kampioneve të provave të fibrave të amiantit në ajër dhe përcaktimi i koncentrimin të fibrave të amiantit në kampionët e ajrit përcaktohen në mënyrën shpjeguar më poshtë. Gjithsesi mund të përdoren dhe mënyra të tjera me të cilat mund të tregohet ekuivalenca e rezultateve në lidhje me metodën e referimit.

Kampionët merren në zonën e frymëmarrjes të secilit prej punëmarrësve: d.m.th. në një gjysmë harku me rreze 300 mm përballë fytyrës së punëmarrësit dhe maten duke filluar nga një pikë, në gjysmën e vijës që bashkon veshët e tij.

Përdoret një pompë lëvizëse me bateri, që fiksohet në rripin ose xhepin e punëmarrësit. Fluksi nuk duhet të ketë rrahje/dridhje, me një prurje të rregullt fillimisht prej 1 L/min 5%. Gjatë kohës së marrjes së kampionit, prurja duhet të mbahet në kufijtë ± 10% të prurjes fillestare.

Koha e marrjes së kampionit matet me një tolerancë prej 2%.

Sasia optimale e fibrës në filtër është midis 100 dhe 400 fibër/mm<sup>2</sup>. Sipas preferencës, i

gjithë filtri ose një segment i tij, i vendosur mbi xhamin e mikroskopit, bëhet transparent nëpërmjet metodës acetone-triacetina dhe mbulohet me xhamin mbulues.

## 2. Mbrojtja e punëmarrësve kundër rreziqeve të ekspozimit ndaj zhurmës

### 2.1 Parime të përgjithshme.

Këto rregulla kanë për qëllim të mbrojnë punëmarrësit kundër rrezikut për dëgjimin, dhe aty ku është shprehimisht e parashikuar, kundër rreziqeve për shëndetin dhe sigurinë të shkaktuara nga ekspozimi ndaj zhurmës gjatë punës.

### 2.2 Përkufizime

Në përputhje me këto rregulla kuptojmë:

a) ekspozim ditor personal të një punëmarrësi ndaj zhurmës (LEP, dit), ekspozimin ditor personal të një punëmarrësi ndaj zhurmës të shprehur në dB(A), të matur, llogaritur dhe referuar 8 orëve ditore.

Ekspozimi ditor personal nuk merr në konsideratë efektet e çdo pajisjeje të mbrojtjes personale;

b) ekspozimi javor profesional i një punëmarrësi ndaj zhurmës (LEP, ë), mesatarja javore e vlerave të përditshme (LEP, d), i vlerësuar për ditët e punës në një javë.

### 2.3 Vlerësimi i rrezikut të mundshëm

Punëdhënësi kryen vlerësimin e zhurmës gjatë punës, me qëllim që të identifikojë punëmarrësit dhe vendet e punës që merren në konsideratë në pikat në vazhdim dhe të zbatojë masat parandaluese dhe mbrojtëse aty ku parashikohet.

Ekspozimin ditor personal ose mesatar javorë është i ndryshueshëm gjatë javës, pra tejkalon vlerën e dhënë të pikës 2.5, vlerësimi programohet dhe kryhet në intervale të mundshme nga personeli kompetent, nën përgjegjësinë e punëdhënësit.

Metodat dhe instrumentet e përdorura duhet të jenë të përshtatshme, duke vlerësuar veçanërisht karakteristikat e zhurmës që do të matet, kohëzgjatjen e ekspozimit, faktorët e ambientit dhe karakteristikat e aparatit të matjes. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, vlerësimi duhet të kryhet si rregull sa herë që ka ndryshime në punë, që influencojnë ndjeshëm në shtimin e zhurmës dhe sa herë që struktura përkatëse kërkon vlerësim të argumentuar.

Punëdhënësi harton dhe mban në dispozicion të organeve të ruajtjes një raport në të cilin tregohen kriteret dhe mënyrat e kryerjes të vlerësimeve dhe në mënyrë të veçantë elementët e sipërpërmendur. Punëmarrësit ose përfaqësuesit e tyre konsultohen siç është parashikuar në pikën 3.

### 2.4 Masat teknike, organizative dhe procedurale.

Punëdhënësi, bazuar në njohuritë e marra për zhvillimin e teknikës, zvogëlon në minimum rreziqet që vijnë si shkak i ekspozimit ndaj zhurmës nëpërmjet masave teknike, organizative dhe procedurale që zbatohen konkretisht duke i dhënë përparësi ndërhyrjes që bëhet në burim.

Në vendet e punës, të cilat gjatë kryerjes së detyrës ditore nga punëmarrësi sjellin një ekspozim personal ditor më të madh se 90 dBA, ose një vlerë të presionit akustik të momentit jo të ponderuar më të madh se 140 dB (200 Pa), vihet një sinjalistikë e përshtatshme. Këto vende gjithashtu evidentohen dhe kufizohen lëvizjet, kur rreziku i ekspozimit e justifikon dhe kur është e mundshme të realizohen.

### 2.5 Informimi dhe formimi

Në aktivitetet që, për një punëmarrës, shkaktojnë një ekspozim ditor personal ndaj zhurmës më të lartë se 80 dBA, punëdhënësi merr masat që punëmarrësit ose përfaqësuesit e tyre të informohen mbi:

- a) rreziqet për dëgjimin për shkak të ekspozimit ndaj zhurmës;
- b) masat e marra në zbatim të këtyre rregullave;
- c) masat mbrojtëse të cilave punëmarrësit duhet t'u përshtaten;
- d) funksionet e pajisjeve të mbrojtjes personale, kushtet në të cilat parashikohet përdorimi dhe mënyrat e përdorimit sipas përshkrimit në pikën 2.6;
- e) kuptimin dhe rolin e kontrollit shëndetësor të përmendur në pikën 2.7.
- f) rezultatet dhe kuptimin e vlerësimeve sipas pikës 2.3.

Nëse aktivitetet e mësipërme sjellin një vlerë të ekspozimit ditor personal ndaj zhurmës më të madh se 85 dBA, punëdhënësi parashikon marrjen e një formimi të duhur nga punëmarrësit mbi:

- a) përdorimin korrekt pajisjet mbrojtëse personale të dëgjimit;
- b) përdorimin korrekt, me qëllim zvogëlimin në minimum të rrezikut për dëgjimin, të mjeteve, makinerive, aparateve, të cilat të përdorura në mënyrë të vazhdueshme, krijojnë një ekspozim personal ditor të punëmarrësit ndaj zhurmës jo më të lartë se 85 dBA.

#### 2.6 Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale të dëgjimit.

Punëdhënësi vë në dispozicion pajisjet mbrojtëse personale të dëgjimit për të gjithë punëmarrësit, ekspozimi personal ditor i të cilëve mund të tejkalojë 85 dBA. Mjetet e mbrojtjes individuale për dëgjimin u adoptohen sipas kushteve të punës secilit prej punëmarrësve, duke pasur parasysh sigurinë dhe shëndetin. Mjetet mbrojtëse individuale të dëgjimit konsiderohen të përshtatshme me këto rregulla, nëse përdoren në mënyrë korrekte, mbajnë një nivel rreziku të barabartë ose më të vogël se sa një ekspozim ditor personal prej 90 dBA.

Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2.4, punëmarrësit, të cilët janë nën ekspozimi personal ditor që tejkalon 90 dBA, duhet të përdorin mjetet mbrojtëse individuale të dëgjimit të vëna në dispozicion nga punëdhënësi.

#### 2.7 Kontrolli shëndetësor

Punëmarrësit, ekspozimi personal ditor i të cilëve ndaj zhurmës tejkalon 85 dBA, pavarësisht nga përdorimi i mjeteve të mbrojtjes individuale, i nënshtrohen kontrollit shëndetësor.

Ky kontroll përfshin:

- a) një vizitë mjekësore paraprake, së bashku me një kontroll të funksioneve të dëgjimit, për të qartësuar efektin e punëve specifike, me qëllim vlerësimin e përshtatshmërisë së punëmarrësve;
- b) vizitë mjekësore periodike, së bashku me një kontroll të funksioneve të dëgjimit, për të kontrolluar gjendjen e shëndetit të punëmarrësve dhe për të marrë mendim mbi përshtatshmërinë e punës. Këto duhet të merren parasysh, së bashku me ekspozimin dhe sensibilitetin akustik individual. Vizita e parë kryhet jo më shumë se pas një viti nga vizita parashikuara.

Frekuenca e vizitave të tjera vendoset nga mjeku kompetent. Gjithsesi intervalet nuk mund të jenë më të mëdha se dy vjet për punëmarrësit, ekspozimi personal ditor i të cilëve nuk tejkalon 90 dBA dhe një vit në rastet e ekspozimit ditor personal që tejkalon 90 dBA, të përmendur edhe në pikat 2.10 dhe 2.11.

Kontrolli shëndetësor është i njëjtë për punëmarrësit, ekspozimi ditor personal i të cilëve lëviz midis 80 dBA dhe 85 dBA, kur punëmarrësit e interesuar bëjnë kërkesë dhe mjeku kompetent e konfirmon, bëjnë vizita me qëllimin për të përcaktuar efekte të mundshme që kanë të bëjnë jo vetëm me dëgjimin.

Punëdhënësi, në përputhje me mendimin e mjekut kompetent, merr masa parandaluese dhe mbrojtëse për çdo punëmarrës, me qëllim që të favorizojë shërimin audiologjik. Këto masa përfshijnë zvogëlimin e ekspozimit ditor personal të punëmarrësit dhe masa të tjera të mundshme organizative.

Kundër masave të përshtatura dhe rregullave të marra në drejtim të tyre, punëmarrësit e interesuar mund të ankohen tek organet përkatëse brenda 30 ditëve, duke informuar me shkrim punëdhënësin.

#### 2.8 Tejkalimi i vlerave limit të ekspozimit

Nëse pavarësisht nga aplikimi i masave të parashikuara në pikën 2.4, ekspozimi ditor personal i një punëmarrësi ndaj zhurmës rezulton më i madh se 90 dBA ose vlera e presionit akustik të momentit jo e ponderuar rezulton më e madhe se 140 dB (200 Pa), punëdhënësi u komunikon strukturave përkatëse, brenda 30 ditëve nga përcaktimi i tejkalimit, masat teknike dhe organizative të aplikuara në përputhje me pikën 2.4, duke informuar punëmarrësit ose përfaqësuesit e tyre.

#### 2.9 Aparatet e reja, impiantet e reja dhe ristrukturimet

Projektimi, ndërtimi dhe realizimi i impianteve të reja, makinat dhe aparatet, zgjerimi dhe modifikimet rrënjësore të fabrikave dhe impianteve ekzistuese kryehen në përputhje me pikën 2.4.

Pajisjet e reja, makinat dhe aparatet e destinuar për përdorim gjatë punës, të cilat gjatë përdorimit të vazhdueshëm mund të provokojnë një ekspozim personal ditor ndaj punëmarrësit që i përdor, më të madhe se 85 dBA, janë të pajisura me një informacion lidhur me zhurmën e prodhuar

në kushte normale dhe rreziqet që sjell përdorimi. Punëdhënësi, në momentin e blerjes së makinave, mjeteve dhe aparateve të reja, i jep prioritet atyre që shkaktojnë më pak zhurmë në kushte normale të funksionimit.

#### 2.10 Punimet që sjellin ndryshime të rëndësishme të ekspozimit ditor personal

Aty ku karakteristikat e ndryshme të një vendi pune sjellin ndryshime të rëndësishme në ekspozimin personal ditor të një punëmarrësi ndaj zhurmës nga një ditë tek tjetra, punëdhënësi mund të kërkojë për punëmarrësit që kryejnë detyra të veçanta, përjashtime të aplikimit të dispozitës në pikën 2.6, me kusht që kontrollet e duhura të tregojnë se mesatarja e vlerave ditore të ekspozimit të punëmarrësit ndaj zhurmës nuk mund të kalojë vlerën 90 dBA.

Kërkesa e përjashtimit u drejtohet organeve të ruajtjes, me një përshkrim të detyrave të kryera, me treguesit e vlerave të ekspozimit ditor personal shoqëruar me një relacion të mjekut kompetent, i cili përmban edhe një vlerësim të kontrolleve për dëgjimin.

#### 2.11 Kriteret për matjen e zhurmës

Ekspozimet personale të përmendur në pikën 2.9:

h) maten direkt me fonometër të integruar ose:

i) llogariten duke filluar nga matjet e presionit akustik, duke përfshirë kohën e ekspozimit.

Matjet mund të kryhen në vendet ku punojnë punëmarrësit ose me instrumente të fiksuara te punëmarrësit. Lokalizimi dhe kohëzgjatja e matjeve duhet të jenë përfaqësuese të vlerave të matura.

Fonometrat e përdorur duhet të jenë konform me përshkrimet e normave IEC 651 grupi 1: këto duhet të jenë të pajisur me treguesit e mbingarkesës.

Këto instrumente nuk janë të përshtatshëm në llogaritjen LAeq T<sub>e</sub> dhe në praninë e zhurmave impulsive.

Ku përdoren fonometrat integrorë këta duhet të jenë konform me përshkrimet e normës IEC 804 grupi 1.

Lejohen metodat e matjeve që parashikojnë regjistrimin, si etapa të ndërmjetme të sinjaleve mbi mbështetëse sa manjetikë.

Instrumenti i përdorur për të matur drejtpërdrejt vlerën maksimale (pikun) të presionit akustik të momentit jo të ponderuar, duhet të ketë një rritje konstante të kohës jo më të madhe se 100 mikrosekondë.

Të gjitha instrumentet duhet të tarohen në intervale jo më të gjatë se një vit dhe të rikontrollohen para çdo matjeje.

Matja e presionit akustik në prani të personit që kontrollohet duhet të marrë në konsideratë edhe dridhjet e shkaktuara nga vetë pajisja matëse e presionit; matja konsiderohet e qetë nëse mund të kryhet në distancë 0,1 metër nga koka deri në lartësinë e veshëve.

Ponderimi i përkohshëm “ sloë ” dhe “ fast “ janë të vlefshme nëse intervali i matjeve rezulton më i madh se sa kostantja e kohës së ponderimit të zgjedhur dhe nëse niveli i presionit akustik nuk ndryshon në mënyrë të shpejtë. Për çdo matje duhet të tregohet dhe pasaktësia nga e cila mund karakterizohet ( gabime të rastit).

#### 2.12 Kriteret për kontrollin e funksionit të dëgjimit tek punëmarrësit.

Për kontrollin e funksionit të dëgjimit të punëmarrësve, merren në konsideratë aspektet e mëposhtme:

1) Kontrolli i kryer në përputhje me mjekësinë e punës, përfshin:

- një kontroll fillestar para ekspozimi ndaj zhurmës dhe pas një viti ekspozimi;

- kontrolle periodike me intervale në përputhje me natyrën e rrezikut dhe të përcaktuar nga mjeku, të parashikuara në pikën 2.7.

2) Çdo kontroll përfshin të paktën një otoscopi dhe një kontroll audiometrik me audiometri liminare tonale në zonë që mbulon edhe frekuencën 8.000 Hz.

3) Kontrolli audiometrik respekton dhe dispozitat e standardit ISO 6189-1983 dhe duhet të kryhet në një ambient me nivel zhurme të tillë që të lejojë matjen e një niveli dëgjimi prej 0 dB, i cili përputhet me standardin ISO 389-1979.

### 3. MBROJTJA E PUNËMARRËSËVE KUNDËR RREZIQEVE TË SHKAKTUARA NGA SUBSTANCAT KIMIKE GJATË PUNËS

#### 3.1 Parime të përgjithshme

Kjo pjesë përcakton kërkesat minimale për mbrojtjen e punëmarrësve kundër rreziqeve që shkaktohen ose mund të shkaktohen nga substancat kimike të pranishme në vendin e punës ose si rezultat i çdo aktiviteti pune që sjell praninë e substancave kimike.

Në përputhje me këtë pjesë, fjalët kanë këtë kuptim:

a) substancë kimike: janë elementët kimikë ose komponimet e tyre, në gjendje natyrore ose të fituar nga një proces prodhimi, përfshirë shtesat dhe solventet kryesore, si dhe ndonjë papastërti me origjinë natyrore ose të marrë në procesin e prodhimit, me përjashtim të solventëve që mund të veçohen nga substanca pa ndryshuar përbërjen e saj.

b) substanca kimike të rrezikshme:

1) substanca kimike të klasifikuar si të rrezikshme.

Përfshihen substancat e rrezikshme vetëm për ambientin;

2) substanca kimike të klasifikuar si preparate të rrezikshme.

Përfshihen preparatet e rrezikshme vetëm për ambientin;

3) Substanca kimike, të cilat dhe pse nuk janë të klasifikuara si të rrezikshme, në bazë të pikave 1) dhe 2) mund të sjellin rrezik për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve për shkak të karakteristikave kimike, kimiko-fizike ose toksikologjike dhe të mënyrës se si përdoren ose janë të pranishme në vendin e punës, përfshirë substancat kimike për të cilët është përcaktuar një vlerë e kufizuar e ekspozimit;

c) aktivitete që sjellin praninë e substancave kimike: çdo aktivitet pune në të cilin përdoren substancat kimike ose parashikohet përdorimi, ose çdo lloj aktiviteti që përfshin prodhimin, magazinimin, transportin ose eliminimin dhe përpunimin e mbetjeve që rezultojnë nga këto aktivitete;

d) vlerë e kufizuar e ekspozimit profesional: nëse nuk është specifikuar ndryshe, kufiri i koncentrimit mesatar të ponderuar në kohë i një substance kimike në ajër, në zonën e frymëmarrjes së një punëmarrësi, referuar një periudhe të caktuar.

e) vlera e kufizuar biologjike: kufiri i koncentrimin të substancës përkatëse, të vlerave të saj metabolike, ose të një treguesi të efektit ose mënyrës biologjike përkatëse;

f) kontroll shëndetësor: vlerësimi i gjendjes së shëndetit të çdo punëmarrësi në funksion të ekspozimit ndaj substancave kimike në vendin e punës;

g) rrezik: karakteristika tipike e një substance kimike për të prodhuar efektet e dëmshme.

h) rrezik i mundshëm: mundësia e krijimit të një potenciali të dëmshëm në kushte të përdorimit ose ekspozimit.

#### 3.2 Vlerësimi i rrezikut të mundshëm

Në vlerësimin e rrezikut të mundshëm, punëdhënësi përcakton paraprakisht praninë e mundshme të substancave kimike të rrezikshme, në vendin e punës dhe vlerëson rrezikun e mundshëm për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve të shkaktuar nga prania e këtyre substancave, duke marrë në konsideratë veçanërisht:

a) karakteristikat e rrezikshme;

b) informacionet mbi shëndetin dhe sigurinë të komunikuar nga prodhuesi ose furnizuesi nëpërmjet skedës së sigurisë;

c) nivelin, tipin dhe kohëzgjatjen e ekspozimit;

d) kushtet në të cilat kryhet puna në praninë e këtyre substancave, përfshirë sasinë e tyre;

e) vlerat e lejuara të ekspozimit profesional ose të vlerave të kufizuara biologjike;

f) efektet e masave parandaluese dhe mbrojtëse të marra ose që do të merren;

g) konkluzionet e arritura nga kryerja kontrollit shëndetësor të bëra. nëse ka të tilla.

Në vlerësimin e rrezikut të mundshëm punëdhënësi tregon cilat masa janë ndërmarrë.

Në rastin e aktiviteteve të punës që sjellin ekspozimin ndaj shumë substancave kimike të rrezikshme, rreziqet e mundshme vlerësohen mbi bazën e rrezikut që sjell kombinimi i të gjithë substancave kimike të mësipërm.

Furnizuesi ose prodhuesi i substancave kimike duhet të vërë në dispozicion të punëdhënësit blerës, të gjitha informacionet e nevojshme për vlerësimin e plotë të rreziqeve të mundshme.

Në rastin e një aktiviteti të ri që sjell praninë e substancave kimike të rrezikshme, vlerësimi i rrezikut të mundshëm nga këto substanca dhe zbatimi i masave të parandalimit programohen paraprakisht. Aktiviteti i ri fillon vetëm pasi ka përfunduar vlerësimi i rreziqeve të mundshme dhe zbatimi i masave të parandalimit.

Punëdhënësi përditëson periodikisht vlerësimin në rast ndryshimesh të rëndësishme që mund të kenë përfunduar ose kur rezultatet e kontrollit shëndetësor e kërkojnë nevojën për këtë.

### 3.3 Masat dhe kërkesat kryesore për parandalimin e rreziqeve të mundshme

Duhet të eliminohen rreziqet e mundshme të shkaktuara nga substancat kimike të rrezikshme ose të zvogëlohen në minimum nëpërmjet masave të mëposhtme:

a) projektimi dhe organizimi i sistemeve të punimeve në vendin e punës;  
b) furnizimi me mjetet e përshtatshme për punët specifike dhe procedurat përkatëse të mirëmbajtjes;

c) zvogëlimi në minimum i numrit të punëmarrësve që janë ose mund të jenë të ekspozuar;

d) zvogëlimi në minimum i kohëzgjatjes dhe i intensitetit të ekspozimit;

e) masat higjienike të duhura;

f) zvogëlimi në minimum i sasisë së substancave të pranishëm në vendin e punës sipas nevojës së punës;

g) metodat e punës të përshtatshme, përfshirë dispozitat që garantojnë sigurinë në përpunimin, magazinimin dhe transportin në vendin e punës të substancave kimike të rrezikshme si dhe të mbetjeve që përmbajnë këto substanca kimike.

2. Nëse rezultatet e vlerësimit të rrezikut tregojnë se, në raport me tipin dhe sasinë e substancës kimike, mënyrën dhe frekuencën e ekspozimit ndaj kësaj substance të pranishme në vendin e punës, ekziston vetëm një rrezik i kufizuar për shëndetin dhe sigurinë e punëmarrësve dhe se masat e mëparshme janë të mjaftueshme për të zvogëluar rrezikun e mundshëm, nuk aplikohen kërkesat e pikave të mëposhtme.

### 3.4 Masat specifike të mbrojtjes dhe parandalimit

Punëdhënësi, mbi bazën e aktiviteteve dhe vlerësimit të rrezikut të mundshëm, parashikon që rreziku i mundshëm të eliminohet ose zvogëlohet nëpërmjet zëvendësimit me substanca të tjera ose procese, të cilat në kushtet e përdorimit nuk janë ose janë më pak të rrezikshëm për shëndetin e punëmarrësve, kjo bëhet kur natyra e aktivitetit e lejon. Kur natyra e aktivitetit nuk e lejon eliminimin e rrezikut të mundshëm nëpërmjet zëvendësimit, punëdhënësi garanton që rreziku i mundshëm të zvogëlohet nëpërmjet aplikimit të masave të mëposhtme të listuara sipas radhës së prioritetit:

a) projektimin e proceseve të duhura të punës dhe kontrolle teknike, si dhe përdorimin e mjeteve dhe materialeve të përshtatshme;

b) mjetet e duhura organizative dhe të mbrojtjes kolektive në burimin e rrezikut të mundshëm;

c) pajisjet mbrojtëse personale, përfshirë dispozitat e mbrojtjes individuale, kur ekspozimi nuk mund të parandalohet me mjete të tjera;

d) kontrolli shëndetësor i punëmarrësve.

Me përjashtim të rasteve kur nuk mund të tregohet me mjete të tjera, arritja e një niveli mbrojtjeje dhe parandalimi, punëdhënësi, periodikisht dhe sa herë që kushtet ndikuese të ekspozimit ndryshojnë, parashikon matjen e substancave që mund të paraqesin rrezik për shëndetin me metoda të standardizuara, ose në mungesë të tyre, me metoda të përshtatshme ose duke ju referuar në mënyrë të veçantë vlerave kufizuese të ekspozimit profesional dhe për periudhat përfaqësuese të ekspozimit në kohë dhe hapësirë.

Nëse është kaluar vlera e lejuar e ekspozimit profesional të vendosur në rregullat në fuqi, punëdhënësi identifikon dhe eliminon shkaqet e ngjarjes duke përshtatur menjëherë masat e duhura të mbrojtjes dhe parandalimit.

Rezultatet e matjeve u bashkëngjiten dokumenteve të vlerësimit të rreziqeve të mundshme (risqeve) dhe u bëhen të ditura përfaqësuesve të punëmarrësve për sigurinë. Punëdhënësi mban



parasysh matjet e bëra. Mbi bazën e vlerësimit të rreziqeve të mundshme dhe të parimeve të përgjithshme për parandalimin dhe mbrojtjen, punëdhënësi merr masat teknike dhe organizative të përshtatshme me natyrën e veprimeve, përfshirë magazinimin, përpunimin dhe izolimin e substancave kimike të papajtueshme midis tyre; në mënyrë të veçantë, punëdhënësi eviton praninë e koncentrimëve të rrezikshme të substancave të djegshme ose sasi të rrezikshme të substancave kimikisht jo të qëndrueshme.

Aty ku natyra e aktivitetit të punës nuk mundëson parandalimin në vendin e punës të pranishëm së koncentrimëve të rrezikshme të substancave të djegshme ose sasi të rrezikshme të substancave kimikisht jo të qëndrueshme, punëdhënësi, në mënyrë të veçantë duhet:

a) të evitohet praninë e burimeve të ndezjes që mund të shkaktojnë zjarre dhe eksplozione, ose ekzistencën e kushteve jo të favorshme që mund të provokojnë efekte fizike të dëmshme për shkak të substancave ose përzierjeve të substancave kimike jo të qëndrueshme;

b) të zvogëlojë, nëpërmjet masave procedurale dhe organizative të parashikuara nga aktet në fuqi, efektet e rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë e punëmarrësve në rast zjarresh ose eksplozionesh të shkaktuar nga substanca ose përzierje të substancave kimikisht jo të qëndrueshme;

6. Punëdhënësi vë në dispozicion pajisjet e punës dhe zbaton sisteme të mbrojtjes kolektive dhe individuale në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulloret, veçanërisht për sa i përket përdorimit të mjeteve të mësipërme me fuqi eksplozive në atmosferë.

7. Punëdhënësi merr masat për të siguruar një kontroll të mjaftueshëm të impianteve, aparateve dhe makinerive, duke vënë në dispozicion sisteme dhe mekanizma për zvogëlimin e mundësive të rrezikut për ekspozim ose mekanizma për të zvogëluar presionin e ekspozimit.

8. Punëdhënësi informon punëmarrësit për kalimin e vlerave të lejuara të ekspozimit profesional, për shkakun e ngjarjes dhe për masat e mbrojtjes dhe parandalimit të marra dhe ja komunikon këto organeve të ruajtjes.

### 3.5 Dispozitat në rast zjarri ose emergjence

Punëdhënësi, për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punëmarrësve nga pasojat e aksidenteve ose të emergjencave të shkaktuara nga prania e substancave kimike të rrezikshme në vendin e punës, vendos procedura të përshtatshme ndërhyrjeje për t'u zbatuar në këto raste. Këto masa përfshijnë ushtrime praktike për sigurinë që duhet të kryhen me intervale të rregullta dhe vënien në dispozicion të mjeteve të përshtatshme për ndihmën e shpejtë.

Në rast zjarri ose emergjencë, punëdhënësi merr menjëherë masa të drejtpërdrejta për të zvogëluar efektet dhe në mënyrë të veçantë asistencën për largimin, evakuimin dhe informimin e punëmarrësve. Punëdhënësi merr masa të përshtatshme për të normalizuar situatën sa më parë.

Punëmarrësve që u lejohet të punojnë në zonën e prekur ose punëmarrësit e domosdoshëm për kryerjen e riparimeve dhe aktiviteteve të nevojshme u jepen veshje mbrojtëse, mjete të mbrojtjes individuale dhe mjete të përshtatshme për ndërhyrjen që përdoren deri sa vazhdon situata anormale.

Punëdhënësi përshtat masat e nevojshme për të përgatitur sistemin e alarmit dhe sisteme të tjera komunikimi të nevojshme për të sinjalizuar menjëherë aksidentin ose emergjencën.

Masat e emergjencës, të përfshira në plan duhet të përmbajnë:

a) informacione paraprake mbi aktivitetet e rrezikshme, mbi substancat kimike të rrezikshme, mbi masat e identifikimit të rrezikut të mundshme, mbi masat parandaluese dhe procedurat, në mënyrë të tillë që zyrtarët kompetentë për situatat e emergjencës të mund të përcaktojnë menjëherë procedurat përkatëse dhe masat parandaluese ;

b) çdo lloj tjetër informacioni mbi rreziqet e mundshme të shkaktuara ose që mund të shkaktohen nga aksidente ose situata emergjente, përfshirë informacionet mbi procedurat e ndjekura në bazë të këtij neni.

Në rast zjarri ose emergjence, subjektet e pambrojtura duhet të largohen nga zona menjëherë.

### 3.6 Informimi dhe formimi i punëmarrësve

Punëdhënësi garanton që punëmarrësit ose përfaqësuesit e tyre të kenë në dispozicion:

a) të dhënat e vlerësimit të rrezikut të mundshëm dhe informacione të tjera sa herë që ndryshime të rëndësishme në vendin e punës shoqërohen me ndryshimin e këtyre të dhënave;

b) informacione mbi substancat kimike të rrezikshme të pranishëm në vendin e punës, ndër të cilët natyrën e substancës, rreziqet e mundshme për sigurinë dhe shëndetin, vlerat e lejuara përkatëse të ekspozimit profesional dhe dispozita të tjera normative që i përkasin substancave kimike;

c) formimin dhe informacione mbi masat parandaluese dhe veprimet e përshtatshme që duhen zbatuar për mbrojtjen e tyre dhe të punëmarrësve të tjerë në vendin e punës;

d) konsultimin e çdo skede me të dhënat e sigurisë të vënë në dispozicion nga furnizuesit.

Punëdhënësi siguron që informacionet:

a) të jenë në përputhje me rezultatet e vlerësimit të rrezikut të mundshëm. Këto informacione mund të përbëhen nga informacione gojore ose nga kurse formimi dhe praktika individuale të integruara me informacione të shkruara, sipas natyrës dhe nivelit të rrezikut të mundshëm të përcaktuar gjatë vlerësimit;

b) të jenë të përditësuara me ndryshimet e kushteve.

Aty ku depozitat dhe tubacionet për substancat kimike të rrezikshme të përdorura gjatë punës nuk evidentohen me sinjalet e sigurisë, punëdhënësi siguron që natyra e përmbajtjes së kontenitorëve dhe tubacioneve dhe rreziqet e mundshme përkatëse të jenë qartësisht të identifikuar.

Prodhuesi dhe furnitori i transmetojnë punëdhënësit të gjitha informacionet në lidhje me substancat kimike të rrezikshme të prodhuara ose të furnizuara.

### 3.7 Kontrolli shëndetësor.

Kontrolli shëndetësor kryhet:

a) para se të punësohet punëmarrësi për detyrën që ka ekspozim;

b) periodikisht, një herë në vit dhe me interval të përcaktuar nga mjeku kompetent me motivacionin e duhur në dokumentin e duhur të vlerësimit të rrezikut të mundshëm e që u komunikohet përfaqësuesve të punëmarrësve në funksion me vlerësimin e rreziqeve të mundshme dhe të rezultateve të kontrollit shëndetësor;

c) në momentin e mbylljes së raportit të punës; në këtë rast mjeku kompetent vë në dispozicion të punëmarrësit treguesit e ndryshëm në lidhje me kontrollet mjekësore që duhen ndjekur.

Monitorimi biologjik është i detyrueshëm për punëmarrësit e ekspozuar ndaj substancave për të cilët është fiksuar një vlerë e lejuar biologjike. Rezultatet e këtij monitorimi i informohen punëmarrësit të interesuar. Në formë anonime, këto rezultate i bashkëlidhen dokumentit të vlerësimit të rreziqeve të mundshme dhe i komunikohen përfaqësuesve për sigurinë të punëmarrësve.

Kontrollet shëndetësore duhet të vërtetojnë rrezikun e ulët për punëmarrësin.

Punëdhënësi, në përputhje me mendimin e mjekut kompetent merr masa parandaluese dhe mbrojtëse të veçanta për çdo punëmarrës mbi bazën e rezultateve të analizave klinike dhe biologjike të kryera.

Në rastin kur, në momentin e kontrollit shëndetësor, përcaktohet në një punëmarrës ose një grup punëmarrësish të ekspozuar në mënyrë të ngjashme ndaj të njëjtit agjent, ekzistenca e efekteve të dëmshme për shëndetin, të shkaktuara nga ky ekspozim ose kalimi i një vlere të lejuar biologjike, mjeku kompetent informon individualisht punëmarrësin e interesuar ose punëdhënësin.

Organi i ruajtjes, me vendim të motivuar, mund të përcaktojë periudha të ndryshme të kontrollit shëndetësor periodik, të ndryshme nga ato të përcaktuara nga mjeku kompetent.

**LIGJ**  
**Nr.8937, datë 12.9.2002**

**PËR RUAJTJEN E NXEHTËSISË NË NDËRTESTA**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të krijojë bazën ligjore të nevojshme për vendosjen e rregullave dhe bërjen të detyrueshme të marrjes së masave për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa.

Neni 2

Për qëllimet e këtij ligji, termat e përdorura kanë këto kuptime:

“Ndërtesë” do të thotë një ngrehinë, një bashkësi lokalesh, mjedis banimi, shërbimi e prodhimi me karakter publik ose privat.

“Instalim termik” do të thotë bashkësi pajisjesh termike së bashku me rrjetin lidhës, që shërbejnë për ngrohjen dhe ftohjen e mjedisit të brendshëm të ndërtesave.

“Ngrohje qendrore” do të thotë një impiant ngrohjeje, që furnizon me energji termike një ose më shumë apartamente.

“Ngrohje lokale” do të thotë një impiant ngrohjeje, që furnizon me energji termike një grup ndërtesash të ndara nga njëra-tjetra.

Neni 3

Projektimi dhe ndërtimi i ndërtesave të realizojë parametrat teknikë të nevojshëm për ruajtjen, kursimin dhe përdorimin me efikasitet të energjisë. Të gjitha ndërtesat që do të ndërtohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të respektojnë koeficientin vëllimor e normativ të humbjeve termike (Gv), si dhe të parashikojnë vendosjen e instalimit termik të ngrohjes qendrore ose vendore.

Neni 4

Instalimet e prodhimit të nxehtësisë (gjeneratorët e nxehtësisë ose/dhe pompat e nxehtësisë) për ngrohjen dhe/ose freskimin e ndërtesave projektohen për arritjen e temperaturës së ajrit të brendshëm, sipas normave të komfortit të temperaturës, duke marrë parasysh kushtet klimatike zonale dhe anën funksionale të ndërtesës.

Neni 5

Këshilli i Ministrave përcakton normat, rregullat dhe kushtet e projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3484, datë 7.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.61, faqe 1705*

**VENDIM**  
**Nr.38, datë 16.1.2003**

**PËR MIRATIMIN E NORMAVE, TË RREGULLAVE DHE KUSHTEVE TË PROJEKTIMIT  
DHE TË NDËRTIMIT, TË PRODHIMIT DHE RUAJTJES SË NXEHTËSISË NË  
NDËRTESEA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.8937, datë 12.9.2002 "Për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e normave, të rregullave dhe kushteve të projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Personat, fizikë ose juridikë, që hartojnë projekte për ndërtimin e objekteve, publike dhe private, të zbatojnë normat, rregullat dhe kushtet e projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa, të miratuara sipas këtij vendimi.
3. KRRT-të e bashkive dhe të qarqeve të miratojnë lejet e ndërtimit, vetëm pasi të jenë plotësuar normat, rregullat dhe kushtet e projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa, të përcaktuara në këtë vendim.
4. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.2, faqe 19*

**NORMAT, RREGULLAT DHE KUSHTET TË PROJEKTIMIT DHE TË NDËRTIMIT, TË  
PRODHIMIT DHE RUAJTJES SË NXEHTËSISË NË NDËRTESEA**

**1. Të përgjithshme**

Në zbatim të ligjit nr.8937, datë 12.9.2002 "Për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa", nenit 5 janë hartuar "Normat, rregullat dhe kushtet e projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa".

Ky material shërben për llogaritjen e kërkesave për nxehtësi për ngrohjen e lokaleve të banimit, social-kulturore dhe ato private.

**2. Përcaktime**

**2.1 Lokali**

Me termin "*lokal*" kuptohet një hapësirë me volum të përcaktuar, e ndarë plotësisht nga mjedisi i jashtëm ose nga ambiente të tjerë fqinjë, nëpërmjet pareteve/mureve.

**2.2 Pareti/muri**

Me termin "*paret/mur*" do të kuptohet një element ndarës i cili ndan ambientin/lokalin nga mjedisi i jashtëm ose nga një ambient/lokal tjetër pranë tij. Vetë paret ka një trashësi të përcaktuar dhe kufizohet nga dy faqe paralele me sipërfaqe të përcaktuara, njëra nga të cilat, e brendshmeja, shikon nga ambienti/lokali në konsideratë dhe tjetra, e jashtmeja, shikon nga mjedisi i jashtëm ose nga ambienti/lokali fqinjë.

### 2.3 Mjedisi

Me termin "*mjedisi*" kuptohet hapësira e kufizuar brenda pareteve të marrë në shqyrtim. Ndërsa mjedisi i jashtëm është vetëm një volum i papërcaktuar, mjedisi i brendshëm është i kufizuar nga sipërfaqet e pareteve që e përbëjnë atë.

### 2.4 Gradient termik

"*Gradienti termik*" është raporti i shprehur me diferencën e temperaturave, në °C, midis dy pikave/respektivisht dy niveleve, me largësinë/respektivisht diferencën e largësive, të shprehur në metër, midis këtyre dy pikave/respektivisht dy niveleve.

### 2.5 Zonë neutrale në një lokal

Me termin "*zonë neutrale në një lokal*", ku ekziston një temperaturë e ndryshme nga temperatura e ambientit të jashtëm, kuptohet shtresa e ajrit në nivelin e të cilës presioni i brendshëm dhe i jashtëm i ajrit, që rezultojnë nga temperaturat përkatëse të tij, barazohen.

## 3. Madhësitë e përdorura, simboli dhe njësia e matjes

Nr.	Madhësia	Simboli	Përcaktimi	Njësia e matjes SI
3.1	Trashësia e murit	$\delta$		m
3.2	Sipërfaqja e murit	F	Sipërfaqja e murit që konsiderohet gjatë procesit të transmetimit të nxehtësisë	m <sup>2</sup>
3.3	Fluksi i nxehtësisë	Q	Sasia e nxehtësisë që kalon në njësi të kohës	Ëatt
3.4	Temperatura e ajrit të brendshëm në lokal	$t_b$	Temperatura e ajrit të brendshëm që përdoret për llogaritjen e ngarkesës termike në lokal. Si rregull duhet matur me anë të termometrit të thatë, të mbrojtur nga efekti i rrezatimit, në qendër të lokalit, 1,5 m lart nga dyshemeja	°C
3.5	Temperatura e ajrit të jashtëm	$t_j$	Temperatura e ajrit të jashtëm që përdoret për llogaritjen e ngarkesës termike në lokal. Si rregull duhet matur me anë të termometrit të thatë, të mbrojtur nga efekti i rrezatimit, të vendosur në sipërfaqen e çdo paretit të lokalit në kontakt me ajrin e jashtëm.	°C
3.6	Temperatura e ajrit të lokalit fqinjë.	$t_j$	Temperatura e ajrit të brendshëm të lokalit fqinjë me lokalin në konsideratë. Matja e saj bëhet si në 3.4	°C
3.7	Temperatura e sipërfaqes së brendshme të paretit	$t_{pb}$	Temperatura mesatare e ponderuar e sipërfaqes së paretit që shikon nga lokali në shqyrtim	°C
3.8	Temperatura e sipërfaqes së jashtme të paretit	$t_{pj}$	Temperatura mesatare e ponderuar e sipërfaqes së paretit që shikon nga jashtë ose lokali fqinjë me lokalin në shqyrtim	°C
3.9	Temperatura e sipërfaqeve të shtresave përbërëse të një paretit shumështrësor	$t_1, \dots, t_2$	Temperatura mesatare e ponderuar e sipërfaqes që ndan një shtresë nga shtresa tjetër në paretet shumështrësor (numërimi nga jashtë brenda)	°C
3.10	Temperatura radiante e ambientit të jashtëm referuar një sipërfaqeje F	$t_{rj}$	Temperatura uniforme fiktive e sipërfaqeve të brendshme të një ambienti, të pranuar me koeficient emesiviteti të barabartë me trupin absolutisht të zi, nëpërmjet të cilave transmetohet me rrezatim e njëjta sasi nxehtësie si në rastin e ambientit real .	°C
3.11	Temperatura radiante e ambientit të brendshëm referuar një sipërfaqeje F	$t_{rb}$	Temperatura uniforme fiktive e një sipërfaqeje, të pranuar me koeficient emesivitetit të barabartë me trupin absolutisht të zi, e cila duke rrethuar plotësisht sipërfaqen F transmeton me rrezatim të njëjtën sasi nxehtësie si në rastin e ambientit real	°C
3.12	Temperatura operante		Mesatare e temperaturës së ajrit $t_b$ dhe e temperaturës mesatare rrezatuese e cila llogaritet si temperatura mesatare e ponderuar e të gjithë sipërfaqeve të lokalit $t_{mp}$	°C
3.13	Diferenca e temperaturave	$\Delta t$		°C
3.14	Percjellshmëri termike (ose koeficienti i percjellshmërisë termike) e	$\lambda$	Fluksi i nxehtësisë që transmetohet me percjellshmëri në regjim stacionar nëpër një paret homogjen me trashësi 1 m dhe sipërfaqe 1 m <sup>2</sup> kur diferenca e temperaturave	Ë/m°C

<i>Nr.</i>	<i>Madhësia</i>	<i>Simboli</i>	<i>Përcaktimi</i>	<i>Njësia e matjes SI</i>
	një materiali homogjen		midis dy faqeve paralele të tij është 1 °C.	
3.15	Përcjellshmëri termike specifike	$\lambda/\delta$	Fluksi i nxehtësisë që transmetohet me përcjellshmëri në regjim stacionar në një paret homogjen me sipërfaqe 1 m <sup>2</sup> kur diferenca e temperaturave midis dy faqeve të tij është 1°C	Ë/m <sup>2</sup> °C
3.16	Rezistencë termike specifike me përcjellshmëri	$\delta/\lambda$	Inversi i Përcjellshmerise termike specifike	m <sup>2</sup> °C / Ë
3.17	Koeficienti i konveksionit	$\alpha$ $\alpha_j$ $\alpha_b$	Fluksi i nxehtësisë që transmetohet në regjim stacionar me konveksion dhe/ose me rrezatim, nga një paret, me sipërfaqe 1 m <sup>2</sup> , në mjedisin rrethues ose anasjelltas kur diferenca e temperaturave të sipërfaqes së paretit dhe temperaturës së ajrit që pranohet e barabartë me temperaturën mesatare radiante të ambientit është 1 °C Koeficienti i konveksionit nga sipërfaqja e paretit ne ambientin e jashtëm Koeficienti i konveksionit nga ambienti i brendshem ne sipërfaqen e paretit.	Ë/m <sup>2</sup> °C
3.18	Rezistencë termike specifike me konveksion	1/ $\alpha$	Inversi i Koeficientit të konveksionit	m <sup>2</sup> °C / Ë
3.19	Koeficient i përgjithshëm i transmetimit të nxehtësisë	k	Fluksi i nxehtësisë që transmetohet nga një fluid nxehtësidhënës në një fluid nxehtësimarrës të ndarë midis tyre me një paret me sipërfaqe 1 m <sup>2</sup> kur diferenca e temperaturave është 1°C. Në veçanti është Fluksi i nxehtësisë që transmetohet nga mjedisi i jashtëm (ose nga një lokal fqinj) në mjedisin e brendshëm nëpërmjet një paretit me sipërfaqe 1 m <sup>2</sup> kur diferenca e temperaturave ndërmjet lokalit dhe mjedisit të jashtëm (lokalit fqinje) është 1°C.	Ë/m <sup>2</sup> °C
3.20	Rezistencë termike e përgjithshme paretit	1/k	Është inversi i Koeficientit të përgjithshëm të transmetimit të nxehtësisë dhe paraqitet si shumë e rezistencave termike me përcjellshmëri të çdo shtrese përbërëse të paretit si dhe i rezistencave termike me konveksion dhe ose/rrezatim të ajrit të jashtëm dhe të brendshëm	m <sup>2</sup> °C / Ë
3.21	Volum i një lokali	V		m <sup>3</sup>
3.22	Rinovim ajri	q <sub>v</sub>	Prurja e ajrit që futet në një lokal në mënyrë natyrale ose të detyruar për të zëvendësuar ajrin e brendshëm që largohet nga lokali	m <sup>3</sup> /orë
3.23	Humbjet e nxehtësisë me transmetim	Q <sub>0</sub>	Fluksi i nxehtësisë që transmetohet me përcjellshmëri, konveksion dhe rrezatim nga lokali nëpërmjet pareteve në mjedisin e jashtëm.	Ë
3.24	Humbjet e nxehtësisë me ventilim	Q <sub>v</sub>	Fluksi i nxehtësisë që transmetohet me ajrin ventilues dhe infiltrues	Ë
3.25	Nxehtësia specifike	c	Përfaqëson sasinë e nxehtësisë se nevojshme për te rritur temperaturën e 1kg të lëndës me 1°C.	J/kg°C

#### 4. Llogaritja e humbjeve të nxehtësisë nga paretet

##### 4.1 Formula e përgjithshme

Për llogaritjen e humbjeve të nxehtësisë me transmetim në një lokal përdoret formula:

$$Q_0 = Fk(t_b - t_j) \quad (1)$$

e cila duhet të zbatohet për çdo paret përbërës të lokalit që lidh atë me ambientin e jashtëm dhe/ose me ambiente të tjerë fqinjë me temperaturë të ndryshme me lokalin në shqyrtim.

Nqs. një paret është i përberë nga elemente të ndryshëm (psh. pjesë opake/murature dhe pjesë transparente/vetrate, pjesë muri me karakteristika të ndryshme termofizike) formula duhet të zbatohet për çdo element në veçanti, me kufizimet që do të parashtrihen në vijim.

##### 4.2 Kufizime të zbatueshmërisë

Rezultati i formulës (1) është i pranueshëm në rastet kur:

- 4.2.1. Transmetimi i nxehtësisë është në regjim stacionar ç'ka do të thotë se shprehja (1) nuk aplikohet në rastet e punës me ndërprerje të impiantit dhe/ose të reduktimit të ngarkesës në periudhën e natës përveçse kur bëhen korrigjimet e rekomanduara.
- 4.2.2. Temperatura e ajrit të brendshëm dhe temperatura mesatare radiante e ambientit të lokalit nuk ndryshojnë shumë me njëra tjetrën. Kjo do të thotë që për rastet e aplikimit të impianteve me rrezatim duhet të bëhen korrigjimet e rekomanduara.
- 4.2.3. Temperatura e ajrit të jashtëm dhe temperatura mesatare radiante e mjedisit të jashtëm nuk ndryshojnë shumë me njëra tjetrën. Kjo do të thotë që për rastet e pareteve të ekspozuara ndaj rrezatimit diellor duhet të bëhen korrigjimet e rekomanduara.

#### 4.3. Koeficienti i humbjeve volumore me transmetim

Koeficienti i humbjeve volumore me transmetim “ $G_{vt}$ ” përfaqëson energjinë termike të humbur me transmetim referuar njësisë së volumit të ambjentit të ngrohur dhe diferencës  $1^{\circ}\text{C}$  të temperaturës së brendshme dhe temperaturës së jashtme.

Koeficienti i humbjeve volumore me transmetim “ $G_{vt}$ ” përcaktohet me formulën:

$$G_{vt} = \frac{Q_0}{V\Delta t} \quad (2)$$

ku:  $V$  - volumi i ngrohur i ndërtesës i shprehur në  $\text{m}^3$

$\Delta t$  - është e barabartë me  $(t_b - t_j)$  ku  $t_b$  është temperatura e ajrit të brendshëm të përcaktuar në pikën 6 dhe  $t_j$  është temperatura llogaritëse e ajrit të jashtëm e cila përcaktohet në pikën 5.

Humbjet e nxehtësisë me transmetim  $Q_0$  duhet të llogariten pa marrë parasysh shtesat e parashikuara në pikën 10 për punë me ndërprerje të impiantit.

#### 4.3 Koeficienti normativ i humbjeve volumore me transmetim

##### 4.4.1 Koeficienti normativ i humbjeve volumore me transmetim të ndërtesës

Vlerat e koeficientit të humbjeve volumore me transmetim në ndërtesa “ $G_{vt,0}$ ” nuk duhet të kalojnë vlerat normative “ $G_{vt,0}$ ” të cilat rekomandohen në funksion të zonës klimatike dhe të karakteristikave të ndërtesës, pra:

$$G_{vt} \leq G_{vt,0} \quad (3)$$

Për rastin e territorit të Republikës së Shqipërisë vlerat e rekomanduara të koeficientit normativ të humbjeve volumore me transmetim “ $G_{vt,0}$ ” janë si vijon:

**Tabela 1**

Vlerat e koeficientit normativ të humbjeve volumore me transmetim për ndërtesën “ $G_{vt,0}$ ” në  $\text{E}/\text{m}^3\text{C}$

S/V	Zonat sipas gradë-ditëve					
	A		B		C	
	gradë 900 ÷	ditët 1500	gradë 1501 ÷	ditët 2500	gradë 2501 ÷	ditët 3000
$\leq 0.3$	0.62	0.54	0.54	0.45	0.45	0.41
$\geq 0.9$	1.20	1.03	1.03	0.86	0.86	0.81

Për vlera të ndërmjetme të raportit S/V, ku S është sipërfaqje e ndërtesës nga e cila transmetohet nxehtësia dhe V volumi i hapësirës së ngrohur, përcaktimi i koeficientit normativ të humbjeve volumore me transmetim “ $G_{vt,0}$ ” përcaktohet me interpolim.

##### 4.4.2 Koeficienti normativ i humbjeve volumore me transmetim të ambienteve të veçantë

Vlerat e koeficientit të humbjeve volumore me transmetim për ambiente të veçantë “ $G_{vt,t}$ ” nuk duhet të kalojnë vlerat normative “ $G_{vt,t,0}$ ” të cilat rekomandohen në funksion të zonës klimatike dhe të karakteristikave të ambientit, pra:

$$G_{vt,t} \leq G_{vt,t,0} \quad (4)$$

Për rastin e territorit të Republikës së Shqipërisë vlerat e rekomanduara të koeficientit normativ të humbjeve volumore me transmetim për ambiente të veçantë “ $G_{vt,t,0}$ ” janë si vijon:

**Tabela 2**

Vlerat e koeficientit normativ të humbjeve volumore me transmetim për ambientet “G<sub>v,t,0</sub>” në Ë/m<sup>3</sup>°C

S/V	Zona sipas gradë-ditëve					
	A		B		C	
	gradë 900 ÷	ditët 1500	gradë 1501 ÷	ditët 2500	gradë 2501 ÷	ditët 3000
0.4	0.93	0.83	0.83	0.63	0.63	0.59
0.5	1.16	1.03	1.03	0.79	0.79	0.74
0.6	1.40	1.23	1.23	0.95	0.95	0.89
0.7	1.63	1.44	1.44	1.11	1.11	1.05
0.8	1.86	1.65	1.65	1.26	1.26	1.19
0.9	2.09	1.86	1.86	1.68	1.68	1.34
1.0	2.33	2.07	2.07	1.86	1.86	1.49

Për vlera të ndërmjetme të raportit S/V, ku S është sipërfaqje e ambientit nga e cila transmetohet nxehtësia dhe V volumni i hapësirës së ngrohur, gjetja e koeficientit normativ të humbjeve volumore me transmetim për ambiente të veçantë “G<sub>v,t,0</sub>” bëhet me interpolim.

## 5. Temperatura e ambientit të jashtëm

### 5.1 Temperatura e ajrit të jashtëm

#### 5.1.1 Temperatura e përdorur në llogaritje

Temperatura e ajrit të jashtëm që do të përdoret në llogaritjen e kryer me formulën (1) është ajo e treguar në shtojcën A ku paraqitet tabela e vlerave të temperaturës së jashtme për qytetet kryesore të Republikës së Shqipërisë.

Përcaktimi i temperaturës së jashtme llogaritesë është kryer duke patur parasysh:

- të dhënat klimatike shumëvjeçare të periudhës së ftohtë të vitit
- aftësinë akumuluese të ndërtesave
- devijimin e lejueshëm të temperaturës së ambienteve të brendshëm në rastin ekstrem të kushteve klimatike në periudhën e ftohtë të vitit

#### 5.1.2 Korrigjimet

Për lokalitetet që nuk përfshihen në tabelën e pikës 5.1.1. përcaktimi i temperaturës së jashtme bëhet nëpërmjet adoptimit të vlerave të lokaliteteve më të afërta për të cilat njihen këto vlera, duke bërë korrigjimet si vijon:

a) për të marrë parasysh lartësinë e ndryshme nga niveli i detit:

- temperatura nuk ndryshon për ndryshime të kuotës nga niveli i detit deri në 200 m
- rritje (zvogëlim) me 1 °C për çdo 200 m rritje (zvogëlim) të kuotës mbi kuotën 200 m

b) për të marrë parasysh ndryshueshmërinë e ambientit të jashtëm

- temperatura nuk ndryshon, përveç korrigjimeve të lartësisë nga niveli i detit, për komplekset urbane
- zvogëlim me 0.5 ÷ 1 °C për sipërfaqe banimi të vogla
- zvogëlim me 1 ÷ 2 °C për banesa të vetmuara

c) për të marrë parasysh lartësinë e ndërtesave, kufizuar vetëm për pjesën e ndërtesës që ngrihet mbi ndërtesat fqinje

- përveç korrigjimeve të përcaktuara në pikën (b) rekomandohet një zvogëlim 1 ÷ 2 °C

## 5.2 Temperatura në Lokalitet e pangrohur

### 5.2.1 Temperatura llogaritesë

#### 5.2.2.1 Llogaritja e temperaturës në një lokal të pangrohur

N.q.s. shënohen me t', F', k', përkatësisht temperatura e lokalit fqinjë të ngrohur, sipërfaqja e paretëve ndarës midis dy lokaleve të ngrohur dhe të pangrohur dhe koeficienti i përgjithshëm i transmetimit të nxehtësisë të këtyre paretëve dhe t'', F'', k'', të njëjtat madhësi por referuar mjedisit të jashtëm, temperatura e ambientit të pangrohur t''' llogaritet me formulën:



$$t''' = \frac{\sum(F'k't') + \sum(F''k''t'')}{\sum(F'k') + \sum(F''K'')} \quad (5)$$

## 6. Temperatura e ambientit të brendshëm

### 6.1. Temperatura e ajrit të brendshëm të lokalit

#### 6.1.1 Temperatura e përdorur në llogaritje

Temperatura e ambientit të brendshëm të ngrohur që do të përdoret në llogaritje, përveç rasteve të përcaktuara në ligj, nuk duhet të kalojë vlerën 20°C.

Për ndërtesat që shërbejnë si spitale, klinika mjekësore si dhe për ndërtesat ku kryhet aktivitet sportiv si p.sh pishina, sauna dhe ambiente të tjerë të ngjashëm (kategoria e ndërtesave sipas ligjit) pranohen vlera më të larta të temperaturës së ajrit të brendshëm në lokale, zgjedhja e të cilave përcaktohet nga faktorë të karakterit objektiv që paraqiten në relacionin përkatës të llogaritjeve të ngarkesës termike.

Temperatura e ajrit të brendshëm në ambiente të veçantë duhet të matet në pjesën qendrore të tyre, në një lartësi 1.50 m nga dyshemeja dhe në mënyrë të atillë që elementi ndjehës i instrumentit matës të mos influencohet nga çdo efekt radiativ.

Në vijim jepen vlerat e rekomanduara të temperaturës së brendshme për ambientet në funksion të tipit të lokalit dhe aktivitetit të kryer në të.

**Tabela 3.**

Vlerat e rekomanduara të temperaturës së brendshme në lokale

Tipi i ndërtesës ose lokalit	t <sub>b</sub> (°C)
<i>Ndërtesa banimi</i>	
Dhomë ndenjeje	20
Dhomë fjetjeje	16 ... 18
Banjo	20
Guzhinë	18 ... 20
Koridore, ËC	12
Hapësirat e shkallëve	12
Lavanderi	12
<i>Ambiente shkollore</i>	
Klasa mësimi	20
Dhoma e mësuesve	20
Auditore	20
Banjo dhe dushe	20
Koridore, ËC	15
Palestra dhe dushe	16
Shkallët	12
<i>Të tjera</i>	
Sallë teatri, kinema	20
Sallë koncerti	20
Magazina shitjeje	18
Sallë muzeu	18
Garazhde	5

Tipi i ndërtesës ose lokalit	t <sub>b</sub> (°C)
<i>Spitale</i>	
Salla për vizita mjekësore	22-24
Dhoma fjetjeje për të sëmurë	20-22
Salla operacioni	24-30
<i>Lokale</i>	
Restorant	20
Zyra	20
Dyqane të ndryshme	16 ... 20
Salla pritjeje	18 ... 20
Shkallë	12 ... 15
ËC	15 ... 18
<i>Arkiv</i>	
me frekuentim të rrallë	12 ... 15
me personel stabël	18 ... 20

#### 6.1.2 Korrigjimi i temperaturës së brendshme në funksion të gradientit termik

Ndikimi i gradientit termik nuk merret parasysh në lokale me lartësi të shfrytëzueshme deri në 3 m. Në lokalet me lartësi më të madhe:

- humbjet e nxehtësisë nga dysHEMEJA llogariten në funksion të temperaturës së parashikuar në lokal
- humbjet e nxehtësisë nga tavani llogariten në funksion të temperaturës që arrihet në këtë zonë të lokalit në funksion të gradientit termik
- humbjet e nxehtësisë nga muret llogariten në funksion të temperaturës mesatare të dy vlerave të mësipërme

#### 6.1.3 Vlerat e gradientit termik

Vlera e gradientit termik përcaktohet si rritje në përqindje për çdo metër (mbi vlerën 3 m) të vlerës ( $t_b - t_j$ ).

Për impiantet e ngrohjes me radiatorë dhe për një diferencë 40°C të temperaturës mesatare të agjentit ngrohës me temperaturën e ambientit të brendshëm përdoren vlerat e tabelës (4) për gradientin termik.

**Tabela 4.**

Vlerat e rekomanduara të gradientin termik në lokale

Lartësia e lokalit m	Gradienti Termik °C/m
nga 3 ÷ 4	0.06 ( $t_b - t_j$ )
nga 4 ÷ 6	0.05 ( $t_b - t_j$ )
nga 6 ÷ 9	0.04 ( $t_b - t_j$ )
nga 9 ÷ 13	0.03 ( $t_b - t_j$ )
nga 13 ÷ 18	0.02 ( $t_b - t_j$ )
nga 18 ÷ 25	0.01 ( $t_b - t_j$ )
nga 25 ÷ 38	0.005 ( $t_b - t_j$ )

#### 6.1.4 Vlerat e gradientit termik për rastin e impianteve me ajer

Vlera e gradientit termik në këtë rast është më e lartë se ajo e përcaktuar në pikën 6.1.3. dhe duhet përcaktuar nga rekomandimet e literaturës.

#### 6.1.5 Vlerat e gradientit termik për rastin e impianteve me rrezatim

Vlera e gradientit termik në këtë rast është më e vogël se ajo e përcaktuar në pikën 6.1.3. dhe mund të rezultojë edhe negativ për rastin e impianteve me ngrohje nga dysHEMEJA dhe në vlera akoma edhe më të vogla se në pikën 6.1.3. për impiantet e ngrohjes nga tavani.

### 6.2 Temperatura e brendshme në lokalet me sipërfaqe të mëdha të pangrohura

#### 6.2.1. Temperatura operante

Temperatura operante përcaktohet si mesatare e temperaturës së ajrit  $t_b$  dhe e temperaturës mesatare rrezatuese e cila llogaritet si temperatura mesatare e ponderuar e të gjithë sipërfaqeve të lokalit  $t_{mp}$ .

Temperatura operante duhet të qëndrojë e barabartë me temperaturën e parashikuar nga ligji dhe çdo zvogëlim i  $t_{mp}$  duhet të shoqërohet me rritje të temperaturës  $t_b$ .

#### 6.2.2. Koeficienti mesatar i humbjeve në një lokal.

Në qoftë se humbjet termike me transmetim në një lokal me sipërfaqe homogjene totale të mureve  $F_{tot}$  janë  $\sum Q_o$  atëherë koeficienti mesatar i humbjeve përcaktohet si:

$$K_m = \frac{\sum Q_o}{F_{tot} (t_j - t_b)} \quad (6)$$

#### 6.2.3. Korrigjimi i temperaturës së brendshme të një lokali në funksion të Koeficientit mesatar të humbjeve

Temperatura operante e një lokali përcaktohet me formulën:

$$t_{op} = t_b - \frac{K_m}{\alpha_b} (t_j - t_b) \quad (7)$$

Vlera me të cilën duhet të rritet temperatura e brendshme  $t_b$  për të kompensuar zvogëlimin e temperaturës mesatare të ponderuar të sipërfaqeve të lokalit  $t_{mp}$  për të ruajtur konstante temperaturën operante  $t_{op}$  përcaktohet nga shprehja:

$$\frac{(t_b - t_j) \frac{K_m}{2\alpha_b}}{1 - \frac{K_m}{2\alpha_b}} \quad (8)$$


## 7. Koeficientët e përgjithshëm të transmetimit të nxehtësisë

### 7.1 Koeficienti i transmetimit të nxehtësisë me konveksion dhe rrezatim

Për llogaritjen e koeficientit të transmetimit të nxehtësisë me konveksion dhe rrezatim, për sipërfaqet e materialeve kryesore të ndërtimit të cilat kanë një koeficient të emisivitetit  $\approx 0.9$  pranohen vlerat e mëposhtme:

#### 7.1.1. Për sipërfaqet e brendshme të lokaleve (me lëvizje të vogla të ajrit)


**Sipërfaqe vertikale (mure):**



$$\alpha_b = 8.1 \frac{\text{watt}}{\text{m}^2 \cdot \text{K}}$$

$$\frac{1}{\alpha_b} = 0.12 \frac{\text{m}^2 \cdot \text{K}}{\text{watt}}$$


**Sipërfaqe horizontale, rryma e nxehtësisë në ngritje (tavane):**



$$\alpha_b = 9.1 \frac{\text{watt}}{\text{m}^2 \cdot \text{K}}$$

$$\frac{1}{\alpha_b} = 0.11 \frac{\text{m}^2 \cdot \text{K}}{\text{watt}}$$

**Sipërfaqe horizontale, rryma e nxehtësisë në zbritje (dysHEME):**




$$\alpha_b = 5.9 \frac{\text{watt}}{\text{m}^2 \cdot \text{K}}$$

$$\frac{1}{\alpha_b} = 0.17 \frac{\text{m}^2 \cdot \text{K}}{\text{watt}}$$

#### 7.1.2. Për sipërfaqet e jashtme të lokaleve (shpejtësia e erës deri në 4 m/s)


**Sipërfaqe vertikale dhe horizontale (rryma e nxehtësisë në ngritje):**



$$\alpha_j = 23 \frac{\text{watt}}{\text{m}^2 \cdot \text{K}}$$

$$\frac{1}{\alpha_j} = 0.043 \frac{\text{m}^2 \cdot \text{K}}{\text{watt}}$$

**Sipërfaqe horizontale (rryma e nxehtësisë në zbritje):**



$$\alpha_j = 16.4 \frac{\text{watt}}{\text{m}^2 \cdot \text{K}}$$

$$\frac{1}{\alpha_j} = 0.061 \frac{\text{m}^2 \cdot \text{K}}{\text{watt}}$$

Në rastet kur shpejtësia e erës, gjatë sezonit të ngrohjes, e kalon vlerën 4 m/s përdoren shprehjet empirike si vijon:

➤ Sipërfaqe vertikale dhe horizontale (rryma e nxehtësisë në ngritje):  $\alpha_j = 2.3 + 10.5\sqrt{v}$

➤ Sipërfaqe horizontale (rryma e nxehtësisë në zbritje):  $\alpha_j = 0.7(2.3 + 10.5\sqrt{v})$

## 7.2 Rezistenca termike e paretit homogjen ose shtresës homogjene të paretit

Rezistenca termike e paretit homogjen ose shtresës homogjene të paretit jepet nga shprehja

$$\frac{\delta}{\lambda}$$

Vlerat e koeficientit të përcjellshmërisë termike të materialeve kryesore homogjene që përdoren në praktikën ndërtimore, referuar temperaturave të punës të materialeve të ndërtimit jepen në shtojcën B

Materialet e referuar, konsiderohen në gjëndje normale të punës së tyre në strukturat ndërtimore (përqindja e lagështisë në kufij normale)

## 7.3 Vlerat e rezistencës termike të hapësirave të ndërmjetme të ajrit

Në rastet e hapësirave të ndërmjetme të ajrit, kur pranohet që emesiviteti i sipërfaqeve të hapësirës është i njëjtë me atë të materialeve kryesore të ndërtimit dhe e barabartë me 0.9, kur temperatura e ajrit është ndërmjet vlerave të temperaturës së brendshme dhe të jashtme, kur trashësia e hapësirës është më e madhe se 1 cm, pranohen vlerat e mëposhtme të rezistencës termike:

**Tabela.5**

Vlerat e rezistencës termike të hapësirave të ndërmjetme të ajrit

Hapësira e ajrit	Trashësia e 1 cm	hapësirës së ajrit 2 - 10 cm
Shtresë ajri horizontale (rryma e nxehtësisë në ngritje):	0.1323	0.143
Shtresë ajri vertikale	0.1323	0.156
Shtresë ajri horizontale (rryma e nxehtësisë në zbritje):	0.1323	0.191

Në rast se hapësira e ajrit është më e madhe se 10 cm atëhere koeficientët e këmbimit të nxehtësisë me konveksion dhe rrezatim duhet të llogariten në veçanti.

## 7.4 Koeficienti i përgjithshëm i transmetimit të nxehtësisë

Koeficienti i përgjithshëm i transmetimit të nxehtësisë të një paretit është i barabartë me inversin e shumës së rezistencave termike të shtresës dhe të ajrit të jashtëm e të brendshëm

### 7.4.1. Koeficienti i përgjithshëm i transmetimit të nxehtësisë të një paretit uniform me një ose shumë shtresa me trashësi konstante

#### 7.4.1.1. Paretit i thjeshtë

Për paretin e thjeshtë me faqe të rrafshta dhe paralele i përbërë nga material homogjen me koeficient të përcjellshmërisë termike  $\lambda$  dhe trashësi  $\delta$  kemi:

$$K = \frac{1}{\frac{1}{\alpha_j} + \frac{\delta}{\lambda} + \frac{1}{\alpha_b}} \quad (9)$$

#### 7.4.1.2. Paretit i përbërë

Për paretin të përbërë nga disa shtresa homogjene me faqe të rrafshta dhe paralele respektivisht 1,2,3,...,n, me koeficient të përcjellshmërisë termike respektivisht  $\lambda_1, \lambda_2, \lambda_3, \dots, \lambda_n$  dhe trashësi respektivisht  $\delta_1, \delta_2, \delta_3, \dots, \delta_n$  kemi:

$$K = \frac{1}{\frac{1}{\alpha_j} + \frac{\delta_1}{\lambda_1} + \frac{\delta_2}{\lambda_2} + \frac{\delta_3}{\lambda_3} + \dots + \frac{\delta_n}{\lambda_n} + \frac{1}{\alpha_b}} \quad (10)$$

#### 7.4.1.3. Paretit me materiale johomogjene

Për rastin e paretit të përbërë nga një ose më shumë shtresa prej materiali johomogjen, heterogjeniteti mund të neglizhohet për rastet kur ai është i shpërndarë uniformisht në paret (rasti i murit të tullës me shtresë uniforme të llaçit) dhe për këtë rast rezistenca termike e llogaritur

nëpërmjet shprehjes  $\delta_n/\lambda_n$  ruan kuptimin e saj ose mund të përdoret koeficienti  $\lambda_{ek}$  i cili llogaritet si mesatare e karakteristikave termike të shtresave përbërëse të murit.

Për rastet kur heterogjeniteti, pamvarësisht se është i shpërndarë uniformisht në paret, ka rëndësi (psh. muri i tullës me vrima) atëherë shprehja  $\delta_n/\lambda_n$  duhet të merret parasysh ose mund të punohet me rezistencën termike të shtresës  $R_1, R_2, R_3, \dots, R_n$ . Në këtë rast koeficienti i përgjithshëm i trasmetimit të nxehtësisë për murin llogaritet me formulën:

$$K = \frac{1}{\frac{1}{\alpha_j} + \frac{\delta_1}{\lambda_1} + \frac{\delta_2}{\lambda_2} + \frac{\delta_3}{\lambda_3} + \dots + \frac{1}{R_1} + \frac{1}{R_2} + \dots + \frac{1}{R_n} + \dots + \frac{\delta_n}{\lambda_n} + \frac{1}{\alpha_b}} \quad (11)$$

#### 7.4.1.4. Rasti i paretëve me hapësira ajri

Për rastin e paretëve me shtresa ndërmjetme ajri përdoret rezistenca termike e shtresës  $R_{aj}$ .

### 7.5 Rezistenca termike e paretëve jouniforme.

#### 7.5.1 Parete jouniformë të ndashëm në elemente uniformë

Llogaritja e rezistencës termike të paretit jouniform (ose elementi jouniform i paretit) realizohet duke e ndarë atë dhe duke llogaritur humbjet për çdo element ndarës duke plotësuar kushtet si vijon:


- çdo element përbërës uniform, i konsideruar homogjen, ka një rezistencë termike të njohur
- çdo element uniform kufizohet nga plane paralele me paretin në konsideratë
- në çdo element uniform i përbërë nga material homogjen neglizhohen komponentët e fluksit të nxehtësisë në drejtim jo normal me sipërfaqet kufizuese të paretit

#### 7.5.2 Parete jouniformë të pandashëm në elemente uniformë

Për rastet kur nuk plotësohen kushtet e pikës 7.5.1. duhet të kryhen llogaritje të sakta ose të përdoren shprehje empirike për vlerësimin e rezistencës termike.

##### 7.5.2.1 Parete me nyje termike

Nyjet termike përbëhen nga elementë me koeficient të lartë të përcjellshmërisë termike të futura në paret ose pjesë të paretit me karakteristika termike normale.



Nga pikpamja strukturale nyjet termike përcaktohen si nyje lidhëse ndërmjet materialeve me formë dhe përbërje të ndryshme nga ajo e strukturës ndërtimore të lokalit.

Vlerësimi i influencës së nyjes termike në humbjet e nxehtësisë në lokale bëhet nëpërmjet korrigjimit të shprehjes së humbjeve termike me transmetim  $Q_0$  si vijon:

$$\bar{Q}_0 = Q_0 + \sum_i k_i l_i \quad (12)$$

- ku:
- $\bar{Q}_0$  humbjet e nxehtësisë me transmetim nga paretet dhe nyjet termike në to (Ë)
  - $Q_0$  humbjet e nxehtësisë me transmetim nga paretet (Ë)
  - $k_i$  koeficienti linear i përcjellshmërisë termike të nyjes së  $i$ -të (Ë/m<sup>°K</sup>)
  - $l_i$  gjatësia e nyjes termike të  $i$ -të (m)

Koeficienti linear i nyjes termike është funksion i parametrave të mëposhtëm:

- Spesori  $\delta$  i elementeve përbërës të nyjes termike
- Koeficienti i trasmetimit të nxehtësisë së elementeve përbërës të nyjes termike

### 7.6 Koeficienti i transmetimit të nxehtësisë për paretet në kontakt me tokën

Për përcaktimin e koeficientit të transmetimit të nxehtësisë për paretet në kontakt me tokën në mungesë të një normative rekomandohet të përdoret procedura e paraqitur në shtojcën D. Rastet që shqyrtohen në këtë procedurë janë:

- *ndërtesë me dysheme të vendosur direkt në tokë*
- *ndërtesë me dysheme të vendosur mbi një hapësirë të ajruar (bodrume)*
- *dyshemeja e ndërtesës ndodhet në një nivel më të ulët referuar kuotës së terrenit të jashtëm*

Llogaritjet e humbjeve të nxehtësisë nga toka duhet të kryhen duke patur parasysh edhe të dhënat si vijon:

- Sipërfaqet e paretëve, përfshirë dyshemenë, që këmbëjnë nxehtësi me tokën,
- Karakteristikat e izolimit të dyshemesë dhe të mureve në kontakt me tokën (tipi, trashësia dhe vendndodhja)
- Karakteristikat gjeometrike të tipologjisë në konsideratë (sipërfaqja dhe perimetri)
- Karakteristikat fizike të terrenit
- Karakteristikat e materialit të terrenit:

## 8. Sipërfaqet e këmbimit të nxehtësisë

### 8.1. Sipërfaqet llogaritëse

Sipërfaqja e cila duhet të merret në konsideratë gjatë kryerjes së llogaritjeve termike është sipërfaqja e brendshme e paretit duke marrë në konsideratë dimensionet neto në brendësi të lokalit duke neglizhuar trashësinë e murit dhe/ose të soletës.

Për dritaret, portat, etj merret në konsideratë hapësira drite në mur e hapur përpara se të vendoset dritarja, porta. etj.

## 9. Korrigjimet për ekspozim

Këto korrigjime duhet të zbatohen me kushtet e mëposhtme:

- *vlerat e rrezatimit diellor janë normale*
- *lagështia në material është në kufij normale*
- *shpejtësia dhe temperatura e erës janë normale*

Korrigjimet për ekspozim të cilat duhet ti shtohen humbjeve bazë të nxehtësisë janë:

**Tabela 7**

Vlerat e korrigjimit për ekspozim

Orientimi	J	JL	L	VL	V	VP	P	JP
Vlera në %	0	2 ÷ 5	5 ÷ 10	10 ÷ 15	15 ÷ 20	15 ÷ 20	10 ÷ 15	5 ÷ 10

## 10. Korrigjimet për funksionim me ndërprerje të impiantit dhe reduktim të ngarkesës

Këto korrigjime duhet të zbatohen me kushtet e mëposhtme:

- *Impianti punon me ndërprerje sipas një regjimi të përcaktuar*
- *Impianti redukton ngarkesën termike në periudhën e natës*

Korrigjimet për funksionim me ndërprerje të impiantit dhe reduktim të ngarkesës të cilat duhet ti shtohen humbjeve bazë të nxehtësisë janë:

**Tabela 8**

Vlerat e korrigjimit për funksionim me ndërprerje të impiantit dhe reduktim të ngarkesës

Korrigjimet në % për funksionim me ndërprerje dhe reduktim të ngarkesës				
Mënyra e funksionimit	Impiante me ajër të ngrohtë	Impiante me ujë	Radiatorë me avull	Impiante me tuba të inkuorporuar në strukturë
Përdorim i vazhduar me reduktim natën	12	8	10	5
Me përdorim ditor 16 ÷ 18 orë	15	10	12	8
Me përdorim ditor 12 ÷ 16 orë	20	12	15	10
Me përdorim ditor 8 ÷ 12 orë	25	15	20	12
Me përdorim ditor 6 ÷ 8 orë	30	20	25	15
Me përdorim ditor 4 ÷ 6 orë	35	25	30	20

## 11. Humbjet e nxehtësisë me ajrin ventilues

Formula llogaritëse e humbjeve me ajrin ventilues është:

$$Q_v = c_{aj} \rho_{aj} q_v (t_b - t_j) \quad (13)$$

ku:  $c_{aj}$  - nxehtësia specifike e ajrit (në kushte standarde 1000 (J/kg°K)  
 $\rho_{aj}$  - densiteti i ajrit (në kushte standarde 1.2 kg/m<sup>3</sup>)  
 $q_v$  - prurja e ajrit ventilues (m<sup>3</sup>/ore).

Në rastet kur prurja e ajrit ventilues nuk njihet ajo mund të përcaktohet në funksion të numrit të ndërrimeve të ajrit ( $n_{aj}$ ). Në këtë rast prurja e ajrit ventilues përcaktohet me shprehjen:

$$q_v = n_{aj} V \quad (14)$$

ku:  $n_{aj}$  - numri i ndërrimeve të ajrit për ventilim dhe infiltrim  
 $V$  - volumi i zonës në shqyrtim

### 11.1 Përcaktimi i prurjes së ajrit ventilues

Sasia e ajrit ventilues që shkëmbëhet me ambientin e jashtëm rezulton nga prezenca e fenomenit të ventilimit natyral ose e ventilimit të detyruar.

#### 11.1.1 Ventilimi natyral

Në rastin e prezencës së fenomenit të ventilimit natyral duhet të kihet parasysh faktorët e mëposhtëm:

- tipi i mbylljeve të përdorura në ndërtesë,
- përshkueshmëria e pareteve të ndërtesës,
- shpejtësia dhe drejtimi i erës,
- diferenca e temperaturave jashtë dhe brenda.

##### 11.1.1.1 Ventilimi natyral në lokalet me dritare/dyer normale

a) Në ambientet me dendësi normale të njerëzve sasia minimale e ajrit të këmbyer rekomandohet të pranohet në vlerën 0.3 l/orë. Në këtë mënyrë prurja e ajrit ventilues minimale në këto ambiente llogaritet me shprehjen:

$$q_v = 0.3 V \quad (15)$$

b) Referuar kërkesave për ruajtjen e pastërtisë së ajrit në ambientet ku qëndrojnë njerëz rekomandohet që sasia minimale e ajrit të këmbyer të pranohet në vlera:

- jo më pak se 13 m<sup>3</sup>/h për person në lokale ku nuk pihet duhan,
- jo më pak se 20 m<sup>3</sup>/h për person në lokale ku pihet duhan,

dhe në rastet kur numri i personave nuk njihet pranohet prezenca e një personi për çdo 10 m<sup>2</sup> të sipërfaqes së lokalit.

Sasia minimale e ajrit të këmbyer përcaktohet si maksimumi i vlerave të përcaktuara nga përcaktimet e dhëna në pikat (a) dhe (b).

Në raste të veçanta si në guzhina apo ambiente higjienike, për rastet kur nuk është i pranishëm ventilimi i detyruar, rinovimi i ajrit duhet të bëhet referuar volumit të lokalit dhe me konkretisht sugjerohet:

guzhina	1 ndërrim ajri/orë
banjo	2 ndërrime ajri/orë
para banjo	1 ndërrim ajri/orë

Një procedurë më ekzakte për përcaktimin e vlerave të rekomanduara të ndërrimeve të ajrit për t'u përdorur në llogaritje jepet në shtojcën E.

##### 11.1.1.2 Ventilimi natyral në lokalet ku shpejtësia e erës është e lartë

Në rastet kur shpejtësia e erës në ambientin përreth lokalit kalon vlerat 4 m/s duhet të merret parasysh rritja e sasisë së ajrit ventilues e cila mund të llogaritet me formulën:

$$q_v = 0.167 l a \left( v^{\frac{4}{3}} - 6.3 \right) \quad (16)$$

ku:  $v$  - shpejtësia e erës në m/s për rastet kur  $v > 4$  m/s  
 $l$  - është gjatësia në m e hapjeve (dyer, dritare, etj)  
 $a$  - është një koeficient që varet nga lloji i dritares/derës dhe pranohet i barabartë me:

- 4 - për dyer/dritare prej druri ose metalike me cilësi shumë të lartë
- 2.5 - për dyer/dritare prej druri ose metalike dopjo (ku l matet vetëm për pjesën e jashtëme)
- 10 - për dyer/dritare prej druri ose metalike të thjeshta
- 15 - për hapësirat poshtë derës

### 11.1.2 Ventilimi i detyruar

Prurja e ajrit ventilues në këtë rast varet nga:

- prurja e ajrit të sistemit të ventilimit (dhënie ajri),
- prurja e ajrit nga sistemi i largimit të ajrit,
- numri i orëve të funksionimit të impiantit,

Formula që përdoret për llogaritjen e prurjes së ajrit ventilues  $q_v$  është:

$$q_v = \frac{V [n_0 t_{sp} + (n_f + n_x) t_{ac}]}{t_{sp} + t_{ac}} \quad (17)$$

ku:  $V$  - volumi i ngrohur i zonës në shqyrtim

$n_f$  - numri i ndërrimeve të ajrit të siguruara nga impianti i ventilimit

$n_o$  - numri i ndërrimeve të ajrit kur impianti i ventilimit nuk punon

$n_x$  - numri i ndërrimeve të ajrit nga infiltrimet natyrale (nqs. ekzistojnë) kur impianti i ventilimit është në punë

$t_{sp}$  - periudha e kohës kur impianti i ventilimit nuk funksionon

$t_{ac}$  - periudha e kohës kur impianti i ventilimit është në funksionim

Vlera e  $n_f$  varet nga karakteristikat e sistemit të ventilimit; vlera e  $n_o$  lidhet me procesin e ventilimit natyral dhe përcaktohet sipas procedurës së dhënë në shtojcën E; vlera e  $n_x$  është e lidhur me karakteristikat e permeabilitetit të komponentëve ndërtimore dhe me veçoritë e zonës klimatike përsa i përket erës dhe ndërhyr në formulë vetëm për rastin kur në ndërtesë nuk vepron impianti i ventilimit.

### 11.2 Koeficienti i humbjeve volumore me ventilim

Koeficienti i humbjeve volumore me ventilim " $G_{v_v}$ " përfaqëson energjinë termike të humbur me ajrin ventilues referuar njësisë së volumit të ambjentit të ngrohur dhe diferencës  $1^\circ\text{C}$  të temperaturës së brendëshme dhe temperaturës së jashtme.

Koeficienti i humbjeve volumore me ventilim " $G_{v_v}$ " përcaktohet me formulën:

$$G_{v_v} = \frac{Q_v}{V\Delta t} \quad (18)$$

ku:  $V$  - volumi i ngrohur i ndërtesës i shprehur në  $\text{m}^3$

$\Delta t$  - është e barabartë me  $(t_b - t_j)$  ku  $t_b$  është temperatura e ajrit të brendshëm përcaktuar në pikën 6 dhe  $t_j$  është temperatura llogaritëse e ajrit të jashtëm e cila përcaktohet në pikën 5.

Referuar vlerave të parametrave të ajrit koeficienti i humbjeve volumore me ventilim " $G_{v_v}$ " përcaktohet edhe me formulën:

$$G_{v_v} = 0.35 n_{aj} \quad (19)$$

Për të zvogëluar pjesërisht humbjet e nxehtësisë me ventilim gjatë rinovimit të ajrit përdoret rikuperimi i nxehtësisë. Përdorimi i rikuperimit të nxehtësisë bëhet i detyrueshëm dhe duhet të mbulojë jo më pak se 50% të humbjeve të nxehtësisë me ventilim " $Q_v$ " për zonat e ftohta me numër të gradë ditëve më të madh se 1400, prurje të ajrit në lokal më të madh se  $2000 \text{ m}^3/\text{orë}$  dhe për orë të funksionimit të impiantit të ventilimit më të madh se 1250 orë/vit.



## Shtojca A

### 1. Hyrje

Përcaktimi i temperaturës llogaritëse për periudhën e ngrohjes si dhe i numrit të gradë-ditëve për qytetet kryesore të territorit të Republikës së Shqipërisë përbën një element të domosdoshëm për përcaktimin e humbjeve të nxehtësisë në ndërtesa si dhe për llogaritjen e nevojave për energji për ngrohjen e tyre.

Përcaktimi i këtyre parametrave duhet bërë bazuar në treguesit klimatikë, që përcaktohen mbi bazën e vrojtimeve meteorologjike të kryera në qytetet apo rajonet në shqyrtim, si dhe nga konsiderata tekniko ekonomike të cilat duhet të marrin parasysh karakteristikat energjitike të ndërtesave si dhe nivelin e fondit energjistik kombëtar disponibël për plotësimin e nevojave për ngrohjen e ndërtesave.

### 2. Temperatura llogaritëse e sistemeve të ngrohjes

Temperatura e ajrit të jashtëm që përdoret për llogaritjen e kryer me formulën (1) përfaqëson një parametër i cili përcaktohet duke patur parasysh:

- treguesit klimatik të periudhës së ftohtë të vitit për territorin e Shqipërisë
- aftësinë akumuluese të ndërtesave
- devijimin e lejuar të temperaturës së mjediseve të brendshëm në rastin ekstrem të kushteve meteorologjike për periudhën e ftohtë të vitit.

Llogaritja e treguesit klimatik, e cila është temperatura mesatare ditore e ajrit, është kryer duke shfrytëzuar normat klimatologjike të temperaturës së ajrit (periudha e vrojtimit 1961-1990), të nxjerra nga seria e të dhënave shumëvjeçare të Bankës së të Dhënave të Institutit Hidrometeorologjik (IHM).

Aftësia akumuluese e ndërtesave merret parasysh nëpërmjet konstantes së kohës së tyre e cila është funksion i karakteristikave termofizike të materialeve ndërtimore dhe karakteristikave gjeometrike të ndërtesës në shqyrtim. Në llogaritje janë konsideruar 3 tipe ndërtesash me konstante kohe përkatësisht 30 orë, 50 orë dhe 80 orë.

Në llogaritjet e temperaturës llogaritëse është pranuar që në rastet ekstreme të temperaturës së jashtme temperatura e ambientit të brendshëm mund të devijojë nga vlera 20°C duke pranuar si temperaturë llogaritëse vlerën  $t_b = 17^\circ\text{C}$ .

Bazuar në këto konsiderata në vijim jepet temperatura llogaritëse për qytetet kryesore të Republikës së Shqipërisë. Për llogaritjet përkatëse janë shfrytëzuar normat klimatologjike të temperaturës së ajrit (periudha e vrojtimit 1961 - 1990), të nxjerra nga seria e të dhënave shumëvjeçare të Bankës së të dhënave të Institutit Hidrometeorologjik (IHM).

Nr.	Qyteti	Lart.mbi nivelin e detit (m)	Gjerësia Gjeografike (Grad, min)	$t_{log}$	Nr.	Qyteti	Lart. mbi nivelin e detit (m)	Gjerësia gjeografike	$t_{log}$
1.	Ballsh	190	40 36	-1.0	19.	Krujë	560	41 30	-3.0
2.	B. Curri	360	42 21	-9.0	20.	Krume	434	42 11	-12.0
3.	Berat	226	40 43	-1.0	21.	Kuçovë	32	40 48	-1.0
4.	Bilisht	890	40 37	-11.0	22.	Kukës	350	42 02	-12.0
5.	Burrel	309	41 36	-6.0	23.	Laç	25	41 38	0.0
6.	Cërrik *	80	41 01	-1.0	24.	Lezhë	20	41 47	-1.0
7.	Corovodë	410	40 30	-2.0	25.	Librazhd	250	41 11	-4.0
8.	Durrës	5	41 18	1.0	26.	Lushnje	19	40 57	0.0
9.	Elbasan	100	41 05	-1.0	27.	Peshkopi	657	41 41	-11.0
10.	Ersekë	1030	40 20	-9.0	28.	Përmet	240	40 14	-2.0
11.	Fier	12	40 44	0.0	29.	Pogradec	720	40 54	-6.0
12.	Gramsh	200	40 52	-2.0	30.	Pukë	810	42 02	-11.0
13.	Gjirokastër	193	40 05	-3.0	31.	Rëshen	100	41 04	-4.0
14.	Himarë *	30	40 06	1.0	32.	Sarandë	23	39 52	3.0
15.	Kavajë	16	41 11	0.0	33.	Shkodër	30	42 05	-3.0
16.	Konispol *	400	39 39	1.0	34.	Tepelenë	220	40 18	-1.0
17.	Koplik	70	42 13	-3.0	35.	Tiranë	110	41 20	-1.0
18.	Korçë	899	40 36	-10.0	36.	Vlorë	4	40 27	1.0

\* Në këto qytete seria klimatologjike është më e vogël se 30 vjeçare

### 3. Gradë-ditë

Gradë-ditët përbëjnë elementin bazë për llogaritjen e konsumit të energjisë të përdorur në periudhën e ngrohjes. Llogaritja e gradë-ditëve kryhet mbi bazën e të dhënave klimatologjike (periudha e vrojtimit 1961-1990) të Bankës të të dhënave të IHM.

Përcaktimi i pragut të temperaturës së brendëshme të përdorur në llogaritje vleresohet mbi bazën e konsideratave tekniko-ekonomike.

Në vijim jepen gradë-ditët për pragje të ndryshëm të temperaturës së brendëshme si dhe numri i ditëve për të cilat temperatura e jashtme është nën këtë prag.

Gradë-ditët dhe numri i ditëve nën një prag të caktuar

Nr.	Qyteti	Pragu					
		15.5		17.5		20	
		Gr Ditë	Nr. Ditë	GrDitë	Nr.Ditë	GrDitë	Nr. Ditë
1	Ballsh	1128	190	1535	216	2115	247
2	B.Curri	2131	209	2594	228	3235	252
3	Berat	1130	187	1536	213	2110	242
4	Bilisht	2369	243	2878	265	3570	286
5	Burrrel	1571	209	2012	232	2628	259
6	Cërrik	1211	186	1607	205	2169	237
7	Çorovodë	1323	200	1748	223	2344	252
8	Durrës	863	175	1244	204	1797	237
9	Elbasan	1131	190	1537	215	2113	246
10	Ersekë	2374	251	2897	271	3599	288
11	Fier	1068	188	1473	215	2055	248
12	Gjirokastrë	1358	200	1773	221	2361	249
13	Gramsh	1246	195	1661	218	2245	248
14	Himarë	637	158	997	190	1532	222
15	Kavajë	1126	193	1541	219	2134	252
16	Konispol	1095	193	1507	218	2089	246
17	Koplik	1316	190	1721	213	2287	238
18	Korçë	2273	240	2774	260	3453	281
19	Krujë	1401	207	1842	232	2458	259
Më poshtë po japim dhe tabelën përmbledhëse të llogaritjeve të humbjeve për transmetim dhe ventilim

### Pallat 9 – katesh

	Koef.i trans te nx. (Wm <sup>20</sup> C)	Gjatësi (m)	Gjerësi, lartësi (m)	Sipërfaqe (m <sup>2</sup> )	Sipërfaqe për t'u zbritur (m <sup>2</sup> )	Sipërfaqe llogaritëse (m <sup>2</sup> )	Temp.e brendsh. (°C)	Temp.e ajrit të jasht. (°C)	Humbjet e nx.për transmet. (W)	Humbjet nga nyjet termike (W)	Nr.i ndrrimeve të ajrit në 1 orë	Humbjet e nx.për infiltrim (W)	Humbjet totale (W)
Mur i jashtëm	1,522	93,6	27,54	2577,744	293,03	2284,714	20	-1	73024,02887	21493,79077	1,5	141913,8789	236431,6985
Dritare dopjo	4,258	205,74	1,4	288,036	0	288,036	20	-1	25756,60305				25756,60305
Derë e jashtme	1,748	2	2,5	5	0	5	20	-1	183,54				183,54
Derë e brendshme	2,016	0	0	0	0	0	20	20	0				0
Mur i brendshëm	1,54	0	0	0	0	0	20	20	0				0
Vetrata	0	0	0	0	0	0	20	0	0				0
Dysheme	1,61	30,6	16,2	495,72	0	495,72	20	8	9577,3104				9677,3104
Çati	0	0	0	0	0	0	20	20	0				0
Tarracë	0,502	30,6	16,2	495,72	0	495,72	20	-1	5225,88024				5225,88024

Volumi i ndertesës 13662,1288 m<sup>3</sup>

$Q_{\text{tat}} = 277174,0322 \text{ W}$

Per kete rast  $G_v = 0.96 \text{ W/m}^3\text{°C}$

**LIGJ**  
**Nr.9290, datë 7.10.2004**

**PËR PRODUKTET E NDËRTIMIT**  
*(Ndryshuar me ligjin nr.9825, datë 1.11.2007;*  
*ndryshuar me ligjin nr.10 327, datë 30.9.2010)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti**

Ky ligj përcakton kushtet e përdorimit të produkteve të ndërtimit, pranimin e miratimeve teknike për këto produkte, vlerësimin dhe vërtetimin e konformitetit me kërkesat themelore, si dhe rregullon hedhjen në treg të produkteve të ndërtimit, kryerjen e mbikëqyrjes së tregut dhe zbatimin e procedurave të veçanta për njohjen e tyre.

**Neni 2**  
**Fusha e zbatimit**

Ky ligj zbatohet për ato produkte ndërtimi që plotësojnë kërkesat themelore, të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, dhe nuk zbatohet për produktet që nuk plotësojnë specifikimet teknike që u referohen neneve 5, 6 e 7 të këtij ligji.

**KREU II**  
**PËRKUFIZIMET DHE KËRKESAT THEMELORE TË PRODUKTIT TË NDËRTIMIT**

**Neni 3**  
**Përkufizime**

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

1. "Produkt ndërtimi" është çdo produkt, i prodhuar për t'u përdorur, në mënyrë të përhershme, në punimet e ndërtimit.
2. "Punime ndërtimi" janë punimet e ndërtimit në ndërtesa, në objekte publike, në vepra industriale, të infrastrukturës dhe në objekte të tjera.
3. "Hedhja në treg" është një produkt ndërtimi i përshtatshëm për përdorim në Republikën e Shqipërisë.
4. "Specifikime teknike" janë standardet, miratimet teknike dhe rregullat teknike shqiptare, sipas neneve 5, 6 e 7 të këtij ligji.
5. "Standard shqiptar" është standardi i miratuar nga organizmi shqiptar i standardizimit.
6. "Standard i harmonizuar" është standardi i miratuar nga Organizata Europiane e Standardizimit dhe i botuar në "Gazetën zyrtare" të Komunitetit Europian.

7. "Miratim teknik shqiptar" është miratimi teknik i një produkti ndërtimi, i dhënë nga organi miratues përkatës shqiptar.

8. "Organ miratues" është organi përgjegjës që jep miratimet teknike shqiptare.

9. "Ministër" është ministri që mbulon fushën e ndërtimit dhe të prodhimit të materialeve të ndërtimit.

10. "Produkt i vogël ndërtimi" është një produkt ndërtimi, i cili luan një rol të vogël në raport me shëndetin dhe sigurinë.

11. "Rregull teknologjik i pranuar" është dispozita teknike, e cila, sipas ekspertëve, reflekton gjendjen e teknologjisë.

12. "Organ certifikimi" është organi që vërteton konformitetin e produkteve të ndërtimit ose të një sistemi, për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit.

13. "Organ inspektimi" është organi që vlerëson dhe rekomandon metodat e kontrollit të cilësisë e të seleksionimit të produkteve të ndërtimit, të prodhuara dhe të përdorura nga prodhuesi.

14. "Laborator testimi" është organi që mat, ekzaminon, teston, kalibron ose përcakton karakteristikat apo cilësinë e materialeve a të produkteve të ndërtimit.

15. "Vlerësim konformiteti" është çdo veprimtari, e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, që përcakton nëse është plotësuar tërësia e kërkesave teknike të dokumentacionit përkatës.

16. "Vërtetim konformiteti" është pranimi paraprak i përputhshmërisë së produktit me kërkesat teknike.

#### Neni 4

#### **Kërkesat themelore**

Kërkesat themelore të punimeve të ndërtimit, të cilat përcaktohen në rregulloret përkatëse e që duhet të plotësohen nga produktet, duke ruajtur karakteristikat kryesore, janë:

- a) rezistenca dhe qëndrueshmëria mekanike;
- b) siguria në rast zjarri;
- c) higjiena, shëndeti dhe mjedisi;
- ç) siguria në përdorim;
- d) mbrojtja nga zhurmat;
- dh) kursimi i energjisë dhe ruajtja e ngrohtësisë.

#### KREU III

#### HEDHJA NË TREG E PRODUKTIT TË NDËRTIMIT

#### Neni 5

#### **Hedhja në treg**

Produkti i ndërtimit hidhet në treg kur është i përshtatshëm për përdorimin e synuar dhe përmbush kërkesat themelore, të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.

#### Neni 6

#### **Standardet e adaptuara**

Produkti është i përshtatshëm kur plotëson karakteristikat kryesore për përdorimin e synuar dhe hidhet në treg kur është në përputhje me standardet shqiptare të harmonizuara, të adoptuara nga standardet përkatëse europiane.

#### Neni 7

#### **Standardet shqiptare**

Kur nuk ekzistojnë standardet shqiptare, të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, produkti i ndërtimit hidhet në treg nëse është në konformitet me:

- a) standardet shqiptare;
- b) rregullat teknike shqiptare;
- c) miratimet teknike shqiptare, në përputhje me nenet 11, 12 dhe 13 të këtij ligji.

#### Neni 8

#### **Vlerësimi i konformitetit**

Kur produkti i ndërtimit nuk i plotëson, tërësisht ose pjesërisht, kërkesat e nenit 6 apo të nenit 7, hidhet në treg vetëm nëse prodhuesi zbaton procedurat e vlerësimit të konformitetit, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 17 të këtij ligji. Në këtë rast, deklarimi i konformitetit bazohet në testin fillestar të produktit, të kryer nga një laborator i miratuar testimi.

#### Neni 9

#### **Hedhja në treg e produktit të vogël**

1. Një produkt i vogël ndërtimi hidhet në treg pas deklarimit me shkrim të prodhuesit se ka zbatuar rregullin teknologjik të pranuar.
2. Deklarimi i prodhuesit është i vlefshëm kur produkti plotëson kriteret e përcaktuara nga standardet shqiptare për konformitetin.

#### Neni 10

#### **Kërkesa e konformitetit**

Ministri kërkon vlerësimin e konformitetit të produktit të ndërtimit për vendosjen e markës së konformitetit, me anë të së cilës prodhuesi ose përfaqësuesi i tij konfirmon, para se produkti të hidhet në treg, se ky produkt është prodhuar në përputhje me standardet.

### KREU IV

### MIRATIMI TEKNIK DHE ORGANI MIRATUES

#### Neni 11

#### **Miratimi teknik**

1. Miratimi teknik shqiptar i produktit të ndërtimit jepet nga organi miratues, i cili vërteton se ky produkt është i përshtatshëm për përdorimin e synuar. Miratimi teknik jepet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjatjeje edhe për 5 vjet të tjera.
2. Miratimi teknik shqiptar për një produkt ndërtimi mbështetet në ekzaminimet, provat dhe vlerësimet, sipas kërkesave themelore për punimet e ndërtimit.
3. Miratimi teknik shqiptar i jepet një produkti ndërtimi të veçantë vetëm nga një organ miratues, i autorizuar nga ministri.

#### Neni 12

#### **Kritere për miratimin teknik**

1. Organi miratues jep miratimin teknik shqiptar vetëm për një produkt ndërtimi, kur:
  - a) nuk ka as standard shqiptar dhe as rregull teknik shqiptar, sipas nenit 7 të këtij ligji;
  - b) ndryshon dukshëm nga një standard shqiptar ose rregull teknik shqiptar.
2. Për rishikimin e një miratimi teknik shqiptar zbatohen të njëjtat rregulla si për dhënien e tij. Kërkesa për miratim mund të paraqitet po tek ai organ miratues, që ka dhënë miratimin e parë.
3. Miratimi teknik shqiptar i dhënë anulohet nëse organi miratues vihet në dijeni nga organet e kontrollit se produkti i ndërtimit nuk është më i përshtatshëm për përdorimin e synuar dhe se nuk plotëson standardet shqiptare të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji.

## Neni 13

### **Kërkesa për miratimin teknik**

1. Kërkesa për miratimin teknik shqiptar të produktit të ndërtimit mund të bëhet nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij, por pasi të ketë deklaruar se nuk ka bërë një kërkesë të njëjtë në organe të tjera miratuese.

2. Kërkesa e prodhuesit përmban përshkrimin e produktit të ndërtimit, specifikimet, projektet dhe rezultatet e provave, që përcaktojnë produktin dhe përdorimin e tij të synuar, si dhe vendet ku ai do të shpërndahet.

3. Prodhuesi, para se të bëjë kërkesën për miratim, ka të drejtë të kërkojë nga organi miratues të dhëna për:

- a) procedurën e dhënies së miratimit teknik shqiptar;
- b) përfundimin e afatit për realizimin e procedurës;
- c) koston dhe mënyrën e pagesës.

4. Ministri përcakton kriteret për procedurat e dhënies, të zgjatjes, të rishikimit dhe të anulimit të miratimit teknik shqiptar.

5. Organi miratues, kur e sheh të nevojshme, i kërkon prodhuesit ose përfaqësuesit të tij dokumente shtesë, rezultate të reja provash, llogaritje ose të dhëna të tjera, për të bërë të mundur vlerësimin e produktit. Organi miratues garanton ruajtjen e sekretit për të gjitha të dhënat e marra gjatë procedurës.

## KREU V

### **VLERËSIMI E VËRTETIMI I KONFORMITETIT ME KËRKESAT E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

## Neni 14

### **Vërtetimi i konformitetit**

*( Riformuluar fjalia e tretë e pikës 1 me ligjin nr. 9825, datë 1.11.2007, neni 1)*

1. Prodhuesi është përgjegjës për vërtetimin e konformitetit të një produkti ndërtimi me kërkesat teknike. Para vërtetimit të konformitetit, përdorimi i tij do të përcaktohet nga provat, kontrolli ose metoda të tjera të vlerësimit të konformitetit. Procedurat e vlerësimit dhe të vërtetimit të konformitetit, në përputhje me specifikimet teknike, kryhen sipas nenit 12 të ligjit nr. 9779, datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore.

2. Organet e caktuara për vërtetimin e konformitetit caktohen sipas nenit 14 të ligjit nr. 9779, datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore.

## Neni 15

### **Metodat e kontrollit të konformitetit**

1. Për vërtetimin e konformitetit të produkteve të ndërtimit, në përputhje me specifikimet teknike, përdoren metodat e mëposhtme:

a) kontrolli fillestar i fabrikës dhe kontrolli fillestar i prodhimit në fabrikë nga një ekip i miratuar;

b) vënia në provë kontrolli e mostrave të marra në fabrikë, në përputhje me një provë të paracaktuar nga prodhuesi ose ekipi i miratuar;

c) vënia në provë e mostrave të marra nga një sasi e përgatitur për lëvrim, në tregun e hapur ose në një objekt, nga prodhuesi ose ekipi i miratuar;

ç) mbikëqyrja, gjykimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i kontrollit të prodhimit në fabrikë nga një ekip i miratuar.



2. Kontrolli i prodhimit në fabrikë, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë një kontroll i përhershëm, i brendshëm i prodhimit nga prodhuesi. Të gjitha elementet, kërkesat dhe mënyrat e përdorura nga prodhuesi për kontrollin e prodhimit në fabrikë, dokumentohen, në mënyrë sistematike, në formën e politikave dhe të procedurave të shkruara.

3. Metodatat e përdorura për vërtetimin e konformitetit të produkteve të ndërtimit, sipas pikës 1 të këtij neni, varen nga kërkesat teknike për produktin ose për familje të veçanta të produkteve të ndërtimit.

#### Neni 16

### **Kriteret e vërtetimit të konformitetit**

1. Vërtetimi i konformitetit të produktit të ndërtimit nënkupton që:

a) prodhuesi i një produkti ndërtimi ka një sistem kontrolli të prodhimit në fabrikë, prej të cilit sigurohet se prodhimi është në konformitet me specifikimet teknike;

b) përveç sistemit të kontrollit në fabrikë, për një produkt të veçantë ndërtimi, të përcaktuar në specifikimet përkatëse teknike, është miratuar një organ certifikimi për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e kontrollit të prodhimit ose të vetë produktit.

2. Përcaktimi i procedurave, sipas pikës 1 të këtij neni, varet nga:

a) lloji i produktit të ndërtimit;

b) rëndësia e produktit, në raport me kërkesat themelore për punimet e ndërtimit;

c) rezultatet e ndryshme të karakteristikave të produktit për qëndrueshmërinë e tij;

ç) ndjeshmëria ndaj defekteve gjatë prodhimit.

#### Neni 17

### **Procedurat e vlerësimit të konformitetit**

1. Procedurat e vlerësimit të konformitetit të produktit mbështeten:

a) në deklaratën e konformitetit, të bërë nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij;

b) në certifikatën e konformitetit për sistemin e kontrollit dhe të mbikëqyrjes së prodhimit ose për produktin, të lëshuar nga një organ certifikimi.

2. Nëse një organ certifikimi lëshon certifikatën e konformitetit për sistemin e kontrollit dhe të mbikëqyrjes së prodhimit, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij bën një deklaratë konformiteti për produktin e ndërtimit, në mbështetje të kësaj certifikate.

3. Për një prodhim të veçantë (ose jashtë serie), deklarata e konformitetit bazohet në vënien në provë të mostrës së produktit të ndërtimit dhe në kontrollin e këtij produkti në fabrikë.

#### Neni 18

### **Marka e konformitetit**

1. Pasi është shpallur dokumenti i konformitetit, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij vendos markën e konformitetit te produkti i ndërtimit.

2. Nuk mund të vendoset një markë konformiteti ose shenjë tjetër, e ngjashme me të, që mund të krijojë pështjellim në treg ose mashtrim të konsumatorit, te një produkt ndërtimi, që nuk është i përshtatshëm për përdorimin e synuar ose për të cilin marka e konformitetit nuk është miratuar.

#### Neni 19

### **Përgjegjësitë e organit të certifikimit**

1. Prodhuesi i materialeve të ndërtimit mund të angazhojë një organ certifikimi në procedurat e vlerësimit të konformitetit vetëm nëse ky organ ka autorizim, që vërteton aftësinë dhe përgjegjësinë e nevojshme për kryerjen e certifikimit të konformitetit, me rregullat dhe procedurat e caktuara. Produktet, të cilat janë brenda përgjegjësisë së organit të certifikimit, cilësohen në autorizim.

2. Detyrat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni kryhen nga organi i certifikimit, i cili mund t'ia caktojë një ose më shumë nga këto detyra edhe organeve të inspektimit ose laboratorëve të testimit.

## KREU VI MBIKËQYRJA E TREGUT

### Neni 20

#### **Organi i inspektimit të produktit**

*(Ndryshuar pjesërisht pikat 1 e 2, me ligjin nr. 9825, datë 1.11.2007, neni)*

1. Organi i inspektimit për përmbushjen e kërkesave të këtij ligji dhe të akteve të dala në zbatim të tij, për produktet e ndërtimit që hidhen në treg, është Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar.

2. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, përveç zbatimit të masave që rrjedhin prej akteve të veçanta, ushtron edhe këto përgjegjësi:

a) kërkon nga furnizuesi të paraqesë të gjitha të dhënat e nevojshme dhe dokumentet e dala për konformitetin, për produktet e ndërtimit;

b) kryen ekzaminimet e nevojshme dhe provat për produktet e ndërtimit, në përputhje me konformitetin, sipas specifikimeve teknike;

c) merr mostra të produkteve të ndërtimit për testim;

ç) urdhëron tërheqjen e dokumenteve të konformitetit në rastin e moskonformitetit të produkteve të ndërtimit;

d) ndalon hedhjen në treg të produkteve të ndërtimit në rast moskonformiteti;

dh) ndalon përkohësisht, deri në kryerjen e ekzaminimeve ose të provave, çdo furnizim, ofertë ose ekspozim të produkteve të ndërtimit, kur dyshohet se këto produkte nuk janë në përputhje me rregullat;

e) urdhëron zhdukjen e produkteve të ndërtimit në rast moskonformiteti kur ky është thelbësor për mbrojtjen e shëndetit dhe të jetës së njerëzve.

### Neni 21

#### **Përballimi i kostove të procedurave të inspektimit**

1. Kostot e procedurave të inspektimit, kostot e analizave, të shpenzimeve ditore, udhëtimeve dhe të shpenzimeve të tjera, të bëra për procedurat e paraqitura, përballohen nga vetë personi, kur ato janë në disfavor të tij.

2. Ankimi kundër vendimeve të marra në përputhje me pikën 2 të nenit 20, nuk e pezullon zbatimin e tyre.

### Neni 22

#### **Procedura të veçanta**

*(Shfuqizuar pika 1, ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 9825, datë 1.11.2007, neni 3)*

1. Shfuqizuar.

2. Njoha e deklarimeve dhe e miratimeve të sistemeve të huaja bëhet në përputhje me nenin 15 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësoret dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore.

**KREU VII**  
**SANKSIONET DHE MOSMARRËVESHJET**

**Neni 23**  
**Sanksionet**

*(Ndryshuar pjesërisht pika 1, shfuqizuar pika 3 me ligjin nr.9825, datë 1.11.2007, neni 4)*  
*(Shtuar nënpikat "viii" dhe "ix" me ligjin nr.10 327, datë 30.9.2010, neni 1)*

1. Në kuptim të këtij ligji, kur shkeljet nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

- a) personi juridik gjobitet me 100 000 deri në 1 000 000 lekë kur:
    - i) hedh në treg një produkt ndërtimi në kundërshtim me nenet 5, 6, 7 e 8 të këtij ligji;
    - ii) bën një deklaratë për pranimin e produktit të ndërtimit në kundërshtim me nenin 9 të këtij ligji;
    - iii) jep një miratim teknik shqiptar në kundërshtim me nenet 11, 12 dhe 13 të këtij ligji;
    - iv) nuk vendos markën e konformitetit në produktin e ndërtimit, në përputhje me pikën 1 të nenit 18 të këtij ligji;
    - v) në kundërshtim me pikën 2 të nenit 18, vendos në produktin e ndërtimit një markë konformiteti ose çdo markë tjetër, të ngjashme me një markë tjetër ekzistuese, që krijon pështjellim në treg ose mashtron konsumatorin;
    - vi) miraton një organ certifikimi për vërtetimin e konformitetit në kundërshtim me nenin 19 të këtij ligji;
    - vii) në kundërshtim me nenin 20 të këtij ligji, nuk vepron në përputhje me vendimet e strukturave përkatëse;
    - viii) vendos pezullimin e veprimtarisë deri në shlyerjen e detyrimit nga subjekti fizik dhe juridik;
    - ix) vendos sekuestrimin e mjeteve dhe të makinerive, të cilat punojnë gjatë kohës që subjekti është i pezulluar;
  - b) personi fizik gjobitet me 50 000 deri në 500 000 lekë për të njëjtat kundërvajtje të përmendura në shkronjën "a" të këtij neni.
2. Gjobat vendosen dhe vilen nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar.
3. Shfuqizuar.

**Neni 24**

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9825, datë 1.11.2007, neni 5)*

Mosmarrëveshjet për procedurat e vlerësimit të konformitetit zgjidhen në përputhje me nenet 21, 22, 23 dhe 24 të ligjit nr. 9779, datë 16.07.2007 "Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore.

**KREU VIII**  
**DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

**Neni 25**

**Nxjerrja e akteve nënligjore**

*(Shtuar fjalia në fund të pikës 1 me ligjin nr.10 327, datë 30.9.2010, neni 2)*

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4 e 7 të këtij ligji. Këshilli i Ministrave miraton formularët përkatës, që dokumentojnë procedurat e zbatuara nga INUK-ja, sipas përcaktimeve të bëra në nënpikat "viii" dhe "ix" të shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri, që mbulon fushën e ndërtimit dhe të prodhimit të produkteve të ndërtimit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 19 e 26 të këtij ligji.

Neni 26  
**Dispozitë kalimtare**

Derisa të miratohen aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, zbatohen ligji dhe aktet nënligjore në fuqi.

Neni 27  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Ligj nr.9290, datë 7.10.2004 shpallur me dekretin nr.4377, datë 7.10.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.81, faqe 5931*

**Ligj nr.9825, datë 1.11.2007 shpallur me dekretin nr.5510, datë 9.11.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.152, faqe 4445*

**Ligji nr.10327, datë 30.9.2010 shpallur me dekretin nr.6721, datë 12.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.142, faqe 7700*

**VENDIM**  
**Nr.58, datë 1.2.2006**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT E KONTROLLIT TË PRODUKTIT NË FABRIKË DHE NË QENDRËN E SHPËRNDARJES, PËR MARRJEN E CERTIFIKATËS SË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT PËR ÇIMENTOT, PËR TË CILAT KA RËNDËSI PARËSORE REZISTENCA DHE QËNDRUESHMËRIA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 25 të ligjit nr.9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullores “Për procedurat e kontrollit të produktit në fabrikë dhe në qendrën e shpërndarjes, për marrjen e certifikatës së vlerësimit të konformitetit, për çimentot, për të cilat ka rëndësi parësore rezistenca dhe qëndrueshmëria”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

## RREGULLORE

# MBI PROCEDURAT E KONTROLLIT TË PRODUKTIT NË FABRIKË DHE NË QENDRËN E SHPËRNDARJES, PËR MARRJEN E CERTIFIKATËS SË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT, PËR ÇIMENTOT PËR TË CILAT KA RËNDËSI PARËSORE REZISTENCA DHE QËNDRUESHMËRIA

## PJESA I

### PROCEDURA PËR KONTROLLIN E PRODUKTIT NË FABRIKË DHE NË QENDRËN E SHPËRNDARJES SË ÇIMENTOVE

#### 1. Qëllimi dhe fusha e aplikimit

Procedura ka si qëllim që të përcaktojë kërkesat për një sistem kontrolli të produktit në fabrikë dhe në qendrën e shpërndarjes, në mënyrë që të sigurohet çimento sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, që mund të përdoret për prodhimin e një betoni normal, të armuar ose të paranderur dhe për të cilat ka rëndësi rezistenca dhe qëndrueshmëria.

Procedura aplikohet në fabrikë nga prodhuesi i çimentos ose në qendrën e shpërndarjes nga ndërmjetësi, ose mund të jetë specifike.

#### 2. Kërkesat e fabrikës. Detyrat e prodhuesit

Quket fabrikë, linja që përdoret për prodhimin dhe shitjen e çimentos, e cila është e përshtatshme për një prodhim të vazhdueshëm në masë të saj, disponon impiante të mjaftueshme për bluarje dhe homogjenizim, si dhe kapacitetet e nevojshme për depozitim, personel ekspert dhe pajisje të përshtatshme për të provuar, vlerësuar dhe korrigjuar cilësinë e produktit.

Prodhuesi demonstron se ka një sistem kontrolli të procesit në fabrikë ose një sistem cilësie, për të siguruar që çimentoja e prodhuar është konform kërkesave të standardit S SH EN 197-2.

Prodhuesi duhet të dokumentojë aktivitetin e kontrollit të cilësisë nëpërmjet manualit të cilësisë, për çdo fabrikë.

Prodhuesi bën një deklaratë që përcakton politikën, objektivat për cilësinë dhe mjetet e vëna në dispozicion për arritjen e cilësisë së produktit dhe e bën të njohur këtë politikë në të gjitha nivelet e fabrikës.

Prodhuesi përshkruan në manualin e cilësisë strukturën organizative, përgjegjësitë dhe detyrat për arritjen e cilësisë së produktit, përshkruan format e aplikuara për realizimin e cilësisë së parashikuar, si dhe funksionimin efektiv të kontrollit në prodhimin e çimentos.

Prodhuesi duhet të caktojë një përfaqësues, i cili pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera, ka përgjegjësi dhe autoritet të veçantë për të siguruar se detyrat e kontrollit të prodhimit në fabrikë janë aplikuar e ndjekur.

Prodhuesi të paktën një herë në vit, rishikon sistemin e kontrollit të cilësisë së prodhimit, edhe nëpërmjet inspektimeve, për t'u siguruar për aftësinë dhe efikasitetin e tij.

Manuali i cilësisë përcakton procedurat që duhen zbatuar, në mënyrë që çimentoja e prodhuar dhe e nxjerrë në treg të jetë në konformitet me standardet dhe rregullat teknike në fuqi.

Çdo lloj ndryshimi thelbësor në manualin e cilësisë ose në procesin e shpërndarjes së produkteve që tregtohen rifuxhio, i bëhet e ditur organizimit që ushtron të drejtën e kontrollit, brenda dy muajve nga vënia në zbatim, prej përfaqësuesit të drejtorisë.

#### 3. Kërkesat për qendrën e shpërndarjes. Detyrat e ndërmjetësit

Quket qendër shpërndarje, impianti i lëvizjes së çimentos, që nuk ndodhet brenda fabrikës, i cili e merr çimenton rifuxho dhe e depoziton, paketon dhe shpërndan, rifuxho ose në thasë.

Qendra e shpërndarjes trajton vetëm produkte me dëshmi konformiteti.

Ndërmjetësi që menaxhon një qendër shpërndarje, është një person fizik ose juridik, i cili merr prej prodhuesit sasinë e çimentos të certifikuar sipas S SH EN-19-2, ka të drejtën e përdorimit të markës së konformitetit të vendosur nga prodhuesi, nëse provon që vetitë e çimentos rifuxhio të furnizuar janë ruajtur gjatë fazës së transportit, marrjes, depozitimit, ambalazhimit dhe shpërndarjes. Konformiteti vlerësohet në bazë të standardeve.

Ndërmjetësi dokumenton aktivitetin e përshkruar më sipër nëpërmjet manualit të cilësisë, për çdo qendër shpërndarje.

Ndërmjetësi harton një deklaratë ku përcakton politikën, objektivat për cilësinë dhe masat e marra për ruajtjen e cilësisë së çimentos së furnizuar dhe shpërndarë dhe siguron se kjo politikë është bërë e njohur në të gjitha nivelet.

Ndërmjetësi shpjegon në manualin e cilësisë strukturën organizative, përgjegjësitë dhe mundësitë e drejtimit në lidhje me ruajtjen e cilësisë së çimentos së furnizuar dhe shpërndarë. Gjithashtu përshkruan mjetet e përdorura për të kontrolluar cilësinë e çimentos, si dhe efektivitetin e funksionimit të sistemit të cilësisë.

Ndërmjetësi cakton një përgjegjës për cilësinë, i cili pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera, ka autoritet dhe përgjegjësi të veçantë, për të siguruar se rregullat e kontrollit gjatë furnizimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së çimentos, janë aplikuar dhe zbatuar konform standardeve të rregullores.

Ndërmjetësi të paktën një herë në vit rishikon sistemin e kontrollit të cilësisë së furnizimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së çimentos, nëpërmjet verifikimeve inspektuese, për t'u siguruar mbi aftësinë dhe efikasitetin e sistemit të kontrollit, në mënyrë që të përmbushen kërkesat e parashikuara në rregullore.

Manuali i cilësisë së ndërmjetësit përshkruan procedurat e zbatuara dhe të përdorura për sistemin e kontrollit të cilësisë së çimentos së furnizuar dhe shpërndarë, si dhe referon në të dokumentet që përmbajnë të dhënat e fundit rreth provave të autokontrollit dhe të kontrollit të cilësisë.

Çdo lloj ndryshimi thelbësor në manualin e cilësisë i duhet bërë e ditur nga përfaqësuesi i drejtorisë, organizmit të autorizuar, brenda një muaji nga vënia në zbatim.

#### 4. Kontrolli në fabrikë. Detyrimet e prodhuesit

Drejtuari i fabrikës është përgjegjës për kontrollin e dokumentacionit dhe të dhënave që lidhen me kontrollin e prodhimit në fabrikë, si dhe zbatimin e rregullores.

Dokumentet e vjetëruara eliminohen dhe zëvendësohen me variante të tjera të mundshme ose bëhet modifikimi i tyre. Hartohet gjithashtu një listë për të identifikuar gjendjen e revizionimit të dokumenteve në përdorim, për të evituar përdorimin e dokumenteve të papërshtatshme.

Prodhuesi duhet të ketë një procedurë të dokumentuar, për të garantuar që materialet përbërëse janë konform kërkesave të pikës 4 të S SH EN 197 - 1 dhe të përshtatshëm për të siguruar prodhimin e çimentos.

Manuali i cilësisë përshkruan dhe dokumenton parametrat e zgjedhur për prodhimin, kontrollin e provave gjatë procesit, si dhe frekuencën e tyre.

Përshkruhen në mënyrë të mjaftueshme teknikat e kontrollit të cilësisë të fabrikës, procedurat dhe operacionet sistematike që janë zbatuar.

Prodhuesi zbaton dhe dokumenton një sistem provash të autokontrollit. Kriteret e konformitetit dhe plani i marrjes së kampionit i përgjigjen rregullores. Frekuenca e provave të autokontrollit nuk është më e ulët se ajo e treguar në tabelën 1, ose përsa i përket fazës fillestare për një tip të ri çimentoje në kolonën 5 (prova fillestare). Vetitë që përcaktohen në prova, për çdo tip dhe klasë çimentoje, janë ato të treguara në kolonat 1 dhe 2 të tabelës 1 dhe metodat e provave të përdorura, tregohen në kolonën 3 të tabelës 1. Për ato çimento për të cilat shpërndarja nuk është e vazhdueshme, frekuenca e provave dhe e marrjes së kampionëve është e përcaktuar në manualin e cilësisë së fabrikës. Të gjitha të dhënat e marra nga provat dokumentohen dhe janë të disponueshme për një kontroll në vazhdim nga organizmi i autorizuar.

Prodhuesi i ruan rezultatet e kontrollit të prodhimit të fabrikës dhe të provave të autokontrollit për një periudhë të paktën 3-vjeçare.

Aparaturat për kontrollin dhe provat në fazën e prodhimit, verifikohen rregullisht dhe tarohen sipas mënyrës së përcaktuar në manualin e cilësisë, si dhe në përputhje me ligjin nr. 8996, datë 30.01.2003 "Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse".

Në manualin e cilësisë pasqyrohen të gjitha procedurat e zbatuara nga prodhuesi për gjendjen e kontrollit dhe të provave në të gjitha fazat e prodhimit.

#### 5. Kontrolli i qendrës së shpërndarjes. Detyrimet e ndërmjetësit

Drejtuari i qendrës së shpërndarjes është përgjegjës për kontrollin e dokumenteve dhe të dhënave që lidhen me kontrollin e kryer në qendrën e shpërndarjes, në përputhje me standardet e përshkruara në rregullore.

Ky kontroll duhet të sigurojë që dokumentet të jenë tërësisht të disponueshme, dokumentet e papërdorshme të hiqen nga qarkullimi dhe ndryshimet ose modifikimet e çdo dokumenti të bëhen të njohura.

Me qëllim që të parandalohet përdorimi i dokumenteve të papërdorshme duhet të hartohet një listë kryesore në mënyrë që të identifikohen versionet aktuale të dokumenteve.

Sistemi i kontrollit të cilësisë parashikon një sistem të përshtatshëm provash për pranimin dhe identifikimin, që synon të vërtetojë që çimentoja rifuxho e marrë në qendrën e shpërndarjes nuk ka pësuar ndryshime si pasojë e ndotjes, vjetërimit dhe që kjo i korrespondon çimentos së specifikuar në kontratat e blerjes. Identifikimi garantohe duke marrë një kampion për çdo parti të lëvruar, me të paktën një kampion për çdo 500 ton çimento të marrë.

Mbi këto kampione kryhen provat e dhëna në tabelën 2.

Vetia që përcaktohet për një identifikim të shpejtë (imtësia, H/K, ngjyra etj.), zgjidhet nga ndërmjetësi me një aprovim paraprak nga organizmi i autorizuar.

Ndërmjetësi dokumenton se ka një sistem provash të autokontrollit. Autokontrolli i kryer mbi kampionet e çimentos ka si qëllim të sigurojë që çimentoja i ka ruajtur vetitë e saj.

Frekuenca e marrjes së kampioneve dhe kryerjes së provës, karakteristikat që duhet të kontrollohen dhe metodat e provave, i korrespondojnë atyre të dhëna në tabelën 2. Rezultatet e provave të autokontrollit të kryera në qendrën e shpërndarjes ballafaqohen dhe krahasohen me të dhënat që merren nga fabrika që furnizon çimenton. Autokontrolli kryhet në laboratorin e ndërmjetësit ose në një laborator të akredituar.

Ndërmjetësi i ruan të dhënat e kontrollit në faza të ndryshme për një periudhë të paktën 3-vjeçare.

Aparaturat për kontrollin dhe provat në fazën e marrjes dhe të transportit prej ndërmjetësit, verifikohen rregullisht dhe taten sipas mënyrës së përcaktuar në manualin e cilësisë dhe në përputhje me ligjin nr.8996, datë 30.1.2003 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse”.

Në manualin e cilësisë përcaktohet një laborator provash i akredituar për një ballafaqim të rezultateve, nëse paraqitet nevoja.

Në manualin e cilësisë pasqyrohen të gjitha procedurat e zbatuara nga ndërmjetësi për gjendjen e kontrollit dhe të provave në fazat e marrjes dhe të dorëzimit.

#### 6. Administrimi i moskonformitetit dhe veprimet korrigjuese të prodhuesit

Në manualin e cilësisë raportohen veprimet e zbatuara në rastin e mospërputhjes së specifikimeve të brendshme të përcaktuara nga prodhuesi.

Në rastin kur rezultatet e provave për një çimento nuk rezultojnë brenda vlerave limite të treguara në tabelën 5, menjëherë prodhuesi përcakton sasinë, ndërmerr një veprim të përshtatshëm për bllokimin e shpërndarjes së kësaj sasive dhe njofton klientin në rastin kur çimentoja është shpërndarë. Veç kësaj, prodhuesi stabilizon menjëherë shkaqet e moskonformitetit, duke ndërmarrë masat e nevojshme korrigjuese për një korrigjim të të gjithë procedurës së kontrollit të fabrikës. Të gjitha veprimet e ndërmarra dhe rezultatet dokumentohen.

Manuali i cilësisë përshkruan me detaje procedurën për korrektimin e sistemit të kontrollit të prodhimit në fabrikë në rastin e moskonformitetit të rezultateve. Veprimet e ndërmarra dokumentohen në kohën e duhur. Konsiderohen veprime korrigjuese edhe modifikimet e bëra në sistemin e kontrollit të cilësisë mbas sinjalizimit të bërë nga organizmi i autorizuar.

#### 7. Administrimi i moskonformitetit dhe veprimet korrigjuese të ndërmjetësit

Ndërmjetësi demonstroi përputhshmërinë e karakteristikave të produktit të shitur me karakteristikat e produktit të markuar në origjinë. Në rastin kur çimentoja paraqet një rezultat prove që nuk korrespondon me karakteristikat ose nuk është konform kërkesave të S SH EN 197-1, menjëherë ndërmjetësi përcakton sasinë, ndërmerr një sërë veprimesh që bllokojnë shpërndarjen e kësaj sasive çimentoje dhe informon prodhuesin, organizmin që ka lëshuar dëshminë e konformitetit, si edhe klientin, nëse çimentoja është shitur.

Ndërmjetësi ndërkaq stabilizon menjëherë shkaqet e mospërputhjes dhe moskonformitetit dhe nëse këto varen nga qendra e shpërndarjes, ndërmerr veprimet korrigjuese dhe bën një korrigjim të të gjitha procedurave të kontrollit.

Të gjitha veprimet e ndërmarra dhe rezultatet dokumentohen.

8. Lëvizja, magazinimi, ambalazhi, shitja dhe hetimi. Detyrimet e prodhuesit ose të ndërmjetësit

Manuali i cilësisë përshkruan kushtet paraprake të vendosura për të siguruar ruajtjen e cilësisë së çimentos deri sa kjo të jetë nën përgjegjësinë e prodhuesit ose të ndërmjetësit.

Dokumenti që shoqëron mallin mund të verifikohet në qendrën e prodhimit ose të shpërndarjes. Pikërisht ky kusht është kërkesë edhe në rastin e depozitave të çimentos rifuxho, të cilat administrohen nën përgjegjësinë e plotë të prodhuesit.

9. Kualifikimi. Përgjegjësitë e prodhuesit ose të ndërmjetësit

Manuali i cilësisë përmban procedurat që prodhuesi ose ndërmjetësi përdor për të garantuar se i gjithë personeli që merr pjesë në operacionet që mund të influencojnë në kontrollin e prodhimit, ka eksperiencën dhe kualifikimin e përshtatshëm.

Dokumentacioni përkatës ruhet.

10. Përdorimi i markës së konformitetit

Ndërmjetësi autorizohet të përdorë markën e konformitetit të vendosur nga prodhuesi, kur rezultatet e provës së autokontrollit në qendrën e shpërndarjes dhe ato të organizmit të autorizuar mbi kampionet e marra, janë konform standardeve. Rezultatet e provave të autokontrollit konfirmues për çdo çimento të certifikuar të kryer nga ndërmjetësi, duhet të mbeten brenda intervalit të vlerave maksimale dhe minimale të rezultateve të provave të autokontrollit të kryera nga prodhuesi në fabrikë në 12 muajt paraardhës. Kur rezultatet nuk korrespondojnë me kërkesat, autorizimi dhe mbajtja e përdorimit të markës së konformitetit bazohet në një verifikim rast pas rasti nga ana e organizmit të autorizuar.

## PJESA II PRO PËR DHËNIEN E DËSHMISË SË KONFORMITETIT

### 1. Hyrje

Prodhuesi ose shpërndarësi bashkëpunojnë me organizmat e autorizuar për vlerësimin e konformitetit sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 723, datë 5.11 .2004 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit”, për të lejuar inspektim e tyre në fabrikë dhe në sistemin e kontrollit të prodhimit. Prioritet i jepet kontrollit të prodhimit.

Detyrimet e përshkruara kryhen pa vonesë duke i dhënë prioritet kontrollit të produktit.

Prodhuesi për çdo qendër të veçantë, ndër të tjera, përcakton në manualin e cilësisë:

- tipet e çimentos së prodhuar dhe shënjat korresponduese të njohjes (thasë ose kartela identifikimi);

- përshkrimin e impianteve të prodhimit dhe të shpërndarjes;

- vendndodhjen e mundshme të depozitave të administruara nën përgjegjësinë e plotë të prodhuesit;

- përshkrimin e ambienteve dhe pajisjeve të provave, të nevojshme për provat e brendshme të autokontrollit;

- listën e depozitave;

- organizimin e kontrollit të brendshëm të cilësisë;

- personat përgjegjës të ngarkuar nga firma për kontrollin e brendshëm në fabrikë;

- një deklaram që vërteton se shërbimi i verifikimit inspektiv të sistemit të cilësisë është i pavarur nga shërbimi i prodhimit.

Manuali i cilësisë dhe rishikimet e njëpasnjëshme të tij, i dorëzohen organizmit të autorizuar, që angazhohet t’i mbajë të rezervuara.

2. Inspektimi fillestar i fabrikës dhe i sistemit të cilësisë

2.1. Inspektimi i një fabrike të re

Organizmi i autorizuar kryen një verifikim fillestar të fabrikës dhe të sistemit të kontrollit të cilësisë së produktit të zbatuar nga fabrika. Në fund organizmi i autorizuar:



a) konfirmon që sistemi i kontrollit të cilësisë së fabrikës është sipas procedurave të përshkruara në pjesën I dhe se ky sistem funksionon;

b) vlerëson që impianti i përdorur për prodhim dhe pajisjet e përdorura për kontrollin e çimentos janë konform kritereve të përcaktuara në pikat 2, 3 të pjesës II.

#### 2.2. Inspektimi i një fabrike ekzistuese

Në rastin e prodhimit të një tipi të ri ose klase të re rezistence të çimentos në një fabrikë ekzistuese, organizmi i autorizuar, vendos në bazë të modifikimeve të paraqitura në manualin e cilësisë së fabrikës dhe të komunikuar nga fabrika, nëse është i nevojshëm një inspektim shtesë.

Në rast se duhet, organizmi i autorizuar ekzaminon çdo novacion që ka shkaktuar modifikime thelbësore në procedurën për kontrollin e procesit të prodhimit dhe vërteton që ai është kryer sipas kritereve të dhëna në rregullore.

#### 2.3. Kriteret për vlerësimin e impiantit të prodhimit

Organizmi i autorizuar vlerëson përshtatshmërinë e impiantit të prodhimit në lidhje me manualin e cilësisë dhe përshtatshmërinë e tij për të prodhuar çimento, që kënaq kërkesat e parashikuara nga ligji nr.9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”.

Vlerësimi, veç të tjerave, verifikon nëse:

a) materialet përbërëse që do të përdoren për prodhimin e çimentos, janë të mbrojtura prej ndotjes;

b) disponohen impiante të përshtatshme për prodhimin e vazhdueshëm në masë të çimentos, në veçanti për një prodhim të mjaftueshëm dhe depozitim të përshtatshëm; këto impiante lejojnë kontrollin e cilësisë me një siguri të mjaftueshme për të garantuar kërkesat e përshkruara;

c) janë marrë masa për të parandaluar ndotjen e çimentos gjatë transportit dhe depozitimit;

d) çdo çimento është e depozituar në një ose më shumë silose të ndara; mbi silos shënohet në mënyrë të qartë tipi i çimentos, klasa e rezistencës dhe çdo informacion shtesë i nevojshëm;

e) në pikat e shpërndarjes së çimentos nga fabrika lejohen marrje të kampioneve sipas metodave të mostrimit të përshkruara në S SH EN - 196.

#### 2.4. Kriteret për vlerësimin e laboratorëve

a) Laboratori përgjegjës për kryerjen e provave të kërkuara prej sistemit të kontrollit të cilësisë në fabrikë, disponon pajisje të nevojshme për kryerjen e provave të parashikuara në manualin e cilësisë.

b) Laboratori përgjegjës për kryerjen e provave të autokontrollit disponon pajisjet e nevojshme për kryerjen e provave të listuara në standardin specifik të produktit përkatës (tabelat në fund të rregullores), duke përdorur metoda provash të përcaktuara ose ekuivalente.

#### 2.5. Raporti i inspektimit

Inspektimi fillestar dokumentohet nën titullin “Raport inspektimi”, që ruhet në dokumentet e prodhuesit.

#### 3. Provat fillestare mbi çimentot

Provat fillestare mbi çimentot, përfshijnë rezultatet e provave të kontrollit inspektiv të jashtëm, që kryhen gjatë periudhës fillestare, zgjatja e së cilës është 3 muaj, në marrëveshje me organizmin e autorizuar.

Numri i kampioneve të kontrollit inspektiv fillestar dhe periudha brenda së cilës merren këto kampione, përcaktohet në marrëveshje me prodhuesin dhe organizmin e autorizuar. Marrja e kampioneve dhe provat kryhen siç tregohet më poshtë.

Vlerësimi i provave fillestare të çimentos, bazohet si mbi rezultatet e provave të autokontrollit, ashtu edhe mbi rezultatet e provave të kontrollit të jashtëm inspektiv të marra në periudhën fillestare. Duke kryer vlerësimin, organizmi i autorizuar harton një raport inspektimi që i bashkëngjitet akteve të prodhuesit.

#### 4. Vlerësimi, miratimi dhe mbikëqyrja e kontrollit të prodhimit

Organizmi i autorizuar kryen vlerësimin, miratimin e sistemit të kontrollit të prodhimit zbatuar nga prodhuesi në fabrikë, për të përfutur produkte sipas ligjit nr.9092, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”.

Organizmi i autorizuar kryen funksionet e veta, si më sipër, të paktën një herë në vit dhe me paralajmërim.

Në vijim të çdo vizite kontrolli, organizmi i autorizuar harton një raport inspektimi që është posaçërisht për drejtuesin e fabrikës, i cili parashikon të gjitha veprimet korrigjuese që duhen ndërmarrë si rezultat i verifikimit.

Zbatimi i veprimeve korrigjuese i komunikohet nga prodhuesi organizmit të autorizuar.

#### 5. Vlerësimi i rezultateve të provave mbi kampionet e autokontrollit

Organizmi i autorizuar verifikon nëse rezultatet e autokontrollit të prodhuesit kënaqin kërkesat e standardit.

Numri i verifikimeve statistikore të kryera nga organizmi i autorizuar, mbi të dhënat në periudhën e kontrollit, është nga 1 deri 3 në vit dhe kryhet sipas marrëveshjeve paraprake.

Periudha e kontrollit është 12 muaj ose e barabartë me periudhën fillestare në rastin e një tipi të ri çimentoje.

Vlera karakteristike është ajo e rendit 0.05 për limitin e poshtëm të rezistencës mekanike dhe e rendit 0.10 për limitet e tjera të rezistencës mekanike, llogaritur sipas shprehjes:

$$f_k = f_m - kS_s$$

$f_k = f_m + k$  (për limitin e sipërm të rezistencës mekanike) ku:

$f_m$  = mesatarja aritmetike e  $n$  rezultateve;

$S_s$  = shmangia kuadratike mesatare e  $n$  rezultateve;

$k$  - faktor i përcaktuar në tabelën 6 të shtojcës 3, në funksion të numrit të rezultateve eksperimentale dhe të përqindjes së popullatës dhe formulimit të rrezikut të tipit 1-a me mbrojtje të njëanshme ku:

= 5% për limitin e poshtëm të rezistencës mekanike;

= 10% për limitin e sipërm të rezistencës mekanike.

Vlerat karakteristike të llogaritura në këtë mënyrë, respektojnë limitet e tabelës 3.

Në alternative përpunohen rezultatet e karakteristikave kimike e fizike (shih S SH EN 197 - 1, pika 9, 5, 2) duke pasur parasysh numurin  $nD$  të rezultateve difektoze të çdo tip prove, në serinë complete të kampioneve të kontrolluara. Duhet që:

$$nD \leq nA$$

ku  $nA$  është numri i pranueshëm i defekteve = 10% që është në funksion të numrit  $n$  të rezultateve të provës që jepet nga tabela 7.

Në rastin kur disa tipe e klasa çimentosh nuk janë shpërndarë në mënyrë të vazhdueshme, frekuencat e mësipërme dhe pikat e marrjes së kampioneve variojnë sipas marrëveshjes paraprake mes organizmit të autorizuar dhe prodhuesit.

#### 6. Provat

Çdo kampion homogjenizohet dhe ndahet në 3 nënkampionë.

Metodat e marrjes së kampionëve duhet të plotësojnë kërkesat sipas S SH EN 196/7.

Një nënkampion trajtohet nga prodhuesi për provat dhe një tjetër ambalazhohet, identifikohet saktësisht nga organizmi i autorizuar dhe dërgohet në një laborator të akredituar në formë anonime.

Nënkampioni i tretë vutose me vula të të dy palëve dhe ruhet nga prodhuesi për një periudhë minimumi tre muaj dhe përdoret në rastet kur:

a) një nga kampionët e parë humbet, dëmtohet ose ndotet;

b) në rast kundërshtimesh janë të nevojshme prova të tjera.

Prishja e vulës së nënkampionit të fundit kryhet nga organizmi i autorizuar dhe, nëse kërkohet, në prani të një përfaqësuesi të prodhuesit të deleguar posaçërisht.

Të dy nënkampionët e parë provohen respektivisht nga prodhuesi dhe organizmi i autorizuar, për cilësitë e çdo tipi dhe klase të çimentos listuar në kolonën 1 dhe 2 të tabelës 1, duke përdorur metodat e provave sipas kolonës 3 të tabelës 1.

##### 6.1. Vlerësimi i rezultateve të provave

Organizmi i autorizuar vërteton që:

- rezultatet e provave të kontrollit të jashtëm nuk janë nën vlerat limite të treguara në tabelën 5;

- ripërpunimi statistikor i rezultateve të provave të brendshme të autokontrollit çon në vlera karakteristike korresponduese me limitet e dhëna në tabelën 3 dhe 4;

- ka përputhje midis rezultateve të provave të autokontrollit të brendshëm dhe atyre të kontrollit të jashtëm sipas procedurës së shtojcës A.

Kur verifikimet e mësipërme rezultojnë negative, organizmi i autorizuar zbaton masat e tabelës 8.

7. Inspektimi fillestar i qendrës së shpërndarjes dhe i sistemit të cilësisë

7.1. Inspektimi i një qendre të re shpërndarje

Organizmi i autorizuar kryen një verifikim fillestar të qendrës së shpërndarjes dhe sistemit të cilësisë.

Me këtë inspektim organizmi i autorizuar:

a) konfirmon që procedurat për kontrollin e cilësisë së shpërndarjes janë sipas rregullores;

b) verifikon që impianti është i përshtatshëm për ruajtjen e cilësisë së çimentos. Inspektimi përfshin kontrollin e sistemit të shkarkimit, impiantin e vendosjes në depozitë, sistemin e marrjes nga depozita dhe të ngarkimit dhe laboratorin. Veçanërisht i kushtohet rëndësi procedurave për evitimin e destinacionit të gabuar të çimentos ose ndotjen midis çimentove të ndryshme.

7.2. Inspektimi i një qendre shpërndarje ekzistuese

Në rastin e shpërndarjes së një tipi apo klase të re çimentoje nga një qendër shpërndarje ekzistuese, organizmi i autorizuar vendos në bazë të modifikimeve të bëra në manualin e cilësisë së impiantit të shpërndarjes, nëse është i nevojshëm një inspektim i veçantë. Në rast se po, organizmi i autorizuar vlerëson se cili nga verifikimet e procedurave është sipas kriterëve të pikave 7.3 e 7.4.

7.3. Kriteret për vlerësimin e qendrës së shpërndarjes

Organizmi i autorizuar vlerëson përshtatshmërinë e qendrës së shpërndarjes në lidhje me procedurat dhe kërkesat e mëposhtme:

a) praninë e një laboratorit në qendrën e shpërndarjes ose marrëveshjen me një laborator të akredituar, për të kontrolluar që një çimento rifuxho e marrë nuk ka pësuar ndryshime dhe i korrespondon çimentos së specifikuar në kontratat e blerjes;

b) marrjen e masave të përshtatshme për të parandaluar ndotjen e çimentove të ndryshme gjatë furnizimit, transportit e depozitimit;

c) magazinimin e çdo çimentoje në një apo me tepër sillose të ndara. Mbi çdo sillos vendoset qartë shënimi për tipin dhe klasën e rezistencës së çimentos, adresat e prodhuesit dhe të fabrikës, si dhe informacione të tjera shtesë.

d) trajtimin e përshtatshëm në pikat e shpërndarjes së çimentos, sipas metodave të përshkruara në S SH EN 196/7

7.4. Kriteret e vlerësimit të laboratorëve

Përshtatshmëria e laboratorëve vendoset në bazë të karakteristikave të mëposhtme:

a) provat e përcaktuara në manualin e cilësisë kryhen në laboratorët e brendshëm me kushtet dhe pajisjet që parashikon standardi, ose në mungesë të tyre, në laboratorë të jashtëm të akredituar;

b) laboratorit që kryen provat e autokontrollit të disponojë të paktën pajisjet e nevojshme për kryerjen e provave mbi vetitë e dhëna në tabelën 2, duke përdorur metodat e provave të përcaktuara, ose metoda ekuivalente.

7.5. Raporti i inspektimit

Organizmi i autorizuar në bazë të një raporti specifik vë në dijeni drejtuesin e qendrës së shpërndarjes për vendimin rreth mbajtjes së markës së konformitetit, në përputhje me pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.723, datë 5.11.2004 “Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmit të autorizuar për kryerjen dhe vlerësimin e konformitetit”.

8. Vlerësimi, miratimi dhe mbikëqyrja e sistemit të kontrollit të qendrës së shpërndarjes

8.1. Detyrat e organizmit të autorizuar

Organizmi i autorizuar kryen vlerësimin, mbikëqyrjen e sistemit të kontrollit të cilësisë së zbatuar nga ndërmjetësi, si dhe i jep ose i heq qendrës së shpërndarjes të drejtën e përdorimit të markës së konformitetit.

## 8.2. Frekuenca e inspektimeve

Organizmi i autorizuar kryen verifikimet e mësipërme të paktën një herë në vit, duke lajmëruar paraprakisht drejtuesin e qendrës së shpërndarjes.

## 8.3. Raporti i inspektimit

Në vijim të çdo vizite kontrolli, organizmi i autorizuar përgatit një raport që ia dërgon drejtuesit të qendrës së shpërndarjes.

Përfaqësuesi i drejtuesit të qendrës së shpërndarjes informon organizmin e autorizuar për çdo veprim korrigjues të ndërmarrë ose të programuar si rezultat i raportit të kontrollit dhe nëse këto veprimet kanë qenë efektive apo jo.

## 9. Vlerësimi i rezultateve të provave në kampionet e autokontrollit për vërtetim

Organizmi i autorizuar verifikon nëse rezultatet e autokontrollit në qendër kënaqin kriteret e konformitetit të S SH EN 197 - 1 dhe që vlerat e marra nuk ndryshojnë në mënyrë të rëndësishme nga vlerat e autokontrollit të kryer në fabrikën që furnizon çimenton.

Numri i verifikimeve statistikore mbi të dhënat relative në periudhën e kontrollit nuk është më i ulët se një verifikim në vit.

Periudha e kontrollit është 12 muaj.

Çdo vlerësim kryhet mbi totalin e rezultateve të provave të autokontrollit të marra gjatë 12 muajve paraardhës nga data e verifikimit.

Rezultatet e provave të autokontrollit të kryera në fabrikën që furnizon çimenton dhe ato të kryera në qendrën e shpërndarjes, vlerësohen nga organizmi i autorizuar në afate të rregullta.

10. Provat mbi kampionet e kontrollit të jashtëm inspektiv të marra pranë qendrës së shpërndarjes

### 10.1. Marrja e kampionit

Kampionet merren kryesisht për të kryer një kontroll për saktësinë e rezultateve të provave të marra nga laboratorit i qendrës së shpërndarjes. Kampionet e sakta merren nën përgjegjësinë e organizmit të autorizuar, në pikën ose pikat e dorëzimit të çimentos, nga qendra e shpërndarjes ose nga ngarkesat e nisura për konsum.

Në fund të marrjes së kampioneve përfaqësuesit të organizmit të autorizuar i lejohet hyrja në çdo moment, pa paralajmërim, në qendrën e shpërndarjes.

### 10.2. Numri i kampionëve

Numri i kampionëve të marra në një vit nuk është me pak se 3 për çdo tip e klasë rezistence të çimentos së shpërndarë nga qendra e shpërndarjes.

### 10.3. Provat

Çdo kampion homogjenizohet dhe ndahet në tre nënkampionë.

Metodat e marrjes së kampionëve të përdorur për marrjen dhe përgatitjen e kampionëve plotësojnë kërkesat e S SH EN - 196 - 7.

Një nënkampion trajtohet nga qendra e shpërndarjes për provat dhe një tjetër ambalazhohet dhe identifikohet qartë, nën kujdesin e organizmit të autorizuar dhe nga këtu dërgohet në një laborator të akredituar në formë anonime.

Nënkampioni i tretë vulozet dhe ruhet nga qendra e shpërndarjes për një periudhë minimumi 3 muaj dhe përdoret në rastet kur:

a) një nga dy nënkampionët humbet, dëmtohet ose ndotet;

b) janë të nevojshme prova shtesë në rast mospërputhesh.

Përdorimi i nënkampionit të fundit kryhet nën kujdesin e organizmit të autorizuar në prezencë, nëse kërkohet, të një përgjegjësi të qendrës së shpërndarjes.

Dy nënkampionet e para provohen respektivisht nga qendra e shpërndarjes dhe organizmi i autorizuar, për vetitë e çdo tipi e klase çimentoje, të cilësuara në kolonat 1 dhe 2 të tabelës 2, duke përdorur metodat e provave të përcaktuara në kolonën 3 të tabelës 2.

## 11. Dëshmia e konformitetit

### 11.1. Të përgjithshme

Konformiteti i një çimentoje me standardet tregohet në një dëshmi konformiteti.

Dëshmia e konformitetit lëshohet nga organizmi i autorizuar, i cili e kryen veprimtarinë e tij mbështetur në vendimin nr.723, datë 5.11.2004 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat dhe

rregullat bazë të funksionimit të organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit”, që i lejon prodhuesit të përdorë markën e konformitetit.

Të gjitha procedurat deri në lëshimin e dëshmisë së konformitetit e më pas, organizmi i autorizura i kryen mbështetur në aktet e mësipërme.

Kur prodhimi i një produkti për të cilin është dhënë dëshmia e konformitetit ndërpritet, prodhuesi njofton organizmin e autorizuar brenda 15 ditëve nga data e ndërprerjes. Organizmi i autorizuar në këtë rast e pezullon dëshminë e konformitetit për një periudhë jo më shumë se 6 muaj. Me rifillimin e prodhimit, dëshmia rivendoset vetëm nëse provat mbi kampionët e marrë dalin pozitive.

Nëse bëhet fjalë për prodhimet stinore (shitur për një periudhë kohe të vitit 3-6 muaj në vazhdim), dëshmia e konformitetit lëshohet për herë të parë, siç parashikohet në rregullore. Organizmi i autorizuar dhe prodhuesi merren vesh për frekuencën e autokontrollit. Në periudhën e prodhimit organizmi i autorizuar kryen të paktën 3 marrje kampioni. Për vitet në vijim, dëshmia e parë jepet vetëm nëse provat mbi kampionët e parë të marrë nga jashtë dalin pozitive. Prodhuesi informon organizmin e autorizuar për zgjatjen e supozuar të prodhimit stinor dhe regjistron fillimin e shpërndarjes të paktën 30 ditë para fillimit të vetë shpërndarjes ose përfundimin e tyre brenda 15 ditëve nga vetë përfundimi.

Organizmi i autorizuar azhurnon listën e dëshmimeve të lëshuara, listë e cila i dërgohet çdo vit Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Policisë së Ndërtimit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

#### 11.2. Dhënia e dëshmisë për produkte të veçanta

Veç një tipi ose klase rezistence të caktuar të çimentos, e cila prodhohet në një fabrikë për të cilën prodhuesi ka marrë dëshmi konformiteti në të njëjtën fabrikë mund të prodhohet çimento e veçantë që ka përbërje, veti fizike ose kimike, ose rezistencë në shtypje të ndryshme dhe për të cilën prodhuesi kërkon që të vlerësohet, certifikohet dhe identifikohet si çimento e ndryshme. Në këtë rast dëshmia e konformitetit jepet në bazë të provave të autokontrollit dhe kampioni i parë për provat e kontrollit të organizmit të autorizuar analizohet nga laboratorit i provave.

#### 11.3. Ndërprerja e prodhimit

Prodhuesi i cili ndërpret përfundimisht prodhimin e një tipi të veçantë çimentoje ose të një klase të caktuar të rezistencës, informon organizmin e autorizuar, i cili e anulon dëshminë e konformitetit.

#### 11.4. Certifikata SL e konformitetit dhe deklarata SL e konformitetit

Në rastin kur shihet që është plotësuar sistemi i vërtetimit të konformitetit sipas paragrafit 7 të S SH EN 197 —2, trupi certifikues lëshon një certifikatë konformiteti SL, me informacionin e treguar më poshtë. Kjo certifikatë i jep të drejtë prodhuesit që të vendosë markën SL (sipas ligjit).

Certifikata e konformitetit SL do të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- Emrin dhe adresën e trupit certifikues.
  - Emrin dhe adresën e prodhuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar dhe vendin e prodhimit.
  - Përshkrimin e produktit (emërtimi standard i çimentos sipas S SH EN 197 — 1 dhe ndonjë identifikim tjetër shtesë i kërkuar).
  - Kushtet që duhet të plotësojë produkti (shtojca ZA e S SH EN 197 — 1, në konformitet sipas S SH EN 197 — 2, siç jepet në shtojcën ZA të S SH EN 197—1).
  - Kushte të veçanta të zbatueshme gjatë përdorimit të produktit (asnjë lidhur me konformitetin).
  - Numrin e certifikatës.
  - Kushtet dhe periudhën e vlefshmërisë së certifikatës, atje ku ajo është e zbatueshme.
  - Numrin dhe pozicionin e mbajtur nga personi i cili firmos certifikatën.
- Veç këtyre, për çdo produkt që përfaqësohet nga një certifikatë e konformitetit SL, prodhuesi duhet të lëshojë një deklaratë konformiteti, që përfshin informacionin e mëposhtëm:
- Emrin dhe adresën e prodhuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar.
  - Numrin e certifikatave të konformitetit SL të marra.

- Emrin dhe pozicionin e personit që firmos deklaratën në emër të prodhuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar.

#### 11.5. Vendorsja e markës SL të konformitetit

##### 11.5.1. Çimentoja e paketuar në thasë

Në rastin e çimentove të paketuara në thasë, vendorsja e shenjës së konformitetit SL, numrit të identifikimit të organit certifikues dhe çdo informacion tjetër shoqërues që tregohet më poshtë, duhet të vendoset mbi thes ose në dokumentet tregtare shoqëruese, ose në një kombinim të tyre. Nëse mbi thes nuk shënohet i gjithë informacioni, por veç një pjesë e tij, atëhere informacioni i plotë duhet të jepet në dokumentet tregtare shoqëruese.

SL 0123
Ndonjë kompani Adresa e regjistruar Fabrika 4 Viti 01 (ose data e vulosjes) 01 23-C PD-0456 S SH EN 197-1 CEM 1 42,5R
Informacion shtesë

**SL** — Vendorsja e shenjës së konformitetit SL konsiston në simbolin “SL” sipas vendimit nr.723, datë 5.11.2004 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizimit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit”.

**0123** - Numri i identifikimit të organit certifikues

**Ndonjë kompani** — emri ose shenja identifikuese e prodhuesit

**Adresa e regjistruar** — Adresa e regjistruar e prodhuesit

**Viti 01** — Dy shifrat e fundit të vitit në të cilën është vendosur marka

**0123 — CPD — 0456** - Numri i certifikatës SL të konformitetit

**S SH EN 197-1** — Numri i standardit europian

**CEM 1 42,5 R** — Shembulli i një emërtimi standard që tregon produktin e çimentos dhe klasën e rezistencës, siç jepet në paragrafin 8 të S SH EN 197—1

#### **Informacion shtesë:**

Limiti për kloruret në % - Vetëm kur çimento e zakonshme e prodhuar ka një përmbajtje limit kloruresh të ndryshme nga vlera e përcaktuar në tabelën 3 të S SH EN 197 -1.

Limiti për humbjet në kalcinim të hirit fluturues në % - Vetëm kur në lidhje me 5.2.4.1 të S SH EN 197-1, është përdorur hi fluturues me humbjet në kalcinim në kufijtë nga 5% - 7%.

Shënim standard për shtesat — Vetëm kur në lidhje me 5.5 të S SH EN 197-1, është përdorur një përzierje në përputhje me serinë EN 934.

Për arsye praktike mund të zgjidhet ndonjë nga alternativat e mëposhtme, për të paraqitur informacionin mbi thasët e çimentos:

a) Kur mbi thes tregohet vetëm shenja SL, atëhere elementet e mëposhtme të informacionit shoqërues, jepen në dokumentet tregtare shoqëruese në vend që të jepen mbi thes:

- emri ose shenja identifikuese e fabrikës
- viti i vendorsjes së shenjës SL,
- numri i certifikatës së konformitetit SL,
- informacion shtesë.

b) Në rastin kur dy shifrat e fundit të vitit në të cilin është vendosur shenja SL janë stampuar me parë mbi thes, ky i fundit shoqërohet me datën e saktë të vendorsjes së shenjës  $\pm 3$  muaj.

c) Në rastin kur dy shifrat e fundit të vitit në të cilin është vendosur shenja nuk janë stampuar më parë mbi thes, atëhere këto do të vendosen me anën e një stampuesi datash në një vend të dukshëm të qartë. Ky vend tregohet në informacionin shoqërues.

Produkti duhet të shoqërohet në formë të përshtatshme, me një dokumentacion ku jepet ndonjë legjislacion për substancat e dëmshme për të cilat kërkohet aprovim, së bashku me ndonjë informacion të kërkuar nga ai legjislacion, kur dhe ku kërkohet.

#### 11.5.2. Çimentoja rifuxho

Në rastin e çimentos rifuxho, vendosja e markës SL të konformitetit, numrit të identifikimit SL, numrit të identifikimit të organit certifikues dhe informacionit shoqërues siç jepet për çimentot e paketuara në thasë (11.5.1), bëhet në një formë të përshtatshme në dokumentet tregtare shoqëruese.

#### 11.6. E drejta e përdorimit të markës së konformitetit

Ndërmjetësi i cili administron qendrën e shpërndarjes dhe që plotëson detyrimet që rrjedhin nga pikat paraardhëse, përdor markën e konformitetit në produktet e shpërndara, pas autorizimit të prodhuesit përkatës dhe organizmit të autorizuar, i cili ka dhënë dëshminë e konformitetit për produktet përkatëse.

### 12. Procedura në rastin e moskonformitetit

#### 12.1. Përgjegjësia e prodhuesit

Veprimet korigjuese që ndërmerren në rast të një moskonformiteti, kryhen nën përgjegjësinë e plotë të prodhuesit, i cili dokumenton aktivitetin që kryen në mënyrë të detajuar dhe ia paraqet organizmit të autorizuar.

### 13. Veprimet e organizmit të autorizuar ndaj prodhuesit

#### 13.1. Kontrolli i prodhimit dhe autokontrolli

Organizmi i autorizuar ndërmerr veprime eventuale ndaj prodhuesit për shkak të vlerësimit, aprovimit dhe mbikëqyrjes së sistemit të cilësisë së prodhimit dhe të vlerësimit të rezultateve të provave të autokontrollit, në bazë të vlerësimit rast për rast të raporteve relative. Në rast se rezultatet e provave të autokontrollit të prodhuesit tregojnë se kriteret e konformitetit nuk janë plotësuar, veprimet që ndërmerr organizmi i autorizuar janë ato të treguara në tabelën 8.

#### 13.2. Kontrolli i jashtëm

1. Nëse kontrollet e kryera tregojnë diferenca për shkak të gabimeve të kampionit ose të provës, identifikohen arsyet. Organizmi i autorizuar përcakton nëse janë ndërmarrë veprimet e përshtatshme për korigjimin e këtyre diferencave dhe tregon veprimet e mundshme të mëtejshme, në mënyrë që të korigjohen të gjitha rezultatet relative.

2. Nëse rezultatet e kontrollit të jashtëm inspektiv japin rezultate të provave jashtë vlerave karakteristike, organizmi i autorizuar vlerëson rezultatet e provave të autokontrollit të prodhuesit për një periudhë të mjaftueshme dhe jo më pak se 12 muaj dhe njofton organizmin e certifikimit. Nëse provat e autokontrollit janë të kënaqshme nuk ndërmerren veprime të tjera. Nëse provat e autokontrollit tregojnë moskonformitet statistikor, organizmi i autorizuar ndërmerr veprimet e parashikuara në tabelën 8.

3. Nëse rezultatet e provave të kontrollit të jashtëm inspektiv nuk kënaqin kërkesat e parashikuara për vlerat limite (tabela 3), organizmi i autorizuar ndërmerr veprimet e parashikuara në tabelën 8.

4. Rezultatet e provave të përmendura më sipër në pikat 2 e 3, janë ato të marra pas realizimit të ndërhyrjeve të mundshme korigjuese sipas pikës 1.

#### 13.3. Përgjegjësia e ndërmjetësit

Veprimet korigjuese që ndërmerren në rast të një moskonformiteti pranë qendrës së shpërndarjes, kryhen nën përgjegjësinë e plotë të ndërmjetësit, i cili dokumenton aktivitetin e kryer në mënyrë të hollësishme dhe të miratuar nga organizmi i autorizuar.

#### 13.4. Veprimet e organizmit të autorizuar ndaj ndërmjetësit

Kushtet e pikave 13.1 dhe 13.2 që i referohen fabrikave vlejné edhe për qendrat e shpërndarjes, përveç veprimeve që ndërmerren nga organizmi i autorizuar që në këtë rast nuk i referohen tabelës 8, por kryhet një ekzaminim në vend nga vetë organizmi i autorizuar për të stabilizuar moskonformitetin.

Organizmi i autorizuar i heq të drejtën e përdorimit të markës ndërmjetësit, në qoftë se vërehen kushte që nuk garantojnë mbajtjen e karakteristikave origjinale të produktit dhe/ose konstatohen veprime të qëllimshme. Ky veprim i komunikohet prodhuesit.

**SHTOJCA A**  
**VLERËSIMI I PËRFAQËSUESHMËRISË DHE I PËRPIKMËRISË SË**  
**REZULTATEVE TË PROVAVE TË REZISTENCËS**  
**MEKANIKE NË SHTYPJE PAS 28 DITËSH**

**A.1 E përgjithshme**

Kjo shtojcë përshkruan procedurat që duhet të përdoren për të vlerësuar përfaqësueshmërinë dhe përpikmërinë e rezultateve të provave të rezistencës 28-ditore. Vlerësimi është mirë të kryhet në rastin e inspektimit vjetor nga organi inspektues.

**A.2 Grupi i rezultateve të marra në konsideratë**

Procedura vlerësuese merr në konsideratë tri grupet e rezultateve të provave:

A — rezultatet e provave të autokontrollit gjatë periudhës së marrë në konsideratë.

B — rezultatet e provave të kryera nga prodhuesi në mostrat e marra për testimin kontrollues.

C — rezultatet e provave të kryera në laboratorin e provave në mostrat e marra për testimin kontrollues.

Numri i rezultateve për çdo grup B dhe C është minimumi 6. Ato duhet të shpërndahen në mënyrë të barabartë në të gjithë periudhën që merret në konsideratë.

**A. 3 Procedura vlerësuese**

**A.3.1. Hyrje**

Procedura vlerësuese përfshin dy pjesë, siç përshkruhet në A.3.3. dhe A.3.4., për çimenton për muraturë shih gjithashtu A.3.5. Simbolet e përdorura janë listuar në A.3.2.

**A.3.2 Simbolet**

Simbolet e përdorura në A.3.3. — A.3.5. janë dhënë në tabelën A<sub>1</sub>.

Tabela A<sub>1</sub> — Simbolet

<b>Simboli</b>	<b>Kuptimi</b>
M <sub>A</sub>	Është mesatarja e të gjitha rezultateve të testimit të autokontrollit gjatë periudhës që merret në konsideratë.
M <sub>B</sub>	Është mesatarja e rezultateve të provave të kryera nga prodhuesi në mostrat e marra për testim kontrollues.
M <sub>C</sub>	Është mesatarja e rezultateve të provave të kryera nga laboratorit testues në mostrat e marra për testim kontrollues.
N <sub>B</sub>	Është numri i mostrave të marra për testim kontrollues.
S <sub>A</sub>	Është devijimi standard i të gjitha rezultateve të testimit të autokontrollit gjatë periudhës së marrë në konsideratë.
S <sub>D</sub>	Është devijimi standard i diferencave ndërmjet rezultateve korresponduese të mostrave të marra për testim kontrolli siç përcaktohet nga $d_i = B_i - C_i$ Ku B <sub>i</sub> është rezultati i provës individuale nga prodhuesi. C <sub>i</sub> është rezultati i provës individuale korresponduese nga laboratorit testues. $S_D = [(\sum d_i^2 - (\sum d_i)^2 / (N_B - 1))]^{1/2}$

A.3.3 Vlerësimi nëse grupi A dhe B i takojnë të njëtit popullim (kontrolli i marrjes së gabuar të mostrës).

a) Kur  $|M_A - M_B| \leq 2,0^2$  Mpa,

Dy grupet e rezultateve mund të konsiderohet që i takojnë të njëtit popullim.



b) Kur  $|M_A - M_B| > 2,0^2$  Mpa,

Nëse  $|M_A - M_B| \leq 2,58 \times S_a / (N_B)^{1/2}$

Dy grupet e rezultateve mund të konsiderohet që i takojnë të njëjtit popullim.

Nëse  $|M_A - M_B| \leq 2,58 \times S_a / (N_B)^{1/2}$

Arsyeja duhet të identifikohet nga prodhuesi. Në këtë rast, dy grupet e rezultateve të provave mund të konsiderohet që i takojnë popullimeve të ndryshme me një nivel besueshmërie 99%, siç përshkruhet në ISO 2854.

A.3.4. Krahasimi ndërmjet grupeve B dhe C me qëllim kontrollin e përpikmërisë së testimit të autokontrollit (kontrolli i gabimit të testimit).

Duhet të kënaqen dy kushte:

a)  $S_D < 3,4^2$  MPa

b)  $|M_A - M_B| < 4,0^2$  Mpa

Nëse njëra ose të dyja nga këto kondita nuk kënaqen, arsyet identifikohen nga prodhuesi dhe organizmi akreditues.

A.3.5. Çimentoja për muraturë

Për çimenton për muraturë (S SH EN 413— 1), në vend të vlerave të dhëna në A.3.3. dhe A.3.4, zbatohen kriteret e mëposhtme numerike:

KRITERET	ÇIMENTO MURATURË, TIPI/KLASA		
	MC5	MC12.5/MC12.5X	MC22.5X
$ M_A - M_B $	1.0	1.4	2.0
$S_D$	1.7	2.4	3.4
$ M_B - M_C $	2.0	3.0	4.0

2) Këto vlera janë të zbatueshme për çimenton sipas S SH EN 197 — 1.

Vlerat për çimenton e muraturës janë dhënë në A.3.5. Vlerat për çimentot e tjera mund të tregohen në standardin specifik të produktit përkatës.

## SHTOJCA B (INFORMATIVE) EMËRTIME TË PËRGJITHSHME

B.1. Emërtime nga S SH EN 197—1, 2

B. 1.1 Tipi i çimentos së zakonshme

Një nga 27 produktet e familjes së çimentos (sipas tabelës te S SH EN 197-1).

B.1.2. Klasa e rezistencës së çimentos

Klasa e rezistencës në shtypje.

B.1.3. Prova e autokontrollit

Prova të vazhdueshme nga ana e prodhuesit të mostrave të veçanta të çimentos të marra në pikën (ose pikat) e daljes nga fabrika/depozita.

B. 1.4. Periudha e kontrollit

Periudhë prodhimi dhe shpërndarjeje e kryer për të vlerësuar rezultatet e provës së autokontrollit.

B. 1.5. Vlera karakteristike

Vlera e një cilësie të kërkuar, jashtë së cilës shtrihet një përqindje e caktuar  $P_k$  e të gjitha vlerave të shpërndarjes.

B. 1.6. Vlera karakteristike e specifikuar

Vlera karakteristike e një vetie mekanike, fizike ose kimike, e cila në rastin e një limiti të sipërm nuk duhet të kalojë ose në rastin e një limiti të poshtëm është minimumi që mund të arrihet.

B. 1.7. Vlera limite e një rezultati të vetëm

Vlera e një vetie mekanike, fizike ose kimike, e cila — për një rezultat të vetëm prove në rastin e një limiti të sipërm nuk duhet të kalojë ose në rastin e një limiti të poshtëm është minimumi që mund të arrihet.

#### B. 1.8 Propabiliteti i lejuar i pranimit CR

Për një plan të dhënë të marrjes së mostrës, propabiliteti i lejuar i pranimit të çimentos me një vlerë karakteristike jashtë vlerës karakteristike të specifikuar.

#### B. 1.9 Plani i marrjes së mostrës

Plan specifik i cili saktëson përmasën (përmasat) (stastistikore) të mostrës që do të merret, përqindjen  $P_k$  dhe propabilitetin e lejuar të pranimit CR.

#### B. 1.10. Mostër e veçantë

Mostër e marrë në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend. Ajo mund të përftohet nga kombinimi i një apo më tepër marrjeve të njëpasnjëshme.

#### B. 1.11. Certifikata e konformitetit

Dokument i cili jepet për vlerësimin e konformitetit sipas rregullave të skemës, tregon se është siguruar besueshmëri e mjaftueshme që çimentoja të jetë në konformitet me standardin specifik të produktit përkatës.

#### 8.1.12. Shenja e konformitetit

Shenjë e mbrojtur që përdoret në bazë të certifikatës së konformitetit.

#### B. 1.13. Çimento e certifikuar

Çimento për të cilën jepet një certifikatë konformiteti.

#### 8.1.14. Periudhë fillestare

Periudhë ndërmjetëse pas lëshimit të parë të certifikatës së konformitetit për një çimento.

#### B. 1.15. Organizëm certifikues

Organizëm i paanshëm, qeveritar ose joqeveritar, që ka kompetencën dhe përgjegjësinë e nevojshme për të dhënë certifikatën e konformitetit sipas rregullave të procedurave dhe menaxhimit.

#### B.1.16. Kontrolli i produktit në fabrikë

Kontrolli i brendshëm i përhershëm i prodhimit të çimentos, i ushtruar nga prodhuesi, që përbëhet nga kontrolli i brendshëm i cilësisë i plotësuar nga provat e autokontrollit.

#### B.1.17. Fabrikë

Mjetet e përdorura nga prodhuesi për prodhimin e çimentos, duke përdorur pajisje të përshtatshme për një prodhim në masë dhe të vazhdueshëm të saj, duke përfshirë në veçanti pajisjet, për një bluarje dhe homogjenizim të mjaftueshëm dhe kapacitetin e nevojshëm të sillozit, për magazinimin dhe shpërndarjen e çdo tipi çimentojeje të prodhuar. Këto pajisje dhe kontrolli i aplikuar i prodhimit sigurojnë kontrollin e produktit me saktësi të mjaftueshme në mënyrë që të sigurohet plotësimi i kërkesave të standardit specifik të produktit përkatës.

#### B. 1.18 Fabrikë e re

Fabrikë e cila akoma nuk prodhon çimento të certifikuar sipas kësaj skeme.

#### B.1.19 Depo

Mjet i trajtimit me shumicë të çimentos (i palokalizuar në fabrikë) e cila përdoret për shpërndarjen e çimentos (rifuxho ose e paketuar) pas transferimit ose depozitimit, ku prodhuesi ka përgjegjësinë e plotë për të gjitha problemet e cilësisë së çimentos.

#### B. 1.20 Qendër shpërndarjeje

Mjet i trajtimit me shumicë të çimentos (i palokalizuar në fabrikë) e cila përdoret për shpërndarjen e çimentos, pas transferimit ose depozitimit, ku ndërmjetësi ka përgjegjësi të plotë për të gjitha problemet e cilësisë së çimentos.

#### B. 1.21. Ndërmjetës

Person fizik ose juridik i cili merr me shumicë nga prodhuesi çimento, të certifikuar sipas S SH EN 197 — 2, me shenjën e konformitetit, që merr përgjegjësi të plotë për të gjitha problemet e cilësisë së çimentos, për ruajtjen në një vend trajtimi me shumicë dhe furnizon me çimento persona të tjerë.

#### B.1.22. Konfirmimi i provave të autokontrollit

Testim i vazhdueshëm, kryer nga një ndërmjetësi, që konsiston në testimin e mostrave të marra prej tij në pikat e furnizuara prej qendrës së shpërndarjes.

B.1.23. Manuali i cilësisë së fabrikës

Dokument, i cili jep informacion mbi kontrollin e produktit në fabrikë nga prodhuesi, në mënyrë që të sigurohet konformiteti i çimentos me kërkesat e standardit specifik të produktit përkatës.

**VENDIM**  
**Nr.279, datë 18.4.2007**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PRODUKTEVE TË NDËRTIMIT, PËR TË CILAT  
KËRKOHEM VLERËSIMI I DETYRUAR I KONFORMITETIT**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.756, datë 15.9.2010)*

*I përditësuar*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.9097, datë 3.7.2003 “Për vlerësimin e konformitetit” dhe të neneve 5, 6, 7 e 10 të ligjit nr.9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së produkteve të ndërtimit dhe kryerjen e vlerësimit të detyruar të konformitetit, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Çdo person fizik e juridik, vendas dhe i huaj, që prodhon dhe tregton materiale ndërtimi, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përpara hedhjes në treg të tyre, duhet të kryejë vlerësimin e konformitetit, në rast se nuk janë të shoqëruara me markën e konformitetit.
3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Lidhja 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.68, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.59, faqe 1532*

*Vendim i KM nr.756, datë 15.9.2010 botuar në Fletoren Zyrtare nr.132, faqe 7002*

**LISTA E PRODUKTEVE TË NDËRTIMIT QË I NËNËSHTROHEN VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT**

<b>Nr. Rendor</b>	<b>Emërtimi i familjes së produktit</b>	<b>Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të</b>
<b>I. Produktet e ndërtimit për betonin dhe beton-armenë.</b>		
1	Shtesat për beton, llaç dhe bojak. Shtesat e betonit. Pjesa 2: Përcaktimet, kërkesat, konformiteti, markimi dhe etiketimi.	S SH EN 934-2
2	Shtesat për beton, llaç dhe bojak (llaç për mbushje). Pjesa 3: Shtesat për llaçe të mureve. Përkufizimet, kërkesat, konformiteti markimi dhe etiketimi.	S SH EN 934-3
3	Elementët shtesë për beton, llaç dhe bojak (llaç për mbushje). Pjesa 4: Elementët shtesë për bojak për tirantat e paranderura. Përkufizimet, kërkesat, konformiteti, markimi dhe etiketimi.	S SH EN 934-4
4	Blloqe betoni për shtresë. Kërkesat dhe metoda të provave. (*)	S SH EN 1338
5	Pllaka betoni për shtresë. Kërkesat dhe metoda të provave. (*)	S SH EN 1339
6	Bordura prej betoni të trotuareve. Kërkesat dhe metoda të provave. (*)	S SH EN 1340
7	Produktet dhe sistemet për mbrojtjen dhe riparimin e strukturave të betonit. Përcaktimet, kërkesat, kontrolli i cilësisë dhe vlerësimi i konformitetit. Pjesa 2: Sistemet e mbrojtjes së sipërfaqes për beton.	S SH EN 1504-2
8	Produkte të parafabrikuar betoni-arme, me inerte të lehtë, me struktura të hapura.	S SH EN 1520
9	Tubat dhe aksesorët prej betoni, prej betoni të armuar dhe prej betoni me fibra çeliku.	S SH EN 1916
10	Materiale inerte për prodhimin e betoneve.	S SH EN 12620
11	Produkt parafabrikate prej betoni. Elementë për rrethime.	S SH EN 12839
<b>II. Produktet e ndërtimit për punimet e muraturës.</b>		
12	Çimento. Pjesa 1: Përbërja, specifikimet dhe kriteret e konformitetit për çimenton e zakonshme.	S SH EN 197-1
13	Çimento. Pjesa 4: Përbërja, karakteristikat dhe kriteret e konformitetit për çimentot me rezistencë të ulët për kohë të shkurtër.	S SH EN 197-4
14	Çimento për muraturë. Pjesa 1: Specifikime.	S SH EN 413-1

<b>Nr. Rendor</b>	<b>Emërtimi i familjes së produktit</b>	<b>Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të</b>
15	Gëlqere për ndërtim. Pjesa 1 : Përkufizime, specifikime dhe kriteri i konformitetit.	S SH EN 459-1
16	Specifikimet për njësitë e muraturës. Pjesa 1: Njësi murature prej argjile.	S SH EN 771-1
17	Specifikimet për elementët e muraturës. Pjesa 2: Njësi e muraturës prej silikati të kalçiumit(tullat silikate).	S SH EN 771-2
18	Specifikimet për njësitë e muraturës. Pjesa 3: Njësi murature prej agregatësh betoni. (Agregatë të rëndë e të lehtë)	S SH EN 771-3
19	Specifikimet për elementët e muraturës. Pjesa 4: Elementë muri prej betoni poroz.	S SH EN 771-4
20	Specifikimet për njësitë e muraturës. Pjesa 5: Njësi murature guri të fabrikua.	S SH EN 771-5
21	Specifikime për llaç murature. Pjesa 1: Llaç i ngurtësuar dhe i suvatuar.	S SH EN 998-1
22	Specifikime për llaçin e muraturës. Pjesa 2: Llaç murature.	S SH EN 998-2
23	Çimento. Përbërja, specifikime dhe kriteret konformiteti për çimento speciale me termicitet të ulët.	S SH EN 14216
24	Çimento, Përbërja, specifikimet dhe kriteret e konformitetit për çimentot speciale me termicitet shumë të ulët.	S SH EN 14396
<b>III. Produktet e drurit në ndërtim dhe konstruksionet prej lënde druri.</b>		
25	Produkte per izolim termik te godinave. Produkte prej lesh druri.(WW) Karakteristikat.	S SH EN 13168
26	Pllaka me bazë druri për konstruksione. Karakteristikat, vlerësimi I konformitetit dhe markimi.	S SH EN 13986
<b>IV. Produktet në ndërtim për konstruksione metalike.</b>		
27	Kollona ndriçimi. Pjesa 5: Kërkesat për kollonat e ndriçimit prej çeliku.	S SH EN 40-5
28	Kolonat e ndriçimit. Pjesa 6: Kërkesat për kolonat e ndriçimit prej alumini.	S SH EN 40-6
29	Kolonat e ndriçimit. Pjesa 7:Kërkesat për fibrat e përforcuara me polimerë të përbërë të kolonave të ndriçimit	S SH EN 40-7
30	Veshjet me shirit çeliku per tendosjen e kablllove. Terminologjia, kërkesat, kontrolli i cilësisë.	S SH EN 523
31	Produkte të laminuar në të nxehtë prej çeliqesh për konstruksione, të palidhur. Kushtet teknike të lëvrimit.	S SH EN 10025-1

<b>Nr. Rendor</b>	<b>Emërtimi i familjes së produktit</b>	<b>Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të</b>
<b>V. Materialet dhe produktet për izolimin termik, akustik, materiale të papërshkueshëm nga uji, lidhesat &amp; mbrojtësat e ndryshëm.</b>		
32	Produkte për izolim termik për ndërtesat. Produkte të fabrikuara prej leshi mineral. Specifikime.	S SH EN 13162
33	Produkte për izolim termik për ndërtesat. Prodhime polistireni të bymyer të fabrikuara. Karakteristikat.	S SH EN 13163
34	Produkte për izolim termik në ndërtim. Prodhime prej polistireni të shkumëzuara, të fabrikuara. Karakteristikat.	S SH EN 13164
35	Produkte për izolim termik të godinave. Produkte të prodhuara prej shkume të ngurtë prej poliuretani (PUR) Karakteristikat.	S SH EN 13165
36	Produkte për izolim termik të godinave. Shkumë fenolike. (PF) Karakteristikat.	S SH EN 13166
37	Produkte për izolim termik të godinave. Produkte të qelqit celular.(CG) Karakteristikat.	S SH EN 13167
38	Produkte për izolim termik për ndërtesa. Produkte të parafabrikuara prej perlitit të bymyer. Specifikime.	S SH EN 13169
39	Produkte për izolim termik për ndërtesa. Produkte prej tape të bymyer, të fabrikuar (ICB). Karakteristikat.	S SH EN 13170
40	Produkte për izolim termik për ndërtesa. Produkte prej fibrash druri të fabrikuar (ICB). Specifikime.	S SH EN 13171
41	Lidhësit, lidhësit e përbërë dhe përzieriet e prodhuara në fabrikë me bazë sulfat kalçiumi për shtresat e holla. Pjesa 1: Përcaktimet dhe kërkesat.	S SH EN 13454-1
42	Fletët fleksibël për hidroizolim. Fletët prej bitumi të armuar për hidroizolim hermetik. Përcaktimet dhe karakteristikat.	S SH EN 13707
43	Fletë fleksibël për hidroizolim. Përcakimet dhe karakteristikat e nënshtresave. Pjesa 2: Nënshtresat për muret.	S SH EN 13859 -2
44	Fletë fleksibël për hidroizolim. Fletët plastike dhe prej gome për hermetizim të lagështisë, duke përfshirë fletën plastike dhe prej gome të bazamentit të depozitës. Përcaktimet dhe karakteristikat.	S SH EN 13967

<b>Nr. Rendor</b>	<b>Emërtimi i familjes së produktit</b>	<b>Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të</b>
45	Fletët fleksibël për hidroizolim. Fletët prej bitumi për hermetizim të lagështisë, duke përfshirë fletët prej bitumi të bazamentit të depozitës. Përcaktimet dhe karakteristikat.	S SH EN 13969
46	Fletë fleksibël për hidroizolim. Shtresat prej bitumi për kontrollin e avullit të ujit. Përcaktimet dhe karakteristikat.	S SH EN 13970
47	Fletë fleksibël për hidroizolim. Shtresat plastike dhe prej gome për kontrollin e avullit të ujit. Përcaktimet dhe karakteristikat.	S SH EN 13984
<b>VI. Produktet e ndërtimit për impiantet inxhinierike të pastrimit të ujrave, lëngjeve dhe sistemet e shpërndarjes së gazit.</b>		
48	Tubat prej fibre çimentoje për kullimin dhe shkarkimin e ujrave të zeza. Pjesa 2: Puseta e hyrjes dhe kontrollit.	S SH EN 588-2
49	Guarnicione hermetizuese prej gome. Specifikime për materialet për guarnicionet hermetizues për bashkimet e tubacioneve, që përdoren për ujin dhe për drenazhim. Pjesa 1: Goma e vullkanizuar.	S SH EN 681-1
50	Guarnicione hermetizuese prej gome. Specifikime për materialet për guarnicionet hermetizues për bashkimet e tubacioneve, që përdoren për ujin dhe për drenazhim. Pjesa 2: Elastomeret termoplastike.	S SH EN 681-2
51	Guarnicione hermetizuese prej gome. Specifikime për materialet për guarnicionet hermetizues për bashkimet e tubacioneve, që përdoren për ujin dhe për drenazhim. Pjesa 3: Materialet celulare të gomës së vullkanizuar.	S SH EN 681-3
52	Guarnicione hermetizuese prej gome. Specifikime për materialet për guarnicionet hermetizues për bashkimet e tubacioneve, që përdoren për ujin dhe për drenazhim. Pjesa 4: Elementet hermetizues prej poliuretani të derdhur.	S SH EN 681-4
53	Guarnicione elastomerë. Kërkesat e materialeve për guarnicionet që përdoren në tuba dhe rakorderitë që transportojnë gaz dhe hidrokarburë të lëngët.	S SH EN 682
54	Tubat dhe rakorderitë e tubave prej çeliku të galvanizuar në të nxehtë dhe me saldim gjatësor, me bokull bashkuese për sistemet e ujrave të shkarkimit. Pjesa 1: Kërkesat, provat, kontrolli i cilësisë. (*)	S SH EN 1123-1
55	Tubat dhe rakorderitë e tubave prej çeliku inoksidabël dhe me saldim gjatësor, me bokull bashkuese për sistemet e ujrave të shkarkimit. Pjesa 1: Kërkesat, provat, kontrolli i cilësisë. (*)	S SH EN 1124-1
56	Ventilat e futjes së ajrit për sistemet e drenazhimit. Kërkesat, metodat e provës dhe vlerësimi i konformitetit. (*)	S SH EN 12380
57	Sisteme të vogla të trajtimit të shkarkimeve ujore për deri 50pt. Pjesa 1: Rezervuarë septikë të parafabrikuar.	S SH EN 12566-1

<b>Nr. Rendor</b>	<b>Emërtimi i familjes së produktit</b>	<b>Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të</b>
58	Sistemet për zbulimin e rrjedhjeve. Pjesa 1: Parime të përgjithshme.	S SH EN 13160-1
59	Gjeotekstilet dhe produktet që kanë lidhje me gjeotekstilet. Karakteristikat që kërkohen për përdorimin në projektet e depozitimeve të mbeturinave të lëngëta.	S SH EN 13265
60	Lidhëse për veshje izoluese magnezite. Hidroksid magnezi dhe klorur magnezi. Pjesa 1: Përcaktimet, kërkesat	S SH EN 14016-1
<b>VII. Materiale speciale, produkte, strukturat dhe pajisje të ndryshme.</b>		
61	Tjegulla dhe elementë betoni, specifikimet e prodhimeve.	S SH EN 490
62	Laminat dekorativ të presionit të lartë (HPL). Fletë me bazë rrëshirat termodure. Pjesa 1: Specifikimet.	S SH EN 438-7
63	Specifikimet për komponentët ndihmës të muraturës. Pjesa 1: Lidhësë, rripa(breza) tensioni, çengela dhe konsola.	S SH EN 845-1
64	Specifikimet për komponentët ndihmës të muraturës. Pjesa 2: Arkitrarët.	S SH EN 845-2
65	Specifikimet për komponentët ndihmës të muraturës. Pjesa 3: Shtrati lidhës i përforcimit prej çeliku.	S SH EN 845-3
66	Materialet për shenjat në rrugë. Reflektuese të vendkalimeve të rrugës. Pjesa 1: Kërkesat e performancës fillestare.	S SH EN 1463-1
67	Lidhësat për pllaka. Përkufizime dhe specifikime.	S SH EN 12004
68	Shtresa kundër shkëlqimit verbues të rrugëve. Pjesa 1: Performanca dhe karakteristikat.	S SH EN 12676-1
69	Ngjitësit me bazë gipsi për blloqet prej gipsi. Përkufizimet, kërkesat dhe metodat e provave. (*)	S SH EN 12860
70	Agregatë për përzierje bituminoze dhe trajtime sipërfaqësore për rrugë Aeroporte dhe zona të tjera të trafikut.	S SH EN 13043
71	Agregatë të lehtë. Pjesa 1: Agregatë të lehtë për beton dhe llaç.	S SH EN 13055-1
72	Inerte të lehtë. Pjesa 1: Inerte të lehtë për përzierje bituminoze dhe për trajtimin e sipërfaqeve si dhe për përdorime me lidhësa dhe pa lidhësa.	S SH EN 13055-2
73	Agregate për llaçe.	S SH EN 13139



<b>Nr. Rendor</b>	<b>Emërtimi i familjes së produktit</b>	<b>Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të</b>
74	Agregatë për materiale lidhës hidraulik dhe jolidhës për përdorim në industrinë civile dhe ndërtimin e rrugëve.	S SH EN 13242
75	Agregate për çakëllin (ballastin) e hekurudhave.	S SH EN 13450
<b>VIII. Mbrojtja nga zjarri dhe siguria në shtëpi.</b>		
76	Sistemet e zbulimit dhe të alarmit të zjarrit. Pjesa 3: Sistemet zanore të alarmit të zjarrit.	S SH EN 54-3
77	Sistemet e zbulimit dhe të alarmit të zjarrit. Pjesa 4: Pajisjet për furnizim elektrik.	S SH EN 54-4
78	Sistemet e zbulimit dhe të alarmit të zjarrit. Pjesa 5: Zbuluesit e ndjeshëm ndaj nxehtësisë. Zbuluesit në majë.	S SH EN 54-5
79	Sistemet e zbulimit dhe të alarmit të zjarrit. Pjesa 7: Zbuluesit e tymit. Zbuluesit me majë të cilët përdorin dritë të përhapur, dritë të transmetuar ose jonizim.	S SH EN 54 -7
80	Sistemet e zbulimit dhe të alarmit të zjarrit. Pjesa 12: Zbuluesit e tymit. Zbuluesit në linjë, të cilët përdorin një tufë rrezesh optike.	S SH EN 54-12
81	Sistemet e palëvizshëm të shuarjes së zjarrit. Komponentët për dallimin e gazit. Pjesa 1 : Kërkesat dhe metodat e provave për pajisjet elektrike të kontrollit automatik dhe për shërbimet e vonimit. (*) Dalluesit e veçantë të zjarrit.	S SH EN 12094-1
82	Sistemet e palëvizshëm të shuarjes së zjarrit. Komponentët për dallimin e gazit. Pjesa 2 : Kërkesat dhe metodat e provave për pajisjet joelektrike të kontrollit (*)	S SH EN 12094-2
83	Sistemet e palëvizshëm të shuarjes së zjarrit. Komponentët për dallimin e gazit. Pjesa 3: Kërkesat dhe metodat e provave për pajisjet manuale dhe të ndalimit. (*)	S SH EN 12094-3
84	Sistemet e palëvizshëm të shuarjes së zjarrit. Komponentët për dallimin e gazit. Pjesa 4 : Kërkesat dhe metodat e provave për bashkësitë e valvolave. (*)	S SH EN 12094-4 —
85	Sistemet e palëvizshëm të shuarjes së zjarrit. Komponentët për dallimin e gazit. Pjesa 9 : Kërkesat dhe metodat e provave për dalluesit e veçantë të zjarrit. (*)	S SH EN 12094-9
86	Sistemet shuarjes së zjarrit. Komponentët për dallimin e gazit. Pjesa 10 : Kërkesat dhe metodat e provave për manometrat e presionit dhe për kontaktet me presion. (*)	S SH EN 12094-10

<b>Nr. Rendor</b>	<b>Emërtimi i familjes së produktit</b>	<b>Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të</b>
87	Sistemet e shuarjes së zjarrit. Komponentët për dallimin e gazit. Pjesa 11 : Kërkesat dhe metodat e provave për pajisjet mekanike të peshimit. (*)	S SH EN 12094-11
88	Sistemet e shuarjes së zjarrit. Komponentët për dallimin e gazit. Pjesa 12: Kërkesat dhe metodat e provave për pajisjet pneumatike të alarmit. (*)	S SH EN 12094-12
89	Sistemet e kontrollit të tymit dhe nxehtësisë. Pjesa 2: Specifikimet për ventilatorët e tymit të zakonshëm dhe të nxehtësisë.	S SH EN 12101-2
90	Sistemet e kontrollit të tymit dhe nxehtësisë. Pjesa 3: Specifikime për ventilatorët e tymit të fuqishëm dhe të nxehtësisë.	S SH EN 12101-3
91	Sistemet e palëvizshme të fikjes së zjarrit. Pjesa 1: Përbërësit për sistemet e spërkatjes me ujë. Spërkatësit.	S SH EN 12259-1
92	Sisteme zjarrfikëse të fiksuar. Përbërës për spërkatje (shi i imët) dhe sisteme ujore spërkatëse. Pjesa 2: Valvolat sinjalizuese të lagështisë	S SH EN 12259-2
93	Sisteme zjarrfikëse të fiksuar. Përbërës për spërkatje (shi i imët) dhe sisteme ujore spërkatëse. Pjesa 3: Valvolat sinjalizuese të thatësisë.	S SH EN 12259-3
94	Sisteme zjarrfikëse të fiksuar. Përbërës për spërkatje (shi i imët) dhe sisteme ujore spërkatëse. Pjesa 4: Alarmet motorike ujore.	S SH EN 12259-4
95	Sisteme e palëvizshëm të fikjes së zjarrit. Pjesa 5: Dedektorët me rryme uji.	S SH EN 12259-5
96	Sistemet e palëvizshëm të fikjes së zjarrit. Pjesa 1: Sistemet me pluhurosje. Kërkesat dhe metodat e provës për përbërësit. (*)	S SH EN 12416-1
97	Sistemet e palëvizshëm të fikjes së zjarrit. Pjesa 2: Sistemet me pluhurosje. Projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja.	S SH EN 12416-2
98	Sistemet e palëvizshëm të fikjes së zjarrit. Sistemet me shkumë. Pjesa 1: Kërkesat dhe metodat e provave për përbërësit. (*)	S SH EN 13565-1
<b>IX. Pajisje teknike të ndërtimit.</b>		
99	Aksesorë për ndërtesat. Pajisjet për daljet e emergjencës, të cilat vihen në lëvizje me anë të një doreze-levë ose të një pllake që shtypet. Kërkesat dhe metodat e provës. (*)	S SH EN 179
100	Aksesorë për ndërtesat. Pajisjet për daljet e emergjencës dhe kundra panikut, të cilat komandohen me anë të një doreze horizontale. Kërkesat dhe metodat e provës. (*)	S SH EN 1125

<b>Nr. Rendor</b>	<b>Emërtimi i familjes së produktit</b>	<b>Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të</b>
101	Aksesorë për ndërtesat. Pajisjet me amortizim për mbylljen e derës. Kërkesat dhe metodat e provës. (*)	S SH EN 1154
102	Aksesorë për ndërtesat. Pajisjet mbajtëse-hapëse elektrike për dyert rrotulluese. Kërkesat dhe metodat e provës. (*)	S SH EN 1155
103	Aksesorë për ndërtesat. Pajisjet kordinuese të dymve. Kërkesat dhe metodat e provës. (*)	S SH EN 1158
104	Materialet për shenjat në rrugë Hedhja e materialeve. Zbukurimet prej xhami,pajisjet kundër rrëshqitjes dhe përzierësit e dy komponenteve.	S SH EN 1423
105	Pajisje për ndërtim. Çengela (ngritësa) me një aks,kërkesat dhe metodat e provave.	S SH EN 1935
106	Dyer garazhdesh dhe porta hyrje. Produkt standard. Pjesa 1: Produkte pa karakteristika kontrolli të rezistencës ndaj zjarrit dhe tymit.	S SH EN 13241-1
107	Agregatë të lehtë. Pjesa 1: Agregatë të lehtë për beton dhe llaç.	S SH EN 13055-1
108	Agregate për llaçe.	S SH EN 13139
109	Agregatë për materiale hidraulikisht lidhës dhe jolidhës për përdorim në industrinë civile dhe ndërtimin e rrugëve.	S SH EN 13242
110	Agregate për çakëllin(ballastin) e hekurudhave.	S SH EN 13450
111	Materiale nivelues dhe niveluesit për dysheme. Materiale niveluese. Vetitë dhe kërkesat.	S SH EN 13813
112	Pajisje të parandalimit të mbimbushjes për tankerat e palëvizshëm për lëndë djegëse të lëngëta.	S SH EN 13616
113	Radiator dhe konvektor. Pjesa 1: Karakteristika termike dhe kërkesat.	S SH EN 442-1
114	Panele radiatore të montuara në tavan, të furnizuar me ujë me temperature 1200 °C Pjesa 1: Specifikime teknike dhe kërkesa	S SH EN 14037-1
115	Aparatura prej guri. Pjesa 1: Specifikimet.	S SH EN 13383-1
116	Kushinetat e strukturës. Pjesa 4: Kushineta me rula	S SH EN 1337-4
117	Kushinetat e strukturës. Pjesa 6: Kushineta me çernierë	S SH EN 1337-6

<b>Nr. Rendor</b>	<b>Emërtimi i familjes së produktit</b>	<b>Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të</b>
118	Kushinetat e strukturës. Pjesa 7: Kushineta sferike dhe cilindrike prej PTFE	S SH EN 1337-7
119	Ashensorët për ndërtesat. Bravat dhe shula. Bravat , shulat dhe pllakat mbyllëse mekanike. Kërkesat dhe metodat e provave.	S SH EN 12209
120	Pajisje kundër përmytjeve në ndërtesa. Pjesa 1: Kërkesat.	S SH EN 13564-1
121	Dyer garazhdesh dhe porta hyrje. Produkt standard. Pjesa 1: Produkte pa karakteristika kontrolli të rezistencës ndaj zjarrit dhe tymit.	S SH EN 13241-1
122	Grila të jashtëm. Kërkesat e performancës përfshirë dhe sigurinë	S SH EN 13561
123	Grila. Kërkesat e performancës përfshirë dhe sigurinë.	S SH EN 13659
<b>X. Produktet e ndërtimit për paretet e jashtme e të brendshme, tavane, dysheme.</b>		
124	Pllaka prej guri natyror për shtresë të jashtme. Kërkesat dhe metodat e provave. (*)	S SH EN 1341
125	Kalldrëmet prej guri natyror për shtresa të jashtme. Kërkesat dhe metodat e provave. (*)	S SH EN 1342
126	Bordurat prej guri natyror për shtresa të jashtme. Kërkesat dhe metodat e provave. (*)	S SH EN 1343
127	Pllaka argjili për shtrim. Kërkesat dhe metodat e provave. (*)	S SH EN 1344
128	Kanale kullimi për zona kalimi për këmbësorë dhe mjete. Klasifikimi, kërkesat për projektim dhe prova markimi dhe vlerësimi i konformitetit.	S SH EN 1433
129	Pllaka për tarraca. Pjesa 2: Pllake tarrace për përdorim të jashtëm.	S SH EN 13748-2
130	Pllaka qeramike. Përkufizime,klasifikime,karakteristika dhe markimi.	S SH EN 14411
131	Produkte guri dhe eterniti për çati dhe veshje(mbulesa) Pjesa 1: Specifikimet e produktit	S SH EN 12326-1
132	Tavanë të varur. Kërkesat dhe metodat e provave. (*)	S SH EN 13964
133	Oxhakët Veshjet e brendshme prej qeramike e oxhakut. Kërkesat dhe metodat e provës. (*)	S SH EN 1457

<b>Nr. Rendor</b>	<b>Emërtimi i familjes së produktit</b>	<b>Standardi ose standarde të barasvlefshëm me të</b>
134	Oxhakët. Kërkesat për oxhaqet metalikë. Pjesa 1: Produktet e sistemit të oxhakut.	S SH EN 1856-1
135	Oxhakët. Kërkesat për oxhaqet metalikë. Pjesa 2: Lidhjet forcuese metalike dhe lidhëset e tubave të aspirimit.	S SH EN 1856-2
136	Oxhakët. Komponentët. Bloqe prej betoni të grykës.	S SH EN 1858
137	Oxhakët. Komponentët. Veshjet e grykës së shkarkimit prej betoni.	S SH EN 1857
138	Oxhakët. Kërkesat dhe metodat e provave për grykat e shkarkimit prej qeramike (*)	S SH EN 13502
139	Përbërësit e oxhaqeve. Elementët e paretëve të jashtme të betoneve.	S SH EN 12446
<b>XI. Produktet e ndërtimit për instalime sanitare.</b>		
140	Depozitat e WC dhe kompletet e WC me sifon integral.	S SH EN 997
141	Dhoma inspektimi dhe puse lidhjesh prej betoni të pa armuar me shufra hekuri dhe të armuara.	S SH EN 1917
142	Lavamanët e kuzhinës. Kërkesat e funksionimit dhe metodat e provës. (*)	S SH EN 13310

**Shënim:** (\*) Kërkesat dhe Metoda e Provave janë përfshirë në këtë listë, pasi ato janë Standarde të përbashkëta dhe të harmonizuara me kërkesat.

**VENDIM**  
**Nr.613, datë 13.12.1993**

**PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË NDËRTIM DHE PROJEKTIM TË SHOQËRIVE**  
(Ndryshuar me vendim të KM nr.142, datë 4.3.1996;  
ndryshuar me vendim të KM nr.428, datë 4.8.2000;  
ndryshuar me vendim të KM nr.335, datë 11.7.2002;  
ndryshuar me vendim të KM nr.786, datë 22.11.2006)

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Çdo shoqëri vendase dhe e huaj, ose shoqëri me kapital të përbashkët, që do të ushtrojë veprimtari në fushën e ndërtimit dhe projektimit, të prodhimit të materialeve të ndërtimit dhe të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të shërbimeve publike, duhet të regjistrohet në

regjistrin themeltar të Komisionit të posaçëm për dhënien e licencave profesionale pranë sektorit të licencave të Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, duke paraqitur dokumentet përkatëse si më poshtë:

a) Kërkesën me shkrim, ku të paraqitet një autobiografi e shkurtër për veprimtarinë si shoqëri dhe për veprimtarinë që do të ushtrojë.

b) Licenca e lëshuar nga shteti përkatës, e legalizuar nga ky shtet, me vulë a-pustil, për vendet anëtare të konventës së Hagës, dhe e legalizuar në shtetin përkatës, për vende joanëtare të kësaj konvente.

c) Shfuqizuar.

ç) Shfuqizuar.

d) Shfuqizuar.

dh) Deklaratë, ku të thuhet se njeh dhe do të zbatojë në veprimtarinë e saj KTP, KTZ, STASH-et dhe ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit.

e) Të deklarojë që merr përsipër të dërgojë informacion në Ministrinë e Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit çdo tre muaj për veprimtarinë e shoqërisë, objektet, realizimin në lekë dhe numrin e fuqisë punëtore si kusht i domosdoshëm për rinovimin e liçencës.

2. Shoqëria shqiptare ose e huaj apo shoqëria me kapital të përbashkët që nuk është pajisur me dokumentin e regjistrimit në regjistrin themeltar të ndërmarrjeve, nuk ka të drejtë të ushtrojë veprimtari në fushën e ndërtimit e të projektimit, të prodhimit të mterialeve të ndërtimit dhe të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të shërbimeve publike.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**

*Vendim i KM nr.613, datë 13.12.1993 botuar në Fletoren Zyrtarenr.1, faqe 37/1994*

*Vendim i KM nr.142, datë 4.3.1996 i pabotuar*

*Vendim i KM nr.428, datë 4.8.2000 botuar në Fletoren Zyrtare nr.28, faqe 1423*

*Vendim i KM nr.335, datë 11.7.2002 botuar në Fletoren Zyrtare nr.44, faqe 1280*

*Vendim i KM nr.786, datë 22.11.2006 botuar në Fletoren Zyrtare nr.128, faqe 5092*

**VENDIM**  
**Nr.444, datë 5.9.1994**

**PËR TARIKAT E STUDIMIT, PROJEKTIMIT, DREJTIMIT DHE KOLAUDIMIT TË**  
**VEPRAVE TË NDËRTIMIT**

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e tarifave të studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit të financuara me fonde shtetërore, që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**

## **Tarifat për studimin, projektimin, drejtimin dhe kolaudimin e veprave të ndërtimit**

Për të vlerësuar punën studimore, projektuese, drejtimin dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit që financohen nga Buxheti i Shtetit, janë hartuar tarifat e mëposhtme:

A. Tarifat në përqindje për studimin e projektimin, drejtimin dhe likuidimin e punimeve të ndërtimit

B. Tarifat për kolaudimin përfundimtar, kontabilitetin e punimeve dhe azhurnimin e çmimeve

C. Tarifat për studimet dhe projektimet urbanistike

D. Tarifat për studimet dhe punimet gjeologjike e gjeodezike

Për punët që nuk parashikohen në tarifat e mësipërme, vlerësimi i tyre bëhet sipas shpenzimeve faktike të kryera nga personeli inxhiniero-teknik (pagat bazë, ato shitesë dhe plotësuese), duke shtuar mbi këto deri 60% për shpenzimet e ndryshme administrative e të tjera, në varësi nga puna, vendi i ndërtimit dhe shpenzimet që mendohet të kryhen (pagesa për personelin administrativ, kancelarinë, shpenzime për qira, ujë të pijshëm, energji elektrike, telefon, udhëtim e dieta, amortizimin e pajisjeve etj.). Mbi shumën e përgjithshme të këtyre shpenzimeve shtohet fitimi i planifikuar në masën 15%.

Në të gjitha rastet si në ato të dhëna në tabela, ashtu dhe në ato të llogaritura sipas shpenzimeve faktike, do të aplikohet tatimi mbi qarkullimin në përqindjen e përcaktuar në dispozitat përkatëse.

Këto tarifa janë maksimale dhe shërbejnë për t'u orientuar gjatë lidhjes së kontratave, kur prokurimi është i drejtpërdrejtë dhe bëhet me persona juridikë vendas. Për persona juridikë të huaj shfrytëzohen tarifat e vendeve përkatëse.

A. Tarifat në përqindje për studimin e projektimin, drejtimin dhe likuidimin e punimeve të ndërtimit

Tarifat në përqindje i referohen kushtimit të punimeve të montim-ndërtimit të llogaritura sipas metodikës që jepet në broshurën "Analiza teknike nr.1", miratuar nga Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit në dhjetor 1992.

Në kushtimin e ndërtim-montimit, të llogaritur sipas preventivit, përfshihet edhe fondi rezervë, edhe tatimi mbi qarkullimin, por jo vlera e vetë pajisjeve e makinerive.

Punimet jashtë sheshit të ndërtimit të ndërtesave të ndryshme, si ujësjellësit, kanalizimet, rrugët, linjat ajrore e nëntokësore etj., si dhe veprat e artit në rrugët, hekurudhat etj., që në preventiv duhet të parashikohen veç, vlerësohen me tarifat e veçanta, përveç rasteve kur në tarifat përkatëse parashikohet ndryshe.

Shpenzimet sipas tarifës, të aplikuara mbi vlerën e preventivit, likuidohen në mbarim të projektit në masën 60%. Pjesa që mbetet (40%) do të likuidohet pas prokurimit të zbatimit të veprës.

Kur kushtimi i punimeve të ndërtim-montimit sipas preventivit të hartuar nga institucioni projektues rezulton mbi 10% nga vlerësimi i ofertës së pranuar për zbatimin e punimeve, tarifat në përqindje rillogariten në bazën e fondit të ofertës fituese për zbatim.

Nëse vepra nuk prokurohet për zbatim brenda 12 muajve nga data e përfundimit të projektit, projektuesit i lind e drejta marrjes së kësaj shume 40%, pa pritur prokurimin e zbatimit.

Në tabelë jepen tarifat në përqindje për kushtimin veprave nga 1 000 000 deri në 300 000 000 lekë. Për kushtimin nën 1 000 000 lekë merret tarifa e pandryshueshme (ajo për kushtimin 1 000 000 lekë). Për kushtimin nga 1 000 000 deri në 300 000 000 lekë, vlerat ndërmjetëse, nga ato të treguara në tabelë, merren me interpolin linear. Për veprat me kushtim mbi 300 000 000 lekë veprohet si vijon: vlera 300 000 000 shumëzohet me përqindjen përkatëse dhe diferenca mbi 300 000 000 me përqindjen e dhënë për pjesën mbi 300 000 000 lekë.

Për të pasur parasysh përmbajtjen e tarifave në përqindje dhe për të bërë vlerësimin e punëve sipas fazave, në vazhdim të tabelave të tarifave jepet ndarja e këtyre tarifave në përqindje sipas fazave:

Hartimi i projekteve dhe preventivave

Studimi dhe hartimi i projekteve dhe preventivave sipas fazave përkatëse (pikat 1, 2, 3, 4) bëhet në përputhje me normativat e kushtet teknike të projektimit, zbatimit dhe dispozitat e tjera

ligjore, duke përfshirë të gjitha shpenzimet për punën që kryhet në zyrë dhe jashtë saj.

Shpenzimet që kryhen për studimet e punimet gjeologjike, gjeodezike, hidrologjike, sizmologjike etj., nuk përfshihen në tarifë, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe.

Në fazën e studimit dhe hartimit të projektidesë, institucioni projektues ndihmon edhe në plotësimin e përmirësimin e detyrës së projektimit, përgatit e paraqet materialet për miratimin e sheshit të ndërtimit dhe merr pjesë në mbrojtjen e miratimin e projektidesë.

Në këtë fazë nxirren të dhënat e nevojshme dhe bashkëpunohet për plotësimin e dokumenteve të tenderit dhe kontratës për projektzbatimin (në rastin kur projektzbatimi nuk parashikohet në kontratën e projektidesë).

Mbas hartimit të projektzbatimit, institucioni projektues gjatë zbatimit të punimeve ndihmon e sqaron drejtorin e punimeve për zbatimin e punimeve, plotëson e përmirëson projektin brenda fondit rezervë të parashikuar në preventiv dhe, në rastet kur kërkohet, merr pjesë në kolaudimet pjesore dhe në atë përfundimtar.

Përgatit të dhënat e nevojshme për tenderin e sipërmarrjes dhe ndihmon në hartimin e kontratës përkatëse.

Për veprat deri 20 000 000 lekë, kur nuk hartohet projektide, nuk merret tarifa përkatëse, kurse për veprat mbi 20 000 000 lekë, kur në kontratë pranohet të mos bëhet projektide e plotë sipas dispozitave, për të përballuar vështirësinë për hartimin e projektzbatimit pa projektidenë e plotë, jepet 25% e tarifës së projektidesë.

Kur studimi e projektimi i veprës kërkohet me urgjencë të veçantë, në marrëveshje tarifave përkatëse rriten me koeficientin deri 1.20.

Në rast se investitori gjatë kryerjes së punimeve kufizon detyrat e përcaktuara fillimisht në kontratë, përveç vlerësimit të punës që është kryer dhe do të parashikohet të kryhet, paguan edhe 25% të tarifës që i takon për punët që nuk do të kryhen sipas kontratës fillestare.

Pjesëmarrja në kontraktim (pika 5)

Parashikon asistencën e ndihmën që duhet t'i jepet investitorit dhe firmës zbatuese për porositë, kontraktimet e furnizimet e makinerive, pajisjeve dhe materialeve teknologjike e ndërtimore, duke përfshirë përcaktimin e saktësimin e karakteristikave të tyre mbi bazën e specifikimeve dhe përshkrimeve të dhëna në projektet përkatëse.

Rekomandohet që kjo detyrë t'i jepet institucionit projektues.

Drejtimi i punimeve (pika 5)

Parashikon asistencën gjatë hartimit të kontratës ndërmjet investitorit dhe zbatuesit. Në rastin kur nuk asiston në hartimin e kontratës, studion projektet, preventivat dhe për përmbajtjen e kontratës dhe i paraqet investitorit vërejtjet e propozimet konkrete.

Drejtimi i punimeve parashikon mbikëqyrjen e vazhdueshme e të kualifikuar të gjithë proceseve të punimeve dhe dokumentacioneve që duhet të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta, duke dhënë udhëzime, porosi e urdhra për zbatimin me përpikëri e në kohë të kërkesave të projektit, të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit (teknologjike dhe të ndërtimit), të dispozitave përkatëse, të kontratave etj.

Drejtori i punimeve i jep mendim investitorit për nënsipërmarrësit e mundshëm të propozuar nga zbatuesi, si dhe ndihmon për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet institucionit projektues dhe zbatuesit.

Mbajtja e dokumentacionit dhe provat sipas fazave

Parashikon kontrollin e mbajtjes së dokumentacioneve nga zbatuesi gjatë kryerjes së punimeve, të punimeve të maskuara dhe të provave të ndryshme, në përputhje me rregullat dhe dispozitat në fuqi.

Gjatë fazave të ndryshme të zbatimit, sipas rastit, mban dokumentacionet e nevojshme dhe asiston ose dhe bën vetë provat dhe kualidimet e nevojshme.

Kontrolli dhe likudimi i punës së kryer

Parashikon kontrollin e dokumentimit, verifikimin dhe saktësimin e vëllimeve të punës së kryer (sipas librezave të masave) dhe materialeve të furnizuara.

Parashikon gjithashtu kontrollin e zbatimit të çmimeve njësore (sipas kontratës dhe analizave të veçanta) dhe kryen likuidimin e shpenzimeve pjesore e përfundimtare.



A. Tarifat në përqindje për projektimin, drejtimin dhe likuidimin e punimeve të ndërtimit  
I. Ndërtesa banimi, social-kulturore, ekonomike, të shërbimit dhe industriale

Kushtimi në milion lekë	Tarifat sipas grupeve			
	a	b	c	d
1.0	8.4	10.2	13.2	16.7
2.5	7.2	9.0	11.4	14.8
5.0	6.5	7.8	10.2	12.9
7.5	5.6	6.7	9.1	11.2
10	5.2	6.2	8.6	10.4
15	4.6	5.3	7.1	8.3
20	4.3	5.0	6.3	7.4
25	4.1	4.8	5.6	6.7
30	3.9	4.5	5.0	6.2
40	3.7	4.4	4.7	5.8
50	3.5	4.2	4.5	5.6
75	3.3	4.0	4.1	5.3
100	3.1	3.7	4.0	4.9
150	2.9	3.5	3.7	4.6
200	2.7	3.3	3.5	4.3
300	2.5	3.0	3.2	4.0
Pjesë mbi 300	2.0	2.5	2.0	3.3

Ndarja e tarifës sipas fazave të ndryshme:

Nr.	Emërtimi	Në përqindje
1.	Projektideja	14
2.	Preventivi paraprak	3
	Shuma 1+2	17
3.	Projektzbatimi	40
4.	Preventivi P.Z.	10
	Shuma 3+4	50
5.	Pjesëmarrja për kontraktim	3
6.	Drejtimi i punimeve	20
7.	Mbajtja e dokumentacionit dhe provat sipas fazave	3
8.	Kontrolli e likuidimi i punës së kryer	7

Klasifikimi ndërtimeve sipas grupeve të mësipërme parashikon:

Grupi a

- Ndërtesa të thjeshta, si: depo, stalla, hangarë, garazhe, ndërtesa fshati pa kërkesa, ndërtime të përkohshme, si dhe ndërtime të thjeshta industriale pa kërkesa të veçanta teknike.

Grupi b

- Ndërtimi i shkollave, spitaleve të vogla, ndërtime me rëndësi mesatare, stacione, merkato, varreza e të tjera të këtij karakteri, ndërtesa fshati me rëndësi, si dhe ndërtime industriale me kërkesa teknike.

Struktura ose pjesë strukturash, komplekse prej betonarmeje të veçanta.

Grupi c

- Ndërtimi i shkollave, instituteve, spitaleve dhe objekteve social-kulturore të rëndësishme, banesat e përbashkëta dhe vilat e veçanta pa kërkesa të mëdha, si dhe ndërtime industriale të një rëndësie të madhe.

- Struktura dhe pjesë strukturash prej betonarmeje që kërkojnë studime teknike të veçanta, duke përfshirë edhe strukturat antisizmike të veçanta.

Grupi d

- Banesa të rëndësishme, vilat me kërkesa të veçanta, ndërtime administrative, teatro, hotele

e të tjera të rëndësishme dhe me kërkesa të mëdha teknike e arkitektonike, ndërtime me karakter fetar, pavione, ekspozita dekoracione të brendshme e të jashtme, ndërtime të karakterit artistik e monumental me kërkesa të larta artistike e arkitektonike, projektimi i pajisjeve e mobilieve për banesa, zyra etj., restaurime artistike, si dhe ndërtime industriale të rëndësishme e me kërkesa teknike të veçanta.

Për veprat industriale që përfshihen në grupet b, c, d të mësipërme, në varësi nga fondet dhe kur teknologët hartojnë projekte e preventiva të veçantë e të plotë për anën teknologjike, impiantet dhe linjat teknologjike, tarifat gjithashtu merren në përqindje të kushtimit në lekë të ndërtimontimit brenda sheshit të ndërtimit, në masën 80% të atyre të dhënë më sipër për punimet e ndërtimit me instalimet përkatëse.

Shënim:

1. Për studimin dhe hartimin e projekteve për rikonstrukcionin dhe zgjerimin e veprave ekzistuese, tarifat e projektimit (për ndërtimin dhe teknologjinë) shumëzohen me 1.20, kurse për përshtatjen e projekteve ekzistuese për t'u përdorur në një vend tjetër, tarifat shumëzohen me 0.30.

2. Për hartimin e seksioneve ose banesat tip, si dhe ndërtime të tjera për t'u përdorur si tip, tarifat caktohen në marrëveshje, por të mos kalojë 1.5 të tarifës përkatëse.

3. Në tarifat e mësipërme nuk përfshihen studimet gjeologjike e sizmike që kryhen nga nënsipërmarrësit përkatës, prandaj këto shpenzime të llogariten e të shtohen veç.

A. Tarifat në përqindje për projektimin, ndërtimin dhe likuidimin e punimeve të ndërtimit

Kushtimi në milione lekë	II. Rrugë-hekurudha		III. Ndërtimë e struktura të veçanta		
	Fushore e kodrinore	Malore me vështirësi	Ura druri me muraturë e struktura të zakonshme	Diga, urë betonarmeje metalike e struktura të veçanta metalike	Tunele e vepra nëntokësore
	a	b	a	b	c
1.0	8.6	12.5	8.8	14.2	17.6
2.5	6.8	10.2	7.3	12.8	14.9
5.0	5.3	8.3	6.0	10.9	12.6
7.5	4.4	7.9	5.0	8.8	10.3
10	4.2	7.5	4.8	8.1	9.3
15	3.9	6.9	4.2	7.1	8.2
20	3.7	6.6	3.8	6.6	7.9
25	3.6	6.3	3.6	6.4	7.7
30	3.5	6.0	3.4	6.1	7.4
40	3.4	5.8	3.2	5.7	7.0
50	3.3	5.6	3.1	5.5	6.6
75	3.2	5.1	2.7	4.9	6.1
100	3.1	4.6	2.5	4.4	5.9
150	3.0	4.3	2.3	4.1	5.1
200	2.9	4.2	2.2	4.0	4.8
300	2.8	4.1	2.1	3.9	4.6
Pjesa mbi 300	2.4	3.4	1.8	3.2	3.8

Ndarja e tarifës sipas fazave të ndryshme në përqindje

Nr.	Emërtimi	II	III
1.	Projektideja	11	10
2.	Preventivi paraprak	3	3
	Shuma 1+2	14	13

3.	Projektzbatimi	31	45
4.	Preventivi P.Z	10	7
	Shuma 3+4	41	52
5.	Pjesëmarrja për kontraktim	5	5
6.	Drejtimi i punimeve	25	15
7.	Mbajtja e dokumentacionit dhe provat sipas fazave	5	10
8.	Kontrolli e likuidimi i punës së kryer	10	5

Klasifikimi i veprave të mësipërme parashikon:

## II. Rrugë automobilistike e hekurudhore

a) Rrugë të zakonshme automobilistike, linja tramvaji dhe dekovili, në zonat fushore e kodrinore (me përjashtim të veprave të artit me rëndësi që trajtohen veças).

b) Rrugë automobilistike, hekurudhore, linja tramvaji në zona malore ose ato që parqesin vështirësi e kërkojnë studime të veçanta (me përjashtim të veprave të artit me rëndësi që trajtohen veças), si dhe impiantet e teleferikëve.

### Shënim

1. Për rikonstrukcionin dhe zgjerimin e rrugëve, të urave të veçanta ekzistuese, tarifrat shumëzohen me 1.20.

2. Tarifrat parashikojnë projektimin dhe ndërtimin komplet të rrugës, duke përfshirë veprat e zakonshme të artit, pa urat e mëdha e të rëndësishme që vlerësohen me tarifa të veçanta.

3. Në tarifë nuk përfshihen shpenzimet për studime gjeologjike dhe hidrogjeologjike, relievet masive për zonat që nuk kanë harta, të cilat kryhen nga institucionet e tjera projektuese.

## III. Ura, ndërtime të veçara dhe struktura speciale

### a) Ura druri dhe muraturë

Konstruksione e ndërtime për vepra hidraulike, struktura metalike dhe drusore të tipeve të zakonshëm. Ato prej betonarmeje merren sipas I/b.

b) Diga, diga pritëse dhe ngritëse, ura metalike dhe betonarmeje, veprat metalike të rëndësishme që kërkojnë llogaritje të veçanta, kurse ato prej betonarmeje merren sipas I/c.

### c) Tunele, galeri, vepra nëntokësore e nënujore, si dhe themele speciale.

#### Shënime

1. Për veprat nëntokësore në miniera, tarifrat llogariten mbi bazën e tarifave të dhëna më sipër, për tunelet dhe veprat nën tokë të veçara (III/c), si më poshtë:

- Për studimin dhe hartimin e projektidesë së minierave dhe preventivat përkatës, për hapjen dhe shfrytëzimin e minierës, për anën ndërtimore e teknologjike, tarifa gjithsej, e dhënë në III/c shumëzohet me 0.45. Vetëm për këtë rast në fazën e projektidesë nuk parashikohet në tarifë projektzbatimi, drejtimi i punimeve etj.

- Për pusët dhe anekset nëntokësore në miniera, duke përfshirë edhe anën teknologjike e të montimit, tarifrat e dhëna në III/c shumëzohet me 0.6, kurse për punimet kapitale (galeritë) me 0.35.

2. Për projektimin e urave dhe veprave nëntokësore me kushte të vështira gjeologjike, që kërkojnë llogaritje dhe marrjen e masave të veçanta, tarifrat përkatëse të projektimit shumëzohen me 1.2.

3. Studimet gjeologjike, sizmike dhe hidrogjeologjike për të gjitha veprat e mësipërme III/a, b, c dhe ato nën tokë të minierave nuk janë përfshirë në tarifë, prandaj llogariten e shtohen veç.

A. Tarifat në përqindje për projektimin, drejtimin e likuidimin e punimeve të ndërtimit

Kushtimi në milion lekë	IV. Hidrocentrale	V. Ndërtime detare e lumore	VI. Bonifikim-ujtje	
			Me rrjedhje natyrore	Me ngritje mekanike
1.0	9.2	12.3	8.6	9.5
2.5	7.4	9.8	6.8	7.8
5.0	6.6	7.6	5.3	6.3
7.5	5.8	6.8	4.4	5.2
10	5.4	6.3	4.2	5.1
15	4.7	5.3	3.9	4.8
20	4.4	5.2	3.7	4.6
25	4.2	5.1	3.6	4.5
30	3.9	5.0	3.5	4.4
40	3.7	4.9	3.4	4.3
50	3.5	4.8	3.2	4.2
75	3.3	4.6	3.1	4.0
100	3.1	4.5	3.0	3.9
150	2.9	4.3	2.8	3.8
200	2.7	4.2	2.7	3.6
300	2.5	3.8	2.5	3.3
Pjesa mbi 300	2.1	3.1	2.1	2.7

Ndarja e tarifës sipas fazave të ndryshme në përqindje

Nr.	Emërtimi	IV	V-VI
1.	Projektideja	15	11
2.	Preventivi paraprak	3	3
	Shuma 1+2	18	14
3.	Projektzbatimi	32	35
4.	Preventivi P.Z	10	6
	Shuma 3+4	42	41
5.	Pjesëmarrja për kontraktim	10	5
6.	Drejtimi i punimeve	15	25
7.	Mbajtja e dokumentacionit dhe provat sipas fazave	10	5
8.	Kontrolli e likuidimi i punës së kryer	5	10

Klasifikimi i veprave të mësipërme parashikon:

IV. Ndërtimi i hidrocentraleve

Tarifat janë të mesatarizuara dhe përdoren për të gjitha punimet që kryhen në hidrocentral, pa përfshirë studimet gjeologjike, gjeodezike, hidrologjike e sizmike, të cilat kryhen nga institucionet përkatëse.

V. Ndërtimet detare e lumore

Parashikohen punimet për portet detare të plota, lumore ose liqen, si dhe objekte të pjesshme të tyre, ndërtimet për kantieret detare, të riparimit të anijeve, të ndërmarrjeve të peshkimit, duke përfshirë skoljerat, sheshet, kalatat, thellimet brenda e jashtë porteve etj.

Për kalata e pontile të veçuara që kanë probleme gjeologjike dhe llogaritje të vështirë, mbi tarifat përkatëse përdoret koeficienti 1.10.

Për rikonstruksionin e objekteve ekzistuese përdoret koeficienti 1.2, kurse për rastet e ndërhyrjeve në strukturën mbajtëse, për verifikimin e aftësisë mbajtëse dhe riaftësimin ose rritjen e aftësisë mbajtëse, përdoret koeficienti deri 1.5.

Studimet gjeologjike, sizmike, klimatiko-hidrologjike, rilevimet topografike në tokë e batimetrike në det dhe modelimet e ndryshme që kryhen nga institucionet e tjera, nuk përfshihen në tarifat e mësipërme, por llogariten e shtohen veç.

VI. Kullim-ujitje e mbrojtje nga lumenjtë

a) Parashikohen punimet për kullim-ujitjen e tokave me rrjedhje natyrore, sistemimin e rrjedhjes së ujërave dhe rezervuarët malorë.

Sistemet dhe mbrojtjet nga lumenjtë

b) Kullim ujitja me ngritjen mekanike të ujit, devijimin e ujit me fuqi motorike dhe prodhimin e energjisë elektrike.

Në tarifa përfshihen ndërtimi i të gjitha veprave të artit, si dhe shpenzimet që bëhen për studimet topografike, gjeologjike e hidrologjike.

Për vepra të kombinuara me punime të grupeve a dhe b merret mesatarja e ponderuar sipas fondeve përkatëse.

A. Tarifa në përqindje për projektimin, drejtimin e likuidimin e punimeve të ndërtimit

Kushtimi në milion lekë	VIII. Ujësjellës kanalizime të jashtme	VIII. Linjat ajrore elektrike e telefonike
1.0	9.4	6.9
2.5	7.5	5.5
5.0	6.3	4.9
7.5	5.3	4.4
10	4.8	4.1
15	4.4	3.6
20	4.1	3.3
25	3.9	3.2
30	3.8	3.1
40	3.6	2.9
50	3.4	2.8
75	3.2	2.6
100	3.0	2.5
150	2.8	2.3
200	2.6	2.2
300	2.4	2.0
Pjesa mbi 300	2.0	1.7

Ndarja e tarifës sipas fazave në përqindje

1.	Projektideja	12	12
2.	Preventivi paraprak	3	2
	Shuma 1+2	15	14
3.	Projektzbatimi	38	40
4.	Preventivi P.Z	7	6
	Shuma 3+4	45	46
5.	Pjesëmarrja për kontraktim	5	5
6.	Drejtimi i punimeve	20	17
7.	Mbajtja e dokumentacionit dhe provat sipas fazave	5	8
8.	Kontrolli e likuidimi i punës së kryer	10	10

Në klasifikimin e mësipërm parashikohet:

VII. Ujësjellësit dhe kanalizimet e jashtme, duke përfshirë veprat e marrjes, depozitimit dhe linjat e shpërndarjes.

VIII. Linjat ajrore elektrike e telefonike. Për linjat nëntokësore, tarifat e sipërme shumëzohen me 0.70.

B) Tarifat për kualidimin përfundimtar të punimeve të ndërtim-montimit

Kualidimi përfundimtar i punimeve të ndërtim-montimit dhe furnizimeve i përket si veprimtarisë së zbatimit, ashtu edhe drejtimit të punimeve.

Gjatë kolaudimit bëhet shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit dhe provat e nevojshme për të vërtetuar kërkesat e projektit, kontratës dhe dispozitave të tjera në fuqi dhe në përfundim lëshohet certifikatë e kolaudimit.

Kolaudimi bëhet sipas normave dhe përshkrimeve të përcaktuara për punimet e ndërtim-montimit, duke përcaktuar e sqaruar në relacionin e kolaudimit përmbajtjen e procesverbaleve të mbajtura gjatë zbatimit e drejtimit të punimeve, për provat dhe kolaudimet pjesore gjatë zbatimit, si dhe rezervat, detyrat dhe çështjet e tjera që mund të dalin.

Tarifat për shpenzimet e nevojshme për kolaudimin përfundimtar të punimeve të ndërtim-montimit dhe furnizimeve, në përqindje mbi kushtimin në lekë të këtyre punimeve, janë si vijon:

Kushtimi në milion lekë	Tarifa në përqindje	Kushtimi në milion lekë	Tarifa në përqindje
1.0	0.85	7.5	0.25
2.0	0.50	10	0.22
2.5	0.45	20	0.15
5.0	0.30	30 e lart	0.12

#### Shënim

1. Tarifa për veprat me kushtim deri 1 000 000 lekë është e pandryshueshme, për veprat mbi 1-30 milionë tarifit ndërmjetëse merren me interpolim linear, kurse mbi 30 milionë janë të pandryshueshme.

2. Kur kërkohet që gjatë kolaudimit të bëhet edhe shpërndarja e shpenzimeve në ngarkim të bashkëpronarëve të ndryshëm në varësi nga kuotat e bashkëpronësisë, tarifit e mësipërme shumëzohen me 1.30.

3. Në raste të veçanta, për veprat e rëndësishme, kur kolaudatori caktohet që në fillim me detyrimin që të bëjë kontrollë të vazhdueshme gjatë zbatimit të punimeve, tarifit shumëzohen me 1.20.

#### C. TARIFAT PËR STUDIMET DHE PROJEKTIMET URBANISTIKE

Tarifit e mëposhtme parashikojnë shpenzimet e përgjithshme për kryerjen e studimeve e të projekteve urbanistike të qyteteve, fshatrave dhe qendrave të banuara, në të gjitha fazat dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregulloren urbanistike.

Në to përfshihen shpenzimet që kryhen në zyrë (për procesin studimor e projektues) për personelin drejtues, shpenzimet administrative, ato për qira, energji elektrike, ujë të pijshëm etj., shpenzimet jashtë zyrës, si ato të transportit, dietat etj.

Tarifit janë hartuar për studimet dhe projektimet urbanistike të qyteteve, fshatrave dhe qendrave të banuara ekzistuese, për qytete, fshatra dhe qendra të reja, tarifit përkatëse shumëzohen me koeficientin 1.2.

Në funksion të madhësisë së qytetit, fshatit a qendrës së banuar, njësisë urbanistike, vlerave historike e muzeale, në aspektin e zhvillimit turistik etj. të konfiguracionit të relievit ku ato ndodhen, zbatohen koeficientët:

Për qytete muze-1.15, për qytete e fshatra me pjerrësi terreni mbi 10%-1.1, për studime urbanistike pjesore në zona muze dhe me rikonstruksione në qytete-1.1 dhe për studime urbanistike në qendra të qyteteve dhe në rrugë kryesore të tij-1.2.

Shpenzimet që kryhen nga institucionet e tjera për studime gjeologjike, gjeodezike, sizmologjike, hidrogjeologjike etj., nuk parashikohen në tarifit përkatëse, prandaj ato do të faturohen veç.

#### I. Studimi dhe hartimi i planeve rregulluese të qyteteve

Nr.	Qytete me popullsi deri	Tarifa në lekë/hektarë	
		a	b
1	10.000 banorë	19.200	15.300
2	20.000 banorë	16.300	13.000
3	50.000 banorë	9.800	7.800
4	100.000 banorë	7.000	5.600
5	200.000 banorë	5.200	4.100
6	mbi 200.000 banorë	4.100	3.300

Shënime:

- 1) Në tarifatat e mësipërme parashikohet:
  - a) Studimi dhe projektimi komplet i planit rregullues të përgjithshëm në fazën e projektidesë, si dhe hartimi i projektit teknik të rrjetit rrugor.
  - b) Studimi dhe projektimi vetëm i planit rregullues të përgjithshëm në fazën e projektidesë.
2. Për qytete me popullsi të ndërmjetme, tarifatat e mësipërme merren me interpolim linear.

#### II. Studime dhe projektme urbanistike pjesore në qytete

Nr.	Njësia urbanistike dhe popullsia	Tarifat në lekë/hektarë			
		a		b	
		Shumë familje	Një familje	Shumë familje	Një familje
A	Grup banimi 1000 banorë	28.800	33.400	23.200	26.700
B	Bllok banimi 3000-4000 banorë	25.600	29.400	20.500	23.500
C	Kompleks banimi 6000-8000 banorë	22.100	-	17.700	-
D	Lagje banimi	18.600	-	14.900	-

Shënim:

1. Në tarifatat e mësipërme parashikohet:
  - a) Studimi dhe projektimi urbanistik pjesor komplet në fazën e projektidesë dhe të hartimit të projektzbatimit.
  - b) Studimi dhe projektimi vetëm i planit urbanistik pjesor në fazën e projektidesë.

#### III. Studimi dhe projektimi i planeve rregulluese të fshatrave

Nr.	Fshati me popullsi deri	Tarifa në lekë/hektarë	
		a	b
1	500 banorë	8.200	6.500
2	1000 banorë	5.800	4.600
3	2000 banorë	4.200	3.400
4	2000 banorë	3.800	3.000

Shënime:

1. Në tarifatat e mësipërme parashikohet:
  - a) Studimi dhe projektimi komplet i planeve rregulluese të përgjithshme në fazën e projektidesë, si dhe hartimi i projektit teknik të rrjetit rrugor.
  - b) Studimi dhe projektimi vetëm i planit rregullues të përgjithshëm në fazën e projektidesë.
2. Për fshatra me popullsi të ndërmjetme, tarifatat e mësipërme merren me interpolim linear.
3. Për fshatra brenda zonave turistike, tarifatat e mësipërme shtohen me koeficientin 1.25.

#### IV. Studimi dhe projektimi i planeve rregulluese të përgjithshme në zona turistike

Nr.	Emërtimi	Tarifa në lekë/hektarë	
		a	b
1	Deri në 10 ha	15.000	12.000
2	Mbi 10 ha	12.000	10.000

Shënime:

1. Në tarifatat e mësipërme parashikohet:
  - a) Studimi dhe projektimi komplet i planit rregullues të përgjithshëm në zona turistike në fazën e projektidesë, si dhe hartimi i projektit teknik të rrjetit rrugor.
  - b) Studimi dhe projektimi vetëm i planit rregullues të përgjithshëm në zona turistike në fazën e projektidesë.

2. Për studime urbanistike pjesore komplekse në zona turistike, tarifat e mësipërme shtohen me koeficientin 1.25.

#### V. Studimi dhe miratimi i shesheve të ndërtimit

Nr.	Emërtimi	Tarifa në lekë
A	Për studimin e sheshit të ndërtimit kompletuar me koeficientin urbanistik:	
1	Shesh ndërtimi deri 0.5 ha	3500-5000
2	Shesh ndërtimi mbi 0.5 ha	5000-7500
B	Paraqitja grafike e planimetrisë së sheshit të ndërtimit	
1	Shesh ndërtimi deri 0.5 ha	2100-3000
2	Shesh ndërtimi mbi 0.5 ha	3000-4500

Shënime:

1. Në tarifrat e mësipërme, vlerat e ndërmjetme merren në funksion të problematikës dhe të shkallës së vështirësisë që paraqet studimi I sheshit të ndërtimit.

2. Dokumentacioni teknik plotësohet në përputhje me rregulloren urbanistike.

#### VI. Studimi dhe paraqitja grafike e rishikimit të vijës kufizuese dhe të kufirit suburban

A	Për qytete me popullsi deri	Tarifa në lekë	B. Për fshatra me popullsi deri	Tarifa në lekë
1	10.000 banorë	15.000	500 banorë	3.300
2	20.000 banorë	20.000	1000 banorë	4.600
3	50.000 banorë	27.000	2000 banorë	5.400
4	100.000 banorë	34.000	mbi 2000 banorë	6.300
5	200.000 banorë	40.000		
6	mbi 200.000 banorë	45.000		

#### D. Tarifrat për studime e punime gjeologjike dhe gjeodezike

Tarifat në vazhdim parashikojnë shpenzimet e përgjithshme për studimin dhe kryerjen e punimeve gjeologjike dhe gjeodezike që bëhen për veprat e ndryshme të ndërtimit e të sektorëve të tjerë.

Në këto tarifa përfshihen shpenzimet që kryhen në zyrë (për punën studimore projektuese dhe hartimin e raportit gjeologjik e topografik, për personelin drejtues, për shpenzimet administrative, për amortizimin ose qiranë e ndërtesave, pajisjeve, makinerive, instrumenteve etj.), si dhe shpenzimet që kryhen jashtë zyrës, si shpenzimet e transportit, dietat, pagat e punëtorëve ndihmës, provat laboratorike etj.

#### I. Për studime e punime gjeologjike

##### a) Studime gjeologjike me rikonicion

Kushtimi i ndërtim –montimit Në milion / lekë	Tarifa lekë
Deri në 5	4000
“ 10	6000
“ 20	7000
“ 50	8000

Shënim:

1. Tarifat ndërmjetëse nuk interpolohen.

2. Për veprat mbi 50 milionë lekë nuk parashikohet studim gjeologjik me rikonicion.



b) Studime gjeologjike të veçanta me rilevim gjeologjik

Nr.	Emërtimi i veprës	Tarifa
1	Për vepra të zakonshme në varësi nga madhësia, rëndësia dhe terreni	8.000-11.000
2	Për të dhënat e nevojshme për hartimin e skicidësë së hidrocentraleve sipas madhësisë dhe vendit	80.000-110.000

c) Shpime të ndryshme

Nr.	Lloji i shpimit	Tarifa lekë/ml
1	Me sondë stacionare	8.500
2	Me autosondë	4.500
3	Me sondë dore	3.400
4	Nën det e nën ujë	10.000

ç) Studime gjeologjike me reliev kompleks (gjeologjik e topografik) me metodën “INSITU” në zona me qëndrueshmëri të vogël në rrëshqitje

Madhësia e relievit	Tarifa lekë/ha
Deri 5 ha	13.500
“ 10 ha	12.000
“ 20 ha	7.600
“ 30 ha	4.500
Pjesa mbi 30 ha	2.500

II. Për studimin e hartimin e relieveve gjeodezike

Nr.	Terreni që rilevohet	Tarifa lekë/ha për shkallën				
		1: 100	1: 200	1: 500	1 : 1000	1: 2000
1	Fushor e kodrinor	12000	9100	5900	3300	2500
2	Malor e i aksidentuar	18800	14300	9300	5100	3900

- Për relievet me sipërfaqe deri në 1 ha, tarifat e mësipërme shumëzohen me koeficientin 2.0, kurse për sipërfaqe deri 5 ha, me 1.2.

- Për azhurnimin e relieveve gjeodezike ekzistuese mbi tarifat përkatëse zbatohet koeficienti 0.60.

## VENDIM

Nr.699, datë 22.10.2004

### PËR “MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN NË KONSTRUKSIONET DHE NDËRTIMET, QË SHËRBEJNË PËR VEPRIMTARI AKOMODUESE TURISTIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 41 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, me propozim të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit dhe të Ministrit Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në konstruksionet dhe ndërtimet që shërbejnë për veprimtari akomoduese turistike, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Personat fizikë ose juridikë, që hartojnë projekte për ndërtimin e objekteve, publike ose private, të zbatojnë rregullat teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, të miratuara sipas këtij vendimi.

3. Këshillat e rregullimit të territorit të miratojnë lejet e ndërtimit, vetëm pasi të jetë parashikuar plotësimi i normave dhe kushtet teknike të mbrojtjes nga zjarri, në përputhje me rregullat teknike, të miratuara në këtë vendim.

4. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për kontrollin e zbatimit e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.83, faqe 6189*

**RREGULLAT TEKNIKE**  
**PËR PARANDALIMIN E ZJARREVE NË KONSTRUKSIONE, NDËRTIME, ME AKTIVITET**  
**AKOMODUES TURISTIK**

**KREU I**  
**TË PËRGJITHSHME**

**1. OBJEKTI**

Miratimi i rregullave dhe normave teknike për parandalimin e zjarreve ka si qëllim mbrojtjen e personave dhe të mirave materiale nga rrezja e zjarreve dhe ka për objekt kriteret e sigurisë, për t'u aplikuar në konstruksionet ose ndërtesat e përshtatura për aktivitetet akomoduese turistike, të përcaktuara në akte nënligjore dhe të renditura si më poshtë:

- a) hotele;
- b) motele;
- c) fshatra hotelesh;
- d) fshatra turistike;
- e) rastet e dhënies të apartamenteve me qira;
- f) shtëpi dhe apartamente të destinuar për pushime;
- g) qendra agroturistike;
- h) rezidenca turistike;
- i) kampe alpine;
- j) qendra rezidenciale-turistike për të rinj;

**2. FUSHA E APLIKIMIT**

Kjo rregullore aplikohet për konstruksionet, ndërtesat dhe objektet e sipërcituara në pikën 1, për ato objekte që janë ekzistuese ose që do të ndërtohen të reja në të ardhmen. Për ndërtesat ekzistuese, që merren me aktivitete akomoduese turistike, aplikohen dispozitat e parashikuara për ndërtesat e reja, si dhe për rastet e rikonstruksionit të tyre me mbi 50% të vlerës.

Në aktivitetet respektive ekzistuese, kjo rregullore është e aplikueshme kur kërkohet një rritje të kapaciteteve akomoduese, kur sistemi i rrugëve të shpëtimit ekzistues është i përputhshëm me popullimin, si dhe me sistemin e ri plan-volumetrik të aktivitetit. Për këtë rast, mund të aplikohet kreu II pjesa II e rregullores.

**3. KLASIFIKIMI**

Aktivitetet akomoduese, për të cilat bëhet fjalë në pikën 1, në lidhje me kapacitetet akomoduese, numri i shtretërve në dispozicion të të pranishmëve të ftuar ose pushues të ndërtesës ose lokaleve (ndarjeve), që bëjnë pjesë në këto njësi ndahen në:

a) aktivitete akomoduese me një kapacitet më të madh se 25 shtretër, për të cilat aplikohen përshkrimet e kreut II;

b) aktivitete akomoduese me kapacitet deri në 25 shtretër, për të cilat aplikohen përshkrimet e kreut III.

Për kampet alpine aplikohen përshkrimet në kreun IV.

#### 4. TERMA, PËRCAKTIME DHE TOLERANCA DIMENSIONALE

Për termat, përcaktimet dhe tolerancën dimensionale i referohemi sa është përcaktuar në dispozitat e mëparshme.

Hapësirë e qetë: vend i sigurt statik (i ngjitur) dhe komunikues me një rrugë braktisjeje vertikale ose në të i përfshirë. Një hapësirë e tillë nuk duhet të jetë në përbërje të rrugëve të evakuimit dhe duhet të ketë karakteristika të tilla për të garantuar qëndrimin e personave.

Korridor i verbër: korridor ose pjesë korridori, në të cilën është i mundshëm evakuimi në një drejtim të vetëm. Gjatësia e korridorit të verbër llogaritet nga fillimi i tij deri në fund të kryqëzimit me një tjetër korridor, ku është i mundshëm evakuimi në dy drejtime, deri në vendin më i afërt e të sigurt, deri tek rruga e evakuimit vertikal.

Kufiri i qëndrueshmërisë ndaj zjarrit: është koha në minuta nga fillimi i provës në qëndrueshmëri, kundrejt zjarrit sipas një regjimi të përcaktuar të temperaturave, deri në humbjen e qëndrueshmërisë të përbërësve kryesorë të elementëve të strukturave.

Materiale të padjegshme: nën ndikimin e zjarrit, ose të temperaturave të larta nuk flakërohen, nuk digjen, nuk karbonizohen.

Materiale vështirësisht të djegshme: nën ndikimin e zjarrit, ose të temperaturave të larta flakërohen me vështirësi, digjen ose karbonizohen dhe vazhdojnë të digjen vetëm në prani të burimit të zjarrit.

Materiale të djegshme: nën ndikimin e zjarrit, ose të temperaturave të larta flakërohen, digjen pa flakë dhe vazhdojnë të digjen edhe pas heqjes së zjarrit.

R: rezistenca e pjesëve të jashtme të objektit ndaj zjarrit shprehur në minuta (0-120 minuta).

REI: rezistenca e pjesëve të brendshme të objektit shprehur në minuta (0-120 minuta).

RE: rezistenca e dyerve të dhomave, kjo e fundit e shprehur në minuta.

Lartësia antizjarr: lartësia e objekteve e shprehur në metra, me ndarje të tillë: 0-24 metër, 24-54 metër, mbi 54 metër.

Rezistenca e materialeve ndaj zjarrit e përcaktuar sipas klasave:

KLASA 0: materiale të padjegshme;

KLASA 1: materiale vështirësisht të djegshme;

KLASA 2: materiale të djegshme.

KLASA 1 IM: materiale, pajisje për mobilim, që kanë si përbërës lëndë të tilla si dru+përbërësit e pambukut, leshit etj, si dhe nënproduktet e tyre dhe përdoren për mobilimet të brendshme.

Me termin "OBJEKT"-LOKAL, ose pjesë objekti, lokali: kuptohet një hapësirë me volum të përcaktuar, e ndarë plotësisht ose pjesërisht nga mjedisi i jashtëm, ose nga ambjente të tjera fqinje, nëpërmjet pareteve/mureve.

## KREU II

### DISPOZITAT RELATIVE NË AKTIVITETE AKOMODUESE TURISTIKE ME KAPACITET MË TË MADH SE 25 SHTRETËR

#### PJESA E PARË

#### AKTIVITETET NË NDËRTESAT E REJA

#### 5. VENDNDODHJA

##### 5.1. Të përgjithshme

Ndërtesat e destinuar për aktivitetet akomoduese turistike, vendosen në mënyrë të tillë, ku respektohen distancat e sigurisë, të përcaktuara nga dispozitat në fuqi, distancat që kërkohen nga aktivitetet e tjera, që sjellin rreziqe shpërthimesh nga zjarret. Aktivitetet akomoduese mund të jenë vendosur:

a) në ndërtesa të ndara e të ndërtuara, për një specifikë të tillë të parashikuar në rregullore dhe të izoluar nga të tjerat.

b) në ndërtesa ose objekte që janë në vazhdim, ose ndërtesa të tjera me destinacione të ndryshme, por duke pasur parasysh normativat specifike, këto destinacione i nënshtrohen kontrolleve të strukturave të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin, siç përcaktohet në dispozitat në fuqi.

#### 5.2 Ndarjet, komunikimi

Duke marrë në konsideratë sa është përcaktuar në rregullat teknike, aktivitetet akomoduese turistike:

a) nuk mund të komunikojnë me aktivitetet që nuk i përkasin atyre;

b) mund të komunikojnë direkt me aktivitet që u përkasin atyre, por që nuk janë subjekt i kontrolleve të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin;

c) mund të komunikojnë nëpërmjet filtrave të provës të tymit ose hapësirave të zbuluara me aktivitetet e lejuara, subjekt i kontrolleve të strukturave të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin;

d) duhet të jenë të ndara nga aktivitetet e treguara në germën “a” dhe “c” të kësaj pike, nëpërmjet strukturave të karakteristikave të paktën me rezistencë të pjesëve të brendshme të ndarjeve ndaj zjarrit 90 minuta (REI 90).

#### 5.3 Hyrja në zonë

Për të lejuar ndërhyrjen e shërbimit zjarrfikës me (automjete) të PMNZSH-së, hyrjet në zonat ku ngrihen ndërtesat, objekt i kësaj rregulloreje, duhet të plotësohen këto kushte specifike minimale:

- gjerësia: 3,50 m;

- lartësia e lirë: 4 m;

- rrezja e kthimit: 13 m;

- pjerrësia: jo më e madhe se 10%;

- rezistenca ndaj ngarkesës: të paktën 20 tonë (8 mbi aksin e përparëm, 12 mbi aksin e pasëm, hapi 4 m).

#### 5.4 Afrimi i mjeteve të shpëtimin

Për strukturat akomoduese turistike të vendosura në lartësinë mbi 12 metër, duhet të sigurohet mundësia e afrimit të automjeteve autoskallë, të paktën nga njëra anë, me qëllim që të arrihet nëpërmjet dritareve dhe kalimeve të brendshme në kate, në objekte të ndryshme. Në rastet kur kjo kërkesë nuk është plotësuar, ndërtesat me lartësi mbi 12 metër duhet të kenë vendosur shkallë shpëtimi për evakuim, e cila më poshtë emërtohet “shkallë të provës së tymit”.

## 6. KARAKTERISTIKAT KONSTRUKTIVE

### 6.1 Rezistenca ndaj zjarrit e strukturave

Kërkesat e rezistencës ndaj zjarrit të elementeve strukturale, duhet të vlerësohen në bazë të përshkrimeve dhe modaliteteve të provës, të vendosura nga dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore, në varësi të tipit të materialit të përdorur, në realizimin e elementeve të ndërmjetme (beton, çelik, dru masiv, dru i laminuar, elementë përbërës, etj.).

Elementet strukturore duhet të jenë njohur ligjërisht në një nga vendet e Komunitetit European, në bazë të normave të harmonizimit ose të normave dhe rregullave teknike të huaja të njohura, ekuivalente nga vende kontraktuese të markave CEE, të cilat mund të tregtohen në vendin tonë. Për këtë qëllim, përdoruesi për secilin prototip duhet të disponojë certifikatat e cilësisë, situatë që motivon aprovimin ose mosaprovimin e materialeve.

Këto instanca, për të cilat bën fjalë paragrafi i mësipërm, duhet të kenë dokumentacionin e nevojshëm për indentifikimin e produktit, certifikatave relative të provës, të lëshuara ose të rinjohura nga organet kompetente të shtetit unitar të Komunitetit European, ose nga vende të tjera jashtë tij.

Dimensioni i spesorëve dhe i mbrojtjeve, për t’u adaptuar për tipe të ndryshme materialesh, si dhe klasifikimi i ndërtesave në funksion të ngarkesave të zjarrit, përcaktohen nga përlllogaritja e ngarkesave për zjarr, për objekte që kanë struktura mbrojtëse prej druri.

Kërkesat e rezistencës ndaj zjarrit të dyerve dhe elementeve të tjera mbyllse vlerësohen dhe certifikohen në bazë të dispozitave të parashikuara në akte nënligjore të veçanta të këtyre elementeve.

Strukturat mbrojtëse duhet të garantojnë rezistencën ndaj zjarrit (R) dhe strukturave ndarëse në to (REI) (rezistenca e pjesëve të brendshme të objektit ndaj zjarrit) në bazë të tabelës së mëposhtme:

Lartësia antizjarr	R	REI
Deri 24 m	60	60
Mbi 24 m deri në 54 m	90	90
Mbi 54 m	120	120

Për strukturat në lidhje me zonat me rrezik specifik të shtuar, duhet të aplikohen dispozitat e vendosura në norma nënligjore respektive të veçanta për to.

#### 6.2 Reaksioni i zjarrit ndaj materialeve.

Materialet e instaluar në strukturat akomoduese turistike duhet të kenë koeficientët specifikë si më poshtë:

a) në ambiente, në korridore, në shkallë, në sheshpushime shkallësh, në kalimet në përgjithësi, lejohet përdorimi i materialeve të klasës 1, në masën 50% të maksimumit të sipërfaqes së tyre totale (dysHEME+tavane+parete+projektimi horizontal i shkallëve), kurse për pjesën e mbetur duhet të përdoren materiale të klasës 0, jo të djegshme;

b) në të gjitha ambientet e tjera lejohet që dysHEMETË, duke përfshirë dhe riveshjet e tyre, të jenë të klasit 2 dhe të gjitha materialet e tjera të riveshjes të jenë të klasit 1, ose dhe të klasit 2 në qoftë se ka impiante të shuarjes automatike, ose të sistemeve të filtrimit të tymrave, të asistuar nga sisteme të zbulimit të zjarreve.

c) materialet e riveshjes së djegshme, si dhe materialet izoluese për të cilat bën fjalë germa “f” e mëposhtme, të shpërndara nëpër klasa të ndryshme të reaksionit të zjarrit duhet të përdoren si elemente konstruktive të klasit 0, duke përjashtuar hapësirat boshe; duke marrë parasysh kufizimet e përshkruara në germën “a” lejohet instalimi, si dhe i materialeve të riveshjes dhe materialeve izoluese, në pamje të vendosura të cilat kanë klasë të reaksionit ndaj zjarrit 1, ose 1-1 dhe janë të homologuara duke pasur parasysh kushtet efektive të përdorimit, në lidhje me burimet e mundshme të lindjes së harkut elektrik;

d) materiale të predispozuara të marrjes zjarr në të dyja anët, si: (tenda, etj.) duhet të jenë të klasës të reaksionit ndaj zjarrit më e madhe se 1;

e) mobiljet dhe dyshekët duhet të jenë të klasës së reaksionit ndaj zjarrit 1 IM;

f) materialet izoluese në pamje, që duken direkt dhe ekspozohen ndaj flakëve duhet të jenë të klasës së reaksionit ndaj zjarrit jo më të madhe se 1; në rastin e materialeve izoluese në pamje me komponentë izolues jo të ekspozuar direkt ndaj flakëve lejohen klasat e reaksionit ndaj zjarrit 0-1; 1-0; 1-1.

Materialet që bëjnë fjalë germa e mësipërme duhet të jenë të homologuara në bazë të dispozitave në fuqi.

Lejohet vendosja në punë e riveshjes prej druri, trajtuar në mënyrë oportune me prodhime të vernikuara, të homologuara të klasës 1 të reaksionit ndaj zjarrit. Materialet izoluese të instaluar në brendësi të ndarjeve duhet të jenë jo të djegshme.

Lejohet instalimi i materialeve izoluese jo të djegshme në brendësi të ndarjeve të realizuara nga struktura me materiale të padjegshme, që kanë rezistencë ndaj zjarrit të paktën REI 30.

#### 6.3 Ndarjet

Ndërtesat duhet të jenë të ndara me ndarje, sipërfaqja e të cilave nuk duhet t'i kalojë përmasat e tabelës A.

Pranohet se dy kate mbi tokë të ndërtesave përbëjnë një pjesë të vetme të ndërtimit, dhe sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit nuk duhet të jetë më e madhe se 4000 m<sup>2</sup>.

Kati i parë nëntokë, hapësirë e destinuar për të gjithë dhe në shërbim të publikut, lejohet me kusht që kjo sipërfaqe nuk duhet të tejkalojë përmasat 1000 m<sup>2</sup>.

Tabela A

Lartësia antizjarr	Sipërf. Mak e ndarjeve
Nën 24 m	3000 m <sup>2</sup>
Mbi 24 m dhe nën 54 m	2000 m <sup>2</sup>
Mbi 54 m	1000 (*) m <sup>2</sup>

(\*) ndarjet lejohen për t'u zgjeruar vetëm në një kat.

#### 6.4 Kate nëntokësore

Sipërfaqja e lirë në shërbim të publikut lejohet të vendoset vetëm deri në kuotat minus (-) 10,00 metër.

Për sa më sipër, zona e vendosur në kuotat -7,50 dhe -10,00 m, duhet të jenë të mbrojtur nga impiante automatike të fikjes së zjarreve me ujë, të ndara dhe të komanduara nga impiante zbulimi dhe sinjalizimi antizjarr.

#### 6.5 Korridoret

Ndarjet e dhomave dhe të korridoreve duhet të kenë karakteristikat e rezistencës ndaj zjarrit jo më vogël se REI 30. Dyert e dhomave duhet të kenë karakteristika të rezistencës ndaj zjarrit REI 30, si dhe të jenë pajisur me udhëzues për rastet e vetmbylljes.

#### 6.6 Shkallët

Karakteristikat e rezistencës ndaj zjarrit për shkallët duhet të përputhet me kërkesat, sa është parashikuar përshkrimet e pikës 6.1.

Shkallët e shërbimit, për ndarjet në më shumë se dy kate mbi tokë, duhet të jenë të tipit të mbrojtur.

Shkallët e shërbimit, për ndarjet në më shumë se gjashtë kate, duhet të jenë të tipit të provës së tymit.

Gjerësia e shkallëve nuk mund të jetë më e vogël se 1,20 metër.

Basamakët e shkallëve duhet të jenë në linjë të drejtë, në mënyrë të tillë, por jo më pak se tri shkallë dhe jo më shumë se pesëmbëdhjetë të tilla. Shkallët duhet të jenë drejtëkëndore, duhet të kenë lartësinë jo më të vogël se 17 cm dhe jo më të madhe se 30 cm. Janë lejuar basamakë shkallësh jo në linjë të drejtë, në kondicione të tilla që janë sheshpushime në çdo pesëmbëdhjetë shkallë. Përmasat e shkallës mund edhe të jenë 30 cm deri në 40 cm të paretit të brendshëm.

Kafazët e shkallëve nuk duhet t'i kenë përmasat e ajrimit më të vogla se 1 m<sup>2</sup>. Në kafazët e ajrimit këshillohet të instalohen dhe të aplikohen dispozitivat për mbrojtjen nga agjentët atmosferikë.

#### 6.7 Ashensorët dhe ashensorët për ngarkesa

Ashensorët, ashensorët për ngarkesa nuk janë të dobishëm për t'u përdorur për rastet e zjarreve, për këtë qëllim bëjnë pjesë ashensorët antizjarr, sipas përcaktimeve të pikës 6.8. Ashensorët dhe ashensorët për ngarkesa, që nuk janë instaluar nga brenda në një shkallë të tipit të mbrojtur, duhet të jenë të tipit me kafaz të mbrojtur, me karakteristikat dhe rezistencat nga zjarri sipas përcaktimeve të pikës 6.1.

Karakteristikat e ashensorëve dhe të ashensorëve për ngarkesa duhet të përputhen me specifikimet e dispozitave në fuqi për parandalimin e zjarreve.

#### 6.8 Ashensorët antizjarr

Në strukturat e objekteve akomoduese turistike me lartësi mbi 54 metër, duhet të vendosen dhe të jenë parashikuar që në projekt ashensor antizjarr, i cili është i dobishëm për rastet e zjarreve në operacione të ndihmës për evakuim të pranishmëve i cili realizohet si më poshtë:

1. Hapësirat e strukturave të këtyre objekteve, ku vendosen këto pajisje duhet të kenë rezistencën ndaj zjarrit REI 120; hyrjet për zbritjet nga katet duhet të kenë kaluar provën filtrave të tymit, me rezistencë ndaj zjarrit REI 120; hyrja në objekte të këtyre pajisjeve duhet të jenë vendosur direkt nga jashtë, nëpërmjet filtrit të provës së tymit, kjo e realizuar me materiale strukturore me rezistencë ndaj zjarrit REI 120;

2. Ashensorët antizjarr ndërtohen në mënyrë të tillë që të kenë dopio sistem ushqimor elektrik, ku njëra është për siguri;

3. Për rastet e zjarreve duhet realizuar kalimi automatik i ushqimit normal dhe i ushqimit për siguri;

4. Në rastet e zjarreve, këta ashensorë i rezervohen personelit të strukturave të shërbimit zjarrfikës dhe atyre të shpëtimit;

5. Montimi i ushqimit elektrik normal, për sigurimin e këtyre objekteve të pajisjeve ashensor antizjarr duhet të jenë të mbrojtur kundër zjarreve dhe të ndara qartë;

6. Ashensorët antizjarr duhet të jenë pajisur me sistem citofonie në kabinë;

7. Për ashensorët antizjarr duhet të parashikohen hapësira të veçanta në këto objekte.

## 7. PËRMASAT PËR EVAKUIM NË RAST EMERGJENCE

### 7.1 Përqendrimi i personave

Përqendrimi i personave të caktuar në:

- zona të destinuara për dhoma: sipas numrit të vendeve të shtretërve;

- zona në shërbim të publikut: destinuar për grumbullime për 0,4 persona/m<sup>2</sup>, përcaktuar sipas pikës 8.4.4;

- zona të destinuara për shërbim: persona pranishëm të grumbulluar, më pak se 20%.

### 7.2 Kapaciteti i daljeve (fluksit)

Në fund të dimensioneve të daljeve, kapacitetet e fluksit të daljeve duhet të jenë jo më të mëdha se vlerat pasuese:

- 50 persona për kate tokësore;

- 37,5 persona për kate nëntokësore;

- 37,5 persona për objekte deri në tre kate;

- 33 persona për objekte mbi tre kate.

### 7.3 Sistemet e rrugëve të daljes

Për objekte ose pjesë objektesh, që janë të destinuara për veprimtari akomoduese turistike, duhet të jetë i parashikuar rezervë një sistem i organizuar rrugë daljeje, dimensionuar në bazë të maksimumit të fluksit të parashikuar në funksion të kapaciteteve të fluksit, që parashtron një vend i sigurt.

Rrugëkalimet përfshijnë korridoret, hapësirat e shkallëve dhe daljet e jashtme, shkallët, sheshpushimet midis shkallëve etj.

Duhet të jetë parashikuar të paktën një hapësirë e qetë për çdo kat, ku kanë hyrë persona me kapacitet të pakësuar ose të penguar. Hapësirat e qeta duhet të jenë të dimensioneve të ulëta në numër, të dobishme dhe të parashikuara në aktet normative në fuqi.

Largësia e nevojshme duhet të jetë e përmasave të deduksionit të ngarkesës së mundshme, si elemente të dala ekskluzivisht sipas pajisjeve të fikësve të zjarrit.

Ndërmjet elementeve të dala nuk janë konsideruar këto përmasa, lartësia e lejuar është maksimumi 2 m dhe mundësisht druri i paretit të shkallëve nuk duhet të kalojë përmasat mbi 8 cm.

Duhet të evitohet vendosja sipërfaqësore ose e penguar e drejtimit të daljes.

Portat e hyrjes për në shkallë kur hyn nga jashtë, për në vendin e mbrojtur, duhen të jenë të vendosura për t'u hapur në krahun e daljes për jashtë, me një shtyrje të thjeshtë.

Dyert e dhomave për të ftuarit duhet të jenë të pajisura me një bravë që zhbllkohet automatikisht nga brenda duke e shtyrë lehtësisht në rast rreziku.

Dyert që hapen në drejtim të rrugëve të daljes duhet të jenë ndërtuar në mënyrë të tillë që të kenë largësinë e nevojshme të po atij drejtimi.

### 7.4 Gjerësia e rrugëve të daljes

Gjerësia e nevojshme e rrugëve të daljes duhet të jetë shumfishi i modulit të daljeve, por jo më pak se dy dalje për çdo objekt moduli (1,20 m). Përmasat e largësisë së daljes duhet të jenë realizuar në pikën më të ngushtë të dritës.

Bën përjashtim largësia e korridoreve të brendshme në apartamente që ushtrojnë veprimtari akomoduese dhe e dyerve të dhomave.

### 7.5 Gjatësia e rrugëve të daljes

Nga dyert e çdo dhome, nga çdo pikë e objektit, duhet të jetë e mundur për t'u kapur një

dalje, për te vendi i sigurt ose te shkallët e jashtme të sigurisë, me një rrugë të përshkruar, por jo më të gjatë se 40 m.

Është pranuar për objektet deri në 6 (gjashtë) kate, rruga e përshkruar e arritur drejt daljes për në shkallën e mbrojtur, nuk duhet të jetë më shumë se 30 m, me kusht që i njëjti drejtim të futet direkt për në vendin e sigurt.

Gjerësia e korridorit të verbër nuk mund t'i kalojë të 15 m.

#### 7.6 Gjerësia totale e daljeve

Gjerësia totale, në çdo kat, shprehur në numër modulesh, është e përcaktuar nga raporti në mes maksimumit të grumbullimeve parashikuar në kapacitetet e fluksit të kateve.

Për strukturat që kryejnë veprimtari akomoduese dhe që zënë më shumë se dy kate mbi tokë, gjerësia totale e rrugëve të daljes që vendosen në hyrje, vjen e llogaritur duke shtuar maksimumin e grumbullimeve të parashikuara në dy kate pasuese, me referimin e vlerave të mbivendosjes.

Në brendësi të gjërësisë së daljes janë mbështetur portat e hyrjes, kur këto janë të hapshme në drejtim të daljes.

Është e këshillueshme të instalohen këto lloj portash hyrjeje:

a) tip i rrotullueshëm, nëse pranë është instaluar një portë e hapshme, e shtytshme në drejtim të jashtëm me karakteristikat e daljes.

b) tip i rrëshqitshëm me lëvizje automatike, veçanërisht të jenë të hapshme me të shtyrë, kur mungon ushqimi elektrik.

Shkallët e lëvizjes nuk duhet të parashikohen në gjerësinë e daljes.

#### 7.7 Numri i daljeve

Numri i daljeve në ndërtesat njëkatëshe nuk duhet të jetë më pak se dy. Ato shkojnë në mënyrë të tillë që të jenë në krah të kundërt. Është e këshillueshme që ndërtesat me mbi dy kate të jenë të ndërtuara vetëm nga një shkallë e vetme, sepse thëllësia e korridorit që përshkrohet, nuk i kalon 15 m dhe ndalen duke qëndruar në shikimin e pikës 7,5 m në drejtimin e parë.

Në strukturat akomoduese njëkatëshe në të gjitha dhomat që kanë hyrjet direkt me daljet, nuk është e nevojshme realizimi i një daljeje të dytë eksodi brenda zonës së rezervuar të dhomës.

### 8. ZONA DHE IMPIANTE ME RREZIK TË VEÇANTË

#### 8.1 Objekte të përcaktuara për depozita

8.1.1 Objekte me sipërfaqe jo më të vogël se 12 m<sup>2</sup>, destinuar për magazinimin e materialeve të djegshme

Ndarje të tilla mund të jenë të vendosura edhe në sipërfaqe të brendshme (dhome). Strukturat ndarëse duhet të kenë të paktën karakteristika REI 60, si dhe të jenë të pajisura me pajisje vetkyçëse në raste rreziku. Ngarkesa e flakës duhet të jetë kufizuar në 60 kg/m<sup>2</sup> dhe duhet të jetë instaluar në to një impiant automatik diktimi e alarmi për zjarret. Ventilimi natyral nuk duhet të jetë më pak se 1/40 e sipërfaqes të objektit.

Në qoftë se nuk është e mundur të arrihet ajrimi natyral i raportit të mësipërm, realizohen dy ajrime mekanike, në prurjen e dy orareve të garantuara edhe në rastet e emergjencave, deri sa të sigurohet një sipërfaqe ajrimi e barabartë me 25% të asaj të parashikuar.

Pranë dyerve të dhomave, duhet të jetë instaluar një fikëse zjarri.

8.1.2 Objekte me sipërfaqe maksimumi 500 m<sup>2</sup>, destinuar për magazinimin e materialeve të djegshme

Mund të jenë të vendosura edhe në sipërfaqe nëntokësore në brendësi të ndërtesës duke përjashtuar sipërfaqet e dhomave. Strukturat ndarëse duhet të paktën të kenë karakteristika REI 90 dhe të jenë të pajisura me pajisje vetkyçëse për rastet e rrezikut. Ngarkesa e flakës duhet të jetë e kufizuar në 60 kg/m<sup>2</sup> dhe duhet të jetë instaluar në të një impiant automatik alarmi për lajmërimin e zjarrit. Ventilimi natyral nuk duhet të jetë më pak se 1/40 e sipërfaqes të objektit.

- kategoria C, D, dhe E: kampe që nuk hyjnë në kategoritë e mëparshme, që vijnë të klasifikuara në funksion të situatës të objekteve me referim të lartësisë, në vazhdim të vështirësisë së hyrjes, për më tepër të përqindjes së sistemit normalisht të adoptuar për furnizim.

Nuk hyjnë në asnjë kategori kampet alpine të fushimit të përkoshëm, duke nënkuptuar me këtë përcaktim ndërtime modeste të përshtatura për fjetjen e alpinistëve, me kujdesjet e mëposhtme:

- gjithmonë të ruajtura dhe të hapura në vazhdimësi, pa prezencën e ushqimeve dhe pajisjeve të gatimit, por me nevojën e ngushtë për pushim dhe shtrim emergjence.

### 24. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Pavarësisht nga kategoria së cilës i përkasin, mbrojtja antizjarr në çdo kamp duhet të ketë synim që:

- të ulë rrezikun që mund të vijë nga një zjarr;
- të kufizojë përhapjen e zjarreve dhe tymrave;
- t'u lejojë të gjithë frekuentuesve të dalin të padëmtuar.

Në veçanti duhet të respektohen dispozitat e mëposhtme:

a) burimet e harqeve elektrike: duhet të jenë eliminuar harqet elektrike; duhet të vendoset ndalimi i përdorimit të duhanit, si dhe ndezja e zjarreve, përjashtim mund të bëhet për objektet që do të flitet më poshtë në germën "f";

b) aparaturat e pjekjes: mbi aparaturat e pjekjes (furnela, kuzhina) në afërsi të kampeve që funksionojnë me gaz, cila qoftë fuqia e tyre duhet të jenë instaluar rubineta me valvula, përveç një valvule kryesore të sinjalizuar me përjashtim të kampeve që bën fjalë pika 25, bombola eventuale të gazit duhet të vendosen nga jashtë kampeve dhe pa ndonjë komunikim direkt ndërmjet tyre.

c) depozita të rrezikshme: depozitat me substanca të ndezshme, produktet që marrin flakë lehtë, mbeturinat etj, duhet të jenë vendosur nga jashtë kampeve ose lokaleve të ndara pa komunikim direkt;

d) portat e daljeve: nga portat e daljeve duhet të jenë eliminuar mbylljet me çelës nga brenda, dispozitivët me shul me rëshqitje, ose të ngjashme me to, duke garantuar hapjen me ngritjen e dorezës nga brenda, mbyllja eventuale mund të vijë vetëm nga jashtë, në rastin në periudhat e pushimeve të këtij aktiviteti; në rastet kur në kushtet e rënies të dëborës bëhet e nevojshme, që portat e eksodit të vendosura nga jashtë mund të hapen nga brenda;

e) zgarat e hekurit: zgarat e hekurit ose çdo lloj mbrojtëse tjetër fikse e dritare, që nuk lejon përdorimin si rrugë eksodi emegjence në të njëjtën mënyrë (njëlloj), gjithashtu hapja ndaj ndihmave duhet eliminuar;

f) lokale të përshtatura për gatim ushqimesh: edhe nga ana e të ftuarve duhet të jenë të mbrojtura nga mure të paktën deri në lartësinë 150 cm nga toka, dhe mbi dyshemetë të paktën rezja 100 cm rreth e qark vendit ku do të jetë zjarri me flakë të lirë, me materiale të reaktionit ndaj zjarrit të klasës 0; largësia në zonat e mbrojtura nuk duhet të zgjatet për të njëjtat reze prej 100 cm;

g) burime të nxehtësisë: për qark stufave me reze të paktën 1 m lartësi dhe largësi duhet të jenë vendosura mbrojtje të padjegshme; kanalet e tymit nëpër brendësi ose në afërsi të materialeve të djegshme duhet të jenë të mbrojtur duke evituar që të kenë kontakt me temperaturat, në gjendje të mos provokojnë hark elektrik me veten; për operacionin e tharrjes së robave duhet të jenë parashikuar vende të posaçme ose mbështetëse fikëse në distancë të përshtatshme nga burime të nxehtësisë, ku evitohet mundësia e ndezjes (harkut elektrik);

h) dispozitivat e thirrjeve: ku nuk është present ose disponibël për emergjencë, një aparat telefonik duhet të jetë instaluar në pozicion të dukshëm e të mbrojtur një aparat radio thirrje me ushqim të pavarur, mbajtëse fikëse në mënyrë që të çojë automatikisht lajmërimin për shpëtim (njoftimin e ndihmës për një periudhë jo më të vogël se 2 orë, e diferencuar në bazë të tipit të ndërhyrjes së kërkuar dhe kodifikuar për identifikimin dhe individualizim;

i) pajimet e emergjencës: kur kuotat e kampit i kalojnë të 1200 m mbi nivelin e detit dhe për kuota më të ulëta, kushtet meteorologjike lokale që mund të prezantohen e paraqiten janë të afrueshme me ato të këtyre kuotave, duhet të jetë e pranishme qesja e emergjencës. Ky disponibël i vulosur përbëhet nga një pëlhurë e aluminuar në formë thesi të përshtatshëm (të aftë) të përmbajë një alpinist. Thasët e emergjencës në numër të barabartë sa kapacitetet maksimale të kampit të rritura me 20 %, duhet të jenë të ruajtura në një vend të veçantë, qartësisht të shenjuara ku janë parashikuar tregues të qartë për përdorimin e tyre, të vendosura në një distancë nga kampi në mënyrë të tillë që të mos përfshihet nga zjarret eventuale;

j) skeda teknike: nën kujdesin e titullarit të aktivitetit duhet të redaktohen skedat teknike, që tregojnë karakteristikat e çdo kampi me qëllim primar atë të mbrojtjes nga zjarri, në të cilat duhet të shënohet emri, mbiemri i administratorit dhe përgjegjësi i aktivitetit; përgjegjësi i sigurimit duhet të procedojë të paktën një herë në vit me kontroll të përgjithshëm të situatës të pajimeve të parashikuara dhe efikasitetin e pajisjeve.

## 25. KAMPE ME KAPACITET JO MË TË MADH SE NJËZET E PESË SHTRETËR

Kampet alpine të çdo kategorie, me kapacitet jo më të madh se 25 shtretër, duhet të respektojnë sa është parashikuar në gerat e mëposhtme:

a) strukturat horizontale dhe vertikale të kampeve me konstruksione të reja duhet të posedojnë karakteristika të rezistencës ndaj zjarrit jo më të vogla se R 30. Këto përshkrime nuk aplikohen për kampet ekzistuese;

b) duhet të kryhen prova periodike të paktën me frekuencë vjetore duke respektuar përshkrimet e pikës 24;

c) lejohet mbajtja në brendësi të lokaleve një bombul GLP, me peshë që të mos i kalojë 25 kg, me qëllim që kjo të përdoret për ushqimin e pajisjeve të gatimit;

d) duhet të jenë instaluar fikësa zjarri konform sa është përshkruar në kërkesat e pikës 11.2.

## 26. KAMPE ME KAPACITET MË TË MADH SE NJËZET E PESË SHTRETËR

### 26.1 Kampe të kategorisë A

Kampet alpine të kësaj kategorie aplikohen në bazë të faktit, nëse janë të reja ose ekzistuese, dispozitat për të cilat bën fjalë pjesa e parë dhe e dytë të kapitujve të kësaj rregulloreje.

### 26.2 Kampe të reja të kategorive B, C, D, E

Për kampet e kësaj kategorie vlejnjë të njëjtat dispozita të kapitullit II të pjesës parë, por duhet vërejtur që:

- nuk janë respektuar përshkrimet e pikëve 5.3 dhe 5.4 dhe janë të disponueshme përveç të tjerash të paktën shkallë të vogla në gjendje për të shkuar në të gjithë katet e ndërtesës; për lartësi 6 m shkallët duhet të jenë fikse; vendodhja e shkallëve duhet të jetë e treguar qartë e dukshëm për të treguar një përdorim të thjeshtë dhe të lehtë nga ana e të ndihmuarve;

- frekuenca e provave periodike për të cilat bën fjalë pika 14.1, duhet të jetë të paktën njëvjeçare;

- për kampet e kategorisë C, D dhe E deri në dy kate mbi tokë është lejuar që numri i daljeve të jetë një, për çdo kat.

### 26.3 Kampe ekzistues të kategorisë B

Për të tilla kampe vlejné dispozitat e përshkruara në kapitullin II pjesa e dytë. Gjithashtu kërkohet që:

- të jenë të disponueshme shkallë të kryqëzuara në gjendje për të arritur katet e ndërtesës; për lartësi mbi 6 m, shkallët duhet të jenë fikse; vendodhja e shkallëve duhet të jetë treguar qartë për një përdorim të thjeshtë nga ana e personave që kërkojnë ndihmë;

- që të ketë për çdo ndërtesë më shumë se dy kate mbi tokë dhe për çdo kat një dalje të dytë eksodi, që të garantojë shpopullimin e nevojshëm.

Është e lejuar gjithashtu:

a) rezistenca ndaj zjarrit të këtyre strukturave, pavarësisht nga ngarkesa e zjarrit dhe lartësia e ndërtesës të jetë jo më e vogël se REI 30;

b) nuk aplikohen përshkrimet në lidhje me ndarjet me karakteristika të rezistencave ndaj zjarrit midis korridoreve dhe dhomave, për të cilat bën fjalë pika 19.5;

c) shkallët duhet të jenë të tipit të mbrojtur në ndërtesat me tre kate mbi tokë;

d) gjerësia minimale e rrugëve të eksodit nuk duhet të jenë më të vogla se 60 cm, pa reduktimet e tolerancave dimensionale, llogaritur për një kapacitet fluksi të paktën për 30 persona; për gjërësi të barabartë ose më të mëdha se 90 cm, pranohet sa është përshkruar në pikën 20.2;

e) rrugët e daljes, referuar sa më sipër janë të ndërtuara nga shkallë të kryqëzuara të realizuara nga materiale jo të djegshëm të vendosura nga jashtë kampeve, të ankoruara në mënyrë solide me karakteristikat minimale: gjerësi jo më të vogla se 35 cm në pjesën e kryqëzimit, lartësia neto jo më e madhe se 30 cm dhe me kryqëzues, kryqëzime të larguara të paktën 15 cm nga paretet; shkallë të tilla duhet të jenë të arritshme nëpërmjet kafazëve të hapshëm të dimensioneve neto, jo më të vogla se 60 cm gjerësi, si dhe 80 cm lartësi; çdo shkallë me kryqëzimin duhet të jetë e llogaritur për një kapacitet daljeje fluksi të barabartë për 20 persona; shkallë të tilla duhet të jenë realizuar konform normave antiaksident dhe gjithashtu duhet të parashikojnë parmacë të vazhduar për të paktën 30 cm, nga filli i kryqëzimit; për lartësi të shkallëve të kryqëzuara më të larta se 10 cm duhet të jetë parashikuar një shesh pushimi të paktën 70 cm, me zgjatje dhe 50 cm me parapet normal dhe ndalues këmbësh, nga e cila është e mundur të marrësh distancën për në një shkallë tjetër më të afërt;

f) dispozitivët e ndriçimit të sigurisë dhe të alarmit ushqehen, kur nuk disponohet energji elektrike nga një burim tjetër alternativ, grup elektrogjen, gjenerator ere, gjenerator me diell etj;

g) në pamundësi për të realizuar një impiant hidrik antizjarr për mungesë të burimeve hidrike të përshtatshme, përshkrimet e pikës 11.3 zëvendësohen të paktën me fikësa me kapacitet 13 A dhe 89 BC për çdo 50 m<sup>2</sup> dhe sidoqoftë me një fikës për çdo kat;

h) frekuenca e provave periodike, që bën fjalë pika 14.1, të jetë të paktën njëvjeçare.

### 26.4 Kampe ekzistuese të kategorive C, D dhe E

Në të tilla kampe aplikohen përshkrimet e pikës pararendëse 26.3, me përjashtim sa kërkohet nga pikat "a" dhe "c".

Është lejuar gjithashtu që kur nuk ka ushqim elektrik, ndriçimi i sigurisë të jetë me llampa të lëvizshme me ushqim automatik dhe sisteme alarmi, që vihen në punë në mënyrë manuale.

### 27. DISPOZITA TRANZITORE

Kampet alpine ekzistuese duhet të përshtaten me këto dispozita të pranishme në këtë rregullore, brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e saj.

**LIGJ**  
**Nr.9482, datë 3.4.2006**

**PËR LEGALIZIMIN, URBANIZIMIN DHE INTEGRIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9786, datë 19.7.2007;  
ndryshuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008;  
ndryshuar me ligjin nr.10 099, datë 19.3.2009;  
ndryshuar me ligjin nr.10 169, datë 22.10.2009;  
ndryshuar me ligjin nr.10 219, datë 14.2.2010)*

*I përditësuar*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

**Objekti i ligjit**

*(Ndryshuar pika 1 dhe pika 4 me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 1)*

Ky ligj ka për objekt:

1. Legalizimin e ndërtimeve informale dhe të objekteve me leje, me shtesa informale në objekt.
2. Kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore, ku është ngritur ndërtimi pa leje, sipas përcaktimit të bërë në nenet 19, 20, 21 e 22 të këtij ligji.
3. Urbanizimin e zonave, blloqeve informale e të ndërtimeve informale, si dhe integrimin e tyre në zhvillimin territorial dhe infrastrukturor të vendit, duke përmirësuar kushtet e jetesës.
4. Procedurat për realizimin e legalizimit të ndërtimeve informale/objekteve me leje, me shtesa informale në objekt dhe ngritjen e funksionimit të strukturave përgjegjëse për realizimin e tyre.

Neni 2

**Fusha e zbatimit**

*(Shfuqizuar pika 3 me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 2/1;  
shtuar pikat 4/1 dhe 4/2 me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 2/2;  
zëvendësuar fjalët në pikën 5 me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 2/3)*

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha objektet e ndërtuara pa leje, të ngritura para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, pavarësisht nëse ato kanë funksion strehimi, veprimtarie ekonomike apo funksione të tjera social-kulturore, të ngritura dhe që disponohen nga individë apo persona juridikë të regjistruar e që veprojnë sipas të drejtës tregtare shqiptare.

Këshilli i Ministrave përcakton kriteret, procedurat dhe dokumentacionin e zbatueshëm për të kualifikuar objektet në ndërtime, që legalizohen ose jo.

2. Ngrehinat funksionale (mure rrethuese) dhe objektet ndihmëse (garazh etj.) në shërbim të ndërtimeve pa leje, të përfunduara brenda afatit të parashikuar sipas pikës 1 të këtij neni, legalizohen vetëm në qoftë se janë ngritur brenda sipërfaqes së parcelës ndërtimore, që legalizohet sipas neneve 19, 20, 21 e 22 të këtij ligji.

3. Shfuqizuar.

4. Fusha e veprimt të këtij ligji nuk shtrihet për ndërtimet pa leje të ngritura mbi troje private brenda vijës së verdhë, kur planet rregulluese urbanistike parashikojnë ndërtime mbi 5 kate nga niveli zero.

4/1. Fusha e zbatimit të këtij ligji nuk shtrihet për ndërtimet informale mbi 3 kate, të ngritura në troje private, brenda vijës së verdhë, kur ato nuk janë shtesa informale në objekt, sipas përcaktimit të bërë në nenin 1 të këtij ligji.

4/2. Fusha e zbatimit të këtij ligji nuk shtrihet për ndërtimet informale brenda një distance prej 100 metrash nga akset rrugore kombëtare, me përjashtim të rasteve kur ndërtimi informal përfshihet brenda një zone informale të miratuar.

5. Të gjitha ndërtimet e tjera pa leje, të cilat nuk u përgjigjen kushteve të përcaktuara në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, si dhe ato për të cilat nuk është kërkuar legalizimi brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 7 të këtij ligji, prishen sipas ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

### Neni 3

#### **Përkufizime**

*(Shfuqizuar fjalët në shkronjën “a” me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 3/1; riformuluar shkronjat “b,c,ç” me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 3/2/3/4; ndryshuar shkronja “d” me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 3/5; shfuqizuar shkronja “e” me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 3/6; shtuar shkronja “gj/1” me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 3/7; shfuqizuar fjalët në shkronjën “i” me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 3/8; ndryshuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 2.2.2009)*

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Ndërtim pa leje” është objekti, për të cilin është përfunduar konstruksioni dhe mbulesa, i destinuar për banim, veprimtari ekonomike dhe/ose funksione të tjera (si për shembull, social-kulturor, arsim, shëndetësi e të tjera të këtij lloji), për të cilin nuk janë respektuar procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”.

Në ndërtimet pa leje bëjnë pjesë edhe tejkalimet dhe shtesat informale të objekteve të ndërtuara me leje brenda vendbanimeve formale nga subjekte, persona fizikë dhe juridikë, privatë, për qëllime shitblerjeje/qiradhënieje (banesa, zyra, dyqane, punishte, parkim etj.) ose për vete.

b) “Zonë me ndërtime të legalizuara” është territori me sipërfaqe mbi 5 ha, i zënë nga ndërtime të legalizuara, që nuk gëzon mbrojtje të veçantë nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

c) “vendbanim me ndërtime të legalizuara” është territori me sipërfaqe mbi 5 ha, i miratuar zyrtarisht për zonë të banuar urbane (qytet) ose rurale (fshat), i zënë nga ndërtime të legalizuara.

ç) “bllokbanim me ndërtime të legalizuara” është territori me sipërfaqe mbi 1 ha deri në 5 ha, brenda ose jashtë vendbanimit formal, i zënë me ndërtime të legalizuara.

d) “kufiri i zonës/vendbanimit/bllokbanimit me ndërtime të legalizuara” është vija gjeografike e shtrirjes territoriale të ndërtimeve të legalizuara, për të cilin do të miratohet studimi urbanistik, sipas dispozitave në fuqi, nga KRRTRSH-ja dhe/ose KRRT-të përkatëse.

dh) “Vendbanim formal” është territori i përfshirë brenda vijave kufizuese (të verdha), të miratuara zyrtarisht për zonat e banuara urbane (qytet) ose rurale (fshat).

e) shfuqizuar.

ë) “Territore të tjera” janë tokat bujqësore (tokë arë, sipërfaqe fruti/perime-kulturë, ullishte, vreshta) dhe tokat jobujqësore (pyje, kullota e toka të pafrytshme).

f) “Parcela ndërtimore” janë sipërfaqet e zëna nga pronari i ndërtimit pa leje.

g) “Pronar i ndërtimit pa leje” është personi fizik ose juridik, që ka kryer vetë ose ka qenë investitor i ndërtimit pa leje dhe vërteton se e posedon ose e disponon lirisht atë dhe parcelën ndërtimore, pavarësisht nga fakti se pronësia mbi to është e peregjistruar në emër të tij në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP).



gj) “Leje legalizimi“ është dokumenti, që lëshohet sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj nga zyra përkatëse e ALUIZNI-t dhe që shërben për regjistrimin e objektit në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

gj/1) “kartela e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme të legalizuar” është dokumenti, që hartohet nga ALUIZNI, për regjistrimin fillestar të pasurisë së paluajtshme të legalizuar.

h) “Njësi e qeverisjes vendore” janë komuna dhe bashkia. Njësia bashkiake (për Tiranën) dhe qarku referohen në këtë ligj jo me emërtimin “njësi e qeverisjes vendore”, por përkatësisht me emërtimin “njësia bashkiake” dhe “qarku”.

i) “ALUIZNI” është agjencia e posaçme shtetërore e krijuar sipas këtij ligji, me emërtimin “Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale”, e cila bashkërendon punën nëpërmjet organeve qendrore shtetërore dhe njësive të qeverisjes vendore/njësive bashkiake dhe jep lejen e legalizimit sipas këtij ligji.

## KREU II ORGANET QENDRORE DHE VENDORE PËR LEGALIZIMIN, URBANIZIMIN DHE INTEGRIMIN E ZONAVE/NDËRTIMEVE DHE SHITESAVE INFORMALE

### Neni 4

#### **Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale**

*(Ndryshuar neni me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 4;  
ndryshuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 2.2.2009)*

1. Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale bashkërendon punën me organet qendrore shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore për:

a) hartimin dhe miratimin e studimeve urbanistike;

b) bashkëpunimin dhe njësimin e procedurave me organet qendrore shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për procesin e legalizimit, urbanizimit dhe integritit të zonave/vendbanimeve/bllokbanimeve me ndërtime të legalizuara;

c) programimin e fondeve nga Buxheti i Shtetit për legalizimin dhe urbanizimin e territoreve informale;

ç) programimin e fondeve nga Buxheti i Shtetit për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale dhe rregullimet e nevojshme ose, sipas rastit, në vendbanimet formale;

d) dhënien e lejes së legalizimit, sipas nenit 28 të këtij ligji.

2. ALUIZNI, në zbatim të detyrave të vendosura nga ky ligj, kryen:

a) fushatën kombëtare të informimit dhe të sensibilizimit të qytetarëve, në bashkëpunim me mjetet e informimit të gjerë publik, në nivel kombëtar;

b) fushatën kombëtare të informimit dhe të sensibilizimit të qytetarëve, në bashkëpunim me mjetet e informimit të gjerë publik, në nivel kombëtar;

c) ngritjen e bazës së të dhënave për ndërtimet pa leje dhe ecurinë e legalizimit;

ç) përgatitjen e manualeve të procedurave, udhëzimeve dhe formularëve.

3. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të kësaj agjencie, të drejtorisë qendrore, drejtorive në nivel qarku dhe zyrave pranë njësive të veçanta të qeverisjes vendore përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

### Neni 5

#### **Detyrat e njësisë së qeverisjes vendore**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 5;  
ndryshuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 2.2.2009)*

Sipas këtij ligji, njësia e qeverisjes vendore ka këto detyra:

a) ngre strukturat e nevojshme për pranimin, trajtimin dhe kontrollin e vetëdeklarimeve të

objekteve pa leje, si dhe për zbatimin e detyrave të përcaktuara në këtë ligj, për kryerjen e procesit të legalizimit.

Në Bashkinë e Tiranës vetëdeklarimi kryhet pranë 11 njërive bashkiake të qeverisjes vendore, njësi të krijuara dhe të organizuara sipas ligjit nr.8654, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”;

b) identifikon në terren ndërtimet pa leje, për të cilat nuk është bërë vetëdeklarimi, identifikon të gjitha rastet eventuale të ndërtimeve pa leje, të kryera pas miratimit të këtij ligji dhe nis procedurat për prishjen e tyre, sipas ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” ;

c) arkëton pagesat e kryera nga subjekti, që legalizon ndërtimin në përputhje me këtë ligj, me përjashtim të truallit të parcelës ndërtimore;

ç) administron të ardhurat e krijuara dhe monitoron përdorimin e tyre në përputhje me këtë ligj;

d) bashkërendon punën, sipas rastit, me këshillin e qarkut, ALUIZNI-n, ministritë e linjës dhe KRRTRSH-në, për mbarëvajtjen dhe ecurinë e procesit të legalizimit, urbanizimit dhe integritetit të zonave informale.

#### Neni 6

### **Detyrat e njësisë së urbanistikës të njësisë së qeverisjes vendore** *(Shfuqizuar shkronjat “a” e “b” me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 6)* *(Ndryshuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 2.2.2009)*

Njësia e urbanistikës pranë njësisë së qeverisjes vendore, sipas këtij ligji, ka këto detyra:

a) verifikon gjendjen reale të ndërtimeve në vend dhe sipas dokumentacionit të përcaktuar në pikën 3 të nenit 2 të këtij ligji, harton ose porosit hartografinë dhe ndërton sistemet e nevojshme të informacionit;

b) bën përditësimin teknik të planvendosjes në terren të ndërtimeve pa leje dhe të territoreve të zëna nga këto të fundit, në kufijtë dhe shtrirjen sipërfaqësore të vendbanimit formal, të zonës informale (miratuar nga KRRTRSH-ja) ose të territoreve të tjera;

c) harton detyrat e projektimit për studimet urbanistike dhe harton ose porosit studimet urbanistike, sipas këtij ligji;

ç) mbledh dokumentacionin gjatë procesit të vetëdeklarimit dhe ia dorëzon atë zyrës përkatëse të ALUIZNI-t për shqyrtim për leje legalizimi.

Për ushtrimin e përgjegjësive të caktuara në këtë ligj, këto struktura mund të punësojnë personel shtesë.

## KREU III PROCEDURAT DHE AFATET

### Neni 7 **Vetëdeklarimi**

1. Të gjitha subjektet që disponojnë ndërtime pa leje janë të detyruara që, duke filluar nga 60 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, t'i vetëdeklarojnë ato (objektin pa leje dhe parcelën ndërtimore) pranë zyrës së urbanistikës të njësisë përkatëse.

1.1. Zyra e urbanistikës pranë njësisë së qeverisjes vendore, në përputhje me detyrat e ngarkuara nga ky ligj, është e detyruar të pranojë vetëdeklarimet për një periudhë 4-mujore nga data e fillimit të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni. Për organet e qeverisjes vendore, të organizuara në njësi administrative ose rajone, vetëdeklarimi kryhet pranë këtyre njërive ose zyrave të rajonit.

Ndërtimi pa leje dhe sipërfaqja e parcelës ndërtimore vetëdeklarohen sipas formularit, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është shtojca “A” e tij.

2. Periudha e vetëdeklarimit është një proces vullnetar për të gjitha subjektet gjatë 2 muajve të parë, ndërsa gjatë 2 muajve të dytë të saj procesi i vetëdeklarimit shoqërohet me sanksione, sipas

nenit 8 të këtij ligji. Sanksionet e zbatuara sipas nenit 8 të këtij ligji, kalojnë për llogari të qeverisjes vendore ku kryhet vetëdeklarimi.

#### Neni 8

##### **Sanksionet e zbatueshme për mosrespektim afati**

Kur vetëdeklarimi nuk kryhet brenda afateve ligjore të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 7 të këtij ligji, vendoset kjo masë gjobe:

I. Për “vendbanimet informale” dhe “territore të tjera”:

a) brenda muajit të tretë, vetëdeklarimi shoqërohet me gjobë 10 lekë për metër katror sipërfaqe toke të zënë;

b) brenda muajit të katërt, vetëdeklarimi shoqërohet me gjobë 20 lekë për metër katror sipërfaqe toke të zënë;

c) në përfundim të afatit të vetëdeklarimit subjektit i humb e drejta e legalizimit.

II. Për “vendbanimet formale” zbatohen të njëjtat tarifa dhe afate, por i referohen:

a) sipërfaqes së parcelës, për ndërtime “vila”;

b) sipërfaqes së ndërtuar (m<sup>2</sup> ndërtim) për shtesa familjare, jo për qëllime shitblerjeje;

c) sipërfaqes së ndërtuar (m<sup>2</sup> ndërtim) shumëzuar me koeficientin 3, për shtesa komerciale nga subjektet fizike dhe juridike, për qëllime shitblerjeje/qiradhënieje.

#### Neni 9

##### **Zyra përgjegjëse për vetëdeklarim**

Vetëdeklarimi nga subjektet, që kanë ngritur ndërtimet pa leje, kryhet pranë zyrës së urbanistikës në njësinë vendore, në territorin e së cilës është ndërtuar objekti pa leje. Për Bashkinë e Tiranës vetëdeklarimi kryhet në njësitë bashkiake, në territorin e së cilës ndodhet trualli, sipas nenit 3 të ligjit nr.8654, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”.

Në rastet kur:

a) ndërtimi pa leje ndodhet në situata të paqarta administrative, atëherë ato vetëdeklarohen pranë njësisë më të afërt të qeverisjes vendore, duke pasur si kriter orientimi njësinë vendore, që ka regjistruar personin fizik ose banorët e zonës si votues në listën zgjedhore për zgjedhjet për legjislaturën e 17-të të Kuvendit;

b) ndërtimi pa leje shtrihet në kufijtë administrativë të më shumë se një njësie vendore, atëherë ndërtimi deklarohet pranë njësisë vendore që zë sipërfaqen më të madhe të parcelës ndërtimore.

#### Neni 10

##### **Procedura për fillimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 7)*

*(Ndryshuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 2.2.2009;*

*ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.10 099, datë 19.3.2009, neni 1)*

Procedura që ndiqet për fillimin e procesit të legalizimit është si më poshtë:

a) vetëdeklarimi nga ana e subjekteve, që kanë ngritur objekte pa leje kryhet në zyrën e urbanistikës, sipas nenit 7 të këtij ligji;

b) organi i përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji, në të njëjtën periudhë me vetëdeklarimin, kryen në terren evidentimin e ndërtimeve pa leje, për përfshirjen e tyre në procesin e legalizimit. Brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj, njësia e urbanistikës e qeverisjes vendore përgatit raportin për gjendjen faktike, së bashku me argumentimin teknik e ligjor të zonës;

c) për zonat informale dhe vendbanimet informale, në kuptim të këtij ligji, depozitimi i raportit të gjendjes faktike, së bashku me argumentimin teknik e ligjor, bëhet në këshillin e qarkut brenda 30 ditëve me mbarimin e afatit të vetëdeklarimit. Shqyrtimi dhe miratimi i zonave informale në këshillin e qarkut bëhet brenda 30 ditëve nga dorëzimi i materialit përkatës. Zonat i propozohen për miratim KRRTRSH-së në mbledhjen më të afërt;

ç) për bllokbanimet dhe ndërtimet informale, brenda ose ngjitur vijave kufizuese (të verdha), të miratuara zyrtarisht për zonat e banuara urbane (qytet) ose rurale (fshat), depozitimi i gjendjes faktike dhe argumentimi teknik bëhen në zyrën e urbanistikës të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse brenda 30 ditëve nga mbarimi i afatit të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji. Shqyrtimi dhe miratimi i materialeve bëhen në këshillin bashkiak ose komunal dhe KRRT-në e bashkisë/komunës përkatëse brenda 30 ditëve;

d) për objektet/parcelat informale deri në 1 ha, për bllokbanimet dhe ndërtimet pa leje, të veçuara ose në territore të tjera dhe për “shtesa pa leje në ndërtime me leje” vendos njësia e urbanistikës dhe KRRT-ja përkatëse e njësisë së qeverisjes vendore. Depozitimi i gjendjes faktike, i argumentimit teknik, shqyrtimi dhe miratimi bëhen në zyrën e urbanistikës dhe të këshillit të qeverisjes vendore brenda 6 muajve nga mbarimi i afatit të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji.

Për ndërtimet pa leje në “territore të tjera”, zyra e urbanistikës përkatëse kërkon miratimin e këshillit të qarkut dhe të drejtorive rajonale të bujqësisë dhe ushqimit dhe agjencive rajonale të mjedisit. Këshilli i qarkut dhe drejtoritë rajonale të bujqësisë dhe ushqimit dhe agjencitë rajonale të mjedisit i kthejnë përgjigje zyrës së urbanistikës brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës dhe i paraqitjes së dokumentacionit.

Zyra e urbanistikës dorëzon menjëherë dokumentacionin përkatës pranë këshillit të qarkut dhe drejtorive rajonale të bujqësisë e mjedisit jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit.

Në rast se pas kalimit të afateve, zyrat e urbanistikës apo këshillat e qarqeve nuk ushtrojnë përgjegjësitë e përcaktuara në këtë nen, atëherë ALUIZNI merr përsipër ushtrimin e tyre. Afatet, mënyra dhe koha e ushtrimit të këtyre përgjegjësive përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 11

##### **Shqyrtimi në KRRTSH**

*(Shfuqizuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 8)*

*(Ndryshuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 2.2.2009)*

1. Në rastet kur, sipas nenit 10 të këtij ligji, procesi i legalizimit të ndërtimit miratohet nga KRRTSH-ja, njësia e qeverisjes vendore ose këshilli i qarkut depozitojnë pranë ALUIZNI-t, brenda 30 ditëve nga përfundimi i procedurave në njësinë vendore ose këshillin e qarkut, dokumentacionin tekniko-ligjor për ndërtimet informale në territorin e tyre.

1.1. ALUIZNI paraqet dokumentacionin e përpunuar, së bashku me oponencën e vet, brenda 15 ditëve, në Këshillin e Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë. Dokumentacioni shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjen më të afërt të tij.

Dokumentacioni tekniko-ligjor, i përmendur në pikën 1 të këtij neni, përcaktohet me udhëzim të ministrit, që mbulon veprimtarinë e planifikimit të territorit.

2. KRRTSH-ja përcakton me vendim emërtimin dhe kufirin e zonës/vendbanimit informal mbi 5 ha.

3. KRRT-të dhe organet e zgjedhura të qeverisjes vendore përcaktojnë me vendim emërtimin dhe kufirin e bllokbanimit informal mbi 1 deri në 5 ha.

#### Neni 12

##### **Bashkërendimi i punës ndërmjet njësive të qeverisjes vendore dhe ALUIZNI-t**

1. Njësitë e qeverisjes vendore dorëzojnë, rregullisht çdo muaj, pranë ALUIZNI-t, të dhëna të plota për numrin e objekteve të vetëdeklaruar, të shqyrtuara, kërkesat për legalizim së bashku me dokumentacionin shoqërues, larminë dhe tipologjinë e ndërtimeve dhe/ose zonave informale, vëllimin e investimeve, pagesat e taksës për ndikimin në infrastrukturë për ndërtimet e reja, sanksione në kuptim të këtij procesi, si dhe raporte për çështje të vështirësive të hasura dhe problemeve të dala për zgjidhje etj.

2. Mënyra e plotësimit të këtyre të dhënave, si dhe ruajtja e tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit, që mbulon çështjet e territorit.

#### Neni 13

##### **Pezullimi i procedurave në zona të ndotura**

*(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 9)*

1. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të pezullojë zbatimin e procedurave të legalizimit të objekteve pa leje, në territore me nivel të lartë ndotjesh mjedisore, si dhe të zbatojë ose të planifikojë strategji për eliminimin e ndotjeve të mjedisit në zonë sipas afateve konkrete. Këshillat e qarkut paraqesin, brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit të caktuar, sipas nenit 7 të këtij ligji, propozimet konkrete për pezullimin e procedurës së legalizimit për shkak të nivelit të lartë të ndotjes.

Këshilli i Ministrave e shqyrton propozimin e paraqitur brenda 30 ditëve nga depozitimi i të gjithë dokumentacionit dhe merr vendim për këtë çështje.

2. Njësitë e qeverisjes vendore, 2 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të identifikojnë dhe të regjistrojnë të gjithë banorët e vendosur në zona të njohura dhe problematike për nivelin e ndotjeve dhe të njoftojnë me shkrim ALUIZNI-n.

3. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, në bashkëpunim me inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut, merr masa të posaçme për parandalimin e ngritjes së ndërtimeve të reja në këto zona.

#### Neni 14

##### **Efektet juridike të vendimmarrjes së KRRTRSH-së**

*(Shfuqizuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 10)*

*(Ndryshuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 2.2.2009)*

1. Vendimet e KRRT-së dhe KRRTRSH-së, sipas neneve 10 dhe 11 të këtij ligji, sjellin si pasojë:

- a) ndryshimin e regjimit të tokës në tokë truall;
- b) ndryshimin e destinacionit të përdorimit në zonë banimi/ekonomike.

2. Vendimet e KRRT-së dhe vendimet e KRRTRSH-së i njoftohen seksionit të administrimit dhe mbrojtjes së tokës në këshillin e qarkut, i cili pasqyron ndryshimet në fondin e tokës bujqësore.

#### KREU IV

##### **KALIMI I PRONËSISË SË PARCELËS NDËRTIMORE**

#### Neni 15

##### **Regjistrimi i pasurisë në ZRPP**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 11)*

Për ndërtimet e legalizuara, ALUIZNI përgatit dokumentacionin për regjistrim në regjistrat e pronave të paluajtshme pranë ZRPP-së, në përputhje me ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" të ndryshuar.

#### Neni 15/1

##### **Kompensimi i ish-pronarëve**

*(Shtuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 12)*

1. Për rastet e parashikuara në shkronjën "d" të nenit 10, Këshilli i Ministrave merr vendim për shpërblimin e pronarëve dhe për sipërfaqet takuese, brenda 30 ditëve nga afati i dorëzimit të listës.

2. Zyrat rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave kompensojnë subjektet brenda 3 muajve, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave për shpërblimin e pronarëve.

3. Për efekt të përlogaritjes së sipërfaqes së parcelës ndërtimore, të zënë nga ndërtimi informal, që kompensohet, agjencia e kthimit dhe kompensimit të pronave në qark e trajton atë si truall, në përputhje me metodikën për vlerësimin e pronës së paluajtshme, që kompensohet dhe asaj që do të shërbejë për kompensim, sipas ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

#### Neni 16

### **Rregullim specifik për ata që disponojnë parcelën, sipas një akti të ligjshëm të paregjistruar** (Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 13)

1. Nëse subjekti, që disponon objektin pa leje, posedon kontratën e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore, të lidhur ose të vërtetuar përpara noterit publik, me pronarin e ligjshëm vetë ose nga personi, i cili i ka kaluar të drejtën e pronësisë, pavarësisht nga numri i transaksioneve të kryera, ai i dorëzon ato në drejtorinë rajonale të ALUIZNI-t.

2. Për të gjithë këtë rreth personash, që posedojnë këto kontrata, kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore regjistrohet sipas kontratës, duke paguar vetëm tarifën në fuqi për regjistrimin në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pa kamatëvonesë dhe taksa të zbatueshme.

Në kuptim të këtij neni, termi “kontratë” i referohet çdo veprimi juridik për kalimin e pasurisë së paluajtshme të njohur nga dispozitat e Kodit Civil në formën e një kontrate të veçantë, përfshirë edhe marrëveshjet e lidhura apo të vërtetuara përpara një noteri publik, me objekt disponime të pronësisë së paluajtshme.

3. Pronari, i cili ka kryer kalimin e parcelës ndërtimore, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, zhvishet nga e drejta e kompensimit të pronës sipas këtij ligji ose sipas ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”.

#### Neni 17

### **Kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore**

(Shtuar paragrafi i parë me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 14/1;  
shfuqizuar fjalët në pikën 1 me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 14/2;  
reformuluar pika 3 me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 14/3)  
(Ndryshuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 2.2.2009)

ALUIZNI, me vendim të Këshillit të Ministrave, ngarkohet të kryejë procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

1. Kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore ose truallit bëhet sipas dispozitave të Kodit Civil. Për efekt legalizimi parcela ndërtimore, si rregull, nuk i kalon 500m<sup>2</sup>. Sipërfaqet e truallit mbi 500m<sup>2</sup>, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i bashkëlidhen parcelës ndërtimore dhe i shiten pronarit të truallit me çmim tregu.

2. Çmimi i truallit të parcelës ndërtimore, për ndërtimet pa leje me destinacion strehimi, përcaktohet sipas neneve 19, 20, 21 e 22 të këtij ligji. Kur objekti pa leje ka destinacion social-ekonomik apo shfrytëzohet sipas këtij destinacioni, çmimi i truallit për metër katror paguhet sipas vlerës së tregut në çastin e kalimit të pronësisë.

Kur objekti pa leje ka destinacion të përzier strehimi dhe veprimtarie social-ekonomike, çmimi i shitjes së truallit paguhet sipas çmimit të përcaktuar për shitje trualli për metër katror për banim, shumëzuar me koeficientin e shfrytëzimit të ndërtesës për destinacion social-ekonomik. Koeficienti caktohet nga Këshilli i Ministrave sipas raportit të shfrytëzimit të ndërtesës gjithsej.

3. Organet e qeverisjes vendore përcaktojnë destinacionin e objektit sipas vetëdeklarimit apo verifikimit në terren, përfshirë edhe të dhënat që administrojnë sipas ligjit për organet e qeverisjes vendore. Objekti regjistrohet në zyrën e regjistrimit sipas destinacionit.

Neni 17/1

**Mënyra e pagesës së parcelës ndërtimore të ndërtimit pa leje**  
(Shtuar neni me ligjin nr.10 169, datë 22.10.2009, neni 1)

1. Paga e vlerës së parcelës ndërtimore të ndërtimit pa leje, në proces legalizimi, bëhet:
  - a) në lekë, në vlerë të plotë monetare;
  - b) me bono privatizimi, në përputhje me dispozitat e neneve 19, 20 e 21 të këtij ligji.
2. Bonot e privatizimit, të përfituara nga ish të përndjekurit politikë dhe nga subjektet e tjera gjatë procesit të privatizimit të pronës shtetërore, kanë të njëjtin trajtim me bonot e tjera të privatizimit.
3. Taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera financiare, që lidhen me kalimin e së drejtës së pronësisë, bëhen vetëm në lekë.

Neni 18

1. Likuidimi i çmimit të truallit të parcelës ndërtimore bëhet menjëherë në çastin e nënshkrimit të kontratës.

Përrjashtim nga rregulli i mësipërm bëhet vetëm për likuidimin e çmimit të ndërtimeve me destinacion banimi. Në këto raste, në mungesë të aftësisë paguese, subjekti ka të drejtë të shlyejë çmimin e blerjes, sipas kërkesës së tij, me dy këste që shlyhen brenda 1 viti nga data e kontratës. Subjekti, që ndodhet në kushtet e paaftësisë financiare, duhet të deklarojë këtë fakt në çastin e vetëdeklarimit të ndërtimit pa leje. Ky vetëdeklarim konsiderohet i mirëqenë.

2. Zyra qendrore e ALUIZNI-t ka të drejtë të miratojë zgjatjen e afatit të pagesës së detyrimit për subjektin individual, i cili nuk ka likuiduar këstin sipas kontratës. Afati maksimal për përmbushjen e këtij detyrimi është jo më shumë se 3 vjet të tjerë. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në varësi të rasteve të deklaruara për paaftësi paguese, të përcaktojë mënyrat dhe procedurat alternative për shlyerjen e detyrimit.

Likuidimi i çmimit të kontratës së shitjes kryhet në numrin e llogarisë bankare të çelur për këtë qëllim nga ALUIZNI.

Neni 19

**Çmimi i shitjes në zonat informale**

(Shtuar fjalët në fund të shkronjës “dh” me ligjin nr.10 169, datë 22.10.2009, neni 2)

(Riformuluar shkronja “dh” me ligjin nr.10 219, datë 4.2.2010, neni 1/1;

shtuar paragraf pas paragrafit të parë me ligjin nr.10 219, datë 4.2.2010, neni 1/2)

Për parcelat ndërtimore jashtë vijave të verdha çmimi është si më poshtë:

- |   |                |
|---|----------------|
| a) për sipërfaqe deri në 100 m <sup>2</sup> | 100 mijë lekë; |
| b) për sipërfaqe deri në 200 m <sup>2</sup> | 150 mijë lekë; |
| c) për sipërfaqe deri në 300 m <sup>2</sup> | 200 mijë lekë; |
| ç) për sipërfaqe deri në 400 m <sup>2</sup> | 300 mijë lekë; |
| d) për sipërfaqe deri në 500 m <sup>2</sup> | 400 mijë lekë; |

dh) për pjesën e sipërfaqes mbi 500 m<sup>2</sup>, sipas vlerës së tregut në çastin e kalimit të pronësisë.

Çdo pronar i ndërtimit pa leje, që trajtohet sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të paragrafit të parë të këtij neni mund të paguajë me bono privatizimi deri në 70 për qind të vlerës së parcelës ndërtimore jashtë vijave të verdha.

Kur ndërtimi pa leje ka destinacion zhvillimin e veprimtarive social-ekonomike, paga e truallit realizohet sipas vlerës së tregut në çastin e kalimit të pronësisë.

## Neni 20

### **Çmimi i shitjes brenda vijave të verdha**

*(Shtuar fjalët në fund të shkronjës “ç” me ligjin nr.10 169, datë 22.10.2009, neni 3)*

*(Shtuar paragraf pas paragrafit të parë me ligjin nr.10 219, datë 4.2.2010, neni 2)*

Për parcelat ndërtimore të vendbanimeve/ndërtimeve informale brenda vijave të verdha çmimi i shitjes është si më poshtë:

a) për sipërfaqe deri në 100 m<sup>2</sup> 200 mijë lekë;

b) për sipërfaqe deri në 200 m<sup>2</sup> 300 mijë lekë;

c) për sipërfaqe deri në 300 m<sup>2</sup> 400 mijë lekë;

ç) për sipërfaqe mbi 300 m<sup>2</sup> sipas vlerës së tregut në çastin e kalimit të pronësisë dhe, deri në 50 për qind të vlerës, pagesa mund të kryhet me bono privatizimi.

Çdo pronar i ndërtimit pa leje, që trajtohet sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të paragrafit të parë të këtij neni, mund të paguajë me bono privatizimi deri në 70 për qind të vlerës së parcelës ndërtimore të vendbanimeve/ndërtimeve informale brenda vijave të verdha.

Kur ndërtimi pa leje ka destinacion zhvillimin e veprimtarive social-ekonomike, pagesa e truallit realizohet sipas vlerës së tregut në çastin e kalimit të pronësisë.

## Neni 21

### **Çmimi i shitjes brenda vijave të verdha të shtesave në ndërtime**

*(Shtuar fjalët në fund të shkronjës “ç” me ligjin nr.10 169, datë 22.10.2009, neni 4)*

*(Riformuluar shkronja “ç” me ligjin nr.10 219, datë 4.2.2010, neni 3)*

1. Për sipërfaqet e trojeve, të zëna me shtesa anësore pa leje në ndërtime me leje (jo për shitblerje/qiradhënie etj.), brenda vijave të verdha, çmimi i shitjes është si më poshtë:

a) për sipërfaqe deri në 50 m<sup>2</sup> 100 mijë lekë;

b) për sipërfaqe deri në 75 m<sup>2</sup> 200 mijë lekë;

c) për sipërfaqe deri në 100 m<sup>2</sup> 400 mijë lekë;

ç) për pjesën e sipërfaqes mbi 100 m<sup>2</sup>, sipas vlerës së tregut në çastin e kalimit të pronësisë.

2. Kur shtesat kanë destinacion zhvillimin e veprimtarive social-ekonomike, pagesa e truallit realizohet sipas vlerës së tregut në çastin e kalimit të pronësisë.

## Neni 22

### **Pagesa në “territore të tjera”**

*(Shtuar fjalët në paragrafin e parë me ligjin nr.10 169, datë 22.10.2009, neni 5)*

Për parcelat ndërtimore në “territore të tjera” zbatohen të njëjtat tarifa dhe mënyra pagese, sipas nenit 19 të këtij ligji, por shteti nuk angazhohet të investojë për infrastrukturën në këto terriore. Këshilli i njësisë vendore, përpara se të vendosë kalimin e pronësisë në favor të subjektit, kërkon miratim të posaçëm nga:

a) këshilli i qarkut dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për toka të kategorisë bonitete (1-4);

b) këshilli i qarkut për toka të kategorisë (5-10).

## Neni 23

### **Taksa e ndikimit në infrastrukturë**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 15)*

Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë zbatohet në kufirin minimal, të përcaktuar për njësinë vendore përkatëse, sipas pikës 2 të nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”.



#### Neni 24

### Zbatimi i legalizimit në zona pilot

Për zonat informale të përfshira në “Zonat pilot” të Projektit të Menaxhimit të Tokës Urbane, të financuar nga Banka Botërore, taksa e ndikimit në infrastrukturë është e barabartë me diferencën e taksës së parashikuar sipas këtij ligji dhe shumës së kontributit financiar, që poseduesi i ndërtimit pa leje ka dhënë deri në çastin e legalizimit për rregullimet e kryera në infrastrukturën e zonës së tij, nëse kjo diferencë është pozitive.

#### Neni 25

### Rastet kur subjekti disponon më shumë se një ndërtim informal

1. Në rast se një subjekt deklaron më shumë se një ndërtim informal, atëherë ai ka të drejtë të zgjedhë se për cilin objekt do të përfitojë transferimin e kalimit të pronësisë dhe legalizimin sipas tarifave të këtij ligji. Për objektet e tjera zbatohet çmimi dhe tarifa e taksës, sipas vlerës së tregut dhe masës në fuqi, pavarësisht nga kategorizimi i objekteve në fjalë dhe madhësia e parcelës respektive të truallit.

2. Deklarata noteriale për heqjen dorë nga ushtrimi i së drejtës për parcelën ndërtimore për këtë subjekt nuk do të sjellë më pas asnjë pasojë dhe subjekti trajtohet sipas pikës 1 të këtij neni.

#### Neni 26

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve për të drejta mes vetë subjektit

1. Nëse gjatë legalizimit ka mosmarrëveshje për raportet e pronësisë në objekt ose/dhe rreth përfshirjes së personave të tjerë, të cilët pretendojnë të drejta mbi parcelën ndërtimore, që legalizohet sipas këtij ligji, kjo mosmarrëveshje zgjidhet nga gjykata.

2. Gjatë shqyrtimit të konfliktit gjyqësor procedurat për legalizim të objektit pezullohen dhe rifillojnë sipas kushteve të këtij ligji, pasi vendimi gjyqësor të jetë i formës së prerë, me kushtin që ndërtimi pa leje të jetë vetëdeklaruar sipas afatit të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji.

#### Neni 27

### Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit

*(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr.9786, datë 19.7.2007, neni 1)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 16)*

*(Ndryshuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 2.2.2009)*

*(Shtuar shkronja “f” me ligjin nr.10 169, datë 22.10.2009, neni 6)*

Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e ndërtimit informal përfshin:

- a) gen-planin e objektit në shkallën 1:500, të lëshuar nga njësia vendore;
- b) planimetrinë e çdo kati të objektit dhe sipërfaqet në m<sup>2</sup>, që do të legalizohen në shkallë 1:100;
- c) certifikatën e përbërjes familjare;
- ç) vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi;
- d) vërtetimin ose certifikatën e pronësisë së parcelës ndërtimore nga ZRPP-ja përkatëse (pasi subjekti të jetë pajisur me të sipas këtij ligji, kur ai e disponon menjëherë gjatë vetëdeklarimit); dhe/ose çdo akt tjetër ligjor për fitimin e pronësisë.
- dh) deklaratën personale, që merr përsipër përgjegjësinë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës. Sipas këtij ligji, shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblim në raste fatkeqësish, për shkak të cilësive të punimeve të objektit;
- të faktorëve që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit;

e) deklaratën ku pranohet zbatimi i planit rregullues, përfshi respektimin e hapësirave publike, gjelbërimin, tipin e rrethimit, ngjyrat, ndriçimin, parkimin etj.;

ë) marrëveshjen noteriale për pjesët takuese, sipas pikës 2 të nenit 30 të këtij ligji, nëse ajo realizohet.

f) kërkesë e subjektit për mënyrën e pagesës së parcelës ndërtimore të ndërtimit pa leje, në përputhje, përkatësisht, me nenet 19, 20 ose 21 të këtij ligji.

Për çështjet e mësipërme, subjekti kërkues, i interesuar për legalizimin e objektit pa leje, paguan tarifën e shërbimit pranë njësisë së qeverisjes vendore ku ndodhet objekti pa leje.

#### Neni 28

##### **Dhënia e lejes së legalizimit**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 17)*

*(Ndryshuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 2.2.2009)*

Zyra përkatëse e ALUIZNI-t, me plotësimin e të gjithë dokumentacionit të përcaktuar në nenin 27 të këtij ligji, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, pajis subjektin me lejen e legalizimit. I njëjti rregullim, por me ndryshime specifike, të përcaktuara në këtë ligj, zbatohet edhe për “shtesat pa leje në ndërtime me leje”. Kriteret, procedurat dhe formulari i lejes së legalizimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Formulari i vetëdeklarimit i bashkëlidhet këtij ligji, si shtojca “A” e ligjit.

#### Neni 29

##### **Dokumentacioni për regjistrimin e objektit në ZRPP**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 18)*

Leja e legalizimit, e shoqëruar nga dokumentacioni teknik dhe kartela e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme të legalizuar paraqiten nga ALUIZNI në ZRPP për regjistrimin fillestar të objektit në regjistrat e pasurive të paluajtshme, në përputhje me ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

#### Neni 30

##### **Regjistrimi i pasurisë**

1. Kur ndërtimi pa leje disponohet nga një subjekt, kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore dhe objektit që legalizohet regjistrohen në emër të subjektit që disponon objektin. Për regjistrimin e pronës së legalizuar, sipas këtij neni, ZRPP-ja zbaton dispozitat e ligjit nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i familjes”, kreu II “Regjimi pasuror martesor në bashkësi”.

2. Kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet:

a) në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve;

b) në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit, sipas nenit 7 të këtij ligji, pranë njësisë së urbanistikës. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

#### Neni 31

##### **Urbanizimi i zonave/vendbanimeve/blokbanimeve me ndërtime të legalizuara**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 19)*

1. Urbanizimi i zonave/vendbanimeve/blokbanimeve me ndërtime të legalizuara kryhet në bazë të studimeve urbanistike, në përfundim të procesit të legalizimit.

a) Njësia e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me ALUIZNI-n, i propozon KRRRT-ve apo KRRTRSH-së, për miratim, kufirin e zonës/vendbanimit/blokbanimit me ndërtime të legalizuara.

b) Hartimi i studimeve urbanistike realizohet ose porositet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në çdo rast, studimet urbanistike duhet të respektojnë planet e miratuara nga KRRT-ja e bashkisë/komunës, të hapësirave dhe shesheve publike, për investime në rrugë, infrastrukturë dhe objekte social-kulturore.

c) KRRT-ja e këshillit të qarkut miraton studimin urbanistik për bllokbanimet me ndërtime të legalizuara për qarkun respektiv. Bashkia/komuna vepron për të gjitha territoret brenda vijave të verdha.

ç) Miratimi i studimeve urbanistike për zonat/vendbanimet me ndërtime të legalizuara nga KRRTRSH-ja bëhet në mbledhjen e saj më të afërt, pas miratimit të tyre nga njësia e qeverisjes vendore përkatëse dhe pas dorëzimit në KRRTRSH. Për studimet urbanistike të zonave/vendbanimeve/bllokbanimeve me ndërtime të legalizuara, ALUIZNI përgatit oponentin përkatëse teknike.

d) Për zonat/ndërtimet e legalizuara hartohen normat dhe standardet urbanistike minimale.

Ngarkohen ALUIZNI dhe Instituti i Studimeve dhe Projekttimeve Urbanistike për hartimin e këtyre normave/standardeve, brenda 2 muajve nga miratimi i këtij ligji. Normat dhe standardet urbanistike minimale miratohen nga KRRTRSH-ja.

2. Për urbanizimin e zonave informale, gjatë procesit të hartimit të studimeve urbanistike dhe realizimit të tyre, mund të kontribuojë edhe komuniteti i zonës, sipas një kontrate bashkëfinancimi dhe kontrolli, të nënshkruar për këtë qëllim.

#### Neni 32

##### **Ndarja e të ardhurave të arkëtuara nga legalizimi i ndërtimeve pa leje**

*(Ndryshuar shkronja "a" e pikës 1, ndryshuar pika 2, shtuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr.9786, datë 19.7.2007, neni 2)*

*(Ndryshuar pika 1 dhe 3 me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 20)*

*(Ndryshuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 2.2.2009)*

*(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.10 169, datë 22.10.2009, neni 7)*

1. Të ardhurat e arkëtuara nga transferimi i pronësisë së parcelave ndërtimore transferohen në Buxhetin e Shtetit për Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si fond kompensimi financiar, sipas parashikimeve të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.

2. Të ardhurat e arkëtuara nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë kalojnë për llogari të njësisë së qeverisjes vendore ku ndodhet objekti pa leje dhe destinohen prej saj për zhvillimin e infrastrukturës dhe urbanizimin e territoreve që legalizohen.

3. Të ardhurat e arkëtuara nga tarifa e shërbimit dhe çdo penalitet tjetër, i cili shoqëron procesin e vetëdeklarimit dhe të legalizimit, përdoren nga organet që kryejnë shërbimin për përballimin e shpenzimeve, që do të kryhen për përditësimin e zonës me ndërtime pa leje, për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor të nevojshëm për legalizimin e objekteve dhe financimin e studimeve urbanistike të territorit me ndërtime pa leje.

4. Mënyra, koha e mbledhjes së këtyre të ardhurave, vlera e tarifës së shërbimit dhe administrimi i saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 33

##### **Dispozitë detyruese**

*(Riformuluar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 21)*

Mosdeklarimi brenda afatit kohor, si dhe mosparaqitja nga subjekti vetëdeklarues i dokumentacionit të plotë ligjor, sjell përjashtimin nga procesi i legalizimit, urbanizimit dhe integritimit të ndërtimeve informale dhe prishjen e objektit pa leje, në përputhje me ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit".

#### Neni 34

### **Njohja e sipërfaqes së parcelës ndërtimore për efekt kompensimi**

1. Subjektet, që bëhen pronare të parcelave ndërtimore, në zbatim të dispozitave të këtij ligji dhe që në të njëjtën kohë janë subjekt i zbatimit të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, përfitojnë kthim ose kompensim vetëm në masën, që i përgjigjet diferencës ndërmjet vlerës së pasurisë së paluajtshme të shpronësuar dhe vlerës së parcelës ndërtimore. Në rast se kjo diferencë është negative, ata nuk përfitojnë nga ligji nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar. Kjo dispozitë nuk shtrin efektet e saj, nëse kalimi i pasurisë së parcelës ndërtimore te subjekti është kryer sipas pikës 1 të nenit 16 të këtij ligji.

2. Në përcaktimin e vlerës së përmendur në pikën 1 të këtij neni zbatohet metodika në fuqi për Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe përfshihet në vlerën e pasurisë edhe pagesa e kryer nga subjekti për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore sipas këtij ligji.

3. Këshilli i Ministrave përcakton kriteret e procedurat për bashkëveprimin e punës për identifikimin e këtyre subjekteve mes Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe organeve të qeverisjes vendore dhe ZRPP-së.

#### Neni 35

### **Trajtimi i rasteve të veçanta brenda vijës së verdhë për efekt të planit rregullues**

*(Riformuluar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 22)*

Për ndërtimet pa leje, të parashikuara në pikën 4 të nenit 2 të këtij ligji:

1. Familja që disponon ndërtimin pa leje në këtë territor, do të përfshihet në kategorinë e familjeve të pastreha.

2. Statusi i parcelës ndërtimore nuk ndryshon, e drejta e zhvillimit të saj i përket pronarit të ligjshëm dhe objekti pa leje shfrytëzohet nga familja që e disponon atë, deri në momentin e sistemimit me banesë.

3. Procedura dhe mënyra e sistemimit me banesë të familjeve të pastreha, sipas këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut ndërhyr për prishjen e objektit me njoftimin nga ALUIZNI, kur disponuesi i ndërtimit pa leje është sistemuar me banesë.

#### KREU V

### **LEGALIZIMI I SHITESAVE NË NDËRTIME**

#### Neni 36

### **Legalizimi i objekteve me shtesa**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 23)*

Ky ligj i shtrin efektet edhe për legalizimin e objekteve, me leje ndërtimi nga KRRT-të apo KRRTSH-ja, tek të cilat janë kryer shtesa anësore apo në lartësi, tej lejes së ndërtimit, si dhe për legalizimin e shtesave, në objektet e ngritura përpara vitit 1993.

Këtu përfshihet edhe legalizimi i objekteve të miratuara me vendim të KRRT-së së njësisë së qeverisjes vendore ose të KRRTSH-së, të cilat kanë ndryshime në funksionin e hapësirave.”

#### Neni 37

### **Fillimi i procedurës së legalizimit**

*(Ndryshuar paragrafi i parë, shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 24)*

Çdo subjekt, i cili ka kryer ndërtime, sipas nenit 35 të këtij ligji, është i detyruar t'i vetëdeklarojë ato në zyrën e urbanistikës pranë KRRT-së përkatëse, sipas afatit të përcaktuar në

nenin 7 të këtij ligji dhe të dokumentacionit të përcaktuar për legalizim. Subjekti paraqet në zyrën e urbanistikës, përveç kopjes së lejes ekzistuese (kur objekti është ndërtim pas vitit 1993), edhe këto dokumente:

a) deklaratën noteriale, ku projektuesi i licencuar i konstruksionit të ndërtimit, zbatuesi dhe investitori garantojnë së bashku qëndrueshmërinë konstruktive të objektit në legalizim, të shoqëruar me oponencën e institucioneve të specializuara, të përcaktuar sipas urdhrit të ministrit, që mbulon veprimtarinë e planifikimit të territorit;

b) në rastet kur subjekti nuk mund të sigurojë dokumentin sipas shkronjës “a” të këtij neni, atëherë ai është i detyruar të paraqesë një akt ekspertimi nga një ekspert ose ent i licencuar për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit;

c) aktmarrëveshjen me pronarin e truallit për shtesën, nëse është ndërtuar në territor privat.

Kur subjekti dhe pronari i truallit nuk kanë marrëveshje të veçantë për shtesën pa leje, pjesë përbërëse e dokumentacionit të kërkuar është marrëveshja për ndërtimin e investimit kryesor. Të drejtat dhe detyrimet e palëve për investimin kryesor njësohen me të drejtat dhe detyrimet e palëve në shtesën pa leje.

Për objektet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit, zyra e urbanistikës së njësisë së qeverisjes vendore përcjell pranë ALUIZNI-t argumentimin tekniko-ligjor të kualifikimit, dokumentacionin e sipërpërmendur, si dhe çdo dokumentacion tjetër që ajo disponon për objektet, në përputhje me afatin e vendosur në nenin 10 shkronja “a” të këtij ligji.

#### Neni 38

Instituti i Momumenteve të Kulturës, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dërgon pranë ALUIZNI-t inventarin e zonave ose objekteve monument kulture së bashku me kufijtë përkatës, brenda të cilave procesi i legalizimit të shtesave ose ndërtimeve pa leje përjashtohet për shkak të mbrojtjes së veçantë që gëzohet me ligj. Materiali i Institutit të Momumenteve të Kulturës përgatitet i ndarë për çdo qark dhe u shpërndahet organeve të njësisë vendore në qark, në bashki dhe në njësitë bashkiake për Tiranën nëpërmjet ALUIZNI-t. Materiali i Institutit të Momumenteve të Kulturës bëhet publik për 3 herë rresht në numra të veçantë të Buletinit të Njoftimeve Publike.

#### Neni 38/1

#### **Legalizimi i ndërtimeve pa leje në territoret me përparësi zhvillimin e turizmit**

*(Shtuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 25)*

Legalizimi i ndërtimeve informale në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit do të kryhet pas përcaktimit të vijës kufizuese të këtyre zonave. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të ligjit.

#### Neni 39

#### **Përjashtime nga legalizimi**

Përjashtohen nga legalizimi të gjitha shtesat në ndërtime, të cilat cenojnë dhe kanë ndikim në planin rregullues, interesin publik në akset/veprat kryesore të infrastrukturës publike (për shembull, bllokim aksesi publik, rrugë, kolektorë, diga, aeroporte ose trung kryesor në infrastrukturë etj.) ose në integritetin e monumenteve të kulturës.

Paragrafi i parë i këtij neni e shtrin fuqinë e tij për të gjitha ndërtimet pa leje.

#### Neni 40

#### **Pezullimi i procedurave të legalizimit**

Në rastet kur, si pasojë e shqyrtimit të një mosmarrëveshjeje në gjykim ndërmjet subjektit dhe pronarit të truallit privat/kufitar, gjykata ka vendosur masë sigurimi, procedurat për legalizimin e shtesës së objektit pezullohen dhe rifillojnë sipas këtij ligji, kur masa e sigurimit humb fuqinë e saj,

me kusht që shtesa pa leje të jetë vetëdeklaruar, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1.1 të nenit 7 të këtij ligji.

#### Neni 41

##### **Kriteret për legalizimin e shtesave**

*(Ndryshuar fjalia e parë me ligjin nr.9786, datë 19.7.2007, neni 3)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 26)*

*(Ndryshuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 2.2.2009)*

Njësia e urbanistikës shqyrton kërkesat e paraqitura për legalizimin e shtesave dhe u njofton subjekteve, që përmbushin kriteret e dokumentacionit, të paguajnë taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe gjobën, kur janë objekt i saj, sipas nenit 43 të këtij ligji. Shqyrtimi dhe miratimi i legalizimit të shtesës së ndërtimit kryhen sipas afateve të vendosura në nenin 10 të këtij ligji.

#### Neni 42

##### **Procedura dhe kriteret të zbatueshme**

1. Kur shtesat janë ndërtuar të gjitha ose pjesërisht në territore publike, subjekti paraqet kërkesën për legalizimin e shtesës dhe të truallit publik, mbi të cilin është ndërtuar shtesa sipas këtij ligji. Për kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore, në të cilën është ndërtuar shtesa, ndiqen të njëjtët mekanizma nga zyra e urbanistikës si ato të parashikuara në këtë ligj.

2. Nuk legalizohen, në kuptim të këtij ligji, ndërtimet ose shtesat e ndërtimeve pa leje, të kryera brenda territoreve të shkollave dhe institucioneve të tjera publike.

3. Asnjë ndërtim tjetër informal, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, nuk legalizohet brenda këtyre territoreve.

#### Neni 43

##### **Penalitetet për legalizimin e shtesave të subjektit ndërtues**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 26)*

1. Subjektet, shoqëri ndërtuese (dhe/ose investitorë) që kanë kryer shtesa anësore ose shtesa të kateve të larta jashtë lejeve të ndërtimit për qëllim kalimi pronësie ose qiradhënieje, paguajnë për efekt të legalizimit, sipas afatit të përcaktuar në nenin 41 të këtij ligji, për llogari të njësisë së qeverisjes vendore, këto penalitete:

a) për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, gjobë 4 për qind të çmimit minimal fiskal, siç është parashikuar në tabelat e marrëveshjes ndërmjet Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

b) për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe për veprimtarive social-ekonomike, gjobë 10 për qind të çmimit minimal fiskal, siç është parashikuar në tabelat e marrëveshjes ndërmjet Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

c) për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe me ndryshim destinacioni, gjobë 20 për qind të çmimit minimal fiskal, siç është parashikuar në tabelat e marrëveshjes ndërmjet Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

2. Përcaktimi i vlerës së tregut në kuptim vetëm të pikës 1 të këtij neni, kryhet në bazë të çmimit minimal fiskal, siç është parashikuar në tabelat e marrëveshjes ndërmjet Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 2116, datë 25.5.2004 dhe Udhëzimit të Tatim-Taksave nr. 2116/3, datë 14.12.2004.

3. Për rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kur procesi i vetëdeklarimit është kryer nga blerësit e ndërtimit me shtesë, legalizimi i ndërtimit informal kryhet në favor të këtyre të fundit. Për subjektin/shoqëritë ndërtuese (dhe/ose investitorin) do të ndiqen procedurat për pagesën e penaliteteve.

## KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 44 **Ankimi**

Kundër vendimit të njësisë së qeverisjes vendore, që refuzon të pranojë dokumentacionin, ose kur kjo njësi nuk nxjerr vendim me shkrim brenda afatit të parashikuar nga ky ligj, subjekti mund të paraqesë ankim administrativ pranë zyrës përkatëse të njësisë vendore ose kryetarit të organit të qeverisjes vendore. E njëjta procedurë ankimi zbatohet edhe për vendime të zyrës përkatëse të ALUIZNI-t, sipas ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”.

### Neni 45 **Dispozita kalimtare** *(Ndryshuar me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008, neni 27)*

1. Deklarimet e bëra në bazë të ligjit nr.9304, datë 23.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”, konsiderohen të mirëqena. Kur ndërtimet informale të deklaruara kanë evoluar në sipërfaqe dhe vëllim për shkak të veprimtarive të reja informale, brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj, subjekti është i detyruar t’i rideklarojë ato nga e para. Mosdeklarimi i shtesave të reja çon në heqjen e të drejtës së legalizimit dhe prishjen e objektit, sipas ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

2. Për “zonat informale”, të miratuara me vendim të KRRTRSH-së, në mbështetje të ligjit nr.9304, datë 23.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”, strukturat e ngarkuara nga ky ligj të veprojnë sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

3. Këshilli i Ministrave, brenda 1 muaji nga miratimi i zonave/vendbanimeve informale, përcakton mënyrën e administrimit të territorit të tyre dhe përparësitë në trajtimin e këtyre zonave.

4. Për ecurinë e procesit të vetëdeklarimit dhe të përcaktimit të “zonës informale” zbatohen procedurat e përcaktuara në udhëzimet nr.1, datë 6.1.2005 “Për procedurat e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për ndërtimet e banesave në “zonat informale”” dhe nr.3, datë 13.5.2005 “Për procedurat e miratimit të “zonës informale”” të Këshillit të Ministrave.

5. Në territoret e përcaktuara si territore me ndërtime informale ndalohet dhënia e lejeve për shesh ndërtimi ose e lejeve të ndërtimit subjekteve private, deri në miratimin e studimit urbanistik për to.

### **Dispozitë kalimtare e shtuar me ligjin nr.10 169, datë 22.10.2009, neni 8**

1. Personat, të cilët i kanë kryer pagesat për parcelat ndërtimore të ndërtimit pa leje përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfitojnë lehtësitë e parashikuara në këtë ligj.

2. Për të përfituar nga e drejta e pagesës me bono privatizimi për pjesën e mbetur të detyrimit apo për rikthimin e shumave të paguara në lekë, në këmbim të dorëzimit të bonove të privatizimit, personat duhet të paraqesin kërkesë, me shkrim, pranë ALUIZNI-it brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Procedurat dhe afatet e rimbursimit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### **Dispozitë kalimtare e shtuar me ligjin nr. 10 219, datë 4.2.2010, neni 4**

1. Personat, të cilët i kanë kryer pagesat për parcelat ndërtimore të ndërtimit pa leje përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfitojnë lehtësitë e parashikuara në këtë ligj.

2. Për të përfitur nga e drejta e pagesës me bono privatizimi për pjesën e mbetur të detyrimit apo për rikthimin e shumave të paguara në lekë, në këmbim të dorëzimit të bonove të privatizimit, personat duhet të paraqesin kërkesë, me shkrim, pranë ALUIZNI-it brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Procedurat dhe afatet e rimbursimit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 46

#### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në përputhje me nenet 2, 4, 15, 17 pika 2, 18, 28, 34 e 45 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri, që mbulon fushën e planifikimit të territorit, të nxjerrë aktet nënligjore, sipas neneve 11 e 12 të këtij ligji.

#### Neni 47

#### **Shfuqizime**

Ligjet nr.9304, datë 23.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale” dhe nr.9209, datë 23.3.2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”, shfuqizohen.

#### Neni 48

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Ligj nr.9482, datë 3.4.2006 shpallur me dekretin nr.4831, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.36, faqe 1139*

**Ligj nr.9786, datë 19.7.2007 shpallur me dekretin nr.5441, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.103, faqe 2981*

**Ligj nr. 9895, datë 9.6.2008**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.102, faqe 4475*

**Ligj nr.10 099, datë 19.3.2009 shpallur me dekretin nr.6126, datë 8.4.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.43, faqe 2187*

**Ligj nr.10 169, datë 22.10.2009 shpallur me dekretin nr.6320, datë 5.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.152, faqe 6871*

**Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 2.2.2009**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.12, faqe 934*

**Ligj nr.10 219, datë 4.2.2010 shpallur me dekretin nr.6431, datë 24.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.15, faqe 479*



## VETËDEKLARIM

## PËR LEGALIZIMIN E OBJEKTIT

NJËSISË SE URBANISTIKËS SË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE \_\_\_\_\_

## OBJEKTI

Adresa e truallit të ndërtimit \_\_\_\_\_

Funksioni i objektit \_\_\_\_\_

Viti i ndërtimit \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Deklaruesi \_\_\_\_\_

Emër \_\_\_\_\_ Atësi \_\_\_\_\_ Mbiemër \_\_\_\_\_

Prona mbi të cilën është ndërtuar: publike ...  / private ...  [plotëso me kryq]

## a- Të dhëna urbanistike për objektin

Sipërfaqja e zënë \_\_\_\_\_ [m<sup>2</sup>]; Sipërfaqe endërtimit \_\_\_\_\_ [m<sup>2</sup>];

Distanca nga aksi i rrugës \_\_\_\_\_ [m];

Distanca nga trotuari \_\_\_\_\_ [m];

Koficienti i shfytëzimit të truallit \_\_\_\_\_ %

Pozicioni topografik ( kufizimet ):

Veriu : \_\_\_\_\_ [m]

Jugu : \_\_\_\_\_ [m]

Lindje: \_\_\_\_\_ [m]

Perëndim: \_\_\_\_\_ [m]

## b. Të dhëna ndërtimore për objektin

Numri i kateve mbi tokë \_\_\_\_\_ / nën tokë \_\_\_\_\_ Lartësia e përgjithshme e objektit \_\_\_\_\_ [m];

Vëllimi i objektit \_\_\_\_\_ [m<sup>3</sup>];

Lloji i mbulesës \_\_\_\_\_

Hyrja kryesore nga \_\_\_\_\_

Hyrjet e shërbimit nga \_\_\_\_\_

Kondicione të veçanta \_\_\_\_\_

Projektues (nëse ka ) \_\_\_\_\_

Zbatues (nëse ka ) \_\_\_\_\_

Emër \_\_\_\_\_ Mbiemër \_\_\_\_\_ Nr. Liçencës \_\_\_\_\_

Emër \_\_\_\_\_ Mbiemër \_\_\_\_\_ Nr. Liçencës \_\_\_\_\_

## Objekte të tjera brenda sipërfaqes së zënë në shërbim të objektit kryesor (nëse ka ) ;

Sipërfaqe e ndërtimit të tij \_\_\_\_\_ [m<sup>2</sup>]; mure rrethuese \_\_\_\_\_ [m] garazh \_\_\_\_\_ [m<sup>2</sup>];

Bashkë me këtë dokument paraqes:

1. fotografi të katër pamjeve të objektit.
2. certifikatë të gjendjes familjare.
3. kontratë noteriale të kalimit të pronësisë së parcelës mbi të cilën ka ndërtuar (nëse ka).
4. certifikatë pronësie nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive (fotokopje), nëse është ndërtuar mbi pronën private të vetëdeklaruesit.

Njoh detyrimet ligjore të pagesës për kalimin e pronësisë dhe deklaroj:

Pamundësinë financiare të pagesës...  pagesën me këste...  menjëherë... 

Për sa më sipër, deklaroj se janë të vërteta dhe të sakta.

Vetëdeklaruesi

Për Njësinë e Qeverisjes Vendore

Emër \_\_\_\_\_ Mbiemër \_\_\_\_\_ Nënshkrimi \_\_\_\_\_

**Shënim:** Ky dokument është hapi i parë për legalizim, por i pamjaftueshëm. Ai duhet të plotësohet nga kërkesat e tjera të ligjit.

## VETËDEKLARIM

## PËR LEGALIZIMIN E SHITESËS

NJËSISË SE URBANISTIKËS SË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE \_\_\_\_\_

## OBJEKTI \_\_\_\_\_

M BI LEJEN E NDËRTIMIT MIRATUAR ME VENDIMIN E KRRT/KRRTRSH NR. \_\_\_\_ DATË \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_ 

Adresa e objektit me shtesë \_\_\_\_\_

Gjendja faktike: e përfunduar ...  / nuk është përfunduar ...  [plotëso me kryq]Prona mbi të cilën është ndërtuar shtesa anësore [ nëse ka] publike ...  / private  [plotëso me kryq]Të dhënat sipas lejes së miratuarTë dhënat sipas gjendjes faktikeSipërfaqja e sheshit ... [m<sup>2</sup>];Sipërfaqja e sheshit ... [m<sup>2</sup>];Sipërfaqja e ndërtimit [m<sup>2</sup>];Sipërfaqja e ndërtimit [m<sup>2</sup>];Vëllimi i objektit ... [m<sup>3</sup>];Vëllimi i objektit ... [m<sup>3</sup>];

Lartësia e Përgjithshme [m];

Lartësia e Përgjithshme [m];

Numri i kateve mbi tokë /nën tokë

Numri i kateve mbi tokë /nën tokë

Përkrahja (nëse ka) ndryshime në funksionet e hapësirave të objektit

a. Subjekti ndërtues \_\_\_\_\_

...../...../.....

numri i licensës data

Investitori \_\_\_\_\_

Emri

Atësia

Mbiemri

Arkitekt \_\_\_\_\_

Emri

Mbiemri

A- \_\_\_\_\_/...../.....

numri i licensës data

Konstruktor \_\_\_\_\_

Emri

Mbiemri

K- \_\_\_\_\_/...../.....

numri i licensës data

b. Personi fizik \_\_\_\_\_

Emri

Atësia

Mbiemri

Bashkë me këtë dokument paraqes:

1. Vendimet e K.RR.T/KRRTRSH. për lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit.
2. Certifikatë pronësie nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive. [ nëse ka] edhe për shtesën anësore.
3. Për shtesa anësore mbi pronë publike kërkesë për kalimin në pronësi të truallit

Përsa parashtror në kërkesën time deklaroj se janë të vërteta.

DREJTUESI LIGJOR I SUBJEKTIT NDËRTUES/  
PERSONI FIZIK

Për Njësinë e Qeverisjes Vendore

Emër Mbiemër Nënshkrimi

Shënim: Ky dokument është hapi i parë për legalizim, por i pamjaftueshëm. Ai duhet të plotësohet nga kërkesat e

**VENDIM**  
**Nr.544, datë 12.8.2004**

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS DHE TË DOKUMENTIT TË LEGALIZIMIT TË**  
**SHTESAVE NË NDËRTIME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 5, pika 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Subjekti juridik, që ka kryer ndërtim me sipërfaqe më të madhe se projekti i miratuar me vendim të KRRT-së së njësisë së qeverisjes vendore dhe që ka depozituar e protokolluar kërkesën për legalizimin e shtesës brenda afateve të përcaktuara në paragrafin e parë të nenit 6 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”, duhet të plotësojë formularin A “Kërkesa teknike”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Njësia e urbanistikës e njësisë së qeverisjes vendore e pajis subjektin me këtë formular.

2. Subjekti juridik plotëson dhe depoziton në njësinë e urbanistikës formularin A dhe dokumentacionin e përcaktuar në nenin 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”, brenda afatit të caktuar në pikën 2 të nenit 6 të po këtij ligji.

3. Kur njësia e urbanistikës vëren se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e legalizimit dhe se subjekti i ka shlyer të gjitha detyrimet e përcaktuara me ligj, vendos ta pajisë atë me dokumentacionin e nevojshëm, si më poshtë vijon:

a) Me leje të re ndërtimi për të gjithë objektin, përfshirë edhe sipërfaqen jashtë lejes së miratuar, për ndërtimet e përfshira në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004.

Vlerësohen ndërtimet e papërfunduara, ndërtimet për të cilat procesverbali i përfundimit të karabinasë është depozituar deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit të sipërpërmendur.

b) Me dokumentin e legalizimit shtesë, sipas formularit B “Legalizim shtesë”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për ndërtime e përfshira në pikën 2 të nenit 5 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004.

Vlerësohen ndërtimet e përfunduara, ndërtimet për të cilat subjekti juridik ka depozituar, në përputhje me nenin 13 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, pranë njësisë së urbanistikës së njësisë së qeverisjes vendore, kërkesën për marrjen e lejes së shfrytëzimit.

4. Ngarkohen Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.59, faqe 3827*

# KËRKESA TEKNIKE

## PËR LEGALIZIMIN E SHITESËS

MBI LEJEN E NDËRTIMIT MIRATUAR ME VENDIMIN E KRRT NR. \_\_ DATË \_\_/\_\_/\_\_\_\_

**OBJEKTI** \_\_\_\_\_  
**NJËSISË SE URBANISTIKËS SË NJËSISË VENDORE** \_\_\_\_\_

Subjekti ndërtues \_\_\_\_\_ / ...../.....  
numri i licensës data

Adresa e sheshit të objekti ... \_\_\_\_\_

Gjendja faktike është përfunduar ...  / nuk është përfunduar ...  [plotëso me kryq]

Prona shtesë [ nëse ka ] është publike ...  / private ...  [plotëso me kryq]

### Të dhënat sipas lejes së miratuar

Sipërfaqja e sheshit ... [m<sup>2</sup>];

Sipërfaqe e ndërtimit ... [m<sup>2</sup>];

Vëllimi i objektit ... [m<sup>3</sup>];

Lartësia e Përgjithshme ... [m];

Nr. kateve mbi tokë ... / nën tokë ...

### Të dhënat sipas gjendjes faktike

Sipërfaqja e sheshit ... [m<sup>2</sup>];

Sipërfaqe e ndërtimit ... [m<sup>2</sup>];

Vëllimi i objektit ... [m<sup>3</sup>];

Lartësia e Përgjithshme ... [m];

Numri i kateve mbi tokë ... / nën tokë ...

Për të gjitha ndryshimet e mësipërme si arkitektonike dhe konstruktive të objektit, autorët e projektit janë dakort:

Arkitekt \_\_\_\_\_  
Emri Mbiemri

A- \_\_\_\_\_  
numri i licensës data nënshkrimi

Konstruktor \_\_\_\_\_  
Emri Mbiemri

K- \_\_\_\_\_  
numri i licensës data nënshkrimi

Bashkë me këtë kërkesë parqes:

1. Vendimet e K.RR.T. për lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit.
2. Projektin e plotë teknik të objektit ku të evidentohen ndryshimet .
3. Formularin 3/1 të rifreskuar, të plotësuar sipas kërkesës së ligjit.
4. Të dhënat e studimeve gjeologo-inxhinierike të rifreskuar.
5. Të dhënat e studimeve inxhiniero-sizmiologjike për objektet të marra nga Instituti i Sizmiologjise.
6. Dokumentat e pronësive nga Zyra e hipotekës të rifreskuara.
7. Kontrata e rifreskuar me pronarët e truallit dhe aktmarrveshjet me pronarët kufitarë të cënuar.

Përsa parashtroj në kërkesën time deklaroj se janë të vërteta dhe origjinale

Mendimi i zyrës së Urbanistikës sipas përkatësisë \_\_\_\_\_

DREJTUESI LIGJOR I SUBJEKTIT NDËRTUES

(.....)

Datë .../.../200...



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NJËSIA VENDORE \_\_\_\_\_  
NJËSIA E URBANISTIKËS

## LEGALIZIM SHITESË

NR. \_\_\_ DATË \_\_\_/\_\_\_/200\_\_

MIRATOHET

NUK MIRATOHET

OBJEKTI \_\_\_\_\_

SUBJEKTIT \_\_\_\_\_ ME NR. LICENSE \_\_\_\_\_

MBI LEJEN E NDËRTIMIT MIRATUAR ME VENDIMIN E KRYT NR. \_\_\_ DATË \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

### ME SPECIFIKIMET SI MË POSHTË:

1. Sipërfaqja e sheshit që legalizohet ..... [m<sup>2</sup>];
2. Sipërfaqja ndërtimit që legalizohet ..... [m<sup>2</sup>];
3. Sipërfaqja totale e ndërtimit që legalizohet ..... [m<sup>2</sup>];
4. Volumi i ndërtimit që legalizohet ..... [m<sup>3</sup>];
5. Lartësia e përgjithshme e objektit ..... [m];
6. Numri i kateve shtesë që legalizohen (mbi tokë) ..... (nën tokë) .....
7. Lloji i mbulesës .....
8. Distanca e volumit nga aksi i rrugës ..... [m]; Nga trotuari ..... [m];
9. Distanca e volumit nga kufijtë e pronës:

Veriu ..... [m];

Lindja ..... [m];

Jugu ..... [m];

Perëndimi ..... [m];

PËRGJEGJËSI I URBANISTIKËS

KRYETARI I NJËSISË VENDORE

(.....)

(.....)

Datë .... / .... / 200...

**UDHËZIM**  
**Nr.6, datë 26.11.2004**

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.544, DATË 12.8.2004**  
**“PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS DHE TË DOKUMENTIT TË LEGALIZIMIT TË**  
**SHTESAVE NË NDËRTIME”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.544, datë 12.8.2004 “Për miratimin e procedurës dhe të dokumentit të legalizimit të shtesave në ndërtime”, Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit nxjerr këtë

**UDHËZIM:**

1. Në zbatim të pikës 1 të vendimit, njësia e urbanistikës e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse pajis subjektin juridik me formularin A “Kërkesa teknike”, kur vërteton se:

1.1 është paraqitur kërkesa për legalizim shtese brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”;

1.2 është depozituar procesverbali i përfundimit të karabinasë sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004.

Në rastet e ndërtimeve të përfunduara, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004, përfshihen edhe rastet kur vërtetohet se subjekti juridik ka depozituar kërkesën për leje shfrytëzimi brenda datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004.

2. Në zbatim të pikës 2 të vendimit, “Subjekt juridik i interesuar” është subjekti ndërtues në emër të të cilit është dhënë leja e ndërtimit.

Subjekti juridik duhet të depozitojë brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të nenit 6 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004 këto dokumente:

2.1 Formularin A “Kërkesa teknike”. Ky formular duhet nënshkruar nga drejtuesi ligjor i subjektit dhe autorët e projektit, të cilët shprehen dakord me ndryshimet arkitektonike dhe konstruktive të objektit.

“Autorë të projektit të objektit”, në kuptim të kësaj pike, janë arkitekti dhe konstruktori.

2.2 Vendimin e KRRT-së për “Leje shesh ndërtimi” dhe “Leje ndërtimi”.

2.3 Projektin e plotë teknik të objektit. Projekti duhet të përfshijë të gjithë sipërfaqen e ndërtimit, ku shtesa tej lejes së miratuar të evidentohet qartë dhe dukshëm.

2.4 Të dhënat e studimit gjeologo-inxhinjrik, të rifreskuar nga autori i studimit të mëparshëm.

2.5 Studimin sizmiologjik, në rastet kur leja e ndërtimit është dhënë për objekte deri në 8 kate dhe shtesa ka kaluar këtë lartësi.

2.6 Raportin e vlerësimit për anën teknike dhe konstruktive të ndërtesës ose të karabinasë, të hartuar nga dy konstruktorë, ku të paktën njëri të mos jetë autor i projektit konstruktiv të këtij objekti.

“Konstruktori”, në kuptim të kësaj pike, duhet të jetë i licencuar për projektim dhe kolaudim.

2.6.1 Në raportin e vlerësimit për anën teknike dhe konstruktive të ndërtesës ose të karabinasë, konstruktorët shprehen edhe për zbatimin e funksioneve të mjediseve nën tokë të objektit, në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar.

2.6.2 Në rastet kur funksionet e mjediseve nën tokë të objektit nuk janë zbatuar në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar, autorët e projektit të objektit të argumentojnë me shkrim pazbatueshmërinë teknike të tyre.

Këtij argumentimi t’i bëhet oponenca nga Instituti i Ndërtimit.

2.7 Oponencën e raportit të vlerësimit për anën teknike dhe konstruktive të ndërtesës ose të karabinasë, të hartuar nga Instituti i Ndërtimit, sipas përcaktimit të pikës 5 të nenit 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004.

2.7.1 Subjekti juridik kërkon përgatitjen e oponencës në Institutin e Ndërtimit. Bashkëlidhur kërkesës, subjekti ndërtues duhet të paraqesë:

a) Raportin e vlerësimit për anën teknike dhe konstruktive të ndërtesës ose të karabinasë, bashkëlidhur fotokopje të licencave të konstruktorëve;

b) Mendimin e autorëve të projektit të objektit, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.6.2. të këtij udhëzimi.

2.7.2 Instituti i Ndërtimit, me marrjen e kërkesës dhe pasi verifikon në terren objektin dhe zbatimin e projektit, i dërgon mendimin e tij subjektit kërkuar brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

2.8 Formularin 3/1 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të rifreskuar. Ky dokument vërteton se ndërtimi ose karabinaja nuk përbën rrezik për njerëzit dhe mjedisin në zbatim të pikës 6 të nenit 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004.

2.9 Të shlyejë detyrimet, në zbatim të pikës 8 të nenit 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004.

2.9.1 Për llogaritjen e detyrimeve që subjekti kërkuar duhet të paguajë për legalizimin e objektit, “vlera e investimit të shtesës” të llogaritet në bazë të kostos mesatare të ndërtimit të banesave, të përcaktuar në udhëzimin nr.1, datë 4.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, të vlerës së tregut të lirë të banësive dhe të koficientit “K””.

2.9.2 Në funksion të shkronjës “c” të pikës 8 të nenit 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004, kur funksionet e mjedisëve nën tokë të objektit janë teknikisht të pazbatueshme, të vërtetuara nga autorët e projektit të objektit dhe e konfirmuar nga instituti që bën oponencën, për llogaritjen e vlerës së ndërtimit të sipërfaqes së miratuar si vend parkimi, vepohet si në pikën 2.9.1 të këtij udhëzimi.

Përcaktimi i sipërfaqes së miratuar si vend parkimi është dhënë në lejen e ndërtimit të miratuar nga KRRT-ja.

2.9.3 Në zbatim të shkronjës “ç” të pikës 8 të nenit 2 të ligjit nr.9029, datë 23.3.2004, taksat të llogariten mbi vlerën e investimit të shtesës.

Taksat për marrjen e lejes së ndërtimit janë përcaktuar në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” (neni 51) dhe në ligjin nr.8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore” (neni 16).

Në çdo rast, në llogaritjen e detyrimit që subjekti juridik duhet të shlyejë për legalizimin e shtesës, taksat për marrjen e lejes së ndërtimit i shtohen vlerës së përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 8 të nenit 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004.

2.10 Dokument të pronësisë të lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rastet kur ndërtimi ka zgjeruar sipërfaqen e saj, duke cenuar pronën kufitare.

Në kuptim të pikës 10 dhe 11 të nenit 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004, ndërtimi cenon drejtpërdrejt pronën kufitare (private apo publike) kur është vendosur mbi të.

2.11 Aktmarrëveshjen e zgjidhjes së konfliktit me pronarin kufitar të pronës, kur ndërtimi cenon tërthorazi pronën kufitare (kontratë shitblerje, kontratë dhurimi, etj.).

Në çdo rast, aktmarrëveshja, në kuptim të kësaj pike, duhet të jetë nënshkruar përpara noterit.

Ndërtimi cenon tërthorazi pronën kufitare kur sipërfaqja nga kufiri i pronës nuk mund të shfrytëzohet në ruajtje të distancave urbane.

2.12 Kontratën e rifreskuar me pronarin e truallit në zbatim të pikës 9 të nenit 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004.

2.13 Vërtetim nga Policia e Ndërtimit dhe njësia përkatëse vendore për shlyerjen apo mosshlyerjen e gjobave.

Në zbatim të pikës 12 të nenit 8 të këtij ligji, “me detyrime për ndryshime në objekt” do të kuptohen gjobat e vendosura si kundërvajtje administrative, në rastet kur sipërfaqja dhe volumi i objektit është zmadhuar tej projektit të miratuar në lejen e ndërtimit dhe ndryshim i destinacionit të funksioneve të mjedisëve nën tokë të objektit, përpara datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004.

Në këtë rast, kjo vlerë e gjobës së paguar, zbritet nga pagesa e detyrimeve të subjektit, të përcaktuara në pikën 8 të nenit 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004.

Kur subjekti ndërtues, për objektin që kërkon legalizim të shtesës, ka paguar vlerën e gjobave, ky i fundit kërkon në institucionin që e ka gjobitur, vërtetimin e vlerës së paguar.

Në çdo rast, vlera e mbetur e arkëtuar ndahet sipas përcaktimit të nenit 3 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004.

2.14 Vërtetim nga dega e tatimeve për shlyerjen e detyrimeve sipas përcaktimit të pikës 13 të nenit 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004.

3. Në zbatim të pikës 3 të vendimit, për ndërtimet e papërfunduara ose karabina sipas përcaktimit të shkronjës “a” të pikës 3 të tij, njësia e urbanistikës kur vëren se ndërtimi apo karabinaja është në përputhje me kriteret e legalizimit dhe subjekti juridik ka plotësuar dokumentacionin dhe kërkesat e nenit 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004, kërkesa e subjektit kalon për shqyrtim dhe miratim në këshillin teknik, i cili vendos ta pajisë me leje të re ndërtimi, subjektin juridik.

Në këtë rast, procedura e zbadhjes së lejes së ndërtimit njehsohet me përcaktimin e nenit 49 të ligji nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”.

Për ndërtimet sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004 dhe shkronjës “b” të vendimit, lejet për legalizimin e shtesave në ndërtime i jepen subjektit ndërtues nga njësia e urbanistikës së njësisë së qeverisjes vendore.

Për ushtrimin e kompetencës së vendimmarrjes, njësia e urbanistikës të organizojë grupin e punës për:

3.1 verifikimin në terren të çdo ndërtimi, objekt i legalizimit të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004;

3.2 vërtetimin e përputhshmërisë me kriteret e legalizimit sipas përcaktimeve të bëra në pikat 2, 3, 4, 6 e 7 të nenit 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004;

Në funksion të pikës 7 të nenit 2 të ligjit, kur ndërtesa ose karabinaja ndodhen pranë monumenteve të kulturës, njësia e urbanistikës përcakton në përputhje me ligjin nr.9048, datë 2.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, nëse cenohen apo jo monumentet e kulturës.

3.3 përcaktimin e vlerës së investimit të shtesës;

3.4 llogaritjen e detyrimeve që duhet të paguajë subjekti ndërtues;

3.5 ndjekjen e procedurës së kalimit në pronësi private të sipërfaqes pronë publike të zënë, sipas përcaktimit të pikës 11 të nenit 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004.

Në përbërje të këtij grupi, të jenë përfaqësues të strukturës tip të njësisë së urbanistikës, në përputhje me kriteret që ndërtimi ose karabinaja duhet të plotësojë për t’u legalizuar, sipas përcaktimit të nenit 24 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”.

Grupi i punës shqyrton dhe jep me shkrim mendimin e tij për çdo ndërtim që kërkon pajisje me leje legalizimi të shtesës sipas formularit “B” “Legalizim shtese”.

Gjatë punës së tij, ky grup, në raste të veçanta, mund të kërkojë edhe mendimin e këshillit teknik.

4. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I RREGULLIMIT  
TË TERRITORIT DHE TURIZMIT  
**Bashkim Fino**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.87, faqe 6299*



**VENDIM**  
**Nr.289, datë 17.5.2006**

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË LEGALIZIMIT,  
URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONA VE/NDËRTIMEVE INFORMALE (ALUIZNI)**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.678, datë 4.10.2006)*

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.1147, datë 5.8.2008)*

*I përditësuar*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 46 të ligjit nr.9482, datë 16.2.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale në Republikën e Shqipërisë, me poshtë e quajtur ALUIZNI, është institucion qendror, person juridik, publik, në varësi të Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2. ALUIZNI ka drejtorinë qendrore në Tiranë, dhe drejtori, në nivel qarku, e zyra, në këto njësi të qeverisjes vendore:

a) Bashkia Tiranë	7 zyra
b) Bashkia Kavajë	1 zyrë
c) Bashkia Kamëz	1 zyrë
ç) Komuna Paskuqan	1 zyrë
d) Bashkia Vlorë	1 zyrë
dh) Bashkia Sarandë	1 zyrë
e) Bashkia Orikum	1 zyrë
ë) Bashkia Durrës	2 zyra
f) Bashkia Fushë-Krujë	1 zyrë
g) Komuna Manzë	1 zyrë
gj) Bashkia Laç	1 zyrë
h) Bashkia Korçë	1 zyrë
i) Bashkia Pogradec	1 zyrë
j) Bashkia Lushnjë	1 zyrë
k) Bashkia Fier	1 zyrë
l) Bashkia Berat	1 zyrë
ll) Bashkia Elbasan	2 zyra
m) Bashkia Shkodër	1 zyrë
n) Komuna Bushat	1 zyrë.”.

3. ALUIZNI përmbush objektivat, kryen detyrat dhe ushtron përgjegjësitë e përcaktuara në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

4. Organika dhe struktura e ALUIZNI-t, në qendër, në qark dhe në njësitë e veçanta të qeverisjes vendore përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

5. ALUIZNI drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe 3 zëvendës drejtorë.

6. Drejtori i përgjithshëm i ALUIZNI-t emërohet, lirohet ose shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave, ndërsa zëvendës drejtorët emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

7. Personeli i ALUIZNI-t duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, të përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil, dhe kërkesat e veçanta, që përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i

kësaj agjencie. Marrëdhëniet e punës rregullohen me ligjin nr.7971, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

8. ALUIZNI financohet nga Buxheti i Shtetit, nga të ardhurat, që siguron nga mbledhja e tarifës së shërbimit, në përputhje me ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dhe nga donacione të huaja.

9. Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të kësaj agjencie.

10. Zyrat e ALUIZNI-t, në nivel qarku funksionojnë në çdo qark, me vendndodhje në administratën e prefektit. Prefekti jo më vonë se 10 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi siguron mjediset e përshtatshme për funksionimin e zyrave dhe merr masa për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tyre.

11. Prefekti, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, identifikon dhe i propozon Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit njësitë përkatëse të qeverisjes vendore, ku do të ngrihen zyrat e njësisë vendore të ALUIZNI-it, si dhe përcakton mjediset e përshtatshme të punës për këto zyra.

12. Zyrat në nivel qarku dhe në njësitë e veçanta të qeverisjes vendore raportojnë te drejtori i përgjithshëm.

13. Arkiva, mjetet e punës dhe logjistika e Agjencisë së Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave Informale (ALUIZNI), e krijuar sipas vendimeve nr.440, datë 26.6.2003, dhe nr.241, datë 21.4.2005 të Këshillit të Ministrave, të transferohen në administrim të ALUIZNI-t.

14. Fondet buxhetore, të planifikuara për Agjencinë e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave Informale (ALUIZNI), pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të transferohen në llogari të ALUIZNI-t.

15. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, prefektët dhe Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

*Vendim i KM nr.289, datë 17.5.2006 botuar në Fletoren Zyrtare nr.53, faqe 1529*

*Vendim i KM nr.678, datë 4.10.2006 botuar në Fletoren Zyrtare nr.113, faqe 4439*

*Vendim i KM nr.1147, datë 5.8.2008 botuar në Fletoren Zyrtare nr.135, faqe 6021*

## **UDHËZIM**

### **Nr.6, datë 4.2.2003**

#### **PËR TAKSËN MBI NDËRTE SAT**

*(Ndryshuar me udhëzimin nr.1, datë 2.2.2005)*

*I përditësuar*

Në zbatim të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 25 të ligjit nr.8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministri i Financave:

#### **UDHËZOJNË:**

Komunat dhe bashkitë që disponojnë ndërtesa në territorin e tyre, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, ushtrojnë të drejtën e vendosjes së taksave mbi ndërtesat.

#### **Baza e taksës mbi ndërtesat**

1. Baza e taksës mbi ndërtesat është “sipërfaqja e ndërtimit në metër katror” e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës për çdo kat.

2. Në zbatim të pikës 1 të nenit 11 të ligjit nr.8982, datë 12.12.2002, sipërfaqe ndërtimi do të konsiderohet çdo sipërfaqe pavarësisht nga pozicioni vertikal (poshtë apo lart) në raport me truallin me të cilin është ndërtuar.

3. Nuk konsiderohen sipërfaqe ndërtimi shkallët dhe sheshet e tyre, ndarjet dhe modifikimet e ndryshme, brenda kufirit të dy sipërfaqeve të ndërtimit, që përbëjnë katet e ndërtesave kur ndërtesat janë në pronësi të përbashkët.

4. Pronësia mbi ndërtesat, për efekt të kësaj takse, konsiderohet e vlefshme nga këto dokumente:

- Dokumenti i zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- Vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave të paluajtshme;
- Vendimet e privatizimit;
- Dokumentet e Entit Kombëtar e Banesave;
- Dokumenti i Institutit të Projektimit të Sistemit të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

Në rastet kur mungon dokumentacioni i mësipërm i vërtetimit të pronësisë, të dhënat mbi madhësinë e bazës së taksueshme mund të sigurohen nga personat juridikë, fizikë dhe individët, nëpërmjet vetëdeklarimit. Bashkitë/komunat verifikojnë në terren saktësinë e të dhënave të vetëdeklaruar. Në mungesë të të dhënave nga vetëdeklarimet, për ndërtesat e banimit, përcaktimi i madhësisë së bazës së taksueshme mund të bëhet me metoda të tjera të përafërta deri në sigurimin e të dhënave nga burimet zyrtare të përcaktuara me ligj, mbi bazën e të cilave bëhen dhe korrigjimet përkatëse.

5. Në rastet kur mungojnë të dhëna të dokumentuara lidhur me planimetrinë, taksa mbi ndërtesat llogaritet në bazë të planimetrisë së përgatitur nga vetë personi fizik, juridik, vendas ose i huaj. Kryetari i bashkisë ose komunës ngre komisione të cilat bëjnë evidentimin me procesverbale dhe azhurnimet e nevojshme në terren për të gjitha ndërtesat që ndodhen në territorin e juridiksionit të tyre.

6. Kur njësitë e qeverisjes vendore vendosin që KESH-i të mos jetë agjent tatimor, atëherë ato, brenda muajit shkurt 2003, duhet të tërheqin të gjitha dokumentet që disponon Korporata Elektroenergetike Shqiptare (KESH) në rrethe, si dhe dokumentet e tjera, derivate që vërtetojnë pronësinë mbi ndërtesat.

7. Këshillat e komunave dhe bashkive përcaktojnë taksën mbi ndërtesat për çdo person fizik, juridik, vendas dhe të huaj, në bazë të sipërfaqes së ndërtimit, të përcaktuar në planimetrinë ose projektin e ndërtesës përkatëse.

8. Në rastet kur mungon planimetria, taksa mbi ndërtesat llogaritet në bazë të planimetrisë së përgatitur nga personi fizik, juridik, vendas ose i huaj, i shoqëruar me vërtetimin e zyrës së urbanistikës në bashki (në rastin e qyteteve) dhe nga topografi i komunës (në rastin e fshatrave).

#### **Taksapaguesit**

1. Taksapagues të taksës mbi ndërtesat janë të gjithë personat fizikë, juridikë, vendas dhe të huaj, që kanë në pronësi ndërtesa.

#### **Detyrimet e prapambetura**

Njësitë e qeverisjes vendore brenda muajit shkurt 2003 duhet të rakordojnë me degët e KESH-it në rrethe për detyrimet e prapambetura të taksapaguesve. Detyrimet e prapambetura quhen ato detyrime që rezultojnë deri me futjen në fuqi të ligjit nr.8982, datë 12.12.2002 dhe llogariten me aktet ligjore të mëparshme. Për detyrimet e prapambetura, njësitë e qeverisjes vendore harton një grafik për arkëtimin e tyre. Gjithashtu njësitë e qeverisjes vendore bëjnë rakordimet për detyrimet e arkëtura nga KESH-i dhe të pa transferuara në favor të njësisë së qeverisjes vendore. Këto detyrime duhet të transferohen nga KESH-i megjëherë në favor të njësisë së qeverisjes jo më vonë se data 15 mars 2003.

#### **Përfundimet**

1. Sipas pikës 4 të nenit 11 të ligjit “Për sistemin e taksave vendore”, përfundohen nga taksa mbi ndërtesat:

- pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qiramarrësit me qira të paliberalizuar;

- ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare.

2. Në bazë të nenit 6 të ligjit nr.8982, datë 12.12.2002, subjektet e parashikuara me ligje të veçanta. Sipas nenit 16.1 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, përjashtohen invalidët nga taksat e drejtpërdrejta. Për këtë, të gjithë invalidët e punës duhet detyrimisht të paraqesin pranë autoriteteve të pushtetit vendor dëshminë e invalidit të punës, e cila përban të gjitha gjeneralitetet e invalidit të punës. Si fillim, degëve të invalidëve në rrethe t’u kërkohet lista emërore e invalidëve të rrethit dhe sipas vendbanimeve të njëjësive të qeverisjes vendore. Këto degë duhet të paraqesin çdo 3-muaj listën emërore të invalidëve (për ndryshimet).

#### **Roli i këshillave të bashkive dhe komunave në taksën mbi ndërtesat**

1. Kategoritë minimale të ndërtesave të dhëna në aneksin nr.1 të ligjit nr.8982, datë 12.12.2002 mund të nënkategorizohen nga këshillat e bashkive dhe komunave. Në kategorinë minimale “Ndërtesa të reja të tjera”, në zërin “Për tregti dhe shërbime” do të përfshihen” dhe shtohet:

a) Ndërtesat për tregtimin e artikujve të ndryshëm me pakicë e shumicë, ku bëjnë pjesë:

- ndërtesat për tregtimin e artikujve të ndryshëm me pakicë, si dyqanet e tregtimit me pakicë, njësi të ushqimit social (restorante, fast-fud, bar-bufe, disko, kafe-internet, pub e të tjera të ngjashme me to).

- ndërtesat për tregtimin e artikujve të ndryshëm me shumicë, si magazina, dyqane etj., ku realizohet shitje dhe rishitje me shumicë.

b) Ndërtesat për veprimtari shërbimesh dhe profesione të lira, si më poshtë:

- ndërtesat për shërbime, si riparim i artikujve elektro-shtëpiakë, radio-televizorë, frigoriferë, lavatriçe, autoservise, pastrim kimik, si dhe sallone bukurie, agjenci këmbimi valute, agjenci turizmi, motele, salla për lojëra të ndryshme dhe ndërtesa të tjera të ngjashme;

- ndërtesat për profesione të lira, ku bëjnë pjesë zyrat e avokatëve e të noterëve, ekspertëve kontabël të autorizuar e të tjera të kësaj natyre, klinikat e mjekëve, stomatologëve, farmacistëve e të tjera të kësaj natyre, galeritë e artit të çdo lloj natyre që prodhojnë dhe tregtojnë objekte artistike, ndërtesat jopublike të edukimit etj.

1/1. Në kategorinë minimale “Ndërtesa të tjera”, në zërin “Të tjera” do të përfshihen ndërtesat e prodhimit, në të cilat realizohet prodhim, përpunim dhe tregtim i artikujve të prodhuar, si p.sh.: ndërtesa për prodhim tullash, tjegullash, blloqe betoni, furra gëlqereje etj., të ngjashme me to, ndërtesat për prodhime me karakter ushqimor, si prodhime buke, ëmbëlsirash, pije freskuese, mish, vaji, bulmeti e të tjera të ngjashme me to, si dhe çdo lloj ndërtesë tjetër prodhimi në sektorë të tjerë që nuk bëjnë pjesë në grupet e mësipërme, si p.sh.: fabrika e prodhimit të detergjentëve, fabrika e prodhimit të çimentos, të metaleve etj.

2. Këshillat e bashkive dhe të komunave kanë të drejtë të miratojnë nivelin e taksës mbi ndërtesat +,- 30% të nivelit tregues të kësaj takse të dhënë në aneksin nr.1 të ligjit nr.8982, datë 12.12.2002.

3. Sipas pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.8982, datë 12.12.2002, këshilli i njësisë së qeverisjes vendore vendos nëse mbledhja e kësaj takse do bëhet nga strukturat e njësisë së qeverisjes vendore ose nga të tretët (agjent të mbledhjes së taksave).

4. Masa e shpërblimit të agjentit tatimor përcaktohet nga këshilli i bashkisë ose komunës duke marrë në konsideratë dhe ofertën e agjentit tatimor. Midis njësisë së qeverisjes vendore dhe agjentit të mbledhjes së taksave përpilohet një kontratë, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë. Kontrata (marrëveshja) nënshkruhet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore dhe nga drejtuesi juridik i palës së agjentit, njëkohësisht kontrata duhet noterizohet.

5. Numrin e kësteve të pagimit të taksave nga taksapaguesi dhe kohën e kryerjes së tyre e miraton këshilli i komunës ose bashkisë.

#### **Administrimi i taksës mbi ndërtesat**

1. Njësitë e qeverisjes vendore njoftojnë personat, fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj për detyrimin e taksës mbi ndërtesat. Taksapaguesi njoftohet nëpërmjet një formulari për shumën për t’u paguar, datën e duhur, vendin e pagesës dhe numrin e kodit buxhetor të bashkisë ose komunës. Ky formular duhet të shpërndahet me ndihmën e rrjetit të ndërmarrjeve që kanë akses në familje (si KESH, Telekom, Ujësjetellës, etj). Lajmërimi për datën dhe vendin e pagesës duhet të bëhet zyrtarisht

në media elektronike të shkruara dhe vizive.

2. Për çdo rast të ndryshimeve të mundshme të sipërfaqeve të ndërtimit nga personat, fizikë e juridikë, vendas dhe të huaj, ata duhet të njoftojnë njësitë e qeverisjes vendore nëpërmjet një deklarate, e cila do të shoqërohet me planimetrinë dhe projektin përkatës.

3. Agjenti tatimor ose njësia e qeverisjes vendore arkëton taksën mbi ndërtesat me mandat arkëtimi, i cili pritet në tri kopje, prej të cilave një i jepet taksapaguesve, një degës së taksave të njësisë së qeverisjes vendore dhe një mbahet nga agjenti tatimor ose nga arka e njësisë së qeverisjes vendore. Agjenti tatimor mund të përdorë dhe fatura apo dokumente të tjera me anë të cilit mbledh ndonjë detyrim të tijin. Numri dhe afati i pagesës së kësaj takse caktohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore.

4. Kur këshilli i komunës ose bashkisë vendos që këtë taksë ta mbledhin me administratën e saj, atëherë personat, fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, bëjnë pagesën në arkën e komunës apo bashkisë përkatëse. Dokumenti që vërteton këtë pagesë është mandati i arkëtitimit. Mandati i arkëtitimit përpilohet në dy kopje, një prej të cilave i jepet taksapaguesit dhe tjetri mbahet nga njësia e qeverisjes vendore. Njësia e qeverisjes vendore është e detyruar që brenda 10 ditëve t'i arkëtojë këto para në bankë për llogari të saj dhe të bëjë rekordimin me degën e thesarit për kalimin e tyre në favor të llogarisë së saj. Në rastet kur taksapaguesi, në marrëveshje me njësinë e qeverisjes vendore bën arkëtimin e detyrimit të tij në bankë, është e detyruar që këto para t'i arkëtojë për llogari të njësisë së qeverisjes vendore mbi bazën e akt-detyrimit tatimor dhe një kopje të mandat-arkëtitimit të bankës t'ia paraqesë njësisë së qeverisjes vendore. Në fund të çdo muaji njësia e qeverisjes vendore kryen rakordimet me degët e thesarit për taksën e ndërtesës.

5. Në rastin kur këshilli i komunës ose bashkisë vendos të lidhë kontratë me një agjent tatimor për mbledhjen e kësaj takse, taksapaguesi është i detyruar të bëjë arkëtimin e detyrimit në arkat e shërbimit të agjentit të njësisë së qeverisjes vendore. Sipas kontratës, agjenti tatimor është i detyruar që t'i derdhë paratë në favor të njësisë së qeverisjes vendore.

6. Afati, numri i kësteve dhe procedurat e tjera për pagimin e kësaj takse janë kompetencë e këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

#### **Dënimet dhe apelimi**

1. Rastet e mospagimit në afatet të detyrimeve nga ana e taksapaguesve përbëjnë shkeljen dhe dënohen sipas ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me procedurat e tjera të miratuar me vendim të këshillit të komunës dhe bashkisë.

2. Taksapaguesi ka të drejtë të ankohet me shkrim për shumën dhe mënyrën në të cilën janë vlerësuar detyrimet e tij, të kërkojë rimbursime, si dhe të ankohet kundër çdo veprimi (ose mosveprimi) tjetër të zyrës të taksave vendore.

3. Çdo apelim paraqitet te kryetari i bashkisë ose komunës brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për detyrimin e taksës mbi ndërtesat. Kryetari i bashkisë ose komunës duhet të nxjerrë një vendim brenda 30 ditëve nga paraqitja e apelimit. Nëse taksapaguesi nuk është dakord me vendimin e kryetarit të bashkisë ose komunës, vendimi mund të apelohe në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit të shkuar.

Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen njësitë e qeverisjeve vendore, institucionet që janë të lidhura për sigurimin e të dhënave të taksës mbi ndërtesat.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUSHTETIT VENDOR  
DHE DECENTRALIZIMIT  
**Ben Blushi**

MINISTRI I FINANCAVE  
**Kastriot Islami**

*Udhëzimi nr.6, datë 4.2.2003 i pabotuar*

*Udhëzimi nr.1, datë 2.2.2005 botuar në Fletoren Zyrtare nr.14, faqe 543*

**VENDIM**  
**Nr.173, datë 29.3.2006**

**PËR MIRATIMIN E KOSTOS MINIMALE FISKALE NË NDËRTIM DHE PËR MËNYRËN  
E PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT TË SHITJES SË BANESAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27/1 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Për të përcaktuar koston e ndërtimit dhe çmimin e shitjes së banesave, për qëllime të përlllogaritjes së detyrimeve tatimore të aplikueshme mbi to, të ndiqen parimet bazë të dokumentit kontabël dhe rregullat specifike, të përcaktuara në aktet ligjore tatimore.

2. Kostoja minimale fiskale, për një metër katror sipërfaqe ndërtimi banese, në qytetin e Tiranës, të jetë 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, përfshirë edhe TVSH-në e llogaritur të situacionit të punimeve në ndërtim.

3. Vlera minimale e TVSH-së së llogaritur të situacionit gjendet duke pjesëtuar koston minimale fiskale me koeficientin 6. TVSH-ja e situacionit për një metër katror ndërtim banese, për qytetin e Tiranës, sipas koston minimale fiskale, është 30 000 lekë:  $6 = 5\ 000$  lekë. Nga kjo TVSH e llogaritur, shoqëritë e ndërtimit kanë të drejtë të zbresin TVSH-në e paguar në import apo blerjet brenda vendit për lëndët e para dhe materialet e ndërtimit të shoqëruara, në çdo rast, me deklarata doganore apo fatura tatimore, të lëshuara nga shitësit e tyre.

4. Në koston minimale fiskale nuk përfshihet pjesa që, sipas aktmarrëveshjeve, i takon pronarit të truallit, vlera e projektit, taksa vendore për bashkitë e komunat, që japin lejen e ndërtimit, dhe tarifa e pagueshme në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

5. Kostoja minimale fiskale për një metër katror sipërfaqe ndërtimi banese në rrethet e tjera të vendit përcaktohet në bazë të vlerës sipas pikës 2 të këtij vendimi dhe të koeficientëve, të miratuar me udhëzimin nr.5, datë 31.5.2001 të Këshillit të Ministrave, si aneksi 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Për përcaktimin e çmimit të shitjes së një metri katror sipërfaqe ndërtimi banese të merret për bazë konsiderata që jep blerësi e merr shitësi. Kur çmimi i shitjes së një metri katror të sipërfaqes ndërtim banesë është dukshëm nën vlerën e hapur të tregut, administrata tatimore, në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar, mund të përdorë metodat alternative për përcaktimin e vlerës së hapur të tregut, e rrjedhimisht, edhe të detyrimeve tatimore. Në këto metoda alternative mund të përfshihen:

a) Të dhënat nga hetimet e bëra nga vetë administrata tatimore për banesa të tjera të ngjashme, të ndodhura në zonën ku ndodhet banesa, për të cilën po përdoret metoda alternative. Administrata tatimore mund të përdorë të dhëna të marra nga blerës të tjerë në të njëjtën ndërtesë, nga shoqëri konkurrense që ndërtojnë e shesin në të njëjtën zonë, dëshmi të mbledhura nga intervista me të punësuar, teknikë, përgjegjës a menaxherë të shoqërisë që ndërton.

b) Të dhënat e siguruara nga agjencitë imobilare. Administrata tatimore është e autorizuar të përdorë, si vlerë të hapur të tregut, çmimin e afishuar nga shoqëri të specializuara në transaksionet e pasurive të paluajtshme për zonën dhe ndërtesën ku ndodhet banesa, për të cilën po përdoren metodat alternative.

c) Të dhëna të siguruara nga njoftimet në media. Administrata tatimore është e autorizuar të përdorë, si vlerë të hapur të tregut, çmimet e botuara në media, për zonën ku ndodhet ndërtesa dhe ndërtesën ku ndodhet banesa, për të cilën po përdoren metodat alternative.

ç) Të dhënat e siguruara nga zyrat e noterisë. Administrata tatimore është autorizuar të përdorë, si vlerë të hapur të tregut, çdo informacion të siguruar në zyrat e noterisë, ku lidhen kontratat e sipërmarrjes dhe të shitjes së banesave ndërmjet shitësit e blerësit.

d) Të dhëna të siguruara nga bankat e nivelit të dytë. Administrata tatimore është e autorizuar të përdorë, si vlerë të hapur të tregut, çdo informacion të siguruar në bankat e nivelit të dytë, të cilat ose japin kredi për klientin e tyre blerës të banesës, ose financojnë blerjen e banesës me instrumente të tilla financiare, si qira financiare etj.

dh) Të dhëna të ndryshme statistikore e studimore të botuara nga ente, publike a private, nëpër guida, fletëpalosje, manuale etj., që ndihmojnë në arritjen e vlerës së hapur të tregut për banesën, për të cilën po përdoren metodat alternative.

e) Çmimet e referuara në policat e sigurimit nga rreziqet e banesave, të vëna në dispozicion të administratës tatimore nga shoqëritë e sigurimit.

e) Çdo metodë tjetër ligjore, e cila bën të mundur arritjen të vlera e hapur e tregut.

Në rast se për përcaktimin e çmimit ka të dhëna sipas dy a më shumë metodave, atëherë metoda e cila cakton çmimin më të lartë do të jetë e detyrueshme për t'u përdorur.

Për të gjitha metodat alternative të përdorura, të parashikuara në shkronjat e mësipërme, i takon tatimpaguesit të provojë së vlerësimi i administratës tatimore është i gabuar.

7. Detyrimet tatimore, që rrjedhin nga shitja e banesave, nuk llogariten, në asnjë rast, nën çmimin minimal fiskal, të llogaritur sipas kostos minimale fiskale, të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi (për rrethet e tjera të korrigjuara me koeficientët e përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi) plus elementet e veçanta, të papërfshira në koston minimale fiskale, rast pas rasti, sipas pikës 4 të këtij vendimi, plus fitimin minimal fiskal, sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Çmimet e llogaritura nëpërmjet metodave, të drejtpërdrejta apo atyre alternative, u vihen, në mënyrë periodike, në dispozicion zyrave të hipotekës, të cilat janë të detyruara të përdorin po ato çmime për qëllime të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

9. Ngarkohet Ministria e Financave që, në bashkëpunim me shoqatat e specializuara të ndërtuesve, të bëjë indeksimin e kostos minimale fiskale, të fitimit minimal fiskal dhe të elementeve të tjera, të prekshme nga inflacioni, për çdo vit kalendarik.

10. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.31, faqe 1045*

## Aneksi 1

### Tabela per koeficientet sipas rretheve

NR	RRETHI	KOEFICIENTI
1	Berat	0.828
2	Diber	0.761
3	Durres	0.828
4	Elbasan	0.722
5	Fier	0.794
6	Gjirokaster	0.818
7	Gramsh	0.772
8	Kavaje	0.768
9	Korce	0.756
10	Kruje	0.831
11	Kucove	0.873
12	Kukes	0.837
13	Lac	0.831
14	Lezhe	0.748
15	Librazhd	0.722
16	Lushnje	0.825
17	Mirdite	0.84
18	Mat	0.83
19	Peqin	0.724
20	Permet	0.786
21	Pogradec	0.871
22	Puke	1.153
23	Sarande	0.895
24	Shkoder	0.945
25	Skrapar	0.67
26	Tepelene	0.825
27	Tropoje	1.199
28	Vlore	0.828
29	Tirane	1



**LISTA E FITIMEVE MINIMALE FISKALE TE SHITJES SE APARTAMENTEVE NE TIRANE**

N.R	ZONA dhe NËNZONA	Fitimi Minimal Mesatarizuar €uro	RRUGET Pika referimi për përcaktim të zonave
1	<b>1</b> 111	60	Kinema A.Demi, Fusha Sportit, Kushtrimi I Lirisë
2	<b>1</b> 112	50	Poligrafiku, Shkoza, Autotraktorët
3	<b>1</b> 211	200	Piramida, St"Q.Stafa", RTSH
4	<b>2</b> 212	162	Pazar Ri, 9-katëshet, Bashkia, Sh. "A.Rustemi"
5	<b>2</b> 213	120	M.Jashme, Ambulanca 1, Bryti
6	<b>2</b> 214	50	Q.Studenti, Asambli Ushtrisë, Tregu elektronik
7	<b>3</b> 311	60	Xhamllëku, Profarma, Rr. Bardhyl
8	<b>3</b> 312	50	Porcelani, IKV, Kinostudio
9	<b>4</b> 411	60	Spitalet, SHIK, Oxhaku
10	<b>4</b> 412	50	Allias, Rr. Njazi Meka
11	<b>4</b> 511	230	Blloku, Libri Universitar, Kulla Vodafone
12	<b>5</b> 512	192	St."S.Sternasi", Rest.Shushica, Doganat, Liqeni
13	<b>5</b> 513	69	Kopshiti Botanik, K.Parisit, Liqeni
14	<b>5</b> 514	54	H.Diplomati, Bll. "V.Shanto", Selita e Vogël
15	<b>6</b> 6	60	Teknologjika, Kombinati
16	<b>6</b> 711	138	Gjykata, DPE, Pas Ekspozitës
17	<b>7</b> 712	150	Pas Bll. të ambasadave, Inxh.ndërtimi
18	<b>7</b> 713	54	NSHRAK, Parku M.Rendit, F.Bukës
19	<b>7</b> 714	50	Unaza e Re, F. Miellit, F. Aviacionit
20	<b>8</b> 811	120	Selvia, Gjymn"Partizani", Vila Goldi
21	<b>8</b> 812	60	Medreseja, Farmacia 10, Tregu industrial
22	<b>8</b> 813	50	Tregu idust., Ajka, Uz.Dinamo
23	<b>9</b> 911	168	Piazza, Z.Popullit, Gjymn."S.Frashën".St.Trenit,
24	<b>9</b> 912	120	St.Trenit, Arkiva, Hipotekat, Politeknikumi,
25	<b>9</b> 913	50	Don Bosko, Fab.Këpuçëve,
26	<b>10</b> 1011	192	PTT, Telekomit, L.Shkrimtarëve,
27	<b>10</b> 1012	172	M.Shyri, Drejt.Policisë, Kisha katolike
28	<b>10</b> 1013	120	Bll.Ambasadave, Rr.Durrësit, Prokuroria, Brraka
29	<b>11</b> 1111	90	Zogu i Zi, ish-Shkolla Partisë
30	<b>11</b> 1112	60	FERLUT, ish-Uzina Tirana, FIAT,
31	<b>11</b> 1113	50	Laprakë, Spitali Ushtrarak, Dogana Tiranë

**Shënim 1:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi per dyqane mallrash apo sherbimesh ne katin perdhe esht 2 here me i larte se fitimi minimal i siperfaqeve per banim sipas zonave.

**Shënim 2:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi per garazh te mbuluar eshte 70% e fitimit te siperfaqeve te apartamenteve te banimit sipas zonave.

**Shënim 3:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi per zyra eshte i njejte me Fitimin minimal te siperfaqeve te apartamenteve te banimit

**Shënim 4:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi per parkim te hapur eshte 30% e fitimit minimal te siperfaq te apartamenteve te banimit

**Shënim 5:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi qe del jashte konturit te sip. te ndertimit, por qe shitet eshte 30 perqind e fitimit minimal te siperfaqeve te apartamenteve te banimit, sipas zonave.

**LISTA E FITIMEVE MINIMALE FISKALE TË SHITJES APARTAMENTEVE NË VLORË**

<b>ZONAT</b>	<b>FITIMI MINIMAL</b>
	<b>FISKAL</b>
	<b>(EURO / M2)</b>
<b>1</b>	<b>60</b>
<b>2</b>	<b>58</b>
<b>3</b>	<b>50</b>
<b>4</b>	<b>45</b>
<b>5</b>	<b>40</b>

**Shënim 1:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi per dyqane mallrash apo sherbimesh ne katin perdhe eshte 2 here me i larte se fitimi minimal i siperfaqeve per banim sipas zonave.

**Shënim 2:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi per garazh te mbuluar eshte 70% e fitimit te siperfaqeve te apartamenteve te banimit sipas zonave.

**Shënim 3:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi per zyra eshte i njejte me Fitimin minimal te siperfaqeve te apartamenteve te banimit

**Shënim 4:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi per parkim te hapur eshte 30% e fitimit minimal te siperfaqeve te apartamenteve te banimit

**Shënim 5:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi qe del jashte konturit te sip. te ndertimit, por qe shitet eshte 30 perqind e fitimit minimal te siperfaqeve te apartamenteve te banimit, sipas zonave.

## LISTA E FITIMEVE MINIMALE FISKALE TË SHITJES APARTAMENTEVE NË KORÇË

ZONAT	FITIMI MINIMAL FISKAL
	( EURO / M2 )
1	50
2	45
3	40
4	35
5	30

**Shënim 1:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi per dyqane mallrash apo sherbimesh ne katin perdhe eshte 2 here me i larte se fitimi minimal i siperfaqeve per banim sipas zonave.

**Shënim 2:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi per garazh te mbuluar eshte 70% e fitimit te siperfaqeve te apartamenteve te banimit sipas zonave.

**Shënim 3:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi per zyra eshte i njejte me Fitimin minimal te siperfaqeve te apartamenteve te banimit

**Shënim 4:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi per parkim te hapur eshte 30% e fitimit minimal te siperfaqeve te apartamenteve te banimit

**Shënim 5:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi qe del jashte konturit te sip. te ndertimit, por qe shitet eshte 30 perqind e fitimit minimal te siperfaqeve te apartamenteve te banimit, sipas zonave.

**LISTA E FITIMEVE MINIMALE FISKALE TË SHITJES APARTAMENTEVE NË  
DURRËS**

<b>Zonat</b>	<b>Fitimi minimal Fiskal</b>
	<b>(Euro/M<sup>2</sup>)</b>
1	70
2	60
3	56
4	50
5	40

**Shënim 1:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi per dyqane mallrash apo sherbimesh ne katin perdhe eshte 2 here me i larte se fitimi minimal i siperfaqeve per banim sipas zonave.

**Shënim 2:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi per garazh te mbuluar eshte 70% e fitimit te siperfaqeve te apartamenteve te banimit sipas zonave.

**Shënim 3:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi per zyra eshte i njejte me Fitimin minimal te siperfaqeve te apartamenteve te banimit

**Shënim 4:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi per parkim te hapur eshte 30% e fitimit minimal te siperfaqeve te apartamenteve te banimit

**Shënim 5:** Fitimi minimal per 1 m2 sip. ndertimi qe del jashte konturit te sip. te ndertimit, por qe shitet eshte 30 perqind e fitimit minimal te siperfaqeve te apartamenteve te banimit, sipas zonave.

**VENDIM  
Nr.397, datë 21.6.2006**

**PËR MIRATIMIN E PLANVEPRIMIT PËR LEGALIZIMIN, URBANIZIMIN DHE  
INTEGRIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e planveprimit për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, sipas matricës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha ministratë, prefektët dhe institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.68, faqe 1899*

OBJEKTIVI	MASA	ISTITUCIONI PERGJEJGES	TREGUESIT E MONITORUESHEM	AFATI
1. Përcaktimi i kriterëve dhe procedurave dhe dokumentacionit përkatës për legalizimin e ndërtimeve pa leje.	a. Hartimi dhe miratimi i vendimit "Për fotografimin ajror të territorit të vendit".	MPPTT ALUIZNI	Vendim i Keshillit të Ministrave	15 ditë pas miratimit të këtij vendimi.
	b. Marrja e masave konkrete për disponimin e materialit hartografik, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit.			Brenda 60 ditëve të hyrjes të këtij vendimi.
	c. Implementimi i Vendimit 289, dt.17.5.2006 të KM "Për organizimin dhe funksionimin e ALUIZNI".			Brenda dy mujeve nga hyrja në fuqi e ligjit
	d. Ngritja e strukturës qëndrore të ALUIZNI.			
	e. Sigurimi i ambienteve të punës dhe evidentimi i nevojave dhe prioriteve për ngritjen e strukturave në njësi të veçanta të qeverisjes vendore.			Menjehere me miratimin e këtij vendimi
	f. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit "Për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin e zbatueshëm për të kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo".			Brenda dy mujeve nga hyrja në fuqi e ligjit
2. Përcaktimi i sistemit të mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të të dhënave dhe ngritja e një "data base".	a. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit "Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të të dhënave për ndërtimeve pa leje dhe ngritjen e bazës së të dhënave".	MPPTT ALUIZNI	Vendim i Keshillit të Ministrave	Brenda dy mujeve nga hyrja në fuqi e ligjit
	b. Hartimi dhe miratimi i projekt udhëzimit "Për mënyrën e plotësimit të të dhënave për ndërtimet pa leje dhe ruajtjen e tyre".	MPPTT ALUIZNI	Vendim i Keshillit të Ministrave	Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e ligjit
3. Informimi dhe sensibilizimi i komunitetit për përfitimet dhe detyrimet e legalizimit të ndërtimit pa leje, për të mundësuar pjesmarrjen e tij në çdo fazë të procesit të legalizimit.	a. Hartimi i plan veprimit të fushatës kombëtare.	MPPTT e ALUIZNI	Dokumentacioni përkatës	15 dite pas miratimit e këtij
	b. Prodhimi dhe shpërndarja e broshurës "Vetëdeklarimi dhe legalizimi".			Brenda 30 ditëve nga hyrjes në fuqi e këtij vendimi.
	c. Prodhimi i spoteve publicitare.			Gjatë periudhës katër muajore të vetëdeklarimit
	d. Zhvillimi i fushatës sensibilizuese kombëtare me transmetim spoti, shpërndarje të broshurës dhe shumfishim formularësh vetëdeklarimi.			Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e
	e. Organizimi i seminarit kombëtar me temë "Vetëdeklarimi dhe legalizimi".			Gjatë periudhës
	f. Organizim konferencash shtypi, emisione televizive, tryezash të			

urbanizimit dhe integritimit të ndërtimeve pa leje.	rrumbullakta për procesin e vetëdeklarimit.	ALUIZNI	katër muajore të vetëdeklarimit	
4. Plotësimi i kuadrit ligjor të nevojshëm në mbështetje të ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integritimin e ndërtimeve pa leje".	<p>g. Organizim i takimeve trainuese në nivel qarku.</p> <p>a. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit të KRRTRSH "Për normat dhe standartet minimale urbanistike".</p> <p>b. Hartimi dhe miratimi i projektudhëzimit "Për miratimin e dokumentacionit teknik e ligjor të argumentimit dhe pasqyrimin të gjendjes faktike të zonave/vendbanimeve/blokbanimeve dhe ndërtimit informal të veçuar".</p> <p>c. Hartimi i manualit shpjegues "mbi plotësimin e dokumentacionit për legalizimin e ndërtimeve pa leje".</p> <p>d. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit "Për kriteret, procedurat dhe miratimin e lejes së legalizimit".</p> <p>e. Hartimi i Urdhërit "Për përcaktimit e institucionit të oponencës".</p> <p>ë. Hartimin dhe miratimin e projektvendimit të KM "Për përcaktimin e koficientit të shfrytëzimit të ndërtesës", për rastet e ndërtimeve me funksion të përzier.</p> <p>f. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit të KM për "Kalimin e kopetencave nga njësitë vendore ALUIZNI-t, për realizimin e procesit të legalizimit, urbanizimit dhe integritimit të ndërtimeve pa leje, me mënyra, afatet dhe kohën e realizimit".</p>	<p>MPPTT ALUIZNI ISPU</p> <p>MPPTT ALUIZNI</p> <p>MPPTT, ALUIZNI Ministritë e linjes</p> <p>MPPTT</p> <p>MPPTT ALUIZNI</p> <p>MPPTT ALUIZNI me ministritë e linjes</p>	<p>Vendim i KRRTRSSH</p> <p>Udhëzim i Ministrit të MPPTT</p> <p>Dokumentacioni përkatës Vendim i Keshillit të Ministrave</p> <p>Urdhër i Ministrit të MPPTT</p> <p>Vendim i Keshillit të Ministrave</p>	<p>Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e ligjit</p> <p>Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit</p> <p>Menjëhere me miratimin e ketij vendimi.</p> <p>Brenda katër muajve nga hyrja në fuqi e ligjit</p>
5. Ndërmarrja e masave të veçanta për përfshirjen në procesin e legalizimit dhe urbanizimit edhe të territoreve me karakteristikë të veçanta.	<p>a. Identifikimi i territoreve të zëna nga ndërtime pa leje brenda zonave me përparësi zhvillimin e turizmit.</p> <p>b. Përgatitje e materialit dhe miratimi me Vendim i zonave/vendbanimeve informale dhe territoreve të tjera të zëna, rast pas rasti.</p> <p>c. Ndjekje të procedurave të vetëdeklarimit dhe legalizimit për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, të miratuara për legalizim me VKM.</p> <p>ç. Identifikimi i territoreve të zëna nga ndërtimet pa leje, në zona të ndotura apo problematike për shkak të ndotjes mjedisore.</p> <p>d. Paraqitje e propozimit për pezullim të procedurave të legalizimit dhe miratimin e tyre në Këshillin e Ministrave, rast pas rasti.</p> <p>e. Hartimi i strategjive për eliminimin e ndotjeve në zonat me ndërtime pa leje, me afate konkrete, zbatimi dhe miratimi i tyre njëkohësisht me miratimin e propozimit për pezullimin e procedurave të legalizimit.</p>	<p>MTKRS, MMPAU, MPPTT në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore.</p> <p>MMPAU, e Këshillat e Qarqeve</p> <p>MMPAU, MPPTT e njësi vendore</p>	<p>Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e ligjit</p> <p>Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit</p> <p>Sipas afate që përcakton VKM</p> <p>Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e ligjit</p> <p>30 ditë nga mbarimi i afatit të vetëdeklarimit</p> <p>Menjëhere me miratimin e propozimit për pezullim legalizimi në Qarqe</p>	

	<p>f. Zbatimi i strategjisë për eliminimin e ndojëve, e rifillim procedurash legalizimi</p> <p>g. Marrja e masave të posaçme për parandalimin e ndërtimit në zonat e rindotura dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- identifikimin dhe rregjistrimin e banorëve.</li> <li>- identifikimin dhe ndërtimin pa leje në zonat e mbrojtura, nga ligji 8906, datë 06.06.2002.</li> </ul>	<p>MB, MIPAUA ALUIZNI, Policia ndërtimore dhe kryetari i njësisë vendore</p>	<p>Listat përkatëse</p>	<p>sipas afateve konkrete të VKM. Brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e VKM për pezullim procedurash dhe në vijim. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi dhe çdo tre muaj në vijim.</p>
<p>6. Përmirësime dhe rregullime të fushave të veçanta, që interferojnë me implementimin e ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".</p>	<p>a. Evidentimi i subjekteve, pronat e të cilëve janë të rregjistruara në regjistrat e pasurive të paluajtshme, që do të dërgohen KM për shpërblimin në natyrë ose lekë.</p> <p>b. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit "Për shpërblimin e pronarëve dhe pjesën takuese" sipas listës së paraqitur nga ZQRRPP, rast pas rasti.</p> <p>c. Hartimi dhe miratimi i amendimeve në ligjin 7843 "Për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme" apo të akteve nënligjore në funksion të përcaktimeve të bëra në ligjin "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".</p> <p>ç. Hartimi dhe miratimi i amendimeve në ligjin 8408 "Për policinë e ndërtimit" apo të akteve nënligjore në funksion të përcaktimeve të bëra në ligjin "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".</p> <p>d. Hartimi dhe miratimi i ligjit të ri të urbanistikës.</p> <p>e. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit "Për kriteret dhe procedurat e bashkëveprimit të punës midis institucioneve përkatëse për identifikimin e subjekteve që janë njëkohësisht subjekt i zbatimit të ligjit për legalizimin dhe i ligjit për kthim kompensimin e pronës".</p>	<p>ZQRRPP e ALUIZNI</p> <p>MD, ZQRRPP MBUMK, KSHKKP,</p> <p>MD, ZQRRPP e MBUMK</p> <p>MPPTT e Policia e Ndërtimit</p> <p>MPPTT</p> <p>MD, KSHKKP, ZQRRPP</p> <p>MF &amp; MPPTT</p> <p>MF, MPPTT &amp; ALUIZNI MD, MPPTT</p> <p>ALUIZNI</p>	<p>Listat përkatëse</p> <p>Vendim i Keshillit të Ministrave</p> <p>Parlamenti Shqiptar</p> <p>Vendim i Keshillit të Ministrave</p>	<p>Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi dhe çdo tre muaj në vijim. 30 ditë pas depozitimit të listës. 1 vit nga hyrja në fuqi e ligjit. Brenda janarit të viti 2007 Brenda 10 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit</p>
	<p>a. Përgatitja e një udhëzuesi "Për mbledhjen, administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të përftuara nga ligji "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".</p> <p>b. Përgatitja e një dokumenti të tarifave të shërbimit që do të aplikojë njësi vendore gjatë procesit të vetëdeklarimit dhe legalizimit.</p> <p>c. Përgatitja të përmbajtjes dhe formës së deklaratave të përgjegjësisë për defektet e banesës, të zbatimit të planit rregullues, të heqjes dorë nga ushtrimi i të drejtës për legalizimin, të ndarjes së pjesëve takuese etj</p>	<p>MF &amp; MPPTT</p> <p>MF, MPPTT &amp; ALUIZNI MD, MPPTT</p> <p>ALUIZNI</p>	<p>Udhëzues i përbashkët</p>	<p>Brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit</p>

7. Mënjanimi i keqinterpretimeve, unifikimi i procedurave dhe veprimet konkrete për implementimin e ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".	ç. Identifikimi, pranimi i dokumentacionit, shqyrtimi dhe miratimi i boniteteve të tokave bujqësore si dhe pasqyrimi i vendimeve të KRRTRSH/KRRT në MBUMK& MPPTT	Dokument përkatës	Deri në përfundim të procesit të vetëdeklarimit.
	d. Përmbajtja e deklaratës së investitorit për kalimin në pronësi të sipërfaqes së strehimit të familjes së pastrehë dhe mënyra e regjistrimit në ZRRPP.	MD e ZQRRPP	30 ditë nga mbarimi i afatit të vetëdeklarimit.
	dh. Evidentim i situatës dhe i numrit të subjekteve në pamundësi financiare për pagesat e legalizimit.	ALUIZNI	Vendim i Këshillit të Ministrave
	e. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit "Për përcaktimin e mënyrave alternative dhe procedurave për shlyrjen e detyrimit financiar për subjektet në pamundësi financiare.	MF, MPPTT & ALUIZNI	Dokument përkatës
	ë. Mënyra e veprimit për rastet e ndërtimeve pa leje në zona ku plani i përgjithshëm rregullues parashikon ndërtime mbi 5 kate nga niveli ±00 dhe mënyra e zbatimit të saj.	MPPTT, Policia e ndërtimit & ALUIZNI	Ne fund te vitit 2006
	f. Modalitetet e kontratës së bashkëfinansimit dhe kontrollit për urbanizimin e zonës/vendbanimit informal ndërmjet komunitetit dhe njësisë vendore.	MPPTT, ALUIZNI MF	Brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.
	g. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit të Këshillit të Ministrave "Për administrimin e territorit të zonës/vendbanimit informal të miratuar dhe prioritetet në trajtim" menjëherë pas miratimit nga KRRTRSH, rast pas rasti.	MPPTT, ALUIZNI MB	Pas mbarimi të afatit të vetëdeklarimit e në vijim.
	gj. Përgatitja e materiali të inventarit të zonave dhe monumenteve të kulturës, në fuzion të zbatimit të ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".	Istituti i Monumenteve të Kulturës	Brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit
	h. Publikimi në buletine të njoftimeve dhe dërgimi në zyrat e ALUIZNI dhe njësitë e qeverisjes vendore të materialit të inventarit të zonave dhe monumenteve të kulturës.	IMK ALUIZNI	15 ditë pas marrjes së njoftimit
	i. Marrja e masave të posaçme për vendosjen e kontrollit mbi territorin e këtyre zonave.	Policia e Ndërtimit me	Vazhdimisht



**VENDIM**  
**Nr.437, datë 28.6.2006**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR MBLEDHJEN, PËRPUNIMIN DHE  
ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE PËR NDËRTIMET PA LEJE, PËR NGRITJEN E  
BAZËS SË TË DHËNAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 4 pika 3 e 46 pika 1 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. Procedurat e mbledhjes së të dhënave.**

**1. Të dhënat mblidhen nëpërmjet:**

- i) vetëdeklarimit nga subjekti juridik apo personi fizik, pronar i sipërfaqes së parcelës ndërtimore të zënë dhe ndërtimit pa leje ose të shtesës pa leje, mbi ndërtimin me leje;
- ii) identifikimit dhe verifikimit në terren të çdo ndërtimi pa leje;
- iii) hartës/fotografisë së gjendjes ndërtimore.

2. Njësia e urbanistikës në njësinë e qeverisjes vendore, pajis çdo subjekt me formularin përkatës të vetëdeklarimit. Formulari, i shoqëruar me fotografitë e katër pamjeve të objektit, plotësohet dhe nënshkruhet nga subjekti në dy kopje. Njëra kopje, e nënshkruar edhe nga punonjësi pranues, e protokolluar dhe e vulosur me vulën e institucionit, i kthehet subjektit.

3. Të dhënat e mbledhura nga vetëdeklarimi regjistrohen, verifikohen, ruhen, përpunohen, krahasohen, përdoren dhe komunikohen, por nuk ndryshohen, korrigjohen ose fshihen.

**4. Për çdo deklaram të kryer, hapet një dosje e veçantë, ku shënohen:**

- a) emri i qarkut përkatës;
- b) emri i komunës/bashkisë, së cilës i përket ndërtimi pa leje;
- c) numri i zonës, sipas modelit “Fleta e regjistrimit të të dhënave të formularëve”, i vendndodhjes së objektit apo shtesës pa leje, të deklaruar;

ç) numri rendor, i vendosur nga njësia e urbanistikës, për numërimin e banesave, sipas përcaktimit të ligjit nr.9296, datë 21.10.2004 “Për verifikimin, identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve nga njësitë e qeverisjes vendore”;

d) numri i protokollit të komunës/bashkisë, ku është dorëzuar vetëdeklarimi.

5. Të dhënat e deklaruara nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit regjistrohen në regjistrin e zonës, sipas modelit “Fleta e regjistrimit të të dhënave të formularëve”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Shtesat anësore apo në lartësi mbi ndërtimet me leje regjistrohen në një regjistër të veçantë, ku shënohen adresa e truallit të ndërtimit dhe specifikimet përkatëse.

7. Regjistri me ndërtime pa leje, regjistri i shtesave, me sipërfaqe tej lejes së miratuar, si dhe regjistri i shtesave për objektet të ndërtuara para vitit 1993, sipas modeleve përkatëse, që i bashkëlidhet këtij vendimi,

8. Zyra e Urbanistikës në njësinë e qeverisjes vendore, për çdo formular vetëdeklarimi të kryer:

- a) identifikon, në hartën/fotografinë e gjendjes ndërtimore, objektin pa leje apo shtesën në ndërtimin me leje;
- b) verifikon në terren çdo tregues dhe bashkësinë e tyre;
- c) harton procesverbalin e konstatimit.

9. Procesverbali i konstatimit, sipas modelit të miratuar nga ALUIZNI, ruhet në dosjen e objektit të deklaruar.

**II. Procedurat e përpunimit të të dhënave**

**10. Objektet e deklaruara dhe të identifikuara grupohen në:**

- i) ndërtime në pritje të legalizimit;

- ii) ndërtime për t'u prishur;
- iii) ndërtime me procedurë të pezulluar.

11. Në procesverbalin e konstatimit:

a) për ndërtimet me deklaram të pasaktë të sipërfaqes së tokës së zënë, të sipërfaqes së ndërtimit dhe të numrit të kateve, shënohet “deklarimi i rremë”;

b) për objektet e paidentifikuara në hartën/fotografinë e gjendjes ndërtimore, shënohet “i kryer pas hyrjes në fuqi të ligjit”;

c) për ndërtimet, të cilat ndodhen në kushtet e mospërfshirjes në procesin e legalizimit, nga pengesat e vendosura nga neni 39 i ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, shënohet “i përjashtuar nga legalizimi”;

ç) për objektet e ndërtuara në troje private, brenda vijës së verdhë, kur planet e përgjithshme rregulluese/studimet urbanistike në fuqi, që parashikojnë ndërtime mbi 5 kate nga niveli i tokës, shënohet “i përjashtuar nga legalizimi për shkak studimi”.

12. Grupimi i ndërtimeve për t'u prishur përbëhet nga të gjitha ndërtimet, ku procesverbali i konstatimit përmban shënimin “deklarim i rremë”, “ i kryer pas hyrjes në fuqi të ligjit” ose “i përjashtuar nga legalizimi”.

13. Në grupimin e ndërtimeve “me procedurë të pezulluar legalizimi” përfshihen të gjitha ato objekte, për të cilat ka filluar procedimi gjyqësor, sipas përcaktimeve të neneve 13 e 26 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, ose për të cilat është vendosur masë sigurie, me vendim gjykate, sipas përcaktimit të neneve 40 të po këtij ligji.

14. Objektet e deklaruara nga subjekte, të cilat kanë ndërtuar më shumë se një ndërtim pa leje, të identifikuar pas depozitimit të deklaramit të zgjedhjes dhe heqjes dorë nga ushtrimi i së drejtës mbi parcelën ndërtimore, grupohen në listën e ndërtimeve “legalizim me kushtet e tregut”.

15. Sipërfaqja e zënë nga ndërtimet pa leje, të futur në grupin “në pritje të legalizimit”, sipas vendndodhjes, paraqitet në hartë, dhe, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, në relacionin përkatës përshkruhen kufiri i kësaj sipërfaqeje dhe pozicioni topografik i saj.

Këtu përfshin edhe objektet e përshkruara në pikën 14 të këtij vendimi.

Për secilën zonë hapet një regjistër i veçantë.

Tërësia e të dhënave të secilës zonë pasqyrohet në “Pasqyrën përmbledhëse të të dhënave të zonës”, sipas modelit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

16. Sipërfaqja e zonës, e pasqyruar në hartë, emërtohet me njërën nga termat e përcaktuar në nenin 3 të ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, sipas kritereve:

a) të vendndodhjes;

b) të sasisë së sipërfaqes së zënë nga ndërtimet pa leje, të vendosura mbi të.

17. Harta/fotografia e gjendjes ndërtimore, pas miratimit të kufirit gjeografik të shtrirjes së ndërtimeve pa leje, përditësohet në terren nga njësia e qeverisjes vendore, sipas kësaj procedure:

a) verifikohen të dhënat e deklaruara të objektit të identifikuar në hartën/fotografinë;

b) identifikohen në terren kufijtë e parcelës ndërtimore dhe pasqyrohen në genplan, në shkallën 1:500;

c) pasqyrohen në hartën e zonës genplani i objektit, kufiri i parcelës ndërtimore dhe kondicionet urbane;

ç) saktësohet me përshkrim kufiri i secilës parcelë me kufitarët, sipas gjendjes faktike.

d) pas miratimit të kufijve të zonës në KRRT–në përkatëse dhe miratimit të kontratave të kalimit të pronësisë në këshillin bashkiak a komunal, harta e zonës i kalon strukturës përkatëse të ALUIZNI-t.

III. Procedurat e administrimit të të dhënave

18. Gjatë periudhës katërmujore të vetëdeklarimit dhe procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje, njësitë e qeverisjes vendore procedojnë si më poshtë:

a) Zyra e urbanistikës në njësinë e qeverisjes vendore plotëson dosjet e vetëdeklarimeve, që përmbajnë të gjithë dokumentacionin, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim. Dosja e “ndërtimit

në pritje të legalizimit”, në përfundim të procesit të plotësimit dërgohet për miratim në zyrën përkatëse të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale. Dosjet e vetëdeklarimeve arkivohen dhe administrohen, në përputhje me dispozitat e ligjit për arkivat.

b) Pas depozitimit të vendimit përkatës, në dosjen e objektit për t’u prishur dërgohet në organin, që mbulon prishjen e ndërtimeve pa leje njoftimi për ekzekutim.

c) Dosjet e objekteve me procedura të pezulluara të legalizimit ruhen sipas ligjit “Për arkivat” dhe me depozitim të vendimit të formës së prerë të gjykatës, rihapet procedura e legalizimit.

ç) Dosjet për objektet “e përjashtuara nga legalizimi për shkak studimi”, pas evidencimit dhe nënshkrimit fletë për fletë nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, arkivohen dhe ruhen sipas legjislacionit për arkivat.

d) Kontratat e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore dhe pagesat e kryera për të përbëjnë dokumentacionin financiar dhe ruhen në dosjen përkatëse.

19. Dosja e ndërtimit pa leje, përmban dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Formularin e vetëdeklarimit, bashkë me dokumentacionin shoqëruar të tij.

b) Dokumentacionin, teknik e ligjor, për legalizimin e ndërtimit pa leje apo të shtesës mbi ndërtimin me leje.

c) Procesverbalin e konstatimit, të njësisë së qeverisjes vendore.

ç) Vendimin dhe/ose shkresën e gjykatës për pezullimin e procedurave të legalizimit ose për vendosje mase sigurie.

d) Deklaratën e zgjedhjes së objektit dhe e heqjes dorë nga përfitimi, në rastet e dy a më shumë ndërtimeve pa leje, të deklaruara nga i njëjti subjekt.

dh) Mandatpagesat.

e) Vendimet e miratimit.

ë) Dokumentacionin e vlerësimit, nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore.

Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, pas pajisjes së dosjes me lejen e legalizimit, kryen procedurat e regjistrimit fillestar.

20. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe Instituti i Topografisë Ushtarake, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Instituti i Studimit të Tokave, Instituti i Projektive dhe Studimeve Urbane, Instituti i Ndërtimit, njësitë e qeverisjes vendore, të çdo niveli, dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë palë pjesëmarrëse aktive në procesin e legalizimit, urbanizimit dhe integritit të ndërtimeve pa leje dhe janë të detyruara të përgatisin e të vënë në dispozicion të njësisë së qeverisjes vendore dhe ALUIZNI-t, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, për realizimin e këtij procesi.

21. Zyra Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, përcakton me hollësi masat dhe veprimet, që duhen ndërmarrë për inventarizimin, transferimin dhe kompensimin e tokës, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integritimin e ndërtimeve pa leje”.

IV. Informatizimi i të dhënave

22. Zyra Qendrore e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale mbledh, trajton e administrojnë të dhënat për ndërtimet pa leje dhe pronësinë mbi to. Ajo ndjek edhe ecurinë e procesit të legalizimit dhe vë në dispozicion të zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme përkatëse dokumentacionin e nevojshëm.

Informatizimi i të dhënave, “baza e të dhënave”, përfshin çdo tregues të veçantë apo bashkësi të treguesve të një ndërtimi pa leje dhe dokumentacionin zyrtar, të pranuar apo të lëshuar, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integritimin e ndërtimeve pa leje”.

Baza e të dhënave është e njëjtë për të gjitha strukturat e ngarkuara për legalizimin dhe regjistrimin, në regjistrat e pasurive të paluajtshme, të ndërtimeve pa leje dhe të truallit, mbi të cilin janë ngritur.

23. Baza e të dhënave të sistemit të informatizimit për ndërtimet pa leje:

a) ndalohet të përdoret për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë vendim;

b) ndalohet t'u transmetohet institucioneve, enteve ose subjekteve, të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë vendim;

c) mund të përdoret gjatë procedimeve, gjyqësore ose administrative.

Kur gjatë një procedimi, juridik a administrativ, vërtetohet se të dhënat janë të pasakta, të paplota ose të trajtuara në kundërshtim me parimet e këtij vendimi, autoriteti procedues njofton zyrën qendrore të ALUIZNI-t.

24. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, institutet e administratës qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.72, faqe 2086*









REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QARKU \_\_\_\_\_  
BASHKIA / KOMUNA \_\_\_\_\_

PASQYRË PËRMBLEDHËSE E FORMULARËVE  
“VETËDEKLARIM PËR LEGALIZIM”

1. Emertimi i zonës/ Bllokbanim informal/ Vendbanim informal: \_\_\_\_\_
2. Numuri total i vetëdeklarimeve: \_\_\_\_\_
3. Koha e ndërtimit nga viti 199\_\_ deri në vitin 200\_\_.
4. Numri i objekteve me funksion:
  - a) Banimi: \_\_\_\_\_
  - b) Arsimor \_\_\_\_\_
  - c) Shendetësor \_\_\_\_\_
  - d) Social- kulturor \_\_\_\_\_
  - e) Banimi+ aktivitet tjetër \_\_\_\_\_
5. Sipërfaqja e zënë (aktualisht sipas vetëdeklarimeve): \_\_\_\_\_ ha
6. Sipërfaqja e territorit që propozohet: \_\_\_\_\_ ha
7. Numri total i parcelave ndërtimore: \_\_\_\_\_
  - a) deri në 100 m<sup>2</sup>, \_\_\_\_\_
  - b) deri në 200 m<sup>2</sup> \_\_\_\_\_
  - c) deri në 300 m<sup>2</sup>, \_\_\_\_\_
  - d) deri në 400 m<sup>2</sup>, \_\_\_\_\_
  - e) deri në 500 m<sup>2</sup>, \_\_\_\_\_
  - f) > 500 m<sup>2</sup>: \_\_\_\_\_
8. Lloji i pronësisë mbi tokën ku janë kryer ndërtimet:
  - a) pronë private me çertifikatë pronësie: \_\_\_\_\_ ha
  - b) pronë private me kontratë kalimi pronësie: \_\_\_\_\_ ha
  - c) pronë publike: \_\_\_\_\_ ha
9. Sipërfaqja e ndërtimit: \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>
  - a) Sip. Objekteve me funksion banimi: \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>
  - b) Sip. Objekteve me funksion ekonomik \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>



c) Sip. Objekteve me funksion banimi+ aktivitet tjtër \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>

10. Numri total i objekteve: \_\_\_\_\_

a) 1 katëshe: \_\_\_\_\_

b) 2 katëshe: \_\_\_\_\_

c) ≥ 3 katëshe: \_\_\_\_\_

11. Numri i familjeve: \_\_\_\_\_

12. Numri i banorëve: \_\_\_\_\_

13. Koeficienti i shfrytëzimit të zonës: \_\_\_\_\_ %.

Drejtori i njësisë së urbanistikës  
(.....)

Kryetari Bashkisë/Komunës  
(.....)

#### VENDIM

Nr.438, datë 28.6.2006

### **PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT TË ZBATUESHËM, PËR TË KUALIFIKUAR OBJEKTET NË NDËRTIM, QË LEGALIZOHEN OSE JO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, pika 1 e 46, pika 1, të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

#### **I. KRITERET DHE DOKUMENTACIONI I ZBATUESHËM PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMIT PA LEJE**

1. Kualifikohet për legalizim objekti pa leje i përfunduar deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, që:

a) ka minimalisht të ngritur një kat, me lartësi dysheme-tavan jo më pak se 2 m;

b) ka të përfunduar konstruksionin së bashku me mbulesën;

c) nuk ka trajtim të veçantë, sipas përcaktimit të neneve 2, pika 4 dhe 35 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”;

ç) nuk ndodhet në kushtet e përjashtimit nga procesi i legalizimit, sipas përcaktimeve në pikën 2 të këtij vendimi.

2. Nuk kualifikohet për legalizim objekti i ndërtuar pa leje ose shtesa e sipërfaqes tej lejes së miratuar që:

a) cenon sistemin, rrugor dhe hekurudhor, kombëtar e rajonal, si dhe brezat mbrojtës të tyre, të parashikuar nga plani i përgjithshëm rregullues apo studime të çdo niveli, të miratuar a në proces;

b) shkel vijën e ndërtimit në rrugët e kategorisë së parë, të dytë dhe të tretë, të parashikuar nga plani i përgjithshëm rregullues, studimet urbanistike apo projektet e veçanta për infrastrukturën rrugore të çdo niveli, të miratuar deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9482, date 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”;

c) është ngritur brenda territorit të shkollave, kopshteve, spitaleve, çerdheve, qendrave shëndetësore dhe të çdo institucioni tjetër publik;

ç) cenon integritetin e Monumenteve të Kulturës, sipas përcaktimit të pikës 1, të nenit 29 të ligjit nr.9048 datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të specifikuar nga materiali i botuar i Institutit të Monumenteve të Kulturës, sipas përcaktimit të nenit 38 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006;

d) është ngritur mbi/ose brenda brezit mbrojtës të kolektorit, digës, ose aeroportit;

dh) cenon trungun kryesor të infrastrukturës inxhinierike, sipas përcaktimeve në rregulloren e urbanistikës të miratuar me vendimin nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar;

e) është ngritur brenda territoreve dhe kufirit mbrojtës të zonave të mbrojtura, me akte, ligjore dhe nënligjore, si:

i) zonë turistike, sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të nenit 2 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”;

ii) zonë e mbrojtur, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”;

iii) zonë me vlera arkeologjike, muzeale e historike ose në kufi me objektet apo strukturat ndërtimore me vlera të veçanta, sipas përcaktimit të neneve 73 e 74 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, dhe të neneve 31, 32 e 33 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”;

ë) cenon sistemet dhe brezat mbrojtëse të kanaleve kulluese dhe ujitëse;

f) është ngritur brenda kufirit mbrojtës të burimeve natyrore, si naftë e gazmbajtëse, burimeve minierare, energjetike, burimeve e rezervave ujore etj.

3. Objekti i veçuar, i ngritur në territore të tjera, nuk kualifikohet për t’u legalizuar, kur është ndërtuar:

i) në zona me rrezik përmbytjeje;

ii) në shtretërit e lumenjve;

iii) brenda sipërfaqeve të baseneve, rezervuarëve dhe liqeneve;

iv) në zonat e riskut gjeologjik, çarje-rrëshqitje;

v) niveli i ndotjes së mjedisit kalon nivelin e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mjedisin.

4. Për të kualifikuar objektet, që legalizohen apo jo, njësitë e qeverisjes vendore mbështeten në:

a) hartën/fotografinë e gjendjes ndërtimore;

b) materialin grafik të planit të përgjithshëm rregullues dhe të çdo studimi të miratuar, të infraskukturës, inxhinierike dhe rrugore, të zonës, sipas përcaktimeve të rregullores së urbanistikës miratuar me vendimin nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar;

c) materialin grafik për territorin brenda kufirit të zonave me mbrojtje të veçantë nga aktet, ligjore e nënligjore, rast pas rasti.

## II.PROCEDURAT E KUALIFIKIMIT TË OBJEKTEVE, QË LEGALIZOHEN DHE DOKUMENTACIONI TEKNIK E LIGJOR

5. Për kualifikimin e objekteve që legalizohen apo jo, veprohet, si më poshtë vijon:

a) Identifikohet nga njësia e qeverisjes vendore, me pranimin e formularit të vetëdeklarimit, ndërtimi në hartë/fotografi, gjendja ndërtimore, sipas vendndodhjes;

b) Verifikohet në terren nga njësia e qeverisjes vendore, brenda 20 ditëve nga dorëzimi i formularit të vetëdeklarimit, ndërtimi i identifikuar në hartë/fotografi dhe hartohet procesverbali i konstatimit.

Për rastet e ndërtimeve, që përjashtohen nga procesi i legalizimit, sipas pikës 2 të këtij vendimi, njësia e urbanistikës i dërgon, brenda 5 ditësh, mendimin e saj KRRT–së njësisë së qeverisjes vendore. Kjo e fundit merr vendim në mbledhjen më të afërt të saj.

c) Grupohen sipas vendndodhjes dhe tipologjisë së tyre ndërtimet e përfshira në procesverbalin e konstatimit.

6. Për objektet e ndërtuara pa leje apo shtesat e sipërfaqeve tej lejes së miratuar ndaj të cilave ka filluar proces gjyqësor ose është vendosur masa e sigurisë me vendim gjykate, nga njësia e qeverisjes vendore, ndiqen këto procedura:

a) I kërkohet deklaruësit apo personit të tretë, me marrjen dijëni të procedimit gjyqësor, depozitimi, në dosjen e ndërtimit pa leje, përkatësisht, të kopjes së vendimit të gjykatës ose të shkresës së gjykatës për zhvillimin e një procesi gjyqësor dhe për objektin e gjykimit.

b) Vë në dijëni, menjëherë, personin e interesuar për legalizimin e ndërtimit pa leje, kur njoftimi për zhvillimin e procedimit gjyqësor vjen nga gjykata, për vendosje mase sigurie, sipas nenit 40 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

c) Depoziton në dosjen e ndërtimit pa leje, në të dyja rastet e mësipërme, aktin për pezullim procedurash legalizimi. Kjo dosje ruhet nga njësia e qeverisjes vendore, sipas ligjit për arkivat.

ç) Rifillon, me paraqitjen e vendimit të formës së prerë të gjykatës për procedimin gjyqësor, shkak i pezullimit të procedurave të legalizimit, procesin e legalizimit të ndërtimit pa leje, sipas kontekstit dhe përmbajtjes së vendimit të formës së prerë të gjykatës.

7. Për rastet kur vërehet se një subjekt ka deklaruar më shumë se një objekt pa leje, veprohet si më poshtë vijon:

7.1. Kur objektet pa leje ndodhen brenda kufirit territorialo-administrativ të së njëjtës njësi të qeverisjes vendore, kjo e fundit i kërkon deklaruësit:

a) të zgjedhë objektin, për të cilin kërkon legalizim, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”;

b) të depozitojë deklaratën noteriale të heqjes dorë nga përfshirja në procesin e legalizimit, sipas kushteve të përcaktuara në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, për objektet e tjera, e cila depozitohet në dosjen përkatëse.

7.2. Kur objektet pa leje ndodhen brenda kufirit territorialo-administrativ të dy ose më shumë njësive të qeverisjes vendore dhe/ose kur rasti i pikës 7/1, të këtij vendimi nuk është vënë re, ALUIZNI, i kërkon njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, ku ka vendbanimin subjekti, të veprojë sipas përcaktimit të pikës 7.1 të këtij vendimi.

Në kuptim të kësaj pike subjekti identifikohet nga të dhënat e certifikatës së përbërjes familjare, të lëshuar sipas gjendjes familjare të datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006.

7.3. Për objektet, të cilat legalizohen me kushtet e tregut:

i) çmimi i shitjes për metër katror të sipërfaqes së zënë nxirret, në përputhje me vlerën e tregut;

ii) taksa e legalizimit përlllogaritet sipas neneve 51 paragrafi i parë, e 77 të ligjit 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, dhe të nenit 16 të ligjit nr.8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”.

8. Për rastet, kur vërehet se objekti ndodhet në kushtet e trajtimit të veçantë, për shkak të vendndodhjes në troje private, të parashikuara nga plani i përgjithshëm rregullues/studimet urbanistike, të ndërtimeve mbi 5 kate nga niveli zero, njësia e qeverisjes vendore vepron si më poshtë vijon:

a) afishon hartën me kufirin e zonës nën juridiksion, të mbuluar me plan urbanistik, të miratuar për ndërtimet mbi 5 kate nga niveli zero, me fillimin e procesit të vetëdeklarimit. Në këtë rast niveli zero është kuota e nivelit të truallit;

b) dërgon kopje të kësaj harte në ZRPP përkatëse dhe i kërkon asaj listën e pronarëve privat, të regjistruar mbi këto territore, e cila detyrohet të dërgojë, brenda 30 ditëve në njësinë e qeverisjes vendore, përkatëse, materialin e kërkuar;

c) dokumentacioni i afishimit dhe i dërguar nga ZRPP, depozitohet në dosjen e objektit pa leje, evidencohet dhe nënshkruhet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore;

ç) pas kryerjes së procedurave të mësipërme, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, me urdhër të tij, njofton subjektin deklaruës, pronarin e sipërfaqes së truallit, sekretarinë teknike të KRRT dhe ZRPP përkatëse, për pezullimin e legalizimit të objektit.

9. Hartimi i dokumentacionit teknik të përcaktuar më poshtë dhe dokumentacioni i përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi, mbështetet në normat dhe kriteret e legjislacionit urbanistik në fuqi.

a) Genplani në shkallën 1:500, për çdo ndërtim pa leje të deklaruar, hartohet nga njësia e qeverisjes vendore, në bazë të dokumentacionit hartografik të gjendjes ndërtimore, brenda 20 ditësh nga paraqitja e kërkesës së të interesuarit.

b) Planvendosja e zonës/vendbanimit/bllokbanimit/grupndërtimit informal përgatitet nga njësia e qeverisjes vendore dhe përmban:

i) kufirin e zonës/vendbanimit/bllokbanimit/grupndërtimit informal të miratuar nga KRRTRSH-ja/KRRT-ja;

ii) sipërfaqen e bazës të secilit objekt dhe kufirin e secilës parcelë ndërtimore.

c) Për hartimin e planimetrisë dhe genplanit njësia vendore:

i) përditëson në terren hartën/fotografinë e gjendjes ndërtimore;

ii) verifikon të dhënat e deklaruara dhe specifikon në hartë/fotografi, sipas deklarimit, kufirin e secilës pronë.

Harta e përfutur konfirmohet nga njësia e qeverisjes vendore dhe depozitohet në strukturën përkatëse të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale.

10. Pas deklarimit fillestar dhe kualifikimit për legalizim njësia e qeverisjes vendore njofton subjektin deklarues për plotësimin e dokumentacionit. Dosjet për objektet e kualifikuara për përjashtim ose pezullim i dërgohen ALUIZNI-t. Pas shqyrtimit të këtij të fundit brenda një muaji i kthehen njësive të qeverisjes vendore, të cilat i arkivojnë dhe njoftojnë deklaruesit.

11. Planimetria e çdo kati apo e sipërfaqeve shtesë tej lejes së miratuar e shkallës 1:100, hartohet dhe nënshkruhet nga një projektues i licencuar.

12. Institucionet e përcaktuara nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për përgatitjen e oponencës mbi qëndrueshmërinë konstruktive të objektit me sipërfaqe tej lejes së miratuar me vendim të KRRTRSH-së/KRRT-së, japin mendimin e tyre, me shkrim, brenda 20 ditësh nga paraqitja e kërkesës së të interesuarit.

I interesuari dërgon bashkë me kërkesën dhe deklaratën noteriale ose aktekspertimin, sipas përcaktimit të nenit 37 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integritimin e ndërtimeve pa leje”, edhe projektin e plotë të zbatimit të objektit.

Kopja e oponencës dërgohet zyrtarisht në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore dhe/ose në strukturën përkatëse të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, brenda afatit të mësipërm.

13. Njësia përkatëse e qeverisjes vendore, për objekte të ngritura pa leje ndërtimi, brenda ose në afërsi të territoreve të mbrojtura nga aktet, ligjore dhe nënligjore, menjëherë, me marrjen e formularit të vetëdeklarimit për secilin objekt, i kërkon sipas rastit, organit përkatës mendim. Ky i fundit jep mendimin e tij me shkrim, brenda 20 ditësh nga paraqitja e kërkesës së njësive përkatëse të qeverisjes vendore.

14. Udhëzimi nr.3, datë 13.5.2005 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e zonës informale”, shfuqizohet.

15. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Vendim nr.438, datë 28.6.2006 botuar në Fletoren Zyrtare nr.72, faqe 2094*

**VENDIM**  
**Nr.36, datë 12.6.2006**

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË  
LIDHJEVE TË REJA NË RRJETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9, 26, pika 1, dhe 27, pika 1 germa b, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.04.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.06.2006, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “KESH” sh.a. për tarifën e lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e metodologjisë për përcaktimin e tarifave të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, e bashkëngjitur këtij vendimi.
  2. Shfuqizimin e vendimit nr.17, datë 19.12.2001 “Për miratimin e udhëzimit mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj”.
  3. Ngarkohet shoqëria “KESH” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi më 1 shtator 2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

*Botuar ne Fletoren Zyrtare nr.65, faqe 1805*

**METODOLOGJIA PËR TARIFAT E LIDHJEVE TË REJA NË RRJETIN  
E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE**

**QËLLIMI**

Kjo metodologji bëhet për të realizuar një unifikim të cilësisë së punimeve, standardeve dhe karakteristikave teknike të lidhjeve të reja të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

**OBJEKTI**

Kjo metodologji parashikon klasifikimin e kërkesave për lidhjet e reja për konsumatorin familjar në TU dhe për konsumatorin jofamiljar në TU, për lidhjet në tension të mesëm, si dhe për rilidhjet.

**HYRJE**

Domosdoshmëria për të pasur një metodologji të lidhjeve të reja vjen për shumë arsye, nga të cilat më kryesoret janë:

- Të gjitha punimet e lidhjes së re që bëhen në rrjetin shpërndarës të KESH-it duhet të bëhen nga vetë KESH-i apo operatorë të tjerë të kontraktuar nga KESH-i, sipas ligjeve në fuqi, duke respektuar në këtë mënyrë të gjitha standardet e cilësisë së materialeve, karakteristikat teknike sipas normave, seksionet e kabllave (në mënyrë që t'i përgjigjen lidhjeve edhe në të ardhmen). Kjo mënyrë do të eliminojë të gjitha të metat e vërejtura gjatë kohës në rrjetin shpërndarës elektrik për menaxhimin aktual apo perspektiv të tij.

- Duhet të bëhet mbi të gjitha respektimi me shumë rigorozitet i normave të sigurimit teknik, duke filluar me normat teknike që do të duhet të ndiqen në fazën e realizimit.

- Standardet e materialeve që do të përdoren, do t'i përgjigjen normave europiane IENC.

## KAPITULLI I KRITERE TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

Pagesa e lidhjes për çdo objekt apo grup objektesh sipas një plani urbanistik të caktuar, përcaktohet duke iu referuar këtyre treguesve:

- a) Fuqisë maksimale të kërkuar ( $P_k$ ) të çdo konsumatori që kërkon të lidhet me energji elektrike. Për përdoruesit familjarë, fuqia e kërkuar që do të vihet në dispozicion nga ana e KESH sh.a., do të llogaritet me 10% shtesë për efekte të mbrojtjes me limitatorë;
- b) Largësisë minimale nga kabina më e afërt e transformacionit;
- c) Largësisë minimale nga n/stacioni më i afërt;
- d) Shpenzimeve administrative që bën furnizuesi për lidhjen me energji elektrike të konsumatorit.

### Neni 2

Kërkesa dhe dosja për lidhjen me energji elektrike të një konsumatori duhet të përmbajë dokumentacionin e përshkruar në Kodin e Shpërndarjes, kapitulli IV (lidhjet), pikat 4.1, 4.1.2, 4.2 dhe 4.2.1.

### Neni 3

Zgjidhja teknike e furnizimit me energji elektrike duhet të ketë parasysh:

a) Tensionin i ushqimit, zgjidhja teknike e lidhjes dhe vendndodhja e pikës së dorëzimit të energjisë elektrike, përcaktohen nga ndërmarrja furnizuese (KESH) në bazë të situatës së rrjetit ekzistues të zonës, si dhe të fuqisë maksimale të kërkuar ( $P_k$ ). furnizimet e konsumatorëve të përhershëm me fuqi maksimale të kërkuar ( $P_k$ ) deri në 30 kË përbëjnë lidhje në TU, me përjashtim të rasteve të veçanta të ndërtimeve të veçuara për të cilat nuk ekziston asnjë mundësi tjetër furnizimi.

b) Dorëzimi (pika e lidhjes) dhe matja e energjisë elektrike bëhet brenda territorit në pronësi (ose të marrë me qira) në pozicionin që lejon entin furnizues të kryejë funksionet e veta në përputhje me kontratën e furnizimit edhe në rastin kur mungon konsumatori. Në rastin e ndërtesave me më shumë njësi të paluajtshme (apartamente), dorëzimi (pika e lidhjes) dhe matja do të bëhet në ambientin e caktuar të përqendruar. Në rastet e pronave të rrethuara, pika e dorëzimit dhe e matjes do të vendosen në kurifin e pronësisë në mënyrë të përshtatshme dhe me hyrje të drejtpërdrejtë nga rruga e hapur për publikun. Në rastet kur dorëzimi dhe matja e energjisë bëhet brenda kufijve të pronësisë së ndërtesës, kërkuesi është i detyruar t'i japë furnizuesit lejet dhe autorizimet e nevojshme, në momentin kur paraqitet kërkesa për lidhjen e energjisë elektrike.

c) Për pallatet e reja të banimit, në vartësi nga studimi që ka bërë furnizuesi (KESH-i) për furnizimin me energji elektrike, ndërtuesi është i detyruar të lërë një ambient të përshtatshëm për kabinë elektrike sipas kushteve teknike të instalimeve elektrike.

- Furnizuesi (KESH) do të hartojë projektin e kabinës elektrike dhe të furnizimit të saj nga linjat e tensionit të mesëm (TM).

- Furnizuesi (KESH) do të bëjë vendosjen e pajisjeve dhe të materialeve të tij në kabinën elektrike dhe do të kryejë edhe punimet për montimin e tyre.

- Për kabinën (pjesa ndërtimore) të bëhet "Shpronësim për intera publikë", sipas legjislacionit në fuqi.

- Në qoftë se investitori i pallatit nuk planifikon lënien e një ambienti për kabinë elektrike kur është parashikuar në mënyrën e furnizimit, atëherë furnizuesi (KESH) nuk do t'i firmosë formularin e lejes së ndërtimit për furnizimin me energji elektrike.

d) Lidhja me energji elektrike e përdoruesit realizohet me linjë ajrore ose kabllore në vartësi të sistemit të shpërndarjes (ajror apo nëntokësor) që ka përdorur enti furnizues në atë zonë. Në qoftë

se në zonat në të cilat rrjeti elektrik shpërndarës është ajror dhe lidhja e konsumatorit projektohet nga enti furnizues për t'u bërë me linjë nëntokësore, atëherë do t'i referohet tarfiave për lidhjen kabllore (nëntokësore).

e) Me pagesën e kostove të parashikuara, furnizuesi është i detyruar të ndërtojë rrjetin elektrik dhe pajisjet e nevojshme nga pika e furnizimit me energji elektrike deri në pikën e dorëzimit, përfshirë grupin e matjes, limitues ose tregues të fuqisë maksimale. Kërkuesi duhet të vërë në dispozicion të furnizuesit vendin dhe hapësirën e përshtatshme (sipas kërkesave të furnizuesit) për instalimin e matjes dhe të pajisjeve të pikës së dorëzimit. Të gjitha punimet (ndërtimore) që bëhen për të bërë të mundur vendosjen e pajisjeve sa më sipër (si dhe vendi ku vendosen ato), janë në ngarkim të kërkuesit.

f) Çdo objekt që është i pandarë duhet të ketë vetëm një pikë dorëzimi (një pikë lidhje) të energjisë elektrike dhe për rrjedhojë i korrespondon një kontratë furnizimi me energji elektrike.

## KAPITULLI II LIDHJA ME ENERGJI ELEKTRIKE E PËRDORUESVE TË PËRHERSHËM OSE TË PËRSËRITUR

### Neni 4

#### **Lidhja e përdoruesve (familjarë dhe jofamiljarë njëfazor apo trefazor) në TU**

a) Përcaktimi i pagesës për një lidhje të re në TU do të përdoret nga shuma e tri tarifave të përcaktuara si më poshtë:

- Tarifa e distancës ( $T_d$ ) që ka të bëjë me largësinë e konsumatorit nga kabina më e afërt e transformacionit TM/TU të furnizuesit.

Distanca do të matet në mënyrë radiale (distanca më e shkurtër) nga kabina e transformacionit më e afërt në hartat e entit furnizues, ku të jenë pasqyruar linjat, kabinat me të dhënat përkatëse (tipi, fuqia, viti i vënies në shfrytëzim) dhe të jetë azhurnuar në bazë të genplanit edhe objekti që do të furnizohet me energji elektrike.

Tarifat e pagesës për largësinë nga kabina TM/TU për linjat ajrore do të jetë si vijon:

Pagesa për këtë tarifë do të jetë 82 000 lekë për 200 m e para nga kabina e transformacionit dhe pastaj për 700 m e para do të rritet në 4 100 lekë për çdo 100 m distancë, nga 700 deri 1200 m do të rritet me 8 200 lekë për çdo 100 m distancë dhe për distanca më të mëdha se 1200 m do të rritet me 16 400 lekë për çdo 100 m distancë.

Tarifat e pagesës për largësinë nga kabina TM/TU për linjat ajrore jepen në tabelën e mëposhtme:

Largësia nga kabina TM/TU	Vlera e fiksuar e tarifës	Vlera e shtuar për çdo 100 m ose fraksione më të mëdha se 50 m
a) distanca 0-200 m	8 200 lekë	--
b) distanca 0-700 m - për 200 m e para - për një largësi të mëtejshme	8 200 lekë --	4100 lekë
c) distanca 0-1200 m - për 700 m e para - për një largësi të mëtejshme	28 700 lekë --	-- 8200 lekë
d) distanca 1200 m e më tej - për 1200 m e para - për një largësi të mëtejshme	69 700 lekë --	-- 16 400 lekë

Tarifat e pagesës për largësinë nga kabina TM/TU për linjat kabllore do të jetë si vijon:

Pagesa për këtë tarifë do të jetë 18 000 lekë për 200 m e para nga kabina e transformacionit dhe pastaj për 700 m e para do të rritet me 9 000 lekë për çdo 100 m distancë, nga 700 deri në 1200 m do të rritet me 18 000 lekë për çdo 100 m distancë dhe për distanca më të mëdha se 1200 m do të rritet me 36 000 lekë për çdo 100 m distancë.

Tarifat e pagesës për largësinë nga kabina TM/TU për linjat kabllore jepen në tabelën e mëposhtme:

Largësia nga kabina TM/TU	Vlera e fiksuar e tarifës	Vlera e shtuar për çdo 100 m ose fraksione më të mëdha se 50 m
a) distanca 0-200 m	18 000 lekë	--
b) distanca 0-700 m - për 200 m e para - për një largësi të mëtejshme	18 000 lekë --	9 000 lekë
c- distanca 0-1200 m - për 700 m e para - për një largësi të mëtejshme	63 000 lekë --	-- 18 000 lekë
d-distanca 1200 m e më tej - për 1200 m e para - për një largësi të mëtejshme	153 000 lekë --	-- 36 000 lekë

- Tarifa e fuqisë ( $T_f$ ) përbën pagesën për çdo kE të fuqisë maksimale të kërkuar ( $P_k$ ) dhe është e barabartë me 1500 lekë për kabinat ajrore dhe me 2500 lekë për kabinat tip boks (pa asnjë lloj ndryshimi nga lloji i furnizimit). Në rast lidhjeje të ndërtesave me më shumë se 4 njësi të paluajtshme (apartamente) pagesa e fuqisë bëhet duke marrë parasysh në fuqi të kërkuar prej 3.3 kE për çdo apartament.

- Tarifa fikse e lidhjes ( $T_l$ ) është një pagesë fikse prej 3 250 lekësh dhe ka të bëjë me tarifën për matjen e rezistencës së tokëzimit prej 1000 lekë, azhurnimin e rrjetit prej 1250 lekësh, lidhja e energjisë elektrike prej 500 lekë dhe shpenzimet administrative prej 500 lekësh.

b) Në rastet kur një objekt është lidhur me energji elektrike dhe ndahet në më shumë se një pronar (përdorues të energjisë elektrike) kontratën për "Lidhjen e re" e trashëgon përdoruesi që i ka paguar detyrimet për të. Pronarët e tjerë, nëse duan të furnizojnë me energji elektrike pjesën e tyre të objektit, i nënshtrohen të gjitha detyrimeve që përmban ky udhëzim.

c) Për kërkesat që kanë të bëjnë me rritjen e fuqisë maksimale të kërkuar ( $P_k$ ) në krahasim me atë që është lidhur kontrata, përdoruesi i detyrohet furnizuesit pagesat për tarifën e fuqisë ( $T_f$ ) për  $P_k$  dhe tarifën fikse ( $T_l$ ) prej 3250 lekësh.

d) Për elektrifikimin e qendrave rezidenciale, të zonave të studiuara për vendndodhje të shumëllojshme industriale, artizanale dhe tregtare, kur furnizimi është i parashikuar në TU, aplikohen tarifat e këtij kapitulli edhe pse është e nevojshme të realizohen vepra të urbanizimit kryesor.

Që elektrifikimi të realizohet përpara lidhjes së secilit përdorues, kërkuesi duhet të paguajë fillimisht tarifën e distancës ( $T_d$ ). Në momentin e lidhjes së energjisë elektrike, përdoruesi paguan edhe tarifat e fuqisë dhe tarifën fikse 3250 lekë.

## Neni 5

### Lidhja e përdoruesve në tension të mesëm deri 20 kV

a) Përcaktimi i pagesës për një lidhje të re në TM do të përbëhet nga shuma e tri tarifave të përcaktuara si më poshtë:

- Tarifa e distancës ( $T_d$ ) që ka të bëjë me largësinë e konsumatorit nga n/stacioni më i afërt i furnizuesit. Distanca do të matet në mënyrë radiale (distanca më e shkurtër) nga n/stacioni më i afërt në hartat e furnizuesit ku të jenë pasqyruar linjat, n/stacioni me të dhënat përkatëse (fuqia, viti i



vënies në shfrytëzim), dhe të jetë azhurnuar në bazë të genplanit edhe objekti që do të furnizohet me energji elektrike. Pagesa për këtë tarifë do të jetë:

Për linjat ajrore: 15 500 lekë për 500 m e para nga kabina e transformatorit dhe pastaj do të rritet me vlerën 3100 lekë për çdo 100 m distancë; dhe

Për linjat kablllore: 49 000 lekë për 500 m e para nga kabina e transformacionit dhe pastaj do të rritet me 9800 lekë për çdo 100 m distancë. Në rastet e distancave të ndërmjetme, p.sh. deri 150 m, pagesa do të jetë si për 100 m, ndërsa mbi 150 m do të jetë si për 200 m.

- Tarifa e fuqisë ( $T_f$ ) përbën pagesën për çdo kE të fuqisë maksimale të kërkuar ( $P_k$ ) dhe është e barabartë me 4000 lekë.

- Tarifa fikse e lidhjes ( $T_l$ ) është një pagesë fikse prej 3 250 lekësh dhe ka të bëjë me tarifën për matjen e rezistencës së tokëzimit prej 100 lekësh, azhurnimin e rritit prej 1250 lekësh, lidhja e energjisë elektrike prej 500 lekësh dhe shpenzimet administrative prej 500 lekësh.

b) Për kërkesat që kanë të bëjnë me rritjen e fuqisë maksimale të kërkuar ( $P_k$ ), në krahasim me atë që është lidhur kontrata, përdoruesi i detyrohet furnizuesit pagesat për tarifën e fuqisë ( $T_f$ ) 4000 lekë për çdo kE të shtuar dhe tarifën fikse ( $T_l$ ) prej 3250 lekësh.

c) Për rastet kur një përdorues ka një kontratë në TU dhe kërkon shtesë fuqie, e cila sjell si domosdoshmëri kalimin në furnizim me TM, atëherë pagesa do të jetë e njëjtë si për çdo lidhje në TM, vetëm se llogaritja e tarifës së fuqisë do të bëhet vetëm për shtesën e fuqisë mbi atë ekzistuese që ka pasur konsumatori kur furnizohej me TU.

#### Neni 6

#### Udhëzime të përbashkëta

a) Largësia e caktuar në paragrafët e mëparshëm për përcaktimin e pagesës duhet të jetë e dukshme në planimetritë që përmbajnë vendndodhjen e kabinave TM/TU dhe të n/stacioneve, dhe janë të matura në vijë të drejtë me qendrën e kabinës ose të n/stacionit të cilit i jemi referuar deri në pikën e dorëzimit të energjisë elektrike. Në rastet kur në genplanin e paraqitur nga kërkuuesi nuk mund të gjykohet për largësinë e objektit nga kabina ose n/stacioni, atëherë kërkuuesi është i detyruar t'i paraqesë furnizuesit një planimetri të re nga ku mund të përcaktohet qartë largësia e objektit nga kabina apo (n/stacioni). Planimetritë që do të prëdoren për të përcaktuar largësinë e objektit nga kabina (n/stacioni), duhet të sigurohen nga furnizuesi dhe duhet të përmbajnë kabinat (n/stacionet), numrin që i dallon, muajin dhe vitin e hyrjes në shërbim. Elementet e mësipërme duhet të tregohen në një vend të posaçëm, në një pozicion të dukshëm nga jashtë kabinës.

b) Në faturat e shtypura nga furnizuesi për pagesat e lidhjes së re, në bazë të tarifave të këtij udhëzimi, duhet të jetë i treguar numri i kabinës (n/stacionit) të cilës i jemi referuar.

#### KAPITULLI III

#### LIDHJA ME ENERGJI ELEKTRIKE E PËRDORUESVE TË PËRKOSSHËM JO TË PËRSËRITUR

#### Neni 7

a) Pagesat për lidhjen e përdoruesve me furnizim të karakterit me kohëzgjatje të përkohshme, qoftë edhe më të madhe se një vit, por jo të përsëritur në vitet e mëpasshme, janë të përcaktuara si më poshtë:

b) Lidhje ose shtesë fuqie në TU do të paguhet tarifa e fuqisë prej 1500 lekësh për kabinat ajrore dhe me 2500 lekë për kabinat tip boks, për kE të fuqisë maksimale të kërkuar.

c) Lidhje ose shtesë fuqie në TM do të paguhet tarifa e fuqisë prej 4000 lekësh për kE të fuqisë maksimale të kërkuar.

d) Për çdo veprim lidhjeje ose shkëputjeje të kërkuar jashtë orarit të punës do të paguhet një shtesë prej 1500 lekësh.

**KAPITULLI IV**  
**RILIDHJA ME ENERGJI ELEKTRIKE E PËRDORUESVE SEZONALË MODIFIKIME**  
**KONTRAKTUESE, LIDHJE TË REJA, TRANSFERIME DHE TË ABONENTËVE QË U ËSHTË**  
**NDËRPRERË ENERGJIA PËR ARSYE DEBIE APO SHKELJE TË KONTRATËS**

**Neni 8**

- a) Rilidhja e përdoruesve sezonalë
  - Paguesa për rivënien dhe shkëputjen e përdoruesve sezonalë me karakter të vazhdueshëm do të jetë fikse, 3250 lekë.
- b) Modifikime kontraktuale, lidhje të reja, transferime
  - Paguesa për modifikime kontraktuale me kërkesë të përdoruesit që nuk sjellin rritje të fuqisë maksimale të kërkuar ( $P_k$ ), që do të çonin në ndryshime tarifore, do të jetë në vlerën 3250 lekë.
- c) Për abonentët, të cilëve u është ndërprerë energjia për arsye debie apo shkelje të kontratës së energjisë elektrike, në momentin e rilidhjes së energjisë elektrike do të aplikohet pagesa:
  - Paguesa për abonentët familjarë të jetë 500 lekë.
  - Paguesa për abonentët privatë të jetë 1000 lekë.

**KAPITULLI V**  
**PËRDORUES TË VEÇANTË DHE ZHVENDOSJE TË IMPIANTEVE ELEKTRIKE**

**Neni 9**

Për lidhjen me energji elektrike të objekteve të vendosura jo në mënyrë të përhershme, të vendosura jashtë vendbanimeve (instalime të sinjalizimeve rrugore, repetitorë televizivë, impiante të mbrojtjes katodike, radiofonia, të transmetimit të të dhënave, stacione elektropompimi, vende për kafshët, magazina, e të ngjashme me to), ndërtime që nuk janë lehtësisht të hapura nga rruga e kalimit të automjeteve ose që janë të ndara nga impiantet e shpërndarjes ekzistuese me pjesë detare, liqene ose laguna, pagesa është fiksuar në masën 100% të shpenzimeve të ndërtimit të linjës elektrike.

**Neni 10**

Për lidhjen e ndriçimit dhe të reklamave, ndriçimit të monumenteve, impianteve të ngjitjes, instalime të përkohshme ose të lëvizshme (roulotess etj.) ndërtime të veçuara të pabanuara në mënyrë të përhershme ose sidoqoftë jo rezidenciale (vila, shtëpia për gjueti rifuxhio në male etj), të vendosura në më tepër se 2000 metra nga kabina elektrike TM/TU së cilës i referohemi, kërkuesi është i detyruar t'i rimbursojë furnizuesit shpenzimet përkatëse.

**Neni 11**

Zhvendosjet e pajisjeve elektrike dhe të grupit të matjes bëhen me kërkesë të përdoruesit dhe ky i fundit është i detyruar t'i rimbursojë furnizuesit shpenzimet përkatëse.

**Neni 12**

Me shpenzim përkatës kuptohet kostoja e dokumentuar e materialeve të veprës, përveç shpenzimeve të përgjithshme, të cilat konsiderohen të barabarta me 20% të vlerës së parathënë (shpenzime plotësuese që kryen furnizuesi).

## KAPITULLI VI NORMAT TRANZITORE

### Neni 13

Këto tarifa nuk aplikohen për lidhjet e përcaktuara më parë se data e hyrjes në fuqi të kësaj metodologjie, ndërkohë që ekzekutimi i punimeve përkatëse nuk ka filluar në këtë datë. Konsiderohen të përfunduara lidhjet për të cilat detyrimi i pagesës së tarifave është derdhur ose është parashikuar në faturën përkatëse.

## UDHËZIME PËRFUNDIMTARE

### Neni 14

1. Vlerat e tarifave të përcaktuara në këtë udhëzim do të rishikohen në çdo kohë nga ERE, me propozim të furnizuesit, duke u bazuar në lëvizjen e inflacionit.

2. Furnizuesi ka të drejtë të verifikojë edhe mbas lidhjes ekzistencën e kushteve në bazë të të cilave është përcaktuar pagesa. Në rastet kur nga ky verifikim konstatohet se personi që ka bërë aplikimin për lidhjen me energji elektrike i detyrohet furnizuesit (me përjashtim të rasteve kur vepra përbën objekt për ndjekje penale) vlerën respektive të diferencës së pagesës reale që i detyrohet dhe asaj të derdhur.

3. Në dosjen përkatëse të çdo lidhjeje duhet të shtohen edhe:

- a) Protokollin i tokëzimit;
- b) Aktin e marrjes në dorëzim nga ana e furnizuesit (KESH);
- c) Procesverbalin e vendosjes së matësit elektrik.

### Neni 15

Detyrohen palët për respektimin e të gjitha akteve nënligjore të miratuara nga ERE.

### Neni 16

Çdo normë juridike e paraqitur në këtë metodologji është objekt rishikimi dhe ndryshimi me miratim të ERE-s.

### Neni 17

Shfuqizohet vendimi nr.17, datë 19.12.2001 “Për miratimin e udhëzimeve mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj”.

### Neni 18

Kjo metodologji hyn në fuqi më datë 1 shtator 2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**UDHËZIM**  
**Nr.5, datë 7.9.2006**

**PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE, NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, DHE TË KOEFICIENTIT “K“ PËR VITIN 2006**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 nenit 14 të ligjit nr.9416, datë 20.5.2005 “Për procedurat e privatizimit të banesave, të ndërtuara ose të blera me fonde shtetërore nga Enti Kombëtar i Banesave”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**UDHËZON:**

1. Kostoja mesatare e ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, në shkallë republike, për vitin 2006, të jetë 29 220 (njëzet e nëntë mijë e dyqind e njëzet) lekë/m<sup>2</sup> për sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave, sipas qyteteve, për vitin 2006, të jetë sipas tabelave nr.1 e nr.2, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.

3. Vlera e koeficientit “K” të jetë sipas tabelës nr.3, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatim e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**KOSTO MESATARE E NDËRTIMIT PËR VITIN 2006**

Tabela nr.1

Nr	Qyteti	Çmimi për njësi (mesatare arih.)	
		Sip.shfrytëzimi	Sip.ndërtimi
		Lek/m <sup>2</sup>	Lek/m <sup>2</sup>
1	Bajram Curri	31.877	27.904
2	Berat	28.732	25.150
3	Burrel	29.769	26.058
4	Durrës	30.823	26.976
5	Elbasan	27.548	24.113
6	Erskeë	28.590	25.025
7	Fier	28.948	25.340
8	Gramsh	28.244	24.723
9	Gjirokastrë	30.009	26.267
10	Korçë	28.742	25.158
11	Krujë	28.376	24.838
12	Kavajë	28.484	24.934
13	Kuçovë	28.427	24.883
14	Kukës	31.262	27.366
15	Laç	28.353	24.818
16	Lezhë	30.252	26.477
17	Librazdh	28.227	24.708
18	Lushnje	29.299	25.647
19	Prrenjas	28.913	25.309
20	Peqin	28.421	24.878
21	Peshkopi	29.493	25.816
22	Përmet	28.745	25.161

23	Pogradec	28.303	24.772
24	Pukë	29.493	25.816
25	Rrëshen	28.462	24.913
26	Çorovodë	29.209	25.568
27	Sarandë	29.579	25.892
28	Shkodër	29.655	25.957
29	Tepelenë	28.796	25.206
30	Tiranë	28.860	25.262
31	Vlorë	31.174	27.283
<b>Kosto mesatare</b>		<b>29.220</b>	<b>25.577</b>

## TË DHËNAT NË TREGUN E LIRË TË APARTAMENTEVE

Tabela nr.2

Nr	Qyteti	Kosto e shitjes lek/m2 sip.shfrytëz.për tregun e lirë
1	2	3
1	Bajram Curri	23 049
2	Ballsh	32 076
3	Berat	30 111
4	Bulqizë	15 814
5	Burrel	26 426
6	Cërrik	32 623
7	Corovodë	10 018
8	Delvinë	25 019
9	Devoll	35 876
10	Durrës	57 829
11	Elbasan	41 838
12	Ersekë	22 594
13	Fier	48 248
14	Fushë-Krujë	30 970
15	Fushë-Arrëz	6 777
16	Gjirokastër	39 034
17	Gramsh	30 723
18	Himarë	50 279
19	Kavajë	48 738
20	Këlcyrë	16 862
21	Korçë	46 170
22	Koplik	36 775
23	Krujë	32 324
24	Krumë	30 276
25	Kuçovë	23 134
26	Kukës	27 851
27	Laç	28 296
28	Leskovik	21 230
29	Lezhë	66 798
30	Librazhd	36 033
31	Lushnje	40 190
32	Maliq	29 617
33	Memaliaj	10 899
34	Mamurras	19 463
35	Patos	31 307
36	Përmet	22 551
37	Peqin	34 979
38	Peshkopi	25 399
39	Pogradec	45 533
40	Poliçan	10 474
41	Prrenjas	34 350
42	Pukë	12 973
43	Roskovec	39 740

44	Rrëshen	31 078
45	Rubik	33 306
46	Sarandë	50 995
47	Shëngjin	66 798
48	Shkodër	45 763
49	Shijak	35 166
50	Tepelenë	18 360
51	Tiranë	79 615
52	Vau i Dejës	23 415
53	Vlorë	48 156
54	Vorë	46 725

## VLEFTA E KOEFICIENTIT “K”

Tabela nr.3

Nr	Qyteti	Koeficienti korrigjues “K”
1	2	3
1	Bajram Curri	0 .7231
2	Ballsh	1.000
3	Berat	1.000
4	Bulqizë	0.5362
5	Burrel	0.8877
6	Cërrik	1.000
7	Corovodë	0.3430
8	Delvinë	0.8458
9	Devoll	1.000
10	Durrës	1.000
11	Elbasan	1.000
12	Ersekë	0.7903
13	Fier	1.000
14	Fushë-Krujë	1.000
15	Fushë-Arrëz	0.2298
16	Gjirokastër	1.000
17	Gramsh	1.000
18	Himarë	1.000
19	Kavajë	1.000
20	Këlcyrë	0.5866
21	Korçë	1.000
22	Koplik	1.000
23	Krujë	1.000
24	Krumë	0.9685
25	Kuçovë	0.8138
26	Kukës	0.8909
27	Laç	0.9980
28	Leskovik	0.7366
29	Lezhë	1.000
30	Librazhd	1.000
31	Lushnje	1.000
32	Maliq	1.000
33	Memaliaj	0.3785
34	Mamurras	0.6865
35	Patos	1.000
36	Përmet	0.7845
37	Peqin	1.000
38	Peshkopi	0.8612
39	Pogradec	1.000
40	Poliçan	0.3724
41	Prrenjas	1.000
42	Pukë	0.4399
43	Roskovec	1.000

44	Rrëshen	1.000
45	Rubik	1.000
46	Sarandë	1.000
47	Shëngjin	1.000
48	Shkodër	1.000
49	Shijak	1.000
50	Tepelenë	0.6376
51	Tiranë	1.000
52	Vau i Dejës	0.7896
53	Vlorë	1.000
54	Vorë	1.000

**UDHËZIM**  
**Nr.6, datë 8.11.2006**

**PËR DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR PËR MIRATIMIN E KUFIRIT TË ZONËS/VENDBANIMIT/BLLOKBANIMIT/NDËRTIMIT INFORMAL TË VEÇUAR DHE TË TERRITOREVE TË TJERA ME NDËRTIME PA LEJE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1.1 të nenit 11 dhe nenit 45 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”,

**UDHËZOJ:**

1. Njësia e qeverisjes vendore, për të realizuar grupimin e ndërtimeve pa leje, emërtimin e territorit të zënë dhe për të përcaktuar kufirin e zonës/vendbanimit/bllokbanimit/ndërtimit informal të veçuar dhe të territoreve të tjera, për efekt vendimmarrjeje, i referohet:

- a) gjendjes faktike të situatës ndërtimore;
- b) identifikimit dhe verifikimit të ndërtimeve pa leje në terren dhe në hartë;
- c) vendndodhjes së objekteve;
- d) madhësisë së territorit me ndërtime pa leje;
- e) kufirit territorialo-administrativ të njësive të qeverisjes vendore dhe vijave kufizuese të ndërtimit (vija e verdhë);
- f) studimeve urbanistike dhe të infrastrukturës në nivel kombëtar e rajonal të miratuara ose në proces;
- g) studimeve urbanistike të tjera, të miratuara deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”;
- h) statusit të sipërfaqes së tokës së zënë;
- i) morfologjisë dhe kushteve të relievit;
- j) mbrojtjes së veçantë ligjore që gëzojnë zona të caktuara.

1.1 Për Bashkinë e Tiranës, realizimi i grupimit të ndërtimeve pa leje, emërtimi i territorit të zënë dhe përcaktimi i kufirit të zonës/vendbanimit/bllokbanimit/ndërtimit informal të veçuar dhe të territoreve të tjera, bëhet nga njësiti bashkiake.

2. Për propozimin dhe miratimin e kufirit të zonës/vendbanimit informal me ndërtime pa leje, zyra e urbanistikës së njësisë së qeverisjes vendore përgatit dokumentacionin tekniko-ligjor, i cili përmban:

a) hartën e zonës/vendbanimit informal të përditësuar, në shkallën 1:1000 deri 1:2500 me kufirin e propozuar dhe sipërfaqen (e shprehur në shifra në relacion dhe në legjendën e hartës).

Në këtë hartë mbivendosen:

- i) studimet urbanistike dhe të infrastrukturës në nivel kombëtar e rajonal, të miratuara ose në proces;
- ii) infrastrukturën inxhinerike;
- iii) zonat që gëzojnë mbrojtje të veçantë ligjore;

iv) kufirin administrativo-territorial të njësisë/-ve së/të qeverisjes vendore dhe vijën e ndërtimit (vija e verdhë).

b) hartën e shkallës 1:2500 deri në 1:25000, ku paraqitet zona e propozuar në raport me kufijtë administrativë;

c) hartën kadastrale në shkallën 1:1000 deri 1:2500, ku pasqyrohet situata e pronësisë mbi tokën;

d) hartën e shkallës 1:1000 deri 1:2500, ku paraqitet boniteti i tokës;

e) numrin total të ndërtimeve pa leje të deklaruara dhe të padeklaruara;

f) pasqyrën përmbledhëse të të dhënave për ndërtimet pa leje;

g) relacionin me argumentimin tekniko-ligjor për propozimin e kufirit të zonës/vendbanimit informal.

3. Për realizimin e dokumentacionit të paraqitur në pikën 2 të këtij udhëzimi, njësia e qeverisjes vendore bashkëpunon me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ose/dhe strukturat rajonale përkatëse.

4. Propozimi për miratimin e kufirit, për zonën informale dhe vendbanimin informal, shqyrtohet dhe miratohet në këshillin e qarkut.

5. Vendimi i këshillit të qarkut, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor depozitohen pranë zyrës qendrore të ALUIZNI-t.

6. Zyra qendrore e ALUIZNI-t përgatit oponencën dhe e paraqet në sekretarinë e KRRTRSH-së për emërtim dhe miratim të kufirit të zonës/vendbanimit informal, së bashku me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën e këshillit të qarkut drejtuar KRRTRSH-së;

b) vendimin e këshillit të qarkut;

c) dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi;

d) mendimin e marrë nga institucionet e përcaktuara në pikën 3 të këtij udhëzimi.

7. Vendimi i miratimit të kufirit dhe emërtimit të zonës/vendbanimit informal, nga KRRTRSH-ja, i përcillet njësisë të qeverisjes vendore për përcaktimin e kufijve dhe sipërfaqeve të parcelave ndërtimore.

8. Njësia e qeverisjes vendore, për përcaktimin e kufijve dhe sipërfaqeve të parcelave ndërtimore për zonën/vendbanimin informal, përgatit:

a) hartën e shkallës 1:1000 deri 1:2500, sipas madhësisë së zonës, ku paraqitet kufiri i miratuar nga KRRTRSH-ja dhe parcelat përkatëse të objekteve;

b) hartën kadastrale të zonës, në shkallën 1:1000 deri 1:2500, ku të pasqyrohet situata e pronësisë mbi tokën.

9. Kufijtë e secilës parcelë përcaktohen në përputhje me:

a) kufirin e zonës së miratuar nga KRRTRSH-ja;

b) studimet urbanistike;

c) ndarjen territorial-administrative;

d) zonat e mbrojtura nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

10. Për përcaktimin e kufijve të secilës parcelë duhet të merret në konsideratë infrastruktura dhe rrjeti inxhinierik.

11. Shqyrtimi dhe miratimi i kufirit për bllokbanimet/ndërtimet informale dhe territoret e tjera, kufiri dhe sipërfaqja e parcelës për secilin objekt realizohet nga KRRT-të e njësisë të qeverisjes vendore me një vendimmarrje të vetme.

12. Për propozimin dhe miratimin në KRRT të kufirit të bllokbanimeve/ndërtimeve informale dhe territoreve të tjera, të kufirit dhe sipërfaqes së parcelave të objekteve, zyra e urbanistikës së njësisë së qeverisjes vendore përgatit dokumentacionin tekniko-ligjor, sipas pikës 2 dhe 3 të këtij udhëzimi.

13. Për objektet e veçanta pa leje dhe për shtesat pa leje në ndërtimet me leje, vendimmarrja realizohet në KRRT-të e njësisë të qeverisjes vendore. Dokumentacioni i domosdoshëm që do të paraqitet do të jetë sipas pikës 2-a/b/c/d/g të këtij udhëzimi.



14. Në rastet kur njësia e qeverisjes vendore nuk ushtron përgjegjësitë, për shkaqet e parashikuara në pikën “d” neni 4 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, kompetencat e njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të Këshillit të Ministrave, i kalojnë ALUIZNI-t.

15. Vendimet e KRRT-së/KRRTRSH-së do të jenë baza për përgatitjen e genplanit në shkallën 1:500 për parcelën dhe objektin që legalizohet dhe do të realizohet në përputhje të plotë me to.

16. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT  
DHE TELEKOMUNIKACIONIT

**Lulzim Basha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.119 faqe 4782*

**VENDIM**  
**Nr.1180, datë 5.8.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR LEGALIZIM DHE  
MBLEDHJEN E ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË PROCESIT TË LEGALIZIMIT**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.1587, datë 3.12.2008;  
ndryshuar me vendim të KM nr.246, datë 13.4.2010)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Tarifa e shërbimit për legalizimin e objekteve pa leje/shtesave informale në ndërtime me leje, është në vlerën 4 000 (katër mijë) lekë, për çdo kat të objektit pa leje/shtesës informale në ndërtime me leje.

1.2 Të ardhurat e mbledhura nga tarifa e shërbimit për legalizim do të përdoren nga ALUIZNI për përditësimin në terren dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik të objekteve pa leje apo shtesave informale në ndërtime me leje, si dhe për ngritjen e funksionimit të zyrave të përkohshme, që do të kryejnë këtë shërbim, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

1.3 Për objektet informale, të kualifikuara për legalizim, ALUIZNI afishon listën e subjekteve poseduese dhe i pajis ato me formularin e pagesës së tarifës së shërbimit.

1.4 Brenda një muaji nga pajisja me formularin e pagesës së tarifës së shërbimit, modeli i të cilit i bashkëlidhet këtij vendimi, subjektet, që do të vazhdojnë procedurat e legalizimit të objekteve pa leje apo shtesave informale, në ndërtime me leje, do ta derdhin këtë pagesë në numrin e llogarisë bankare, të hapur për këtë qëllim nga ALUIZNI.

2. Subjektet, që kanë vetëdeklaruar jashtë afateve ligjore (në muajin e 3-të dhe të 4-t) të periudhës së vetëdeklarimit, së bashku me tarifën e shërbimit do t'i shlyejnë edhe sanksionet e parashikuara për këtë qëllim, për llogari të ALUIZNI-t, duke iu referuar kohës së vetëdeklarimit dhe natyrës së ndërtimit informal (vilë, shtesë familjare, shtesë tregtare), të parashikuara në nenin 8 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar. Të ardhurat e mbledhura nga këto sanksione së bashku me tarifën e shërbimit, do të përdoren nga ALUIZNI, në përputhje me përcaktimin e bërë në pikën 1.2 të këtij vendimi.

3. Drejtoria rajonale e ALUIZNI-t, në përputhje me të dhënat ndërtimore të dokumentacionit teknik (genplan, planimetri) kryen llogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në

infrastrukturë, për çdo objekt informal, publikon listën emërore të subjekteve taksapaguese dhe i pajis ato me formularin e pagesës.

3.1 Taksa e ndikimit në infrastrukturë llogaritet duke iu referuar koston mesatare vjetore të ndërtimit të banesave për m<sup>2</sup>, publikuar nga Enti Kombëtar i Banësive, në kohën e llogaritjes, në përputhje me pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr.9416, datë 20.5.2005, “Për procedurat e privatizimit të banësive, të ndërtuara ose të blera me fonde shtetërore nga Enti Kombëtar i Banësive”.

3.2 Për objektet me leje, me shtesa informale në ndërtim, përqindja e taksës vendore të ndikimit në infrastrukturë do të aplikohet mbi vlerën e investimit të shtesës informale.

3.3 Taksa e ndikimit në infrastrukturë paguhet brenda 30 ditëve nga data e pajisjes me formularin e pagesës, modeli i të cilit i bashkëlidhet këtij vendimi, për llogari të njësisë së qeverisjes vendore, ku ndodhet ndërtimi informal. Fondi i krijuar nga pagesa e kësaj takse, do të përdoret për financimin e studimeve urbanistike, realizimin e tyre dhe përmirësimin e infrastrukturës së territoreve, që legalizohen.

4. Pagesa për parcelën ndërtimore, mbi të cilën është ngritur objekti informal/shtesa informale, në ndërtime me leje, llogaritet nga ALUIZNI, sipas neneve 19, 20, 21 e 22 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

4.1 Për objektet informale, me funksion banimi, kur sipërfaqja e parcelës ndërtimore është e një madhësie të ndërmjetme nga sipërfaqet e përcaktuara në nenet 19, 20, 21 e 22, pagesa për të, do të jetë shumë e vlerës më të vogël në lekë, plus vlerën shtesë, që del nga llogaritja me interpolim për sipërfaqen shtesë.

4.2. Kur objekti informal ka funksion social-ekonomik, vlera në lekë e parcelës ndërtimore llogaritet duke u bazuar në çmimin e tregut për m<sup>2</sup>, në çastin e kalimit të pronësisë.

4.3. Për objektet informale, me funksion të përzier (për banim dhe funksion social-ekonomik) për të llogaritur vlerën e parcelës ndërtimore do të aplikohet dhe koeficienti i shfrytëzimit të ndërtesës në legalizim, i përcaktuar me vendimin nr.870, datë 27.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për koeficientin e shfrytëzimit të ndërtesës në legalizim, me destinacion social-ekonomik”, sipas formulës: Vlera shtesë = Sip.social-ekonomike x Çmimi për m<sup>2</sup> i parcelës x(1±K).

4.4 Pagesa e parcelës ndërtimore, për objektet informale me destinacion social-ekonomik dhe shtesat informale në ndërtime me leje, do të bëhet vetëm në lekë, në vlerë të plotë monetare.

4.5 Për objektet informale, me destinacion banimi apo të përzier (banim dhe social-ekonomik), pagesa e vlerës së parcelës mund të bëhet në lekë, në vlerë të plotë monetare, dhe/ose me bono privatizimi.

Në rastin kur pagesa kryhet me bono privatizimi, ajo duhet të paraprihet nga depozitimi i kërkesës me shkrim, të poseduesit të ndërtimit informal, pranë drejtorisë rajonale të ALUIZNI-t, ku të përcaktohet përqindja e pagesës me bono privatizimi.

4.6 Për shlyerjen e pagesës së parcelës ndërtimore, subjektet mund të përfitojnë nga skema e kreditimit bankar.

5. Sanksionet për subjektet dhe / ose shoqëritë ndërtuese që kanë kryer shtesa anësore ose shtesa në kate, për qëllim kalimi pronësie ose qiradhënieje, llogariten nga ALUIZNI, në përputhje me përcaktimet dhe përqindjet e përcaktuara në nenin 43 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

Për shtesat informale (anësore apo në lartësi), të ngritura në territore (zona) ku nuk ka çmim minimal fiskal, të përcaktuar në përputhje me pikën 2 të nenit 43 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, çmimi minimal fiskal do të llogaritet si mesatare aritmetike e çmimit të zonave me të cilat ky territor (zonë) kufizohet.

5.1 Likuidimi i penalteteve do të bëhet për llogari të njësisë të qeverisjes vendore brenda 30 ditëve nga pajisja me formularin e penalteteve për legalizimin e shtesave informale të subjektit ndërtues.

5.2 Për subjektet dhe/ose shoqëritë ndërtuese të cilat kanë paguar sanksione të mëparshme për shkelje të lejes së ndërtimit, nga vlera totale e sanksioneve do të zbritet vlera e paguar më parë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 mars 2008.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.136, faqe 6038*

*Vendim i KM nr.1587, datë 3.12.2008 botuar në Fletoren Zyrtare nr.195, faqe 10663*

*Vendim i KM nr.246, datë 13.4.2010 botuar në Fletoren Zyrtare nr.49, faqe 1827*

**UDHËZIM**  
**Nr.2, datë 4.4.2007**

**PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE, NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, DHE TË KOEFICIENTIT “K”, PËR VITIN 2007**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 14 të ligjit nr.9416, datë 25.5.2005 “Për procedurat e privatizimit të banesave, të ndërtuara ose të blera me fondet shtetërore, nga Enti Kombëtar i Banesave”, dhe të nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**UDHËZON:**

1. Kostoja mesatare e ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, në shkallë republike, për vitin 2007, të jetë 29 874 (njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë/m<sup>2</sup>, për sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mestare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave, për vitin 2007, sipas qyteteve, të jetë sipas tabelave nr.1 e nr.2, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.

3. Vlera e koeficientit “K” të jetë sipas tabelës nr.3, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

4. Për qytetet, për të cilat nuk janë nxjerrë vlerat e kostos mesatare të ndërtimit, si dhe për zonat rurale, të merren vlerat e qytetit më të afërt, sipas tabelës.

5. Vlerat mesatare të banesave në tregun e lirë nuk mund të përdoren për t’iu referuar zonave të afërta.

6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.45, faqe 1151*

## KOSTOJA MESATARE E NDËRTIMIT PËR VITIN 2007

Në këtë vlerë të koston mesatare nuk janë përfshirë vlerat e:

1. rrjetit inxhinierik,
2. projektit,
3. studimit gjeologjik dhe sizmik,
4. lejes së ndërtimit,
5. truallit,
6. shpenzimeve operationale të EKB 4%.

Tabela 1

Nr.	Qyteti	Çmimi për njësi (mesatare aritmetike)	
		Sip.shfrytëzimi lekë/m <sup>2</sup>	Sip.ndërtimi lekë/m <sup>2</sup>
1	Berat	29 667	24 794
2	Dibër	31 141	26 029
3	Durrës	30 098	25 141
4	Elbasan	28 104	23 482
5	Ersekë	30 311	25 324
6	Fier	29 663	24 796
7	Gramsh	28 802	24 071
8	Gjirokastër	30 182	25 226
9	Korçë	30 301	25 317
10	Krujë	29 176	24 382
11	Kavajë	29 762	24 867
12	Kuçovë	29 457	24 618
13	Kukës	31 758	26 542
14	Laç	29 042	24 267
15	Lezhë	29 127	24 336
16	Librazhd	28 584	23 886
17	Lushnjë	30 543	25 526
18	Mat	30 297	25 317
19	Përrenjas	29 170	24 378
20	Peqin	29 099	24 317
21	Përmet	30 279	25 289
22	Pogradec	30 060	25 124
23	Pukë	30 391	25 398
24	Rrëshen	29 415	24 582
25	Skrapar	29 757	24 872
26	Sarandë	30 289	25 314
27	Shkodër	30 001	25 072
28	Tepelenë	29 961	25 040
29	Tropojë	31 986	26 734
30	Tiranë	29 914	24 993
31	Vlorë	29 743	24 844
	Kosto mesatare	29 874	24 964

Për qytetet të cilat nuk janë përfshirë në listë, të merret kostoja mesatare e qytetit më të afërt.

TË DHËNAT E TREGUT TË LIRË TË APARTAMENTEVE PËR VITIN 2007

Tabela nr.2

Nr.	Qytetet	Kostoja e shitjes lekë/m <sup>2</sup> sip shfrytëzimi për tregun e lirë
1	Berat	30 451
2	Bulqizë	18 116
3	Cërrik	32 746
4	Çorovodë	9 835
5	Delvinë	23 750
6	Devoll	36 545
7	Dibër	31 940
8	Durrës	81 080
9	Elbasan	44 065
10	Fier	48 953
11	Fushë-Krujë	33 151
12	Fushë-Arrëz	7 932
13	Gjirokastër	45 876
14	Gramsh	31 031
15	Has	29 667
16	Himarë	50 174
17	Kavajë	43 102
18	Këlcyrë	14 915
19	Kolonjë	25 564
20	Korçë	47 201
21	Krujë	38 734
22	Kuçovë	23 392
23	Kukës	27 204
24	Laç	31 722
25	Leskovik	21 974
26	Lezhë	64 571
27	Librazhd	35 951
28	Lushnjë	40 529
29	M.Madhe	37 250
30	Maliq	30 913
31	Mallakastër	29 951
32	Mamurras	22 614
33	Mat	29 315
34	Memaliaj	8 763
35	Mirditë	31 180
36	Patos	18 680
37	Peqin	36 520
38	Përmet	23 191
39	Pogradec	46 222
40	Poliçan	9 877
41	Përrenjas	33 902
42	Pukë	13 128
43	Roskovec	29 336
44	Rubik	34 000
45	Sarandë	50 537
46	Shëngjin	68 482
47	Shkodër	47 509
48	Shijak	39 026
49	Tepelenë	16 851
50	Tiranë	97 000
51	Tropojë	22 861
52	Vau i Dejës	23 415
53	Vlorë	49 335
54	Vorë	55 348

VLEFTA E KOEFICIENTIT “K” PËR VITIN 2007

Tabela nr.3

Nr.	Qytetet	Vlera e koeficientit “K”
1	Berat	1.0264
2	Bulqizë	0.5818
3	Cërrik	1.1652
4	Çorovodë	0.3305
5	Delvinë	0.7841
6	Devoll	1.2061
7	Dibër	1.0256
8	Durrës	2.6939
9	Elbasan	1.5679
10	Fier	1.6503
11	Fushë-Krujë	1.1362
12	Fushë-Arrës	0.2547
13	Gjirokastër	1.5200
14	Gramsh	1.0774
15	Has	0.9342
16	Himarë	1.6869
17	Kavajë	1.4482
18	Këlcyrë	0.4926
19	Kolonjë	0.8434
20	Korçë	1.5577
21	Krujë	1.3276
22	Kuçovë	0.7941
23	Kukës	0.8566
24	Laç	1.0923
25	Leskovik	0.7257
26	Lezhë	2.2169
27	Librazhd	1.2577
28	Lushnjë	1.3270
29	M.Madhe	1.2416
30	Maliq	1.0202
31	Mallakastër	1.0097
32	Mamurras	0.7787
33	Mat	0.9676
34	Memaliaj	0.2925
35	Mirditë	1.0600
36	Patos	0.6297
37	Peqin	1.2550
38	Përmet	0.7659
39	Pogradec	1.5377
40	Poliçan	0.3329
41	Përrenjas	1.1622
42	Pukë	0.4320
43	Roskovec	0.9890
44	Rubik	1.1222
45	Sarandë	1.6685
46	Shëngjin	2.3512
47	Shkodër	1.5836
48	Shijak	1.2966
49	Tepelenë	0.5624
50	Tiranë	3.2426
51	Tropojë	0.7147
52	Vau i Dejës	0.7805
53	Vlorë	1.6587
54	Vorë	1.8503

**UDHËZIM**  
**Nr.7, datë 8.11.2006**

**PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT DHE RUAJTJEN E TË DHËNAVE**  
**PËR NDËRTIMET PA LEJE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 2 të nenit 12 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”,

**UDHËZOJ:**

1. Përzgjedhja dhe mbledhja e të dhënave për ndërtimet pa leje
  - a) Njësia e qeverisjes vendore, për të realizuar përzgjedhjen dhe mbledhjen e të dhënave të nevojshme për procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, shfrytëzon:
    - i) të dhënat e përfuara nga/gjatë etapës së vetëdeklarimit;
    - ii) të dhënat e përfuara nga/gjatë etapës së identifikimit në terren;
    - iii) të dhënat e përfuara nga/gjatë etapës së plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor.
  - b) Këto të dhëna kanë të bëjnë me vetëdeklaruesin e ndërtimit pa leje, ndërtimin/objektin pa leje dhe me parcelën ndërtimore.
    - c) ALUIZNI përpunon të dhënat e mbledhura nga njësitë e qeverisjes vendore, të cilat do të shërbejnë për monitorimin, realizimin e procesit të legalizimit, regjistrimin fillestar të ndërtimeve pa leje, kompensimin dhe për urbanizimin e integrimin e territoreve informale.
    - d) Me të dhënat e mbledhura nga njësitë e qeverisjes vendore gjatë etapave të ndryshme, ALUIZNI do të krijojë bazën e të dhënave (*data base*) të procesit të legalizimit.
2. Të dhënat e përfuara nga/gjatë etapës së vetëdeklarimit

Nga regjistri i të dhënave të formularëve “Vetëdeklarim për legalizim objekti” (A dhe A1), i cili përbën një bazë të rëndësishme të dhënash për vazhdimësinë e procesit, njësia e qeverisjes vendore selekton dhe shfrytëzon këto elemente:

  - a) numrin e dosjes së vetëdeklarimit të ndërtimit pa leje, i cili është numër unik brenda bashkisë/komunës dhe do të shërbejë si element identifikues për objektin deri në përfundim të procesit;
  - b) emrin, atësinë dhe mbiemrin e plotë të vetëdeklaruesit;
  - c) datën e vetëdeklarimit, e cila do të shërbejë për përcaktimin e sanksioneve financiare të zbatueshme për etapën e vetëdeklarimit.
3. Të dhënat e përfuara nga/gjatë etapës së identifikimit në terren
  - a) Grupet e punës të ngritura nga njësia e qeverisjes vendore, përmes hartimit të procesverbalit të konstatimit, saktësojnë dhe grumbullojnë në terren të dhëna reale për gjendjen ndërtimore të objekteve dhe gjendjen e parcelave ndërtimore.

Këto të dhëna janë:

    - i) sipërfaqja e parcelës ndërtimore;
    - ii) sipërfaqja totale e ndërtimit;
    - iii) sipërfaqja e bazës së objektit;
    - iv) numri i kateve të objektit pa leje;
    - v) funksioni i hapësirave të objektit pa leje;
    - vi) qëllimi i shfrytëzimit të objektit pa leje (qiradhënie/shitblerje);
    - vii) kualifikimi paraprak për ndërtimet pa leje (vazhdojnë procedurat e legalizimit/nuk legalizohen/pezullohen);
    - viii) data e identifikimit në terren.
  - b) Të dhënat e grumbulluara do të paraqiten në formë tabelore (tabela nr.1 bashkëngjitur këtij udhëzimi) dhe plotësimi i saj do të realizohet sipas grupimevezonë /vendbanim/ bllokbanim /ndërtim informal dhe territore të tjera, si dhe për shtesat pa leje në objekte me leje.

c) Përpunimi i të dhënave të përfituara nga tabela nr.1 dhe nga hartat dixhitale, produkt i fotografisë ajrore, do të shërbejnë për hartimin dhe përputhjen e plotë të parcelave ndërtimore (genplaneve).

4. Të dhënat e përfuara pas vendimmarrjes në KRRT / KRRTSRH

Këto të dhëna kanë të bëjnë me:

a) emërtimin e territorit informal;

b) kualifikimin e objekteve për legalizim (po, jo, pezullohen);

c) ridimensionimin e sipërfaqeve të parcelave ndërtimore dhe/ose sipërfaqes së ndërtimit.

5. Të dhënat e përfuara përmes procedurave për plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor

a) Gjatë plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor, njësia e qeverisjes vendore grumbullon të dhënat e mëposhtme:

i) numrin e zonës kadastrale;

ii) numrin e pasurisë;

iii) adresën e plotë të pasurisë (qarku, qyteti/fshati, rruga/lagjja, pallati/godina, shkalla/kati, apartamenti);

iv) sipërfaqen e parcelës ndërtimore;

v) sipërfaqen totale të ndërtimit;

vi) sipërfaqen e bazës së objektit;

vii) dokumentin me të cilin gëzon/fiton pronësinë mbi tokën (ligj, vendim, kontratë, trasaksion etj.);

viii) pjesëmarrjen në bashkëpronësi;

ix) vlerën e paguar për parcelën ndërtimore.

b) Të dhënat e grumbulluara do të pasqyrohen në tabelën nr.2 bashkëngjitur këtij udhëzimi, me përjashtim të rubrikës “Kufizimet D/E”. Këto të dhëna, së bashku me ato të përfuara nga leja e legalizimit, do të shërbejnë për regjistrimin fillestar të pasurisë.

6. Administrimi dhe ruajtja e të dhënave të grumbulluara

a) Të gjitha të dhënat e përmendura në këtë manual do të plotësohen, administrohen dhe ruhen nga njësitë e qeverisjes vendore, në formë dixhitale (*cd*) dhe shkresore (*hard copy*).

b) Të dhënat duhet të jenë të sakta, të plota dhe nuk mund të përdoren për qëllime që nuk janë parashikuar në këtë udhëzim.

c) Informacioni për ecurinë do t’u përcillet në mënyrë periodike drejtorive rajonale të ALUIZNI-t.

d) Njësitë e qeverisjes vendore, të dhënat përfundimtare sipas zonimeve do t’ia përcjellin drejtorive rajonale të ALUIZNI-t, në dy kopje, në formë dixhitale (*cd*) dhe shkresore (*hard copy*). Materialet shkresore duhet të mbajnë firmën e kryetarit dhe vulën e njësisë së qeverisjes vendore.

e) Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t krijon sistemin e saj të përpunimit dhe administrimit të të dhënave, që do të shërbejë për legalizimin e objekteve pa leje dhe për regjistrimin fillestar, si dhe për ecurinë e të gjitha etapave të procesit.

f) Hartat dixhitale, produkt i fotografimit ajror, së bashku me infomacionet e mbledhura gjatë etapave të ndryshme, janë të dhënat bazë që do të shërbejnë për realizimin e procesit të legalizimit, regjistrimit fillestar, urbanizimit dhe integritit të territoreve me ndërtime pa leje.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT  
DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
**Lulzim Basha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.119, faqe 4784*



**TABELA Nr.1**

Qarku \_\_\_\_\_ Bashkia/Komuna \_\_\_\_\_ Fshati/Rajoni \_\_\_\_\_  
 Zona \_\_\_\_\_

Nr.	Nr. i dosjes	Emër	Adresi	Mbiemër	Data e vetdeklarimit	Sipërfaqjet			Nr. kateve	Funksioni/Qëllimi			Data e identifikimit në terren	Kualifikimi paraprak
						parcela	ndërtimi	baza		banesë	funksion social-ekonomik	qëllimi kombinuar		
1														
2														
3														
4														
5														
6														
7														
8														
9														
10														
11														
12														
13														
14														
15														
16														
17														
18														
19														
20														
21														
22														
23														
24														
25														
26														
27														

Për Njësinë e Qeverisjes Vendore



**URDHËR**  
**Nr.8, datë 30.10.2006**

**PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË HARTIMIT DHE PARAQITJES**  
**SË MATERIALEVE GRAFIKE**

Në mbështetje të shkronjës “c” pika 2 të nenit 4 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e manualit “Për hartimin dhe paraqitjen e materialeve grafike”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Drejtoritë rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, njësitë e qeverisjes vendore, gjatë hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike, të veprojnë sipas përcaktimeve të bëra në këtë manual.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**  
**Shaban Memia**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.119, faqe 4788*

**MANUAL**  
**PËR HARTIMIN DHE PARAQITJEN E MATERIALEVE GRAFIKE**

Ky manual shërben për unifikimin dhe standardizimin e procedurave në hartimin dhe paraqitjen e materialeve grafike nga specialistët e urbanistikës dhe të ALUIZNI-t.

Materiali grafik dhe të dhënat e përfuara sipas kritereve të përcaktuara në këtë manual do të shërbejnë për plotësimin e bazës së të dhënave në përputhje me nomenklaturën e sistemit të legalizimit dhe të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

1. Procedurat për hartimin e materialeve grafike

1.1 Në bazë të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.437, datë 28.6.2006 “Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të të dhënave për ndërtimet pa leje për ngritjen e bazës së të dhënave”, njësia e qeverisjes vendore, gjatë identifikimit në terren të ndërtimeve pa leje, bazuar në hartën kadastrale, kryen matjet e domosdoshme për hartimin e procesverbalit të konstatimit, miratuar me urdhrin nr.46, datë 18.7.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t, dhe matje të tjera shtesë për përgatitjen e genplanit. Të dhënat e terrenit shënohen në skicën fushore. Në skicë duhet të jenë të dallueshme përmasat e të gjitha elementeve: gjatësitë e kontureve të parcelës ndërtimore, të kontureve të objektit, largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve, hyrja për në parcelë, si dhe hyrja për në objekt.

1.2 Matjet kryhen në mënyrë që saktësia e tyre të plotësojë kushtet teknike të përcaktuara në standardet e manualeve teknike gjeodezike. Skica duhet të vizatohet në mënyrë që të jetë e lexueshme, pa deformime, shmangie apo korrigjime të vijave. Skica do të shoqërohet me librezën e matjeve fushore dhe çdo material tjetër të përdorur për kompletimin e matjeve.

1.3 Në skicë shënohet emri, atësia, mbiemri dhe adresa e poseduesit, si dhe emri, mbiemri dhe nënshkrimi i hartuesit dhe data e përpilimit të saj.

1.4 Matjet për hartimin e procesverbalit të konstatimit, kryhen në vijueshmëri territoriale, sipas grupimit për zonën/bllokbanimin/vendbanimin informal.

Në përfundim të tyre, grupi i ekspertëve pranë njësisë së qeverisjes vendore përditëson e harton materialet grafike si më poshtë:

- a) hartën e territorit të përditësuar;
- b) genplanin në shkallën 1:500;
- c) planimetritë në shkallën 1:100.

## 2. Modeli i paraqitjes së genplanit të parcelës ndërtimore.

2.1 Pas miratimit të kufirit të zonës/bllokbanimit/vendbanimit informal, ndërtimit informal të veçuar apo territoreve të tjera nga KRRT/KRRTRSH, njësia e qeverisjes vendore, brenda 10 ditëve, miraton planveprimin për hartimin e genplaneve të parcelave ndërtimore, në vijueshmëri territoriale, për njëren nga kategoritë e mësipërme.

Në planveprim përcaktohen grupet e punës, kalendari i veprimtarisë për secilin grup etj.

### 2.2 Genplani hartohet:

- a) bazuar në skicën fushore, sipas pikës 1 të këtij manuali;
- b) bazuar në verifikimet e bëra në terren (nëse lind nevoja), të shoqëruara me matjet përkatëse, në mënyrë që:

- i) të mos ketë shmangie lineare më të madhe se  $0.2 \text{ m/m} * SH$  (që në shkallën 1:500 është 10 cm);

- ii) të plotësohet me të dhënat e kërkuara në pikën 1.3 të këtij manuali;

- c) bazuar në kufirin e zonës/vendbanimit/bllokbanimit informal, ndërtimit informal të veçuar, territoreve të tjera, miratuar me vendim të KRRT-së.

2.3 Genplani i objektit dhe parcelës ndërtimore përkatëse hartohet në shkallën 1:500, në format A4/A3, sipas modelit G-1, bashkëngjitur këtij manuali.

2.4 Në genplan paraqitet emërtimi që merr zona/bllokbanimi/vendbanimi informal, ndërtim informal i veçuar, pas vendimmarrjes në KRRT/KRRTRSH, si dhe numri i dosjes së vetëdeklarimit të objektit.

### 2.5 Genplani (modeli G-1 bashkëngjitur manualit) përbëhet nga gjashtë rubrika:

a) Në rubrikën e parë përcaktohen:

- i) njësia e qeverisjes vendore, brenda kufirit administrativ të së cilës ndodhet objekti;

- ii) emri, mbiemri dhe nënshkrimi i hartuesit të genplanit;

- iii) data e përpilimit të genplanit;

- iv) emri, mbiemri, nënshkrimi i drejtorit/përgjegjësit të njësisë së urbanistikës dhe vula përkatëse.

b) Rubrika e dytë përmban të dhënat e identifikimit të pasurisë:

- i) zonën kadastrale;

- ii) numrin e pasurisë marrë nga harta ekzistuese kadastrale, në të cilën identifikohet parcela ndërtimore;

- iii) indeksin e hartës dhe shkallën përkatëse, në të cilën përfshihet parcela ndërtimore (si indeks i hartës do të përdoret nomenklatura e hartës ekzistuese kadastrale);

- iv) shkallën e përdorur në hartimin e genplanit, e cila është 1:500;

- v) adresën e pasurisë (qarku, qyteti, fshati, lagjja, rruga, pallati/godina, shkalla, kati, apartamenti);

- vi) sipërfaqen e parcelës ndërtimore në  $\text{m}^2$ ;

- vii) sipërfaqen e ndërtimit, duke iu referuar sipërfaqes së bazës së objektit;

- viii) emrin, atësinë dhe mbiemrin e poseduesit të objektit.

2.6 Në rastin kur parcela ndërtimore që posedohet nga deklaruesi e kalon sipërfaqen e parashikuar në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, dhe poseduesi përfiton vetëm një pjesë të saj (sipërfaqen e përcaktuar në ligj), kësaj të fundit i vendoset numri i ri i pasurisë, i cili është fraksion i numrit origjinë.

2.7 Nëse parcela ndërtimore ndodhet në më tepër se një pasuri, si numër origjinë konsiderohet ai i pasurisë në të cilën ka zënë sipërfaqen më të madhe.

c) Në rubrikën e tretë paraqitet planvendosja e objektit dhe e parcelës ndërtimore, si pjesë e hartës së përditësuar të territorit. Elementet përbërëse të saj janë:

- i) shenja orientuese e veriut (në anën e majtë lart);

- ii) paraqitja planimetrike e parcelës ndërtimore dhe e objektit të ngritur në të, së bashku me ngrehinat funksionale (në qendër);

- iii) hyrja në parcelë dhe hyrja në objekt;
- iv) numri i pasurisë së objektit/parcelës dhe objekteve/parcelave të tjera kufitare;
- v) emërtimet e rrugëve që ndodhen pranë parcelës ndërtimore;
- vi) numri i kateve të objektit, si dhe i objekteve kufitare.

2.8 Për shtesat pa leje mbi objektet e ndërtuara para vitit 1993, në genplan do të paraqitet sipërfaqja e bazës së objektit ekzistues (të ndërtuar para vitit 1993) dhe sipërfaqja e bazës së objektit shtesë të ndërtuar në të. Këto dy sipërfaqe të jenë të dallueshme nga njëra-tjetra.

2.9 Për shtesat pa leje mbi objektet me leje nga KRRT/KRRTSH, rubrika e planvendosjes së objektit, si pjesë e hartës së përditësuar, bazohet te planvendosja e lejes së sheshit dhe e lejes së ndërtimit, lëshuar nga KRRT/KRRTSH-ja. Rubrikat e tjera plotësohen sipas përcaktimeve të bëra në këtë manual.

d) Në rubrikën e katërt paraqiten kufitarët e objektit me emrat përkatës (nëse ka) dhe numrat e pasurisë.

e) Rubrika e pestë paraqet legjendën e genplanit me shenjat konvencionale sipas modelit të dhënë.

f) Rubrika e gjashtë përmban:

i) emrin, mbiemrin, nënshkrimin e personit përgjegjës të sektorit të hartografisë në drejtorinë rajonale të ALUIZNI-t;

ii) emrin, mbiemrin, nënshkrimin e drejtorit të drejtorisë rajonale të ALUIZNI-t dhe vulën përkatëse.

3. Procedurat e ndërmarra nga drejtoria rajonale e ALUIZNI-t

Genplanet e përgatitura nga njësitë e qeverisjes vendore, të hartuara në 4 (katër) kopje, kontrollohen nga specialistët përkatës në drejtorinë rajonale të ALUIZNI-t, në formën e tyre dixhitale dhe përmes verifikimit në terren, në përputhje me hartën e përditësuar.

Kontrolli në formë dixhitale mundëson verifikimin e çdo genplani të paraqitur.

Për të realizuar kontrollin në terren të genplaneve do të aplikohet metoda e sondazhit, me një normë kontrolli 10% të numrit të përgjithshëm të genplaneve, brenda kufirit të territorit të miratuar. Pas kontrollit hartohet procesverbali i rezultatit.

Në rastin kur nga kontrolli rezulton se genplanet janë të sakta, bëhet konfirmimi i të gjithë genplaneve të territorit. Kur nga kontrolli rezultojnë mbivendosje, deformime dhe çdo pasaktësi tjetër, genplanet i kthehen njësisë së qeverisjes vendore për t'u ribërë.

4. Modeli i paraqitjes të planimetrisë së objektit

a) Planimetria e çdo kati hartohet në shkallën 1:100, në format A4/A3. Në qendër vendoset emërtimi i katit, në anën e majtë sipër, orientimi gjeografik (veriu), i cili duhet të përkojë me orientimin e paraqitur në genplan.

b) Modeli i planimetrisë përbëhet nga katër rubrika.

i) Rubrika e parë përmban paraqitjen grafike të planimetrisë së katit përkatës me:

- 1) dimensionet totale dhe të pjesshme të objektit;
- 2) dimensionet e brendshme;
- 3) kuotën e katit;
- 4) sipërfaqen e katit, të shtesës ose të ndarjeve funksionale.

Në rastin e një godine me më shumë se një funksion (banesë dhe funksion social-ekonomik), sipërfaqet e tyre duhet të paraqiten grafikisht të dallueshme nga njëra-tjetra.

ii) Në rubrikën e dytë paraqitet:

- 1) numri i dosjes së vetëdeklarimit;
- 2) numri i fletës;
- 3) shkalla e planimetrisë;
- 4) data e hartimit.

iii) Në rubrikën e tretë jepen:

- 1) të dhënat e objektit;
- 2) emërtimi i fletës;
- 3) adresa e plotë e objektit;
- 4) emri, atësia dhe mbiemri i poseduesit të objektit.

- iv) Në rubrikën e katërt përcaktohet:
- 1) njësia e qeverisjes vendore (komuna/bashkia) në territorin e së cilës ndodhet objekti dhe në krah vula e saj;
  - 2) emri, mbiemri dhe nënshkrimi i hartuesit, numri licencës (në rastin kur hartuesi është subjekt privat);
  - c) shkrimi i përdorur në modelet grafike bashkëngjitur këtij manuali, të jetë “Arial”.
5. Hartimi i materialeve grafike për qytetin e Tiranës
- Për qytetin e Tiranës materialet grafike do të hartohen nga:
- a) Bashkia e Tiranës, për shtesat pa leje mbi objektet me leje ndërtimi nga KRRT/KRRTSH-ja;
  - b) Njësitë bashkiake, për zonat/vendbanimet/bllokbanimet/ndërtimet informale të veçuara dhe territore të tjera, si dhe për shtesat pa leje mbi ndërtimet para vitit 1993.
6. Mënyra e administrimit dhe e ruajtjes së materialeve grafike (genplanit dhe planimetrisë)
- a) Vizatimet për genplanin dhe planimetrinë do të hartohen në një nga programet dixhitale të vizatimit teknik (mundësisht në një nga variantet e AUTOCAD-it).
  - b) Materialet grafike ruhen në CD në tri kopje, dy prej të cilave përcillen në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në drejtorinë rajonale përkatëse të ALUIZNI-t.
7. Materialet e hartuara (genplani dhe planimetritë) janë pjesë e dokumentacionit tekniko-ligjor të domosdoshëm për pajisjen me leje legalizimi dhe për regjistrimin fillestar.
8. Në rastet kur njësia e qeverisjes vendore, nuk ushtron përgjegjësitë për shkaqet e parashikuara, kompetencat e njësisë së qeverisjes vendore me vendim të Këshillit të Ministrave, i kalojnë ALUIZNI-t, sipas pikës “d” të nenit 4 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

# GEN PLAN

Emërtimi sipas KRRT/KRRTRSH: \_\_\_\_\_

NR DOSJES SË VETDEKLARIMIT: \_\_\_\_\_

BASHKIA / KOMUNA \_\_\_\_\_

HARTO: \_\_\_\_\_  
emër mbiemër

Data: \_\_\_/\_\_\_/20\_\_\_

PËR NJËSINË E QEVERISJES VENDORE

\_\_\_\_\_  
emër mbiemër nënshkrim vula

IDENTIFIKIMI I PASURISË : \_\_\_\_\_

ZONA KADASTRALE: \_\_\_\_\_

NR. PASURISË: \_\_\_\_\_

INDEKSI I HARTËS: \_\_\_\_\_

SHKALLA 1: 500

ADRESA E PASURISË: Qarku: \_\_\_\_\_


Q/F \_\_\_\_\_ RR/L \_\_\_\_\_

P/G \_\_\_\_\_ SH \_\_\_\_\_ K \_\_\_\_\_ AP \_\_\_\_\_

SIPËRFAQJA E PARCELËS NDËRTIMORE \_\_\_\_\_ M2

SIPËRFAQJA E NDËRTIMIT \_\_\_\_\_ M2

POSEDUESI: \_\_\_\_\_  
emër etësie mbiemër



KUFITARËT:

VERI: \_\_\_\_\_

JUG: \_\_\_\_\_

LINDJE: \_\_\_\_\_

PERËNDIM: \_\_\_\_\_

LEGJENDA:

----- KUFIRI I PARCELËS

▨ PARCELA NDËRTIMORE

▣ OBJEKTI

PËR DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-t:

PËR SEKTORIN E HARTOGRAFISË:

\_\_\_\_\_  
emër mbiemër nënshkrim

DREJTORI:

\_\_\_\_\_  
emër mbiemër nënshkrim vula

# GEN PLAN

Emërtimi sipas KRRT/KRRTRSH: \_\_\_\_\_

NR DOSJES SË VETDEKLARIMIT: \_\_\_\_\_

BASHKIA / KOMUNA \_\_\_\_\_

HARTOI: \_\_\_\_\_  
emër mbiemër

Data: \_\_\_/\_\_\_/20\_\_\_

PËR NJËSINË E QEVERISJES VENDORE

\_\_\_\_\_  
emër mbiemër nënshkrimi vula

IDENTIFIKIMI I PASURISË:

ZONA KADASTRALE: \_\_\_\_\_

NR. PASURISË: \_\_\_\_\_

INDEKSI I HARTËS: \_\_\_\_\_

SHKALLA 1: 500

ADRESA E PASURISË: Qarku: \_\_\_\_\_


Q/F \_\_\_\_\_ RR/L \_\_\_\_\_

P/G \_\_\_\_\_ SH \_\_\_\_\_ K \_\_\_\_\_ AP \_\_\_\_\_

SIPËRFAQJA E PARCELËS NDËRTIMORE \_\_\_\_\_ M2

SIPËRFAQJA E NDËRTIMIT \_\_\_\_\_ M2

POSEDUESI: \_\_\_\_\_  
emër adresë mbiemër



KUFITARËT:

VERI: \_\_\_\_\_


JUG: \_\_\_\_\_


LINDJE: \_\_\_\_\_

PERËNDIM: \_\_\_\_\_

LEGJENDA:

----- KUFIRI I PARCELËS

 PARCELA NDËRTIMORE


 OBJEKTI

PËR DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-T:


PËR SEKTORIN E HARTOGRAFISË: \_\_\_\_\_  
emër mbiemër nënshkrim

DREJTORI: \_\_\_\_\_  
emër mbiemër nënshkrim vula






## PLANIMETRIA E KATIT TË DYTE



Sip. ndërtimi \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>  
 (Sip. shtesës \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>)  
 (Sip. banimi \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup> + Sip. funks. soc-eko. \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>)

Nr. dosjes vetdeklarimit:	Objekti: <b>GODINË 3 KATE BANIMI</b>	Komuna/Bashkia:	Vula e nj.q.v.:
Nr. fletes: <b>A - 2 / 3</b>	Emërtimi i fletes: <b>PLANIMETRIA E KATIT PËRDHE</b>		
Shkalla: <b>1 : 100</b>	Adresa e objektit: Q/F _____, RR/L _____, P/G _____, K _____, Ap _____	për njësinë e qeverisjes vendore: Ark./Ing. <b>Emër Mbiemër</b>	nënshkrimi:
Data: <b>15/02/2007</b>	Poseduesi: <b>Emër, Atësia, MBIEMËR</b>	punoi: Ark./Ing. <b>Emër Mbiemër</b>	licenca nr: <b>A 000/0</b>



# PLANIMETRIA E KATIT \_\_\_\_\_

Nr. dosjes vetdeklarimit:	Objekti:	Komuna/Bashkia:	Vula e nj.q.v.:
Nr. fletës: <b>A - 0 / 0</b>	Emërtimi i fletës: <b>PLANIMETRIA E KATIT _____</b>		
Shkalla: <b>1 : 100</b>	Adresa e objektit: Q/F _____, RR/L _____, P/G _____, K _____, Ap _____	për njësinë e qeverisjes vendore: Ark./Ing. <b>Emër Mbiemër</b>	nënshkrimi:
Data: <b>__ / __ / 200__</b>	Poseduesi: <b>Emër, Atësia, MBIEMËR</b>	punoj: Ark./Ing. <b>Emër Mbiemër</b>	liçenca nr:

**VENDIM**  
**Nr.258, datë 4.5.2007**

**PËR REGJISTRIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË LEGALIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” dhe të neneve 24 e 56 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. Të përgjithshme**

1. Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) fillon zbatimin e procedurave të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme (objektit dhe parcelës ndërtimore), brenda një afati 10-ditor, pas pajisjes së dosjes së objektit pa leje me lejen e legalizimit.

2. Procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të legalizuara, kryhen nga ALUIZNI, në përputhje me ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, aktet nënligjore, në zbatim të tij, dhe me mënyrën e regjistrimit, që zbatohet nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

2.1 Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP), brenda një periudhe 30-ditore, sipas kërkesës së drejtorisë rajonale të ALUIZNI-t, dërgon një informacion të hollësishëm, me numrat e zonës kadastrale dhe të pasurive, si dhe me dokumentacionin përkatës hartografik, në funksion të regjistrimit të objekteve, të përfshira në proces legalizimi, për çdo zonë informale/blokbanim informal/ndërtim informal të veçuar.

3. ZVRPP-ja pasqyron ndryshimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme, brenda një periudhe prej 30 ditësh, nga:

a) miratimi i vendimeve të KRRT-së dhe/ose KRRTRSH-së, sipas neneve 10 e 11 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”;

b) hyrja në fuqi e vendimeve të Këshillit të Ministrave, për mënyrën e administrimit të territorit, për secilën prej zonave/vendbanimeve informale, sipas pikës 3 të nenit 45 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

**II. Dokumentacioni i nevojshëm për kryerjen e procedurave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të legalizuara**

1. Drejtoria rajonale e ALUIZNI-t, për kryerjen e procedurave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të legalizuara, shfrytëzon bazën e të dhënave, si dhe:

a) dokumentacionin ligjor-administrativ, lejen e legalizimit të ndërtimit pa leje;

b) dokumentacionin teknik:

- genplanin e objektit, të hartuar si hartë treguese, miratuar nga drejtoria rajonale e ALUIZNI-t;

- planimetrinë për çdo kat.

2. ALUIZNI plotëson dokumentacionin tekniko-ligjor, të nevojshëm për procedurat përkatëse për regjistrimin fillestar të objektit pa leje, të pajisur me leje legalizimi, si dhe regjistrin e parcelave ndërtimore, sipas të dhënave në kartelën e pasurisë së paluajtshme, në përputhje me listën e emrave të pronarëve të objekteve pa leje, që përfshihen në zonën informale/blokbanimin informal/ndërtimet informale të veçuara, të grupuara në bazë të zonës kadastrale, ku ndodhen, sipas modelit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

**III. Procedurat për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara**

1. Plotësimi i kartelës së pasurisë së paluajtshme, të legalizuar

1.1 ALUIZNI plotëson kartelën e pasurisë së paluajtshme, të legalizuar, sipas formatit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

1.2 Plotësimi i rubrikave, të përfshira në kartelën e pasurisë së paluajtshme, të legalizuar, bëhet në përputhje me:

a) të dhënat e lejes së legalizimit të objektit pa leje;

b) genplanin e objektit, të hartuar si hartë treguese, miratuar nga drejtoria rajonale ALUIZNI-t;

c) hartën treguese të regjistrimit, ku përcaktohen kufijtë e pasurisë për secilin objekt, që gjendet në zonën e pasqyruar në të;

ç) mënyrën e renditjes (Vol\_) dhe (Fq\_), si dhe numrat e referencës së dokumentit arkivor, për zonën kadastrale përkatëse, të përcaktuar nga ZVRPP-ja menjëherë pas paraqitjes së kërkesës nga drejtoria rajonale e ALUIZNI-t.

1.2.1 Plotësimi i rubrikave D e E të kartelës së pasurive të paluajtshme, kryhet nga drejtoria rajonale e ALUIZNI-t, në përputhje me të dhënat që ka ZVRPP-ja, e cila është e detyruar që, brenda një afati prej 15 ditësh nga paraqitja e kërkesës, të japë informacion të plotë, me të gjitha përshkrimet e nevojshme, për plotësimin e këtyre rubrikave.

1.2.2 Në formatin e kësaj kartele, që është në përputhje të plotë me formatin e kartelës së pasurisë së paluajtshme, të miratuar me vendimin nr.519, datë 7.11.1994 të Këshillit të Ministrave, është shtuar seksioni F, për miratimin nga ALUIZNI të të dhënave për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, të legalizuar.

1.2.3 Çdo volum përmban 250 faqe. Për rastet e ndërtimeve informale të veçuara, volumi do të plotësohet sipas numrit të objekteve, të pajisura me leje legalizimi.

1.3 Kartelat e pasurive të paluajtshme, të legalizuara, do të plotësohen në format manual dhe dixhital. Drejtoria rajonale e ALUIZNI-t administron dhe ruan, në përputhje me udhëzimet e drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t, formatin dixhital të kartelës.

2. Plotësimi i regjistrimit të parcelave ndërtimore

2.1 Regjistri i parcelave ndërtimore do të plotësohet në format manual dhe dixhital, në përputhje me përcaktimet e bëra në vendimin nr.437, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave.

2.2 Drejtoria rajonale e ALUIZNI-t administron dhe ruan, në përputhje me udhëzimet e Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t, formatin, dixhital dhe shkresor, të këtij regjistri.

3. Plotësimi i bazës së të dhënave

3.1 Drejtoria rajonale e ALUIZNI-t, duke shfrytëzuar informacionin e regjistruar gjatë etapave të mëparshme të procesit të legalizimit, bën plotësimin e mëtejshëm të bazës së të dhënave, në format manual dhe dixhital, si dhe krijon bazën e të dhënave të pasurisë, sipas treguesve të kartelës së pasurisë së paluajtshme dhe të regjistrimit të parcelave ndërtimore.

3.2 Në përfundim të plotësimit të bazës së të dhënave, drejtoria rajonale kryen procedurat përkatëse të verifikimit të saktësisë së këtyre të dhënave.

3.3 Zyra qendrore e ALUIZNI-t, duke shfrytëzuar informacionin e administruar gjatë të gjithë procesit, nga drejtoritë rajonale, krijon dhe administron bazën e të dhënave, në shkallë vendi.

3.3.1 Të dhënat e kartelës së pasurisë së paluajtshme, genplani i objektit, i hartuar si hartë treguese, dhe planimetria strukturohen në një program unifikues të informatizimit të të dhënave, si pjesë integrale e bazës së përgjithshme të të dhënave.

4. Publikimi i të dhënave për regjistrimin fillestar të objekteve, të pajisura me leje legalizimi

4.1 Drejtoria rajonale e ALUIZNI-t publikon, në një vend të dukshëm, në zonën kadastrale, për një afat 15-ditor, dokumentet e mëposhtme:

a) regjistrin e parcelave ndërtimore;

b) hartën treguese të regjistrimit (HTR), të përditësuar.

4.2 Kur rezultojnë pasaktësi në hartën treguese të pasurive ekzistuese, të regjistruara, ose mbivendosje me pasuritë e legalizuara, ALUIZNI njofton ZVRPP-në, e cila, në përputhje me nenin 17 të ligjit nr.7843, datë.13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, bën korrigjimet e nevojshme në HTR-në përkatëse.

5. Miratimi i kartelës së pasurisë së paluajtshme, të legalizuar

5.1 Në kartelën e pasurisë së paluajtshme, të legalizuar, regjistrohet data e përfundimit të afatit të publikimit të dokumenteve, të përcaktuara në pikën 4.1 të kapitullit III.

5.2 Kartela e pasurisë së paluajtshme, të legalizuar, nënshkruhet nga nëpunësi përgjegjës për plotësimin e saj dhe miratohet nga drejtori i drejtorisë rajonale të ALUIZNI-t.

6. Dorëzimi i dokumentacionit përkatës të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të legalizuara, në ZVRPP

6.1 Drejtorja rajonale e ALUIZNI-t, në funksion të përmbylljes së procedurave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të legalizuara, dorëzon në ZVRPP, për çdo objekt, të gjithë informacionin e regjistruar në format dixhital, në bazën e të dhënave, si dhe dokumentacionin e mëposhtëm manual:

- a) Lejen e legalizimit të objektit;
- b) Genplanin e objektit, të hartuar si hartë treguese, miratuar nga drejtorja rajonale e ALUIZNI-t;
- c) Planimetrinë për çdo kat;
- ç) Volumet e kartelave, sipas përcaktimeve të këtij vendimi;
- d) Regjistrin e parcelave ndërtimore;
- dh) HTR-në e përditësuar.

7. Ligjërimi nga ZVRPP-ja, i regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të legalizuara

7.1 ZVRPP-ja brenda një periudhe prej 15 ditësh nga marrja në dorëzim e dokumentacionit të përcaktuar në pikën 6.1 të këtij vendimi, verifikon saktësinë e të dhënave të kartelës së pasurisë së paluajtshme, të legalizuar, dhe kryen procedurat për ligjërimin e regjistrimit fillestar për ndërtimet pa leje, të pajisura me leje legalizimi, në zbatim të nenit 26 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

IV. Të fundit

1. Brenda një periudhe prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ALUIZNI dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nënshkruajnë një memorandum mirëkuptimi, për bashkërendimin efektiv të veprimtarisë së tyre, në funksion të mbarëvajtjes së procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje dhe të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të legalizuara.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, ALUIZNI dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.57, faqe 1490*

**KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME, TË LEGALIZUAR**

**A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TË PASURISË.**

Zona Kadastrale: \_\_\_\_\_ Nr. i Pasurisë: \_\_\_\_\_

Vol. \_\_\_\_\_ Fq. \_\_\_\_\_

-->Vijon nga: Vol. \_\_\_\_\_, Fq. \_\_\_\_\_

Vijon në: Vol. \_\_\_\_\_, Fq. \_\_\_\_\_ deri në: Vol. \_\_\_\_\_, Fq. \_\_\_\_\_ -->

Indeksi i Hartës: \_\_\_\_\_

Adresa e Pasurisë: Rrethi \_\_\_\_\_ Q/F \_\_\_\_\_

**PËRFUNDIMTARE (data):** \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Rr/L: \_\_\_\_\_ P/G \_\_\_\_\_ Sh: \_\_\_\_\_ K: \_\_\_\_\_ Ap: \_\_\_\_\_

Përshkrim i Veçantë:

**B - SEKSIONI I PËRSHKRIMIT TË PASURISË**

Lloji i Pasurisë: \_\_\_\_\_ Brenda V.K.N. :( JO )--> PO ,Ref: \_\_\_\_\_

Sip. Totale e Pasurisë:	Nga Sip. Totale sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndertesë
1. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	1. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	1. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____
2. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	2. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	2. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____
3. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	3. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	3. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____
4. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	4. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	4. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____

Per pjesen e perbashket :  
\_\_\_\_\_  
Kuota e pjesmarrjes:  
\_\_\_\_\_%  
Nr i Pasurise (pallat):  
\_\_\_\_\_  
VOL \_\_\_\_ FO \_\_\_\_

**C - SEKSIONI I PRONËSISË**

Nr.Dok	Data Regjistrim	Emri	Atesia	Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lesh. Certifikates	Shënime	Firma

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I – individ, F – përfaqësues i familjes; B – bashkëpronar (%)

**D - SEKSIONI I QIRAVE, NË PËRDORIM, MARRËVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITUDAVE DHE INTERESAVE TË TJERA**

Nr.Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Çertifikatës	Shënime	Firma

**E- SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TË GJYKATËS, KUFIZIMEVE, etj.**

Nr.Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Çertifikatës	Shënime	Firma

**F- SEKSIONI I MIRATIMIT NGA ALUIZNI I TË DHËNAVE PËR PASURINË E PALUAJTSHME TË LEGALIZUAR**

Për Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI – t \_\_\_\_\_

Nëpunësi Përgjegjës

\_\_\_\_\_

( emër, mbiemër / nënshkrimi )

**MIRATOHET :**

\_\_\_\_\_

**DREJTORI**  
( emër, mbiemër / nënshkrim / vula )



Dt \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_\_





**VENDIM**  
**Nr.259, datë 4.5.2007**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR NORMAT DHE STANDARDET MINIMALE  
URBANISTIKE, PËR URBANIZIMIN E ZONA VE INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullore për normat dhe standardet minimale urbanistike, për urbanizimin e zonave informale, që i bashkëlidhet këtij vendimi, miratuar me vendimin nr.1, datë 21.11.2006 të KRRTRSH-së.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Instituti i Studimeve dhe Projektimeve Urbanistike dhe ALUIZNI për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Vendim i KM nr.259, datë 4.5.2007 botuar në Fletoren Zyrtare nr.57, faqe 1496*

**RREGULLORE**  
**MBI NORMAT DHE STANDARDET MINIMALE URBANISTIKE PËR URBANIZIMIN E  
ZONA VE INFORMALE**

**I. Të përgjithshme**

1. Hartimi i kësaj rregulloreje mbështetet në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” dhe rregulloren e urbanistikës.

2. Mbështetur në këtë ligj, objekt i kësaj rregulloreje është urbanizimi i ndërtimeve pa leje në:

a) vendbanime formale;  
b) zona informale;  
c) territore të tjera (tokë arë, sipërfaqe frut/perime-kulturë, ullishte, vreshta, pyje, kullota e toka të pafrytshme);

d) shtesa pa leje në ndërtime me leje.

3. Kjo rregullore zbatohet për objektet e ndërtuara pa leje:

a) me funksion strehimi;

b) veprimtari ekonomike;

c) funksione social-kulturore;

d) objekt ndihmës në shërbim të ndërtimit pa leje, brenda sipërfaqes së parcelës.

4. Kjo rregullore nuk zbatohet për:

a) ndërtimet pa leje brenda zonave të përcaktuara sipas ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, me përjashtim të zonave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) ndërtimet pa leje brenda zonave të përcaktuara sipas ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”;

c) ndërtimet pa leje të ngritura mbi troje private brenda vijës kufizuese të ndërtimit, kur planet e përgjithshme rregulluese në fuqi të këtyre zonave parashikojnë ndërtime mbi 5 kate duke filluar nga kuota  $\pm 0.00$  e tyre.

## II. Përkufizime

5. Në këtë rregullore termat e përdorur kanë kuptim sipas ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”:

a) “Vendbanim formal” është territori i përfshirë brenda vijave kufizuese (të verdha), të miratuara zyrtarisht për zonat e banuara urbane (qytet) ose rurale (fshat);

b) “Zonë informale” është territori me sipërfaqe mbi 5 ha, i zënë nga ndërtime pa leje që nuk gëzon mbrojtje të veçantë nga akte ligjore e nënligjore në fuqi;

c) “Territore të tjera” janë tokat bujqësore (tokë arë, sipërfaqe fruti/perime-kulturë, ullishte, vreshta) dhe tokat jobujqësore (pyje, kullota e toka të pafrytshme);

d) “Bllok banimi informal” konsiderohet territori me ndërtime pa leje me sipërfaqe mbi 1 ha deri ë 5 ha, brenda ose jashtë vendbanimit formal;

e) “Ndërtim informal i veçuar” është objekti (ose grupi i objekteve) i ndërtuar pa leje në parcelë/territor deri në 1 ha;

f) “Kufiri i zonës/bllok banimi/ndërtim informal” është vija gjeografike e shtrirjes territoriale të ndërtimeve informale, e miratuar sipas dispozitave në fuqi nga KRRTRSH-ja, për zonat informale dhe nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore, përmes organit të zgjedhur dhe/ose KRRT-së, për bllok banimi/ndërtim informal;

g) “Parcela ndërtimore” janë sipërfaqe të zëna nga pronari i ndërtimit pa leje;

h) “Leje legalizimi” është dokumenti, që lëshohet sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj nga zyra përkatëse e ALUIZNI-t dhe që shërben për regjistrimin e objektit në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

6. Në këtë rregullore termat e përmendur kanë kuptimin:

a) “Studim urbanistik pjesor i një zone informale” është studimi urbanistik i detajuar i një territori të zënë me ndërtime pa leje që nuk gëzon mbrojtje të veçantë nga aktet ligjore në fuqi;

b) “Studim urbanistik pjesor i një zone informale në një vendbanim formal, është një studim urbanistik i detajuar i një territori brenda kufirit të studimeve urbanistike në fuqi, si studime rajonale, masterplane, plane të përgjithshme rregulluese, studime suburbane;

c) “Studim urbanistik pjesor i një zone informale në një vendbanim formal, për të cilin nuk ka plan të përgjithshëm rregullues” është një studim urbanistik i detajuar i një territori në vendbanimet formale në të cilin parashikohen ndërhyrje rregulluese pa kompromentuar zhvillimin perspektiv të atij vendbanimi;

d) “Dendësi bruto e banimit” është raporti midis numrit të banorëve me sipërfaqen e territorit bruto të njësisë urbanistike;

e) “Dendësi neto e banimit” është raporti midis numrit të banorëve me sipërfaqen e territorit të banimit neto;

f) “Intensiteti i ndërtimit neto “i” është koeficienti që tregon intensitetin e ndërtimit në territorin e banimit. Ai shpreh raportin ndërmjet shumës së sipërfaqeve të kateve të banimit mbi sipërfaqen e territorit të banimit.

## III. Studimet urbanistike pjesore

7. Urbanizimi dhe integrimi i zonave/ndërtimeve informale do të bëhet mbi bazën e studimeve pjesore urbanistike.

8. Studimet pjesore urbanistike do të hartohen për:

a) zonë informale, me sipërfaqe mbi 5 ha, brenda vijës kufizuese të ndërtimeve të qendrës së banuar, urbane ose rurale;

b) zonë informale, me sipërfaqe mbi 5 ha, jashtë vijës kufizuese të ndërtimeve të qendrës së banuar, urbane ose rurale;

c) bllok banimi informal, me sipërfaqe 1 deri në 5 ha, brenda vijës kufizuese të ndërtimeve të qendrës së banuar urbane ose rurale;

d) bllok banimi informal, me sipërfaqe 1 deri në 5 ha, jashtë vijës kufizuese të ndërtimeve të qendrës së banuar, urbane ose rurale;

e) ndërtim informal të veçuar të një grupi objektsh, në territor me sipërfaqe deri në 1 ha.

9. Studimet pjesore urbanistike të zonave informale me sipërfaqe mbi 5 ha dhe bllokbanimeve me sipërfaqe 1 deri në 5 ha brenda vijave kufizuese të ndërtimeve të qendrave të banuara urbane dhe rurale, duhet të respektojnë Planin e Përgjithshëm Rregullues në fuqi në drejtim të:

- a) rrjetit rrugor;
- b) zonave me status të veçantë mbrojtjeje:
  - i) zonave me vlera arkitektonike;
  - ii) zonave me vlera arkeologjike;
  - iii) zonave me vlera historike;
  - iv) zonave me vlera mjedisore;
- c) kufirit të njohur të përmytjeve;
- d) respektimit të infrastrukturës inxhinierike nëntokësore.

10. Studimet pjesore urbanistike të zonave informale me sipërfaqe mbi 5 ha dhe bllokbanimeve me sipërfaqe 1 deri në 5 ha, jashtë vijave kufizuese të ndërtimeve të qendrave të banuara, urbane dhe rurale, duhet të respektojnë studimet urbanistike të zonave suburbane, kur këto studime ekzistojnë, në drejtim të:

- a) infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore;
- b) zonave me status të veçantë mbrojtjeje;
- c) gjendjes mjedisore;
- d) zonave me vlera arkitektonike;
- e) zonave me vlera arkeologjike;
- f) zonave me vlera historike;
- g) kufirit të përmytjeve;
- h) respektimit të normave të brezave mbrojtës të burimeve të ujit të pijshëm;
- i) respektimit të normave të infrastrukturës nëntokësore;
- j) zonave me përparësi zhvillimin e turizmit;
- k) porteve dhe aeroporteve etj.

11. Studimet pjesore urbanistike të zonave informale me sipërfaqe mbi 5 ha dhe bllokbanimeve me sipërfaqe 1 deri në 5 ha, jashtë vijave kufizuese të ndërtimeve të qendrave të banuara, urbane dhe rurale, në territoret në kufi me këto qendra, duhet të mos pengojnë zhvillimin perspektiv të tyre, veçanërisht vazhdimësinë e rrjetit rrugor dhe infrastrukturës mbi e nëntokësore në përgjithësi.

12. Studimet pjesore urbanistike të zonave informale me sipërfaqe mbi 5 ha dhe bllokbanimeve me sipërfaqe 1 deri në 5 ha, jashtë vijave kufizuese të ndërtimeve të qendrave të banuara, urbane dhe rurale, duhet të respektojnë studimet e ndryshme lidhur me infrastrukturën nacionale, në proces ose të miratuara, si dhe brezat mbrojtës të tyre, të miratuara me akte nënligjore.

13. Studimet pjesore urbanistike hartohen mbi bazën e detyrës së projektimit dhe hartave topografike me kufijtë e zonës.

14. Studimi urbanistik pjesor përmban:

- a) kufijtë e zonës për të cilën hartohet studimi;
- b) nënndarjen e parcelave;
- c) trasimin e rrjetit rrugor brenda zonës, lidhjen me atë të zonave përreth, profilet e rrugëve dhe planin e piketimit të tij;
- d) karakteristikat dhe trasimin e rrjeteve të furnizimit me ujë, të kanalizimeve, të energjisë elektrike, të telefonisë dhe shërbimeve të tjera;
- e) hapësirat për ndërtimet publike, shëndetësore, arsimore, tregtare, kulturore, sportive etj. me kondicionet urbanistike përkatëse;
- f) koeficientët e shfrytëzimit dhe të menaxhimit të territorit;
- g) ndërtimet që parashikohen për të shembur, rikonstruktuar apo restauruar;
- h) përcaktimet për ndërtimet që do t'i nënshtrohen kushtëzimeve ose ndërhyrjeve të veçanta (objekte monumentale, objekte me vlera të veçanta, zona arkeologjike etj.);

- i) raportin e vlerësimit strategjik mjedisor (VSM);
  - j) ndarjen e territorit sipas pronësisë mbi truallin;
  - k) lista e pronarëve që do të shpronësohen, sipas zërave kadastralë;
  - l) vlerësimi ekonomiko-financiar për zbatimin e studimit urbanistik pjesor.
- Përmbajtja e SUP-it ndryshon në raport me veçoritë specifike të zonave.

15. Studimi urbanistik pjesor hartohet mbi bazën e detyrës së projektimit. Detyra e projektimit duhet të përmbajë:

- a) fragment të planit të përgjithshëm rregullues me pozicionin e zonës informale për të cilin do të kryhet studimi urbanistik pjesor (kur studimi urbanistik pjesor hartohet për një pjesë të tij);
- b) planimetrinë e azhurnuar të zonës informale, për të cilën hartohet studimi urbanistik pjesor në shkallën 1:2000 deri 1:500, sipas morfologjisë së terrenit;
- c) të dhëna inxhiniero-gjeologjike, topografike dhe sizmologjike;
- d) të dhëna mjedisore mbi gjendjen e mjedisit;
- e) të dhëna demografike;
- f) azhurnimi i rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe ajror (ujësjellës, kanalizim, elektrik, telefonik etj.);
- g) të dhëna për monumente me vlera historike, arkeologjike, që ndodhen brenda studimit urbanistik pjesor;
- h) të dhëna për infrastrukturën publike ekzistuese (shkolla, objekte tregtare, kulti, sportive, publike, kulturore, shëndetësore etj.);
- i) treguesit teknikë të gjendjes ekzistuese;
- j) karakteristikat kryesore të ndërtimeve (zhvillimin volumetrik, funksionin, materialet ndërtimore);
- k) të dhëna për ndarjen e territorit sipas pronësisë;
- l) analiza teknike e përgatitur nga zyra e urbanistikës pranë njësisë së qeverisjes vendore.

16. Studimi urbanistik pjesor hartohet në dy faza:

- a) projektideja;
- b) projekti i zbatimit.

17. Projektideja e studimit urbanistik pjesor duhet të përmbajë:

- a) detyrën e projektimit;
- b) relacionin e përgjithshëm;
- c) planimetrinë e zonës në përputhje me planin e përgjithshëm rregullues, në rast se ekziston, ku të përcaktohet pozicioni i zonës për të cilën do të kryhet studimi pjesor urbanistik, në shkallën 1:5000 deri në 1:1000;
- d) planimetrinë e zonimit funksional, gjendja ekzistuese në shkallën 1:2000 deri në 1:500;
- e) planimetrinë e zonimit funksional, propozimi;
- f) skemën e rrjetit rrugor;
- g) skicidenë e infrastrukturës;
- h) situatën mjedisore të zonës;
- i) planimetrinë me fazat e ndërtimit të infrastrukturës;
- j) planimetrinë me fazat e rikonstruksionit të infrastrukturës;
- k) planimetrinë e zonimit funksional sipas numrit të kateve;
- l) pasqyrën e treguesve tekniko-ekonomikë;
- m) parcelizimi në rastin e ndërtimeve me banesa individuale;
- n) planimetrinë me vendosjen e objekteve, funksionin dhe lartësinë e tyre.

18. Projekti i zbatimit të studimit urbanistik pjesor përmban:

- a) planin e zonimit funksional;
- b) rrjeti rrugor në shkallën 1:1000 ose 1:500 dhe për zona në reliev të aksidentuar në shkallën 1:200;
- c) projektin teknik të rrjetit inxhinierik në shkallën 1:1000 ose 1:500;
- d) planin e vendosjes së objekteve, si dhe karakteristikat kryesore të tyre (funksion, zhvillimin volumetrik etj.);

e) parcelizimi në rastin e ndërtimeve me banesa individuale.

#### IV. Sheshi i ndërtimit

19. Planimetria e sheshit të ndërtimit i jepet kërkuarit të saj me vendimin e KRRT-së përkatëse:

a) në planimetrinë e sheshit të ndërtimit do të jepen qartë të gjitha kondicionet urbanistike të përcaktuara nga studimi urbanistik, sipërfaqja e sheshit të ndërtimit dhe sipërfaqja e ndërtimit, kufiri i pronësisë, vija e ndërtimit, koeficienti i shfrytëzimit të territorit, funksioni i objektit, numri i kateve dhe lartësia e objektit mbi e nëntokë, pozicioni kadastral, distancat kundrejt fqinjëve, kundrejt kufirit të pronësisë, hyrjet, daljet, lidhja me rrugët, kondicionet e veçanta (për objekte e pozicione të veçanta) etj. Planvendosja e objektit dhe të dhënat e tjera grafike do të punohen mbi relievin e azhurnuar të gjendjes ekzistuese;

b) në planimetrinë e sheshit të ndërtimit duhet të përcaktohen qartë të gjitha rrjetet inxhinierike që furnizojnë objektin (kanalizim, ujësjellës, elektrik, telefoni, MKZ etj.) dhe miratimi i tyre nga ndërmarrjet përkatëse;

c) planimetria e sheshit të ndërtimit, bashkë me kondicionet urbanistike, hartohet sipas modeleve 1 ÷ 3;

d) paraqitja e studimeve urbanistike bëhet sipas modeleve që i bashkëngjiten kësaj rregulloreje.

#### V. Normat dhe rregulloret e projektimit urbanistik

20. Studimet urbanistike duhet t'u përmbahen normave dhe rregullave të projektimit.

21. Në zonën e banimit përfshihen njësitë urbanistike dhe rrugët e brendshme midis tyre. Mbështetur në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", territoret me ndërtime pa leje klasifikohen në:

a) ndërtim informal i veçuar;

b) bllok banimi informal;

c) zonë informale.

22. Ndërtimi informal i veçuar nuk përbën njësi urbanistike. Në rastin kur ndërtimi informal i veçuar ka funksion banimi, të përdoren normat e njësisë urbanistike më të vogël, bllokut të banimit.

23. Bllok banimi informal është njësia e banimit me sipërfaqe 1 deri në 5 ha me ndërtime njëfamiljare. Elementet përbërëse të bllokut të banimit janë:

a) sipërfaqe ndërtimi;

b) sipërfaqe e lirë;

c) shesh lojërash për fëmijë.

24. Referuar "Rregullores për urbanistikën", miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.722, datë 19.11.1998, si dhe situatës aktuale, njësitë urbanistike të zonave informale të banimit për banesa një familjare, me sipërfaqe mbi 5 ha, klasifikohen:

a) zona me sipërfaqe 30 ha;

b) zona me sipërfaqe 60 ha;

c) zona me sipërfaqe 120 ha.

25. "Zonë me ndërtime informale njëfamiljare me sipërfaqe 30 ha" është njësia urbanistike, në bazë të organizimit të së cilës janë objektet shoqërore të kopshtit dhe çerdhes, njësitë e shërbimit tregtar e komunal, si dhe terrenet sportive për fëmijë mbi 6 vjeç. Kjo njësi banimi përbëhet nga:

a) territor banimi neto;

b) shesh lojërash për fëmijë;

c) sipërfaqe për objekte shoqërore;

d) terrene sportive;

e) rrugë dhe sheshe.

26. "Zona me ndërtime informale njëfamiljare me sipërfaqe 60 ha" është njësia urbanistike në bazë të organizimit të së cilës është shkolla 9-vjeçare. Kjo njësi banimi përbëhet nga:

a) territor banimi neto;

b) shesh lojërash për fëmijë;

c) sipërfaqe për objekte shoqërore;

- d) terrene sportive;
- e) gjelbërim i organizuar;
- f) rrugë dhe sheshe.

27. Në treguesit normativ të objekteve shoqërore sipërfaqet e parcelave të çerdhes dhe kopshtit variojnë nga 0.3-0.4 ha për një çerdhe ose një kopsht dhe 0.6-1 ha për parcelën e shkollës 9-vjeçare brenda vijave kufizuese të qendrave të banuara urbane, mbështetur në “Rregulloren për urbanistikën”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.722, datë 19.11.1998.

Këto norma për zonat informale jashtë vijave kufizuese të ndërtimeve të qendrave të banuara urbane brenda dhe jashtë vijave kufizuese të ndërtimeve të qendrave të banuara rurale, do të jenë 0.1-0.25 ha për parcelat e çerdhes, 0.15-0.4 ha për parcelat e kopshteve”.

28. “Zona me ndërtime informale njëfamiljare me sipërfaqe 120 ha” është njësi urbanistike në bazë të organizimit të së cilës janë:

- a) shërbimet e përqendruara tregtare dhe ekonomike;
- b) kopshte e çerdhe;
- c) dy shkolla 8-vjeçare;
- d) një shkollë e mesme;
- e) terrene sportive;
- f) gjelbërim i organizuar;
- g) shërbim shëndetësor;
- h) administrative etj.

29. Normat e projektimit urbanistik të njësive urbanistike të zonës së banimit janë përmbledhur në tabelat e mëposhtme:

Tabela nr.1

DENDËSITË E BANIMIT BRUTO E NETO PËR NJËSITË E BANIMIT BANORË/HEKTARË

Numri mesatar i kateve	2	3	4	5	6
Dendësia bruto	100-170	280-300	300-350	360-380	380-400
Dendësia neto	140-220	500-530	540-600	650-750	750-780

Tabela nr.2

INTENSITETI I NDËRTIMIT NETO SIPAS NUMRIT TË KATEVE

Treguesi teknik	Numri i kateve				
	2	3	4	5	6
Intensiteti i ndërtimit	0.30-0.8	0.5-0.7	0.7-0.9	1-1.3	1.3-1.4

Tabela nr.3

TREGUESIT TEKNIKË URBANË NË FUNKSION TË MADHËSISË SË PARCELËS

Emërtimi	Banesa në rresht	Banesa të vendosura 2 nga 2	Banesa të veçanta
Sip. e parcelës në m <sup>2</sup>	150-190	200-300	300-500
Dendësia bruto, banorë/ha	170	130	100
Dendësia neto, banorë/ha	220	170	140
Intensiteti i ndërtimit	1.3-0.8	0.85-0.5	0.8-0.3

30. Për të siguruar diellëzimin minimal të ndërtesave, hapësirat funksionale, ndriçimin dhe ajrimin, veprohet si më poshtë:

a) Kur ndërtesat vendosen karshi njëra-tjetrës dhe kanë gjatësi deri në 20 m, distancat duhet të jenë:

- Për ndërtesat 1-katëshe, jo më pak se 4 m;
- Për ndërtesat 2-katëshe, jo më pak se 6 m;
- Për ndërtesat 3-katëshe, jo më pak se 8 m;
- Për ndërtesat 4-katëshe, jo më pak se 10 m;
- Për ndërtesat 5-katëshe, jo më pak se 12 m.

b) Kur ndërtesat janë karshi njëra-tjetrës, kanë dritare dhe gjatësi mbi 20 m, distancat duhet të jenë:

- Për ndërtesat 1-katëshe, jo më pak se 6 m;
- Për ndërtesat 2-katëshe, jo më pak se 9 m;
- Për ndërtesat 3-katëshe, jo më pak se 13.5 m;
- Për ndërtesat 4-katëshe, jo më pak se 18 m';
- Për ndërtesat 5-katëshe, jo më pak se 20 m.

Për përcaktimin e distancave ndërmjet dy ndërtesave me numër të njëjtë katesh, distanca përcaktohet me interpolim, d.m.th. të dy ndërtesat konsiderohen me numër të njëjtë katësh, që është e barabartë me mesateren e shumës së numrit të kateve të tyre.

31. Kur banesat vendosen përbri njëra-tjetrës dhe faqet në brinjë nuk kanë dritare, ato mund të jenë të larguara deri në një metër ose në bashkim të plotë. Në çdo rast ndërtimet duhet të respektojnë kufirin e ndarjes së pronësisë dhe bashkimi i plotë mund të bëhet vetëm mbi bazën e marrëveshjes së pronarëve fqinjë.

32. Distanca e ndërtesave të banimit nga çerdhet, kopshtet, shkollat dhe objektet shëndetësore duhet të jenë jo më pak se 1.5 herë të lartësisë së ndërtesës më të lartë që qëndron nga jugu, ndërsa në drejtime të tjera zbatohen pikat 30, 31 të kësaj rregulloreje.

33. Dalja konsol e mbi 50% të faqes së ndërtesës do të quhet faqe ndërtimi dhe do të merret parasysh në llogaritjen e distancës midis ndërtimeve.

34. Për ndërtimet gjatë rrugëve, çdo dalje konsol do të quhet faqe ndërtimi dhe do të merret parasysh në llogaritjen e distancës midis ndërtimeve.

35. Kur pjerrësia e çatisë lejon shfrytëzimin e mbi 50% të sipërfaqes së përgjithshme të objektit që mbulohet dhe kur ka dritare në çati, për efekt të llogaritjes së distancave, ajo konsiderohet një kat. Kur shfrytëzimi i çatisë është 30-50% dhe kur ka dritare në çati, ajo konsiderohet gjysmë kati.

36. Kur lartësia e katit përdhe është mbi 5.0 m, mbi kuotën e sistemuar, për efekt të llogaritjes së distancave, lartësia e tij konsiderohet si një kat e gjysmë dhe kur është mbi 6.0 m konsiderohet 2 kat.

## VI. Rrjeti rrugor

37. Urbanizimi dhe integrimi i njësive urbanistike informale brenda vendbanimeve urbane dhe rurale duhet të respektojë "Rregulloren për urbanistikën", miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.722, datë 19.11.1998, përsa i përket rrjetit rrugor të parashikuar në planin e përgjithshëm rregullues.

38. Për urbanizimin dhe integrimin e njësive urbanistike informale, brenda vijave kufizuese të ndërtimeve në qytete, studimet urbanistike të hartohen bazuar në normat e rrjetit rrugor:

- a) gjerësia e rrugëve kryesore të jetë 7 m, me 1.5 m trotuar në të dy krahët;
- b) largësia minimale ndërmjet rrugëve kryesore të jetë 40 m;
- c) gjerësia e rrugëve dytësore të jetë 5 m me 1.0 m trotuar në të dy anët;
- d) largësia minimale ndërmjet rrugëve dytësore të jetë 860 m;
- e) në rrugët dytësore nuk lejohet parkim dhe lëvizja të kryhet me një drejtim;
- f) parkimi i automjeteve për të gjitha llojet e ndërtimeve të kryhet brenda sipërfaqes së pronës.

39. Për urbanizimin dhe integrimin e njësive urbanistike informale, në zonat rurale përreth qyteteve, studimet urbanistike të hartohen bazuar në legjisllacionin në fuqi:

- a) të respektohet rrjeti rrugor i parashikuar në studimin e zonës suburbane, kur ai ekziston;

b) në mungesë të studimit të zonës suburbane, lidhja e rrugëve të planit rregullues të qytetit me zonat informale të bëhet me studim të veçantë;

c) gjerësia e rrugëve kryesore të jetë 7 m, me 1.5 m trotuar në të dy krahët;

d) largësia minimale ndërmjet rrugëve kryesore të jetë 80 m;

e) gjerësia e rrugëve dytësore të jetë 5 m me 1.0 m trotuar në të dy anët;

f) largësia minimale ndërmjet rrugëve dytësore të jetë 100 m;

g) në rrugët dytësore nuk lejohet parkim dhe lëvizja të kryhet me një drejtim;

h) parkimi i automjeteve për të gjithë llojet e ndërtimeve të kryhet brenda sipërfaqes të pronës.

40. Për urbanizimin dhe integrimin e njësive urbanistike informale në zonat përreth zonave rurale ekzistuese të respektohen:

a) lidhja e rrjetit rrugor të zonave që urbanizohen dhe integrohen me rrugët ekzistuese, të bëhet me studim të veçantë;

b) gjerësia e rrugës lidhëse të zonës që urbanizohet dhe integrohet me rrugën nacionale ose kryesore të jetë 7 m me 1.5 m bankinë në të dy anët;

c) gjerësia e rrugëve kryesore të jetë 7 m, me 1.5 m trotuar në të dy anët;

d) gjerësia e rrugëve dytësore të jetë 5 m me 1.0 m trotuar në të dy anët;

e) parkimi i automjeteve për të gjitha llojet e ndërtimeve të kryhet brenda sipërfaqes të pronës.

41. Për urbanizimin dhe integrimin e njësive urbanistike informale brenda vijave kufizuese të ndërtimit të fshatrave të respektohen:

a) gjerësia e rrugëve kryesore të zonës të jetë 6 m, me 10 m trotuar në të dy anët;

b) gjerësia e rrugëve dytësore të jetë 5 m, me 1.0 m trotuar në të dy anët;

c) rrugica për kalimin e këmbësorëve me gjerësi të pjesës së shtruar të jetë 3 m;

d) parkimi i automjeteve për të gjitha llojet e ndërtimeve të kryhet brenda sipërfaqes së pronës.

42. Për urbanizimin dhe integrimin e njësive urbanistike informale pranë rrugëve nacionale dhe linjave hekurudhore të respektohen kushtet e Kodit Rrugor.

#### VII. Rrjeti elektrik

43. Distancat ajrore nga përcjellësit anësorë të linjës ajrore, për mënjanimin më të madh të saj, deri në pjesët e dala të godinave dhe ndërtimeve, duhet të jenë më të vogla se:

a) 2 m për linjat 6-10 kv;

b) 4 m për linjat 35-110 kv;

c) 5 m për linjat 150 kv;

d) 6 m për linjat 220 kv;

e) 8 m për linjat 330 kv;

f) 10 m për linjat 400 kv.

44. Nuk lejohet ndërtimi i godinave nën linjat ajrore elektrike, me përjashtim të godinave industriale të rezistueshme ndaj djegies. Distanca ajrore nga përcjellësi i poshtëm deri në çatinë e godinës industriale, nuk duhet të jetë më e vogël se:

a) 3 m për linjat deri në 35 kv;

b) 4 m për linjat 110-150 kv;

c) 5 m për linjat 220 kv;

d) 6 m për linjat 330 kv.

Mbulesat metalike, mbi të cilat kalojnë linjat ajrore elektrike, duhet të tokëzohen.

45. Distancat ajrore nga përcjellësit e linjës ajrore elektrike në lidhje me sipërfaqen e tokës, në regjimin normal të punës, duhet të jetë jo më e vogël se:

a) 7.0 m për linjat deri 110 kv;

b) 7.5 për linjat 150 kv;

c) 8.0 m për linjat 220 kv;

d) 8.5 m për linjat 330 kv.

46. Në ndërprerjet me rrugë, distancat ajrore nga përcjellësi deri në lidhje me sipërfaqen e tokës, duhet të kontrollohet për këputjen e përcjellësit në kampatën fqinje në regjimin e temperaturës



mesatare vjetore të ajrit pa marrë parasysh ngrohjen nga rryma elektrike, këto largësi duhet të jenë jo më të vogla se:

- a) 4.0 m për linjat deri 150 kv;
- b) 5.0 për linjat 220 kv;
- c) 5.5 m për linjat 330 kv.

47. Distancat ajrore nga baza e shtyllës të linjave ajrore deri në anën e bankinës së rrugës duhet të jetë jo më e vogël se 1.5 m.

48. Distancat ajrore nga baza e shtyllës së ndriçimit rrugor deri në anën e bankinës së rrugës duhet të jetë jo më e vogël se 0.5 m.

49. Për linjat ajrore me tension deri 1.0 kv të realizuara me kabëll të fiksuar në tirant, distancat ajrore të linjës nga pjesët kallkan të objektit, nuk ka kufizim distance.

50. Për linjat ajrore me tension 1.0 kv, të realizuara me kabëll të fiksuar në tirant, distancat ajrore të linjës nga pjesët e fasadës së objektit (ballkon, lozhë, dritare, verandë) distanca nuk duhet të jetë më e vogël se 2 m.

51. Distancat e linjave ajrore me godinat që magazinojnë lëndë plasëse, si dhe me impiantet e jashtme, që kanë rrezik zjarri, duhet të plotësojnë kushtet e shfrytëzimit sipas normave të MKZ. Përgjithësisht, aksi i linjës duhet të jetë larg këtyre objekteve sa 1.5 herë lartësia e shtyllës.

52. Distancat ajrore të shtrirjes së linjave kabllore elektrike nëntokësore nga objekti duhet të jetë jo më e vogël se 1.0 m nga vija e ndërtimit.

53. Kuota e shtrirjes së linjave kabllore elektrike nëntokësore, të jetë jo më e vogël se -1.2 m nga kuota e sistemuar.

54. Ndriçimi i rrugëve, kalimeve në zonë banimi, urbane dhe rurale, duhet të jetë jo më e vogël se norma e paraqitur në tabelën nr.3.

Tabela nr.3

Karakteristika e rrugës	Ndriçimi minimal në sipërfaqe horizontale të brezave të lëvizjes në nivelin e rrugës (lx)
- Rrugë kryesore qyteti me trafik të madh	3-4
- Rrugë kryesore të lagjeve	1.5-2
- Rrugë me karakter lokal brenda lagjeve të fshatit	0.3-1

#### VIII. Rrjeti i ujësjellës-kanalizimeve

55. Për urbanizimin dhe integrimin e njësive urbanistike informale, rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimi i ujërave të zeza dhe të bardha, të bëhet bazuar në kushtet teknike të projektimit (KTP) në fuqi.

56. Linjat e ujësjellësit në rrugët me gjerësi 7 m dhe trotuar 1.5 m duhet të jenë 2 m larg vijës së ndërtimit.

57. Linja e kanalizimit për rrugët me gjerësi 7 m dhe trotuar 1.5 m duhet të jetë 6.6 m larg vijës së ndërtimit.

58. Linjat e ujësjellësit në rrugët me gjerësi 6 m dhe trotuar 1 m duhet të jetë 1.5 m larg vijës së ndërtimit.

59. Linja e kanalizimit për rrugët me gjerësi 6 m dhe trotuar 1 m duhet të jetë 6 m larg vijës së ndërtimit.

60. Në rrugët me gjerësi 5 m dhe trotuar 1 m, është e domosdoshme trasimi i linjës së ujësjellësit në njërin trotuar të rrugës dhe kanalizimeve në trotuarin tjetër të saj (KTP).

61. Në rast të kryqëzimit të tubacionit të ujësjellësit me tubacionin e kanalizimeve të ujërave të zeza, tubacioni i ujërave të zeza duhet të kalojë nën tubacionin e ujësjellësit dhe hapësira ndërmjet tyre të jetë jo më e vogël se 0,5 m (KTP).

62. Në rast se në zonat informale nuk ka mundësi të shkarkimit të ujërave të zeza në rrjet, këto shkarkime të trajtohen me gropa septike të përqendruara duke zbatuar KTP dhe KTZ në fuqi.

63. Në rast se gjendja ekzistuese e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimeve në zonat

informale nuk është në përputhje me KTP dhe KTZ, ndërmarrjet përkatëse të marrin masa për rikonstruimin e tyre sipas normave.


Modeli Nr. 1. Praqitja grafike e kufirit të zones informale ose studimit urbanistik pjesor  
Formati i vizatimit sipas standardeve ose shumefishit të tyre

<b>EMERTIMI I STUDIMIT SIPAS PERCAKTIMEVE NE KETE RREGULLORE</b> SHKALLA.....	<b>MIRATOHET</b>  <b>KRYETARI I K.RR.T.R. TE SHQPERISE</b>  <b>MINISTRI I BUJQESISE, USHQIMIT</b> <b>DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT</b> (kur territori eshte jasht vijes kufizuese te ndertimeve)  <b>KRYETARI I K.RR.T. TE NJESISE</b> <b>SE QEVERISJES VENDORE PERKATESE</b>
<b>POZICIONI KADASTRAL</b> SHKALLA .....	<b>FRAGMENT NGA STUDIMI URBANISTIK</b> <b>I RAJONIT, QYTIT OSE FSHATIT</b> SHKALLA .....
	<b>SKEMA E VENDOSJES NE RAPORT ME RAJONIN,</b> <b>QYTETIN OSE FSHATIN</b> (Ne rast se studimet e mesiperme nuk jane hartuar)
	Pergjegjesi i Zyres se Urbanistikes prane njesise se qeverisjes vendore
	Vula e plote e organit projektues te licensuar shteteror ose privat, personit fizik te licensuar qe ka bere studimin dhe ka pergatitur kete dokument.

Modeli Nr. 2. Praqitja grafike sheshit te ndertimit  
Formati i vizatimit sipas standarteve ose shumefishit te tyre

PLANIMETRIA E SHESHIT TE NDERTIMIT TE OBJEKTIT

SHKALLA.....




MIRATOHET

KRYETARI I K.R.R.T. TE NJESISE  
SE QEVERISJES VENDORE PERKATESE


POZICIONI KADASTRAL

SHKALLA.....



SKEMA E VENDOSJES SE SHESHIT  
NE STUDIMIN URBANISTIK PJESOR  
TE ZONES INFORMALE

SHKALLA.....



KONDITIONET URBANISTIKE.

Pergjegjesi i Zyres se Urbanistikes  
prane njesise se qeverisjes vendore


Vula e plote e organit projektues te  
licensuar shteteror ose privat, personit  
fizik te licensuar qe ka bere studimin  
dhe ka pergatitur kete dokument.

Modeli Nr.5. Praqitja grafike e infrastruktures inxhinierike ne sheshin e ndertimit  
Formati i vizatimit sipas standarteve ose shumefishit te tyre

**PLANIMETRIA E SHESHIT TE NDERTIMIT TE OBJEKTIT**

SHKALLA.....


INFRASTRUKTURA; NDERMARJET E UJESHELLESIT; KANALIZIMIT, ELEKTRIKUT, TELEKOMIT,  
INSPEKTORJATIT SANITAR SHETEROR TE RRETHIT, AGJENCIA RAJONALE E MBROJTJES SE MJEDISIT,  
NDERMARJA E MBROJTJES KUNDRA ZJARRIT.



**DREJTORI I NDERMARJES PERKATESE**

Shenime:.....  
firma, vula

**SKEMA E VENDOSJES SE SHESHIT**  
SHKALLA.....



Pergjegjesi i Zyres se Urbanistikes  
prane njesise se qeverisjes vendore

Vula e plote e organit projektues te  
licensuar shteteror ose privat, personit  
fizik te licensuar qe ka bere studimin  
dhe ka pergatitur kete dokument.

**UDHËZIM**  
**Nr.1, datë 20.8.2008**

**PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE, NGA ENTI  
KOMBËTAR I BANESAVE, PËR VITIN 2008**  
*(Ndryshuar me udhëzim të KM nr.2, datë 5.11.2008)*

*I përditësuar*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “dh” të nenit 34/1 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**UDHËZON:**

1. Kostoja mesatare e ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, në shkallë republike, për vitin 2008, të jetë 33 464 (tridhjetë e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë/m<sup>2</sup>, sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mesatare e apartamenteve, në tregun e lirë të banesave, sipas qyteteve, për vitin 2008, është sipas tabelave 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.

3. Për qytetet, për të cilat nuk është nxjerrë kostoja mesatare e ndërtimit, do të zbatohet kostoja e qytetit më të afërt, e përcaktuar në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

4. Për vlerën mesatare të apartamenteve në tregun e lirë, në zonat, që nuk përfshihen në tabelën 2, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi, nuk do të përdoret referimi në zonën më të afërt.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.139, faqe 6187*

*Udhëzim i KM nr.2, datë 5.11.2008 botuar në Fletoren Zyrtare nr.172, faqe 8470*

**TABELA NR.1**  
**KOSTOJA MESATARE E NDËRTIMIT PËR VITIN 2008**

Në vlerën e koston mesatare nuk janë përfshirë vlerat e:

1. rrjetit inxhinierik,
2. projektit,
3. studimit gjeologjik,
4. lejes së ndërtimit,
5. truallit,
6. shpenzimeve operacionale të EKB-së 4%.

Nr.	Qytetet	Çmimi për njësi (mesatare aritmetike)	
		Sip.shfrytëzimi	Sip.ndërtimi
1	Berat	33 187	27 450
2	Dibër	34 842	28 826
3	Durrës	35 195	29 108
4	Elbasan	31 532	26 081
5	Ersekë	33 544	27 742

6	Fier	33 499	27 710
7	Gramsh	32 096	26 551
8	Gjirokastër	33 876	28 024
9	Korçë	33 427	27 640
10	Krujë	33 228	27 490
11	Kavajë	33 526	27 736
12	Kuçovë	32 982	27 279
13	Kukës	35 494	29 366
14	Laç	32 739	27 082
15	Lezhë	33 745	27 906
16	Librazhd	31 805	26 307
17	Lushnjë	33 311	27 555
18	Burrel	33 539	27 744
19	Përrenjas	31 990	26 459
20	Peqin	31 945	26 425
21	Përmet	33 905	28 045
22	Pogradec	33 368	27 594
23	Pukë	33 961	28 092
24	Rrëshen	32 978	27 281
25	Çorovodë	33 552	27 759
26	Sarandë	33 387	27 617
27	Shkodër	33 830	27 981
28	Tepelenë	33 706	27 891
29	Bajram Curri	35 872	29 679
30	Tiranë	33 174	27 439
31	Vlorë	34 156	28 252
	Kostoja mesatare	33 464	27 681

V.O. Për qytetet që nuk janë përfshirë në listë, si kosto mesatare të merret kostoja mesatare e qytetit më të afërt.

**TABELA NR.2**  
**TË DHËNAT E TREGUT TË LIRË TË APARTAMENTEVE SIPAS QYTETEVE**  
**PËR VITIN 2008**

<b>Nr.</b>	<b>Qytetet</b>	<b>Kostoja mesatare e shitjes lek/m<sup>2</sup> sip.shfrytëzimi në tregun e lirë</b>
1	Tiranë	81 875
2	Vorë	45 000
3	Kamëz	44 000
4	Krrabë	24 505
5	Durrës	70 586
6	Kavajë	56 757
7	Shijak	42 000
8	Shkodër	49 540
9	Pukë	13 778
10	Laç-Vau i Dejës	24 000
11	Koplik	43 827
12	Fushë-Arrëz	8 157
13	Lezhë	48 475
14	Shëngjin	48 100
15	Vlorë	50 988
16	Orikum	49 000
17	Himare	50 000
18	Korçë	44 926
19	Pogradec	43 273
20	Bilisht	34 781
21	Ersekë	26 352
22	Maliq	29 589

23	Leskovik	20 838
24	Fier	55 062
25	Lushnjë	40 107
26	Ballsh	34 824
27	Patos	29 018
28	Divjakë	46 533
29	Roskovec	31 079
30	Berat	35 340
31	Kuçovë	24 460
32	Poliçan	18 633
33	Çorovodë	12 488
34	Ura Vajgurore	21 807
35	Elbasan	46 600
36	Librazhd	38 886
37	Cërrik	33 067
38	Gramsh	32 127
39	Peqin	37 399
40	Përrenjas	33 902
41	Rrogozhinë	37 000
42	Gjirokastër	53 731
43	Përmet	23 564
44	Sarandë	55 000
45	Delvinë	40 000
46	Tepelenë	15 940
47	Memaliaj	11 155
48	Këlcyrë	15 423
49	Konispol	30 000
50	Libohovë	29 000
51	Laç	41 876
52	Krujë	41 200
53	Fushë-Krujë	38 200
54	Mamurras	28 570
55	Milot	27 506
56	Rrëshen	43 000
57	Kukës	27 966
58	Tropojë	22 500
59	Krumë	28 833
60	Peshkopi	35 600
61	Burrel	27 700
62	Bulqizë	30 000

**TABELA NR.2**  
**TË DHËNAT E TREGUT TË LIRË TË APARTAMENTEVE PËR VITIN 2008**

**Qyteti i Tiranës**

<b>Nr.</b>	<b>Zonat</b>	<b>Vlera mesatare e shitjes lekë/m<sup>2</sup> sip.shfrytëzimi</b>
1	1/1	90 000
2	1/2	67 500
3	2/1	160 000
4	2/2	120 000
5	2/3	105 000
6	2/4	115 000
7	2/5	80 000
8	3/1	77 500
9	3/2	62 500
10	4/1	67 500
11	4/2	62 500
12	5/1	175 000
13	5/2	112 500
14	5/3	100 000

15	5/4	82 500
16	6	67 500
17	7/1	117 500
18	7/2	117 500
19	7/3	85 000
20	7/4	65 000
21	8/1	102 500
22	8/2	87 500
23	8/3	67 500
24	9/1	130 000
25	9/2	102 500
26	9/3	80 000
27	10/1	140 000
28	10/2	130 000
29	10/3	120 000
30	11/1	85 000
31	11/2	70 000
32	11/3	65 000

**UDHËZIM**  
**Nr.37, datë 20.11.2008**

**PËR PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE NGA PROCESI I LEGALIZIMIT**

Në mbështetje të nenit 32 dhe 43 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, Ministri i Financave

**UDHËZON:**

1. Të ardhurat e arkëtuara nga ALUIZNI në procesin e legalizimeve do të ndahen dhe përdoren si më poshtë:

a) Të ardhurat e arkëtuara nga transferimi i pronësisë së parcelës ndërtimore, sipas nenit 32 pika “a”, do të ndahen:

- 20% për buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore. Këto fonde njësitë e qeverisjes vendore do t’i përdorin këto të ardhura për investime në infrastrukturë e shërbime për zonën/bllokun me ndërtime të legalizuara dhe për sistemimin me banesë të familjeve të pastreha;

- 80% për Buxhetin e Shtetit dhe do të përdoren për fondin e kompensimit financiar, të parashikuar nga ligji nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

b) Të ardhurat e arkëtuara sipas pikës 1 të nenit 32, pra ato nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë, kalojnë për llogari të njësisë të qeverisjes vendore ku ndodhet objekti pa leje. Këto të ardhura përdoren për zhvillimin e infrastrukturës dhe urbanizimit të territoreve që legalizohen.

c) Të ardhurat e arkëtuara sipas nenit 43, i kalojnë plotësisht njësisë të qeverisjes vendore.

d) Të gjitha të ardhurat e arkëtuara të vëna në dispozicion sipas pikave të mësipërme, njësitë e qeverisjes vendore duhet t’i përdorin vetëm sipas destinacionit të përcaktuar në ligj, por pas vendimit të këshillit përkatës.

2. Zyrat rajonale të ALUIZNI-t duhet të udhëzojnë qytetarët që të ardhurat për procesin e legalizimit, të derdhen në llogarinë e të ardhurave të degës përkatëse të thesarit.

3. Me arkëtimin e të ardhurave, të përcaktuar në nenet 32 dhe 43 të ligjit nr.9482 datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dega e thesarit të qendrës rajonale dhe zyra rajonale e ALUIZNI-t bëjnë aktrakordimin mujor, të cilit i bashkëlidhet lista e njësisë vendore ku ndodhet objekti informal (lista përpilohet në bazë të rakordimit të zyrës rajonale të ALUIZNI-t me njësitë vendore përkatëse).

Zyra rajonale e ALUIZNI-t do ta përcjellë një kopje të konfirmuar zyrtarisht nga dega përkatëse e thesarit të aktrakordimit dhe kërkesën për rritjen e autorizuar të fondeve buxhetore në



zyrën qendrore të ALUIZNI-t në Tiranë. Dega e thesarit të qendrës rajonale do të kryejë autorizimin në bazë të kërkesës së rritjes së autorizuar të konfirmuar zyrtarisht nga drejtori i përgjithshëm i Zyrës Qendrore të ALUIZNI-t.

Për fondet që shpenzohen nga njësitë vendore, kërkesa e rritjes së autorizuar të konfirmuar zyrtarisht nga Drejtori i Përgjithshëm i zyrës qendrore të ALUIZNI-t do të dërgohet në degët e thesarit të distriktit ku ndodhen njësitë vendore nga zyra përkatëse rajonale e ALUIZNI-t. Dega e thesarit të distriktit (jo e qendrës rajonale) do t'i akordojë fondet njësisë vendore sipas shumave të autorizuar në kërkesën e rritjes së autorizuar të konfirmuar zyrtarisht nga Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Qendrore të ALUIZNI-t.

4. Për të gjitha derdhjet e arkëtuara deri tani në llogaritë bankare të të ardhurave të degës së thesarit në distrikt (jo në qendrën e rajonit) do të bëhet aktrakordim (bashkëlidhur fotokopje të dokumentit bankar të derdhjes) me përfaqësuesin e zyrës rajonale të ALUIZNI-t. Aktrakordimi depozitohet në degën e thesarit të qendrës rajonale. Dega e thesarit e qendrës rajonale operon sipas procedurës së mësipërme.

MINISTRI I FINANCAVE  
**Ridvan Bode**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.177, datë 2.10.2008, faqe 8804*

**VENDIM**  
**Nr.515, datë 13.5.2009**

**PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE, TË MËNYRËS DHE KOHËS SË USHTRIMIT NGA ALUIZNI TË PËRGJEGJËSIVE TË ZYRAVE TË URBANISTIKËS DHE TË KËSHILLAVE TË QARQEVE, GJATË PROCEDURAVE TË LEGALIZIMIT TË OBJEKTEVE INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. ALUIZNI të kryejë procedurat e evidentimit në terren, të përgatisë raportin e gjendjes faktike dhe të shqyrtojë e t'i kualifikojë ndërtimet informale në të gjitha qarqet e vendit, për shkak të mosushtrimit, nga organet e njësisë të qeverisjes vendore, të përgjegjësive të parashikuara në nenin 10 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

2. ALUIZNI, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të kryejë evidentimin në terren të objekteve informale/objekteve me leje, me shtesë informale në objekt, si dhe të bëjë përditësimin e të dhënave të gjendjes ndërtimore dhe të hartojë procesverbalin e konstatimit të tipit A ose A1, sipas modeleve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Drejtoria rajonale e ALUIZNI-t, duke shfrytëzuar të dhënat e përfuara nga përditësimi dhe në përputhje me kriteret ligjore të miratuara për shqyrtimin dhe kualifikimin e objekteve informale/objekteve me leje, me shtesë informale në objekt, që legalizohen ose jo, vepron, si më poshtë vijon:

3.1. Përgatit hartën në shkallën 1:1000 deri në 1:5000, për zonën kadastrale/bllokun kadastral, ku ndodhen objektet informale/objektet me leje, me shtesë informale në objekt, ku të pasqyrohen:

- a) Sistemi rrugor i nivelit kombëtar e rajonal, ekzistues, i miratuar ose në proces miratimi;
- b) Infrastruktura inxhinierike;
- c) Territoret, që kanë mbrojtje të veçantë ligjore.

c) Situata e pronësisë mbi tokën;  
d) Studimet urbanistike, që parashikojnë ndërtime mbi 5 kate mbi troje private, brenda vijës kufizuese të ndërtimit, të miratuara deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

3.2. Plotëson, në bazë të gjendjes së pasqyruar në hartë, aktin e kualifikimit, të tipit A ose A1, sipas modeleve, që i bashkëlidhen këtij vendimi, duke i kualifikuar këto objekte:

- a) për legalizim;
- b) të përjashtuar nga legalizimi.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.80, datë 1.6.2009, faqe 3503*

**UDHËZIM**  
**Nr.3, datë 3.2.2010**

**PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, PËR VITIN 2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “dh” të nenit 34/1 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**UDHËZON:**

1. Miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, në shkallë republike, për vitin 2010, në masën 34 668 (tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë/m<sup>2</sup>, për sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave, sipas qyteteve, për vitin 2010, të jetë sipas tabelave nr.1, nr.2 e nr.3, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.

3. Për qytetet, për të cilat nuk janë nxjerrë vlerat e koston mesatare të ndërtimit, të merren vlerat e koston së ndërtimit të qytetit më të afërt, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

4. Vlerat mesatare të banesave në tregun e lirë nuk mund të përdoren për t’iu referuar zonave të afërta.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.15, faqe 494*

Tabela nr.1

## KOSTO MESATARE E NDËRTIMIT

Në këtë vlerë të koston mesatare nuk janë përfshirë vlerat e:

1. Rrjetit inxhinierik
2. Projektit
3. Studimit gjeologjik dhe sizmik
4. Lejes së ndërtimit
5. Truallit
6. Shpenzime operationale të EKB 4%

Nr.	Qyteti	Çmimi për njësi (mesatare arith.)	
		Sip.shfrytëzimi lekë/m <sup>2</sup>	Sip. ndërtimi lekë/m <sup>2</sup>
1	Berat	35,600	29,437
2	Dibër	34,985	28,938
3	Durrës	35,059	29,005
4	Elbasan	32,556	26,942
5	Ersekë	35,573	29,421
6	Fier	34,222	28,321
7	Gramsh	33,208	27,491
8	Gjirokastrë	34,767	28,751
9	Korçë	33,949	28,081
10	Krujë	34,287	28,360
11	Kavajë	33,565	27,771
12	Kuçovë	35,697	29,520
13	Kukës	36,555	30,240
14	Laç	34,380	28,436
15	Lezhë	35,265	29,166
16	Librazhd	33,069	27,359
17	Lushnjë	33,357	27,599
18	Mat	34,713	28,709
19	Prrrenjas	34,385	28,438
20	Peqin	32,844	27,165
21	Përmet	34,679	28,676
22	Pogradec	34,660	28,665
23	Pukë	36,794	30,435
24	Rrëshen	35,753	29,581
25	Skrapar	35,033	28,973
26	Sarandë	34,919	28,881
27	Shkodër	35,408	29,291
28	Tepelenë	33,764	27,939
29	Tropojë	36,648	30,321
30	Tiranë	34,260	28,333
31	Vlorë	34,777	28,772
	KOSTO MESATARE	34,668	28,678

V.O: Për qytetet të cilat nuk janë përfshirë në listë të merret kosto mesatare e qytetit më të afërt.

Tabela nr.2

## LISTA E QYTETEVE PËR ÇMIMET E TREGUT TË LIRË PËR VITIN

Nr.	Qytetet	Çmimi mesatar i shitjes lekë/m <sup>2</sup> sip.shfrytëz.
1	Tiranë	84750
2	Vorë	50000
3	Kamëz	49980
4	Durrës	73968
5	Kavajë	58327
6	Shijak	43794
7	Shkodër	51405
8	Pukë	13290
9	Laç-Vau Dejës	26350
10	Koplik	39256
11	Fushë-Arrëz	6922
12	Lezhë	52200
13	Vlorë	59101
14	Orikum	48600
15	Himarë	53400
16	Korçë	45500
17	Pogradec	46057
18	Bilisht	35680
19	Ersekë	24959
20	Maliq	29406
21	Leskovik	20243
22	Fier	56094
23	Lushnjë	41202
24	Ballsh	34800
25	Patos	31692
26	Divjakë	46671
27	Roskovec	36772
28	Berat	37281
29	Kuçovë	32672
30	Polican	20848
31	Çorovodë	15946
32	Ura Vajgurore	29750
33	Elbasan	48984
34	Librazhd	42240
35	Cërrik	39658
36	Gramsh	38666
37	Peqin	39796
38	Prenjas	38650
39	Rrogozhinë	37000
40	Gjirokastër	48035
41	Përmet	27456
42	Sarandë	49500
43	Delvinë	39800
44	Tepelenë	20260
45	Memaliaj	9340
46	Këlcyrë	23250
47	Konispol	34170
48	Libohovë	29400
49	Laç	40552
50	Krujë	52230
51	Fushë-Krujë	52230
52	Mamurras	27247
53	Rrëshen	39193
54	Kukës	34030
55	Tropojë	27300
56	Krumë	27060

57	Peshkopi	40410
58	Burrel	36860
59	Bulqizë	36610
60	Klos	35000
61	Sukth	41000
62	Belsh	34300
63	Selenicë	25200
64	Rubik	28000
65	Komuna Krrabë	24505
66	Komuna Shëngjin	52000
67	Komuna Milot	29481
68	Komuna Kashar	58200
69	Komuna Dajt	57000
70	Komuna Farkë	70000

Tabela nr.3

TË DHËNAT E TREGUT TË LIRË TË APARTAMENTEVE NË QYTETIN E TIRANËS  
PËR VITIN 2009

Nr.	Zonat	Çmimi mesatar i shitjes lekë/m <sup>2</sup> sip.shfrytëz.
1	1/1	90,000
2	1/2	68,000
3	2/1	170,000
4	2/2	123,000
5	2/3	105,000
6	2/4	110,000
7	2/5	74,500
8	3/1	78000
9	3/2	60,000
10	4/1	70,500
11	4/2	61,000
12	5/1	175,000
13	5/2	120,000
14	5/3	105,000
15	5/4	88,000
16	6	68,000
17	7/1	120,000
18	7/2	117,500
19	7/3	87,500
20	7/4	61,500
21	8/1	110,000
22	8/2	90,000
23	8/3	67,500
24	9/1	130,000
25	9/2	100,000
26	9/3	70,000
27	10/1	140,000
28	10/2	140,000
29	10/3	105,000
30	11/1	86,000
31	11/2	69,000
32	11/3	64,000

**VENDIM**  
**Nr.411, datë 19.5.2010**

**PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE TIPIN E FORMULARIT TË LEJES SË  
LEGALIZIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 28 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) lëshon lejen e legalizimit, për objektin /shtesën pa leje në ndërtime me leje, kur:

a) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është kryer vetëdeklarimi vullnetar brenda afatit ligjor;

b) objekti/shtesa pa leje në ndërtime me leje nuk ndodhet në kushtet e përjashtimit nga legalizimi, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar;

c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar;

ç) subjekti posedues ka shlyer pagesat e parashikuara në pikat 1, 2, 3 dhe 5 të vendimit nr.1180, datë 3.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit dhe mbledhjen e administrimit e të adhurave të procesit të legalizimit”, të ndryshuar.

2. Procedurat e pajisjes me leje legalizimi, për objektet informale/shtesat pa leje në ndërtime me leje, të kualifikuara për legalizim, kryhen nga ALUIZNI.

3. Drejtoritë e ALUIZNI-t, pranë qarqeve, pas kualifikimit për legalizim të objekteve informale/shtesave pa leje në ndërtime me leje, veprojnë, si më poshtë vijon:

a) Publikojnë në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit, listën e poseduesve të objekteve informale/shtesave pa leje në ndërtime me leje, që kualifikohen për legalizim.

b) Hartojnë dokumentacionin teknik (genplan, planimetritë dhe fragmentin e fotografisë ajrore dixhitale).

c) Përllogarisin detyrimet financiare të objektit informal/shtesës pa leje në ndërtime me leje, që legalizohet, dhe njoftojnë poseduesit për shlyerjen e tyre.

ç) Pranojnë nga subjekti i interesuar dokumentacionin e përcaktuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar.

d) Lidhin kontratën e kalimit të së drejtës së pronësisë së parcelës ndërtimore, nga shteti te poseduesi i objektit informal/shtesës pa leje në ndërtim me leje, në përputhje me nenin 17 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar.

dh) Përcjellin pranë Drejtorisë Qendrore të ALUIZNI-t, dokumentacionin e objektit informal/shtesës pa leje në ndërtim me leje, për kryerjen e procedurave të certifikimit.

4. Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t kontrollon dhe certifikon dokumentacionin e dërguar nga drejtoritë pranë qarqeve, plotëson procesverbalin e certifikimit dhe lëshon lejen e legalizimit, për objektin informal/shtesën pa leje në ndërtime me leje.

5. Leja e legalizimit, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim, dërgohen pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nga drejtoritë e ALUIZNI-t, pranë qarqeve.

6. Për objektet informale/shtesat pa leje në ndërtime me leje, që përjashtohen nga procesi i legalizimit, drejtoritë e ALUIZNI-t, pranë qarqeve, i dërgojnë njoftim me shkrim poseduesve të tyre, si dhe organeve të njëjësive të qeverisjes vendore, ku këto objekte gjenden.

7. Formulari TIP i lejes së legalizimit është sipas modelit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Vendimi nr.871, datë 27.12.2006 i Këshillit të Ministrave “Për kriteret, procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit”, shfuqizohet.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.76, faqe 4019

NR. SERIAL: 180  
000 000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E LEGALIZIMIT URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE  
DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-T

### LEJE LEGALIZIMI

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/200\_\_

BAZUAR NË LIGJIN NR. 9482, DATË 03.04.2006  
"PËR LEGALIZIMIN, URBANIZIMIN DHE INTEGRIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE"

PËR OBJEKTIN : \_\_\_\_\_

I JEPET: \_\_\_\_\_

Emri \_\_\_\_\_ Adresa \_\_\_\_\_ Mbrojtja \_\_\_\_\_

Emri \_\_\_\_\_ Adresa \_\_\_\_\_ Mbrojtja \_\_\_\_\_

Emri \_\_\_\_\_ Adresa \_\_\_\_\_ Mbrojtja \_\_\_\_\_

ME ADRESË : \_\_\_\_\_

Në  zonën /  vendbanimin /  bllok banimin /  ndërtimin informal /  territore të tjera,  
e emërtuar ..... me Vendimin e K.RR.T.-së/ K.RR.T.R.SH.-së, Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/200\_\_.

**TË DHËNAT E OBJEKTIT:** ZONA KADASTRALE \_\_\_\_\_ NR.PASURISË \_\_\_\_\_

Sipërfaqja e parcelës ndërtimore: \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>

Sipërfaqja e ndërtimit: \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>

Sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup> / për aktivitet \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>

Numri i kateve: mbi tokë \_\_\_\_\_ ; nën tokë \_\_\_\_\_

Kondicione të veçanta: \_\_\_\_\_

#### KUFITARËT E PRONËS:

Veriu: \_\_\_\_\_

Jugu: \_\_\_\_\_

Lindja: \_\_\_\_\_

Perëndimi: \_\_\_\_\_

TË DHËNAT E MËSIPËRME JANË SIPAS GEN-PLANIT DHE PLANIMETRIVE BASHKËNGJITUR.

**TITULLI I PRONËSISË MBI TOKËN I VËRTETUAR ME DOKUMENTIN:**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit

Drejtori

KY DOKUMENT PLOTËSOHET NË TRË KOPJE DHE SË BASHKU ME GEN PLANIN DHE PLANIMETRITË TË OBJEKTIT. ËSHTË I VLEFSHËM PËR REGJISTRIM NË ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME.

**LIGJ**  
**Nr.10 112, datë 9.4.2009**

**PËR ADMINISTRIMIN E BASHKËPRONËSISË NË NDËRTESAT E BANIMIT**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

**Qëllimi**

